

Gjykata Themelore e Prishtinës

Rasti Nr. PKR 375/14

1 shkurt 2018

Aktgjykimi i publikuar mund të mos jetë i formës së prere dhe mund të jetë objekt i ankesës në baze të ligjit të aplikueshëm.

Në emër të popullit

Gjykata Themelore e Prishtinës, në trupin gjykues të përbërë nga:

Gjyqtarja e EULEX-it Anna Adamska – Gallant, si kryetare e trupit gjykues;

Gjyqtarja Suzana Qerkini dhe gjyqtari i EULEX-it Vladimir Mikula, si anëtarë të trupit gjykues;

Të ndihmuar nga Zyrtari Ligjor i EULEX-it Murlan Prizreni, si cili vepron si procesmbajtës;

Në çështjen penale kundër të akuzuarit:

N.K.; emri i babës..; i lindur më...në..Kosovë; qytetar i..dhe i..,

I akuzuar sipas Aktakuzës PPS Nr. 42/13 të ushtruar pranë gjykatës nga Prokurori i EULEX-it pranë Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, Andrew Hughes, më 7 korrik të vitit 2013 me:

- a) dy pika të aktakuzës për krim të organizuar, në kundërshti me nenin 274 të Kodit Penal të Kosovës të vitit 2003 (në tekstin e mëtejshëm: KPK-së) – pikat 1 dhe 3 të aktakuzës;
- b) një pikë të aktakuzës për vrasje të rendë, në kundërshti me nenin 147 të KPK-së

– pika 2 e aktakuzës;

c) katër pika të aktakuzës për posedim të paautorizuar me dashjen për të shitur ose shpërndarë dhe/ose eksportuar/importuar narkotikë të rrezikshëm, në kundërshti me nenin 229, paragrafët 1,2, dhe 3 të KPK-së – pikat 4,5, 6 dhe 7 të aktakuzës;

d) një pikë të aktakuzës për posedim të paautorizuar me dashjen për të shitur ose shpërndarë dhe/ose eksportuar/importuar narkotikë të rrezikshëm në kundërshti me nenin 228 paragrafët 1,2, dhe 3 të KPK-së – pika 8 e aktakuzës;

e) një pikë të aktakuzës për prodhim dhe përpunim të paautorizuar të narkotikëve të rrezikshëm dhe substancave psikotropike, në kundërshti me nenin 230 të KPK-së

– pika 9 e aktakuzës; pas shqyrtimit gjyqësor të mbajtur publikisht, në

praninë e Prokurorit të EULEX-it Andrew Hughes, të akuzuarit N.K. dhe

mbrojtësit të tij B.B.; më datat: 3, 30 dhe 31 maj 2017, 1, 2, 27 dhe 28

qershor 2017, 29 dhe 31 korrik 2017, 1, 2 dhe 3 gusht 2017, 11, 12, 13, 14

dhe 15 shtator 2017, 2, 3, 4, 5, 6 dhe 30 tetor 2017,

1 dhe 18 nëntor 2017, 18, 19, 29, 30 dhe 31 janar 2018, pas këshillimit dhe votimit të

trupit gjykues të mbajtur më 31 janar të vitit 2018, në praninë e prokurorit të EULEX-it

Andrew Hughes, të akuzuarit N.K. dhe mbrojtësit

të tij B.B.,

sipas nenit 359 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës (në tekstin e

mëtejme: KPP-së), shpallë këtë:

AKTGJYKIM

- I. N.K. shpallet fajtor për këtë vepër penale, e cila ka qenë objekt i pikës 8 të aktakuzës: në korrik/gusht të vitit 2003 në Sarajevë, Bosnjë dhe Hercegovinë, duke vepruar në mënyrë të paautorizuar dhe së bashku me një njeri që në këtë procedurë është quajtur K2 dhe me tre burra të tjerë të paidentifikuar, me qëllimin për të kryer vepër penale, ka vënë në qarkullim 25 kg të një substance që ka përbërë narkotikë veçanërisht të rrezikshëm, gjegjësisht heroinë, në atë mënyrë që e ka autorizuar K2-shin që ta vozisë automjetin Volkswagen Caddy në Austri me 25 kg të substancës së lartpërmendur të fshehur në tavanin e veturës të ndryshuar për këtë qëllim, e cila substancë është marrë pastaj nga njerëz të paidentifikuar pas arritjes së K2 në Austri, ndërsa ky akt, sipas nenit 3, paragrafit 2 të KPK-së, klasifikohet si vepër penale sipas nenit 245, paragrafëve 1 dhe 2 të Ligjit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (në tekstin e mëtejshëm: LPJ-së), sipas formulimit të tij që ka hyrë në fuqi më 1 korrik të vitit 1977, duke marrë parasysh se të gjitha këto dispozita kanë mbetur në fuqi sipas paragrafit 1.1 (b) të Rregullores 1999/24 të Misionit të Përkohshëm të Administratës së Kombeve të Bashkuara në Kosovë të datës 12 dhjetor 1999, dhe për këtë krim, sipas nenit 245, paragrafit 2 të LPJ-së, ai dënohet me 6 (gjashtë) vite burgim;
- II. Sipas nenit 364, paragrafit 1, nënparagrafit 1.3 të KPP-së, N.K. lirohet nga akuzat në vijim:
- a) akuza nën pikën 1 të aktakuzës, e cila është klasifikuar si krim i organizuar sipas nenit 274, paragrafëve 1,3, dhe 7 të KPK-së dhe e cila është përshkruar në këtë mënyrë:
- “N.K., në bashkëkryerje me 12 persona të paidentifikuar dhe me të tjerë, e ka organizuar, themeluar, mbikëqyrur, menaxhuar dhe/ose drejtuar këtë grup

kriminal të organizuar dhe strukturuar ose ka marrë pjesë aktive në këtë grup kriminal të organizuar duke e ditur se pjesëmarrja e tij do t'i kontribuonte kryerjes së veprës së rëndë të vrasjes së rëndë kundër bosit gangster rival, R.D. për të përfituar, në mënyrë direkte apo indirekte, dobi financiare apo dobi pasurore tjetër”, që pretendohet se është kryer gjatë viteve 2006-2007, në Sarajevë, Bosnjë dhe Hercegovinë;

- b)** akuza që është përshkruar në pikën 2 të aktakuzës dhe që është klasifikuar si vrasje e rëndë, sipas nenit 147, paragrafëve 3 dhe/ose 5 të KPK-së dhe që është përshkruar në këtë mënyrë:

“N.K., nëpërmjet një grupi kriminal të organizuar dhe të strukturuar siç është theksuar në pikën 1, e ka organizuar vrasjen e R.D. dhe si rrjedhojë e ka privuar viktimën nga jeta e tij në një mënyrë mizore dhe mashtruese; dhe/ose e ka privuar R.D. nga jeta e tij duke vepruar në mënyrë të pamëshirshme dhe të dhunshme; dhe/ose e ka privuar R.D. nga jeta e tij me qëllimin për të përfituar dobi pasurore”, që pretendohet se është kryer në vitin 2007, në Sarajevë, Bosnjë dhe

Hercegovinë;

- c)** akuza që është përshkruar në pikën 3 të aktakuzës, që është klasifikuar si krim i organizuar sipas nenit 274, paragrafëve 1, 3, dhe 7 të KPK-së, dhe që është përshkruar në këtë mënyrë:

“N.K., në bashkëkryerje me K1, K2, K3 dhe 6 persona të paidentifikuar dhe me të tjerë e ka organizuar, themeluar, mbikëqyrur, menaxhuar dhe/ose drejtuar këtë grup kriminal të organizuar kur i ka kryer veprat penale sipas

pesë pikave të aktakuzës për posedim të paautorizuar me dashjen për të shitur apo shpërndarë narkotikë të rrezikshëm; pesë pikave të aktakuzës për shitje të narkotikëve të rrezikshëm: dhe/ose pesë pikave të aktakuzës për eksportim/importim të narkotikëve të rrezikshëm dhe një pikë të aktakuzës për prodhim dhe përpunim të paautorizuar të narkotikëve të rrezikshëm midis Turqisë dhe shteteve evropiane”, që pretendohet se është kryer së paku nga viti 2000 deri në vitin 2012, në

Holandë, Ballkan dhe Turqi;

- d) akuza që është përshkruar në pikën 4 të aktakuzës dhe që është klasifikuar si blerje, posedim, shpërndarje ose shitje e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe substancave psikotropike, në kundërshti me nenin 229, paragrafët 1, 2 dhe 3 të KPK-së, dhe që është përshkruar në këtë mënyrë:

“N.K., në bashkëkryerje me të tjerë, duke përfshirë pjesëtarët e grupit kriminal të organizuar të tij që janë renditur në pikën 3 të aktakuzës, ka transportuar or dorëzuar dhe/ose ka eksportuar/importuar pa autorizim dhe me dashjen për të shitur ose shpërndarë substanca që me ligj janë shpallur si narkotikë të rrezikshëm, gjegjësisht 50 kilogramë heroinë, ndërsa N.K. e ka kryer këtë krim duke vepruar si anëtar i grupit të lartpërmendur”, që pretendohet se është kryer në shkurt të vitit 2003 në Rozhajë, Mal të Zi;

- e) akuza që është përshkruar në pikën 5 të aktakuzës, e cila është klasifikuar si blerje, posedim, shpërndarje ose shitje e paautorizuar narkotikëve të rrezikshëm dhe substancave psikotropike, në kundërshti me nenin 229 paragrafët 1, 2 dhe 3 të KPK-së, dhe që është përshkruar në këtë mënyrë:

“N.K., në bashkëkryerje me të tjerë, duke përfshirë pjesëtarët e grupit kriminal të organizuar të tij që janë renditur në pikën 3 të aktakuzës, ka mbajtur në posedim të paautorizuar, me dashjen për të shitur ose shpërndarë, transportuar apo dorëzuar dhe/ose eksportuar/importuar, substanca që me ligj janë shpallur si narkotikë të rrezikshëm, gjegjësisht 50,000 tableta “ekstazi”, ndërsa N.K. e ka kryer këtë krim duke vepruar si anëtar i grupit të lartpërmendur”, që pretendohet se është kryer në fillim të vitit 2003, përderisa vendi i kryerjes së veprave të lartpërmendura nuk është saktësuar në aktakuzë, edhe

pse është treguar se droga është transferuar nga Bosnja në Turqi;

- f) akuza që është përshkruar në pikën 6 të aktakuzës, që është klasifikuar si blerje, posedim, shpërndarje ose shitje e paautorizuar narkotikëve të rrezikshëm dhe substancave psikotropike, në kundërshti me nenin 229 paragrafët 1, 2 dhe 3 të KPK-së dhe që është përshkruar në këtë mënyrë:

“N.K., në bashkëkryerje me të tjerë, duke përfshirë pjesëtarët e grupit kriminal të organizuar të tij që janë renditur në pikën 3 të aktakuzës, ka mbajtur në posedim të paautorizuar, me dashjen për të shitur ose shpërndarë; transportuar apo dorëzuar dhe/ose eksportuar/importuar substanca që me ligj janë shpallur si narkotikë të rrezikshëm, gjegjësisht 100,000 tableta “ekstazi”, ndërsa N.K. e ka kryer këtë krim duke vepruar si anëtar i grupit të lartpërmendur”, përderisa vendi dhe koha e kryerjes së veprave të lartpërmendura nuk janë saktësuar në aktakuzë, edhe pse është treguar se tabletat janë transportuar në vitin 2003 nga Sarajeva, Bosnja, në Turqi;

g) akuza që është përshkruar në pikën 7 të aktakuzës, e cila në aktakuzë është klasifikuar si blerje, posedim, shpërndarje ose shitje e paautorizuar narkotikëve të rrezikshëm dhe substancave psikotropike në kundërshti me nenin 229 paragrafët 1, 2 dhe 3 të KPK-së; që është përshkruar në këtë mënyrë:

“N.K., në bashkëkryerje me të tjerë, duke përfshirë pjesëtarët e grupit kriminal të organizuar të tij që janë renditur në pikën 3 të aktakuzës, ka mbajtur në posedim të paautorizuar me dashjen për të shitur ose shpërndarë, transportuar apo dorëzuar dhe/ose eksportuar/importuar substanca që me ligj janë shpallur si narkotikë të rrezikshëm, gjegjësisht 25 kilogramë heroinë nga Turqia në Bosnjë dhe Hercegovinë, ndërsa i pandehuri N.K. e ka kryer këtë krim duke vepruar si anëtar i grupit të lartpërmendur, përderisa koha e kryerjes së veprave të lartpërmendura nuk është saktësuar në aktakuzë;

f)akuza që është përshkruar në pikën 9 të aktakuzës, e cila në aktakuzë është klasifikuar si prodhim dhe përpunim të paautorizuar të narkotikëve të rrezikshëm dhe substancave psikotropike në kundërshti me nenin 230

paragrafët d 1, 2 dhe 3 të KPK-së, që është përshkruar në këtë mënyrë:

“N.K., në bashkëkryerje me të tjerë, duke përfshirë pjesëtarët e grupit kriminal të organizuar të tij që janë renditur në pikën 3 të aktakuzës, ka kultivuar, prodhuar, përpunuar, ekstraktuar apo përgatitur, pa autorizim, substanca që janë shpallur narkotikë të rrezikshëm me dashjen për t'i shitur, shpërndarë apo ofruar ato për shitje dhe/ose për të shitur ose furnizuar pajisje

apo materiale duke qenë në dijeni se ato janë përdorur ose do të përdoren për kultivimin, prodhimin apo trafikimin e paligjshëm të ndonjë substance apo preparati që është shpallur si narkotik i rrezikshëm, gjegjësisht përafërsisht 2.5 tonë të acidit acetik anhidrid, ndërsa N.K. e ka kryer këtë krim duke vepruar si pjesëtar i grupit të lartpërmendur”, e cila që pretendohet se është kryer në verën e vitit 2003 në Sarajevë, Bosnjë dhe Hercegovinë, sepse nuk është provuar se N.K. i ka kryer veprat e lartpërmendura;

- III. Sipas nenit 50, paragrafit 1 të LPJ-së, periudha e privimit të N.K nga liria nga 13 maji i vitit 2013 deri më 27 qershor të vitit 2017 do të llogaritet për dënimin me burgim që i është shqiptuar atij;
- IV. Sipas nenit 453, paragrafit 3 të KPP-së, N.K. do ta paguajë një pjesë të shpenzimeve të procedurës penale në paushallin prej 5000 (pesëmijë) eurove, ndërsa çfarëdo shpenzimi tjetër i mbetur i procedurës penale do të paguhet nga mjetet buxhetore të gjykatës.

Gjyqtarja e EULEX-it Anna Adamska - Gallant

Kryetare e trupit gjykues

Gjyqtari i EULEX-it Vladimir Mikula

Gjyqtarja Suzana Qerkini

Përmbajtja

<i>Pjesa 1 Historiku i procedurës</i>	10
<i>1.1. Hetimi</i>	10
<i>1.2. Aktakuza</i>	12
<i>1.2.1. Konfirmimi i aktakuzës</i>	21
<i>1.2.2. Çështja e bashkëkryerësve të paakuzuar</i>	22
<i>1.3. Aspektet procedurale të shqyrtimit gjyqësor</i>	23
<i>1.3.1. Ligji i zbatueshëm procedural</i>	23
<i>1.3.2. Kompetenca e Gjykatës Themelore të Prishtinës</i>	24
<i>1.3.3. Përbërja e trupit gjykues</i>	24
<i>1.3.4. Ndryshimi i trupit gjykues</i>	25
<i>1.3.5. Kohëzgjatja e shqyrtimit gjyqësor</i>	25
<i>1.3.6. Prania e palëve</i>	26
<i>1.3.7. Publiciteti i shqyrtimit gjyqësor</i>	27
<i>1.3.8. Metodat e regjistrimit – fjalë për fjalë /audio regjistrim</i>	28
<i>1.3.9. Përkthimi</i>	29
<i>1.3.10. Përdorimi i video linkut</i>	30
<i>1.3.11. Veçimi dhe bashkimi i procedurës</i>	33
<i>1.3.12. Pengesat ndaj gjyqimit të drejtë</i>	34
<i>Pjesa 2 Procedura e shqyrtimit të provave</i>	40
<i>2.1. Vërejtje e përgjithshme</i>	40
<i>2.2. Rendi i paraqitjes së provave</i>	40
<i>2.2. Procedura e shqyrtimit të provave dhe ndryshimi i përbërjes së trupit gjykues</i>	41
<i>2.3. Propozimet e palëve për prova</i>	41
<i>2.4. Dëshmitarët – problemet specifike</i>	46
<i>2.4.1. Dëshmitarët e mbrojtur</i>	46
<i>2.4.2. Dëshmitarët që kanë refuzuar të dëshmojnë dhe ta përfundojnë marrjen e tyre në pyetje</i>	47
<i>2.4.3. E drejta e dëshmitarit për të qëndruar pranë mbrojtësit</i>	48
<i>2.4.4. Dëshmitarët armiqësorë</i>	49
<i>2.4.5. Dëshmitarët bashkëpunues</i>	52
<i>2.4.6. Marrja në pyetje e dëshmitarëve</i>	54
<i>2.5. Lista e kingpinëve</i>	56

<i>Pjesa. 3 Konstatimet faktike përkitazi me akuzat për vrasje</i>	56
<i>3.1. Akuzat për vrasje – faktet që nuk janë kontestuar</i>	56
<i>3.2. Vërejtje e përgjithshme</i>	58
<i>3.3. Pozita e veçantë e S.T. në kompaninë “AVAZ”</i>	61
<i>3.4. Ndikimi në shkrimet e S.T.</i>	66
<i>3.5. Marrëdhëniet midis S.T. dhe F.R</i>	68
<i>3.6. Takimi i parë i N.K dhe S.T.</i>	69
<i>3.7. Njohja midis N.K, N.O., F.R., S.S.,Ek.L., M.A.G. dhe S.T</i>	70
<i>3.8. Takimet e “grupit të miqve ” në vende publike</i>	81
<i>3.9. Motivet për ta vrarë R.D</i>	89
<i>3.9.1. R.D. si luftëtar kundër drogës apo si gangster rival</i>	89
<i>3.9.2. Motivet private të F.R</i>	92
<i>3.9.2.1. Dokumentet për rolin e F.R. gjatë luftës</i>	95
<i>3.9.3. Incidenti në Turqi</i>	105
<i>3.9.4. Hakmarrja për vdekjen e S.L</i>	131
<i>3.9.5. Motivet e tjera</i>	145
<i>3.10. Kërcënimet dhe thirrjet telefonike midis R.D. dhe njerëzve të N.K.</i>	146
<i>3.11. Pajtimi midis N.K dhe R.D</i>	150
<i>3.12. Vrasja e tentuar e A.P.s</i>	158
<i>3.13. Përgatitjet për vrasjen</i>	160
<i>3.14. Dëshmitë e K4 dhe K5</i>	163
<i>3.15. Dëshmitë e M.J.K. M.J.K., M.Os. dhe B.Os</i>	185

Arsyetim

Pjesa 1 Historiku i procedurës

1.1. Hetimi

1. Më datën 19 shtator të vitit 2012, Prokuroria e Bosnjës dhe Hercegovinës ka nxjerrë urdhër për fillimin e hetimit kundër të pandehurit N.K. për shkak të

dyshimit të bazuar se N.K. ishte përfshirë në trafikimin e organizuar ilegal të narkotikëve dhe organizimin e vrasjes së R.D.

2. Më datën 18 shtator të vitit 2012, Gjykata e Bosnjës dhe Hercegovinës ia ka caktuar paraburgimin N.K dhe të tjerëve, sepse ka ekzistuar dyshimi i bazuar se ata i kishin kryer aktivitetet e lartpërmendura dhe gjykata kishte konkluduar se i pandehuri ishte arratisur dhe kishte ndërmarrë aktivitete të tjera për t'iu shmangur ndjekjes penale në Bosnjë dhe Hercegovinë. Në të njëjtën ditë është lëshuar një urdhër tjetër për lëshimin e një urdhërarresti ndërkombëtar ndaj të pandehurit.
3. I pandehuri është arrestuar më 6 maj të vitit 2013 nga Policia e Kosovës në Prishtinë, duke u bazuar në urdhërarrestin ndërkombëtar të lëshuar nga autoritetet boshnjake. Në mungesë të një marrëveshjeje për ekstradim midis Kosovës dhe Bosnjës dhe Hercegovinës, N.K. është liruar nga mbajtja në Policinë e Kosovës më 7 maj të vitit 2013.
4. Më datën 7 maj të vitit 2013, Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës (PSRK-ja) ka marrë aktvendim për fillimin e hetimit për veprat penale të njëjta që janë renditur në urdhërarrestin ndërkombëtar të lëshuar nga autoritetet boshnjake (tri akuza: krimi i organizuar në lidhje me trafikimin e drogës, vrasja e R.D. dhe trafikimi i drogës gjatë periudhës 2006-2009). Kjo ka rezultuar në arrestimin e pastaj mbajtjen e të pandehurit N.K. në paraburgim duke u bazuar në aktvendimin e marrë nga gjyqtari i EULEX-it.
5. Më datën 18 shtator të vitit 2013, prokurori i PSRK-së e ka zgjeruar hetimin duke i ndryshuar pretendimet faktike për t'i përfshirë aktivitetet në lidhje me trafikimin e drogës gjatë periudhës nga viti 1998 e deri më "sot".

1.2. Aktakuza

N.K. është akuzuar për veprat penale në vijim:

Pika 1 e aktakuzës: Krimi i organizuar, në kundërshti me nenin 274, paragrafët (1), (3) dhe (7) të KPK-së, sepse i pandehuri N.K., në bashkëkryerje me të tjerë (sipas nenit 23 të KPK-së), e ka organizuar, themeluar, mbikëqyrur, menaxhuar dhe/ose drejtuar këtë grup kriminal të organizuar dhe të strukturuar (GKO) apo ka marrë pjesë aktive në këtë GKO, duke e ditur se pjesëmarrja e tij do t'i kontribuonte kryerjes së veprës së rëndë të vrasjes së rëndë kundër bosit gangster rival, R.D. për të përfituar, në mënyrë direkte apo indirekte, dobi financiare apo dobi pasurore tjetër;

Pretendimet në mbështetje të kësaj pike të aktakuzës janë përmbledhur në aktakuzë në këtë mënyrë:

Në vitin 2006, i pandehuri N.K. ka marrë pjesë në një numër takimesh me F.R., E.L., M.A.G, S.S., N.O. dhe me gjasë me të tjerë në Sarajevë, Bosnjë dhe Hercegovinë. Pjesëmarrësit e këtyre takimeve e kanë formuar grupin kriminal të organizuar dhe të strukturuar për ta planifikuar vrasjen e bosit gangster rival, R.D. Si rezultat i këtyre takimeve të organizuara, i pandehuri N.K. e ka ofruar dhe pranuar përgjegjësinë për t'i identifikuar dhe angazhuar vrasësit që do ta ekzekutonin vrasjen e R.D. Vrasësi me përvojë S.R. dhe miku dhe bashkëpunëtori i ngushtë i tij, N.V. nga Serbia, janë angazhuar nga i pandehuri N.K. dhe pjesëtarët e grupit kriminal të organizuar të tij për ta përcjellë dhe vranë R.D. Më datën 27 korrik të vitit 2007, në Sarajevë, rreth orës 23:30, S.R, me ndihmën e N.V., kanë shtënë në R.D. shumë herë duke përdorur armë zjarri të ndryshme dhe

duke e vrarë atë. Pasi është kthyer tek shtëpia e prindërve të tij në Shabac/Serbi, S.R. dhe bashkëpunëtori i tij N.V. janë paguar së paku 100,000 euro nga N.K. dhe grupi kriminal i organizuar (“GKO”) i tij. Përveç mënyrës mizore dhe të dhunshme në të cilën është kryer kjo vrasje dhe për të cilën i pandehuri N.K. ose ka qenë në dijeni paraprakisht ose e ka llogaritur me shpërfillje, ai dhe grupi kriminal i organizuar i tij po ashtu ka përfituar dobi pasurore duke e eliminuar bosin gangster rival R.D., i cili po e pengonte rrjetin ndërkombëtar të trafikimit të drogës të cilin i pandehuri N.K. e kishte themeluar në Sarajevë dhe në tërë rajonin duke u dhënë organeve boshnjake të zbatimit të ligjit informata në lidhje me aktivitetet kriminale të të pandehurit N.K. Për më tepër, kjo vrasje është kryer si hakmarrje për vrasjen e S.L., për të cilën i pandehuri dhe GKO i tij përgjegjës e konsideronin R.D.

Pika 2 e aktakuzës: Vrasja e rëndë, në kundërshti me nenin 147, paragrafi (3) dhe/ose (5) i KPK-së, sepse i pandehuri N.K., nëpërmjet një grupi kriminal të organizuar dhe strukturuar, siç është theksuar në pikën 1 të aktakuzë, e ka organizuar vrasjen e R.D. dhe si rrjedhojë e ka privuar viktimën nga jeta e tij në mënyrë mizore dhe mashtruese (paragrafi 3); dhe/ose e ka privuar R.D. nga jeta e tij duke vepruar në mënyrë të pamëshirshme dhe të dhunshme (paragrafi 5); dhe/ose e ka privuar R.D. nga jeta e tij me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore (paragrafi 7); dhe/ose e ka privuar R.D. nga jeta e tij për shkak të hakmarrjes së paskrupullt ose motiveve të ulëta të tjera (paragrafi 9);

Pretendimet në mbështetje të kësaj pike të aktakuzës janë përmbledhur në aktakuzë në këtë mënyrë:

Në vitin 2006, i pandehuri N.K., nëpërmjet grupit kriminal të organizuar dhe strukturuar të tij në Sarajevë, Bosnjë dhe Hercegovinë, i ka urdhëruar dhe angazhuar S.R. dhe N.V. nga Serbia, për ta vrarë bosin gangster rival R.D., i cili e ka penguar veprimtarinë e organizuar të trafikimit të drogës të të pandehurit N.K. në Sarajevë dhe në mbarë rajonin duke i denoncuar vazhdimisht këto aktivitete publikisht. Më datën 27 qershor të vitit 2007, rreth orës 23:30, S.V. ka shtënë në viktimën R.D. përafërsisht 27 herë nga një armë zjarri automatike e markës Heckler & Koch e pastaj disa herë në kokën e R.D. për tu siguruar se kishte vdekur. I pandehuri N.K. dhe GKO i tij pastaj ua kanë paguar S.R. dhe N.V. së paku 100,000 euro për këtë vrasje. Kjo vrasje është urdhëruar dhe ekzekutuar, në mesin e arsyeve të tjera, edhe si hakmarrje ndaj vrasjes së S.L.

Pika 3 e aktakuzës: Krimi i organizuar, në kundërshti me nenin 274, paragrafët (1), (3) dhe (7) të KPK-së, sepse i pandehuri N.K., në bashkëkryerje (sipas nenit 23 të KPK-së) me të tjerë, e ka organizuar, themeluar, mbikëqyrur, menaxhuar dhe/ose drejtuar grupin kriminal të organizuar të tij për t'i kryer të pesë veprat penale të posedimit të paautorizuar me dashjen për të shitur apo shpërndarë narkotikë të rrezikshëm; pesë veprat penale të shitjes së narkotikëve të rrezikshëm; dhe/ose pesë veprat penale të eksportimit/importimit të narkotikëve të rrezikshëm dhe një veprë penale të prodhimit dhe përpunimit të paautorizuar të narkotikëve të rrezikshëm midis Turqisë dhe shteteve evropiane.

Akuzat në mbështetje të kësaj pike të aktakuzës janë përmbledhur në aktakuzë në këtë mënyrë:

Së paku nga viti 2000 deri në vitin 2012, N.K., si udhëheqës dhe drejtues i grupit kriminal të madh të organizuar dhe strukturuar në të cilin kanë qenë të përfshirë

K1 (menaxhues dhe përzierës i drogës për N.K.), K2 (i ka drejtuar dërgesat midis Turqisë, rajonit të Ballkanit dhe Holandës), K3 (shpërndarës i drogës në Beograd/Serbi), L.K. (menaxhues i shpërndarjes së drogës në Serbi dhe në shtetet e tjera evropiane), M.H. (shofer dhe truprojë), S.A. (shofer), Z.B. (automekanik, i cili ka krijuar ndarje të fshehta për drogë në vetura), H.K. (kontakt në Turqi), I.K. (kontakt në Turqi), A.Ka. (koordinator i ngarkesave të drogës) dhe të tjerë, e ka

menaxhuar dhe drejtuar blerjen, përgatitjen, transportimin, shitjen dhe shpërndarjen e sasive të mëdha të heroinës, ekstazisë, speed-it dhe drogave të tjera, si dhe pararendësit e drogave, siç janë acidi acetik anhidrid, nëpërmjet një rrjeti kriminal të organizuar dhe themeluar mirë. I pandehuri N.K. e ka bashkërenduar – nëpërmjet individëve të lartpërmendur dhe shumë të tjerëve – importimin/eksportimin e tonelatave të këtyre drogave të rrezikshme dhe ilegale nëpër ndarje të fshehta në veturë, siç janë ndarjet e modifikuara të veçanta në rezervuarët e karburantit, mobilet e zgavruara, bagazhet e rrejshme fundore, pemët, rrobat/tekstili dhe duke përdorur metoda të tjera. Nëpërmjet rrugëve të trafikimit të drogës të bashkërenduara mirë, dërgesa të mëdha me tableta ekstazi janë marrë në Holandë dhe janë transportuar në Bosnjë dhe Hercegovinë dhe Kosovë, ku janë ripaketuar dhe transportuar më tej për në Stamboll/Turqi, ku ekstazia është këmbyer për heroinë dhe droga të tjera. Droga që është marrë në Stamboll pastaj është transportuar prapa nëpërmjet Bosnjës dhe Hercegovinës dhe Kosovës dhe pastaj u është dorëzuar dhe shitur dilerëve dhe shpërndarësve në tërë Evropën.

Pika 4: Posedimi i paautorizuar me dashjen për të shpërndarë, shitur ose eksportuar/importuar narkotikë të rrezikshëm, në kundërshti me nenin 229,

paragrafët (1), (2), dhe (3) të KPK-së, sepse i pandehuri N.K., në bashkëkryerje (sipas nenit 23 të KPK-së) me të tjerë, duke përfshirë pjesëtarët e GKO të tij që janë përmendur me rend në pikën 3 të aktakuzës, ka poseduar, pa autorizim, sipas paragrafit (1), me dashjen për të shitur ose shpërndarë; sipas paragrafit (2), transportuar apo dorëzuar dhe/ose, sipas paragrafit (3), eksportuar/importuar substanca që me ligj janë shpallur si narkotikë të rrezikshëm, gjegjësisht 50 kilogramë heroinë, ndërsa i pandehuri e ka kryer këtë krim gjersa ka vepruar si pjesëtarë i grupit të lartpërmendur, sipas paragrafit (4.1).

Akuzat në mbështetje të kësaj pike të aktakuzës janë përmbledhur në aktakuzë në këtë mënyrë:

Përafërsisht në shkurt të vitit 2003, N.K. i është drejtuar K2 dhe ka kërkuar nga ai që të transportojë heroinë për të në Angli. K2 më në fund ka shkuar me aeroplan në Turqi, i ka marrë 50 kilogramë “heroinë të bardhë” nga një person i quajtur H.K., i ka fshehur në dy pako të mëdha me rroba dhe e ka aranzhuar transportimin e tyre në Tuzëll, në Bosnjë dhe Hercegovinë. Shoferi i K2, S.A., e ka transportuar pastaj “heroinën e bardhë” nga Tuzlla për në Sarajevë për t’ia dorëzuar pakot – siç e kishte udhëzuar H.K. – një personi të quajtur A.Ka. Pas pak kohe, A.Ka. ka kërkuar nga K2 që të vinte vetë në Sarajevë, ku K2 është takuar me A.Ka. dhe të pandehurin N.K., i cili e ka informuar K2 se 50 kilogramët e “heroinës së bardhë” që K2 sapo i kishte sjellë nga Turqia i përkisnin atij.

Pika 5 e aktakuzës: Posedimi i paautorizuar me dashjen për të shpërndarë, shitur dhe/ose eksportuar narkotikë të rrezikshëm, në kundërshti me nenin 229, paragrafët (1), (2) dhe (3) të KPK-së, sepse i pandehuri N.K., në bashkëkryerje me të tjerë (sipas nenit 23 të KPK-së), duke përfshirë pjesëtarët e tjerë të GKO që janë

përmendur me rend në pikën 3 të aktakuzës, ka poseduar, pa autorizim, sipas paragrafit (1), me dashjen për të shitur ose shpërndarë; sipas paragrafit (2), transportuar apo dorëzuar dhe/ose, sipas paragrafit (3), eksportuar/importuar substanca që me ligj janë shpallur si narkotikë të rrezikshëm, gjegjësisht 50,000 tableta “ekstazi”, ndërsa i pandehuri e ka kryer këtë krim duke vepruar si pjesëtar i grupit të lartpërmendur, sipas paragrafit (4.1).

Akuzat në mbështetje të kësaj pike të aktakuzës janë përmbledhur në aktakuzë në këtë mënyrë:

Pasi e ka kryer transportimin e 50 kilogramëve të drogës për rrjetin kriminal të organizuar të të pandehurit N.K., K2 ka rënë dakord në fillim të vitit 2003, nëpërmjet bashkëpunëtorit të të pandehurit N.K., A.Ka., që ta bashkërendonte transportimin e 50,000 tabletave “ektazi” në Turqi. Shoferi i K2, S.A., e ka bartur drogën nga Bosnja në Turqi në një ndarje të fshehur në rezervuar, të cilën e kishte ndërtuar mekaniku.

Pika 6 e aktakuzës: Posedimi i paautorizuar me dashjen për të shpërndarë, shitur ose eksportuar/importuar narkotikë të rrezikshëm, në kundërshti me nenin 229 paragrafëve (1), (2), dhe (3) të KPK-së, sepse i pandehuri N.K., në bashkëkryerje me të tjerë (sipas nenit 23 të KPK-së), duke përfshirë pjesëtarët e tjerë të GKO që janë përmendur me rend në pikën 3 të aktakuzës, ka poseduar, pa autorizim, sipas paragrafit (1), me dashjen për të shitur ose shpërndarë; sipas paragrafit (2), transportuar apo dorëzuar dhe/ose, sipas paragrafit (3), eksportuar/importuar substanca që me ligj janë shpallur si narkotikë të rrezikshëm, gjegjësisht 100,000 tableta “ekstazi”, ndërsa i pandehuri N.K. e ka kryer këtë krim duke vepruar si pjesëtar i grupit të lartpërmendur, sipas paragrafit (4.1).

Akuzat në mbështetje të kësaj pike të aktakuzës janë përmbledhur në aktakuzë në këtë mënyrë:

K2 e ka aranzhuar transportimin e 100,000 tabletave “ekstazi” për në Turqi në emër të të pandehurit N.K. Për ta siguruar ujdinë e tij, K2 e ka regjistruar banesën e gruas së tij në emrin e të K1 në emër të të pandehurit N.K. para se t’i merrte 100,000 pilulat për t’i dërguar në Turqi. Avokati A.P. e ka përgatitur dëftesën e borxhit që është nënshkruar nga palët. Pas dhënies së kësaj garancie, i pandehuri N.K. ka arritur me njerëzit e tij dhe me 100,000 tableta “ekstazi” në një garazhë në Sarajevë, ku mekaniku Z.B ia ka ndryshuar K2 rezervuarin e karburantit të Mercedesit të tij, duke ia ndërtuar një ndarje të veçantë për ta vënë drogën aty. Nën mbikëqyrjen e të pandehurit N.K., ekstazia është ngarkuar në Mercedesin e K2 e pastaj është dërguar në Turqi nga shoferi i besuar i K2, S.A.

Pika 7 e aktakuzës: Posedimi i paautorizuar me dashjen për të shpërndarë, shitur ose eksportuar/importuar narkotikë të rrezikshëm, në kundërshti me nenin 229, paragrafët (1), (2), dhe (3) të KPK-së, sepse i pandehuri N.K., në bashkëkryerje (sipas nenit 23 të KPK-së) me të tjerë, duke përfshirë pjesëtarët e tjerë të GKO që janë përmendur me rend në pikën 3 të aktakuzës, ka poseduar, autorizim, sipas paragrafit (1), me dashjen për të shitur ose shpërndarë; sipas paragrafit (2), transportuar apo dorëzuar dhe/ose, sipas paragrafit (3), eksportuar/importuar substanca që me ligj janë shpallur si narkotikë të rrezikshëm, gjegjësisht 25 kilogramë heroinë nga Turqia në Bosnjë dhe Hercegovinë, ndërsa i pandehuri N.K. e ka kryer këtë krim duke vepruar si anëtar i grupit të lartpërmendur, sipas paragrafit (4.1).

Akuzat në mbështetje të kësaj pike të aktakuzës janë përmbledhur në aktakuzë në këtë mënyrë:

Pasi i ka dërguar 100,000 tabletat e “ekstazisë” në Turqi, rezervuari i ndryshuar i Mercedesit të K2, në të cilin janë bartur tabletat e “ekstazisë”, është mbushur, sipas udhëzimeve të N.K dhe GKO të tij, me 25 kilogramë heroinë. Këtë heroinë S.A. e ka transportuar pastaj përsëri nga Turqia në Tuzëll/Bosnjë dhe Hercegovinë.

Pika 8 e aktakuzës: Posedimi i paautorizuar me dashjen për të shpërndarë, shitur ose eksportuar/importuar narkotikë të rrezikshëm, në kundërshti me nenin 228, paragrafëvt (1), (2) dhe (3) të KPK-së, sepse i pandehuri N.K., në bashkëkryerje (sipas nenit 23 të KPK-së) me të tjerë, duke përfshirë pjesëtarët e tjerë të GKO që janë përmendur me rend në pikën 3 të aktakuzës, ka poseduar, pa autorizim, sipas paragrafit (1), me dashjen për të shitur ose shpërndarë; sipas paragrafit (2), transportuar apo dorëzuar dhe/ose, sipas paragrafit (3), eksportuar/importuar substanca që me ligj janë shpallur si narkotikë të rrezikshëm, gjegjësisht, një dërgesë me heroinë, që vlerësohet se kanë qenë më shumë se 25 kilogramë, ndërsa i pandehuri N.K. e ka kryer këtë krim duke vepruar si anëtar i grupit të lartpërmendur, sipas paragrafit (4.1).

Akuzat në mbështetje të kësaj pike të aktakuzës janë përmbledhur në aktakuzë në këtë mënyrë:

Në verën e vitit 2003, K2 ka rënë dakord që ta vozisë nga Austria një automjet të veçantë VW Caddy për ta marrë atje një ceradë të madhe për kamion për të pandehurin N.K. Ndonëse K2 ka dyshuar se në automjetin VW Caddy ka pasur drogë, mekaniku i tij nuk ka arritur që të gjejë drogë në të. Pasi e ka vozitur

veturën për në Austria, K2 ka parë drogë duke u nxjerrë nga veshja e brendshme e tavanit të veturës në pako në formë katrori, të mbështjella me shirit izolues të lehtë. K2 e ka përshkruar këtë dërgesë si “sasi shumë më të madhe se ajo që e kam transportuar nga Turqia” (dërgesa e mëhershme i ka pasur 25 kilogramë heroinë). Kur K2 ka pyetur, dy burra shqiptarë që kanë qenë në vend të ngjarjes kanë konfirmuar se pakot kanë përmbajtur heroinë. Kur K2 e ka pyetur më vonë N.K. në Sarajevë lidhur me heroinën e fshehur në tavanin e VW Caddy, N.K. e ka konfirmuar se ai e kishte aranzhuar transferimin e kësaj droge.

Pika 9 e aktakuzës: Prodhimi dhe përpunimi i paautorizuar i narkotikëve të rrezikshëm, në kundërshti me nenin 230, paragrafëve (1), (2) dhe (3) të KPK-së, sepse i pandehuri N.K., në bashkëkryerje me të tjerë (sipas nenit 23 të KPK-së), duke përfshirë pjesëtarët e tjerë të GKO që janë përmendur me rend në pikën 3 të aktakuzës, ka kultivuar, prodhuar, përpunuar, ekstraktuar apo përgatitur, pa autorizim, sipas paragrafit (1), substanca që janë shpallur narkotikë të rrezikshëm me dashjen për t’i shitur dhe shpërndarë apo për t’i ofruar ata për shitje; sipas paragrafit (2), për ta shitur apo përpunuar një substancë analoge [siç është përkufizuar në paragrafin (6)] me dashjen për të shitur dhe shpërndarë apo ofruar për shitje dhe/ose, sipas paragrafit (3), për të furnizuar pajisje apo materiale duke qenë në dijeni se janë përdorur ose do të përdoren për kultivimin, prodhimin apo përpunimin e paligjshëm apo trafikimin e çfarëdo substance apo preparati që është shpallur narkotik i rrezikshëm, gjegjësisht përafërsisht 2.5 tonë të acidit acetik anhidrid, ndërsa i pandehuri e ka kryer këtë krim duke vepruar si pjesëtar i grupit të lartpërmendur, sipas paragrafit (4.1).

Akuzat në mbështetje të kësaj pike të aktakuzës janë përmbledhur në aktakuzë në këtë mënyrë:

Pasi K2 e ka sjellë ceradën e lartpërmendur të kamionit nga Austria në Sarajevë, i pandehuri N.K. e ka mbikëqyrur procesin e bartjes së mbi 2 tonëve të acidit acetik anhidrid nga një numër i madh e bucelave të kaltra nëpërmjet një gypi të bardhë në xhepat e fshehur të ndërtuar në ceradë, e cila ishte ndërtuar për ta mbuluar një kamion. Duke mos e ditur se çfarë substance ishte pompuar në xhepat e fshehur të ceradës, K2 e ka djegur dorën e vet kur e ka prekur acidin. Ky acid përdoret për procesin e “larjes” së heroinës për ta avancuar shkallën e pastërtisë së saj dhe për ta krijuar përfundimisht të ashtuquajturën “heroinë e bardhë”, formë kjo dukshëm më e koncentruar e kësaj droge. Kjo ceradë e mbushur me acid është transportuar pastaj në një lokacion të panjohur për K2, por, megjithatë, sipas të gjitha gjasave, në Turqi.

Citimi i dhënë më lart konsiston në akronimet dhe emrat e bashkëkryerësve të paakuzuar që në fillim janë përmendur me emra të plotë. Arsyet për këtë redaktim të aktakuzës do të shtjellohen në detaje në pjesën e mëtejme të këtij aktgjykimi.

1.2.1. Konfirmimi i aktakuzës

6. Shqyrtimi fillestar në këtë rast është mbajtur më 14 korrik të vitit 2014 para Malcolm Simmons-it, i cili ka vepruar në cilësinë e kryetarit të trupit gjykues. Në vend të caktimit të shqyrtimit të dytë, mbrojtjes i është dhënë mundësia që të paraqesë kërkesë për hedhje të aktakuzës dhe kundërshtim ndaj provave.
7. Më datën 14 gusht të vitit 2014, në emër të të akuzuarit janë paraqitur kundërshtime ndaj provave. Nuk është paraqitur asnjë kërkesë për hedhje të aktakuzës.
8. Me aktvendimin e marrë më datën 10 shtator 2014, kryetarja e trupit gjykues e ka refuzuar si të pabazuar kundërshtimin e mbrojtjes ndaj provave. Mbrojtja ka

ushtruar ankesë kundër këtij aktvendimi më 17 shtator të vitit 2014.

9. Më datën 17 tetor 2014, Gjykata e Apelit e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e mbrojtjes, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore është vërtetuar.

1.2.2. Çështja e bashkëkryerësve të paakuzuar

10. Më datën 02 shtator të vitit 2014, mbrojtësi i njërit nga bashkëkryerësit e paakuzuar, F.R., ka paraqitur *kërkesë për mjet të jashtëzakonshëm juridik për ta kundërshtuar përfshirjen e tij në aktakuzën kundër N.K.* Mbrojtësi ka argumentuar se F.R. kur nuk është dëgjuar në këtë rast as në cilësinë e dëshmitarit, as të të pandehurit dhe se janë shkelur të drejtat e tij në gjykim të drejtë dhe supozim të pafajësisë, meqë nuk i është dhënë mundësia që të dëgjohej apo ta paraqesë qëndrimin e tij përkitazi me provat në mbështetje të pretendimeve të prokurorit.
11. Mbrojtësi ka kërkuar nga gjykata që:
 - ta heqë çdo përmendje të të mbrojturit të tij nga aktakuza e ngritur kundër z. N.K.;
 - ta nxjerrë një njoftim publik se i mbrojturi i tij nuk është i dyshuar apo i pandehur në këtë rast; dhe
 - ta urdhërojë prokurorin që të hetojë nëse procedura në këtë rast është cenuar nëpërmjet sigurimit të provave të rrejshme apo lajthitëse dhe që, me këtë rast, t'ua bëjë me dije të gjithë dëshmitarëve përmbajtjen e nenit 392 të KPK-së.
12. Prokurori i PSRK-së i është përgjigjur kërkesës së bërë në parashtrësën e datës 9 shtator 2014. Ai ka argumentuar se kërkesa ka qenë e papranueshme për shkak të

mungesës së qëndrimit, meqë F.R. nuk ka qenë palë në këtë procedurë penale. Prokurori ka propozuar që gjykata t'i refuzojë kërkesat duke potencuar në mendimin e tij se në Kosovë ishte praktikë gjyqësore që në aktakuza të përfshiheshin bashkëkomplotistët e paakuzuar.

13. Më datën 2 dhjetor të vitit 2014 është mbajtur një seancë e mbyllur për të vendosur për kërkesën e mbrojtësit të F.R. Mbrojtësi i N.K e ka mbështetur, ndërsa prokurori e ka kërkuar refuzimin e saj.
14. Më datën 4 dhjetor 2014, kryetarja e trupit gjykues Anna Adamska-Gallant ka vendosur që prezantimi, citimi dhe publikimi i pikave të aktakuzës kundër të pandehurit N.K. do të bëhej edhe në të folur, edhe në të shkruar, pa i treguar emrat e personave që paraqiten si bashkëkonspiratorë të paakuzuar dhe që janë përmendur në përshkrimin e pikave të aktakuzës.
15. Në arsyetimin e aktvendimit të lartpërmendur, kryetarja e trupit gjykues ka bërë të ditur se praktika e përmendjes së emrave të bashkëkryerësve të paakuzuar ishte në kundërshti me parimet themelore të Konventës Evropiane të të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut.

1.3. Aspektet procedurale të shqyrtimit gjyqësor

1.3.1. Ligji i zbatueshëm procedural

16. Procedura penale kundër N.K është filluar më 12 maj të vitit 2013. Prandaj, sipas nenit 539 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës (KPP-së), ajo është zhvilluar sipas këtij ligji.

1.3.2. Kompetenca e Gjykatës Themelore të Prishtinës

17. Të gjitha pikat e aktakuzës u referoheshin veprave penale që pretendoheshin se ishin kryer jashtë territorit të Kosovës. Megjithatë, siç rezulton nga neni 115 (3) i Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPK-së), ligji penal i Kosovës zbatohet për çdo person është shtetas i Republikës së Kosovës, nëse ai person kryen veprë penale jashtë territorit të Republikës së Kosovës dhe nëse ky akt dënohet me ligj edhe në vendin ku është kryer vepra.
18. Trupi gjykues ka vërtetuar se të gjitha krimet për të cilat është akuzuar N.K. kanë qenë të dënueshme me ligj në shtetet ku pretendohet se janë kryer, se N.K. është qytetar i Kosovës, se vendbanimi i tij ka qenë jashtë Kosovës dhe se ai është arrestuar nga Policia e Kosovës në Prishtinë.
19. Si rregull e përgjithshme e cila është përcaktuar në nenin 11, paragrafin 1 të *Ligjit për Gjykatat*, Ligjit Nr. 03/L-199, kompetenca për t'i gjykuar të gjitha veprat penale në shkallë të parë i përket Gjykatës Themelore.
20. Sipas nenit 32, paragrafit 3 të KPP-së, në qoftë se nuk dihet vendi i kryerjes së veprës penale, as vendbanimi apo vendqëndrimi i të pandehurit ose nëse të dyja janë jashtë territorit të Kosovës, kompetente është gjykata në territorin e së cilës arrestohet i pandehuri ose në territorin e së cilës i pandehuri vetë u dorëzohet organeve. Prandaj, kompetente për ta gjykuar këtë rast në shkallë të parë ka qenë Gjykata Themelore e Prishtinës.

1.3.3. Përbërja e trupit gjykues

21. Rastin e ka hetuar Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës, prandaj, sipas nenit 3.1 të Ligjit Nr. 03/L-053 për Kompetencat, Përzgjedhjen e Lëndëve dhe

Caktimin e Lëndëve të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve të EULEX-it në Kosovë, kompetencë për këtë rast kanë gjyqtarët e EULEX-it.

22. Këshilli Gjyqësor i Kosovës ka vendosur se, për shkak të ndjeshmërisë së rastit, për të duhet të vendosë një trup gjykues i përbërë me shumicë të gjyqtarëve të EULEX-it dhe me një gjyqtar të EULEX-it si kryetar të trupit gjykues.

1.3.4. Ndryshimi i trupit gjykues

23. Më datën 11 prill 2017 është ndryshuar përmbajtja e trupit gjykues dhe gjyqtarja e EULEX-it Mariola Pasnik është zëvendësuar nga gjyqtari i EULEX-it Vladimir Mikula. Prandaj, sipas nenit 311 (1) të KPP-së, ka qenë e nevojshme që shqyrtimi gjyqësor të fillonte rishtas. Megjithatë, pasi i ka dëgjuar palët, trupi gjykues ka vendosur që të mos i merrte në pyetje dëshmitarët. Në shumicën e rasteve, palët janë pajtuar që t'i konsideronin ato si të lexuara, ndërsa është dashur të dëgjoheshin audio regjistrimet e deklaratave që i kanë dhënë dëshmitari K1 dhe dëshmitari K2.

1.3.5. Kohëzgjatja e shqyrtimit gjyqësor

24. Shqyrtimi gjyqësor ka filluar më 16 janar të vitit 2015. Megjithatë, siç u përmend më lart, për shkak të ndryshimit të përbërjes së trupit gjykues, ka qenë e nevojshme që të fillohej rishtas.
25. Seanca e parë e shqyrtimit gjyqësor në përbërjen e re të trupit është mbajtur më 3 maj të vitit 2018. Rasti është shqyrtuar gjatë 24 ditëve të gjykimit. Shqyrtimi gjyqësor ka përfunduar më 31 janar të vitit 2018.
26. Për shkak të kohëzgjatjes së konsiderueshme të dëshmive të dëshmitarëve të

prokurorisë, kohëzgjatja e shqyrtimit gjyqësor e ka kaluar periudhën e 120 ditëve kalendarike që është përcaktuar në nenin 314, paragrafin 1.2 të KPP-së. Në parim, të gjitha shtyrjet e urdhëruara nga trupi gjykues nuk i kanë tejkaluar 30 ditë dhe janë arsyetuar gjithmonë duke i treguar veprimet procedurale që është dashur të merren gjatë seancës së ardhshme. Ka ndodhur një herë që shtyrja ka qenë më e gjatë se 30 ditë (nëntor 2017 – janar 2018), por nuk i ka tejkaluar tre muaj. Prandaj, nuk ka pasur nevojë që gjykimi të fillohej rishtas.

27. Palët nuk kanë paraqitur kundërshtime ndaj kohëzgjatjes së gjykimit. Prandaj, sipas nenit 382, paragrafit 4 të KPP-së, është supozuar se kanë hequr dorë nga e drejta e paraqitjes së kundërshtimit.

1.3.6. Prania e palëve

28. Prokurori i EULEX-it në Prokurorinë Speciale të Republikës të Kosovës në Kosovë, Andrew Hughes, i akuzuari dhe mbrojtësi i tij B.B. kanë qenë të pranishëm gjatë të gjitha ditëve të gjykimit. Gjatë seancës së mbajtur më 28 qershor të vitit 2017, avokatja Al.Ke. e ka zëvendësuar mbrojtësin B.B. sipas procedurës.
29. E dëmtuara E.D. nuk është ftuar në procedurë gjatë hetimit dhe nuk ka dhënë ndonjë deklaratë në cilësinë e dëshmitares. Ajo është informuar sipas procedurës për gjykimin, të drejtat procedurale përkatëse të saj dhe mundësinë e mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor pa praninë e saj. Ajo është paraqitur në gjykatore vetëm në cilësinë e dëshmitares dhe nuk e ka shfrytëzuar të drejtën e saj si palë gjatë gjykimit.

1.3.7. Publiciteti i shqyrtimit gjyqësor

30. Në parim, gjykimi është mbajtur në gjykatë të hapur. Mediave u është lejuar që ta përcjellin dhe incizojnë procedurën.
31. Kanë qenë vetëm përjashtimet në vijim ndaj karakterit publik të gjykimit dhe atë vetëm gjatë seancave që janë mbajtur para ndryshimit të përbërjes së trupit gjykues:
 - a. Më 15, 16 dhe 17 shtator të vitit 2015, kur dëshmitari K6 ka dhënë dëshmi me qëllim të mbrojtjes së interesave private të tij;
 - b. Më 14, 15, 27 dhe 28 tetor të vitit 2015, kur dëshmitari K3 ka dhënë dëshmi me qëllim të mbrojtjes së interesave private të tij;
 - c. Më 11 nëntor të vitit 2015, kur dëshmitari B.Dj. ka dhënë dëshmi për rrethanat në lidhje me ndihmën mjekësore që ia ka dhënë I.B.;
 - d. Pjesërisht më 14, 15, 16 dhjetor të vitit 2015, kur dëshmitari K1 është caktuar për të dhënë dëshmi;
 - e. Më 13 dhe 18 janar të vitit 2016, kur dëshmitarja A.S. ka dhënë dëshmi me qëllim të mbrojtjes së interesave private të saj;
 - f. Më 27 janar të vitit 2016 – seanca është mbyllur kur është diskutuar propozimi i E.P. për ta përjashtuar publikun nga shqyrtimi gjyqësor;
 - g. Më 23, 24 dhe 25 shkurt të vitit 2016 – seanca është mbyllur për publikun kur kanë marrë pjesë J.Sh., Va.T. dhe Y.T., doktorë të Burgut të Sigurisë së Lartë në Podujevë, dhe R.S., Shef i Burgut të Sigurisë së Lartë në Podujevë;
 - h. Më 31 tetor të vitit 2016 – seanca është mbyllur për publikun kur janë diskutuar bisedat e përgjuara të F.R.;

- i. Më 11 nëntor të vitit 2016 – seanca është mbyllur për publikun kur K1 ka dhënë dëshmi për tentativën e pretenduar të mbrojtjes për të ushtruar ndikim në të;
- j. Më 24 janar të vitit 2017 – seanca është mbyllur kur K1 ka dëshmuar për kërcënimet e pretenduara nga prokurori në Bosnjë dhe Hercegovinë;
- k. Më 27 janar të vitit 2017 – seanca është mbyllur kur dëshmitari R.L. është udhëzuar që ta përdorë akronimin për dëshmitarin K2;
- l. Më 16 shkurt të vitit 2017 – seanca është mbyllur kur është diskutuar çështja e paraburgimit;
- m. Më 16 mars të vitit 2017 – seanca është mbyllur kur K2 i ka përshkruar diskutimet me prokurorin ndërkombëtar.

1.3.8. Metodat e regjistrimit – fjalë për fjalë /audio regjistrim

- 32. Sipas vendimit të kryetares së trupit gjykues, bazuar në nenin 315, paragrafët 2 dhe 5 të KPP-së, procesverballi i procedurës është mbajtur fjalë për fjalë në të shkruar. Koha e përdorur për përkthim ua ka mundësuar procesmbajtësve që t'i kuptojnë dhe shkruajnë saktësisht të gjitha fjalët e thëna në gjykatore.
- 33. Saktësia e procesverbalit është kontrolluar nga kryetarja e trupit gjykues atypëraty. Ekranin e kompjuterit në të cilin është shfaqur procesverballi është vendosur para saj. Kjo mënyrë e regjistrimit e ka bërë përdorimin e metodave të tjera të regjistrimit të tepërt, sepse ka pasur pak të ngjarë që me to të arrihej saktësi më e mirë e përmbajtjes semantike të procesverbalit.

34. Të gjitha seancat që kanë filluar nga 28 prilli i vitit 2015 janë audio regjistruar, çfarë e ka garantuar më tej saktësinë e procesverbalit. Kur ka pasur dyshime përkitazi me përmbajtjen e dëshmisë së dhënë nga dëshmitari, ajo është krahasuar me audio regjistrimin. Kjo metodë e verifikimit është përdorur për ta verifikuar saktësinë e procesverbalit të marrë gjatë seancave të shqyrtimit gjyqësor.
35. Audio regjistrimi i marrjes në pyetje të dëshmitarëve K1 dhe K2 para gjykatës është lëshuar pas shqyrtimit gjyqësor, i cili është rifilluar për shkak të ndryshimit të përbërjes së trupit gjykues. Me këtë rast, ka qenë po ashtu e mundur që të vërtetohej se procesverbali i marrë fjalë për fjalë ishte shumë i detajuar dhe i saktë.
36. Palëve u janë dorëzuar kopjet e audio regjistrimeve.

1.3.9. Përkthimi

37. Bazuar në nenin 16 të *Ligjit për Juridiksionin dhe Kompetencat e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve të EULEX-it në Kosovë*, gjuha që është përdorur në procedurën gjyqësore ka qenë anglishtja.
38. Përkthyesit e kanë përkthyer procedurën gjyqësore dhe të gjitha dokumentet e gjykatës që kanë qenë relevante për këtë gjykim nga gjuha angleze në gjuhën shqipe dhe anasjelltas. Për faktin se shumica e provave kanë qenë të shkruara së pari në gjuhën boshnjake/serbe, shumë dokumente është dashur që të përktheheshin nga njëra nga këto gjuhë në tjetrën.
39. Gjuhët zyrtare të seancave gjyqësore kanë qenë gjuha serbe, shqipe dhe angleze. Në shumicën e rasteve, dëshmitarët dhe i pandehuri kanë dhënë dëshmi në gjuhën serbe, të cilat janë përkthyer në gjuhën angleze në mënyrë konsektive.

Përveç kësaj, është ofruar edhe përkthim simultan në gjuhën shqipe. Vetëm gjatë disa seancave fillestare është ofruar përkthimi konsektiv i trefishtë: anglisht, serbisht dhe shqip, por një mënyrë e tillë e procedimit ka qenë tejet joefektive dhe e ka ngadalësuar gjykimin dukshëm. Prandaj, me pëlqimin e palëve, trupi gjykues ka vendosur që të vazhdonte vetëm me përkthimin konsektiv nga gjuha angleze në gjuhën serbe (apo nga gjuha angleze në gjuhën shqipe).

40. Kryetarja e trupit gjykues ka kërkuar nga folësit që t'i ndanin deklaratat e tyre në intervale, zakonisht çdo 1 deri në 3 minuta, dhe si parim në fund të mendimit të plotë, e pastaj përkthyesi ta përkthente atë që është thënë në gjuhën e përkthimit. Kjo metodë ua ka mundësuar palëve që ta kontrollonin saktësinë e përkthimit të të gjitha provave të marra në gjykatore. Në disa raste, palët kanë bërë vërejtje për cilësinë e përkthimit. Trupi gjykues i ka marrë në konsideratë të gjitha vërejtjet menjëherë, ndërsa sqarimi është shënuar në procesverbal.

41. Fjalët përfundimtare të palëve dhe shpallja e dispozitivit të aktgjykimit janë përkthyer në anglisht, shqip dhe serbisht në të njëjtën kohë.

1.3.10. Përdorimi i video linkut

Arsyeja

42. Shumica e dëshmitarëve në këtë rast kanë jetuar jashtë Kosovës. Prandaj, mënyra më efektive dhe më e shpejtë për t'i dëgjuar ka qenë që të përdorej video konferenca, sepse përndryshe do të kishte qenë e pamundur për ta që të vinin dhe dëshmonin para gjykatës në Kosovë.

43. Krahas kësaj, në rastin e dy dëshmitarëve K1 dhe K3, përdorimi i video konferencës është arsyetuar nga domosdoshmëria e sigurimit të sigurisë së tyre. Prania e tyre në gjykatore mund të kishte krijuar rrezik tejet të madh, jo vetëm për vetë dëshmitarët, por edhe për personat e tjerë të përfshirë në këtë gjykim. Kur ka vendosur për këtë, gjykata e ka vlerësuar të drejtën në gjykim publik, të drejtën në mbrojtje dhe barazinë e palëve, por edhe të drejtat personale të dëshmitarëve në siguri personale. Të drejtat e mbrojtjes janë matur kundrejt të drejtave të dëshmitarëve dhe sigurisë së tyre, si dhe kundrejt obligimit të shtetit për të vënë drejtësi. Gjykata e ka pranuar të drejtën e ballafaqimit të dëshmitarëve. Ndonëse ajo është komponent i rëndësishëm i një gjykimi të drejtë, nuk është e drejtë

absolute, pasi që siguria dhe mirëqenia e dëshmitarëve duhet të ruhet.

44.

Pajisjet

45. Falë kapacitetit teknik të video linkut, të gjithë pjesëmarrësit në procedurë kanë qenë në gjendje që të përfshiheshin në marrjen në pyetje të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë të dëshmitarëve dhe të paraqisnin prova në të njëjtën mënyrë që do të kishte ndodhur në gjykatore.

46. Pajisjet që janë përdorur për videokonferencë ua kanë mundësuar trupit gjykues dhe palëve në gjykatore që ta shihnin dëshmitarin të ulur në një lokacion të largët nga beli e lart. Dëshmitari ka mundur ta shihte personin që e ka marrë në pyetje me anë të kamerës së zmadhuar në fytyrën dhe në pjesën e sipërme të personit që i ka bërë pyetjet. Midis dëshmitarëve dhe personave në gjykatore është zhvilluar komunikim dydrejtimësh me zë në kohë reale. Tingulli është sinkronizuar me imazhin. Ka qenë një ekran 54 inçesh në gjykatore për palët dhe për trupin

gjkues. Ekranin është vendosur me pjesën e prapme të tij të kthyer kah publiku, kështu që publiku nuk ka mundur ta shohë personin që po merrej në pyetje, por vetëm ta dëgjojë.

47. Ka ndodhur disa herë që video linku është ndërprerë ose imazhi është ngrirë. Në një situatë të tillë, video linku është rivënë. Në disa raste të jashtëzakonshme ka ndodhur që marrja në pyetje të vazhdohej vetëm me zë. Megjithatë, kjo ka zgjatur shumë shkurt. Përveç kësaj, gjykatat e tjera ndërkombëtare kanë lejuar që dëshmitari të dëgjohej pa ia treguar fytyrën, çfarë natyrisht duhet të balancohet me të drejtën e të pandehurit në mbrojtje efektive dhe përfshin edhe të drejtën për t'i kundërshtuar dëshmitarët.

Asistenca në lokacionin e largët

48. Prania e gjyqtarëve (në rast të video linkave me gjykatat nga Bosnja dhe Hercegovinë, Serbia dhe Kroacia) dhe anëtarëve të personelit të gjykatës në lokacionin e largët në Kosovë e kanë garantuar identitetin e saktë të dëshmitarit dhe lirinë e tij apo të saj për të folur pa qenë nën trysni apo udhëzime të paligjshme. Asnjë person që ka ofruar asistencë nuk ka raportuar ndonjë ndodhi të tillë. Roli i gjyqtarëve dhe zyrtarëve ligjorë po ashtu ka qenë që ta konfirmonin identitetin e dëshmitarit dhe t'ia paraqisnin dëshmitarin eksponatin e përdorur si provë po që se ishte e nevojshme.
49. Ka ndodhur që gjyqtarët në gjykatat e juridiksioneve të huaja janë larguar nga gjykatorja gjatë seancës për një kohë të shkurtër, por edhe atëherë ndonjë zyrtar i gjykatës gjyqësor ka qenë i pranishëm me dëshmitarin, çfarë e ka garantuar kahjen e duhur të marrjes në pyetje.

Kundërshtimi i mbrojtjes

50. Përderisa mbrojtësi nuk e ka kontestuar faktin se shumica e dëshmitarëve është dashur të dëgjoheshin nëpërmjet video linkut, për shkak të vendbanimit të tyre jashtë Kosovës, ai e ka kundërshtuar fuqishëm propozimin e prokurorit të paraqitur gjatë seancës së shqyrtimit gjyqësor për t'i dëgjuar dëshmitarët K1 dhe K3 nga lokacioni i largët. Mbrojtja ka pretenduar se i akuzuari do të privohej nga e drejta e tij për t'i kundërshtuar drejtpërsëdrejti dëshmitarët që kanë dhënë dëshmi kundër tij dhe se, si rezultat i kësaj, e drejta e tij në gjykim të drejtë nuk do të respektohej.
51. Me urdhrin e datës 14 tetor të vitit 2015, kryetarja e trupit gjykues ka vendosur që të gjithë dëshmitarët të japin dëshmi me anë të videokonferencës.

1.3.11. Veçimi dhe bashkimi i procedurës

52. Në fazën e fundit të shqyrtimit gjyqësor, me aktvendimin e marrë më datën 3 tetor të vitit 2017, gjykata ka vendosur që ta veçoj rastin, i cili ka konsistuar në dy grupe të ndara të akuzave: i pari kishte të bënte me vrasjen e R.D. (pikat 1 dhe 2 të aktakuzës), ndërsa i dyti me akuzat për drogë (pikat 3 – 9 të aktakuzës). Të gjitha provat në lidhje me akuzat për vrasje (pikat 1 dhe 2 të aktakuzës) tashmë ishin paraqitur, ndërsa ende kishte prova që duhej të paraqiteshin në lidhje me akuzat për drogë. Ditën kur është vendosur që të veçohet procedura, ende pritej të dorëzohej një ekspertizë, ndërsa disa prova relevante të tjera që i ishin shpalosur mbrojtjes nga prokuroria vetëm gjatë ditëve të fundit duhej të përktheheshin dhe shqyrtoheshin.
53. Veçimi i procedurës ia ka mundësuar të akuzuarit që të japë dëshmi në lidhje me përfshirjen e pretenduar të tij në vrasjen e R.D. Përndryshe nuk do të kishte qenë

e mundur, sepse me Kod kërkohet që i akuzuari të jap dëshmi vetëm pasi të jenë paraqitur të gjitha provat. Sipas nenit 394 (1.9) të KPP-së, marrja në pyetje e të akuzuarit që është deklaruar i pafajshëm dhe është marrë në pyetje para përfundimit të paraqitjes së provave përbën shkelje esenciale të procedurës penale që Gjykata e Apelit duhet t'i marrë sipas detyrës zyrtare (neni 394 (1.1) i KPP-së).

54. Falë veçimit të procedurës, asnjë ditë e seancave të caktuara nuk është humbur, çfarë do të kishte qenë e pashmangshme po që se procedura për të dyja grupet e akuzave do të ishte zhvilluar bashkërisht. Kjo arsye ka qenë e një rëndësie të veçantë në këtë rast, në të cilin, për shkak të rrethanave që kanë qenë jashtë kontrollit të trupit gjykues, palëve dhe mbrojtësit, ka qenë e domosdoshme që gjykimi të fillohej rishtas në kohën kur pothuajse kishte përfunduar.
55. Me aktvendimin e marrë më 31 janar të vitit 2018, të dyja rastet janë ribashkuar në një procedurë të përbashkët për ta marrë një aktgjykim pas përfundimit të marrjes në pyetje të të pandehurit lidhur me akuzat për drogë dhe para se palët t'i paraqisnin fjalët përfundimtare të tyre.

1.3.12. Pengesat ndaj gjykimit të drejtë

56. Ka pasur disa pengesa serioze ndaj gjykimit të drejtë që janë paraqitur gjatë procedurës së shkallës së parë. Ato ose i ka raportuar mbrojtësi, ose janë vërejtur nga trupi gjykues sipas detyrës zyrtare. Të gjitha janë shqyrtuar siç duhet nga trupi gjykues. Asnjëra nuk ka pasur ndikim në paanshmërinë e ndonjërit gjyqtar. Pengesat që mund të përbëjnë vepër penale janë raportuar për hetime të

mëtejshme. Në veçanti, janë paraqitur pengesat në vijim:

Botimi i aktakuzës

57. Aktakuza është botuar në media në të njëjtën ditë kur është paraqitur në gjykatë. I tërë dokumenti me arsyetimin e hollësishëm ku janë paraqitur pretendimet faktike dhe provat në mbështetje të tyre janë bërë të qasshme për çdo person që ka qenë i interesuar për këtë rast, përfshirë dëshmitarët e mundshëm.
58. Trupi gjykues e ka konsideruar shpalljen e aktakuzës si shkelje të ligjit të zbatueshëm, në të cilin parashihet se aktakuza u dorëzohet vetëm palëve. Kjo mund ta cenojë të drejtën në privatësi të personave që janë përmendur në aktakuzë, duke përfshirë të pandehurin, i cili mbrohet nga supozimi i pafajësisë. Veç kësaj, kjo mund të ndikojë në drejtësinë e procedurës së shqyrtimit të provave dhe ta pengojë të vërtetën, sepse dëshmitarët e mundshëm në këtë rast mund të mësojnë nga kjo se cilat janë provat dhe t'ua përshtatin dëshmitë e tyre pretendimeve të prokurorit. Kjo gjithashtu mund t'i dekurajojë disa persona që të japin dëshmi në dobi të të pandehurit. Ndikimi i botimit të aktakuzës do të shtjellohet në pjesën e mëtejshme të këtij aktgjykimi.
59. Gjatë gjykimit është bërë e qartë se disa nga dëshmitarët që kanë dhënë dëshmi në këtë rast mund t'i kenë bazuar njohuritë e tyre në atë që kanë lexuar në media. Kjo ka qenë veçanërisht e dukshme në rastin e dëshmitarëve K4, K5, K6 dhe I.B., të cilët kanë filluar të dëshmojnë për përfshirjen e pretenduar të N.K në vrasjen e R.D. shumë kohë pas ngritjes së aktakuzës kundër tij.

Hetimi i vazhdueshëm

60. Prokurori ka ngritur aktakuzë në këtë rast pas hetimit që ka zgjatur vetëm një vit e dy muaj, d.m.th. tetë muaj pa kaluar afati i parashkrimit (neni 159 i KPP-së).

Deri në atë moment hetimi duhet të kryhet, të gjitha provat të mblidhen dhe lënda të jetë gati për tu shqyrtuar nga gjykata. Në atë moment, prokurori duhet t'ia shpalosë mbrojtjes të gjitha provat, për ta mundësuar përgatitjen e duhur të shqyrtimit gjyqësor.

61. Aktakuza është ngritur edhe pse prokurori ende po i priste përgjigjet ndaj kërkesave për ndihmë juridike ndërkombëtare që u ishin dërguar shumë shteteve, jo vetëm në rajon. Prokurori e ka paraqitur një numër të madh të propozimeve për paraqitje të provave vetëm gjatë shqyrtimit gjyqësor. Për më tepër, prokurori i ka vazhduar veprimet hetimore pas ngritjes së aktakuzës.
62. Si rezultat i kësaj, jo të gjitha provat i janë shpalosur mbrojtjes dhe gjykatës kur është ngritur aktakuza, çfarë përcaktohet qartë në nenin 244 të KPP-së. Për më tepër, kjo ka ndikuar negativisht në kohëzgjatjen e këtij gjykimi, sepse në shumë raste ka qenë e domosdoshme që të priteshin provat që mungonin. Si rrjedhojë, e drejta e të akuzuarit në gjykim të drejtë ishte në rrezik, sepse ishte veçanërisht e vështirë që ta përgatiste si duhet mbrojtjen e tij.
63. Duhet të theksohet se gjykata ka bërë përpjekje për t'ia mundësuar të akuzuarit që ta përgatiste mbrojtjen e tij, pavarësisht shkeljes së lartpërmendur të së drejtës së tij për t'iu prezantuar provat kundër tij mu në fillim të gjykimit.
64. Gjatë tërë shqyrtimit gjyqësor, gjykata e ka paraqitur qëndrimin se procedura penale sipas Kodit të Procedurës Penale të Kosovës duhet t'i ketë katër faza të ndara që nuk duhet të dyzohen me njëra tjetrën. Prokurorit i është lejuar që të zhvillonte veprime hetimore gjatë fazës së hetimit, ndërsa gjatë shqyrtimit gjyqësor ka qenë i obliguar që të paraqiste propozime për paraqitje të provave të reja. Vendimi përfundimtar për pranimin apo refuzimin e provave i ka përkitur

gjykatës.

65. Në disa raste, ka ndodhur që përgjigjet në kërkesat për ndihmë juridike ndërkombëtare që tashmë ishin dërguar gjatë hetimit janë marrë vetëm gjatë shqyrtimit gjyqësor. Pastaj prokurorit i është lejuar që t'i shpalosë këto prova e të mos paraqes propozim për pranimin e provave të reja.

Pengimi i vendimit gjyqësor për rivendosjen e N.K

66. Më datën 20 qershor 2015, kryetari i gjyqtarëve të EULEX-it e ka pezulluar vendimin e trupit gjykues për transferimin e të pandehurit nga izolimi në vetmi nga Burgu e Sigurisë së Lartë në një qendër të paraburgimit me regjim të rregullt dhe ndihmë mjekësore të duhur. Procedura penale nuk ia jep kryetarit të gjyqtarëve të EULEX-it ndonjë kompetencë për të vepruar në këtë rast. Veprimi i tij ka përberë jo vetëm pengim të qartë të pavarësisë së gjyqësorit, por mund të përbëjë edhe vepër penale të keqpërdorimit të detyrës zyrtare që parashihet me Kodin Penal të Kosovës. Ndërhyrja e tij është raportuar gjerësisht nga mediat lokale si skandaloze.

Pengimi i gjykimit nga Peter Bach

67. Më datën 25 shkurt të vitit 2016, gjatë seancës së shqyrtimit gjyqësor, Shefi i Sektorit të Fuqizimit të EULEX-it, bashkë me një grup të anëtarëve të tjerë të stafit të Sektorit të Fuqizimit, nuk i janë përmbajtur urdhrit përfundimtar të gjykatës për ta përjashtuar publikun nga gjykatorja. Trupi gjykues e ka vërtetuar se ky incident është raportuar nga mediat e Kosovës. Trupi gjykues e ka dërguar rastin për hetim, sepse, sipas mendimit të kryetares së trupit gjykues, ka ekzistuar dyshimi i bazuar se kishte ndodhur vepra e *mospërfilljes së gjykatës*.

Drejtimi i dëshmitarëve:

68. Gjatë procedurës që është zhvilluar në gjykatë është vërejtur se disa dëshmitarë i janë nënshtruar praktikës së ashtuquajtur “drejtimit të dëshmitarëve”, e cila quhet edhe “përgatitja e dëshmitarëve” apo “familjarizimi i dëshmitarëve”. Kjo është vërejtur në rastin e së paku disave nga ta, ndërsa mjafton të përmenden: S.T., K3 dhe K1¹. Gjatë marrjes në pyetje të dëshmitarëve është zbuluar se prokurori ishte takuar me ta dhe e kishte diskutuar me ta përmbajtjen e dëshmimeve të tyre para se ata të paraqiteshin në gjykatë. Megjithatë, takimet dhe përmbajtja e tyre nuk i janë zbuluar mbrojtjes dhe gjykatës.
69. Edhe pse praktika e përgatitjes së dëshmitarit duket se pranohet nga tribunalet ndërkombëtare, praktikë e krijuar duket edhe që prokuroria t’i njoftojë palët e tjera dhe gjykatën për synimin për ta bërë këtë. Për më tepër, shkalla e përgatitjes së dëshmitarit për dhënien e dëshmisë përkufizohet në një mënyrë në të cilën kufizohet paragjykimi. Duket qartë se prokurori në këtë rast nuk e ka respektuar këtë praktikë. Në shumë raste gjatët shqyrtimit gjyqësor, prokurori është udhëzuar që të mos takohet me dëshmitarët e tij. Gjykata gjen se dëshmitari duhet ta japë dëshminë e tij apo të saj mundësisht pa u ndikuar nga çfarë mund të ketë kushdo, qoftë gjatë diskutimeve formale apo bisedave joformale. Kjo rregull e pakëson dhe në të vërtetë, me shpresë, e eviton çdo mundësi që ndonjë dëshmitar ta përshtasë dëshminë e tij sipas asaj që e ka thënë ndokush dhe po ashtu e eviton perceptimin e pabazuar që ai të mund ta ketë bërë këtë. Megjithatë, mbrojtja ka qenë në dijeni për përgatitjen e dëshmitarëve dhe ka pasur mundësi që ta kundërshtojë në fakt kredibilitetin e dëshmitarëve gjatë

¹ Ka qenë e dukshme veçanërisht më datën 20.4.2016, tek dëshmitari K1.

marrjes në pyetje të tërthortë.

Premtimi për t'i dhënë dëshmitarit K2 "imunitet të plotë"

70. Vetëm në fazën e fundit të marrjes në pyetje të K1 është kuptuar se prokurori i kishte premtuar këtij dëshmitari se do t'i jepej imunitet në lidhje me të gjitha faktet që do të mund të shpaloseshin në deklaratën e tij. Ky premtim i ishte dhënë verbalisht, ndërsa gjykatës i është dukur se fushëveprimi i këtij "imuniteti" nuk ishte definuar qartë. Prokurori ka shpjeguar se kishte vazhduar në këtë mënyrë, sepse kishte dashur ta bindte dëshmitarin K1 që të jepte dëshmi. Sidoqoftë, kjo ka qenë qartë shkelje e rregullave të procedurës penale, sepse e ka paraqitur mundësinë e një përfitimi që nuk është paraparë me ligj e që ndalohet qartë me nenin 257, paragrafin 4.3 të KPP-së.
71. Dëshmia që dëshmitari ia ka dhënë prokurorit që i ka dhënë atij premtim të paligjshëm është shpallur e papranueshme. Dëshmitë që K1 i ka dhënë gjatë shqyrtimit gjyqësor para imunitetit janë përdorur për ta vërtetuar kredibilitetin e tij. Gjykata nuk i ka shpallur ato si të papranueshme, sepse kryetarja e trupit gjykues e ka udhëzuar K1 drejt për të drejtat dhe obligimet e tij. Ka qenë e pamundur të injorohej fakti se gjatë dëshmive të para të tij K1 ende ka besuar se imuniteti i tij i mbulonte të gjitha veprat penale që i kishte kryer.
72. Përkundër të gjitha këtyre pengesave, trupi gjykues ka bërë çfarë ka qenë e mundur që të garantonte se e drejta e të akuzuarit në gjykim të drejtë të respektohej plotësisht.

Pjesa 2 Procedura e shqyrtimit të provave

2.1. Vërejtje e përgjithshme

73. Shumica e provave që janë paraqitur në këtë rast kanë pasur të bënin me akuzat për vrasje.
74. Prokurori në fillim ka bërë të ditur se donte t'i merrte në pyetje 172 dëshmitarë. Pas seancave të mbajtura me kryetaren e trupit gjykues me qëllim të përgatitjes së mbajtjes së gjyqimit në mënyrë të shpejtë dhe efektive, ai është tërhequr nga propozimi i tij për ta marrë në pyetje një numër të konsiderueshëm të dëshmitarëve. Disa nga ta, posaçërisht ata që në aktakuzë janë paraqitur si bashkëkryerës, janë marrë në pyetje më vonë si dëshmitarë të propozuar nga mbrojtja.

2.2. Rendi i paraqitjes së provave

75. Në parim, rasti i prokurorit paraqitet para rastit të mbrojtjes. Megjithatë, nuk ka qenë përherë e mundur apo e arsyeshme që të ruhej rendi dhe që dëshmitarët e prokurorisë të merreshin në pyetje para atyre që i kishte propozuar mbrojtja, që është zgjidhja ideale që sugjerohet në nenin 331 (1) të KPP-së.
76. Para së gjithash, kanë qenë dy grupe të akuzave (ato për vrasje dhe ato për drogë), çfarë e ka arsyetuar vendimin që së pari të shqyrtoheshin provat që kishin të bënin me secilin rast ndaras. Së dyti, në shumë raste, ishte e domosdoshme që të veprohej në mënyrë fleksibile, sepse, për shkak të bashkëpunimit të gjerë ndërkombëtar në këtë rast, ka qenë e domosdoshme që bashkërendoheshin oraret jo vetëm brenda trupit gjykues, por edhe me agjendat e gjyqtarëve nga vendet e tjera. Kur ka vendosur për orarin e seancave dhe rendin e paraqitjes së provave,

Gjykata po ashtu ka marrë parasysh se i akuzuari ka qëndruar në paraburgim për një kohë të gjatë. Prandaj, janë bërë të gjitha përpjekjet që gjykimi të zhvillohej sa më shpejt që të ishte e mundur.

2.2. Procedura e shqyrtimit të provave dhe ndryshimi i përbërjes së trupit gjykues

77. Siç u përmend më lart, gjykata ka vendosur që të mos e përsërisë marrjen në pyetje të dëshmitarëve që kanë dhënë dëshmi në këtë rast para ndryshimit të përbërjes së trupit gjykues. Procesverbalet e seancave në të cilat ata i kanë dhënë dëshmitë e tyre janë konsideruar si të lexuara, ndërsa audio regjistrimi i deklaratave të dëshmitarëve K1 dhe K2 është lëshuar për tu dëgjuar edhe një herë. Lista e procesverbaleve që janë konsideruar si të lexuara i është bashkëngjitur këtij aktgjykimi².
78. Në seancën e mbajtur më 3 maj të vitit 2016, aktakuza është konsideruar si e lexuar me pëlqimin e palëve. I akuzuari është deklaruar “i pafajshëm” për të gjitha pikat e aktakuzës. Edhe deklaratat hyrëse të prokurorit dhe mbrojtësit janë konsideruar si të lexuara.
79. Në fazën përfundimtare të këtij aktgjykimi, palëve dhe mbrojtjes u janë dorëzuar 4 lista të provave të dokumentuara dhe materiale që janë pranuar në këtë rast. Ato i janë bashkëngjitur këtij aktgjykimi.

2.3. Propozimet e palëve për prova

80. Palët e kanë përdorur të drejtën e tyre për të paraqitur propozime për prova të reja deri në përfundim të shqyrtimit gjyqësor dhe shumica e tyre janë pranuar nga gjykata. Në këtë pjesë të aktgjykimit janë paraqitur vetëm këto propozime, të

² Shtojca 1.

cilat janë shtjelluar në pjesën e aktgjykimit që ka të bëjë me konstatimet faktike.

81. Gjykata i ka refuzuar këto propozime:

- propozimin e mbrojtjes të datës 15 tetor të vitit 2015 për t'i bashkëngjitur emailat midis K3 dhe prokurorëve të EULEX-it, i cili është ndaluar si i papërshtatshëm për t'i shërbyer qëllimit (neni 258 (2.3) i KPP-së), meqë rrethanat e kontakteve midis dëshmitarit dhe zyrtarëve të EULEX-it mund të verifikohen në mënyra më të përshtatshme nëpërmjet marrjes në pyetje të dëshmitarëve³;
- propozimi i prokurorit i datës 16 nëntor 2016 për ta pranuar transkriptin e thirrjeve të përgjuara telefonike midis S.T. dhe E.D., i cili është ndaluar si i papranueshëm, sepse nuk ka pasur urdhër gjyqësor për masa të fshehta apo të vëzhgimit (neni 97 i KPP-së);
- propozimet e prokurorit të datës 1 dhjetor 2016 për ta marrë në pyetje avokatin V.V. dhe hetuesen I.C. në cilësinë e dëshmitarëve dhe për t'i pranuar dokumentet në lidhje me ta përkitazi me rrethanat e bashkëpunimit të tyre me mbrojtjen në këtë rast. Gjykata ka gjetur se këta dëshmitarë hyjnë në kategorinë e dëshmitarëve të privilegjuar sipas nenit 126 (1.2) të KPP-së. Për shkak të rrethanave tejet specifike të këtij rasti, mbrojtësi, për t'i përmbushur në mënyrë efektive obligimet e tij ndaj të mbrojturit të tij, ka pasur të drejtë që të caktonte avokat kompetentë për të vepruar në juridiksione të tjera⁴;

³ 20.10.2015.

⁴27.2.2017.

- propozimet e prokurorit të datës 1 dhjetor 2016 për t'i pranuar transkriptet e bisedës që është zhvilluar me F.R. nga zyrtari policor më 6 nëntor të vitit 1993. Gjykata ka konstatuar se kjo provë është thelbësisht e pambështetshme, meqë burimi i kësaj prove është i paqartë. Analiza e këtij transkripti çon në përfundimin se nuk ka qenë marrja në pyetje e dëshmitarit (neni 259 (2) të KPP-së);⁴
- Propozimi i mbrojtjes i datës 12 shtator 2017 për t'i marrë në pyetje 19 dëshmitarët (personat që janë përmendur në fletoren e shënimeve) dhe për ta thirrur K2 për ta marrë në pyetje përsëri si propozim i paraqitur për ta zvarritur procedurën (neni 258 (2.4) i KPP-së). Mbrojtja ka qenë e vetëdijshme për ekzistimin e fletores së shënimeve që nga viti 2015 dhe qysh atëherë mund t'i kishte propozuar si dëshmitarë njerëzit që janë përmendur në fletoren e shënimeve⁵;
- Propozimi i mbrojtjes i datës 14 shtator të vitit 2017 për t'i marrë në pyetje K.K. dhe A.B.in për rrethanat e lidhjes midis N.K dhe K2, sepse gjykata ka vlerësuar se ky propozim ishte paraqitur për ta zvarritur procedurën (neni 258 (2.4) të KPP-së). Mbrojtja ka qenë e vetëdijshme për ekzistimin e këtyre dëshmitarëve së paku një vit para se të paraqitej propozimi⁷;
- Propozimi i mbrojtjes i datës 14 tetor të vitit 2017 për ta pranuar procesverbalin e dëshmimeve të H.Me., M.Ha. dhe H.Mu. në gjykimin e K2,. Gjykata ka vendosur ta ndalojë marrjen e kësaj prove sipas nenit 258, paragrafit 2.1 të KPP-së, sepse marrja e saj për t'i plotësuar provat e tjera

⁴ 27.2.2017.

⁵ 13.9.2017.

⁷ 3.10.2017.

ka qenë e panevojshme, posaçërisht për shkak se këta dëshmitarë po dëshmonin para gjykatës dhe kishte material të mjaftueshëm për ta vlerësuar kredibilitetin e tyre⁶;

- Propozimi i prokurorit për t'i pranuar shkresat në lidhje me autorizimin që i është dhënë mbrojtësit M.Ko.: autorizimin e datës 23.10.2012, parashtrësën e mbrojtësit M.Ko. të datës 13.11.2012, autorizimin e datës 28.11.2012 dhe konfirmimin e konfiskimit të sendeve të datës 12.9.2012, meqë gjykata i ka shpallur këto prova si të parëndësishme (neni 258 (2.2) i KPP-së) për t'i provuar elementet e veprave penale për të cilat është akuzuar i akuzuari.

82. Me propozimin e datës 15 dhjetor 2017, mbrojtja e ka kundërshtuar pranueshmërinë e disa provave që i ka paraqitur prokuroria. Gjatë seancës së mbajtur më 18 janar të vitit 2018, gjykata ka vendosur se informatat operative nga Bosnja dhe Hercegovina që i ka përmbajtur regjistratori nr. 12 janë të papranueshme, sepse nuk janë mbledhur sipas parimeve të mbledhjes së provave që janë paraparë me ligjin në zbatim. Materialet që janë mbledhur nga inteligjenca përbëjnë *per se* vetëm burim të informatave për prova potenciale.

83. Pas këshillimit, gjykata ka vendosur se të papranueshme janë provat e kundërshtuara nga mbrojtja në vijim:

- Raporti i ekzaminimit të provave i NjHKO-së – Ekzaminimi Kompjuterik⁷,

⁶ 3.10.2017.

⁷ Regjistratori 10, f. 14 – 18.

¹⁰ Regjistratori 10, f. 19-20.

- Raporti i ekzaminimit të provave i NjHKO-së – telefonat mobilë dhe SIM kartelat¹⁰,
- Raporti i ekzaminimit të provave i NjHKO-së – Analiza Fillestare e Provave e SMS-ve⁸ meqë janë në kundërshti me nenet 249 (1.2) dhe 257 (2) të KPP-së, sepse nuk i plotësojnë kushtet e neneve 138 dhe 147 të KPP-së, meqë nuk përmbajnë: ndonjë pretendim për fajësinë ose pafajësinë e të pandehurit [neni 138 (1.2) të KPP-së], indikacione për përvojën apo trajnimin e specializuar [neni 138 (1.3) të KPP-së], ndonjë shpjegim se praktikant analitike janë përgjithësisht të pranuar në fushën e ekspertizës përkatëse apo kanë bazë shkencore apo teknike [neni 138 (1.6) të KPP-së], ndonjë përfundim me mendimin e ekspertit [neni 138 (1.7) të KPP-së] dhe hapat që i ka marrë zyrtari policor i autorizuar apo eksperti tjetër për t’iu përmbajtur praktikave më aktuale në fushën e forenzikës për ta realizuar kërkimin në mënyrë të saktë dhe të besueshme [neni 147 (4.5) të KPP-së];
- Raporti i pasqyrës së aseteve financiare të NjHKO-së për N.K.⁹,
- Raporti i NjHKO-së për asetet në Mal të Zi¹⁰,
- Raporti i NjHKO-së për pasqyrën e transaksioneve financiare të dyshimta¹¹,
- Raporti i analizës financiare i NjHKO-së¹² sepse janë marrë pa urdhër për analizë financiare, i cili kërkohet sipas nenit 137 të KPP-së; veç kësaj, nuk

⁸ Regjistratori 10, f. 103-108.

⁹ Regjistratori 11, f. 243 – 250.

¹⁰ Regjistratori 11, f. 251 – 341.

¹¹ Regjistratori 11, f. 342 – 353/1.

i plotësojnë kushtet që janë paraparë në nenet 138 të KPP-së, sepse nuk përmbajnë: ndonjë pretendim për fajësinë ose pafajësinë e të pandehurit [neni 138 (1.2) i KPP-së], indikacione për përvojën apo trajnimin e specializuar [neni 138 (1.3) i KPP-së], ndonjë shpjegim se praktikat analitike janë përgjithësisht të pranuar në fushën e ekspertizës përkatëse apo kanë bazë shkencore apo teknike [neni 138 (1.6) të KPP-së].

2.4. Dëshmitarët – problemet specifike

84. Një numër i konsiderueshëm i dëshmitarëve kanë dhënë dëshmi në gjykatë. Analiza dhe vlerësimi i hollësishëm i dëshmive të tyre do të paraqitet në pjesën e mëtejme të këtij aktgjykimi, ndërsa në tekstin e mëposhtëm do të përmenden vetëm disa çështje specifike.

2.4.1. Dëshmitarët e mbrojtur

85. Kanë qenë pesë dëshmitarë të mbrojtur në këtë rast: K1, K2, K3, K4 dhe K5, të cilët e kanë marrë këtë status qysh gjatë hetimit. Vendimi për mbrojtjen e dëshmitarit K6 është marrë gjatë fazës së shqyrtimit gjyqësor me kërkesë të prokurorit¹³. Identiteti i të gjithë dëshmitarëve ka qenë i ditur për të akuzuarin dhe mbrojtjen e tij. Dëshmitarët K1 dhe K3 kanë dhënë dëshmi nga lokacioni i largët në Kosovë, ndërsa K4, K5 dhe K6 ka dhënë dëshmi në gjykatë. K2 ka dhënë dëshmi nga gjykata në Bosnjë dhe Hercegovinë.

¹² Regjistratori 11, f. 353/2 – 388.

¹³ Aktvendimi i datës 15.9.2015.

2.4.2. Dëshmitarët që kanë refuzuar të dëshmojnë dhe ta përfundojnë marrjen e tyre në pyetje

86. Kanë qenë dy dëshmitarë në këtë rast që kanë refuzuar të japin dëshmi:

a) M.L., i cili ishte thirrur për datën 28 prill 2015;

b) E.P., i cili ishte thirrur për datën 27 janar 2016.

Të dy dëshmitarët janë ftuar për të dëshmuar pranë gjykatës së Bosnjë dhe Hercegovinës në Sarajevë. Meqë kanë qëndruar jashtë juridiksionit të gjykatës së Kosovës, nuk ka qenë e lejuar që kundër tyre të përdorej ndonjë masë për t'i detyruar që të japin dëshmi.

87. Mbrojtja ka kërkuar që në cilësinë e dëshmitarit të merret në pyetje Oleg Cavka, por ai ka refuzuar bazuar në faktin se prokurorët nuk duhet të merren në pyetje lidhur me rrethanat e rasteve në të cilat kanë punuar¹⁴.

88. Dëshmia e J.C. është ndërprerë nga dëshmitari pas disa pyetjeve që i janë bërë gjatë marrjes në pyetje të drejtpërdrejtë. Dëshmitari ka pretenduar se ka pasur probleme mendore. Dëshmia e tij nuk është përdorur për të nxjerrë konstatime faktike.

89. Dëshmitari M.U. nuk ka lejuar që të përfundohej marrja e tij në pyetje, sepse gjatë marrjes në pyetje të tërthortë të tij ka bërë të ditur se nuk do t'i përgjigjej më ndonjë pyetje tjetër. Para kësaj situate, ai e ka ndërprerë dëshminë e tij dy herë¹⁸. Kur ka ndodhur për herën e tretë, mbrojtja ka kërkuar që deklarata e tij të

¹⁴ Propozimi i mbrojtjes – 27.10.2015.

¹⁸ 15.4.2016; 18.7.2016.

shpallet e papranueshme, ndërsa prokurori ka propozuar që dëshmitari të thirret përsëri¹⁵. Gjykata nuk ka gjetur arsye për ta shpallur deklaratën e tij të papranueshme dhe ka vendosur që të mos e thërrasë M.U. përsëri. Mbrojtja ka pasur mundësi ta kundërshtonte këtë dëshmitari, ndërsa sjellja e këtij dëshmitari është marrë parasysh kur është vlerësuar kredibiliteti dhe vërtetësia e dëshmisë së tij.

90. Përkundër përpjekjeve, nuk ka qenë e mundur që në mënyrë efektive të ftoheshin dëshmitarët: I.S. dhe N.V. Nga informatat që janë marrë nga autoritetet boshnjake, vendqëndrimi i tyre ka qenë i panjohur për to.

2.4.3. E drejta e dëshmitarit për të qëndruar pranë mbrojtësit

91. Dëshmitarët B.L.¹⁶, M.U.¹⁷ dhe A.E.²² kanë dhënë dëshmi në praninë e mbrojtësve të tyre. Ligji nuk e ndalon një praktikë të këtillë, por gjykata gjen se e drejta e dëshmitarit për të caktuar mbrojtës mund të jetë në interes të drejtësisë. Në rrethanat në të cilat dëshmia e dëshmitarit mund të jetë vetinkriminuese, kjo mundësi është e një rëndësie të veçantë. Mbrojtësit janë këshilluar se mund të qëndrojnë pranë të mbrojturve të tyre dhe t'i këshillojnë ata se kur është e përshtatshme apo e papërshtatshme që të përgjigjen në ndonjë pyetjeje. Nëse këshillohet nga mbrojtësi, dëshmitari mund të thirret në të drejtën kundër vetinkriminimit.

¹⁵ 18.7.2016.

¹⁶ 16.5.2016.

¹⁷ 18.3, 4 dhe 15.4 2016, 18.7.2016.

²² 17.5.2016.

2.4.4. Dëshmitarët armiqësorë

92. Gjatë gjykimit, ka ndodhur dy herë që prokurori ka dashur ta përdorte konceptin e “dëshmitarit armiqësor”. Herën e parë ka ndodhur ka ndodhur gjatë marrjes në pyetje të F.R., i cili është marrë në pyetje si dëshmitar i prokurorit, përkundër bindjes së tij për përfshirjen e këtij dëshmitari në vrasjen e R.D. F.R. nuk e ka mbështetur pretendimin e prokurorit me dëshminë e tij, prandaj prokurori ka dashur që ta sfidojë kredibilitetin e tij. Mbrojtja e ka kundërshtuar fuqishëm dhe ka potencuar se do të ishte e padrejtë ndaj këtij dëshmitari, i cili nuk ishte marrë në pyetje gjatë hetimit dhe nuk kishte pasur mundësi që ta mbronte vetveten ndaj pretendimeve kundër tij¹⁸.
93. Për herë të dytë, prokurori ka dashur që të paraqesë propozim për ta shpallur K1 dëshmitar armiqësor. Kjo ka ndodhur gjatë marrjes së tij në pyetje pas çështjes së imunitetit, kur prokurori ka kuptuar se dëshmitari e tij e kishte ndryshuar dukshëm dëshminë e tij¹⁹.
94. Gjykata ka konstatuar se është e arsyeshme që të përdoret *in extenso* shpjegimi i konceptit të dëshmitari armiqësor, i cili ishte zbatuar në P 58/14 pranë Gjykatës Themelore të Mitrovicës²⁰²¹.

Ky është koncept i mirënjohur në juridiksionet e së drejtës precedentale në të cilat në fuqi është sistemi akuzativ. Nëse dëshmitari e mohon atë që ia ka thënë palës që e ka mbështetur para gjykimit, nëse e kundërshton tezën që do të duhej ta mbështeste me dëshminë e tij para një gjykate të hapur, atëherë ai ka shfaqur

¹⁸ 18.11.2016, f. 18.

¹⁹ 7.11.2016.

²⁰ Aktgjykimi i Gjykatës Themelore të Mitrovicës në Rastin P. 58/14 marrë më datën 27 maj 2015, f. 20-

21.

armiqësi ndaj pretendimit të palës. Zakonisht pala që e ka mbështetur dëshmitarin duhet ta kryejë marrjen në pyetje të drejtpërdrejtë. Ka shumë pak kufizime që i vihen një pale gjatë marrjes në pyetje të drejtpërdrejtë. Kjo është për shkak se provat që paraqiten gjatë marrjes në pyetje të drejtpërdrejtë shërbejnë si bazë e drejtpërdrejtë për konstatimet faktike të trupit gjykues. Prandaj, është e rëndësishme që dëshmitari të dëshmojë për atë që di në mënyrë spontane, po qenë i drejtuar nga dikush. Kjo do të thotë se pyetjet drejtuese apo sugjестive nuk lejohen. Ligjbërësit e Kosovës, në nenin 334, paragrafin 4, e kanë lejuar përdorimin e deklaratës së mëparshme të dëshmitarit vetëm për t'ia rifreskuar kujtesën, kështu që nëse dëshmitari thotë: “Nuk më kujtohet ky fakt”, rrëfimi i mëparshëm i tij për atë fakt mund të lexohet me të nga gjykata, por ajo që lexohet nuk mund të përdoret si provë e drejtpërdrejtë. Si prova mund të përdoren vetëm përgjigjet që dëshmitari i jep pasi t'i jetë rifreskuar kujtesa (...)

Nëse dëshmitarit jo vetëm që nuk i kujtohen faktet, por i paraqet ato në një mënyrë tjetër nga faza paraprake, nuk lejohet që t'i rifreskohet kujtesa. Kjo e vë palën që e ka mbështetur dëshmitarin në një situatë në të cilën kredibiliteti i dëshmitarit nuk mund të gjykohet apo sfidohet në ndonjë mënyrë. Kjo përbën shkelje të parimit të barazisë së palëve, sepse provat janë paraqitur dhe pala nuk mund të luftojë kundër tyre. Ky është një boshllëk që nuk është rregulluar me ligj në Kosovë, ndërsa neve na duket si moszbatim i Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, gjegjësisht nenit 6, i cili thirret në konceptin e gjykimit të drejtë. Koncepti i gjykimit të drejtë e mbulon edhe konceptin e barazisë së palëve. Në kuptim të së drejtës evropiane, barazia e palëve nënkupton dhënien e mundësisë së arsyeshme secilës palë për ta prezantuar rastin e saj, në kushte

të cilat nuk do ta vënë këtë palë se në disavantazh ndaj palës së kundërt. Kushtetuta e Kosovës, në nenin 22 të saj, e parash zbatueshmërinë e drejtpërdrejtë të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Detyra e jonë është që t'i zbatojmë standardet e kësaj konvente. Prandaj, neve na duket se koncepti i dëshmitarit armiqësor është zgjidhja më e mirë.

Dëshmitari armiqësor është ai që mohon çfarë ka thënë më parë. Pasi dëshmitari të shpallet armiqësor, pala mbështetëse mund ta marrë atë në pyetje pa iu nënshtruar kufizimeve të vëna ndaj marrjes në pyetje të drejtpërdrejtë, por marrja e këtillë në pyetje nuk mund të përdoret si provë e drejtpërdrejtë për konstatimet faktike. Ajo mund të përdoret vetëm për t'i gjykuar deklaratat që përndryshe do të ishin konsideruar si bazë për konstatimet faktike të gjykatës. Kurdo që dëshmitari i përgjigjet ndonjë pyetje drejtuese, përballja me deklaratën e mëparshme, apo përballja me çfarëdo prove tjetër që supozohet të përdoret në marrjen në pyetje të drejtpërdrejtë nuk mund të përdoret si provë e drejtpërdrejtë. Ajo mund të përdoret vetëm për vlerësimin e kredibilitetit të dëshmitarit”.

95. Kryetarja e trupit gjykues e udhëzoi prokurorin se pas shpalljes së dëshmitarit si armiqësor ai do të merrej në pyetje pa kufizimet që zbatohen gjatë marrjes në pyetje të drejtpërdrejtë sa u përket pyetjeve drejtuese dhe përdorimit të deklaratave të marra në procedurë paraprake. Megjithatë, deklarata e mëparshme e dëshmitarit nuk do të përdorej si provë e drejtpërdrejtë. Prokurori më në fund e ka tërhequr propozimin për ta shpallur K1 dëshmitar armiqësor.

2.4.5. Dëshmitarët bashkëpunues

96. Prokurori ka paraqitur kërkesa për t'i shpallur K1 dhe K2 dëshmitar bashkëpunues, përkatësisht, më 10 gusht të vitit 2016 dhe më 21 shkurt të vitit 2017. Pasi janë mbajtur seancat më 11 gusht të vitit 2016 dhe 22 shkurt të vitit 2017, janë lëshuar urdhrat për t'i shpallur K1²² dhe K2²³ dëshmitarë bashkëpunues në rastin kundër të pandehurit N.K. Dëshmitarëve u është dhënë imunitet, fushëveprimi i të cilit është përcaktuar si vijon:

- 1) Urdhërohet ndalimi i fillimit të procedurës penale dhe i shqiptimit të dënimeve kundër të dyshuarve K1 dhe K2 për veprat penale që janë përshkruar në pikat 3 – 9 të aktakuzës kundër N.K;
- 2) Dëshmitari K1 dhe K2 do të bashkëpunojnë duke dhënë dëshmi të plotë, të vërtetë dhe të saktë për aktivitetet e grupit kriminal që pretendohet se është organizuar dhe menaxhuar nga N.K., që ka vepruar gjatë një periudhe së paku nga viti 2000 deri në vitin 2012 dhe që është marrë me blerjen, përgatitjen, transportimin, shitjen dhe shpërndarjen e sasive të mëdha të heroinës, ekstazisë, “speed”-it dhe drogave të tjera, si dhe pararendësve të drogës, siç është acidi acetik anhidrid, nëpërmjet një rrjeti kriminal të organizuar të themeluar mirë, pjesëtarë të të cilit kanë qenë K1 (menaxher dhe përzierës i drogës për N.K.), K2 (i ka drejtuar dërgesat midis Turqisë, rajonit të Ballkanit dhe Holandës), K3 (shpërndarës i drogës në Beograd/Serbi), L.K. (menaxher i shpërndarjes së drogës në Serbi dhe

²² Aktvendimi i datës 11 gusht 2016.

²³ Aktvendimi i datës 22 shkurt 2017.

vendet e tjera evropiane), M.H. (shofer dhe truprojë), S.A. (shofer), Z.B. (automekanik, ka krijuar ndarje të fshehta për drogë në veturë), H.K. (kontakt në Turqi), I.K. (kontakt në Turqi), A.KA. (koordinator i dërgesave të drogës) dhe shumë të tjerë.

3) Ky urdhër mund të revokohet nga kolegji shqyrtues me kërkesë të prokurorit të shtetit, nëse vërtetohet se dëshmitë e K1 dhe K2 si dëshmitarë bashkëpunues kanë qenë të rrejshme në cilëndo pjesë relevante të tyre apo nëse ata nuk e kanë thënë të vërtetën e plotë.

97. Gjatë seancës së shqyrtimit gjyqësor që është mbajtur më 7 nëntor të vitit 2016, gjykata ka vendosur to trajtojë K3 *de facto* sidëshmitar bashkëpunues, meqë i ka plotësuar të gjitha kushtet që janë paraparë në nenin 235 të KPP-së. K3 është person që prokurori dyshon se i ka kryer se veprat penale që janë përmendur më lart [neni 19 (1.3) i KPP-së]. Ai pritet që të japë dëshmi në gjykatë, në të cilën ka të ngjarë që të ofrohen informata që do të çojnë në zbulimin e së vërtetës në këtë procedurë penale [neni 235 (1.1) i KPP-së] dhe është pajtuar vullnetarisht që ta dëshmojë të vërtetën në gjykatë [neni 235 (1.3) i KPP-së], çfarë mund të shpie në ndjekjen e suksesshme të kryerësve të tjerë të veprave penale që janë përmendur me rend më lart [neni 235 (1.5) të KPP-së]. Për më tepër, nga ai pritet që në gjykatë të japë dëshmi e cila do të jetë e vërtetë dhe e plotë [neni 235 (1.5) të KPP-së].

98. Marrë parasysh përmbajtjen e dëshmimeve që i ka dhënë K3, gjykata ka konsideruar se ka qenë e nevojshme që ai të thirrej për të dëshmuar përsëri.

99. Si rrjedhojë, sipas nenit 262 (4) të KPP-së, gjykata nuk e shpall personin fajtor vetëm mbi bazën e dëshmisë së dhënë nga dëshmitari bashkëpunues.

2.4.6. Marrja në pyetje e dëshmitarëve

100. Si parim, kryetarja e trupit gjykues nuk i ka lejuar pyetjet sugjестive gjatë marrjes në pyetje të drejtpërdrejtë. Përjashtimet e vetme janë lejuar kur është bërë e dukshme se dëshmitarit nuk i është kujtuar më asnjë fakt, kur ka pasur nevojë që vëmendja e dëshmitarit të përqendrohej në një çështje të veçantë apo kur pyetja ka pasur të bëjë me ndonjë çështje që ka qenë përgjithësisht e ditur.
101. Në këtë fazë nuk janë lejuar as pyetjet sugjестive dhe të përsëritura.
102. Gjatë marrjes në pyetje të tërthortë, pyetjet drejtuese nuk janë lejuar. Palët kanë pasur të drejtë jo vetëm të bënin pyetje, por edhe të kërkonin që dëshmia dhe fushëveprimi i marrjes në pyetje të tërthortë të përcaktohej nga temat që ishin trajtuar gjatë marrjes në pyetje të drejtpërdrejtë, duke i përsëritur faktet e favorshme dhe duke sjellë informata të reja që janë ndërlidhur me to. Qëllimi i kësaj ka qenë që të viheshin në test perceptimi, kujtesa dhe kredibiliteti i dëshmitarit.
103. Ngacmimi i dëshmitarit dhe citimi i gabuar i deklaratave të mëparshme nuk janë lejuar gjatë tërë marrjes në pyetje.

Marrja në pyetje nga gjyqtarët

104. Trupi gjykues ka marrë pjesë aktive në marrjen në pyetje të dëshmitarëve gjatë fazave të ndryshme të marrjes në pyetje. Megjithatë, palëve u është dhënë përherë mundësia që t'i kundërshtonin përgjigjet e dhëna nga dëshmitari, kur ai u është përgjigjur pyetjeve të gjyqtarit. Trupi gjykues e ka bazuar aktivitetin e

tij gjatë marrjes në pyetje në përfundimin se neni 7, paragrafi 1 i KPP-së i obligon gjyqtarët që ta kërkojnë të drejtën objektive. Prandaj, ka qenë e domosdoshme që

të sqaroheshin me përpikëri të gjitha çështjet faktike se gjyqtarëve u janë dukur të paqarta. Neni 299, paragrafi 1 i KPP-së ua jep të drejtën gjyqtarëve që t'i bëjnë pyetje cilitdo dëshmitar, por nuk tregon ndonjë fazë të veçantë të marrjes në pyetje. Duket se kodet nuk vënë ndonjë kufizim sa i përket kohës së marrjes në pyetje nga ana e gjyqtarëve.

Përdorimi i deklaratave të mëparshme

105. Njëri nga parimet kyçe të procedurës penale në Kosovë është që konstatimet faktike të bazohen në provat që i paraqiten drejtpërsëdrejti gjykatës. Ligji është mjaft i rreptë kur kemi të bëjmë me mundësinë dhe qëllimin e përdorimit të dëshmisë së mëparshme të dëshmitarit (nenet 123 dhe 337 të KPP-së).
106. Prokurori i ka prezantuar një numër dëshmish që janë dhënë nga dëshmitarët gjatë procedurave të ndryshme dhe që u janë edhe autoriteteve gjyqësore të vendeve të tjera. Me pëlqimin e palëve, një pjesë e konsiderueshme e tyre janë konsideruar si të lexuara sipas nenit 338 të KPP-së. Kur janë përdorur këto dëshmi, në procesverbal të shqyrtimit gjyqësor është shënuar se kur ka ndodhur kjo.
107. Gjatë marrjes në pyetje të drejtpërdrejtë, palës që e ka propozuar dëshmitarin i është lejuar që ta rifreskojë kujtesën e tij apo të saj me prova të pranueshme, duke përfshirë deklaratën e mëparshme në rastet kur dëshmitarit nuk i janë kujtuar faktet [neni 333 (4) i KPP-së].

108. Gjatë marrjes në pyetje të tërthortë, palëve u është lejuar që dëshmitarin ta përballnin me prova kundërthënëse, duke përfshirë dëshminë e mëparshme të tyre [nenet 334 (1) dhe 337 (5) të KPP-së].

Aktgjykimi me shkrim

109. Për shkak të ndërlikueshmërisë së rastit, gjykatës i është dikur e arsyeshme që në aktgjykim t'i paraqesë në detaje vetëm provat relevante që kanë qenë relevante për konstatimet faktike. Kjo qasje arsyetohet me faktin se gjykata e ka vlerësuar dhe shqyrtuar një tërësi voluminoze të provave; megjithatë, një pjesë e madhe e tyre nuk kanë qenë relevante për rastin.

2.5. Lista e kingpinëve

110. Prokurori ka siguruar dokumente që kanë treguar se Presidenti i ShBA-ve e kishte emëruar N.K. kingpin sipas *Aktit për Emërimin e Kingpinëve të Huaj të Drogës* ("Akti Kingpin"), i cili vë në shënjestër, në mbarë botën, trafikuesit e mëdhenj të huaj të narkotikëve si dhe organizatat dhe punëtorët e tyre. Relevanca e kësaj prove për procedurën në këtë rast kufizohet vetëm me vërtetimin e faktit se i akuzuari është vendosur në listën e kingpinëve, por nuk mund të përdoret për ta dëshmuar përfshirjen e tij në trafikimin e drogës.

Pjesa. 3 Konstatimet faktike përkitazi me akuzat për vrasje

3.1. Akuzat për vrasje – faktet që nuk janë kontestuar

111. Më datën 27 qershor 2007, në orën 23:28, një person anonim e ka informuar përmes telefonit policin kujdestar në qendrën operative të Policisë së Sarajevës se një person i paspecifikuar kishte shtënë disa herë në Rrugën Odobashina Nr.1.

Policët janë dërguar në vendin e ngjarjes. Ata e kanë gjetur R.D., i cili ishte qëlluar për vdekje përballë një ndërtese në Rrugën Odobashina Nr. 1a. Kufoma e tij po qëndronte e shtrirë në fund të shkallëve që çonin në banesën e tij. R.D. ishte qëlluar shumë herë në tërë trupin e tij, ndërsa hetuesit e policisë kishin nxjerrë disa këmishëza të gëzhgojave të 9mm dhe copëza të plumbave 9mm dhe 0.357 mm. Është vërtetuar se për këtë vrasje ishin përdorur dy lloje të armëve; njëra nga e cila ishte shkrepur municion i kalibrit 0.357 i llojit Magnum dhe një armë zjarri automatike e kalibrit 9mm e markës Heckler & Koch. Përveç këmishëzave dhe copëzave të plumbave, nën një veturë të parkuar në Rrugën Odobashina Nr.6a ishte gjetur edhe një silenciator. Silenciatori i gjetur ishte dizajnuar për një armë automatike të markës Heckler & Koch, model MP5.

Autopsia ka zbuluar 10 plagë të shkaktuara nga plumbat në trupin e viktimës. Vdekja është përcaktuar si e dhunshme dhe si rrjedhojë e gjakderdhjes së menjëhershme²⁴.

112.Palët nuk i kanë kontestuar faktet e lartpërmendura. Çështja që duhej të vërtetohej ishte nëse N.K. ishte ai që pretendohet se, në bashkëpunim me njerëz të tjerë, e kishte formuar grupin kriminal të organizuar që e kishte planifikuar, organizuar dhe paguar vrasjen e R.D.

²⁴ Regjistratori nga hetimi: Inspektimi i skenës së vrasjes së R.D., f. 1 – 19; Raporti i inspektimit të vendit të ngjarjes, f. 47 – 55; Klinika e Emergjencës në Sarajevë – Protokoll i Rastit, f. 80/2-80/3; Fotodokumentacioni i Skenës së Vrasjes, f. 80/4-80/84; Raporti i Autopsisë, f. 81 – 96; Ekspertiza e Gjurmëve të Armëve të Zjarrit, f. 97 – 118; Ekspertiza e shiritit ngjitës transparent, f. 133 138; Ekspertiza e provave të armëve të zjarrit, f. 139 – 146; f. 147 – 152. P. 153 – 160, f. 161 – 171, f. 172 – 186, f. 201 - 210; ekspertiza ballistike me shtojcë f. 187 – 194, f. 195 - 200; konstatimet e fakultetit të biologjisë në Beograd, f. 211 – 232; raportet e ADN-së 233 – 238, 239 – 242; 243-246; 247 – 250; 251 – 234; Informatat nga Qendra Mjekoligjore e Ministrisë së Brendshme të Federatës së Bosnjës dhe Hercegovinës, f. 255; Raporti fotografik i NjHKO-së Nr. 12/20140214/6816; Dokumentacioni fotografik i skenës në Bosnjë – raporti i hetimit, f. 26 – 285 dhe përkthimet– f. 286 – 410.

3.2. Vërejtje e përgjithshme

113. Pas vlerësimit të përpiktë të të gjitha provave që janë paraqitur gjatë shqyrtimit gjyqësor, gjykata ka ardhur në përfundimin se nuk është provuar se N.K., në bashkëpunim me persona të tjerë, e ka formuar grupin kriminal të organizuar që e ka planifikuar, organizuar dhe paguar vrasjen e R.D.
114. Dëshmia e S.T. ka qenë provë esenciale në të cilën prokuroria i ka bazuar pretendimet e saj në pikat 1 dhe 2 të aktakuzës.
115. Ajo ka dhënë dëshmi në këtë gjykim disa ditë. Kjo ia ka mundësuar gjykatës që jo vetëm ta dëgjojë versionin e saj të ngjarjeve që kanë shpënë në vrasjen e R.D. dhe që kanë ndodhur pas saj, por edhe ta vëzhgojë sjelljen e saj, mënyrën e të folurit dhe reagimet e saj ndaj pyetjeve të ndryshme, të cilat kanë qenë nganjëherë emocionale, posaçërisht ndaj pyetjeve që nuk i kanë pëlqyer.
116. Ndonëse ishte pyetur për një numër detajesh që kanë ndodhur para shumë kohe, S.T. ka dhënë dëshmi, meqë i ka ditur përgjigjet në të gjitha. Pothuajse asnjëherë nuk ka ndodhur që të mos e ketë ditur apo të mos i jetë kujtuar ndonjë fakt apo rrethanë. Përgjigjet e saj kanë qenë zakonisht shumë të gjata dhe të detajuara. E ka krijuar përshtypjen sikur ka mëtuar t'i plotësonte zbrazëtirat në kujtesë duke sajuar fakte. Për këtë arsye, pretendimet e saj janë dukur jo spontane, çfarë natyrisht ka shpënë në dyshime sa i përket sinqeritetit të saj. Për më tepër, kurdo që rrëfimi i saj është bërë i dobët apo i dyshimtë, ajo ia ka përshtatur atë zhvillimit të marrjes në pyetje.
117. S.T. kurrë nuk e ka ushtruar të drejtën e saj për të mos iu përgjigjur ndonjë pyetje që do ta vinte para turpit të rëndë. Megjithatë, kurdo që është pyetur për fakte që kanë mundur ta bënin të dukej keq, ajo i është shmangur vazhdimisht dhënies së

përgjigjeve të qarta apo ka mohuar se ka ditur apo dëgjuar për ndonjë fakt specifik. Ajo ka pretenduar se nuk i janë kujtuar rrethanat që nuk e kanë mbështetur apo që mund të ishin në kundërshti me versionin e saj të ngjarjeve.

118. ²⁵ Një prirje e tillë ka qenë veçanërisht e dukshme kur kjo dëshmitare është pyetur për aktivitetin kriminal të bashkëshortit të saj²⁹. Duhet të theksohet se Z.T. është dënuar me aktgjykim të formës së prerë të Gjykatës Kushtetuese të Bosnjë dhe Hercegovinës me 40 vite burgim për vrasje, kidnapim dhe trafikim të drogës²⁶. Kur është pyetur për aktgjykimin, ajo ka pretenduar se nuk di për të dhe se nuk e ka lexuar. Përkundër kësaj mungese të deklaruar të njohurive, S.T. e ka shprehur mendimin e saj se rasti kundër burrit të saj ishte fabrikuar³¹ për t'ia pamundësuar atij, mes tjerash, që të fliste për urdhërimin e vrasjes së R.D. nga F.R. dhe N.K.²⁷. Ajo i ka akuzuar gjyqtarët dhe prokurorët e përfshirë në rastin kundër burrit të saj²⁸²⁹.

119. S.T. dukej se ishte tejet e interesuar për F.R. Ajo e pranoi se i kishte resurset e saja për ta përcjellë atë. Ajo pretendoi se dinte gjithçka për të, meqë jeta e saj varej nga kjo³⁴.

120. Si rezultat i marrjes në pyetje, u bë e dukshme se S.T. kishte motiv të qartë për t'iu hakmarrë F.R., për të cilin ajo pretendonte se kishte bashkëpunuar me N.K. në komplotin e vrasjes. Ajo e pranoi se kishte pritur që një person aq i fuqishëm si F.R. do t'i ndihmonte për ta parandaluar burgosjen e Z.T., por se ai kishte refuzuar që ta bënte këtë. Gjykata ka ardhur në përfundim se ajo ka paraqitur

²⁵ .4.2015, f. 3 -7, 13 – 15, 21; 14.5.2015, f. 12.

²⁶ Regjistratori "Përgjigja në NJN nga Bosnja dhe Hercegovina": aktgjykimi i shkallës së parë kundër Z.T. me të tjerë të datës 28.11.13; Aktgjykimet e Gjykatës së Apelit kundër Z.T. me të tjerë të datave 25.4.14 dhe 16.4.15.

³¹ 21.4.2015, f. 11.

²⁷ 21.4.2015, f. 8.

²⁸ 12.5.2015, f. 21 – 22.

²⁹ .4. 7.

2015, f.

akuza të rrejshme kundër tij në shenjë hakmarrjeje. Ai e ka paraqitur përfshirjen e pretenduar të N.K dhe personave të tjerë për t'i përforcuar pretendimet e saj.

121. Shihej qartë se S.T. ka shfaqur interesim për dënimin e N.K, sepse kjo do të sillte

pasoja negative për F.R.

122. Gjykata ka ardhur në përfundimin se faktet që janë paraqitur në aktakuzë në lidhje me komplotin e pretenduar për ta vrarë R.D. janë kundërshtuar bindshëm gjatë shqyrtimit gjyqësor. Faktet janë bazuar ekskluzivisht në deklaratën e S.T. Kredibiliteti i deklaratës së saj është mohuar si rezultat i procedurës së shqyrtimit

të provave gjatë shqyrtimi gjyqësor.

3.3. Pozita e veçantë e S.T. në kompaninë “AVAZ”

Sipas aktakuzës:

Dëshmitarja S.T., një gazetare që punonte prej një kohe të gjatë në një kompani për botimin e gazetave AVAZ dhe në një stacion televiziv në pronësi të F.R., kishte krijuar një marrëdhënie të ngushtë pune me F.R., i cili e përfshinte atë në vendime të rëndësishme lidhur me perandorinë e tij mediale. Meqë ajo ishte një nga pak gazetarët që punonin për F.R. in e që kishin shkollim universitar dhe flisnin rrjedhshëm gjuhën Angleze, F.R. i kishte kërkuar asaj që ta ndihmonte gjatë mbledhjeve të rëndësishme me parterët ndërkombëtarë dhe vendorë të biznesit dhe me politikanët.

123. S.T. ka pretenduar se ka pasur pozitë të veçantë në AVAZ, jo vetëm në aspektin profesional, si gazetare dhe përkthyes, por edhe si dorë e djathtë e F.R.³⁵.

124. Kjo “pozitë e veçantë” pretendohet se e shpjegon praninë e saj në takime të ndryshme të rëndësishme, sepse F.R. i ka besuar dhe po ashtu ka biseduar më vonë me të për atë që është thënë. Pretendohet se për këtë arsye ajo ka qenë e pranishme në takimet kur është diskutuar dhe planifikuar vrasja e R.D.

³⁵ 12.5. 15.

125. Megjithatë, një numër faktesh që S.T. i ka paraqitur lidhur me “pozitën e veçantë” të saj në “AVAZ” janë mohuar gjatë gjykimit, çfarë u ka kontribuar dyshimeve lidhur me vërtetësinë e saj.

126. Gjykata ka gjetur se, duke filluar nga dhjetori i vitit 2001, S.T. ka punuar për “AVAZ”-in, kompaninë mediale që ka qenë pronë e F.R.³⁶. Fillimisht, ajo i ka përkthyer artikujt nga gjuha angleze në gjuhën boshnjake, të cilat janë botuar në edicione të ndryshme AVAZ-it. Pas ca kohëve, ajo ka filluar të shkruaj artikuj vet, të cilët janë botuar në revistën “Express”, në pjesën e saj të quajtur “Kronika e Zezë”, e cila ka qenë për aktivitetet kriminale në Bosnjë dhe Hercegovinë³⁷. Në vitin 2004, ajo e ka pasur edhe një emision televiziv³⁸. Ajo ka qenë redaktore e këtij emisioni, i cili është quajtur *Kontragarda*³⁹.

127. Faktet e lartpërmendura i ka konfirmuar edhe F.R.⁴⁰.

128. Është dëshmuar se S.T. ka qenë punonjësja e vetme në “AVAZ” që ka mundur të flasë anglisht, prandaj ka marrë pjesë në takimet e F.R. me përfaqësues politikë të lartë, ambasadorë dhe persona të tjerë të rëndësishëm e relevantë për Bosnjën dhe Hercegovinën si dhe me afaristë të huaj, siç ka thënë ajo⁴¹.

129. Sipas F.R., kanë qenë tri grupe të përkthyesve në Kompaninë “AVAZ” – që kanë përkthyer artikuj, që kanë shkruar artikuj në gjuhën angleze dhe që kanë përkthyer dokumente zyrtare, kontrata, etj. Në vitin 2001, kanë qenë 20-30 njerëz me njohuri të gjuhës angleze, së paku 7 njerëz kanë punuar në përkthimin

³⁶ 16.3.2015, f.5; data 20.4.2015, f. 3; kontrata e punësimit, por e datës 15 qershor 2004, 16.3.2015 f. 8 – 9; 20.4.2015, f. 33; 18.5.2015, f. 8 – broshura e punësimit, kartelat e identifikimit për gazetarë.

³⁷ 16.3.2015; f. 9-10.

³⁸ Procesverbali i datës 16.3.2015, f. 6, 21.

³⁹ 12.5.2015, f. 4.

⁴⁰ 28.10.2016, f. 4 – 5.

⁴¹ 16.3. 13; fotografitë nga takimet që i janë treguar asaj.

e revistës javore “Avaz” në gjuhën angleze, duke përfshirë S.Nu.⁴². Ata kishin filluar ta botonin revistën javore “Avaz” në gjuhën angleze qysh në vitin 1997, por kjo ishte ndërprerë pas disa viteve (2-4)⁴³. **S.Nu.** ka thënë se revista javore “AVAZ” është botuar në gjuhën angleze në 1998-1999. Kjo nuk ka zgjatur shumë, sepse nuk ka qenë efektive për nga kostoja. S.T. nuk ka punuar për këtë revistë⁴⁴.

130. Gjatë marrjes në pyetje të tërthortë, **S.T.** është përballur me edicionin e gazetës ditore “Avaz” në gjuhën angleze të vitit 1997⁴⁵. Sipas saj, artikujt në gjuhën angleze kanë qenë vetëm “copy-paste”. Një apo 2 vite pasi është larguar, është mbajtur një ceremoni e madhe për ta botuar “Avaz”-in në gjuhën angleze⁴⁶. Edicioni i vitit 1997 ka qenë ndoshta vetëm version testues në gjuhën angleze. Ajo ka thënë dhe ka “garantuar me jetën e saj” se “Avaz”-i nuk është botuar në gjuhën angleze⁴⁷.

131. **F.R.** ka dëshmuar se edhe S.Nu. ka qenë përkthyes gjatë takimeve zyrtare. Veç kësaj, shumica e ambasadave i kanë dërguar përkthyesit e tyre. Me këtë rast, F.R. ka treguar shumë fotografi me zyrtarë dhe me S.Nu., por pa S.T. Ajo kurrë nuk ka përkthyer gjatë takimeve zyrtare, për shkak të mungesës së njohurive dhe kompetencës⁴⁸.

132. **S.Nu.** ka konfirmuar se e flet anglishten; ai e ka mësuar atë gjatë aftësimit profesional në ShBA. Kjo ka qenë në vitin 1999-2000, ndërsa ka zgjatur 14

⁴² 27.10.2016, f. 33 - 34.

⁴³ 27.10.2016, f. 34 dhe kopjet e ballinave të “Dnevni Avaz”-it në gjuhën angleze. ⁴⁴ 09.12.2016, f. 15.

⁴⁵ 21.4.2015, f. 22-24.

⁴⁶ 21.4.2015, f. 23-24.

⁴⁷ 21.4.2015, f. 24.

⁴⁸ 28.10.2016, f. 7 -8.

muaj. Është sponsoruar nga *Zëri i Amerikës*³⁰. Ai ka qenë përgjegjës për kontaktet ndërkombëtare në AVAZ. Ka qenë personi i vetëm që e ka bërë këtë; sigurisht se nuk ka qenë S.T.³¹. Kur i ka qenë jashtë vendit, askush nuk e ka zëvendësuar në këtë funksion si përkthyes. Të huajt kanë ardhur me përkthyesit e tyre³²³³. Dëshmia e tij ka qenë bindshëm në kundërshti me pretendimet dhe vërtetësinë e S.T.

133. Ishte e qartë se S.T. ishte e prirë të mburrej për kualifikimet, shkathtësitë, kontaktet dhe pozitën e jashtëzakonshme të saj. Për shembull, ajo ia ka treguar gjykatës fotografinë e saj me W.P., Përfaqësuesin e Lartë në Bosnjë, për t'i dëshmuar raportet e mira me të. Gjatë marrjes në pyetje, ajo e ka pranuar se kjo fotografi ishte bërë rastësisht sa ka qenë drejtuese e ceremonisë gjatë përvjetorit të "AVAZ"-it⁵². Këtë fakt e ka konfirmuar edhe F.R.³⁴.

134. Gjykata nuk e ka konsideruar të besueshme deklaratën e **K6**, e cili ka pretenduar se përkthimet i ka bërë kryesisht S.T. Ai ka pranuar se ka qenë edhe S.Nu., por se ai është përdorur rrallë për këtë⁵⁴. Si shofer që ka punuar në AVAZ, ai nuk mund të ketë qenë në dijeni se kush ka përkthyer gjatë takimeve kur ai nuk ka qenë aty. Përveç kësaj, gjatë procedurës është dëshmuar se ai e ka ruajtur një raport të mirë me S.T. gjatë këtij gjykimi, kështu që nuk ka arsye serioze për të

³⁰ 9.12.2016, f. 4.

³¹ 9.12.2016, f. 9.

³² 9.12.2016, f. 15.

³³ .4.2015, f. 12 – 13.

³⁴ 28.10.2016, f. 8 – 9.

⁵⁴ 15.9.2015, f. 20.

besuar se ai vetëm e ka përsëritur atë që ia ka thënë S.T.

135. Kur është përballur me provat që kanë treguar se ka pasur njerëz të tjerë që kanë punuar në AVAZ dhe që e kanë njohur gjuhën angleze, S.T. e ka pranuar këtë fakt. Megjithatë, ajo ende ka pretenduar se anglishtja e tyre nuk ka qenë e mirë⁵⁵. Më vonë ajo është tërhequr nga një deklaratë kategorike e tillë. Ajo ka thënë se nuk mund ta ketë ditur nëse F.R. e ka përdorur shërbimin e njerëzve të tjerë, përfshirë atë të S.Nu. Kjo çështje është shembull i tendencës së saj për t'ia përshtatur dëshminë e saj provave me të cilat është përballur⁵⁶.

3.4. Ndikimi në shkrimet e S.T.

136. Nuk është provuar se N.K. dhe F.R. kanë ndikuar në S.T. për të shkruar apo mos shkruar për disa njerëz dhe/apo në ndonjë mënyrë të caktuar. Të dy e kanë mohuar këtë. Ajo nuk ka qenë konsistente në dëshminë e saj, sepse kur ku i janë treguar artikujt e shumtë që i kishte shkruar për këta njerëz specifikë për të cilët do të duhej të kishte qenë e ndaluar të shkruante, ajo e ka pranuar se e ka bërë këtë përkundër udhëzimeve⁵⁷. Ajo ka ndërruar mendje përsëri gjatë marrjes në pyetje të tërthortë kur ka thënë se F.R. nuk është ndjerë rehat që t'i drejtohej kryeredaktorit të saj dhe ta pyeste për artikujt specifikë⁵⁸. Në këtë mënyrë, ajo ka rënë në kundërshti edhe me deklaratën e saj të mëparshme kur ka thënë se askush nuk ka guxuar ta kundërshtonte F.R.⁵⁹. Kjo mospërputhje e ka bërë deklaratën e saj të pabesueshme në këtë pjesë, çfarë i ka kontribuar vlerësimit të përgjithshëm të tërë dëshmisë.

⁵⁵ 20.4.2015, f. 33, 22.4.2015, f. 11.

⁵⁶ 21.4.2015, f. 24 – 25; 22.4.2015, f. 12.

⁵⁷ 16.3.2015; f. 21, 14.5.2015, f. 10-11, 14.5.2015, f. 12, 18.3. 2015, f. 20 – 22. ⁵⁸ 21.4.2015, f. 4.

⁵⁹ 16.3.2015; f. 21.

137. ³⁵Nuk është provuar se, sipas S.T., të gjithë artikujt që janë botuar në gazetën ditore “Avaz” është dashur të kontrolloheshin nga F.R. e më vonë edhe nga ai, edhe nga N.K.⁶⁰.

Përmbledhje e provave relevante

138. Deklaratat e saj i ka mohuar **F.R.**, i cili ka thënë se nuk e ka kontrolluar përmbajtjen e artikujve që janë botuar në revistat dhe gazetat e tij. Ai ka nënvijëzuar se nga viti 2001 është marrë kryesisht me investime dhe me ndërtimin e ndërtesave³⁶.

139. Ai po ashtu ka shpjeguar se kurrë nuk ka dëgjuar që e ka thirrur ndonjë person për të cilin ka shkruar S.T. Nuk i ka lexuar artikujt e saj. Nuk i ka lexuar revistat. Ajo kurrë nuk i është ankuar se ka qenë në presion. Nuk e di se a e ka thirrur N.K. apo jo. Ka ndodhur vetëm njëherë që ajo ka ardhur te ai dhe i ka thënë se kishte marrë kërcënime nga Da.E.³⁷. F.R. kurrë nuk e ka udhëzuar S.T. që të shkruante për N.K. Kurrë nuk i ka dhënë udhëzime³⁸.

140. Për më tepër, asnjë person i arsyeshëm nuk do të besonte se dikush që ka mbajtur post politik të lartë dhe që ka qenë i përfshirë në biznes në një shkallë mjaft të lartë (që mund të dëshmohet së paku nga fakti se Kompania AVAZ i ka ndërtuar dy ndërtesa të mëdha në Sarajevë – Hotelin “Radon Plaza” dhe “Twisted

³⁵ .3.2015, f. 11.

³⁶ 28.10.2016, f. 3.

³⁷ 28.10.2016, f. 19.

³⁸ 28.10.2016, f. 21.

Tower”) do të kishte pasur kohë për t’i lexuar materialet e botuara në një kronikë të zezë në njërën nga revistat e tij.

3.5³⁹⁴⁰. Marrëdhëniet midis S.T. dhe F.R.

141. Është dëshmuar se S.T. është takuar shpesh me F.R.⁶⁴. Megjithatë, nuk ka dëshmi se ajo është bërë dora e djathtë e tij dhe është përfshirë në çështje që kanë kërkuar besimin e madh të tij⁶⁵.
142. Ky fakt në lidhje me marrëdhënien mjaft të afërt midis S.T. dhe F.R. rezulton edhe nga dëshmia e tij, përkundër përpjekjeve të tij për të bindur se kjo nuk ka qenë aq e pazakonshme, sepse ai ka pretenduar se ka pasur marrëdhënie të mira me të gjithë 500-600 punonjësit e tij⁴¹. Megjithatë, gjykata ka konstatuar se është e pamundur të kesh marrëdhënia në nivel të njëjtë me një numër aq të madh njerëzish.

Përmbledhje e provave relevante

143. **F.R.** ka dëshmuar se është takuar me S.T. në restorantit rrotullues ndoshta një apo dy herë gjatë tërë periudhës sa ajo ka punuar për këtë kompani⁴² dhe se në këto raste janë takuar privatisht⁴³. Ai po ashtu e ka pranuar se ka shkuar në zyrën private të tij dhjetëra herë, së paku. Ai ka shpjeguar se i ka ftuar punonjësit me të cilët ka pasur marrëdhënie të mira dhe miqësore dhe se S.T. i ka përkitur këtij

³⁹ .3.2015; P. 10.

⁴⁰ .3.2015, f. 13, 18.3. f.13 – 14.

⁴¹ 28.10.2016, f. 10, 11 – 12.

⁴² 28.10.2016, f. 10.

⁴³ 28.10.2016, f. 15.

- grupi. Në këto raste, ajo kryesisht është ankuar për konfliktin që e ka pasur me kolegët e saj dhe për tekstet që nuk i janë botuar⁴⁴. Ajo po ashtu i ka folur për problemet private të saj, por ai nuk ka dashur të flasë për to publikisht⁴⁵.
144. Ai ka filluar që të ketë marrëdhënie të mira me S.T. një vit/një vit e gjysmë pasi ajo ka filluar të punojë për AVAZ-in⁴⁶. E ka pasur numrin e telefonit privat të saj, por ashtu siç i ka pasur edhe të gazetarëve të tjerë. Në shumë raste, ai i ka dërguar asaj SMS⁴⁷.
145. Kurrë nuk ka folur me S.T. për çështjet afariste. Ajo nuk ka pasur status të veçantë në AVAZ. Nuk kanë pasur marrëdhënie private të veçanta^{48,49,50}.

3.6. Takimi i parë i N.K dhe S.T.

146. Nuk është provuar se ka qenë F.R. ai që i ka njoftuar S.T. dhe N.K. dhe që e ka prezantuar S.T. si dorë të djathtë të tij. Përveç kësaj, nuk është provuar se ai më vonë e ka paralajmëruar se N.K. ka qenë njeri shumë i rrezikshëm, i përfshirë madje edhe në aktivitete kriminale, duke përfshirë vrasjet. Këtë e kanë mohuar edhe F.R., edhe N.K. Përveç kësaj, një konstatim i tillë do të binte ndesh me vlerësimin e S.T. për F.R. si njeri tejet i kujdesshëm dhe madje paranojak⁷⁴.
147. Krahas kësaj, S.T. është tërhequr nga kjo deklaratë gjatë marrjes në pyetje të tërthortë, duke thënë vetëm se sipas të gjitha gjasave ka qenë F.R. ai që e ka

⁴⁴28.10.2016, f. 11.

⁴⁵ 28.10.2016, f. 12.

⁴⁶ 28.10.2016, f. 12.

⁴⁷ 28.10.2016, f. 13.

⁴⁸ 31.10.2016, f. 44-45.

⁴⁹ .3.2015; f. 18. ⁷⁵

18.5.2015, f. 40.

⁵⁰ .5.2015, f. 28.

njoftuar me N.K.⁷⁵. Gjatë marrjes në pyetje të mëtejshme, ajo ka pranuar se nuk i është kujtuar se kur është takuar me N.K. për herë të parë⁷⁶.

Përmbledhje e provave relevante

148. **F.R.** nuk e ka përjashtuar mundësinë që ta ketë njoftuar N.K. me S.T. apo që ata të dy të jenë njohur me njëri tjetrin para tij⁵¹. Është e mundur që ai të jetë njohur me të dhe me të tjerët⁵².
149. **N.K.** ka dëshmuar se e ka njohur S.T. qysh para situatës kur F.R. i ka prezantuar të dy me njëri tjetrin. Ai është takuar me të në vitin 2003 apo 2004 në Sarajevë në kafenenë “Barsa”, pronar i së cilës ka qenë njëri nga miqtë e tij, S.P. Këtë kafene e kanë frekuentuar gazetarët, aktorët, të famshmit, përfshirë S.T. S.P.i i ka njoftuar. Sipas kërkesës së saj – së cilës ai i është përmbajtur – ai nuk i ka treguar F.R. se e kanë njohur njëri tjetrin⁷⁹.

3.7. Njohja midis N.K, N.O., F.R., S.S., Ek.L., M.A.G. dhe S.T.

150. Është dëshmuar se N.K., N.O., F.R., S.S., Ek.L., M.A.G. dhe S.T. e kanë njohur njëri tjetrin, por nuk kanë qenë në ndonjë grup të miqve të afërt, siç ka pretenduar prokuroria duke u bazuar në deklaratën e S.T. Deklarata është kundërshtuar nga dëshmitë e N.O., F.R., S.S., Ek.L., M.A.G. dhe nga deklarata e N.K, të cilat janë përputhur me njëra tjetrën dhe nuk kanë përmbajtur

⁵¹ 28.10.2016, f. 9.

⁵² 28.10.2016, f. 13.

⁷⁹ 4.10.2017, f. 9.

mospërputhje.

Përmbledhje e provave relevante

151. Nga deklaratat e N.K dhe F.R rezulton ata me gjasë për herë të parë janë takuar në vitin 2004 apo 2005. Sipas **N.K**, kjo ka ndodhur në hotelin e tij, sepse F.R. e ka pasur vilën e tij në afërsi të tij. Ai nganjëherë ka ardhur për kafe⁵³.
152. **F.R.** nuk ka qenë në gjendje ta ndërlihte takimin e parë me N.K. me ndonjë ngjarje të veçantë⁵⁴. Ata janë takuar midis vitit 2005 dhe 2006. N.K. ka qenë në listën e partnerëve afaristë të AVAZ-it. Atij nuk i është kujtuar se ku ka ndodhur takimi, nëse ka qenë në “Radon Plaza” apo “Casa Grande” apo në ndonjë vend të tretë⁵⁵. Më vonë ai ka thënë se është e mundur që me N.K. të jetë takuar qysh në vitin 2001. Ai e ka arsyetuar këtë mungesë konsistence me faktin se është takuar me shumë njerëz⁵⁶.
153. Sipas F.R., ai ka ardhur në kontakt me N.K. jo më shumë se vetëm disa herë⁵⁷. Të gjitha takimet me N.K. ka qenë të rastësishme apo spontane⁵⁸. F.R. e ka konfirmuar se është takuar me N.K. një herë në “Casa Grande”, e cila gjendej në afërsi të shtëpisë së tij, të cilën e ka shitur më vonë⁵⁹. Pas pak, ai ka pranuar se ka qenë atje dy herë⁶⁰.

⁵³ 4.10.2017, f. 7, 27.10.2016, f. 23.

⁵⁴ 27.10.2016, f. 20.

⁵⁵ 27.10.2016, f. 18-19.

⁵⁶ 27.10.2016, f. 19.

⁵⁷ 27.10.2016, f. 28.

⁵⁸ 27.10.2016, f. 20, 24.

⁵⁹ 27.10.2016, 23.

⁶⁰ 27.10.2016, 24.

⁸⁸ 27.10.2016, 23.

f.

f.

f.

154. Pastaj, ai ka dëshmuar se N.K. ka ardhur në një restorant në “Radon Plaza”, në bouling. Nuk ka qenë problem që t’i drejtoheshe atij si afarist, t’i shtrëngoje duart me të, etj.⁸⁸ F.R. e ka parë N.K. aty së paku disa herë, përfshirë në restorantin rrotullues⁶¹. Kurrë nuk është takuar me N.K. në zyrën e tij⁶². Kurrë nuk ka marrë para nga ai për fushatën elektorale të tij⁶³. Marrëdhëniet e tyre kanë qenë korrekte. E kanë njohur njëri tjetrin. I janë drejtuar njëri tjetrit me “ti”⁶⁴.
155. Në vitin 2005 apo 2006, F.R. është informuar nga R.G. për disa polemika lidhur me N.K. dhe i ka thënë se do të ishte mirë që ai t’i ndërpriste kontaktet me të. Ai e ka ndjekur këshillën e tij, por mund të ketë ndodhur që t’i ketë shtrënguar duart me N.K. ndonjëherë⁶⁵. F.R. nuk e ka pyetur R.G. për arsyet. E ka trajtuar këtë si këshillë diplomatike⁶⁶. R.G. nuk ka dhënë detaje⁶⁷⁶⁸.
156. Dëshmitë e **N.O.** dhe **F.R.** për rrethanat në të cilat janë takuar me njëri tjetrin përputhen.
157. Sipas **N.O.**, ata e kanë njohur njëri tjetrin që nga viti 2006, pasi është kthyer nga Haga, dhe se në këtë periudhë ai ka qenë në qendër të interesimit të mediave,

⁶¹ 27.10.2016, f. 24.

⁶² 27.10.2016, f. 25.

⁶³ 31.10.2016, f. 13.

⁶⁴ 27.10.2016, f. 28.

⁶⁵ 27.10.2016, f. 28 – 29.

⁶⁶ 27.10.2016, f. 29.

⁶⁷ 31.10.2016, f. 41.

⁶⁸ 7.7.2016, f. 29-30.⁹⁷

28.10.2016, 20.

f.
f.
f.
f.
f.

edhe të TV “Alfa”-s⁹⁶. **F.R.** ka konfirmuar se është takuar me N.O. me gjasë pas lirit të tij nga akuzat në Hagë. Nuk i janë kujtuar rrethanat. Kur N.O. ka qenë në gjykim, AVAZ-i i ka mbështetur fëmijët e tij financiarisht⁹⁷.

158. **N.O.** e ka konfirmuar se ka shkuar nganjëherë në “Radon Plaza”, por jo për tu parë me F.R. Ai ka qenë i afërt me liderin e Partisë “Veprimi Demokratik”, e cila ka qenë rivale e F.R. Në vitin 2014, N.O. e ka udhëhequr fushatën presidenciale të A.I., konkurrentit të drejtpërdrejtë të F.R.⁶⁹. **F.R.** nuk e ka përjashtuar mundësinë që edhe N.O. të ketë ardhur në restorantin rrotullues⁷⁰⁷¹.
159. Siç rezulton nga deklaratat e besueshme të **N.K** dhe **N.O.**, të cilat e përplotësojnë njëra tjetrën, ata janë takuar në fund të vitit 2006, pasi ky i fundit është kthyer nga Haga. N.O. i ka treguar N.K për kohën që e ka kaluar me disa shqiptarë nga Kosova në burg dhe ia ka transmetuar një mesazh nga ta¹⁰⁰. Ai e ka pyetur N.K. nëse mund ta ndihmonte në akomodim gjersa ta merrte një banesë nga shteti. N.K. është pajtuar⁷²⁷³. Si rezultat i kësaj, N.O. është shpërngulur nga “Casa Grande” në fund të vitit 2006/fillim të vitit 2007. Ka qëndruar aty një vit/një vit e gjysmë. Sa ka jetuar aty, është takuar me N.K. pothuajse çdo ditë për kafe¹⁰².
160. **M.A.G.** dhe **N.K.** kanë konfirmuar se e kanë njohur njëri tjetrin nga viti 1998/1999, por nuk kanë mbajtur kontakt së paku nga viti 2005, për shkak të disa tensioneve midis tyre. Ata kanë paraqitur arsye të ndryshme për këtë ndarje, por

⁶⁹ 28.10.2016, f. 15; 31.10.2016, f. 22.

⁷⁰ 28.10.2016, f. 26.

⁷¹ .7.2016, f. 26.

⁷² 4.10.2017, 6-7, 22.7.2016, f. 26.

⁷³ .7.2016, 26 – 27.

f.

gjykata e ka konsideruar si të dëshmuar se kjo ka ndodhur.

161. **M.A.G.** ka dëshmuar se e ka njohur N.K. nga viti 1999, 2000 apo 2001. Nuk ka qenë i sigurt për datat, sepse ka qenë në burg për një kohë të gjatë. Ka qenë marrëdhënie miqësore, pa ndonjë përfshirje në biznes⁷⁴. Ka marrë fund, sepse N.K nuk i ka pëlqyer sensi i tij për humor dhe fakti se M.A.G. po përhapte thashetheme. E kanë ndërprerë komunikimin në vitin 2003, për shkak të shakave për femrat⁷⁵. Nuk ka pasur kontakte me N.K. në vitin 2006 apo 2007¹⁰⁵.

⁷⁴ 6.12.2016, 14, 18.

⁷⁵ 6.12.2016, 15, 36.

¹⁰⁵ 6.12.2016, 27.

f.
f.
f.
f.
f.

162. **N.K.** ka thënë se është takuar me M.A.G. në vitin 1998, në Bosnjë. Në vitin 2001 apo 2002, ai ka qenë kumbarë në dasmën e tij. Kanë pasur marrëdhënie të mira, por marrëdhëniet e tyre janë ftohur në vitin 2003, pasi kanë ndodhur të shtënat me Z.T. në “Holiday Inn”. N.K. e ka akuzuar atë që e ka njoftuar me Z.T.⁷⁶. Pas vitit 2005, ai i ka ndërprerë kontaktet me M.A.G. për shkak të disa mosmarrëveshjeve për femra, sepse ishte person që kishte qejf të fliste. M.A.G. ende shoqërohej me djemtë dhe shokët e djemve të N.K, sepse ishte më i ri dhe shkonte në diskoteka⁷⁷.
163. **F.R.** nuk e ka njohur M.A.G. Ai ka dëgjuar për të vetëm nga mediat⁷⁸.
164. **Ek.L.** ka dëshmuar se e ka njohur M.A.G. “nga qyteti”. Kurrë nuk kanë pirë kafe së bashku. Nuk kanë pasur asgjë të përbashkët.¹⁰⁹
165. **M.A.G.** nuk i ka njohur F.R. dhe N.O.¹¹⁰.
166. **N.O.** dhe **Ek.L.** kanë qenë konsistent se e kanë njohur njëri tjetrin që nga viti 1995. Vetëm janë njohur. Përveç kësaj, janë takuar në “Equestrian Club”. Kanë qenë të dy në bordin menaxhues të tij¹¹¹.
167. **Ek.L.** ka dëshmuar se është takuar me N.O. në vitin 2006, kur ai është kthyer nga Haga. Është takuar me të, por shumë rrallë. Nganjëherë është takuar me të në kafenenë “Va.”, por ka pasur shumë njerëz përreth. Nuk kanë qenë shokë¹¹². Ka

⁷⁶ 5.10.2017, f. 2-4, 6.10.2017, f. 17 – 18.

⁷⁷ 6.10.2017, f. 16.

⁷⁸ 28.10.2016, 20.

f.
f.
f.
f.
f.

ndodhur të jenë takuar me njëri tjetrin, por përherë kanë qenë në shoqërinë e

¹⁰⁹

19.7.2016, 17.

¹¹⁰

6.12.2016, 27.

¹¹¹

22.7.2016, 29.

¹¹² 19.7.2016,

16.

njerëzve të tjerë¹¹³. Është takuar me të edhe në klubin e kuajve. Ka qenë kryetar i këtij klubi. Në parim, nuk i është kujtuar se kush ka qenë atje¹¹⁴.

168. **F.R.** e ka njohur Ek.L. për 25-27 vjet. Të dy kanë qenë gazetarë, kanë qenë shokë të ngushtë, dhe nganjëherë janë takuar shumë shpesh, nganjëherë shumë rrallë. Janë takuar me njëri tjetrin në “Radon Plaza”, në pjesë të ndryshme të tij, duke përfshirë restorantin rrotullues. Edhe Ek.L. ka ardhur aty me partnerët dhe bashkëpunëtorët afaristë të tij. Përveç kësaj, në një kohë të caktuar ka qenë lider i SPD-së, prandaj janë takuar në restorantin rrotullues mjaft shpesh. Edhe ai ka ardhur në zyrën e tij¹¹⁵. Në shumë raste janë takuar në restorantin rrotullues¹¹⁶. Po ashtu e kanë vizituar njëri tjetrin në banesat e tyre; F.R. është takuar me të në zyrën e tij. Një karakter i tillë i lidhjes së tyre është konfirmuar edhe nga Ek.L.¹¹⁷.

169. **Ek.L.** ka dëshmuar se e ka njohur N.K. që nga viti 1987, kur ka punuar si gazetar dhe ka dashur ta zhvillonte një intervistë me M.Ba., disidentin politik më të madh në Kosovë. Ai ka rënë në kontakt me të përmes N.K, i cili e ka pasur një butik në ndërtesën e njëjtë ku ka qenë redaksia e tyre. Pastaj nuk kanë pasur më

f.

f.

f.

f.

f.

kontakte për pothuaj 10 vjet, për shkak të luftës në Bosnjë dhe Kosovë. Në vitin 2001, N.K. është kthyer në Sarajevë, ndërsa ata e kanë vazhduar njohjen e tyre. Nuk kanë pasur biznes të përbashkët. Nuk kanë folur kurrë për R.D.¹¹⁸. Nuk i kujtohet nëse është takuar me N.K. në restorantin rrotullues¹¹⁹.

¹¹³ 19.7.2016, f. 33.

¹¹⁴ 19.7.2016, f. 33.

¹¹⁵ 28.10.2016, 21-22.

¹¹⁶

19.7.2016, 15.

¹¹⁷

19.7.2016, 15, 25 – 26, 35, 37.

¹¹⁸

19.7.2016, 25 – 26.

¹¹⁹ 19.7.2016, 35.

170. ⁷⁹⁸⁰**N.O.** e ka njohur **S.S.** para luftës. Ai ka qenë njëri nga themeluesit e partisë SDA, së bashku me presidentin A.I.¹²⁰. Mund të ketë ndodhur që e ka takuar S.S. në praninë e S.T., ndërsa kjo ka qenë në rastin kur F.R. ka blerë vetura nga N.K.¹²¹.

171. **F.R.** e ka konfirmuar se e ka njohur **S.S.** Ai është takuar me të në zyrën e A.I. Janë takuar nganjëherë, por me një ndërprerje prej 7-8 vitesh e pastaj kanë ndenjor bashkë më shpesh për një muaj⁸¹⁸².

172. **Ek.L.** e ka njohur **S.S.** E kanë njohur njëri tjetrin që nga viti 2002, 2003 apo 2004. Janë takuar për shkak të përfshirjes së tyre në politikë. Shpesh kanë pirë

⁷⁹ .7.2016, f. 30.

⁸⁰ .7.2016, f. 31.

⁸¹ 28.10.2016, f. 26.

⁸² .7.2016, 17.

f.
f.
f.
f.
f.

kafe bashkë¹²³.

173. **S.S.** ka dëshmuar se e ka njohur N.K., se janë takuar 5 apo 6 vite pas luftës dhe se i ka njoftuar një mik i përbashkët, “I.” nga Stambolli. Miqësia e tyre është thelluar pasi N.O., të cilin ai e ka njohur si hero të luftës, ka ardhur nga Haga dhe ka filluar të jetojë në “Casa Grande”⁸³. Nuk kanë pasur ndonjë biznes së bashku⁸⁴. E ka njohur R.D., të cilin e ka takuar para luftës. Kanë pasur marrëdhënie të mira. Nuk kanë pasur as biznes, as ndonjë konflikt me njëri tjetrin⁸⁵. E ka njohur edhe F.R. që nga viti 1994. Marrëdhëniet e tyre kanë qenë tekanjoze – herë më të mira, herë më të këqija. Marrëdhëniet më të mira i kanë tani. Nuk kanë ndonjë biznes së bashku¹²⁷. Marrëdhëniet e tij me Ek.L. kanë qenë më të mirat. Janë takuar me njëri tjetrin pothuajse çdo ditë, posaçërisht gjatë pesë-gjashtë viteve të fundit⁸⁶.
174. **N.O.** ka konfirmuar se e ka njohur S.T., e cila e ka intervistuar shkurtimisht pas kthimit të tij nga Haga. Pas kësaj, ai është takuar me të në disa raste; kanë pirë kafe së bashku me të me dhe me gazetarët e tjerë. Ai është takuar edhe me gazetarë të tjerë⁸⁷.

⁸³ 7.12.2016, 3.

⁸⁴ 7.12.2016, 5.

⁸⁵ 7.12.2016, 4-5.

¹²⁷ 7.12.2016, 5.

⁸⁶ 7.12.2016, f. 5-6.

f.
f.
f.
f.
f.

175. **Ek.L.** ka konfirmuar se e ka njohur S.T. E ka takuar si gazetar që ka punuar në Express, sipas të gjitha gjasave para vitit 2006. Nuk ka pasur marrëdhënie të ngushtë me të; kurrë nuk ka pirë kafe me të dhe kurrë nuk e ka thirrur. E kanë pasur një fotografi të përbashkët që është bërë gjatë një ndeje në përvjetorin e AVAZ-it⁸⁸. Ka potencuar se ajo fotografi nuk ka pasur ndonjë domethënie për të, sepse ka bërë mijëra fotografi me femra¹³¹.
176. **M.A.G.** ka konfirmuar se e ka njohur S.T. dhe se ajo ka qenë në dasmën e tij. Kanë pasur marrëdhënie të shkëlqyeshme¹³². Kjo miqësi ka zgjatur deri në ngjarjet në Turqi, kur ai është takuar me R.D., sepse ajo e ka ditur se ai do të fliste për këtë kudo¹³³. Ai ka pranuar se nuk ka mundur të përmbahej nga thashethemet¹³⁴.
177. **S.S.** ka konfirmuar se e ka njohur S.T. nga AVAZ-i. Ndoshta janë takuar në vitin 2006 apo 2007, kur është hapur hoteli “Radon Plaza”; ai ka ardhur shpesh në restorantin rrotullues. Nuk i kujtohet se kush i ka njoftuar me njëri tjetrin¹³⁵. Nuk

¹³¹ 19.7.2016, 34.

¹³² 6.12.2016, 19.

¹³³ 6.12.2016, 20.

¹³⁴ 6.12.2016, 23.

¹³⁵ 7.12.2016, 6.

⁸⁷ 22.7.2016, f. 29-30.

⁸⁸ 19.7.2016, f. 18, 20.

f.

f.

f.

f.

f.

ka pasur takime të rëndësishme me S.T. Më i rëndësishmi ka qenë kur i ka dhënë intervistë. Nuk kanë qenë miq. Mund të kenë pirë kafe së bashku, por jo dreka etj. Nuk është takuar me të në shoqërinë e të tjerëve. Të gjitha takimet e tyre kanë qenë të rastit⁸⁹.

178. **F.R.** ka konfirmuar se S.L. ka qenë vëllam i tij gjatë martesës së tij në Sarajevën e rrethuar. Në këtë ceremoni ka pasur vetëm dëshmitarë⁹⁰. S.L. ka qenë vëllami i F.R. vetëm rastësisht, për shkak të rrethanave të vështira në Sarajevë⁹¹.
179. Ai ka qenë i pranishëm në dasmën e S.L. E ka ditur se ka qenë i martuar dy herë, por nuk i ka ditur emrat e grave të tij. Më vonë ka kuptuar se ai B.L. ka qenë gruaja e tij⁹².
180. **N.O.** e ka njohur S.L. Nuk kanë qenë shokë, por vetëm e kanë njohur njëri tjetrin. Kur është kthyer nga Haga, të gjithë kanë dashur të pinë kafe me ta¹⁴⁰.

3.8. Takimet e “grupit të miqve ” në vende publike

Sipas aktakuzës:

S.T. ka dëshmuar se, si asistente e besuar e F.R., ajo ka qenë e pranishme personalisht në disa takime që janë mbajtur në një restorant në katin e pesëmbëdhjetë të ndërtesës së

⁸⁹ 7.12.2016, f. 7.

⁹⁰ 28.10.2016, 22.

⁹¹ 28.10.2016, 23.

⁹² 31.10.2016, 6. ¹⁴⁰

22.7.2016, 33.

f.
f.
f.
f.

'Avaz'-it, në të cilat është planifikuar ekzekutimi i R.D. Në mesin e pjesëmarrësve në këto takime kanë qenë, përveç F.R., S.T. dhe i pandehuri N.K. si dhe Ek.L., biznesmeni nga Sarajeva S.S. dhe N.O., komandant boshnjak që e ka mbrojtur enklavën e Srebrenicës gjatë luftës.

181. Gjykata ka gjetur se nuk është provuar se N.K., N.O., F.R., S.S., Ek.L. dhe S.T. janë takuar si grup njerëzish në restorantin rrotullues të Radom Plaza-s.
182. Provë kryesore në mbështetje të këtij pretendimi ka qenë dëshmia e S.T., e cila do të duhej të ishte mbështetur nga deklaratat e K6 dhe S.C. Gjykata e ka vlerësuar këtë provë si të pambështetshme.
183. Dëshmitë e dëshmitarëve të lartpërmendur bien ndesh me deklaratat e N.K, N.O., F.R., S.S. dhe Ek.L., të cilët e kanë mohuar në mënyrë konsistente të kenë ndenjur ndonjëherë të gjithë së bashku me S.T. në restorantin rrotullues dhe e kanë arsyetuar këtë në mënyrë bindëse.
184. Për më tepër, gjykata e ka vlerësuar dëshminë e K6 si të pambështetshme, për shkak të kundërthënive të dukshme në përmbajtjen e saj. Fillimisht, kur është pyetur se si është mbrojtur F.R. në restorantin rrotullues, ai ka thënë se nuk ka pasur nevojë ta përcillnin atje, por vetëm e kanë thirrur kamerierin dhe e kanë pyetur nëse F.R. ishte aty. E kanë monitoruar nga kati i mëposhtëm me kamera vëzhguese¹⁴¹. Vetëm më vonë, kur e ka kuptuar se duhej ta mbështeste rrëfimin e S.T., ai ka dëshmuar se ka qenë i pranishëm aty gjatë takimeve të pretenduara të F.R. me njerëzit e lartpërmendur¹⁴². Krahas kësaj, kur ka qëndruar në dhomën e

f.
f.
f.

mbrojtjes së F.R., ai nuk ka mundur t'i shihte njerëzit në restorant nëpërmjet kamerave vëzhguese, sepse është vërtetuar se ato nuk kanë qenë të instaluar në këtë pjesë, ku janë ulur mysafirët.

185. Një indikacion tjetër se K6 nuk e ka thënë të vërtetën është fakti se e ka ndryshuar dëshminë e tij sa i përket numrit dhe karakterit të takimeve të

¹⁴¹ 15.9.2015, f. 22. ¹⁴²

15.9.2015, f. 24.

pretenduar të F.R., N.K., N.O., S.S. dhe S.T. në restorantin rrotullues¹⁴³. Fillimisht, ai ka pretenduar se i janë kujtuar së paku 10 takime të tilla në një përbërje të tillë; N.K. ka ardhur me Ek.L.¹⁴⁴, S.T. ka ndenjur ulur dhe ka folur me ta. F.R. i ka drejtuar këto takime¹⁴⁵ më vonë. Ai ka ndërruar mendje sa i përket vlerësimit të karakterit të takimeve midis N.K dhe F.R., sepse ka potencuar se N.K. ka qenë vetëm mysafir i F.R. dhe ka ardhur aty shumë rrallë¹⁴⁶. Sipas tij, këto kanë qenë takime miqësore¹⁴⁷. Gjatë dëshmisë së tij të mëtejshme, K6 e ka prezantuar një version tjetër sa u përket marrëdhënieve midis tyre. Këtë herë ai ka thënë se S.T., N.K. dhe S.S. kanë qenë ushtarë të F.R.¹⁴⁸. Në këtë mënyrë, ai ka rënë në kundërshti me vlerësimin e mëhershëm të tij se ka qenë marrëdhënie vetëm miqësore.

186. Dëshmia e S.C., kamarier nga restoranti rrotullues, nuk i ka shërbyer qëllimit për ta konfirmuar ekzistimin e grupit të njerëzve që janë takuar rregullisht në këtë vend siç e ka përshkruar S.T.

187. Pikësëpari, gjatë marrjes në pyetje të drejtpërdrejtë, ai ka pranuar se i ka parë të gjithë këta njerëz, por kurrë së bashku si grup. E ka parë F.R. shpesh me Ek.L.¹⁴⁹. I ka parë shpesh, por jo të gjithë së bashku¹⁵⁰. Mendon se F.R., N.K. dhe Ek.L. i ka parë vetëm një herë. Nuk i ka kujtohet se kur ka qenë kjo situatë, por ka qenë afër kohës kur ka filluar të punonte aty. Mund të ketë qenë një vit apo një vit e gjysmë pasi ka filluar të punonte aty¹⁵¹. I janë kujtuar gjërat më

¹⁴³ 15.9.2015, f. 23.

¹⁴⁴ 16.9.2015, f. 32.

¹⁴⁵ 15.9.2015, f. 28; 33; 16.9.2015, f. 4.

¹⁴⁶ 16.9.2015, f. 31.

¹⁴⁷ 16.9.2015, f. 35. ¹⁴⁸ 16.9.2015, f. 37.

¹⁴⁹
18.7.2016, 6-7.

¹⁵⁰
18.7.2016, 14-15.

¹⁵¹
18.7.2016, 8.

f.
f.
f.

mirë me deklaratën e mëparshme të tij, kur ai pati thënë se “kanë ndenjtur të gjithë me shoqërinë e njëjtë dhe në këtë shoqëri ka qenë F.R.”. Kur është pyetur për të, ai nuk e ka konfirmuar këtë pjesë të deklaratës së tij⁹³.

188. Përveç kësaj, S.C. ka filluar të punonte në restorantin rrotullues në maj/qershor të vitit 2007 dhe ka filluar t’i shërbente F.R. vetëm pas disa muajve⁹⁴. Si rezultat i kësaj, ai nuk ka mundur ta shihte ndonjë takim para vdekjes së R.D. Ky dëshmitar po ashtu ka qenë i qartë se kurrë nuk ka dëgjuar ndonjë bisedë midis tyre.

Përmbledhje e provave relevante

189. Kur është pyetur për takimet e pretenduara të “grupit të miqve” në restorantin rrotullues, N.K. është përgjigjur duke thënë se nga momenti kur ka kuptuar se S.T. ka qenë bashkë me Z.T., çfarë ka ndodhur së paku në vitin 2005, ai kurrë nuk ka pirë kafe me të, as privatisht, as në praninë e të tjerëve¹⁵⁴.

190. N.O. ka mohuar se është takuar ndonjëherë me S.T., F.R., N.K., S.S. dhe Ek.L. në restorantin rrotullues¹⁵⁵. Kur është pyetur për pretendimet e prokurorit se janë takuar në restorantin rrotullues dhe kanë planifikuar se si ta vrisnin R.D., ai ka thënë se kjo është rrenë e kulluar¹⁵⁶. Sipas tij, S.T. është përpjekur t’ia ndërronte kahjen hetimit. Ai ka dhënë dëshmi në gjykimin e Z.T. për rrethanat kur Z.T.

⁹³ 18.7.2016, f. 15.

⁹⁴ 18.7.2016, f. 5, 9. ¹⁵⁴

4.10.2017, f. 16.

f.
f.
f.

është përpjekur ta vriste atë dhe N.K. gjatë martesës së djalit të N.K., e cila është organizuar në “Radon Plaza”¹⁵⁷.

¹⁵⁵

22.7.2016, 31.

¹⁵⁶

22.7.2016, 32.

¹⁵⁷

22.7.2016, 38.

191. **F.R.** ka pretenduar se kurrë nuk është takuar me S.T., N.K., N.O., Ek.L. dhe S.S. në restorantin rrotullues. Ai kurrë nuk ka folur me ta për R.D.⁹⁵.
192. Ai ka konfirmuar se ka pasur kamera vëzhguese në zyrën e tij në “Radon Plaza”, ndërsa nuk ka pasur në pjesët që kanë qenë në dispozicion për mysafirët (përveç hapësirave publike). Nuk ka pasur kamera vëzhguese në pjesën e restorantit rrotullues ku janë ulur mysafirët⁹⁶. Ai ka pasur qasje në të gjitha dhomat dhe hapësirat e hotelit duke e përdorur një kartelë çelës të pronarit⁹⁷. Në zyrën e tij e ka pasur një pajisje e cila është përdorur për ta penguar apo bllokuar përgjimin⁹⁸⁹⁹.
193. Më datën 16 maj të vitit 2015, gjykata e ka refuzuar propozimin e mbrojtjes për ta pranuar manualin e përdorimit të pajisjes së përgjimit si të panevojshëm, sepse çështja për tu dëshmuar ka qenë e njohur përgjithësisht (neni 258 (1.2.1) të KPP-së)¹⁶².

⁹⁵ 28.10.2016, f. 26.

⁹⁶ 27.10.2016, f. 27.

⁹⁷ 31.10.2016, f. 39.

⁹⁸ 31.10.2016, 39 – 40.

⁹⁹ 5.2015, f. 10.

f.

f.

f.

f.

194. F.R. e ka vizituar restorantin rrotullues kurdo që ka pasur kohë. Ky shkua atje dy herë, tri herë në javë. Aty është takuar kryesisht me partnerë afaristë¹⁰⁰. Ka qenë më lehtë për të që pinte në zyrën e tij apo të shkonte tek gazetarët në katin e njëmbëdhjetë¹⁰¹. Restoranti rrotullues ka qenë zakonisht mjaft i zënë. Deri në orën 10.00 në mëngjes, aty është shërbyer kafjalli për mysafirët e hotelit¹⁶⁵.
195. **Ek.L.** ka dëshmuar se ai dhe S.T. kanë kaluar pranë njëri tjetrit në restorantin rrotullues, ku ai shpesh pa shkua për kafe. Vetëm e kanë përshëndetur njëri tjetrin. Kurrë nuk ka ndodhur që të ulen bashku¹⁰². Ka deklaruar se kurrë nuk është ulur në shoqërinë e S.L., N.O., N.K, F.R., S.T. dhe S.S. Ka pranuar se mund të ketë pirë kafe me S.S. dhe F.R. në restorantin rrotullues¹⁰³.
196. **S.S.** ka dëshmuar se është takuar në restorantin rrotullues me Ek.L., nganjëherë me F.R., ndoshta një apo dy herë me N.O., dhe nganjëherë me njerëz të tjerë¹⁰⁴. Nuk është se është takuar me N.K. në restorant, por ndoshta në kafene apo në hapësirën për bouling¹⁰⁵. Nuk është takuar me S.T. në restorantin rrotullues. Ajo nuk ka qenë mjaft e rëndësishme për tu ulur ma ta¹⁷⁰.

¹⁰⁰ 27.10.2016, 30.

¹⁰¹ 28.10.2016, 15.

¹⁶⁵ 31.10.2016, 39.

¹⁰² 19.7.2016, f. 20-21.

¹⁰³ 19.7.2016, f. 21.

¹⁰⁴ 7.12.2016, f. 6.

¹⁰⁵ 7.12.2016, f. 6.

¹⁷⁰ 7.12.2016, f. 7.

¹⁷¹ 7.12.2016, 7.

f.
f.
f.

197. Kurrë nuk ka pasur ndonjë takim në të cilin kanë marrë pjesë S.T., F.R., N.K., N.O., S.S. dhe Ek.L.¹⁷¹. Ka mohuar se ka marrë pjesë ndonjëherë në ndonjë takim ku është diskutuar vrasja e R.D.¹⁰⁶.
198. Kur S.T. ka shpjeguar pse F.R. ka dashur që ajo të ishte e pranishme gjatë takimit ku është diskutuar plani për ta vrarë R.D. (gjatë marrjes në pyetje të tërthortë), ajo ka thënë se ai ka qenë njeri i obsesionuar dhe paranojak. Në rast të ndarjes apo konfliktit me N.K., F.R. i është dashur ta kishte dikë pranë po që se N.K. do ta akuzonte për vrasje apo diçka tjetër. Në atë kohë, S.T. ka qenë mjaft e respektuar, kështu që ajo do t'i ofronte alibi po që se rastësisht N.K. apo njerëzit përreth tij do të vendosnin ta akuzonin. Ajo ka pranuar se F.R. nuk ia ka thënë kurrë, po kjo ka qenë e qartë¹⁰⁷.

¹⁰⁶ 7.12.2016, 7.

¹⁰⁷ 18.5.2015, 33 – 34.

f.

f.

f.

f.

199. Edhe **K6** e ka përshkruar F.R. si njeri shumë të frikësuar, paranojak, hipokondrik. Prandaj është përzier shpesh në punën e zyrtarëve të sigurisë, sepse ka pasur frikë¹⁰⁸.

3.9. Motivet për ta vrarë R.D.

200. Prokurori i ka paraqitur në aktakuzë disa motive të ndryshme pse grupi i pretenduar për të cilin ka treguar S.T. ka qenë i vendosur për ta vrarë R.D.:

- R.D. si luftëtar kundër drogës që është përzier në operacionet e drogës të N.K;
- R.D. si gangster rival;
- Motivet private të F.R.;
- Incidenti në Turqi në vitin 2003 midis M.A.G. dhe R.D.;
- Hakmarrja për vdekjen e S.L.

201. Të gjitha motivet e pretenduara do të analizohen në detaje duke u bazuar në provat që janë paraqitur gjatë shqyrtimit gjyqësor.

3.9.1. R.D. si luftëtar kundër drogës apo si gangster rival

Sipas aktakuzës:

R.D. ka qenë gangster bos në Sarajevë, Bosnjë dhe Hercegovinë, i cili ka hyrë në konflikte me të pandehurin N.K. dhe GKO të tij për një numër arsyesh. Çfarë është më e rëndësishmja, ai i ka denoncuar publikisht operacionet e drogës së të pandehurit N.K.

¹⁰⁸ 15.9.2015, f. 21.

dhe madje “ka bashkëpunuar rregullisht me policinë, prokurorët, dhe kanë folur për punët e tyre. Me këtë, ai e ka rrezikuar F.R. dhe N.K...”

Për më tepër, R.D. i ka përdorur ngjarjet e luftës së fundit për t’i diskredituar publikisht grupet kriminale të tjera të udhëhequra nga etnitë e tjera, siç ishte për shembull grupi që udhëhiqej nga Da.E., edhe pse krimi i organizuar në Bosnjë dhe Hercegovinë ka funksionuar përherë mirë edhe midis etnive që luftuar kundër njëra tjetrës gjatë luftës. Meqë kjo ka rrezikuar t’i lëndonte interesat e biznesit të këtyre grupeve, atyre u është dashur të reagonin.

202. Qëndrimi i prokurorit ndaj R.D. ka qenë së paku konsekuent. Një herë, ai e ka prezantuar atë si hero të luftës, njeri fetar dhe të moralshëm, ndërsa herën tjetër R.D. është shfaqur si bos gangster i përfshirë në biznesin e drogës.
203. Prokurori nuk ka ofruar prova se N.K. ka qenë i përfshirë në krim të organizuar që ndërlidhet me trafikimin e drogës (çfarë do të shtjellohet në detaje në pjesën e mëtejme të këtij aktgjykimi). Megjithatë, ende është e nevojshme që të trajtohet ky pretendim specifik sa i përket motivit për vdekjen e R.D.
204. Gjykata ka gjetur se nuk është provuar se arsyeja për vrasjen e R.D. ka qenë konkurrenca e pretenduar midis tij dhe grupit kriminal të organizuar të N.K. Nëse supozohet se konkurrenca e tij ka rezultuar nga përfshirja e supozuar e R.D. në trafikimin e drogës, prokurori nuk ka paraqitur asnjë provë për të provuar se ka qenë kështu.

205. Në anën tjetër, po ashtu nuk është provuar se R.D. ka qenë luftëtar kundër drogës dhe se si i tillë u ka dhënë informata policisë dhe mediave për shtigjet e drogës, dërgesat e planifikuara dhe njerëzit e përfshirë.
206. Bazuar në dëshminë e **E.D.**¹⁰⁹, **A.P.**¹¹⁰¹¹¹ dhe **A.S.**¹⁷⁷ mund të përfundohet se R.D. ka qenë në parim kundër drogës, por se nuk ka bërë asgjë për ta luftuar. Gjykata gjen se dëshmitë e tyre në këtë aspekt janë të besueshme, sepse këta njerëz, posaçërisht femrat, kanë qenë të afërta me të, kështu që duhet ta kenë ditur qëndrimin e R.D. për drogën. Në anën tjetër, ka qenë e dukshme se ato nuk e kanë ekzagjeruar këtë pjesë të dëshmimeve të tyre duke u përpjekur që ta paraqisnin atë si njeri më të mirë.

Përmbledhje e provave relevante

207. **S.T.** ka dëshmuar se R.D. i ka përdorur përherë kontaktet e tij me gazetarët për t'i akuzuar N.K. dhe F.R. se po merreshin me drogë. Ai i ka raportuar edhe rrugët e drogës¹¹². Ajo e ka mësuar këtë nga gazetarët e tjerë dhe policët. Kur është pyetur për emrat, ajo nuk ka dashur t'i zbulonte, sepse ajo ka pretenduar se ka folur me ta si gazetare¹¹³.
208. Gjatë marrjes në pyetje të tërthortë, ajo ka dëshmuar se raportim i pretenduar nga R.D. nuk ka qenë efektiv, sepse N.K. përherë e ka marrë një mesazh më parë dhe ka arritur ta ndryshonte itinerarin. Megjithatë, R.D. ka folur në media për

¹⁰⁹ 11.12.2015, f. 28, 35.

¹¹⁰ 28.10.2015, f. 13.

¹¹¹ .1.2016, f. 8 – 9.

¹¹² ZT, 16.6.2015, f. 34; 18.3.2015, f. 20.

¹¹³ 18.3.2015, f. 8, 20.

¹⁸⁰ 13.5.2015, f. 36.

- biznesin e drogës të N.K dhe kjo është publikuar gjithkund, përveç në “Avaz”. Përsëri, kur është pyetur për informata specifike, ajo nuk ka qenë në gjendje të tregonte se kur dhe në cilat medime janë publikuar ato¹⁸⁰.
209. **K1** ka dëshmuar se ka dëgjuar shumë histori, sepse “N.K. i ka thënë se R.D. po tregonte histori për të gjoja se ai kishte ardhur në Bosnjë për tu marrë me drogë, për t’i helmuar njerëzit dhe se nuk mund ta zhvillonte biznesin e tij në Bosnjë”. R.D. i ka publikuar të njëjtat histori në gazeta. N.K. ka komentuar se ai ka sajuar histori të rreme¹¹⁴.
210. Deklaratat e të dy dëshmitarëve S.T. dhe K1 nuk janë të bazuara dhe bazohen në thashetheme. Asnjëri nga ta nuk ka qenë në gjendje që të jepte ndonjë detaj për t’i mbështetur këto informata apo për ta treguar burimin e tyre.
211. Prokurori nuk ka paraqitur ndonjë provë të besueshme për ta mbështetur pretendimin e tij se R.D. ka ndërmarrë veprime për ta luftuar drogën dhe se kjo e ka motivuar N.K. për ta organizuar vrasjen e tij. Për më tepër, nëse kjo ka qenë arsyeja për ta bërë këtë, kjo do të ishte bërë me një grup që është marrë me drogë e jo me një “grup të miqve të mirë” (siç e ka quajtur S.T.), të cilët janë takuar në restorantin rrotullues të “Radon Plaza”-s në Sarajevë. Në anën tjetër, sipas S.T., ky raportim i supozuar nga R.D. nuk ka bërë ndonjë dëm, çfarë po ashtu e minon këtë si arsye për vrasje. Mund të bëhet një pyetje retorike: Pse do ta kishte marrë dikush mundin për ta vrarë atëherë?

3.9.2. Motivët private të F.R.

Sipas aktakuzës:

¹¹⁴ 9.11.2016, f. 17.

Si partner afarist dhe mbrojtës politik i të pandehurit N.K. në Sarajevë, F.R. e ka urreyer R.D. për një numër arsyesh personale. Gruaja e F.R. ka qenë në lidhje me R.D. gjatë luftës, para se të martohej me F.R. – rrethanë për të cilën R.D. është mburrur. R.D. po ashtu ka deklaruar publikisht se ka qenë në posedim të dokumenteve që e kanë dëshmuar bashkëpunimin e F.R. me armikun gjatë luftës si dhe intrigat e tij kundër liderëve të tjerë në Sarajevën e kohës së luftës.

212. Prokurori nuk e ka provuar ekzistimin e motiveve private të F.R., të cilat mund ta kenë justifikuar antagonizmin apo armiqësinë e tij ndaj R.D.
213. Është dëshmuar se F.R. dhe R.D. e kanë njohur njëri tjetrin. Këtë fakt e ka dëshmuar **F.R.**, i cili ka përshkruar në detaje kontaktet e tij me R.D., me të cilin është takuar me gjasë në vitin 1992¹¹⁵. Nuk janë takuar më nga viti 1993¹¹⁶. Asnjëri nga anëtarët e familjes së tij nuk e kanë njohur dhe nuk kanë pasur kontakte me R.D.¹¹⁷. Nuk janë takuar me njëri tjetrin për të pirë kafe së bashku¹¹⁸.
214. F.R. ka pretenduar se ia ka pasur frikën R.D.; nuk ka pasur konflikt me të¹¹⁹. Kanë pasur marrëdhënie të mira, ndërsa gjatë luftës kanë qenë pjesëtarë të armatës së njëjtë. Kjo ka pasur domethënie tjetër krahasuar me kohën e paqes¹²⁰. Të gjithë e kanë thirrur “Ç.”¹⁸⁸.

¹¹⁵ 27.10.2016, f. 7.

¹¹⁶ 28.10.2016, f. 21, 30.

¹¹⁷ 28.10.2016, f. 21.

¹¹⁸ 28.10.2016, f. 51.

¹¹⁹ 28.10.2016, f. 29, 31.10.2016, f. 34.

¹²⁰ 28.10.2016, f. 30.

¹⁸⁸ 31.10.2016, f. 35.

215. Është dëshmuar se ka pasur marrëdhënie afariste midis kompanive të F.R. dhe N.K. Të dy e kanë pranuar këtë në deklaratat e tyre dhe i kanë përshkruar transaksionet afariste specifike.

Përmbledhje e provave relevante

216. **N.K.** ka dëshmuar se kompania e tij e quajtur “Casa Grande” ka pasur marrëdhënie afariste me kompaninë e F.R., meqë ka blerë reklama në gazetat e tij. Krahas kësaj, N.K. e ka blerë një shtëpi nga kompania e F.R. Ka qenë një këmbim i pasurisë së paluajtshme midis “AVAZ”-it dhe N.K që është kryer më 17 shtator të vitit 2004¹²¹. Ai po ashtu ia ka shitur kompanisë AVAZ disa automjete të blinduara të importuara nga ShBA-të¹²². Kontratat për automjetet janë lidhur më 9 qershor të vitit 2003 dhe më 18 prill të vitit 2005. Automjetet e blinduara janë përdorur për ta vozitur F.R. dhe mysafirët shumë të rëndësishëm të hotelit të tij¹²³.

217. **F.R.** i ka përshkruar marrëdhëniet afariste midis AVAZ-it dhe kompanisë së N.K në të njëjtën mënyrë siç i ka paraqitur N.K.¹²⁴. Ai nuk ka negociuar personalisht me N.K. për shitblerjen e veturave. Këtë e ka bërë drejtori kompetent¹⁹³.

218. Gjykata ka gjetur se këto marrëdhënie afariste, që është dëshmuar se kanë ekzistuar në një masë të moderuar në krahasim me shkallën e veprimtarisë

¹²¹ 27.10.2016, f. 21 dhe kontrata për këmbimin e pronës së paluajtshme.

¹²² 04.10.2017, f. 7 – 8.

¹²³ 27.10.2016, f. 20 – 21 dhe kontrata për shitblerjen e AUDI-së; 27.10.2016, f. 21 dhe kontrata për këmbimin e pronës së paluajtshme.

¹²⁴ 27.10.2016, f. 22.

¹⁹³ 27.10.2016, f. 23.

afariste të F.R., nuk mund të justifikojnë në asnjë mënyrë se N.K. do të ishte i gatshëm t'i pranonte motivet e pretenduara të F.R. si arsye për përfshirjen e tij në vrasjen e R.D.

219. Prokurori nuk ka paraqitur ndonjë provë të besueshme për ta mbështetur pretendimin e tij se F.R. ka qenë “mbrojtës politik” i N.K. Ky pretendim është bazuar vetëm në deklaratat e llojit “tërë Sarajeva e ka ditur”.
220. Sa i përket marrëdhënies së pretenduar midis gruas së F.R. dhe R.D., duhet të thuhet se prokurori përsëri i ka bazuar pretendimet e tij vetëm në përgojime dhe thashetheme, çfarë gjykata e konsideron si sjellje të pahijshme dhe joprofesionale. Gjatë hetimit, prokurori nuk ka bërë ndonjë përpjekje për t'i verifikuar këto pretendime. Këtë çështje – e cila prek mu në rrafshin personal të njerëzve që nuk kanë qenë palë në këtë procedurë – e kanë përmendur S.T.¹²⁵ dhe K1, të cilët kanë pretenduar se ai kanë dëgjuar për këtë nga R.D.¹²⁶. Çfarë ka qenë specifike, gjatë marrjes në pyetje të tërthortë, S.T. ka thënë se nuk ka besuar se ky ka qenë motivi për vrasjen e R.D.¹⁹⁶.
221. Gjykata gjen se nuk është dëshmuar se ka ekzistuar marrëdhënia e këtij lloji midis R.D. dhe personit të përmendur, prandaj, rrjedhimisht, nuk ka arsye për ta pranuar këtë si motiv për vrasjen e R.D.

3.9.2.1. Dokumentet për rolin e F.R. gjatë luftës

Sipas aktakuzës

¹²⁵ 18.3.2015, f. 10 – 11; 23.6.2015, f. 11.

¹²⁶ 9.11.2016, f. 34, 35.

¹⁹⁶ 13.5.2015, f. 25.

R.D. ka pasur dokumente për F.R., me të cilat e ka shantazhuar. Ai i ka treguar S.T. shumë dokumente në Sarajevë në lidhje me rolin e F.R. gjatë luftës, por nuk ia ka lejuar që t'i lexonte me kujdes.

222. Gjykata gjen se nuk është dëshmuar se R.D. ka poseduar dokumente për bashkëpunimin e pretenduar të F.R., çfarë do të kishte përbërë motiv për vrasjen e tij. Këto pretendime kundër F.R. kanë qenë të njohura për publikun në Bosnjë që nga viti 2002, ndërsa janë botuar artikuj për këtë dhe janë paraqitur në librin e F.Mu.¹²⁷. Nuk ka dëshmi se këto dokumente kanë përmbajtur diçka të jashtëzakonshme që nuk është ditur më parë. Nuk kanë qenë sekrete, sepse kanë qenë në posedim të disa njerëzve (përfshirë gazetarët). Ky motiv është spekulim i kulluar i prokurorisë i bazuar në deklaratën e rrejshme të S.T.
223. Relevanca e librave të F.Mu. që janë pranuar si prova kufizohet me faktin se informatat për bashkëpunimin e pretenduar të F.R. me armikun kanë qenë të ditura publikisht qysh në vitin 2002.
224. Gjykata ka vërejtur se S.T., dëshmitarja vendimtare e Prokurorisë, ka qenë shumë jo konsekuente në deklaratat e saj. Në fillim të dëshmisë së saj, ajo ka qenë e qartë dhe e bindur se R.D. ka poseduar dokumente jashtëzakonisht të dëmshme për F.R., për të cilat publiku nuk ka ditur më parë, ndërsa zbulimi i tyre do t'i kishte shkaktuar atij dëme të pariparueshme, duke përfshirë fundin e karrierës politike së tij. Gjatë marrjes në pyetje, ajo ka filluar ta zbuste qëndrimin e saj, posaçërisht pasi është përballur me provat [siç ishte një ekstrakt nga libri i

¹²⁷F.Mu.; „Argumenti i Sjecanja o Ratu”, 2002 – ekstrakte.

F.Mu. dhe artikulli i “Slobodna Bosnja” (“Bosnja e Lirë”), të cilat kanë treguar se informatat për bashkëpunimin e pretenduar të F.R. me autoritetet serbe ishin publikuar qysh në vitin 2002. Në këtë situatë, ajo e ka përdorur taktikën e zakonshme të saj, duke ia përshtatur dëshminë e saj pyetjeve të bëra dhe duke thënë se ka qenë në dijeni për këtë. Madje as fakti që e ka postuar ballinën e librit të F.Mu. në murin e saj në “Facebook” nuk do të thotë se e ka lexuar atë më parë.

225. Në dëshmitë e saj, S.T. e ka shfaqur përsëri nevojën e saj për të lënë mbresa me mundësitë dhe rëndësinë e saj. Ajo fillimisht ka theksuar se ka qenë e para që e ka përdorur në media nofkën “Sç.”. Kur është përballur me artikullin nga “*Slobodna Bosnja*” të vitit 2002, ku kjo nofkë tashmë ishte përmendur, ajo ka thënë ka shkruar më në hollësi për këtë temë. Kur është pyetur për to, ajo përsëri nuk ka qenë në gjendje që të jepte ndonjë shembull të këtyre informatave më të hollësishme. Më në fund, ajo ka pretenduar se ka qenë artikulli që ajo e ka publikuar në “Facebook” që është kopjuar dhe publikuar pastaj nga gazeta, pa e treguar emrin e saj. Është fakt notor, që mund të kontrollohet lehtë në internet, se ueb faqja në “Facebook” është lansuar vetëm në vitin 2004¹²⁸.
226. Pas pak çastesh, ajo ka pranuar se ka filluar të fliste për bashkëpunimin pretenduar të F.R. me armikun vetëm pas arrestimit të burrit të saj (në vitin 2010).
227. S.T. po ashtu është përpjekur ta bindte gjykatën se dokumentet që ia ka treguar R.D. kanë qenë aq sekrete, sa që vetëm ajo ka pasur shans t’i shihte. Më vonë, ajo ka ndërruar mendje dhe ka shtuar se këto dokumente u janë dhënë edhe

¹²⁸ <https://en.wikipedia.org/wiki/Facebook>.

gazetarëve të tjerë dhe një avokati në Sarajevë. Si gjithmonë, ajo nuk ka dashur të jepte emra për t'i mbështetur pretendimet e saj.

228. Version krejtësisht tjetër të ngjarjeve, që bie ndesh me atë të S.T., ka paraqitur **K1**, i cili ka folur për dokumentet që R.D. i ka përdorur për ta shantazhuar F.R.

Nuk ka prova të tjera për ta mbështetur versionin e K1. Krahas kësaj, A.P. ka

thënë qartë se R.D. ka qenë person diskret dhe se, ndonëse ka qenë i afërt me të, nuk ka dëgjuar për kurrfarë dokumentesh sekrete.

229. Gjykata e ka vlerësuar si të besueshme deklaratën e F.R. – që është mbështetur me dokumentet që i ka paraqitur ai – se pretendimet kundër tij në lidhje me bashkëpunimin me forcat serbe kanë qenë të njohura para shumë kohësh.

Përmbledhje e provave relevante

230. **S.T.** ka dëshmuar se R.D. ka poseduar dokumente në lidhje me luftën në Bosnjë dhe Hercegovinë, sipas të cilave F.R. ka bashkëpunuar me armikun, nën emrin e koduar “Sç.”. Këto dokumente po ashtu kanë treguar se F.R. me një person tjetër janë përpjekur ta armiqësonin R.D. kundër një gjenerali gjatë luftës në Bosnjë dhe Hercegovinë dhe e kanë nxitur që të reagojë¹²⁹. Sipas S.T., ky ka qenë burimi i armiqësisë midis F.R. dhe R.D.¹³⁰.
231. Ajo ka dëshmuar se F.R. është frikuar se një ditë R.D. do t’i përdorte këto dokumente për ta shantazhuar, çfarë do t’i kishte bërë dëm të madh atij dhe reputacionit të tij¹³¹¹³²¹³³. Reputacioni i F.R. do të ishte dëmtuar po që se do të ishte zbuluar se ai kishte bashkëpunuar me inteligjencën²⁰².
232. Ajo ka pretenduar se këto dokumente i janë treguar shumë kohë para vdekjes së R.D. Ajo ka besuar se ka qenë personi i parë që ka folur për to publikisht. Vetëm

¹²⁹ 17.3.2015; f.16 - 18; 13.5.2015, f. 16 – 17.

¹³⁰ 17.3.2015; f.18.

¹³¹ 17.3.2015; f.18.

¹³² .5. 23 – 25 .

¹³³ .

2015, f.
13.5.2015, f.

pastaj, gazetarë të tjerë kanë filluar t'i hulumtonin ato dhe ka pasur publikime për to, përfshirë librin²⁰³.

233. Më vonë, S.T. ka shtuar se këto dokumente i ka poseduar edhe një avokat nga Sarajeva. Si zakonisht, ajo nuk ka dashur ta jepte emrin e tij, sepse ai nuk do ta kishte konfirmuar këtë. Ky avokat ka qenë fillimisht i përfshirë në gjykimin e burrit të saj²⁰⁴.

234. Fillimisht, ajo nuk e ka kufizuar shtirjen e dokumenteve që i ka poseduar avokati. Më vonë, ajo ka thënë se ai i ka pasur vetëm ato që kanë pasur të bënin me bashkëpunimin me armikun dhe që nuk kanë përmbajtur informata në lidhje me përpjekjen për ta marrë pushtetin në Bosnjë. Asaj ia kanë treguar avokatët këto dokumente. Ajo nuk e ka ditur nëse njerëz të tjerë kanë poseduar kopje të tyre²⁰⁵.

235. Kur është marrë në pyetje të tërthortë, S.T. ka pranuar se nuk ka qenë e para që e ka përmendur emrin e koduar "Sç.", por se ka qenë ajo që ka filluar të fliste për bashkëpunimin e pretenduar me armikun²⁰⁶. Më vonë, ajo ka shpjeguar se ka qenë ajo që i ka publikuar disa detaje shtesë, por nuk ka treguar se çfarë kanë qenë ato detaje konkretisht²⁰⁷.

236. Përveç kësaj, ajo është tërhequr edhe nga deklarata e saj se ka qenë ajo që i ka parë këto dokumente për herë të parë, kur R.D. ia ka treguar ato vetëm asaj. Ajo ka pranuar se mund t'i ketë parë ato në Ministrinë e Punëve të Brendshme, ku ajo

f.

f.

2015, f.

13.5.2015, f.

ka punuar, por se asokohe nuk i kanë interesuar, sepse nuk e ka njohur F.R. Ajo ka konfirmuar se R.D. u ka dhënë dokumente disa gazetarëve të tjerë, përkundër pretendimit të saj se ato është dashur të ishin sekrete. Si zakonisht, ajo nuk ka dashur t'i jepte emrat e gazetarëve. Për to është shkruar në shumicën e

204 14.5.2015, 6-7.
205 14.5.2015, 20-21.
206 13.5. 18 - 19.
207 21.

mediave²⁰⁸. Kur është pyetur pse R.D. ua ka dhënë këto dokumente të tjerëve, e jo asaj, ajo ka shpjeguar se ai ka vendosur t'ia tregonte ato vetëm asaj, sepse ajo po punonte për F.R.²⁰⁹.

237. S.T. ka pranuar se revista *Slobodna Bosnja* ka shkruar për “Sç.” qysh në vitin 2002. Përsëri, ajo ka potencuar se ka qenë ajo që ka folur më në detaje²¹⁰. Kur është përballur me artikujt, asaj nuk i është kujtuar nëse i ka lexuar²¹¹. Kur është pyetur për këto detaje, që ajo është dashur t'i zbulonte, ajo ka mohuar të kishte thënë kështu. Pas pak çastesh, ajo ka deklaruar se në *Slobodna Bosnja* ka qenë artikulli i saj, të cilin ajo e kishte publikuar në llogarinë e saj në “Facebook”, por se inicialet e saj nuk ka qenë e mundur të publikoheshin aty, sepse ajo nuk qenë punonjëse e kësaj gazete²¹².

238. Ajo ka pranuar se ka filluar të fliste për këto dokumente vetëm pas arrestimit të burrit të saj. Nofka “Sç.” ishte publikuar shumë kohë më parë²¹³.

239. Ajo ka konfirmuar se ka ditur për librin e F.Mu., në të cilin ishin shtjelluar dyshimet për bashkëpunimin e F.R. me armikun, por ka pretenduar se nuk e ka

f.
f.
2015, f.
13.5.2015, f.

lexuar. Ajo e ka pranuar se e ka publikuar ballinën e këtij libri në llogarinë e saj në “Facebook”. Megjithatë, ajo vetë ka shikuar njëherë dhe e ka vërejtur se kanë qenë dokumentet e njëjta me ato që ia ka treguar R.D. dhe me disa të tjera²¹⁴.

240. Version tjetër për dokumentet që pretendohet se i ka poseduar R.D. ka paraqitur

K1. Ai ka dëshmuar se nga R.D. ka dëgjuar se atë e ka kanë kërcënuar F.R. dhe

²⁰⁸ 13.5.2015, f. 20 - 21.

²⁰⁹ 13.5.2015, f. 21.

²¹⁰ 13.5.2015, f. 24.

²¹¹ 14.5.2015, 4 – 5.

²¹² 14.5.2015, 6.

²¹³ 13.5. 21. ²¹⁴ 22-23.

N.K., sepse ai e ka poseduar dokumentin në të cilin është thënë se F.R. ka qenë i punësuar në Shërbimin Sekret Serb. Në disa raste, K1 e ka parë një dokument me disa faqe, të cilin R.D. e ka përdorur për ta shantazhuar F.R., sepse ai i ka kërkuar 50.000 euro në këmbim të tij¹³⁴. K1 e ka parë atë ndoshta dy muaj para vrasjes së tij¹³⁵.

241. K1 ka pretenduar se F.R. ka kërkuar nga R.D. që të mos e tregonte atë dokument më, që të mos e publikonte dhe që të mos tregonte se ishte tradhtar dhe se kishte punuar kundër Bosnjës gjatë luftës. Kjo është shoqëruar me kërcënime, por K1 nuk ka saktësuar se të çfarë lloji kanë qenë këto kërcënime. Ai ka pretenduar se të gjithë kanë ditur për bashkëpunimin e F.R.²¹⁷.

242. Sipas K1, 2-3 muaj para vdekjes së tij, F.R. nuk e ka paguar më R.D. Secilën herë e ka paguar 50.000 euro. E ka paguar shumë herë. K1 e ka marrë vesh këtë nga R.D., S1, S2 (djemtë e motrës së R.D.) dhe nga A.P.²¹⁸. R.D. u ka treguar të gjithëve për këtë (përfshirë për paratë që i ka marrë nga F.R.) dhe duke e treguar këtë dokument, përkundër faktit se F.R. e kishte paguar²¹⁹. Pas disa çasteve, K1 ka rëndë në kundërshti me vetveten, duke thënë se R.D. kishte nisur ta tregonte këtë dokument vetëm pasi F.R. nuk e ka paguar më. Kjo ka qenë 3-4 muaj para vdekjes së tij²²⁰.

¹³⁴ 9.11.2016, f. 18.

¹³⁵ 9.11.2016, f. 18.

f.
f.
f.
f.

²¹⁷

9.11.2016, 22-23.

²¹⁸ 9.11.2016, 23 –

24.

²¹⁹

9.11.2016, 24.

²²⁰ 9.11.2016,

25.

243. **A.P.**, gjatë marrjes në pyetje të tërthortë të tij, ka dëshmuar se R.D. ka qenë person shumë i heshtur dhe se “është dashur t’ia nxirrje fjalët me dara”. A.P. nuk e ka ditur nëse ai ka pasur dokumente sekrete¹³⁶.

244. Në dëshminë e tij, **F.R.** i ka trajtuar pretendimet se ka qenë

bashkëpunëtor i shërbimit sekret serb. Ai ka potencuar se, si Ministër i Punëve të Brendshme, ai i është nënshtruar procedurës së vetingut, po ashtu sepse i është dashur të kishte qasje në informata sekrete. Përveç kësaj, ka qenë një aktgjykim në rastin që ai e ka ngritur kundër F.Mu., në të cilin ai është shpallur fajtor për shpifje¹³⁷.

245. Duhet të theksohet se objekt i këtij gjykimi nuk ka qenë që të vërtetohej se çfarë ka bërë F.R. gjatë luftës në Bosnjë. Prandaj gjykata i ka refuzuar propozimet në vijim të prokurorit për paraqitje të provave, qëllimi i të cilave ka qenë që të provohej se F.R. kishte bashkëpunuar me armikun:

- propozimin që është paraqitur më 23 shkurt të vitit 2015 dhe që është përsëritur më 18 mars të vitit 2015 për ta dëgjuar F.Mu. dhe H.Si., për të cilin është vendosur më 30 korrik të vitit 2015;

¹³⁶ 8.12.2015, f. 31.

¹³⁷ 27.10.2016, f. 10, dhe dokumentet e paraqitura gjatë seancës: Aktgjykim i gjykatës së shkallës së dytë në Sarajevë i datës 21 mars 2014, Nr. 65 0 P 045003; aktgjykim i gjykatës së shkallës së parë në Sarajevë i datës 8 shtator 2010, Nr. 65 0 P 045003; Certifikata e Autorizimit të Sigurisë e NATO-s e datës 11.4.2013 me vendim, 31.10.2016, f. 42.

- propozimin që është paraqitur më 6 maj të vitit 2015 për ta pranuar si provë procesverbalin e marrjes në pyetje të R.D. dhe raportet e përmendura në librin e F.Mu., për të cilin është vendosur më 18 maj të vitit 2015.

246. Në anën tjetër, dëshmitë e këtyre personave, po të ishin pranuar, do ta kishin bërë të domosdoshme marrjen në pyetje të shumë dëshmitarëve të tjerë që do të mund të kishin pasur njohuri për aktivitetet e F.R. gjatë luftës. Gjykata vë në dukje se, sipas aktakuzës, fakti që është dashur të provohet ka qenë nëse dokumentet që pretendohet se i ka poseduar R.D. mund të kenë qenë aq të dëmshme për F.R. sa të përbënin arsye për ta vrarë R.D.

3.9.3. Incidenti në Turqi

Sipas aktakuzës:

Për shkak të punësimit të saj të mëparshëm në Ministrinë e Punëve të Brendshme, S.T. ka pasur lidhje të mira edhe me policinë e Sarajevës, prandaj edhe F.R. e ka caktuar atë si përgjegjëse për kronikën e krimit për gazetën e tij "Dnevni Avaz". Në cilësinë e saj, S.T. e ka zhvilluar një intervistë me R.D. në Turqi që është botuar në vitin 2006, kur ajo ka qenë dëshmitare e një konflikti që rritej midis R.D. dhe një bosi tjetër të nëntokës së Sarajevës, M.A.G., i cili pastaj e ka kërkuar ndihmën e N.K. për ta luftuar R.D. S.T. ka qenë aty kur R.D. e ka marrë një thirrje telefonike nga N.K., i cili e ka kërcënuar duke i thënë: "Do të të dërgoj te kurdët, të cilët do të vrasin brenda një ore". K1, i cili në të njëjtën kohë ka qenë njëri nga menaxherët e trafikimit të drogës së N.K., ka qenë në dijeni për këtë konflikt dhe i është kujtuar se "madje edhe në Turqi ka pasur konflikt midis tyre, kur N.K. i ka organizuar njerëzit e tij për ta rrahur R.D.".

247. Gjykata konstaton se është dëshmuar se në fund të dhjetorit të vitit 2003 S.T. ka ardhur nga Stambolli për tu takuar me R.D., i cili ka qenë në arrati atje, dhe për ta bërë një intervistë me të.
248. Siç u prezantua tashmë më lart, nuk është provuar se S.T. i ka botuar artikujt e saj në “Dnevni Avaz”. Po ashtu, nuk ka prova që dëshmojnë se ajo ka qenë përgjegjëse për kronikën e zezë që është publikuar në këtë gazetë. Pretendimet e S.T. në këtë pjesë nuk mbështeten me asnjë provë dhe janë mohuar nga F.R. dhe S.Nu.
249. Po ashtu është dëshmuar se në të njëjtën kohë M.A.G. ka ardhur atje me vëllain e tij A.A.G., I.Sp., M.S. dhe A.P. Ata e kanë aranzhuar takimin me R.D. paraprakisht. Pas arritjes, ata e kanë pasur një takim miqësor me R.D. në një kafene, ku kanë rënë dakord që të takoheshin më vonë në restorantin “Bosnja”.
250. Këto konstatime rezultojnë nga dëshmitë e S.T., E.D., M.A.G. dhe A.P., të cilat e mbështesin njëra tjetrën. Gjykata nuk i ka besuar S.T. se ka qenë shumë e vështirë që të aranzhohej takimi me R.D., meqë kjo bie ndesh me provat e tjera, ndërsa ajo vet është tërhequr nga kjo deklaratë.

Përmbledhje e provave relevante

251. **S.T.** ka dëshmuar se e ka zhvilluar një intervistë me R.D. me gjasë në vitin 2003, kur ai ka qenë i arratisur në Turqi për shkak të dyshimit se e kishte vrarë një mysafir dasme serb para luftës në Bosnjë²²³. Ajo ka potencuar se ka qenë jashtëzakonisht e vështirë që të vihej kontakt me të, sepse askush nuk e ka ditur se ku po fshihej; intervista me të do të ishte ekskluzive²²⁴. Një mik i tij

(F.H.P.²²⁵) i është drejtuar për ta bërë një intervistë me të pa i treguar se ku ishte²²⁶.

²²³ 17.3.2015; f.3 - 4; Amir A.P. 27.10.2015, f.23.

²²⁴ 17.3.2015; f.4.

²²⁵ 17.3.2015; f. 15. ²²⁶ 17.3.2015; f. 4.

252. Gjatë marrjes në pyetje të tërthortë, ajo ka thënë se vetëm autoritetet nuk e kanë ditur se ku po rrinte ai, ndërsa kriminelët kanë folur dhe e kanë ditur²²⁷. Kur është pyetur për këtë kundërthënie, ajo ka shpjeguar se kur ajo ka thënë “askush”, ka menduar vetëm për autoritetet e policisë²²⁸.

253. S.T. ka ardhur në Stamboll më 21 dhjetor të vitit 2003²²⁹. Në aeroport ajo i është përgjigjur një thirrjeje në një telefon publik dhe i është thënë që të shkonte në një restorant. Atje është takuar me R.D., i cili i është prezantuar²³⁰. Ajo është kthyer pas dy ditëve, por ka pasur një konflikt midis M.A.G. dhe R.D. Gjatë marrjes në pyetje të tërthortë, ajo ka thënë se kur e ka parë R.D. për herë të parë, fytyra e tij ka qenë krejtësisht e panjohur për të²³¹. Ajo nuk e ka njohur, madje edhe përkundër faktit se kanë qenë fqinj²³². Ajo është përballur me artikullin e saj që ishte botuar më 8 janar të vitit 2004 në *Express*, në të cilin ajo kishte shkruar se ai është dukur ndryshe nga si mbahej mend. Pastaj ajo ka shpjeguar se e ka njohur atë vetëm nga fotografite²³³.

254. Ditën e dytë pasi ka mbërritur atje, ajo është takuar me R.D. për ta bërë një intervistë për jetën e tij si i arratisur nga Bosnja²³⁴.

255. Sipas **A.P.**, **M.A.G.** i ka thënë se do të shkonin në Stamboll për shopping. Në këtë udhëtim kanë marrë pjesë këta njerëz: **A.P.**, **M.A.G.**, vëllai i tij **A.A.G.**, **I.Sp.** dhe **M.S.** Ata kanë udhëtuar rreth datave 25-26 dhjetor të vitit 2003, me gjasë herët

²²⁷ 12.5.2015, f. 28.

²²⁸ 12.5.2015, f. 30.

²²⁹ 17.3.2015; f. 5; konfirmuar nga vulat në pasaportën e saj, f. 7.

²³⁰ 17.3.2015; f. 4.

²³¹ 12.5.2015, f. 27.

²³² 16.5.2015, f. 39.

²³³ 16.5.2015, f. 6. ²³⁴ 17.3.2015; f. 6.

në mëngjes. Kanë ndenjur tri ditë në një hotel¹³⁸. E kanë zgjatur qëndrimin e tyre për një ditë, për shkak të situatës së krijuar¹³⁹.

256. Versioni i **A.P.** mbështetet nga **M.A.G.**, i cili ka thënë se kanë udhëtuar në Turqi “për tu sorollatur”. **A.P.** e ka marrë me vete, sepse ka qenë qesharak. Kanë shkuar vetëm për tri ditë. **M.A.G.** ka paguar për këtë udhëtim.¹⁴⁰ **A.P.** ka dëshmuar se nuk i është kujtuar se kush ka paguar për udhëtimin në Stamboll.¹⁴¹

257. **A.P.** ka dëshmuar se ditën e parë pas arritjes së tyre në Stamboll, rreth orës 7-8 të pasdites, ata janë takuar me **R.D.**, i cili i ka marrë në rrugë¹⁴². Ai i ka pritur ngrohtësisht. Fillimisht kanë kaluar ca kohë në qendrën tregtare “Galeria”. Janë ulur në një kafene¹⁴³. Më vonë kanë shkuar në restorantin “Bosnja”¹⁴⁴. **R.D.** ka qenë në arrati asokohe¹⁴⁵.

¹³⁸ 27.10.2015, f. 21 -22.

¹³⁹ 27.10.2015, f. 33.

¹⁴⁰ 6.12.2016, f. 18.

¹⁴¹ 8.12.2015, f. 13.

¹⁴² 28.10.2015, f. 22.

¹⁴³ 27.10.2015, f. 22 - 23.

258. **M.A.G.** ka dëshmuar se ka shkuar të takohet me R.D., sepse ai ka qenë i mirë me vëllain e tij, çfarë ka qenë përherë e vështirë, meqë ai atëherë ka qenë në arrati. Ka qenë e lehtë të aranzhohej takimi. Miku e tij ka kontaktuar me gruan e R.D.¹⁴⁶.
259. **A.P.**, kur është marrë në pyetje të tërthortë, ka pranuar se qysh para se të udhëtonin për në Stamboll, ata e kanë ditur se atje do të takoheshin me R.D. Këtë e kanë aranzhuar para se të udhëtonin¹⁴⁷.

¹⁴⁴ 27.10.2015, f. 35.

¹⁴⁵ 27.10.2015, f. 23; E.D., 11.12.2015, f. 6.

¹⁴⁶ 6.12.2016, f. 18.

¹⁴⁷ 8.12.2015, f. 28.

260. Sipas **E.D.**, ata kanë folur me mikun e R.D. për të kontaktuar me të në Turqi. R.D. e ka ditur se ku do të rrinin¹⁴⁸.
261. Nga deklaratat e M.A.G., A.P. dhe E.D. rezulton qartë se nuk ka qenë sfidë e madhe që të organizohej takim me R.D. në Turqi. Prandaj, gjykata nuk i ka konsideruar si të besueshme dëshmitë e S.T. në këtë pjesë.
262. Sipas **A.P.**, gjatë këtij takimi M.A.G. dhe vëllai i tij kanë filluar të përhapnin thashetheme për mikun e R.D., ndërsa R.D. nuk është ndjerë rehat për shkak të kësaj¹⁴⁹. Ata kanë folur në një kontekst negativ për një person me emrin “B.”, i cili e ka pasur diskotekën “Aqua” në Sarajevë. Nuk kanë thënë diçka që ka përbërë shqetësim të madh, por R.D. i ka penguar kjo paksa¹⁵⁰. Takimi ka zgjatur 1.5-2 orë¹⁵¹. Pastaj janë larguar nga ky vend¹⁵².
263. **M.A.G.**, kur është marrë në pyetje të tërthortë, ka mohuar se ka folur mr R.D. për diskotekën “Aqua”. Atij s’i ka interesuar fare ajo, sepse objekti ka qenë i rrënuar. Nuk e ka njohur pronarin e atij vendi²⁵⁰.

Ngjarjet në restorantin “Bosnja”

264. Gjukata ka konstatuar se është dëshmuar se M.A.G., A.P. dhe shokët e tij janë takuar me R.D. në restorantin “Bosnja” në Stamboll. Ky takim është planifikuar më parë. Edhe S.T. ka qenë e pranishme kur janë takuar me R.D. Situata është tensionuar, sepse ata e kanë ngacmuar R.D., prandaj janë larguar M.A.G. me

¹⁴⁸ 11.12.2015, f. 32.

¹⁴⁹ 27.10.2015, f.22, 23.

¹⁵⁰ 27.10.2015, f. 24.

¹⁵¹ 27.10.2015, f. 23.

¹⁵² 27.10.2015, f. 25.

²⁵⁰ 7.12.2016, 16.

f.

- shoqëruesit e tij. Çështja e marrjes së restorantin “Aqua” nuk është diskutuar.
265. Këto konstatime bazohen në provat mbështetëse që vijnë nga A.P., M.A.G. dhe E.D. dhe që mbështeten nga dëshmitë e Al.H. në pjesën që ka të bëjë me restorantin “Aqua”. S.T. e ka konfirmuar faktin e takimit, por gjykata nuk e ka konsideruar si të vërtetë pretendimin e saj se takimi midis R.D. dhe të tjerëve nuk është aranzhuar më parë. I njëjti përfundim vlen për pretendimet e saj se çështja e marrjes së restorantit “Aqua” është diskutuar – nuk ka pasur prova për ta mbështetur deklaratën e saj, ndërsa ajo kanë rënë ndesh me dëshmitë e dëshmitarëve të tjerë.
266. E.D. nuk ka qenë dëshmitare e drejtpërdrejtë e ngjarjeve, ndërsa dëshmia e saj kufizohet me atë që ajo e ka dëgjuar nga burri i saj. Rrëfimi i saj ka qenë në përputhje me dëshmitë e pjesëmarrësve të tjerë të ngjarjeve, prandaj gjykata e ka vlerësuar atë si provë të besueshme.

Përmbledhje e provave relevante

267. Sipas **A.P.**, pasi ata janë larguar nga kafeneja në qendrën tregtare, R.D. i ka marrë të gjithë në restorantin “Bosnja”, kur ka pasur muzikë të gjallë. Tashmë ishte bërë vonë, rreth orës 22.00-23.00¹⁵³.
268. A.P. e ka parë S.T. me R.D. në restorantin “Bosnja” për herë të parë. Kur ata kanë ardhur aty, ajo ka qenë e ulur në një tavolinë tjetër duke pritur¹⁵⁴. Ka qenë vetëm. E ka njohur nga Sarajeva, por nuk ka pasur kontakte me të¹⁵⁵.

¹⁵³ 27.10.2015, f. 226.

¹⁵⁴ 28.10.2015, f. 17.

¹⁵⁵ 28.10.2015, f. 24.

269. Thashethemet kanë vazhduar të përhapen. A.P. e ka ndjerë se situata po tensionohej, prandaj, në një moment, ka thënë se kishte kokëdhimbje dhe ka vendosur të kthehej në hotel. Prandaj, ai, M.A.G. dhe A.A.G. janë larguar, ndërsa I.Sp. dhe M.S. kanë ndenjur. R.D. i ka dërguar në hotel me veturë¹⁵⁶. Në veturë e kanë pasur një bisedë të relaksuar¹⁵⁷. Në restorant nuk kanë ndenjur më shumë se 20 minuta¹⁵⁸.
270. Kur janë kthyer I.Sp. dhe M.A.G., ata kanë thënë se e kanë poshtëruar R.D. Kanë thënë se kanë pritur hakmarrje nga ana e tij. Të nesërmen kanë dalë për shopping¹⁵⁹.
271. **M.A.G.** i ka përshkruar ngjarjet në një mënyrë tjetër. Ai ka thënë se me R.D. janë takuar në restorant. S.T. ka qenë aty, çfarë i ka befasuar. Pastaj janë takuar në një restorant tjetër. S.T. nuk ka qenë aty. Kanë shkuar në hotel për të fjetur. Të nesërmen kanë shkuar për shopping, pa R.D. Ai nuk është takuar me ta prapë. Ai nuk ka pasur ndonjë konflikt me të. Këto kanë qenë vetëm histori nëpër media¹⁶⁰.
272. M.A.G. e ka parë S.T. vetëm një herë në Stamboll, në restorant. Ai mendon se R.D. dhe S.T. kanë qenë të parët. Ata kanë ndenjur aty nja 1 apo 2 orë. Kanë folur për gjëra të përgjithshme. S.T. nuk është ulur bashkë me ta¹⁶¹.

¹⁵⁶ 27.10.2015, f. 27.

¹⁵⁷ 28.10.2015, f. 25.

¹⁵⁸ 28.10.2015, f. 23.

¹⁵⁹ 27.10.2015, f. 28.

¹⁶⁰ 6.12.2016, f. 20-21.

¹⁶¹ 6.12.2016, 22.

f.

f.

273. Janë marrë vesh që të takoheshin më vonë në ndonjë vend tjetër, në një klub nate. Ai ka shkuar me shoqëruesit e tij në hotel për t'i ndërruar rrobat, R.D. ka shkuar rrugës së tij, pastaj janë takuar përsëri. S.T. nuk ka ardhur aty¹⁶². Ai e ka mohuar kategorikisht se është takuar me R.D. përsëri pas këtij takimi të fundit në restorant. Ka qenë vetëm një takim miqësor²⁶¹.
274. **S.T.** ka dëshmuar se ajo dhe R.D. kanë qenë ulur në restorantin “Bosnja”, kur papritmas ka ardhur M.A.G. me disa shokë të tij. Ata e kanë përshëndetur R.D. dhe kanë kërkuar nga ai që të ulej me ta²⁶². Ajo i ka njohur disa nga ta, por nuk ua ka ditur emrat. S.T. dhe R.D. janë befasuar nga ardhja e tyre²⁶³.
275. Takimi ka zgjatur së paku pesë apo dhjetë minuta dhe ka qenë miqësor, e pastaj M.A.G. e ka përmendur marrjen e diskotekës “Aqua” e pastaj ka filluar zënka. Ka zgjatur gjithsej nga 15 deri në 20 minuta²⁶⁴. Ajo i ka dëgjuar duke e grindur dhe R.D. duke thënë: “*Unë kurrë s’do t’jua lejojë ta bëni këtë*”²⁶⁵. M.A.G. i ka thënë R.D. se kishte ardhur ta gjente dhe të fliste për diskotekën “Aqua” dhe për hotelin në Sarajevë²⁶⁶. Për këtë kishin rëndë dakord edhe me N.K.²⁶⁷. R.D. ka refuzuar dhe ka thënë se tashmë ia kishte shitur B.Ka.²⁶⁸.
276. **S.T.** ka dëshmuar se pas grindjes R.D. ka shkuar në hotelin e tyre. Në restorant nuk ka qenë askush tjetër²⁶⁹.
277. **E.D.** ka mësuar për atë që kishte ndodhur në Turqi nga R.D., i cili i ka treguar për këto ngjarje pasi është kthyer. Sipas saj, M.A.G. dhe disa njerëz të tjerë, duke përfshirë I.S.n dhe A.P., kanë shkuar në Turqi, ku janë takuar me R.D. Janë

¹⁶² 6.12.2016, 23.

takuar në restorant, ku kanë diskutuar për ca kohë, e pastaj M.A.G. ka filluar të

²⁶¹ 6.12.2016, f. 24.

²⁶² 17.3.2015; f. 6.

²⁶³ 17.3.2015; f. 7.

²⁶⁴ 17.3.2015; f. 10.

²⁶⁵ 17.3.2015; f. 7.

²⁶⁶ 17.3.2015; f. 8.

²⁶⁷ 17.3.2015; f. 9.

²⁶⁸ 17.3.2015; f. 9.

²⁶⁹ 17.3.2015; f. 8.

flasë gjëra të shëmtuara për njerëz që kanë qenë shumë të rëndësishëm për R.D.

Ka qenë e ditur se M.A.G. ka pasur qejf të fliste prapa shpinës së njerëzve, çfarë R.D. nuk i ka pëlqyer dhe ka qenë i xhindosur për këtë. Për shkak të kësaj, R.D. është zemëruar dhe është larguar²⁷⁰.

278. **Al.H.** ka dëshmuar se nuk ka dëgjuar për ndonjë konflikt në lidhje me diskotekën “Aqua”. Atë e ka ndërtuar në fillim R.D. e më vonë ia ka shitur B.Ka.²⁷¹.

Të nesërmen – thirrja e N.K

279. Gjykata ka gjetur se nuk është provuar se M.A.G. e ka thirrur N.K. dhe se ky i fundit ka premtuar se do t’i dërgonte kurdët për t’i ndihmuar atij në situatën me R.D.

280. Para së gjithash, S.T., e cila ka pretenduar se e ka dëgjuar bisedën telefonike midis N.K dhe R.D., nuk ka qenë e sigurt nëse ka qenë ai që ka folur. Ajo e ka përmendur N.K., por në të njëjtën kohë ka shprehur rezervë, duke thënë: “kushdo që ka qenë në anën tjetër” të telefonit²⁷².

f.

f.

281. Kur është pyetur se pse ka besuar se ka qenë N.K. ai që ka folur, ajo ka thënë se për të ka qenë e qartë. Megjithatë, ajo nuk ka qenë në gjendje që të jepte ndonjë arsyetim për bindjen e saj. Ajo ka shtuar se ishte fakt i ditur se M.A.G. dhe N.K. punonin së bashku. Përsëri ajo u është referuar disa thashethemeve, të cilat nuk janë mbështetur me ndonjë provë të besueshme. Në këtë kontekst, duhet të theksohet se edhe N.K., edhe M.A.G. kanë mohuar të kenë pasur ndonjë biznes së bashku dhe se nga viti 2003 marrëdhëniet midis tyre janë përkeqësuar

²⁷⁰ 11.12.2015, f. 7.

²⁷¹ 18.3.2016, 12.

²⁷² 17.3.2015; 10 - 11.

dukshëm. Përveç thashethemeve, prokurori nuk ka paraqitur prova për ta dëshmuar të kundërtën.

282. Edhe S.T. e ka përdorur argumentin se emri i N.K. nuk mund të ndërlidhej me dikë tjetër pos tij, sepse ky emër ishte shumë i rrallë në vendin e saj. Gjykata nuk mund ta ndjekë këtë logjikë, sepse është spekulim i kulluar. Madje edhe në këtë rast ka qenë një Naser tjetër që është dëgjuar në cilësinë e dëshmitarit.

283. Krahas kësaj, ajo nuk ka qenë konsekuente sa i përket përmbajtjes së kësaj bisede. Fillimisht, ajo ka thënë se N.K. në telefon ka thënë se kanë paguar kurdë; pas disa çastesh e ka ndërruar versionin e saj dhe ka thënë se ka qenë M.A.G. ai që ka paguar me paratë e N.K. Mu në fund të dëshmisë së saj, S.T. e ka përmendur një bisedë telefonike midis R.D. dhe M.A.G., kur ky i fundit ka thënë se do t'ua jepte kurdëve 100.000 euro të paguara nga N.K. për vrasjen e tij.

284. As dëshmia e A.P. nuk përbën provë të besueshme për ta mbështetur konstatimin se ka ndodhur cilado nga bisedat që i ka përshkruar S.T. Pa dyshim, ai e ka përmendur një bisedë telefonike midis N.K dhe M.A.G., por në një kontekst tjetër.
285. Kredibiliteti i deklaratës së S.T. dobësohet më tej nga dëshmia e E.D., e cila nuk ka thënë se i kanë thënë se ka pasur bisedë midis vet R.D. dhe N.K. Po të ishte zhvilluar ndonjë bisedë e tillë, R.D. do t'i kishte treguar dhe nuk do ta kishte përsëritur atë që e kishte dëgjuar nga të tjerët.
286. Në anën tjetër, deklarata e E.D. nuk e mbështet pretendimin se N.K. ka folur me M.A.G. në telefon. Kjo pjesë e dëshmisë së saj është e bazuar në thashetheme (ajo ka dëgjuar për këtë nga R.D., i cili ka dëgjuar nga të tjerët), prandaj është thelbësisht e pambështetshme.

Përmbledhje e provave relevante

287. **S.T.** ka dëshmuar se kur kanë qenë duke vozitur me R.D., ai ka thirrur shumë shokë për t'i marrë numrat e telefonave të njerëzve që kanë qenë me M.A.G. dhe numrin e tij po ashtu²⁷³.
288. Sipas saj, N.K. apo, siç ka thënë ajo, “*kushdo që ka qenë në anën tjetër*”, e ka thirrur R.D. dhe ka thënë: “Shiko, mos luaj me ne. Mund të t'i dërgoj kurdët brenda një ore dhe mund të të likuidojnë dhe do ta bëjnë këtë²⁷⁴”. R.D. është përgjigjur: “*Më dëgjo Naser! Nuk më bëhet vonë për ty e për kurdët e tu. Dërgoi njëmijë nëse do të luash me mua*”. Pastaj është shqetësuar dhe zemëruar shumë. Në ndërkohë, R.D. ka marrë vesh se në cilin hotel po rrinte M.A.G. dhe e ka thirrur në telefon “një person që quhej A.P.” dhe ka thënë: “*Vetëm kollitu në*
f.
f.

*telefon nëse M.A.G. është në dhomë*²⁷⁵.

289. Kur është marrë në pyetje të tërthortë, S.T. ka shpjeguar se për të ka qenë e qartë se R.D. ka folur me N.K. Përveç kësaj, ka qenë fakt i ditur se M.A.G. dhe N.K. kanë punuar së bashku dhe ka qenë e qartë se emri i N.K. nuk mund të ndërlidhej me askënd tjetër përpos tij, sepse emri N.K. ishte emër i rrallë në vendin e tyre²⁷⁶. Në atë moment, ajo nuk e ka njohur N.K. Me të është njohur vetëm pas afro një viti²⁷⁷.

²⁷³ 17.3.2015; f. 10.

²⁷⁴ 17.3.2015; f. 10 – 11.

²⁷⁵ 17.3.2015; f. 11.

²⁷⁶ 12.5.2015, 29.

²⁷⁷ 17.3.2015; 12 - 13.

290. Gjatë marrjes në pyetje të tërthortë, S.T. ka thënë se N.K. ka thënë në telefon se i kanë paguar kurdët, por më vonë e ka korrigjuar veten dhe ka thënë se ka qenë M.A.G. ai që ka paguar për këtë me paratë e N.K.²⁷⁸.

291. Mu të fund të dëshmisë së saj, S.T. ka dëshmuar se M.A.G. gjatë një bisede telefonike me R.D. ka thënë: “N.K. i ka paguar kurdët 100.000 euro për të të vrarë. Unë do t’jua jap paratë dhe ata do të të vrasin”. Ajo ende ka qenë në Stamboll. I ka rënë kjo ndërmend vetëm atëherë. Nuk ka dhënë ndonjë shpjegim bindës se pse kjo kishte ndodhur aq vonë²⁷⁹.

292. Gjatë marrjes në pyetje të tërthortë ajo ka pranuar se ka dëgjuar për një N.K. tjetër që ishte pronar i [N. Kompanitit]. Sipas saj, N.K. e ka ndryshuar emrin e tij nga N.K., ndërsa ai e di pse. Është personi i njëjtë²⁸⁰.

293. **A.P.** ka dëshmuar se nuk e ka dëgjuar N.K. duke thënë: “Shko në pjesën aziatike të Turqisë dhe fol me personin për ta vrarë R.D.”. Këtë e ka dëgjuar vetëm nga M.A.G.²⁸¹.

294. **E.D.** ka dëshmuar se R.D. e ka përmendur emrin e N.K në kontekstin se M.A.G. e ka thirrur N.K. për t’i ndihmuar, e pastaj kanë ardhur shqiptarët²⁸². Ajo e ka mësuar këtë nga R.D., i cili ka dëgjuar për këtë nga I.Sp. dhe A.P.²⁸³.

²⁷⁸ 18.5.2015, f. 37.

²⁷⁹ 18.5.2015, f. 42.

²⁸⁰ 12.5.2015, f. 30.

²⁸¹ 10.11.2015, f. 27.

²⁸² 11.12.2015, f. 9.

²⁸³ 11.12.2015, f. 11.

Ngjarjet në hotel

295. Duke u bazuar në dëshmitë e S.T., A.P. dhe E.D., gjykata konstaton se është dëshmuar se nuk ka pasur ndonjë zënkë midis R.D. dhe M.A.G. në hotelin në Stamboll.
296. Është vetëm dëshmitari A.P. ai që ka përshkruar se çfarë ka ndodhur brenda dhomës së hotelit. Dëshmia e tij nuk mbështetet me prova të tjera, prandaj gjykata ka konstatuar se ngjarjet specifike në dhomën e hotelit janë të paprovuara.
297. Gjykata e ka vlerësuar si të pambështetshme dëshminë e M.A.G., i cili ka mohuar të ketë ndodhur ndonjë konflikt në Stamboll, sepse kjo bie ndesh me deklaratat e dëshmitarëve të tjerë, të cilat janë vlerësuar si të besueshme në këtë pjesë.

Përmbledhje e provave

298. Sipas **A.P.**, të nesërmen në mbrëmje, kur janë kthyer në hotel nga shoppingu, mu para se të hynin në hotel, M.A.G. është informuar përmes një telefoni se një granatë/bombë ishte hedhur në shtëpinë e tij në Sarajevë¹⁶³. R.D. ka ardhur pak kohë pas tyre²⁸⁵.
299. E tërë situata ka ndodhur në dhomën e hotelit. A.A.G. ka thënë se dikush e kishte hedhur bombën, ndërsa R.D. ka pyetur: “Çka nëse unë e kam hedhur bombën?”. R.D. e ka goditur A.A.G. me pëllëmbë në fytyrë, duke thënë: “*Je hakmarrës, apo*

¹⁶³ 27.10.2015, f. 28; 28.10.2015, f. 26.

²⁸⁵ 27.10.2015, f. 28.

- jo?” , pastaj M.A.G. dhe A.A.G. kanë ikur. Në ndërkohë, M.A.G. e ka thirrur N.K. Nuk kanë qenë të armatosur¹⁶⁴.
300. M.A.G. ka ikur te shkallët e zjarrit, ku A.P. e ka gjetur pas 20 minutave, pasi ka shkuar R.D.¹⁶⁵. A.P. dhe I.Sp. e kanë qetësuar R.D. dhe e kanë nxjerrë nga dhoma¹⁶⁶. Nuk e kanë parë R.D. deri në fund të qëndrimit të tyre në Turqi¹⁶⁷.
301. Ai po ashtu e ka përmendur situatën kur kanë qenë duke u kthyer nga hoteli “Zagreb” në hotelin e tyre dhe kur R.D. e ka goditur A.A.G. me veturë. Kjo ka ndodhur rreth 20-30 metra larg hotelit të tyre. A.A.G. e kanë dërguar në spital, por lëndimet nuk kanë qenë të rënda, kështu që e kanë lëshuar¹⁶⁸¹⁶⁹.
302. Sipas S.T., kur kanë ardhur te hoteli ku kanë ndenjur M.A.G. dhe shokët e tij, R.D. ka dalë nga vetura dhe ka shkuar me vrap në hotel. Më vonë ai është kthyer kah dalja urgjente. E tërë kjo situatë ka zgjatur së paku 15 apo 20 minuta, ndërsa R.D. ka ndenjur në hotel pjesën më të madhe të kohës. Ai ka dalë duke vrapuar shkallëve teposhtë. A.A.G. ka vrapuar përreth në rroba të brendshme, duke u përpjekur që të ikte, por ka ardhur në drejtim të veturës së R.D., kështu që R.D. e ka goditur me veturë²⁹¹.
303. Në veturë R.D. i ka treguar asaj e kishte rrahur M.A.G., i cili kishte arritur të ikte përmes vrimës së një kanali të lavanderisë dhe i tërë hoteli e kishte dëgjuar duke bërë thirrje për ndihmë. Ka bërë shaka me faktin se ai kishte kërkuar ndihmë²⁹².

¹⁶⁴ 27.10.2015, f. 28-29.

¹⁶⁵ 27.10.2015, f. 29, 30.

¹⁶⁶ 27.10.2015, f. 30.

¹⁶⁷ 27.10.2015, f. 31.

¹⁶⁸ 27.10.2015, f. 32, 28.10.2015, f. 26.

¹⁶⁹ .3.2015; f. 12. ²⁹²

17.3.2015; f.12.

304. ¹⁷⁰**E.D.** ka dëgjuar nga R.D. për zënkën në hotel dhe për faktin se ai e kishte goditur A.A.G. me veturë²⁹³.
305. **M.A.G.** e ka mohuar të ketë pasur ndonjë konflikt apo përleshje me R.D.¹⁷¹. S.T. ka gënjyer për këtë, sepse ai po përhapte thashetheme për të në Sarajevë. Pas ngjarjeve në Turqi, ajo e ka sulmuar atë intensivisht në media¹⁷².

Kurdët në Stamboll

306. Nuk ka prova të besueshme për të konfirmuar se kurdët janë përfshirë në ndonjë mënyrë në situatën në Turqi.
307. I vetmi dëshmitar që ka marrë pjesë në këto ngjarje ka qenë A.P. Dëshmia e tij në këtë aspekt nuk është konsistente dhe në shumë pjesë është jo logjike. Rrjedha e ngjarjeve që ai e ka prezantuar është po ashtu e pamundur dhe nuk është mbështetur me prova të tjera.
308. Para së gjithash, është e dukshme se A.P. ka përzier elemente të ngjarjeve të ndryshme, pa e respektuar kohën dhe vendin. Fillimisht, ai e ka përshkruar ngjarjen që pretendohet se ka ndodhur në hotelin ku ka ndodhur zënka midis R.D. dhe M.A.G. Kjo situatë do të ndodhte pas takimit në restorant gjatë të cilit R.D. është provokuar. Gjatë marrjes së tij në pyetje, ai e ka zhvilluar rrëfimin dukshëm, sepse nga dëshmia e tij ka rezultuar se situata në hotel do të ishte krijuar kur do të ishin përfshirë kurdët.
309. Së dyti, versioni i tij është i pamundshëm për arsye objektive. Sipas tij, M.A.G. ka udhëtuar për t'i angazhuar kurdët në një vend afër kufirit me Sirinë. Ai nuk ka

¹⁷⁰ .12.2015, f. 8.

¹⁷¹ 6.12.2016, f. 25.

¹⁷² 6.12.2016, f. 25.

qenë në gjendje të saktësonte ku saktësisht. Megjithatë, është fakt notor se Turqia është shtet i madh. Janë afro 1000 km nga Stambolli deri te kufiri me Sirinë. Në anën tjetër, M.A.G. me shokë kanë qëndruar në Turqi vetë 3-4 ditë. Prandaj, ka qenë e pamundur që M.A.G. të shkonte dhe të kthehej brenda një kohe aq të shkurtër.

310. Pasi i ka shqyrtuar çështjet e lartpërmendura, gjykata konstaton se është dëshmuar se nuk ka pasur situatë konflikti midis M.A.G. dhe R.D. në Stamboll. Nuk ka prova bindëse se N.K. ka qenë i lidhur në çfarëdo mënyre me ngjarjet në Stamboll. Madje edhe S.T. nuk ka qenë e sigurt nëse ka qenë ai që ka folur me R.D. dhe që e ka kërcënuar atë. Përveç kësaj, nga dëshmitë konsistente të M.A.G. dhe N.K. rezulton se marrëdhëniet midis tyre janë bërë shumë më të ftohta duke filluar nga viti 2003. Prandaj, nuk ka arsye për të besuar se M.A.G. do të kishte kërkuar ndihmë nga N.K.
311. Prandaj, nuk ka dëshmi për të provuar se situata në Stamboll që ka ndodhur në vitin 2003 ka qenë motiv për ta vrarë R.D. katër vite më vonë.

Përmbledhje e provave

312. Sipas **A.P.**, N.K. e ka dërguar M.A.G. në pjesën aziatike të Turqisë, ku ishte paguar për vrasjen e R.D.¹⁷³. A.P. ka marrë vesh për këtë nga M.A.G., i cili i ka thënë “‘Gu.’ (kështu e ka thirru ai N.K.) më ka paguar mua dhe nuk ka më komandant¹⁷⁴”. Ai nuk e ka dëgjuar N.K. duke thënë “shko te pjesa aziatike e

¹⁷³ 27.10.2015, 31.

¹⁷⁴ 27.10.2015, f. 31.

f.

Turqisë dhe fol me personin për ta vrarë R.D.¹⁷⁵”

313. A.P. nuk e ka ditur saktësisht se sa ishin paguar, por përafërsisht 200.000 – 250.000 marka konvertibile¹⁷⁶. M.A.G. i ka treguar për këtë pasi janë kthyer në Sarajevë¹⁷⁷. Më vonë, A.P. e ka korrigjuar vetveten dhe ka shpjeguar se për shumën e parave kishte dëgjuar nga R.D.¹⁷⁸. A.P. nuk e ka ditur se kush i kishte marrë paratë¹⁷⁹.
314. Kur është marrë në pyetje të tërthortë, A.P. ka thënë se M.A.G. kishte shkuar në pjesën aziatike të Turqisë vet dhe kishte kontaktuar me disa njerëz atje¹⁸⁰. Kjo kishte ndodhur gjatë udhëtimit të njëjtë në Turqi. M.A.G. ka shkuar atje vetëm, të nesërmen herët në mëngjes pas ngjarjeve në hotel. Ai është kthyer në orët e mbrëmjes e pastaj është takuar me A.P. dhe vëllain e tij në hotelin “Zagreb” në Turqi³⁰⁴.
315. Kjo situatë kur R.D. e ka goditur A.A.G. me veturë ka qenë afro 2-4 orë para takimit me kurdët¹⁸¹. M.A.G. ka qenë i tërbuar dhe e ka thirrur N.K., i cili i ka thënë që të shkonte në një ndërtesë të caktuar. Kanë qenë rreth 30-40 njerëz me armë që kanë shkuar për ta vrarë R.D.¹⁸². Gjatë marrjes në pyetje të tërthortë, ai

¹⁷⁵10.11.2015, f. 27.

¹⁷⁶ 27.10.2015, f. 37.

¹⁷⁷ 27.10.2015, f. 37.

¹⁷⁸ 27.10.2015, f. 38.

¹⁷⁹ 28.10.2015, f. 12.

¹⁸⁰ 10.11.2015, f. 23.

³⁰⁴ 27.10.2015, f.32.

¹⁸¹ 27.10.2015, 35.

¹⁸² 27.10.2015, 32.

f.

f.

f.

ka shtuar se përveç kurdëve ka qenë edhe një person nga Sanxhaku¹⁸³. M.A.G. dhe R.D. i kanë treguar pastaj se këta njerëz përreth ishin kurdë¹⁸⁴. Kur është marrë në pyetje të tërthortë, A.P. ka dëshmuar se ky takim është mbajtur në njëfarë restoranti në majë të ndërtesës¹⁸⁵.

316. Gjatë kësaj situate, M.A.G. e ka thirrur R.D. dhe ka folur me të gjersa ai është këshilluar nga “kurdi kryesor”. Ai ka propozuar takim për pajtim. Kanë rënë dakord që të takoheshin para hotelit ku ka qëndruar R.D., por R.D. ka pasur dyshime¹⁸⁶. R.D. ka thënë se nuk ka qenë ai që e ka hedhur bombën¹⁸⁷.

317. Kur M.A.G., A.P. dhe të tjerët kanë ardhur në afërsi të hotelit, aty kanë qenë 5-8 automjete më parë¹⁸⁸. Udhëheqësi i këtyre kurdëve i ka shpërndarë ata; ata e kanë pritur R.D. që të dilte¹⁸⁹. A.P. nuk i është kujtuar nëse këta njerëz kanë qenë të uniformuar. Ai ka garantuar se i ka parë së paku 10 njerëz në këtë grup të armatosur. Ata kanë pasur shkorpiionë, Heckler & Koch, armë dore dhe Uzi¹⁹⁰. Gjatë marrjes në pyetje të tërthortë ai ka thënë se është dukur sikur armatë e vërtetë¹⁹¹. Megjithatë, ai ka pranuar se armët kanë qenë të fshehura³¹⁶.

¹⁸³ 10.11.2015, 38; 40-41.

¹⁸⁴ 10.11.2015, f. 29.

¹⁸⁵ 10.11.2015, f. 30-31, 37.

¹⁸⁶ 27.10.2015, f. 32, 28.10.2015, f. 27.

¹⁸⁷ 27.10.2015, f. 333-34; 28.10.2015, f. 27.

¹⁸⁸ 27.10.2015, f. 36.

¹⁸⁹ 27.10.2015, f. 32.

¹⁹⁰ 27.10.2015, f. 33.

¹⁹¹ 10.11.2015, f. 29.

³¹⁶ 10.11.2015, 30.

f.
f.
f.

318. Kurdët kanë qëndruar ma ta dhe u kanë bërë roje. Të nesërmen i kanë dërguar në aeroport. Ai nuk e ka ditur nga kanë ardhur¹⁹². Janë kthyer në Sarajevë më 30 dhjetor¹⁹³.
319. Vetëm atëherë, kur kanë arritur në afërsi të hotelit, R.D. e ka thirrur M.A.G. dhe ka thënë se ka dashur të fliste me Izon dhe A.P. R.D. ka kërkuar nga I.Sp. përmes telefonit që t'ia jepte një shenjë me një të kollitur për t'i treguar nëse ishte grackë. I.Sp. është kollitur dhe i ka thënë R.D.: “Si është puna? Pse s’po pajtoheni?”¹⁹⁴.
320. A.P. ka hyrë në dhomë para M.A.G., ndërsa ai ka arritur që t'i tregonte Izos se ishte grackë¹⁹⁵. Pastaj, M.A.G. e ka marrë telefonin dhe ka filluar të mallkojë e të shajë. Ai ka thënë: “Do t’ju vras!” dhe gjëra të këtilla¹⁹⁶.
321. Pas kësaj, R.D. ka qenë temë pothuajse çdo ditë, sepse ata ia kanë pasur frikën³²².
322. A.P. ka pranuar se ai nuk ka thënë se ata kanë qenë kurdët e njëjtë me ata të pjesës aziatike të Turqisë. Ai nuk ka parë t’u jetë dhënë ndonjë para atyre për ta vrarë R.D. Ai nuk e ka parë as N.K., as djemtë e tij, as bashkëpunëtorët e tij duke folur me ta¹⁹⁷.

¹⁹² 27.10.2015, 36.

¹⁹³ 27.10.2015, 37.

¹⁹⁴ 27.10.2015, f. 34.

¹⁹⁵ 10.11.2015, f. 29.

¹⁹⁶ 27.10.2015, f. 36.

³²² 27.10.2015, 38.

f.

f.

f.

323. Sipas A.P., kur R.D. është kthyer nga Stambolli në Bosnjë, konflikti midis tij dhe M.A.G. është bërë më serioz. R.D. është fshehur nëpër qytet. Ai është kthyer në dhjetor apo tetor të vitit 2004, pastaj ai është arrestuar dhe i ka kaluar 5 muaj në paraburgim. Pasi është liruar, konflikti është bërë vërtetë i tensionuar³²⁴.

¹⁹⁷ 10.11.2015, 41-42.

³²⁴ 27.10.2015, 40.

f.
f.
f.

324. **M.A.G.** ka pretenduar se nuk është takuar me kurdët në Stamboll, nuk ka pasur armë dhe nuk ka folur për ndonjë lokal. Sipas tij, këto pyetje janë bërë nën ndikimin e S.T. dhe A.P.¹⁹⁸¹⁹⁹.
325. Sipas **M.U.**, R.D. i ka thënë se ai e ka pasur një konflikt atje me M.A.G., i cili kishte tentuar ta vriste dhe i kishte angazhuar disa kurdë për këtë. Ka pasur një rrahje në rrugë përballë hotelit. M.U. nuk di ndonjë detaj. Nuk ka qenë aty. Megjithatë, R.D. nuk e ka përmendur N.K. në lidhje me këtë ngjarje.³²⁶
326. Kanë qenë edhe disa dëshmitarë që kanë dhënë dëshmi për situatën me kurdët, e cila ishte bërë njëra nga historitë për të cilat “e tërë Sarajeva kishte ditur”. Dëshmitë e tyre sa i përket kësaj pjese gjykata i ka vlerësuar si thelbësisht të pambështetshme, sepse nuk vijnë nga pjesëmarrësit e drejtpërdrejtë të këtyre ngjarjeve, por janë të bazuara në thashetheme. Sidoqoftë, gjykata konstaton se është e arsyeshme që të citohen për të treguar se çfarë lloj provash janë përdorur në këtë rast.
327. **K1** ka pretenduar se ka mësuar për situatën në Turqi nga R.D., i cili i ka treguar për të pas kthimit të tij. Ai po ashtu ka dëgjuar për të nga M.A.G., i cili i ka treguar për të gjatë takimit me Z.T.³²⁷.
328. Duhet të përmendet se **M.A.G.** ka mohuar ta ketë njohur K1. Ia ka dëgjuar emrin dhe ka dëgjuar se ka qenë dëshmitar, por kurrë s’e ka parë apo vizituar²⁰⁰.

¹⁹⁸ 6.12.2016, f. 37.

¹⁹⁹ 3.2016, f. 10.³²⁷

9.11.2016, 8.

²⁰⁰ 6.12.2016, 27.

f.

f.

329. Kur është pyetur se si ka ditur për konfliktin midis N.K dhe R.D., **K1** ka thënë se M.A.G. ka udhëtuar për në Turqi, ndërsa R.D. ka shkuar atje për të kuptuar se ku po e merrnin drogën. R.D. nuk i ka treguar K1 se çfarë ka kuptuar²⁰¹. K1 nuk ka e ditur nëse kjo ka qenë në vitin 2002 apo 2003²⁰².
330. Sipas K1, M.A.G. ka shkuar në Turqi për ta kërkuar R.D., sepse ka dëgjuar se ai kishte shkuar atje. Kujtesa e K1 është freskuar me deklaratën e tij të datës 17.3.2016, kur ai ka thënë: *“Kur e ka marrë vesh N.K. [se R.D. kishte shkuar atje për të marrë vesh se nga kush po e merrnin drogën], ai i ka dërguar M.A.G. dhe kurdët në Turqi, ndërsa unë nuk e di se çfarë kanë dashur të bënin – ta sulmonin apo ta vrisnin R.D. në Turqi”*. Ai e ka konfirmuar këtë deklaratë³³¹.
331. Dëshmia e K1 nuk ka vlerë provuese, por e shfaq vendosmërinë e këtij dëshmitari për ta mbështetur rrëfimin e tij se N.K. dhe R.D. kanë qenë kundërshtarë për shkak të drogës. Tregon se K1 nuk ka qenë fare në dijeni për ngjarjen që ka çuar në vdekjen e R.D., sepse është në kundërshti me provat e tjera nga të cilat ka rezultuar qartë se R.D. ka ikur në Turqi për shkak të hetimeve të vazhdueshme penale kundër tij dhe nuk ka shkuar atje për shkak të synimit të tij për t’i gjetur shtigjet e drogës.

Kthimi nga Turqia

332. Gjykata ka konstatuar se është dëshmuar se pas ngjarjeve në Turqi ka pasur tension të vazhdueshëm midis R.D. dhe M.A.G. Në anën tjetër, A.P. është bërë i

²⁰¹ 9.11.2016, f. 6.

²⁰² 9.11.2016, 7, 9.11.2016, f. 10.

³³¹ 17.3.2015; 14; 17.3.2016 f. 9.

f.

f.

afërt me R.D., çfarë është konfirmuar edhe nga dëshmitarët e tjerë.

333. Edhe dëshmia e A.P. tregon se ai ka qenë i prirë ta fajësonte N.K. për shumë ngjarje, duke përfshirë vdekjen e mikut të tij T.T., ndonëse nuk ka dëshmi për t'i mbështetur pretendimet e tij. Prandaj, dëshmitë e tij duhet të trajtohen me shumë kujdes.

Përmbledhje e provave relevante

334. **A.P.** i është kujtuar data kur kanë udhëtuar në Turqi, sepse e ka lidhur me vdekjen e T.T.. Tashmë e kishin festuar Vitin e Ri në Bosnjë²⁰³.
335. Në këtë periudhë kanë qenë shokë me M.A.G., por A.P. tashmë e respektonte më shumë R.D.²⁰⁴. Gjatë marrjes në pyetje të tërthortë, ai ka shpjeguar se është me M.A.G. dhe shoqërinë e tij është shoqëruar që nga viti 2001. Ai ka potencuar se ka qenë përherë mik i R.D.²⁰⁵. Ata kanë komandantë, përderisa M.A.G. ka qenë kontrabandist³³⁵.
336. Janë kthyer nga Stambolli më 30 dhjetor. A.P. ka kontaktuar me M.A.G. deri më 18 janar të vitit 2004, kur është vrarë miku më i mirë i tij, T.T.²⁰⁶. A.P. e ka fajësuar M.A.G. për vrasjen e T.T., prandaj u ka dhënë fund të gjitha kontakteve me të²⁰⁷.

²⁰³ 28.10.2015, f. 22.

²⁰⁴ 28.10.2015, f. 12.

²⁰⁵ 10.11.2015, f. 34.

³³⁵ 8.12.2015, f. 15.

²⁰⁶ 27.10.2015, f. 37.

²⁰⁷ 27.10.2015, f. 38-39.

f.

337. Menjëherë pas vdekjes së T.T., A.P. ia ka raportuar ngjarjet policisë në Turqi²⁰⁸. Z.T. është arrestuar për vrasjen e T.T., por A.P. e ka ditur se ka qenë N.K.²⁰⁹.
338. **Z.T.** ka pranuar se ai është dënuar për shpërthimin në banesën e tij kur është vrarë T.T. dhe kur është lënduar i afërmi i tij, B.I., përfshirë faktin që është verbëruar³⁴⁰.

²⁰⁸ 27.10.2015, f. 39.

²⁰⁹ 27.10.2015, f. 39; 8.12.2015, f. 18 – 19.

³⁴⁰ 19.6.2015, 4.

f.

f.

339. **E.D.** ka konfirmuar se **R.D.** ka pasur marrëdhënie shumë të mira me **T.T.**, sepse gruaja e tij ka qenë shoqja më e ngushtë e **E.D.**²¹⁰. Ata janë informuar për vdekjen e tij kur kanë qenë në pushime dimërore në Turqi. Mjeti shpërthyes është vendosur nën veturën e tij²¹¹. Sipas **R.D.**, ka qenë **Z.T.** ai që e ka bërë këtë²¹².
340. Pas vdekjes së **T.T.**, **A.P.** është bërë i afërt me **R.D.**, sepse kanë pasur probleme me njerëzit e njëjtë³⁴⁴. Ai i ka ndërprerë të gjitha kontaktet me **M.A.G.** Nuk ka pasur ndonjë kontakt me **N.K.**²¹³.

3.9.4. Hakmarrja për vdekjen e S.L.

Sipas aktakuzës:

R.D. po ashtu besohet se ka qenë i përfshirë në vrasjen e S.L., i cili ka qenë kumbarë i F.R., kështu që vëllai i S.L., Ek.L., ka komplotuar me F.R., të pandehurin N.K. dhe të tjerët për të kërkuar hakmarrje. Plan për ta vrarë R.D. ishte përgatitur për disa muaj me radhë, por vrasja e S.L. e ka përshpejtuar ekzekutimin e këtij plani.

341. Palët nuk e kanë kontestuar se më datën 24 prill 2007, rreth orës 22.45 në Sarajevë, në kafenenë “Oscar”, M.C., duke i tejkalluar kufijtë e vetëmbrojtjes së nevojshme për t’iu shmangur sulmit të menjëhershëm dhe të paligjshëm, e ka privuar nga jeta tani të ndjerin S.L. Kjo ka ndodhur gjatë konfliktit verbal midis

²¹⁰ E.D., 11.12.2015; f. 13.

²¹¹ 11.12.2015; f. 13.

²¹² 11.12.2015; f. 13.

³⁴⁴ 28.10.2015, f. 11.

²¹³ 10.11.2015, f. 25.

S.L. dhe M.U., kur S.L. e ka nxjerrë një armë dhe ia ka drejtuar M.U. Gjatë përleshjes midis tyre, M.C. ka shtënë me një plumb nga afërsia në pjesën e djathtë të ballit të S.L. dhe ka ikur, ndërsa S.L. ka vdekur²¹⁴.

342. M.C. është dënuar për këtë vepër penale me aktgjykim të formës së prerë me 7 vite burgim, të cilin aktgjykim e ka marrë Gjykata e Lartë e Uzhicës³⁴⁷.
343. Gjykata i ka pranuar konstatimet e gjykatës së Uzhicës në lidhje me këtë ngjarje. Prandaj, në pjesën e mëtejme të aktgjykimit, është e domosdoshme të përqendrohemi vetëm nëse kjo situatë mund të ketë përbërë motiv për N.K. dhe të tjerët për ta vrarë R.D.
344. Gjykata ka konstatuar se nuk ka pasur prova bindëse se vrasja e S.L. ka qenë motiv për ta vrarë R.D. apo së paku për ta përshpejtuar atë. Para së gjithash, prokurori nuk e ka provuar se Ek.L. ka qenë aq i afërt me S.L. për tu ndjerë i obliguar që të hakmerret për vdekjen e tij. Së dyti, vrasësi i S.L. ka qenë i njohur nga fillimi dhe është dënuar për këtë vrasje. Së treti, dëshmitarët Z.T. S.T. dhe K1, të cilët kanë pretenduar se e kanë dëgjuar familjen e L. duke diskutuar për hakmarrjen për këtë vdekje, nuk e kanë përmendur në këtë kontekst N.K., por anëtarët e tjerë të familjes L.
345. Përveç kësaj, nuk është provuar se pas vdekjes së S.L. ka pasur takime midis S.T., N.K., F.R., N.O., S.S. dhe Ek.L. Siç u përmend më lart, nuk është provuar fare se kanë ndodhur takime të tilla. Një pretendim i tillë po ashtu nuk

²¹⁴ Aktgjykimi i Gjykatës së Lartë të Uzhicës i datës 4.11.2010, regjistratori i shqyrtimit gjyqësor 16, d. 8.

³⁴⁷ Cit. z.

mbështetet nga dëshmitë e K6, i cili ka pretenduar se kjo ka ndodhur, sepse dëshmitë e tij gjykata i vlerëson si të pambështetshme. Tashmë u shpjegua se nuk ka pasur arsye për të besuar se ai ka qenë i pranishëm në restorantin rrotullues fare kur F.R. ka pasur takime aty. Krahas kësaj, dëshmitë e K6 që u referohen ngjarjeve të pretenduara pas vdekjes së S.L. janë jo konsistente në vetvete. Një vlerësim i tillë rezulton nga analiza e afatit kohor sa ai ka qenë për ta parë N.K. Ai ka pretenduar se për herë të parë e ka parë në “Casa Grande” në vitin 2007 dhe në “Radon Plaza” vetëm disa muaj më vonë. Kjo nuk është përputhur me kronologjinë e ngjarjeve, duke marrë parasysh se S.L. është vrarë në prill të vitit 2007.

Përmbledhje e provave

346. **A.S.** ka dëshmuar se ka qenë me R.D., M.U. dhe një person tjetër – “M.” me gjasë – në një kafene kur është shtënë në S.L.³⁴⁸ Ajo ka pranuar se pas vdekjes së S.L. R.D. është ndjerë më i frikësuar, por se ai ka qenë i kujdesshëm dhe nervoz edhe para, edhe pas vrasjes së S.L.³⁴⁹
347. Gjatë marrjes në pyetje të tërthortë, ajo ka dëshmuar se R.D. është arrestuar në lidhje me vdekjen e S.L.³⁵⁰. A.S. nuk e ka ditur nëse ai ka pasur konflikt me familjen e L. Ajo vetëm e ka ditur se të gjithë kanë spekuluar se R.D. ka pasur të bëjë diçka me këtë vdekje³⁵¹. Ai nuk i ka përmendur armiq të L.³⁵².
348. **A.P.** ka dëshmuar sepas vrasjes së S.L., Ek.L. dhe N.K. janë bashkuar kundër tij dhe R.D. A.P. e ka ditur këtë, sepse, sipas tij, ata të gjithë kanë qenë të lidhur me F.R. Ai ka pranuar se nuk ka pasur prova për këtë, ndërsa njohuritë e tij i ka

bazuar në intervistën e “G.”³⁵³. N.K. dhe Ek.L. kanë shkuar pas A.P. dhe R.D.,

³⁴⁸ 13.1.2016, f. 14 -15.

³⁴⁹ 18.1.2016, f. 29, 35.

³⁵⁰ 18.1.2016, f. 27.

³⁵¹ 18.1.2016, f. 28.

³⁵² 18.1.2016, f. 29.

³⁵³ 28.10.2015, f. 20-21; 27.11.2015, f. 22.

sepse S.L. dhe Ek.L. kanë qenë të afërm. R.D. ka qenë i pranishëm në restorant kur është vrarë S.L.³⁵⁴. S.C. ka qenë trupprojë e R.D. për 15 ditë³⁵⁵. R.D. ka qenë atje rastësisht. Ai nuk ka pasur të bëjë asgjë me këtë vrasje. Ky person është vrarë spontanisht. Ka qenë marrëzi³⁵⁶.

349. **Al.H.**, një mik i R.D., ka dëshmuar se nuk kanë folur me njëri tjetrin për familjen L. Vetëm M.U. ka thënë se i është frikuar hakmarrjes. R.D. përherë ka thënë se kishte qenë fatkeqësi³⁵⁷. Al.H. ka pranuar se njerëzit kanë bërë me gisht kah R.D. si vrasës, sepse arma e tij është përdorur për ta vrarë S.L.³⁵⁸. Për çudi, në gjykimin e G., Al.H. nuk e ka përmendur S.L. fare në kontekst të vdekjes së R.D. Kur është pyetur për këtë, ai ka shpjeguar se nuk i është dikur relevante. Nuk e ka ditur pse s’e ka përmendur më herët³⁵⁹.

350. **S.T.** ka dëshmuar se F.R. dhe S.L. kanë qenë vëllamë të njëri tjetrit³⁶⁰. Sipas saj, F.R. si shqiptar ka besuar në gjakmarrje³⁶¹. Ajo ka dëshmuar se njerëzit që kanë marrë pjesë në takimet për ta planifikuar vrasjen e R.D. e kanë fajësuar atë për vdekjen e S.L. Ideja për ta vrarë R.D. është përshpejtuar pas kësaj vrasjeje³⁶². Gjatë marrjes në pyetje të tërthortë ajo ka pretenduar se vrasja e S.L. ka qenë vetëm nxitje për ta përshpejtuar vrasjen e R.D.³⁶³. Ajo ka pretenduar se kurrë nuk

e ka përmendur këtë si motiv për ta vrarë R.D. dhe se ka qenë vetëm mbrojtësi i N.K që ka sugjeruar kështu³⁶⁴.

³⁵⁴ 28.10.2015, f. 21.

³⁵⁵ 27.11.2015, f. 44.

³⁵⁶ 27.11.2015, f. 5.

³⁵⁷ 27.1.2016, f. 21.

³⁵⁸ 27.1.2016, f. 28, 29.1.2016, f. 4.

³⁵⁹ 22.02.2016, f. 9 – 10.

³⁶⁰ 16.3.2015; f. 15; edhe fotografia e treguar.

³⁶¹ 18.3.2015, f. 21; 18.5.2015, f. 18.

³⁶² 18.3.2015, f. 7.

³⁶³ 13.5.2015, f. 27. ³⁶⁴ 13.5.2015, f. 28.

351. ²¹⁵²¹⁶Gjatë marrjes në pyetje të tërthortë, ajo ka shpjeguar se F.R., N.K., N.O., Ek.L.

dhe S.S. e kanë fajësuar R.D. si iniciator të vrasjes së S.L. Ajo ka dëshmuar se ata kanë thënë se R.D. e ka sjellë qëllimisht S.L. në vendin ku ai është vrarë. Ata po ashtu kanë pretenduar se R.D. ia ka dhënë M.C. armën me të cilën është vrarë S.L.³⁶⁵. Familja L. e ka kritikuar R.D. se nuk e ka parandaluar vrasjen e S.L.³⁶⁶.

352. **K6** ka pretenduar se takimet e grupit të pretenduar janë mbajtur intensivisht pas vdekjes së S.L. Ai ka dëgjuar se ata po flisnin për këtë, por nuk ka dëgjuar ndonjë detaj. Ai i ka dëgjuar emrat: S.L., R.D. dhe “Vo.”, asgjë më shumë²¹⁷. Pas vdekjes së S.L., gjatë një periudhe dy-tremujore janë mbajtur shumë takime, kur ata kanë folur për këtë vrasje. Një herë, K6 e ka dëgjuar sipas të gjitha gjasave Ek.L. duke thënë se “*nuk mund ta durojmë më*” dhe para kësaj kanë folur për vrasjen. Me këtë rast, K6 ka qenë i ulur me shpinë të kthyer kah ta, në restorant. Të pranishëm kanë qenë: F.R., N.K., Ek.L., S.S. dhe S.T. Ai nuk ka dëgjuar

²¹⁵ 4.2015, f. 21.

²¹⁶ 5.2015, f. 18.

²¹⁷ 15.9.2015, f. 36, 37.

asgjë më shumë. Ky takim ka qenë para vdekjes së R.D.²¹⁸. Gjatë marrjes në pyetje të tërthortë, ai ka thënë se nuk ka qenë i ulur, por ka qëndruar në këmbë prapa banakut. Ka qenë i sigurt se ka qenë Ek.L. ai që i ka thënë këto fjalë. Emri i R.D. nuk është përmendur, por vetëm i R.D., komandantit, penguesit, R.D., Vojvodës, etj. Sipas të gjitha gjasave, N.O. nuk ka qenë i pranishëm atëherë²¹⁹.

353. Në kontekst të dëshmisë së K6, duhet të përmendet se ai po ashtu ka dëshmuar se e ka njohur N.K.²²⁰. Ai e ka parë atë për herë të parë në hotelin “Casa Grande” në vitin 2007, kur F.R. i ka thënë që ta çonte atje. Nuk i është kujtuar kur ka qenë saktësisht kjo²²¹. Ai ka dëshmuar se pas kësaj situatë e ka parë N.K. në shumë raste në hotelin “Radon Plaza”, më shumë se 10 herë²²². Kur është pyetur sa kohë pas kësaj here të parë në “Casa Grande” e ka parë N.K. në “Radon Plaza”, ai ka thënë se e ka parë pas disa muajve²²³.

354. **Z.T.**, gjatë marrjes në pyetje të tërthortë të tij po ashtu ka pretenduar se vrasja e S.L. vetëm sa e ka përshpejtuar vdekjen e R.D.²²⁴. Ai e ka bazuar njohurinë e tij në atë që e ka dëgjuar jo vetëm nga gruaja e tij, por edhe nga dikush tjetër. Ai nuk ka qenë në gjendje që të tregonte se kush ka qenë ky person që i kishte treguar për këtë²²⁵.

²¹⁸ 15.9.2015, f. 39.

²¹⁹ 16.9.2015, f. 33.

²²⁰ 15.9.2015, f. 15.

²²¹ 15.9.2015, f. 15 – 16.

²²² 15.9.2015, f. 17.

²²³ 15.9.2015, f. 17.

²²⁴ 19.6.2015, f. 29.

²²⁵ 19.6.2015, f. 28 – 29.

355. Z.T. ka dëshmuar se 2-3 ditë pas vrasjes së S.L. është ulur me Ek.L., Esh.L. dhe avokatin D.B. në restorantin e tyre “Va.”. Ata e kanë fajësuar R.D. për vdekjen e S.L. Ai i është shmangur dhënies së ndonjë përgjigje të qartë se a ka qenë aty F.R. apo jo. Fillimisht, ai ka thënë se F.R. ka thënë se ata duhej të hakmerreshin apo të merrnin hak për këtë vdekje. Më vonë ai ka thënë se për këtë ka dëgjuar vetëm nga vëllezërit L.²²⁶ Gjatë dhënies së mëtejshme të dëshmisë, Z.T. ka dëshmuar se me F.R. ka folur për këtë vrasje përafërsisht në vitin 2008, tashmë pas vrasjes së R.D.³⁷⁷.
356. Kur është pyetur për këtë takim gjatë marrjes në pyetje të tërthortë, Z.T. ka thënë se vëllezërit L. kanë folur për rrahjen e S.L. nga R.D. disa vite më parë. Ata kanë komentuar se po të kishin reaguuar si duhet atëherë, vrasja e S.L. nuk do të kishte

²²⁶ Z.T. Z.T., 16.6.2015, f. 26 – 27; 19.6.2015, f. 8-9.

³⁷⁷ Z.T., 16.6.2015, f. 27.

ndodhur. Në atë moment, ata nuk kanë folur se si ta organizonin vrasjen e R.D. Ata e kanë ditur se Ek.L. e kishte vrarë S.C., por kanë besuar se ai ka qenë vetëm dytësor. R.D. ka qenë i pranishëm në skenën e krimit, prandaj e kanë shënjuar si kryerësin kryesor²²⁷. Vëllezërit L., D.B., N.K. dhe F.R. e kanë fajësuar R.D. për këtë vdekje, sepse njeriu që e ka vrarë ka qenë në shoqërinë e tyre²²⁸.

357. Edhe Z.T. ka dëshmuar se ka marrë pjesë personalisht në dy takimet kur është diskutuar çështja e R.D. Gjatë takimit të parë, menjëherë pas vrasjes së L., është mbajtur një diskutim i përgjithshëm për jetën e tij, vdekjen e tij dhe gabimin që nuk i ishte marrë hak për rrahjen e tij para disa viteve. Gjatë këtij takimit emri i R.D. është paraqitur si i një njeriu që ka qenë përgjegjës për vdekjen e L.²²⁹. Gjatë takimit të dytë, në praninë e anëtarëve të familjes L.: Ek.L., Es.L. dhe kamerieri N.Du., D.B. ka kërkuar nga Z.T., në emër të N.K., që ta gjente dikë për ta likuiduar R.D. N.K. nuk ka qenë i pranishëm. Oferta nuk ka pasur të bënte me paratë²³⁰. F.R. ka qenë në takim një herë, ndërsa N.K. nuk ka qenë²³¹.

358. Sipas Z.T., S.T. nuk e ka ditur se ai po takohej me ta²³². Megjithatë, gjatë marrjes në pyetje të tërthortë, ai nuk ka qenë i sigurt nëse i kishte thënë asaj se po i ofrohej që të gjente vrasës. Ndoshta i ka thënë, dhe kjo ka qenë para vrasjes²³³.

²²⁷ 22.6.2015, f. 14.

²²⁸ 16.6.2015, f. 29.

²²⁹ 22.6.2015, f. 11-12.

²³⁰ 22.6.2015, f. 13.

²³¹ 19.6.2015, 9.

²³² 19.6.2015, 9.

f.

f.

f.

359. **Ek.L.** ka dëshmuar se mund të jetë takuar me Z.T. dy – tri herë, por se kurrë nuk është shoqëruar me të. Ai ka shkuar një herë në kafenenë e tij “Va.”, por kurrë nuk janë ulur bashkë në një tavolinë. Ai ka kërkuar nga avokati i Z.T. që të mos e çonte në këtë vend, sepse në media përherë kishte informata për përfshirjen e tij në aktivitet kriminal³⁸⁵.
360. Sipas **M.U.** ka pasur takime pas vdekjes së S.L. të cilat janë mbajtur në “Va.” dhe “Re.” dhe në të cilat kanë marrë pjesë shumë njerëz. Nuk e ka ditur se çfarë kanë diskutuar³⁸⁶. Kujtesa i është rifreskuar me deklaratën e tij të mëparshme të datës 29 qershor 2007, ndërsa ka konfirmuar se Ed.L. është betuar se do të merrte hak për vdekjen e S.L.³⁸⁷.
361. M.U. po ashtu ka thënë se R.D. në disa raste i ka thënë se familja L. donte të merrte hak për vdekjen e S.L. Fillimisht, R.D. nuk i ka marrë këto kërcënime seriozisht, sepse nuk ka qenë faji i tij. Më vonë, ai e ka ndërruar qasjen, sepse edhe ata kanë filluar ta kërcënonin. Kjo ka qenë arsyeja pse ai ka filluar të mbante veshur jelek antiplumb. Ai po ashtu i ka pasur dy armë me vete. Ka mësuar se dikush kishte paguar 250.000 euro për vrasjen e tij³⁸⁸.
362. Edhe **K1** ka pretenduar se ka pasur njohuri për vdekjen e S.L. Ai ka thënë se e ka parë Ek.L. disa herë në restorantin rrotullues dhe lokalin e tij³⁸⁹. K1 madje ka thënë se ka pasur marrëdhënie shumë të mira me të. Pas vdekjes së S.L., ai ka shkuar në kafenenë e tij me avokatin e tij, D.B. K1 është përpjekur të linte përshtypje se e kishte njohur Ek.L. shumë mirë³⁹⁰, por kur është pyetur

²³³23.6.2015, 4.

f.
f.
f.

drejtpërsëdrejti, ai ka thënë se kurrë nuk ka folur drejtpërsëdrejti me të³⁹¹. Sa

³⁸⁵ 19.7.2016, f. 22.

³⁸⁶ 4.4.2016, f. 10.

³⁸⁷ 4.4.2016, f. 11.

³⁸⁸ 4.4.2016, f. 12.

³⁸⁹

9.11.2016, 12.

³⁹⁰

9.11.2016, 36-37.

³⁹¹

9.11.2016, 38.

herë që K1 ka shkuar në lokalitë të tij, ai ka dëgjuar se Ek.L. ishte i inatosur me R.D., ndërsa familja L. ka thënë se do të hakmerrej për vdekjen e S.L. Me sa i është kujtuar, Ek.L. nuk i ka ndarë spekulimet e tij me të²³⁴. K1 nuk i është kujtuar nëse kishte folur me F.R. për vdekjen e S.L.²³⁵.

363. Nuk ka provë për të konfirmuar se K1 e ka njohur Ek.L. dhe F.R. Prandaj, gjykata gjen se dëshmia e tij në këtë pjesë është krejtësisht e pambështetshme dhe se është krijuar me qëllimin për ta përforcuar vlerën e tij si dëshmitar. Megjithatë, ajo e ka dëmtuar më tej kredibilitetin e tij.

364. **Ek.L.** ka dëshmuar se e ka një vëlla me emrin Esh.L., ndërsa një vëlla tjetër i është vrarë gjatë luftës. S.L. ka qenë vetëm kushëri i tij, e ka pasur kushëri të tretë²³⁶. Ka pasur shumë familje L. në Sarajevë, afro 45²³⁷. Ai ka pasur marrëdhënie solide me S.L., por nuk kanë qenë shumë të afërt, sepse kanë pasur stile të ndryshme të jetuarit. S.L. dhe R.D. kanë qenë të ngjashëm; kanë kaluar

²³⁴ 9.11.2016, f. 38.

²³⁵ 9.11.2016, f. 39.

²³⁶ 19.7.2016, f. 11-12.

²³⁷ 19.7.2016, 29.

f.

f.

f.

shumë kohë së bashku nëpër kafene²³⁸. Gjatë marrjes në pyetje të tërthortë, ai ka pranuar se e ka ditur se S.L. ka qenë i njohur për autoritetet dhe se ka pasur informata në media për këtë, por nuk e ka ditur me çka është marrë, sepse nuk kanë qenë të afërt me njëri tjetrin³⁹⁷.

365. Ek.L. nuk e ka ditur nëse S.L. ka qenë mik i F.R. I ka parë bashkë shumë rrallë. Ek.L. ka qenë vetëm në dasmën e parë të S.L. E ka ditur se gruaja e tij e dytë e ka pasur emrin B.L.. Ka dëgjuar se ajo ka punuar në AVAZ për ca kohë, por nuk e ka ditur kur saktësisht²³⁹.

366. Nuk i ka ditur detajet e vdekjes së S.L. Ai vetëm ka dëgjuar rrëfime që janë përfolur në lidhje me këtë ngjarje²⁴⁰. Familja e tyre e ka ditur se S.L. e ka vrarë M.C. dhe se ai është dënuar për këtë. Kjo familje nuk e ka fajësuar askënd tjetër²⁴¹. Me sa ka ditur ai, R.D. është përpjekur që t'i ndihmonte S.L. dhe e ka organizuar transportin për në spital për të. Ka pranuar se ai dhe R.D. kanë qenë miq së paku për ca kohë²⁴². Ek.L. e ka njohur R.D. personalisht, e ka vizituar në shtëpi dhe i ka njohur gruan dhe fëmijët e tij²⁴³.

367. Ka mohuar të ketë ndonjë njohuri për kërcënimet e anëtarëve të ndryshëm të familjes L. ndaj M.U.²⁴⁴.

²³⁸ 19.7.2016, 13.

³⁹⁷ 6.12.2016, 4.

²³⁹ 6.12.2016, f. 9-10.

²⁴⁰ 6.12.2016, f. 4.

²⁴¹ 19.7.2016, f. 12.

²⁴² 19.7.2016, f. 12-13.

²⁴³ 19.7.2016, f. 12.

f.

f.

f.

368. Ek.L.ka dëshmuar se nuk ka pasur motiv për ta vrarë R.D.⁴⁰⁴. Ata nuk kanë qenë miq me R.D., por e kanë përshëndetur njëri tjetrin sa herë që janë parë⁴⁰⁵. Ka mohuar të ketë kërkuar nga Z.T. që ta vriste R.D.⁴⁰⁶.
369. S.T. e ka quajtur gënjeshtare patologjike. Sipas mendimit të tij, ajo ka dhënë dëshmi kundër tij për t'iu hakmarrë F.R., meqë ai nuk e ka përkrahur. Ajo ka thënë para dëshmitarëve të tjerë se kushdo që ka qenë i afërt me F.R. duhet ta paguajë çmimin. Ka potencuar se thjesht nuk përgjigje tjetër. Ajo nuk e ka

²⁴⁴ 6.12.2016, f. 6-7.

f.
f.
f.

404 19.7.2016, 25.

405 19.7.2016, 40.

406 19.7.2016, 222.

f.
f.
f.

fshehur urrejtjen e saj në blogjet dhe postimet e saj. E ka mohuar çfarëdo përfshirjeje në vrasjen e R.D.²⁴⁵

370. **F.R.** kashpjeguar se S.L. ka qenë vëllami i tij gjatë martesës së tij në Sarajevën e rrethuar. Në këtë dasmë kanë qenë vetëm dëshmitarët²⁴⁶. S.L. ka qenë vëllam i F.R. vetëm rastësisht, për shkak të rrethanave të vështira në Sarajevë²⁴⁷. F.R. nuk ka qenë i pranishëm në dasmën e S.L. Ai e ka ditur se ka qenë i martuar dy herë, por nuk i janë kujtuar emrat e grave të tij. Më vonë, ai ka konstatuar se B.L. ka qenë gruaja e tij⁴¹⁰. Ek.L. i ka njoftuar ata me njëri tjetrin ose një vit para luftës, ose gjatë luftës. F.R. nuk ka pasur marrëdhënie të afërta me të, por mund të ketë ndodhur që të jenë takuar ndonjëherë rastësisht dhe të kenë pirë kafe së bashku²⁴⁸.

371. F.R. ka dëshmuar se Ek.L. dhe S.L. e kanë pasur të njëjtin mbiemër, por nuk kanë pasur lidhje gjaku me njëri tjetrin²⁴⁹.

372. F.R. ka dëshmuar se pas vdekjes së S.L. nuk është takuar me N.K., N.O, S.T. dhe Ek.L.²⁵⁰. Ka ndodhur të ketë folur me Ek.L. për vrasjen e S.L. dhe për arsyen pse S.C. e kishte vrarë. Ka qenë e qartë nga fillimi se kush ka qenë vrasësi. Ai e ka ditur se kjo kishte ndodhur para vrasjes së R.D.²⁵¹. Nuk kanë folur për hakmarrjen për vdekjen e S.L. Vrasësi ka qenë i ditur. F.R. e ka respektuar ligjin.

²⁴⁵ 19.7.2016, f. 23-24.

²⁴⁶ 28.10.2016, f. 22.

²⁴⁷ 28.10.2016, f. 23.

⁴¹⁰ 31.10.2016, f. 6.

²⁴⁸ 28.10.2016, f. 23.

²⁴⁹ 28.10.2016, f. 23.

²⁵⁰ 28.10.2016, f. 29.

²⁵¹ 31.10.2016, f. 4-5.

⁴¹⁵ 31.10.2016, f. 18.

- Ek.L. nuk ka dashur ta bënte këtë⁴¹⁵.
373. F.R. e ka mohuar ta ketë njohur K1⁴¹⁶. Ka potencuar se ka qenë milioner dhe se nuk ka pasur nevojë të merrte para nga asnjë kriminel⁴¹⁷.
374. E.D. ka dëshmuar se R.D. ka qenë mik i familjes L. Nuk e kanë fajësuar atë për vdekjen e S.L.⁴¹⁸.

3.9.5. Motivët e tjerë

375. **Al.H.** gjatë marrjes së tij në pyetje nga policia pak pas vdekjes së R.D. ka dhënë dëshmi për arsyet e mundshme pse dikush e kishte vrarë. Më këtë rast ai e ka përmendur:

- një konflikt që kishte ndodhur në kafenenë “Bohemia”, ku njerëzit e R.D. dhe sigurimi i tij kishin hyrë në konflikt me M.Me.in dhe Z.T.;
 - marrëdhëniet jo të mira me N.K. dhe M.A.G.;
 - pjesëmarrjen e R.D. në zjarrvënien e kamionëve të kompanisë ‘Textil Cosa Nuglu’ që kishin ardhur nga Turqia⁴¹⁹;
 - një konflikt midis “Am.” dhe R.D.⁴²⁰;
 - një konflikt me N.Sp., për të cilin ai ka dyshuar se e ka hedhur një bombë në shtëpinë e tij⁴²¹ e që kishte ndodhur dy – tre muaj para vdekjes; -
- një konflikt të armatosur para klubit “Bohemi” me A.Sh.⁴²².

⁴¹⁶ 31.10.2016, f. 31.

⁴¹⁷ 31.10.2016, f. 31.
f.

⁴¹⁸ 11.12.2015, f. 43.

⁴¹⁹ 29.1.2016, f. 16.

⁴²⁰ 29.1.2016, f. 17.

⁴²¹ 29.1.2016, f. 19. ⁴²² 22.2.2016, 21.

3.10. Kërcënimet dhe thirrjet telefonike midis R.D. dhe njerëzve të N.K

376. Sipas prokurorit, mënyrë tjetër për të provuar se ka pasur konflikt të thellë midis N.K dhe R.D. ka qenë një bisedë telefonike midis këtij të fundit dhe Al.Ku., një njeriu që ka punuar për N.K.
377. Gjykata ka konstatuar se është dëshmuar se në vitin 2005/2006 është zhvilluar një bisedë midis R.D. dhe Al.Ku., në të cilin ata e kanë caktuar një takim për ta zgjidhur konfliktin midis tyre. Kjo rezulton nga deklaratat e E.D., A.P., Al.H. dhe N.K. Dëshmitë e K1 janë vlerësuar si të pambështetshme, sepse nuk ka prova të tjera për të dëshmuar se ai e ka njohur R.D.
378. Përmbajtja e kësaj bisede dhe fakti se Al.Ku. ka punuar për N.K. nuk mjafton për të provuar se ky i fundit ka qenë i përfshirë në të. Nga provat e paraqitura rezulton se kjo ka qenë situatë vetëm midis Al.Ku. dhe R.D.
379. Më datën 6 maj të vitit 2015, prokurori ka paraqitur propozim për pranimin e audio regjistrimit të bisedës midis R.D. dhe Al.Ku. nga “YouTube” për ta provuar ekzistencën dhe përmbajtjen e kësaj bisede. Ky propozim është refuzuar më 13 tetor të vitit 2015 si thelbësisht i pambështetshëm, sepse në rastin e regjistrimeve të publikuara në “YouTube” nuk mund të vërtetohet burimi dhe vërtetësia e tij [neni 259 (2) i KPP-së]. Propozimi i njëjtë është përsëritur më 29 tetor të vitit 2015 dhe është refuzuar përsëri më 10 nëntor të vitit 2015.
380. Më datën 4 prill 2017, prokurori ka paraqitur propozim për ta pranuar bisedën e përgjuar midis R.D. dhe Al.Ku., por nuk ka siguruar urdhër gjyqësor për të

treguar se është marrë në mënyrë të ligjshme. Propozimi është përsëritur më 26 tetor të vitit 2017, këtë herë me urdhër përkatës. Megjithatë, në këtë fazë, gjykata ka konstatuar se ai është bërë i panevojshëm, sepse fakti lidhur me konfliktin midis njerëzve të R.D., në njërin anë, dhe të N.K, në anën tjetër, ishte provuar [neni 258 (2.1) i KPP-së].

381. Po ashtu duhet të potencohet se, duke u bazuar në provat e mbledhura, është vërtetuar se ka pasur konflikt midis R.D. dhe Al.Ku.
382. Gjykata po ashtu e ka refuzuar propozimin e prokurorit të paraqitur më 6 maj të vitit 2015 për ta dëgjuar si dëshmitare V.S., gazetaren që e ka shkruar artikullin për R.D. dhe konfliktin e tij me N.K., për shkak se nuk është provë e përshtatshme për ta provuar këtë rrethanë [neni 258 (1.2.3) i KPP-së]. Si gazetare, ajo nuk ka pasur njohuri të drejtpërdrejta për marrëdhënien midis këtyre personave dhe vetëm do të mund të transmetonte çfarë ka dëgjuar nga njerëzit e tjerë.

Përmbledhje e provave

383. **A.P.** ka dëshmuar se ka qenë fundi i vitit 2005 apo 2006 kur ai dhe R.D. e kanë thirrur Al.Ku. Qëllimi i kësaj thirrjeje ka qenë që të aranzhohej një takim jashtë qytetit për t'i qëruar hesapet midis tyre. Kjo bisedë është përgjuar²⁵². Nuk është arritur ndonjë marrëveshje²⁵³. A.P. ka shtuar se kjo thirrje telefonike ka qenë para pajtimit midis N.K dhe R.D.⁴²⁵

²⁵² 28.10.2015, f. 3, 4.

²⁵³ 28.10.2015, f. 5. ⁴²⁵

8.12.2015, 21.

f.

384. Ekzistencën e bisedës telefonike midis R.D. dhe Al.Ku. e ka konfirmuar **E.D.** Ajo ka dëgjuar për këtë nga R.D., i cili i ka treguar se e kishte thirrur Al.Ku. Gjatë kësaj bisede, R.D. ka paralajmëruar se e ka ditur se njerëzit e M.A.G. po e përcillnin, ndërsa Al.Ku. e ka mohuar. Ai ka sugjeruar se Al.Ku. dhe njerëzit e

M.A.G. duhej të takoheshin diku dhe t'i zgjidhnin mosmarrëveshjet. Pas kësaj bisede, R.D. e ka thirrur Al.Ku. përsëri dhe e kanë caktuar një takim në një vend pa njerëz, në mënyrë që të mos e lëndonin dikë të pafajshëm⁴²⁶. Ajo ka mësuar për këtë bisedë nga R.D., por e ka dëgjuar edhe në "YouTube". Ajo nuk e ka ndërlidhur këtë bisedë me N.K.⁴²⁷.

385. Sipas **Al.H.**, menjëherë pasi R.D. e ka kuptuar se ishte caktuar çmim për kokën e tij, ai ka vënë kontakt me Al.Ku. Kjo bisedë telefonike është regjistruar dhe mund të gjendet në "YouTube". R.D. ka konsideruar se Al.Ku. ka qenë mik i ngushtë i N.K.⁴²⁸. Më vonë, ai ka rënë në kundërshti me vetveten, sepse ka dëshmuar se për këtë bisedë ka mësuar më vonë, kur ajo është publikuar në "YouTube", por madje edhe gjatë kësaj bisede, ata nuk e kanë ditur se janë shqiptarë. Ata vetëm kanë thirrur njerëz për të kuptuar se kush ishte⁴²⁹.

386. **M.U.** ka dëshmuar se R.D. e ka njohur Al.Ku., i cili ka pasur marrëdhënie të mira me N.K. Ata kanë folur me R.D. për Al.Ku. vetëm një herë. R.D. ka treguar për bisedën telefonike që e ka pasur me Al.Ku. Ai e ka pyetur se pse po e përcillnin, ndërsa ai është përgjigjur duke i thënë se nuk po e përcillnin, ndërsa R.D. i ka thënë: "Le të shkojmë diku jashtë Sarajevës në një fushë. Unë mund të vij vet, ndërsa ne mund të shtimë në njëri tjetrin e të mos kemi viktime të pafajshme në rrugët e Sarajevës"⁴³⁰.

387. **K1** po ashtu ka dëshmuar për këtë thirrje telefonike nga R.D. dhe ka thënë se ishte publikuar edhe në "YouTube", ku e kishte dëgjuar⁴³¹. Megjithatë, është

⁴²⁶ 11.12.2015, f. 24.

⁴²⁷ 11.12.2015, f. 24.

f.

⁴²⁸ 27.1.2016, f. 24.

⁴²⁹ 27.1.2016, f. 26.

⁴³⁰ 04.4.2016, f. 16 – 17. ⁴³¹ 9.11.2016, 21 - 22.

përmendur më parë se gjykata nuk ka gjetur prova që do të vërtetonin se K1 e ka njohur R.D.

388.**N.K.** ka konfirmuar se ai e ka njohur Al.Ku., i cili ka punuar për sigurimin e këtij hoteli. Ai ka pranuar se Al.Ku. i ka pasur disa probleme me R.D. që kishin të bënin me disa klube e diskoteka. N.K. nuk ka pasur të bënte asgjë me këtë²⁵⁴.

3.11. Pajtimi midis N.K dhe R.D.

389. Duke u bazuar në provat që janë dëgjuar gjatë gjykimit, gjykata ka vërtetuar se ka pasur pajtim efektiv midis R.D. dhe N.K. Të gjithë dëshmitarët që kanë pasur njohuri për këtë ngjarje kanë dëshmuar për rrethanat e njëjta (kjo ka ndodhur në kafenenë “Ak.”, është lehtësuar nga një mik i përbashkët nga Zagrebi (L.K.), ndërsa pajtimi ka qenë vetëm midis R.D. dhe N.K. M.A.G. nuk ka qenë i përfshirë në këtë.

390. Diferenca midis dëshmitarëve ka të bëjë me vlerësimin e pajtimit, se a ka qenë “i vërtetë” apo “i rremë”. Më skeptiku ka qenë A.P., i cili ka potencuar se nuk ka besuar në këtë pajtim fare. Megjithatë, duhet të theksohet se ky është vetëm mendimi i tij, i cili nuk mbështetet me prova të tjera. Për më tepër, ky dëshmitar e ka ndryshuar dukshëm dëshminë e tij krahasuar me atë që e ka dhënë në vitin 2009, kur ai nuk ka pasur dyshime se ka pasur pajtim efektiv midis N.K dhe R.D. Kur është pyetur për këtë mospërputhje, ai ka shpjeguar se atëherë nuk ka thënë se ka qenë pajtim i rrejshëm, sepse askush nuk e ka pyetur për këtë. Një

²⁵⁴ 5.10.2017, 20.

shpjegim i tillë nuk mund të trajtohet si i besueshëm, sepse ai nuk është pyetur për këtë as gjatë gjykimit kundër N.K, ndërsa ka thënë se kështu spontanisht, me iniciativë të tij.

391. Një ndryshim i ngjashëm i versioneve të paraqitura të ngjarjeve mund të vërehet në dëshmitë e Al.H., i cili ka dëshmuar në këtë rast se pajtimi nuk ka qenë i vlefshëm, ndërsa në gjykimin kundër M.A.G. ai nuk ka pasur asnjë dyshim se pajtimi ka qenë i vlefshëm. Kur është pyetur për arsyet e një ndryshimi të këtillë, ai ka thënë se atëherë ka qenë A.P. ai që i ka treguar detajet e këtij pajtimi.
392. Gjykata ka vlerësuar se ndryshimi i versioneve nga këta dëshmitarë ka rezultuar nga qëllimi i tyre për tu dënuar dikush përfundimisht për vdekjen e R.D. Kur nuk kanë arritur që ta arrijnë këtë gjatë gjykimit kundër M.A.G., ata i kanë përshtatur versionet e tyre dhe kanë dëshmuar në një mënyrë që do të ishte fajësuese për N.K. Megjithatë, siç është përmendur më lart, gjykata ka konstatuar se në bazë të provave të tjera është dëshmuar se pajtimi midis R.D. dhe N.K. ka qenë i vërtetë.

Përmbledhje e provave

393. Kur është pyetur për pajtimin, **N.K.** ka thënë se njëherë Al.Ku. e ka rrahur A.P. në diskotekën “Biçakqiq” dhe se për shkak të kësaj ishte hedhur një bombë në hotelin e tij. N.K. është shqetësuar shumë, sepse ka dëgjuar se bombën e kishin hedhur njerëzit e R.D. Ai ka kërkuar nga miku i tij nga Zagrebi, L.K. që të kontaktonte me R.D. për ta diskutuar këtë, sepse ata kurrë nuk kishin pasur ndonjë keqkuptim. Takimi ka ndodhur në “Ak.”, në fund të vitit 2005 apo në

fillim të vitit 2006. Janë ulur aty, kanë pirë kafe, kanë qëndruar ulur për një kohë mjaft të gjatë dhe R.D. ka thënë: *“Më vjen mirë që patëm rast të uleshim dhe të kuptonim se asnjëri nuk kemi asgjë kundër njëri tjetrit. Do të flasë me njerëzit e mi që të mos kemi më zënka, ndërsa çfarë unë kam me M.A.G. është çështje*

imja”. E kanë përshëndetur njëri tjetrin dhe që nga ajo kohë nuk kanë pasur më fjalë të këqija. Pas aksidentit janë parë vetëm një herë dhe nuk kanë pasur më keqkuptime²⁵⁵.

394. Sipas **A.P.**, ka pasur një përpjekje për pajtim midis R.D. dhe N.K që është organizuar nëpërmjet mikut të përbashkët të tyre nga Zagrebi, “L.”. Kjo ka ndodhur në Sarajevë²⁵⁶. A.P. ka pretenduar se ky ka qenë pajtim i rrejshëm. I ka treguar R.D. për këtë. Ai ka thënë se ka ditur për këtë, por se do ta ndjente çdo lëvizje që ata do ta bënin²⁵⁷. A.P. nuk ka dashur që të shkonte atje. Pasi ka ndodhur kjo, ai i ka thënë R.D. se nuk ka besuar në këtë, ndërsa R.D. e ka thënë të njëjtën⁴³⁶.

395. A.P. është konfrontuar me deklaratën e tij në gjykimin kundër M.A.G. kur ai ka treguar se ka mësuar nga R.D. se ka pasur pajtim midis tij dhe N.K. Atij nuk i është kujtuar ta kishte thënë këtë, apo ndoshta dikush e kishte ndryshuar dëshminë e tij²⁵⁸.

396. Ai është përballur edhe me procesverbalin e marrjes në pyetje që është mbajtur më 9 qershor të vitit 2008, nga prokurori Oleg Cavka, kur ai ka thënë: *“Kam kuptuar nga të dytë se në atë rast R.D. është pajtuar me N.K., por se ai nuk është pajtuar me ai M.A.G. (...). E di se N.K. ka insistuar që edhe M.A.G. të përfshihej në këtë pajtim, por asgjë s’ka dalë nga kjo”*. A.P. e ka konfirmuar se kjo ka qenë

²⁵⁵ 5.10.2017, f. 20.

²⁵⁶ 28.10.2015, f. 27.

²⁵⁷ 28.10.2015, f. 27.

⁴³⁶ 8.12.2015, f. 36.

²⁵⁸ 28.10.2015, f. 32.

e vërtetë, por ka potencuar se R.D. i nuk i ka besuar kurrë N.K dhe e ka përsëritur qindra herë se N.K. ka dashur ta vriste²⁵⁹.

397. A.P. është përballur edhe me një deklaratë tjetër të tij që ai e ka dhënë para prokurorit Oleg Cavka më 30 janar të vitit 2009. Asokohe ai ka thënë: *“Kur R.D. është kthyer në Sarajevë në vitin 2004, ai ka qenë në konflikt me N.K.; megjithatë ky konflikt është zhdukur shpejt pasi ata janë ulur bashkë në tavolinë, me ndërmjetësimin e L.K. nga Zagrebi, të cilin e kanë njohur me emrin e tij “L.”. Edhe M.A.G. ka dashur të pajtohej me R.D., por R.D. nuk ka dashur, sepse nuk i ka besuar, sepse M.A.G. ka qenë hakmarrës”*. Kur është përballur me të, A.P. ka thënë se askush më parë nuk e ka pyetur se a ka qenë pajtimi i rrejshëm apo jo. Ai ia ka thënë këtë vetëm Cavkas së brendshmi. Ai e ka thënë këtë, por dikush nuk e ka shënuar në procesverbal²⁶⁰.

398. A.P. ka qartësuar se, sipas tij, ky pajtim ka qenë i rrejshëm, sepse ka pasur kërcënime, është hedhur një bombë dhe R.D. ka dyshuar se ka qenë N.K. Në shenjë hakmarrjeje, ata e kanë kryer një sulm në hotelin e tij dhe J.C., i quajtur “Bo.” [J.C.]”, ka qenë i përfshirë në këtë²⁶¹. Ky sulm ka ndodhur në vitin 2005 apo 2006. Që nga ajo kohë, A.P. nuk ka pasur kontakte me J.C., i cili përherë ka dashur që të ishte i afërt me R.D. kurrë s’i ka besuar⁴⁴¹.

399. **E.D.** po ashtu ka ditur për pajtimin që sipas saj ka ndodhur gjysmë viti para vdekjes së R.D., por nuk e ka ditur kur saktësisht. Miku i tyre nga Zagrebi, “L.”,

²⁵⁹ 28.10.2015, f. 35; f. 204 e regjistratorit pas aktakuzës, vëllimi 11.

²⁶⁰ 28.10.2015, f. 35-36; f. 251 e regjistratorit pas aktakuzës, vëllimi 11.

²⁶¹ 27.11.2015, f. 15-16.

⁴⁴¹ 27.11.2015, f. 19-20.

ka ardhur dhe ka thënë se ata kanë rënë dakord që të pajtoheshin dhe që gjithçka do të bëhej mirë⁴⁴². Ky takim me gjasë ka ndodhur në shtëpinë e N.K apo në objektin afarist të tij, por kurrë nuk ka pyetur ku⁴⁴³.

400. Ajo ka dëshmuar se kur R.D. është kthyer nga ky takim. Ai është dikur se ka qenë në disponim të mirë. Ajo e ka pyetur, ndërsa ai i ka thënë se takimi dhe pajtimi kanë shkuar mirë dhe se e ka kanë pasur një bisedë të mirë. E kishin arritur një marrëveshje të mirë. R.D. nuk ia ka treguar hollësitë, por ajo e ka parë se ai ka qenë mjaft i kënaqur, ndërsa ajo ka qenë shumë e gëzuar për këtë⁴⁴⁴. Ajo ka potencuar se burri i saj nuk i ka besuar askujt⁴⁴⁵.

401. **Al.H.** e ka ditur se po arrihej një pajtim midis N.K dhe R.D. që po organizohej në Zagreb nga miku i përbashkët i tyre, “L.”, por nuk e ka ditur se a kishte ndodhur⁴⁴⁶. Ndonëse nuk e ka ditur, ai ka pretenduar se pajtimi nuk ka qenë i vërtetë, sepse R.D. nuk ka pasur besim në N.K., ndërsa N.K. nuk ka pasur besim në R.D.⁴⁴⁷. Më vonë ai ka pranuar se ka dëgjuar për këtë pajtim nga R.D. dhe A.P. Nuk e ka ditur kur ka ndodhur, por se ka ndodhur në “Ak.”. Mendon ka qenë një vit apo një vit [e gjysmë] para vdekjes së R.D.⁴⁴⁸.

402. Gjatë marrjes në pyetje të tërthortë, Al.H. ka konfirmuar se ka dëshmuar në gjykimin e G. dhe se ka pasur pajtim të vërtetë midis N.K dhe R.D., i cili ka ndodhur në “Ak.”. N.K. e ka dhënë *besën*. Pas kësaj, R.D. e ka thirrur N.K. pasi djali i tij është lënduar në një aksident trafiku. Ed. i ka thënë Al.H. se ka qenë i pranishëm në takimin kur ka ndodhur pajtimi midis N.K. dhe R.D.⁴⁴⁹. Ai ka

⁴⁴² 11.12.2015, f. 19.

⁴⁴³ 11.12.2015, f. 20.

⁴⁴⁴ 11.12.2015, f. 20.

⁴⁴⁵ 11.12.2015, f. 53.

⁴⁴⁶ 27.1.2016, f. 10.

⁴⁴⁷ 27.1.2016, f. 11.

⁴⁴⁸ 27.1.2016, f. 23.

⁴⁴⁹ 29.1.2016, f. 19-20.

pretenduar se atëherë ai nuk e ka përmendur se pajtimi nuk ka qenë i vlefshëm, sepse edhe A.P. ka qenë dëshmitar, dhe se, si person që ka marrë pjesë në pajtim, ai është dashur ta shpjegonte këtë⁴⁵⁰. Ai nuk ka thënë se pajtimi ka qenë i pavlefshëm, sepse nuk ka dashur t'i ekspozojë rrezikut⁴⁵¹. Ai ka qenë i qartë se pajtimi ka ndodhur⁴⁵². Në gjykimin kundër N.K ai ka thënë se nuk e ka ditur nëse pajtimi kishte ndodhur, sepse nuk ka qenë i pranishëm aty. Ai nuk ka qenë i pranishëm as në Turqi, ndërsa nuk ka mundur t'i besonte R.D. se N.K. donte ta vriste⁴⁵³. Ai ka pretenduar se madje edhe pas pajtimit, R.D. ka folur për N.K. si armik të tij⁴⁵⁴.

403. Kur është pyetur për ndryshimin e versionit sa i përket pajtimit midis N.K dhe R.D., ai ka thënë se nuk e ka përcjellë këtë gjykim; ai ka ardhur si dëshmitar pa kurrfarë presioni⁴⁵⁵.

404. Në gjykimin e G., Al.H. ka thënë se pak kohë pas pajtimit midis R.D. dhe N.K, R.D. i ka ndërprerë marrëdhëniet me Z.T. Z.T. ka qenë i zemëruar në R.D. Janë grindur. Nuk e ka ditur për çka. Al.H. asokohe ka qenë djalë i ri, njëzetekatërvjeçar, që sipas tij ka qenë shumë pak për rrugën⁴⁵⁶.

405. Al.H. është informuar për pajtimin midis N.K dhe R.D. Që nga ajo kohë, ai kurrë nuk ka dëgjuar për ndonjë incident midis këtyre të dyve. Ai madje e ka dëgjuar një bisedë telefonike midis R.D. dhe N.K. pasi është lënduar djali i të parit⁴⁵⁷.

⁴⁵⁰ 22.2.2016, f. 13.

⁴⁵¹ 22.2.2016, f. 14.

⁴⁵² 22.2.2016, f. 14.

⁴⁵³ 22.2.2016, f. 14.

⁴⁵⁴ 22.2.2016, f. 26.

⁴⁵⁵ 22.2.2016, f. 14.

⁴⁵⁶ 22.2.2016, f. 19. ⁴⁵⁷ 22.2.2016, f. 31.

406. **M.U.** ka dëshmuar se nga **R.D.** ka dëgjuar se ai ishte takuar me **N.K.** në një kafene në Hrashno dhe kanë diskutuar⁴⁵⁸. Ai ka dëgjuar se “**L.**”, një mik i **R.D.** nga Zagrebi, e kishte organizuar këtë takim midis **R.D.** dhe **N.K.** në një kafene; ka pasur negociata midis tyre. Kujtesa i është rifreskuar me deklaratën e dhënë më 30 korrik të vitit 2007. Nuk i është kujtuar se çfarë ka qenë rezultati i këtij takimi, kështu që kujtesa i është rifreskuar përsëri me deklaratën e mëparshme të tij: *“N.K. e ka dhënë fjalën se nuk do ta prekte R.D. dhe se nuk do të luftonte me të më, ndërsa R.D. po ashtu ia ka dhënë fjalën se nuk do ta prekte atë”*. Ai pastaj ka konfirmuar se ishte rëndë dakord që të ndalej konfrontimi midis tyre⁴⁵⁹. Ai ka potencuar se **R.D.** ka lidhur pajtim me **N.K.**, por se kurrë nuk ka lidhur pajtim me **M.A.G.**⁴⁶⁰

407. **N.O.** e ka ditur nga **N.K.** se janë takuar me **R.D.** në kafenenë “**Ak.**”, kanë pirë kafe së bashku dhe ia kanë shpjeguar çdo gjë njëri tjetrit dhe se nuk kanë pasur ndonjë konflikt. Kjo ka qenë para se **N.K.** të takohej me **N.O.** (2006)⁴⁶¹

408. Pajtimin midis **N.K.** dhe **R.D.** në lidhje me konfliktin në Stamboll e ka konfirmuar edhe **S.T.** gjatë marrjes në pyetje të tërthortë të saj. Ajo nuk e ka ditur se kur ka ndodhur, por “**L.**” ka qenë i përfshirë në këtë. Ka qenë një takim që ka ndodhur në Malin Jehorina, ku ata janë pajtuar. Ajo ka dëgjuar për këtë nga **F.R.**, **N.K.**, **L.K.** dhe **R.D.** Kjo ka qenë pas udhëtimit të saj për në Stamboll.

Sipas saj, N.K. nuk i ka besuar shumë kësaj⁴⁶².

⁴⁵⁸ 18.3.2016, f. 14.

⁴⁵⁹ 18.3.2016, f. 16. ⁴⁶⁰ 4.4.2016, f. 17.

⁴⁶¹ 22.7.2016, f. 27.

⁴⁶² 18.5.2015, f. 28 -29.

3.12²⁶². Vrasja e tentuar e A.P.

409. Prokurori është përpjekur ta lidhte N.K. edhe me vrasjen e tentuar të A.P. për të provuar kështu se ka pasur konflikt të dhunshëm të vazhdueshëm midis N.K dhe R.D.⁴⁶³.

410. Prokurori nuk ka paraqitur ndonjë provë të besueshme për ta mbështetur pretendimin e tij se N.K. ka qenë i lidhur me këtë ngjarje. Dëshmia e S.T. është thelbësisht e pambështetshme, meqë i është referuar asaj që e ka dëgjuar nga personat e tjerë dhe e ka lexuar në media. A.P. e ka bazuar bindjen e tij vetëm në gjërat që i ka besuar.

Përmbledhje e provave relevante

411. **A.P.** ka dëshmuar se 12 ditë para vrasjes së R.D. ka pasur një tentim për ta vrarë atë. Në të kanë shtënë L.By. dhe një njeri me emrin “Tj.”²⁶³. Sipas tij, L.By. dhe “Tj.” kanë qenë pjesë e grupit të M.A.G.²⁶⁴.

412. Gjatë marrjes në pyetje të tërthortë, A.P. është përballur me deklaratën e tij nga gjykimi kundër M.A.G., ku ai ka thënë: “R.D. më ka thënë (...) që të mos i

²⁶² 3.2015, f. 8.

²⁶³ 28.10.2015, f. 7-8.

²⁶⁴ 27.11.2015, f. 17.

tregoja asgjë askujt, dhe se “Zu.” ka qenë pas kësaj, se ai i ka ofruar 50.000 Euro për mua dhe 250.000 euro për të.” Kur është pyetur për këtë dëshmi të tij, ai ka shpjeguar se “Zu.” ka qenë M.A.G., por ai ka pretenduar se nuk i është kujtuar nëse kishte deklaruar ashtu. Ai ka potencuar se ka besuar se N.K. ka qenë prapa të gjithave²⁶⁵. A.P. ka qenë i bindur se N.K. ka qenë i përfshirë në tentimin për ta vrarë atë, ndërsa M.A.G. nuk do të kishte qenë në gjendje që të mendonte

²⁶⁵ 28.10.2015, f. 34.

të hynte në konflikt me askënd²⁶⁶. Sipas tij, N.K. ka qenë prapa perdeve. Shqiptarët po përpiqeshin ta vrisnin A.P., ndërsa N.K. po i bindte ata që ta bënin këtë. Ai e ka ditur se ata kanë qenë në luftë me N.K.²⁶⁷.

413. Sipas **S.T.**, ka qenë N.K. ai që e ka sjellë L.By., i cili ka shtënë në A.P.⁴⁶⁹. Kur është marrë në pyetje të tërthortë, ajo ka pranuar se dijenia e saj për përfshirjen e N.K. në këtë rast është bazuar në bisedën e saj me Oleg Cavka-n dhe në atë që e ka lexuar në media. Ka qenë fakt i dëshmuar se L.By. dhe N.K. kanë qenë miq⁴⁷⁰.

414. **A.S.** ka dëshmuar se ajo dhe R.D. e kanë vizituar A.P. në një spital. Pastaj R.D. i ka treguar se ka pasur informata se ishin paguar para për ta vrarë edhe atë. Ai kurrë nuk ka treguar se kush ka paguar për këtë⁴⁷¹. Gjatë marrjes në pyetje të tërthortë ajo po ashtu ka dëshmuar se A.P. dhe R.D. e kanë diskutuar këtë vrasje të tentuar. Në kontekst të saj, ajo e ka përmendur nofkën “*Svraka*” [v.p. laraska] – për L.By. Ajo kurrë nuk ka dëgjuar se ai ka qenë mik i vëllezërve G.⁴⁷².

3.13. Përgatitjet për vrasjen

Sipas aktakuzës:

Pasi kishte dalë vullnetar për të gjetur dhe kontraktuar vrasësit në Serbi, N.K. kishte udhëtuar personalisht për në Serbi për t’ia dorëzuar paratë një ndërmjetësi, i cili më

²⁶⁶ 28.10.2015, f. 9-10.

²⁶⁷ 10.11.2015, f. 24 – 25.

f.

f.

f.

f.

pas do t'ua dorëzonte ato vrasësve pasi të kryhej puna. Duke u kthyer nga Serbia, S.T. ka qenë personalisht e pranishme kur N.K. i kishte njoftuar pjesëtarët e tjerë të grupit të

⁴⁶⁹

19.3.2015, 8.

⁴⁷⁰

13.5.2015, 26.

⁴⁷¹

13.1.2016, 18-19; 18.1.2016, f. 31.

⁴⁷² 18.1.2016,

17.

organizuar kriminal se ai ia kishte dorëzuar paratë personit me pseudonimin 'Kërce' që ai të kontraktonte më pas me dy vrasës të mirënjohur serbë me pagesë, M.M. dhe S.R., për ta vrarë R.D.

Ndërkohë që N.K. thuhet se ka ofruar mbështetjen logjistike për ekipin goditës, pjesëtarët e tjerë të grupit të tij të organizuar kriminal morën përsipër të kryenin detyra të tjera përgatitore, si p.sh. të përcaktonin vendin e përshtatshëm për ekzekutimin e R.D. në Sarajevë. Kjo detyrë iu besua N.O. që organizoi ndjekjen e R.D. dhe se kush do të lajmërohej kur caku do të shkonte tek një banesë që ndodhej në Rrugën Odobasina në qendër të Sarajevës, ku ai jetonte përkohësisht. Në pritje të vrasjes, N.K. u larguar nga Bosnja, duke u munduar të krijonte një alibi për veten e tij duke kaluar kohën në bregdetin e Malit të Zi.

415.Gjykata ka gjetur se nuk është provuar se kanë ndodhur takimet për ta diskutuar planin e vrasjes së R.D. në përbërje të njerëzve siç i ka përshkruar S.T. Planin për të cilin gjoja kanë rënë dakord N.K. dhe "grupi" e ka paraqitur vetëm S.T. në dëshminë e saj. Sipas saj, ata kanë rënë dakord për personat që janë angazhuar për ta ekzekutuar vrasjen, për të tjerët që duhej ta lehtësonin kontaktin me ta, për

2015,

2015, f.

2015, f.

2015, f.

2015, f.

aranzhimet për qëndrimin e tyre në Sarajevë dhe për personat të cilëve u ishte caktuar për detyrë që ta përcillnin R.D.⁴⁷³. Megjithatë, nuk ka dëshmi për t'i mbështetur pretendimet e saj. Dëshmitari tjetër që ka dëshmuar për këto rrethana është Z.T., burri i saj, por ai vetëm ka përsëritur çfarë ka dëgjuar nga gruaja e tij dhe në shumë raste versionet e tyre kanë qenë në kundërshti me njëri tjetrin. S.T. nuk e ka konfirmuar versionin e tij për planet e pretenduara për vrasjen e R.D., të cilat do të diskutoheshin gjatë takimeve me familjen L.

⁴⁷³ 18.3. 22, 24, 25, 26, 29, 19.3.2015, f. 3 – 4, 7,13.5.2015, f. 29; 14.5.2015, f. 38.

416. **Z.T.** ka dëshmuar ndryshe, meqë ka thënë se vëllezërit L. i kanë thënë se N.K. ka kërkuar nga njëri avokat që ta pyeste S.T. nëse e kishte dikë për ta vrasur R.D. Ai i ka thënë se ata duhej ta gjenin dikë tjetër. Ai nuk ka treguar se ka folur personalisht me N.K.⁴⁷⁴, ndërsa sipas S.T., N.K. ia ka thënë këtë atij personalisht. Kur Z.T. është pyetur për këtë kundërthënie, ai ka thënë se ndoshta e ka shprehur këtë mendim duke u bazuar në atë që ai ia ka thënë asaj⁴⁷⁵. Nuk ka dashur të përgjigjet kur është pyetur se a i ka treguar gruas së tij për këto takime apo jo⁴⁷⁶.

417. **S.T.** po ashtu ka pretenduar se pas disa takimeve në të cilat është diskutuar plani i vrasjes së R.D., ajo i ka treguar Z.T. për këtë. Ai e ka këshilluar që ta linte atë punë⁴⁷⁷. Këtë e ka mohuar **Z.T.**, i cili e ka konfirmuar se ka folur me të për këto takime, por se ka pranuar se ka qenë e paevitueshme që ajo të merrte pjesë në to, sepse ajo ka qenë dora e djathtë e F.R. Krahas kësaj, kur ajo i ka treguar atij për këtë për herë të parë, atij nuk i është dukur e rëndësishme, sepse ai tashmë kishte ditur për planet për ta vrasur R.D. Sipas tij, ajo ka qenë tejet e befasuar dhe e

2015, f.

shqetësuar për këtë⁴⁷⁸.

3.14. Dëshmitë e K4 dhe K5

418. Prokurori i ka prezantuar dëshmitarët K5 dhe K4 për t'i mbështetur pretendimet e tij se S.R. e kishte angazhuar N.K. dhe “grupi” për ta vrarë R.D. Ata kanë qenë prindërit e S.R., një vrasësi, i cili ka vdekur më datën 23, kur e ka vendosur një eksploziv pas një veture. Vdekja e djalit të tyre i ka bërë K4 dhe K5 që të dëshmonin për veprat penale që pretendohet se i kishin kryer njerëzit që ata i

⁴⁷⁴

16.6. f. 30.

⁴⁷⁵

19.6. 9.

⁴⁷⁶

22.6. 13.

⁴⁷⁷

23.3. 22.

⁴⁷⁸

16.6. 36 - 37.

2015,
2015, f.
2015, f.
2015, f.
2015, f.

fajësonin për to. Përveç S.T., K4 dhe K5 kanë qenë dëshmitarët kryesorë të prokurorisë për akuzën për vrasje. Prandaj gjykata konstaton se është e nevojshme që të tregohen disa elemente nga deklaratat e tyre në të cilat kundërshtohet kredibiliteti i tyre.

419. Dëshmitë e tyre janë përplot kundërrënie e mospërputhje. Ata i kanë ndryshuar versionet e tyre, kanë shtuar elemente të reja dhe janë tërhequr nga gjërat që i kanë thënë më parë. Gjatë marrjes në pyetje të tyre ka qenë e dukshme se ata kanë qenë krenarë për djalin e tyre dhe se në një mënyrë kanë qenë të vendosur që ta bindnin gjykatën se ka qenë ai që e ka vrarë R.D.
420. Sipas **K5**, gruaja e tij, K4, nuk ka ditur për planin për ta vrarë R.D.⁴⁷⁹. Ajo kurrë nuk ka marrë pjesë në bisedat e tilla. Mund të ketë dëgjuar diçka gjersa ka shërbyer kafe⁴⁸⁰.
421. K5 ka qenë i sigurt se S.R. e ka vrarë R.D. Ai po ashtu ka konfirmuar se ka qenë ai që e ka mbushur armën⁴⁸¹.
422. K5 ka konfirmuar se S.R. është dënua për plaçkitje në Split dhe në “Cargo Centre”. Ai e ka kryer këtë me Da.E. dhe Z.T. Ka qenë mjaft e dukshme se K5 i është shmangur pranimit se Z.T. ka qenë kryerës i drejtpërdrejtë i kësaj veprë; megjithatë ky fakt ka treguar se ata e kanë njohur njëri tjetrin⁴⁸².
423. K5 ka qenë krenar kur ka pranuar se kanë qenë i përfshirë përherë në aktivitete kriminale⁴⁸³. Ai i ka përshkruar detajet e përfshirjes së vet në grupe kriminale. Ai

2015, f.

2015, f.

2015, f.

2015, f.

2015, f.

⁴⁷⁹	29.7.	17.
⁴⁸⁰	30.7.	21.
⁴⁸¹	30.9.	21.
⁴⁸²	30.7.	40.
⁴⁸³	30.7.	44.

asokohe është marrë me vrasje, zhvatje dhe plaçkitje²⁶⁸. Pjesëtarët e këtij grupi i kanë vizituar pas vdekjes së S.R. K4 e kanë quajtur “mumje”, ndërsa K5 “babush”. I kanë ditur të gjitha detajet e aktiviteteve të tyre⁴⁸⁵.

424. K5 ka pretenduar se e ka pasur një fotografi të S.R. dhe N.K së bashku dhe ka premtuar se do t’ia sjellë atë gjykatës. Më vonë, ai ka ndërruar mendje dhe ka thënë se nga shumë fotografi që i ka pasur, ajo ka qenë e vetmja që i ka humbur⁴⁸⁶. Kur është pyetur përsëri për këtë gjatë seancës së ardhshme, ai ka thënë se nuk e ka sjellë, ndërsa ka shpjeguar se do ta sillte kur EULEX-i do t’i finalizonte të gjitha. Më vonë, ai ka thënë e ka gjetur, por nuk ka qenë në gjendje të tregonte se pse nuk e kishte sjellë. Ka thënë se nuk guxonte ta bënte këtë⁴⁸⁷.
425. K5 po ashtu ka dëshmuar se e ka poseduar armën me të cilën është vrarë R.D.⁴⁸⁸.
426. K5 ka konfirmuar se kur ka shkuar për të dëshmuar për herë të parë në Beograd në gjykimin kundër të ashtuquajturit grupi i Shabacit, të cilin ai e ka fajësuar për vdekjen e S.R., ai nuk ka treguar për vrasjen e R.D., sepse mbrojtësit e M.Os.

²⁶⁸ 29.9.2015, f. 21-23.

⁴⁸⁵ 29.9. f. 8 - 9.

2015,
2015, f.
2015, f.
2015, f.
2015, f.

dhe të tjerët kanë qenë të pranishëm. Vetëm kur ai ka ardhur në Sarajevë dhe është takuar me prokurorin Dubravko Kampara, ai ka kuptuar për rastin Ll. **Ai ka folur me AShHM-në e pastaj ka konstatuar se N.K. është bërë “bashkëkryerësi i 33-të në këtë vrasje⁴⁸⁹”**. Në këtë mënyrë, ai ka konfirmuar se më parë nuk ka pasur kurrfarë njohurie për përfshirjen e pretenduar të N.K në këtë rast.

⁴⁸⁶

30.7. 44.

⁴⁸⁷

29.9. 4.

⁴⁸⁸

30.7. 45.

⁴⁸⁹

29.9. 15.

427. Kur ai ka dhënë dëshmi në Beograd, ai është pyetur për N.K. dhe R.D., por jo për L.B.C., “Pr.”n, Kërcën apo dikë tjetër²⁶⁹.

428. K5 ka pranuar se po të mos e kishin vrarë S.R., ky gjykim nuk do të kishte ekzistuar fare²⁷⁰. Ai i ka premtuar djalit të tij të ndjerë se ndaj këtyre njerëzve do të merrej hak⁴⁹². Sipas tij, ka qenë L.B.C. që është dashur të fajësohej për vdekjen e djalit të tij dhe N.K. duhej të distancohej nga ai⁴⁹³. Armiqtë kryesorë të tij kanë qenë: L.B.C., M.Os., N.V., “Sa.”, B.M. dhe I.M.K.. Sipas mendimit të tij, N.V., M.J.K. dhe tjerët do të dënohen⁴⁹⁴.

429. K5 ka qenë shumë krenar për djalin e tij. Sipas tij, mjaftonte që t’ia jepje fotografinë e ndonjë personi që duhej të vritej dhe ai do ta gjente⁴⁹⁵. Vrasjet që i

²⁶⁹ 29.9.2015, f. 42.

²⁷⁰ 29.7.2015, f. 15, 23, 33.

⁴⁹² 29.9.2015, f. 34.

2015, f.

2015, f.

2015, f.

2015, f.

2015, f.

ka kryer S.R. janë paguar nga njerëz të ndryshëm⁴⁹⁶.

430. K5 e ka konsideruar L.B.C. si armikun më të madh të tij. Ai ka thënë se është edhe një grua tjetër që do të paraqitet dhe mendon se “madje as Shën Pjetri nuk do ta shpëtojë L.B.C.”⁴⁹⁷. Duhet të theksohet se kur ai ka thënë kështu, gjykata ende nuk kishte vendosur ta thërriste I.B., meqë ajo as nuk ishte në listën e dëshmitarëve në aktakuzë, as nuk ishte propozuar që të dëgjohej deri në maj të vitit 2015. Kjo deklaratë tregon se dëshmitarët në këtë rast kanë qenë në kontakt me njëri tjetrin, ndonëse kanë pretenduar se nuk e kanë njohur njëri tjetrin.
431. K5 e ka parë L.B.C. për herë të fundit kur ka shkuar në burg për shkak të gruas së tij. Ai e ka ditur se kjo ndërlidhej me ngacmimin e gruas së tij dhe pengimin e

⁴⁹³ 29.9. 35.

⁴⁹⁴ 29.9. 36; 30.9.2015, f. 27.

⁴⁹⁵ 29.9. 25.

⁴⁹⁶ 29.9. 32.

⁴⁹⁷ 29.9. 36.

personit zyrtar. Këtë e ka marrë vesh nga I.B. Ai është takuar me të madje pasi ka dhënë dëshmi në Kosovë. Pas disa çastesh, ai ka shpjeguar se nuk ka folur me të, por vetëm e ka parë policinë kur ata e kanë konfiskuar veturën në Sulçin. Ka qenë i bindur se ajo do të vinte për të dëshmuar në Kosovë²⁷¹.

432. Ai po ashtu ka folur për dhënien e dëshmisë në Kosovë me njërin nga policët që e ka mbrojtur L.B.C. Në fund, ai ka thënë se nuk ka folur me askënd për deklaratën e tij në Kosovë, dhe ka shtuar se çfarë kishte thënë sot ishte qesharake⁴⁹⁹.

433. Ai i ka shikuar dëshmitë e N.K dhe Z.T. nga gjykimi i Z.T. I ka shikuar rastësisht. Ai ka pasur kujdes vetëm nga kërcënimi në dasmë²⁷².

434. Kur marrja në pyetje të tërthortë pothuajse ishte kryer, K5 i ka thënë mbrojtjes:

B.B.: Nuk kam pyetje të tjera.

K5: A e di ti se çka është hakmarrj?

B.B.: Çka është hakmarrja, sepse nuk e di?

K5: Më e mira do të ishte gjak për gjak.

B.B.: Gjak për gjak ndaj z. N.K.?

K5: Jo.

B.B.: Gjak për gjak ndaj L.B.C.?

²⁷¹ 29.9. 36 - 37. ⁴⁹⁹ 29.9.

38.

²⁷² 30.9. 50 - 51.

2015, f.

2015, f.

2015, f.

K5: Varet nga shkalla e përfshirjes së tij.

B.B.: Gjak për gjak ndaj M.J.K.?

K5: Jo.

B.B.: Gjak për gjak ndaj M.Os.?

K5: Po.

B.B.: Atëherë kjo është hakmarrja jote.

K5: Dhe janë dy persona nga Bosnja, por ata janë nga Republika Srpska, njëri është B.M., por ai është në Bosnjë dhe gjykimi do të fillojë.

B.B.: Dhe kjo është hakmarrja jote për vdekjen e djalit tuaj, a është kështu?

K5: Jo kjo gjykatë. Tregova se çfarë do të bëja²⁷³.

435. Deklarata e **K4** është bazuar kryesisht në çfarë ajo ka dëgjuar nga personat e tjerë. Krahas kësaj, ajo ka pasur shumë informata nga gjykime të ndryshme.
436. Ajo ka pretenduar se shtëpinë e ka vizituar shpesh M.Os., por edhe vëllai i tij, B.Os. “Bk.”, B.S., z. N.K. dhe nganjëherë B.J. Ata kanë folur për aktivitetet kriminale, ndërsa ajo i ka dëgjuar⁵⁰². Më vonë ka thënë se i ka vizituar edhe M.J.K.⁵⁰³ Ajo ka rënë në kundërshti me vetveten më vonë, sepse ka thënë se nuk e ka ditur nëse i ka vizituar N.K.⁵⁰⁴.

²⁷³ 30.9.2015, f. 54 - 55.

2015, f.

2015, f.

2015, f.

2015, f.

437. Dëshmitë e saj për N.K. kanë qenë shumë jo konsistente. Fillimisht ajo ka pretenduar se ajo ka dëgjuar për herë të parë për të pas ardhjes së S.R. nga Sarajeva⁵⁰⁵. Pastaj ajo ka dëshmuar se ajo e ka parë emrin e N.K vetëm një herë në media kur ai është arrestuar⁵⁰⁶. Pas vrasjes e ka dëgjuar këtë emër shumë herë.

⁵⁰² 30.6. 4.

⁵⁰³ 27.7. 31.

⁵⁰⁴ 30.6. 10.

⁵⁰⁵ 30.6. 7.

⁵⁰⁶ 30.6. 9.

Kurdo që ka pasur diskutime, këto diskutime kanë ndodhur shpesh pas vrasjes, përfshirë pas kryerjes së kësaj vepre penale. Emrin e tij e ka përmendur M.Os., ndërsa ata i kanë marrë disa informata për N.K. nga ai, meqë ai e ka ndjerë veten të lirë të fliste para tyre, se merrej me drogë, se ishte përplot para, se e kishte nga një pronë në Mal të Zi, Bosnjë dhe Kosovë, se kishte lidhje të forta në Bosnjë dhe se ishte i mbrojtur⁵⁰⁷.

438. Emrin e N.K e ka parë në gazetatat që i kanë lënë policët që i kanë mbrojtur. Ajo e ka parë vetëm një titull; nuk e ka lexuar artikullin⁵⁰⁸.

439. K4 po ashtu ka dëshmuar se ka mësuar për konfliktin midis N.K dhe R.D. nga M.Os. I biri i saj nuk e ka ditur këtë⁵⁰⁹. Kanë diskutuar jo vetëm një herë, por sa herë janë takuar. Kanë filluar të flisnin për këtë pas vrasjes. E pyetur se pse kanë

2015, f.

2015, f.

2015, f.

2015, f.

2015, f.

folur aq shpesh për këtë, ajo është përgjigjur duke thënë se sipas të gjitha gjasave sepse N.K. ka qenë trafikues i drogës, ndërsa R.D. ka qenë pengesë për të. Ajo e ka dëgjuar emrin e N.K shpesh nga M.Os.⁵¹⁰.

440. Gjatë marrjes në pyetje të tërthortë K4 është përballur me deklaratën e dhënë më 24 shtator të vitit 2014, f. 3. Në pyetjen “Çfarë ka thënë saktësisht M.Os.? Kush e ka urdhëruar vrasjen? Si ndodhi që M.Os. kishte të bënte diçka me këtë?”, ajo është përgjigjur: “Ai nuk e ka përmendur njeriun që e ka urdhëruar vrasjen fare dhe ndoshta unë nuk e kam dëgjuar gjersa kam qenë dukur përgatitur kafe. Nuk e di...” Ajo e ka konfirmuar se e ka thënë këtë dhe ka shpjeguar se kanë pritur që

⁵⁰⁷

30.6. 10.

⁵⁰⁸

27.7. 27.

⁵⁰⁹

29.6. 22.

⁵¹⁰

28.7. 9 - 10.

të fillonte procedura për ta treguar tërë historinë. Ka qenë K5 që e ka përmendur N.K.⁵¹¹.

441. Ajo pastaj është përballur me deklaratën e saj se S.R. i ka treguar se kush e ka urdhëruar vrasjen e R.D. Asaj i është bërë një pyetje sugjестive: “Meqë djali i juaj po flet për konfliktin midis N.K dhe R.D., a mos e ka përmendur djali juaj në ndonjë mënyrë se kush e ka urdhëruar vrasjen e R.D.?” , ndërsa ajo është përgjigjur: “Në atë moment, kur unë kam...ndoshta ai i ka treguar burrin tim dhe atyre dhe unë kam larguar...kur ata kanë ardhur... për të bërë kafe, pasi ata po 2015, f. 2015, f. 2015, f. 2015, f.

flisnin, kështu që nuk jam kthyer për të pyetur". Ajo e ka konfirmuar se e ka thënë këtë dhe ka shpjeguar përsëri se e ka lënë që detajet të tregoheshin më vonë⁵¹².

442. Duhet të theksohet se ndonëse i janë bërë pyetje sugjестive, K4 nuk e ka përmendur N.K. si njeri që qëndron prapa vrasjes së R.D.
443. Akuzat kundër N.K janë diskutuar gjerësisht nga miqtë e S.R. dhe K5. Pastaj ata kanë thënë se kanë qenë informata si çdo tjetër. Ka qenë emër si të gjithë të tjerët dhe nuk ka pasur kurrfarë domethënie për ta⁵¹³. Kanë diskutuar për të kur është arrestuar, por kanë dhënë deklaratë për këtë shumë kohë më parë. Kurrë nuk ka dhënë dëshmi në Serbi për N.K. Është pyetur nëse ka ditur për vrasjet e tjera që i ka kryer djali i saj, ndërsa ajo e ka përmendur atë të R.D.⁵¹⁴. Pastaj ajo nuk e ka përmendur N.K. Për herë të parë, ajo e ka përmendur emrin e tij para prokurorit të Bosnjës dhe Hercegovinës⁵¹⁵.

⁵¹¹
28.7. 21 – 22; 34.

⁵¹²
28.7. 39.

⁵¹³
27.7. 28.

⁵¹⁴
27.7. 29.

⁵¹⁵
27.7. 34, 41.

444. Kur ajo ka dhënë dëshmi në Serbi, ajo ka thënë se nuk mund ta thoshte tërë të vërtetën, sepse ishin disa njerëz që ende ishin në liri. Ajo nuk ka qenë mjaft e gatshme që ta tregonte tërë të vërtetën, sepse nuk ka qenë e qartë madje as me vetveten nëse do të ishte në gjendje të fliste për këto gjëra, ndërsa kishte frikë për familjen e saj²⁷⁴.
445. Ajo nuk e ka ia përmendur emrin e N.K prokurorit serb, ndërsa ka treguar për gjithçka vetëm në Kosovë, sepse nuk i kanë besuar prokurorisë dhe gjykatave serbe. Ajo është përballur me dëshminë e saj që e ka dhënë para prokurorit serb kur është përgjigjur se, përveç M.Os., M.J.K. M.J.K., M.M. dhe N.V., askush tjetër nuk ka qenë i përfshirë në vrasjen e R.D. Ajo ka pretenduar se është përgjigjur në këtë mënyrë sepse nuk janë ndjerë të sigurt⁵¹⁷. Duhet të theksohet se gjatë dhënies së asaj dëshmie ajo nuk ka heshtur, por ka thënë qartë “jo, nuk ka pasur njerëz të tjerë⁵¹⁸”.
446. Ajo ka pretenduar se ka pasur frikë nga grupi i M.Os., por ka vendosur të dëshmonte kundër tyre. Ajo ka pasur më shumë frikë nga N.K., sepse ka qenë e ditur se ata kanë qenë njerëz më hakmarrës për shkak kombësisë shqiptare. Asaj kurrë nuk i është drejtuar N.K.⁵¹⁹. Ajo ka pasur më shumë frikë nga N.K., sepse M.Os. para se të arrestohej i ka thënë se ata nuk i harrojnë gjërat, posaçërisht tradhtinë. E ka pasur fjalën për N.K. dhe grupin e tij⁵²⁰.
447. Ajo nuk ka qenë në gjendje të shpjegonte se si kishte ndodhur që më në fund e

²⁷⁴ 28.7. f. 16 – 17.
2015,
2015, f.
2015, f.
2015, f.
2015, f.

kishte përmendur emrin e N.K në lidhje me vrasjen e R.D. Ka thënë se thjesht ka

⁵¹⁷

27.7. 34.

⁵¹⁸

27.7. 35.

⁵¹⁹

30.6. 20.

⁵²⁰

30.6. 21.

ndërruar mendje për shumë arsye, në mesin e të cilave ka qenë përfshirja e M.Os. në vdekjen e djalit të saj²⁷⁵.

448. Ajo i ka fajësuar M.Os. dhe I.M.K.n për vdekjen e djalit të saj²⁷⁶. E ka fajësuar edhe B.Os. dhe M.M. Nuk do të befasohej po të kishte qenë i përfshirë edhe L.B.C. Nuk ka ditur për N.K.⁵²³. Nuk e ka përjashtuar mundësinë që edhe N.K. të ketë qenë i përfshirë në vdekjen e djalit të saj⁵²⁴.

449. S.R. është fshehur deri në vitin 2008 për shkak të tentimvrasjes së D.Z.⁵²⁵. Ka qenë në arrati një vit e gjysmë. Tentimvrasja është kryer në vitin 2006, e pastaj nga viti 2008 deri në nëntor ka qenë i arrestuar⁵²⁶.

450. Sa i përket deklaratës së mbrojtjes se nuk ka qenë djali i saj ai që e ka vrarë R.D., ajo ka deklaruar se sigurisht se ka qenë ai, por njohuria e saj është bazuar vetëm në atë që ajo e ka dëgjuar. Me këtë rast, ajo ka folur për vrasjet e tjera për të cilat ka qenë e sigurt se i ka kryer djali i saj⁵²⁷.

²⁷⁵ 28.7.2015, f.17.

²⁷⁶ 30.6.2015, 14.

f.

2015, f.

2015, f.

2015, f.

2015, f.

2015, f.

2015, f.

451. Informatat më relevante për N.K. ajo i ka marrë nga M.Os. Ajo ka thënë ka qenë një mik që ka ardhur tek ta pas arrestimit të N.K dhe se me të kanë folur. Ajo nuk ka dashur ta japë emrin e tij apo të saj. I tërë qyteti e ka ditur se S.R. e ka kryer këtë vrasje, posaçërisht nga M.Os., i cili është mburrur për këtë⁵²⁸. Asaj i është kujtuar se i ka vizituar dikush që ka folur me ta për gjykimin në Bosnjë,

⁵²³ 31.

27.7.

⁵²⁴ 18.

28.7.

⁵²⁵ 13.

27.7.

⁵²⁶ 27.7. 21.

⁵²⁷ 30.

27.7.

⁵²⁸ 42.

27.7.

por nuk e ka ditur për çka ka qenë. Nuk ka dashur ta jepte emrin. Pas disa çastesh ajo ka pranuar se ka pasur të bëjë me gjykimin kundër Z.T.²⁷⁷.

452. Gjatë tërë dëshmisë që e ka dhënë para gjykatës, ajo nuk e ka përmendur konfliktin midis L.B.C. dhe R.D., për të cilin ajo ka folur gjatë dëshmisë që e ka dhënë më 24 shtator të vitit 2014. Ajo e ka shpjeguar këtë duke thënë se ndoshta thjesht i është shlyer nga kujtesa. Ajo nuk ka ditur shumë për këtë, vetëm se kanë pasur probleme qysh para shumë kohësh²⁷⁸. Ajo ka dëgjuar për këtë konflikt nga

²⁷⁷ 27.7.2015, f. 33.

²⁷⁸ 28.7.2015, f. 25.

2015,

2015,

2015,

2015, f.

2015, f.

S.R., i cili ka marrë vesh për këtë nga M.Os.²⁷⁹. Gjatë dëshmisë së saj në shtator të vitit 2014, ajo ka thënë se R.D. dhe L.B.C. kanë dashur ta vrisnin njëri tjetrin²⁸⁰.

453. Ka thënë se vrasja e R.D. nuk ka qenë me rëndësi, sepse ata nuk e kanë ditur se kush ka qenë ai⁵³³. Pas vdekjes së djalit të saj, ajo ka qenë e shqetësuar tej mase se të tjerët do të dënoheshin dhe e tërë vërteta do të dilte në shesh⁵³⁴.
454. Sipas saj, dëshmia nga shtatori i vitit 2014 ka qenë vetëm një përmbledhje e shkurtër, përkundër faktit se i ka pasur më shumë se 30 faqe⁵³⁵. Nuk e ka ditur se a ka pasur frikë atëherë. Nuk ka qenë e sigurt nëse e ka ditur se N.K. ishte arrestuar. Më herët ajo ka pranuar se e ka parë në media se ishte arrestuar⁵³⁶. Nuk e ka përdorur emrin e N.K në të. Është kufizuar vetëm me N.V. dhe M.Os.⁵³⁷.

⁵³³ 28.7. f. 30.

⁵³⁴ 28.7. f. 31.

⁵³⁵ 28.7. f.37.

⁵³⁶ 28.7. 410.

⁵³⁷ 28.7. 42.

²⁷⁹ 28.7.2015, f.36.

²⁸⁰ 28.7.2015, f.37.
f. 2015,
f.
2015, f.
2015, f.
2015, f.
2015, f.

455. K4 ka pranuar se ka vendosur të raportonte se si ka ditur për tërë grupin pasi është vrarë S.R. Pastaj K5 ka vendosur të tregonte gjithçka²⁸¹. Ajo i ka raportuar detajet e vrasjes së R.D. në vitin 2010⁵³⁹. K5 ka besuar se S.R. ka bërë shumë për grupin, shumë favore, ndërsa në fund ata ia kanë vrarë djalit. K5 dhe K4 nuk kanë bërë asgjë për ta⁵⁴⁰.
456. **K5** e ka bërë të ditur përfshirjen e djalit të saj në vrasjen e R.D. më vonë, pas vdekjes së djalit të saj. Ai ka qenë shumë i paqartë në përgjigjen e tij, ndërsa ka filluar të flasë për plaçkitjen në Split dhe dëshminë që e ka dhënë në Kroaci⁵⁴¹. Ai ka vendosur ta raportojë, sepse ka dashur që të gjithë ata të arrestoheshin. Askush nuk ka mundur të paguante për vdekjen e djalit të saj⁵⁴².
457. Gjatë marrjes në pyetje të tërthortë, K4 shpjeguar se ata të dy, së bashku me K5, kanë vendosur që të shkonin dhe të jepnin dëshmi pas vdekjes së S.R.⁵⁴³. Kanë diskutuar për këtë. K5 ka qenë më në dijeni për gjithçka. Ajo është ndalur për ta mbrojtur atë dhe familjen e tyre. Ajo nuk ka dashur, ndërsa K5 e ka dhënë dëshminë i pari. Ajo ka qenë ajo që ka vendosur ta shpaloste emrin e N.K⁵⁴⁴.
458. **K5** ka pretenduar se ai ka vendosur vet që të dëshmonte dhe nuk ka folur me gruan e tij për këtë, sepse ka qenë ai që ka vendosur. Më vonë ai i ka treguar për këtë gruas së tij, por vetëm kur policia ka ardhur për t'ia marrë pasaportën dhe për ta marrë për të dëshmuar në Kroaci. Ajo ka qenë paksa e frikësuar nga kjo

²⁸¹ 29.6.2015, f. 17, 27.7.2015, f. 22.

⁵³⁹ 29.6.2015, 18.

2015,
2015,
2015,
2015, f.
2015, f.

situatē⁵⁴⁵.

⁵⁴⁰	28.
28.7.	
⁵⁴¹	4.
30.7.	
⁵⁴²	6.
30.7.	
⁵⁴³	39.
27.7.	
⁵⁴⁴	18-19.
28.7.	
⁵⁴⁵	9.
30.7.	

f. 2015,
f.
2015, f.
2015, f.
2015, f.
2015, f.
2015, f.

Përfundim

459. Nga dëshmitë e K4 dhe K5 rezulton se ata kanë qenë të njoftuar për përfshirjen e pretenduar të N.K në vrasjen e R.D. vetëm kur kanë filluar të jepnin dëshmi në Bosnjë dhe Hercegovinë. Shumë detaje jua ka treguar zyrtari i AShHM-së. Kur kanë dhënë dëshmi në Beograd në gjykimin kundër të ashtuquajturit grupi i Shabacit, ata veçse kishin folur për vrasjen e R.D. dhe për njerëzit që pretendohesh se e kishin kryer atë, por nuk e kanë përmendur N.K. në këtë kontekst.
460. Gjykata konstaton se shpjegimi i K4 se ka pasur frikë për ta përmendur N.K. në Beograd është i paarsyeshëm. Në atë moment, ajo nuk ka pasur kurrfarë njohurish për aktivitetet e pretenduara të N.K; ajo madje ka thënë se ai ka qenë krejtësisht jo relevant për të. Në anën tjetër, ajo ka vendosur dëshmojë kundër njerëzve që ajo i ka fajësuar për vdekjen e djalit të saj, kështu sipas saj duhet të ketë qenë definitivisht më e rrezikshme.

Negociatat me vrasësit

461. Sipas K5, M.Os. dhe L.B.C. i janë drejtuar S.R. për ta propozuar atë për vrasjen e R.D. Negociatat kanë qenë të shkurtra. Pak më vonë, K5 ka thënë se ka ardhur vetëm M.Os. Ai ka potencuar se ka qenë i pranishëm gjatë të gjitha negociatave²⁸².
462. Duke marrë parasysh të gjitha kundërthëniet në dëshminë e K5, të cilat do të prezantohen në hollësi më poshtë, si dhe faktin se ajo nuk mbështetet me prova të tjera, gjykata e ka vlerësuar version e tij për ngjarjet si të pambështetshëm dhe

²⁸² 29.7. f.5.
2015,

krimi i organizuar konstatuar se, si i tillë, ai nuk mund të jetë bazë për t'i vërtetuar faktet në këtë rast.

Përmbledhje e provave relevante

463. Gjatë marrjes në pyetje të tërthortë, K5 është përballur me deklaratën që ai e ka dhënë më 29 gusht të vitit 2012 kur ai ka thënë se disa ditë para vrasjes së R.D., M.Os. dhe M.J.K. (e jo L.B.C.) i kanë dhënë ofertë djalit të tij për ta kryer këtë vrasje. Ai nuk e ka mbështetur këtë, duke thënë se ka ardhur vetëm M.Os. Gjatë pyetjeve të mëtejme ai ka thënë se ka qenë e vërtetë se M.Os. dhe M.J.K. kanë ardhur, por jo për të, por vetëm për peshkim²⁸³.
464. K5 ka dëshmuar se gjatë takimit të parë janë përmendur vetëm arsytet patriotike për ta vrarë R.D.⁵⁴⁸. Po ashtu ka pasur konflikt midis N.K dhe R.D., sepse ai ka qenë pengesë për ta⁵⁴⁹. Megjithatë, ai më vonë ka thënë se gjatë këtij takimi, kur S.R. i është ofruar që ta vriste R.D., ai nuk ka ditur asgjë për përfshirjen e N.K. dhe M.A.G.; emrat e tyre janë përmendur vetëm pasi është kryer vrasja⁵⁵⁰. Në këtë mënyrë, K5 ka rënë në kundërshti me vetveten, meqë më herët ka thënë se këta dy emra janë përmendur menjëherë gjatë takimit të parë⁵⁵¹. Ai ka mësuar për këtë nga M.J.K., N.V., M.M., B.Os., por në të vërtetë nuk e ka ditur nga cili saktësisht⁵⁵². Gjatë takimit të parë është diskutuar për paratë⁵⁵³.

²⁸³ 30.9.2015, 48.

f.
2015, f.
2015, f.
2015, f.
2015, f.
2015, f.
2015, f.

⁵⁴⁸ 30.7. 12.

⁵⁴⁹ 29.7. 4, f. 12.

⁵⁵⁰ 30.7. 14.

⁵⁵¹ 30.7. 14, f.15.

⁵⁵² 30.7. 15.

⁵⁵³ 30.7. 14.

465. Sipas K5, M.Os. ka thënë se kanë qenë M.A.G. dhe N.K. ata që kanë dashur ta vrisnin R.D. Ka pasur edhe të tjerë që kanë qenë të përfshirë, por K5 ka qenë i sigurt vetëm për këta të dy⁵⁵⁴.

466. K5 ka dëshmuar se e ka pranuar ofertën që i është dhënë djalit të tij për ta vrarë R.D., sepse ai ka qenë patriot i madh dhe për të ka qenë akt patriotizmi që të vritej një person që me gjasë kishte shkaktuar luftë në Bosnjë⁵⁵⁵. Gjatë marrjes në pyetje të tërthortë, K5 është tërhequr nga kjo deklaratë dhe ka thënë se ka qenë absolutisht jo relevante se a e ka aprovuar vrasjen e R.D. apo jo, por ka potencuar përsëri se [vrasja] ishte bërë si akt i patriotizmit. Pas disa çasteve, ai ka thënë se nuk ka aprovuar asgjë dhe se për fat të keq kjo ka marrë fund⁵⁵⁶. Ai nuk e ka aprovuar vrasjen⁵⁵⁷.

467. Sipas K5, R.D. ka qenë sundues i Bosnjës dhe Hercegovinës e Sarajevë, ndërsa N.K. dhe grupi i tij nuk kanë qenë në gjendje që të bënin çfarë të donin. Në këtë grup ka pasur shumë shqiptarë⁵⁵⁸. Gjithçka ka filluar me N.K. dhe M.A.G. Ai nuk ka qenë i sigurt se a ka qenë ai, apo njëri nga vëllezërit e tij. Vetëm pas vrasjes djali i tij i ka treguar së në grup kanë qenë L.B.C., që ai e ka quajtur

2015,
2015,
2015,
2015,
2015,
2015,

“Sur.”, M.Os., M.J.K., N.V., M.M. dhe S.R. Djali i tij po ashtu i ka treguar se nuk ka qenë për arsye patriotike dhe se N.K. dhe M.A.G. nuk kanë qenë pas kësaj vrasjeje⁵⁵⁹.

468. K5 ka dëshmuar po ashtu se F.R. ka qenë anëtar i grupit, por jo ai që e ka planifikuar vrasjen e R.D. Ai ka qenë anëtar i një grupi të tërë; ai ka qenë babai i

554

29.7. f. 8.

555

29.7. f. 15.

556

29.9. f. 9-10.

557

29.9. f. 16.

558

29.7. f. 10.

559

29.7. f. 13.

f.
2015, f.
2015, f.
2015, f.
2015, f.
2015, f.
2015, f.

tyre, i tërë klanit boshnjak që ka punuar për shtetin. Kur është pyetur se si e ka ditur këtë, ai ka thënë se ai ka ditur shumë gjëra⁵⁶⁰.

469. Sipas K5, ata kanë dashur ta vrisnin R.D., sepse ai ka qenë shumë i fuqishëm për ta në kuptimin fizik, i mirë në gjuajtje dhe nuk ka qenë i përfshirë me policinë. Natyrisht ka qenë pronar i kazinove dhe është marrë me drogë. Ia kanë pasur frikën⁵⁶¹. K5 e ka përmendur edhe F.R., por nuk e ka ditur se çfarë ka qenë roli i tij saktësisht. Nuk ka dashur të shpjegonte menjëherë pse e ka përdorur këtë emër. Ka dashur ta linte për fund. Sipas K5, ai ka qenë edhe anëtar i grupit⁵⁶².

470. Gjatë marrjes në pyetje të tërthortë, K5 ka ndërruar mendje përsëri dhe ka thënë se nuk ka qenë i pranishëm kur L.B.C. ka kërkuar nga M.Os. që të gjente vrasës, por ka qenë i pranishëm kur M.Os. ka ardhur për ta pyetur S.R. në emër të tij. Kjo

ka ndodhur relativisht shpejt, para se S.R. të shkonte në Sarajevë, për një javë. Të nesërmen M.Os. ka sjellë [armë të markës] Heckler & Koch⁵⁶³.

471. K5 ka prezantuar version tjetër të ngjarjeve gjatë marrjes në pyetje të tërthortë të mëtejme. Ai ka thënë se atëherë S.R. i ka thënë se është takuar me L.B.C. dhe N.K. në Budvë kur N.K. ka kërkuar nga L.B.C. që t'i gjente vrasësit e R.D. Nuk i është kujtuar se sa para vrasjes ka ndodhur kjo⁵⁶⁴. Kur është pyetur pse nuk e ka përmendur takimin në Budvë më parë, ai ka thënë se askush se ka pyetur për të. Megjithatë, M.Os. ka qenë ndërmjetës, sepse ka pasur nevojë për pjesëmarrës të tjerë, siç ishin N.V. dhe M.M.⁵⁶⁵. Kur është pyetur përsëri për rolin e djalit të tij

2015, f.

2015, f.

2015, f.

2015, f.

2015, f.

2015, f.

⁵⁶⁰	29.7.	18-19.
⁵⁶¹	29.7.	8.
⁵⁶²	29.7.	9.
⁵⁶³	29.9.	43.
⁵⁶⁴	30.9.	36-37.
⁵⁶⁵	30.9.	37.

gjatë takimit në Budvë, K5 është përgjigjur dy herë [duke thënë]: “Pyeteni N.K.²⁸⁴”.

472. Kur është marrë në pyetje të tërthortë, K5 nuk ka qenë konsekuent as sa i përket pozitës së djalit të tij. Ai ka pretenduar se S.R. ka qenë shumë i ri për të folur me njerëz 20 vjet më të moshuar se ai²⁸⁵. Në anën tjetër, ai ka potencuar djalit të tij nuk i është dashur askush për t’i ndihmuar, sepse atij nuk i është bërë vonë për para dhe ka mundur të bënte çfarë të donte²⁸⁶.
473. Ishte e dukshme për gjykatën se K5 po e ndryshonte vazhdimisht versionin e tij të ngjarjeve. Ai nuk ka qenë i sigurt se kush kishte ardhur për t’i dhënë ofertë S.R. për vrasjen e R.D. Ai ka ndërruar mendje sa i përket momentit kur ka mësuar se kush kanë qenë njerëzit që e kanë urdhëruar vrasjen. K5 po ashtu ka rënë në kundërshti me versionin e S.T., duke e përfshirë në këtë M.A.G., i cili sipas saj nuk ka pasur të bëjë asgjë me vrasjen e R.D.

²⁸⁴ 30.9.2015, f. 38-39.

²⁸⁵ 30.9.2015, f. 37.

²⁸⁶ 30.9.2015, f. 38.

f.

f.

474. K5 e ka përmendur përfshirjen e N.K për herë të parë vetëm në Sarajevë; nuk e ka përmendur kur ka dhënë dëshmi në Beograd²⁸⁷²⁸⁸. Gjatë marrjes në pyetje të tërthortë, e ka mohuar se e ka përmendur vetëm M.J.K., kur ka dhënë dëshmi në Beograd, si njeriun që e ka urdhëruar vrasjen e R.D. Ai ka pranuar se është e mundur të mos e ketë përmendur madje as M.Os. M.Os dhe të tjerët, meqë gjithçka ishte bërë në praninë e avokatëve të tyre⁵⁷⁰. Ai ka pranuar se nuk e ka përmendur F.R., kur ka dhënë dëshmi në Bosnjë. Ai e ka përmendur atë në Serbi, por nuk e ka ditur kur dhe jo si kryerës në këtë rast. Nuk ka dashur të japë arsye²⁸⁹.

3.15. Dëshmitë e M.J.K. M.J.K., M.Os. dhe B.Os.

475. Sipas prokurorit, M.J.K. dhe M.Os. kanë qenë të përfshirë thellë në vrasjen e R.D. Ai ka pretenduar se B.Os. ka qenë i pranishëm gjatë takimeve tek shtëpia e K5 dhe K4, ku është diskutuar dhe paguar vrasja e R.D.

476. As është përmendur më lart, gjykata i ka vlerësuar dëshmitë e K4 dhe K5 si të pavërteta dhe të pambështetshme edhe nga këndvështrimi i deklaratave të M.J.K. M.J.K., M.Os. dhe B.Os., të cilat do të prezantohen shkurtimisht më poshtë. Gjykata ka konsideruar se deklaratat e M.J.K. M.J.K., M.Os. dhe B.Os. janë të besueshme. Këta dëshmitarë i kanë prezantuar në detaje marrëdhëniet e tyre me K4 dhe K5 dhe i kanë shtjelluar pretendimet e tyre. Prokurori nuk ka paraqitur prova bindëse dhe të besueshme për të provuar se ata kanë qenë të përfshirë në

²⁸⁷ 30.7.2015, f. 37.

²⁸⁸ ,09,2015, f. 27.

²⁸⁹30.9.2015, 13.

⁵⁷² 15.3.2017, 11.

ngjarjet që ndërlidhen me vdekjen e R.D. Është e vërtetë se emrat e tyre janë përmendur nga dëshmitarët S.T., I.B., K5 dhe K4; megjithatë vërtetësia e deklaratave të tyre është kundërshtuar në mënyrë efektive.

Përmbledhje e provave

477. **M.J.K.** nuk është marrë në pyetje gjatë hetimit, as nga prokurori boshnjak, as nga ai i EULEX-it. Ai ka dhënë dëshmi vetëm kur është thirrur nga gjykata.
478. M.J.K. ka deklaruar se nuk ka pasur të bënte asgjë me vrasjen e R.D.⁵⁷².
479. Ai ka mohuar ta ketë njohur F.R., M.A.G., N.O., S.S. dhe N.V.⁵⁷³. Nuk i ka njohur B.H., E.Ah.⁵⁷⁴. E ka parë S.R. dy herë në jetën e tij. Kurrë nuk është

shoqëruar me të⁵⁷⁵. Nuk e ka njohur S.T.; e ka ditur se ajo ka qenë boshnjake nga Sarajeva nga mediat. Nuk e ka njohur Z.T.⁵⁷⁶. Nuk e ka dalluar N.K. Kurrë nuk është takuar me të. Ka dëgjuar për të nga mediat⁵⁷⁷.

480. E ka njohur M.Os. me nofkën ““Bl.” [M.Os.]” apo “Zu.”⁵⁷⁸. Gjatë marrjes në pyetje të tërthortë, ai ka qartësuar se M.Os. dhe vëllain e tij i ka takuar në dasmën në Nish⁵⁷⁹.

481. **M.Os.** ka konfirmuar se e ka njohur M.J.K. Kërcën për një kohë të gjatë; kanë qenë nga i njëjti qytet⁵⁸⁰. Gjatë marrjes në pyetje të tërthortë, ai ka qartësuar se e ka njohur M.J.K. Kërcën nga viti 2003 apo 2004⁵⁸¹. E ka konfirmuar se kanë qenë në të njëjtën dasmë në Nish⁵⁸².

482. M.J.K. e ka njohur L.B.C.; ai është takuar me të në vitin 2009 – 2010 në Shabac në një restorant. Është takuar me të 3 - 5 herë; L.B.C. ka qenë në shoqërim të policëve, të cilët e kanë mbrojtur. M.J.K. e ka parë gruan e tij një herë⁵⁸³.

483. Nuk ka pasur biznes me L.B.C. dhe M.Os.⁵⁸⁴. Nuk ka udhëtuar me M.Os. Për herë të fundit në Sarajevë ka qenë në vitin 2004 – 2005⁵⁸⁵.

⁵⁷³ 15.3.2017, f. 4 – 5. ⁵⁷⁴

15.3.2017, f. 6.

⁵⁷⁵ 15.3.2017, f. 5 – 6.

⁵⁷⁶ 15.3.2017, f. 14-15.

⁵⁷⁷ 15.3.2017, f. 10.

⁵⁷⁸ 15.3.2017, f. 6, 7.

⁵⁷⁹ 15.3.2017, f. 16.

f.

f.

⁵⁸⁰ 26.9.2016, f. 11.

⁵⁸¹ 10.10.2016, f. 22.

⁵⁸² 10.10.2016, f. 19.

⁵⁸³ 15.3.2017, f. 7-8, 12.

⁵⁸⁴ 15.3.2017, 8. ⁵⁸⁵ 15.3.2017, 9.

484. ²⁹⁰²⁹¹K5 e ka njohur nga qyteti, por nuk ka pasur kontakte me të. Sipas tij, K5 jeton si pirat – pa ujë dhe pa rrymë. I tërë qyteti e di këtë. Nuk e ka njohur K4, “Zoti na ruajt⁵⁸⁶”.

485. Kur M.J.K. ka lexuar në media se është përfshirë në aktakuzë në lidhje me vrasjen e R.D., ai ka kërkuar nga avokati i tij që të kontaktonte me prokurorin Dubravko Kampara për të dhënë deklaratë. Seanca është caktuar, por është anuluar nga prokurori kur ai dhe avokati e tij kanë qenë rrugës për në Sarajevë. Kurrë nuk është thirrur më⁵⁸⁷.

486. **M.Os.** i ka mohuar tëgjitha pretendimet e K4 dhe K5²⁹².

487. Ai ka dëshmuar se prokurorët nga Bosnja i janë drejtuar dy herë. Herën e parë, ai ka dëshmuar dhe ka thënë se nuk ka pasur të bënte asgjë me vrasjen e R.D. Gjatë kontaktit të dytë, prokurori Kampara i ka ofruar atij ndihmë në rastet kundër tij në Serbi për të dëshmuar kundër N.K dhe – siç e ka përshkruar ai – “IshMinistrit për Siguri në Bosnjë”. Sipas të gjitha gjasave, ai është marrë në pyetje

në prill të vitit 2013, ndërsa ndihmë i është ofruar për 6 muaj më vonë²⁹³.

488. Është dënuar me 10 vite burgim për nxitje të vrasjes, por kur ka dëshmuar para

²⁹⁰ .3.2017, f. 11 – 12.

²⁹¹ .3.2017, f. 10 – 11.

²⁹² 10.10.2016, f. 24 – 31.

²⁹³ 26.9.2016, f. 7 – 8.

f.

f.

gjykatës në Kosovë, aktgjykimi ka qenë ende i formës së prerë²⁹⁴.

489. M.Os. ka mohuar ta ketë njohur N.K. Mund të ketë dëgjuar për ta nga mediat, por, sipas të gjitha gjasave, ai është vënë në dijeni për të gjatë intervistave të tij me prokurorët boshnjakë²⁹⁵.
490. E ka konfirmuar se e ka njohur S.R. dhe prindërit e tij, por vetëm sipërfaqësisht. E ka konfirmuar se ka qenë disa herë në shtëpinë e tyre²⁹⁶. Nuk ka kaluar shumë kohë me S.R.²⁹⁷.
491. Për herë të parë me S.R. është takuar në fund të vitit 2006 në një diskotekë apo bar tek lumi Sava. Në mars apo prillit të vitit 2007, S.R. është plagosur në Shabac. I ka pasur disa probleme, kështu që ka kontaktuar me M.Os. Me këtë rast, S.R. ka kërkuar nga M.Os. që t'i ndihmonte për vizë dhe leje të qëndrimit. I është drejtuar M.Os., sepse ai ka udhëtuar shumë²⁹⁸. Në atë rast, M.Os. e ka vizituar në një spital²⁹⁹. Më vonë, janë takuar edhe në dasmën në Nish³⁰⁰.
492. Gjatë marrjes së tërthortë në pyetje, M.Os. shpjegoi se me gjasë arsyeja pse S.R. i kishte kërkuar atij që t'i ndihmonte me dokumentet ishte fakti se ai e dinte se M.Os. ishte në Angli dhe në Emirate.³⁰¹

²⁹⁴ 26.9.2016, 8.

²⁹⁵ 26.9.2016, 8.

²⁹⁶ 26.9.2016, f. 8-9.

²⁹⁷ 26.9.2016, f. 14.

²⁹⁸ 26.9.2016, f. 15 - 16

²⁹⁹ 26.9.2016, f. 16

³⁰⁰ 26.9.2016, f. 16

³⁰¹ 10.10.2016, f. 10

493. Më 1 maj 2008, M.Os. e vizitoi S.R. në shtëpi.³⁰² Në atë rast, S.R. ishte hidhëruar me të për shkak se ai nuk kishte arritur t'i rregullonte dokumentet për të. Ai e akuzonte M.Os. se po luante me të.³⁰³

494. Ai erdhi edhe një herë në shtëpinë e S.R. pas thirrjes së tij. Në atë kohë, S.R. ishte në paraburgim. Prindërit e tij i thanë M.Os. se S.R. dëshironte që M.Os. ta vizitonte atë në burg. Ai erdhi atje, dhe S.R. edhe një herë foli për dokumentet.

³⁰² 26.09.2016, f. 16

³⁰³ 26.09.2016, f. 18

f.

f.

Ishte në muajin prill ose maj të vitit 2008.³⁰⁴ Pas kësaj situatë, ai edhe një herë ishte në shtëpinë e S.R.³⁰⁵

495. M.Os. pohoi se ai i shmangte takimet me S.R. Në anën tjetër, ai shpjegoi se nuk ishte e mundur veç të refuzohej “një njeri i tillë”, sepse ai tashmë njihej në qytet si një person i përfshirë në aktivitete kriminale.³⁰⁶ Ata kryesisht biseduan për dokumentet.³⁰⁷ Ai nuk donte t’i ndihmonte atij me dokumentet, por ai nuk guxonte ta refuzonte atë haptas.³⁰⁸ Vetëm më vonë M.Os. e mësoi nga mediat se S.R. ishte vrasës profesionist.³⁰⁹³¹⁰

496. Ai për herë të fundit S.R. e pa në Shabac në fund të vitit 2008 kur ai ishte liruar nga paraburgimi. Ata u takuan në një apartament ku më parë jetonte motra e S.R.
606

497. Kur u pyet për sqarim, nëse kontakti i tij i mëparshëm me S.R. ishte në vitin 2007 kur ai ishte në spital, dhe mandej kontakti i më pastajmë me familjen e tij ishte vetëm gjatë pagëzimit, M.Os. e mohoi atë. Ai shpjegoi se ishte takuar me S.R. në qytet në disa raste, në një kafe bar ku S.R. vinte pasi kishte dëgjuar se atje ishte

³⁰⁴ 26.09.2016, f. 18-19

³⁰⁵ 26.09.2016, f. 19

³⁰⁶ 26.09.2016, f. 16-17

³⁰⁷ 26.09.2016, f. 17

³⁰⁸ 10.10.2016, f. 12

³⁰⁹ 26.09.2016, f. 17

³¹⁰ 26.09.2016, f. 19

M.Os. Sipas tij, kjo ishte deri në 5 herë. Ata flisnin vetëm për dokumentet; M.Os. e përsëriste se ai po përpiquej, por që kjo nuk ishte e lehtë.³¹¹

Kjo ishte tema e vetme e bisedave të tyre.³¹²

498. U bë e dukshme se M.Os. po përpiquej t'i fshihte para gjykatës kontaktet e tij me S.R., dhe vetëm pasi iu bë presion me pyetje, ai e konfirmoi se gjithsesi kishte pasur më shumë takime se sa që pohonte në fillim të marrjes së tij në pyetje.

Megjithatë, ky konstatim nuk është i mjaftueshëm për t'i vërtetuar versionet e K4 dhe K5.

499. M.Os. dëshmoi se emri i vëllait të tij nuk ishte “Bg.”, siç kishin deklaruar K4 dhe K5, por B.Os. dhe se ai e kishte pseudonimin “Bz.”, “Bk.”.³¹³ Ai asnjëherë nuk kishte shkuar me vëllanë e tij në shtëpinë e S.R. Ai besonte se vëllai i tij nuk kishte qenë asnjëherë atje.³¹⁴

500. Ai mësoi nga mediat për vdekjen e R.D. Kur ndodhi ajo, ai mund ta kishte komentuar këtë në çfarë mënyre, por ai nuk foli për këtë vrasje me askë, përfshirë S.R. dhe prindërit e tij.³¹⁵

501. M.Os. asnjëherë nuk diskutonte me S.R. për aktivitetet e tij, nuk dinte asnjë detaj.³¹⁶ Ai e konfirmoi se e kishte parë S.R. ndoshta dy herë me M.M. Më vonë, u takuan me M.M. në burgun qendror pas arrestimit të tyre.³¹⁷ Ai asnjëherë nuk i kishte shitur veturë S.R., e as që e kishte blerë nga ai. Ai nuk ia kishte dhënë

³¹¹ 10.10.2016, f. 14

³¹² 10.10.2016, f. 15

³¹³ 26.09.2016, f. 12

³¹⁴ 26.09.2016, f. 19-20

³¹⁵ 26.09.2016, f. 14

³¹⁶ 26.09.2016, f. 17

³¹⁷ 26.09.2016, f. 18

veturën atij. Ai nuk kishte marrë një veturë të blinduar.³¹⁸

502. M.Os. mohoi çdo përfshirje në aktivitete kriminale me S.R. Ai shpjegoi se kishte kaluar gjashtë vjet e tre muaj në paraburgim bazuar mbi akuza të rreme të K4 dhe K5. Ata e akuzuan atë se ishte organizator i bashkimit kriminal dhe se ai kishte urdhëruar pesë vrasje të kryera nga biri i tyre dhe ata vetë. Ata e akuzuan atë edhe se ai merrej me drogë, organizonte grabitje dhe disa vepra të tjera të cilat nuk ishin aq të rënda. E bënë këtë që ta shantazhonin për shkak se e fajësonin atë për vdekjen e birit të tyre. Arsyeja për këtë është se ai nuk i kishte aranzhuar dokumentet për S.R. me të cilat ai do të mund të largohej nga vendi.³¹⁹
503. K4 dhe K5 e fajësonin atë për vdekjen e S.R. Në vitin 2009, ata prej tij fillimisht kishin kërkuar 200.000 euro, e më vonë 100.000 euro. Ata e kërcënuan atë se nëse ai nuk do të paguante, ata do të fabrikonin shumë gjëra kundër tij. Ata asnjëherë nuk ia përmendën atij vrasjen e R.D.³²⁰ Vetëm gjatë shqyrtimit gjyqësor, ata thanë se ai e kontaktoi S.R. me dikë që e kishte urdhëruar vrasjen e R.D.³²¹ Mbështetur mbi këto informata, asnjë hetim nuk ishte iniciuar kundër tij dhe vëllait të tij.³²²
504. M.Os. pretendonte se në periudhën 2006 – 2007 ai ishte vetëm një herë në Bosnje dhe Hercegovinë, në fshatin Etno afër Bjelinës.³²³

³¹⁸ 26.09.2016, f. 22

³¹⁹ 26.09.2016, f. 21

³²⁰ 26.09.2016, f. 20

³²¹ 26.09.2016, f. 21-22

³²² 26.09.2016, f. 22

³²³ 10.10.2016, f.24

505. Vëllai i M.Os. ishte përmendur në shumë raste nga K4 dhe K5, dhe ata e quanin atë “Bg.”. Mirëpo, emri i tij i plotë është **B.Os.**³²⁴ Fakti se ata nuk ia dinin emrin e vërtetë një personi të cilin, siç pretendohet, ata e njihnin shumë mirë dhe e vizitonin në shumë raste në shtëpinë e tyre, përveç tjerash e minon kredibilitetin e dëshmimeve të tyre.
506. B.Os. konfirmoi se ai e njohte M.J.K. nga Shabaci, por e mohoi se ata kanë pasur ndonjë marrëdhënie më të ngushtë. Në të njëjtën mënyrë ai e njohte S.R. Ai asnjëherë nuk e vizitoi atë. Ai nuk kishte asnjë marrëdhënie me L.B.C. Një herë ai e pa I.B. në një restorant në Shabac.³²⁵ Ai nuk e njohte N.V. Ai mësoi për M.M. gjatë shqyrtimit gjyqësor të vëllait të tij.³²⁶
507. Ai e njohte familjen e S.R., një herë ata ishin ftuar për celebrim të pagëzimit; ishte më 1 maj, ata ishin aty pari. Kjo familje donte nga M.Os. që t’i ndihmonte S.R. që të merrte vizën për Emiratet e Bashkuara. Ishte i vetmi rast kur ai e kishte parë familjen e tyre.³²⁷ Ai e pa S.R. ndoshta edhe dy herë, një herë në Shabac, herën e dytë në Nish.³²⁸ M.Os. nuk kishte Audi.³²⁹
508. Ai i takoi K4, K5 dhe dhëndrin e tyre. Ata po e shantazhonin M.Os. për 100.000 euro, përndryshe ata i thanë atij se do ta akuzonin atë në mënyrë të rreme.³³⁰ Familja e S.R. akuzohej se shantazhonte, duke kërkuar para nga njerëz të ndryshëm që të mos dëshmonin rrejshëm kundër tyre.³³¹

³²⁴15.03.2017, f. 20; 26.09.2016, f. 10 – 12

³²⁵ 15.03.2017, f. 18-19

³²⁶ 15.03.2017, f. 20

³²⁷ 15.03.2017, f. 19

³²⁸ 15.03.2017, f. 19-20

³²⁹ 15.03.2017, f. 22

³³⁰ 15.03.2017, f. 21

³³¹ 15.03.2017, f. 22

509. Ai nuk dëshmoi në Serbi dhe në Bosnje. Ai kishte dëgjuar për vrasjen e R.D. nga media. Ai e dinte se emri i R.D. ishte përmendur në kontekstin e luftës në Bosnje dhe kur ai ishte vrarë.³³²
510. B.Os. dhe M.Os. nuk kishin të bënin asgjë me vrasjen e R.D. Ata nuk kanë marrë kurrfarë parash për këtë. Ai asnjëherë nuk e kishte vizituar shtëpinë e S.R.⁶²⁹ Ai asnjëherë nuk e kishte vizituar I.B.⁶³⁰ Ai nuk i njihte S.T., Z.T., dhe N.K.⁶³¹
511. Sipas B.Os., njerëzit dëshmonin kundër tyre për të zhvatur para. I.B. e bëri këtë për ta dëmtuar burrin e saj.⁶³²

3.16. Shuma që duhej të paguhej për vrasjen

Sipas Aktakuzës:

Gjatë këtyre takimeve, N.K. dhe pjesëtarët e tjerë të këtij grupi të organizuar kriminal u pajtuan se vrasës të kontraktuar do të duhej të angazhoheshin nga Serbia për këtë vrasje dhe se duhej të paguhej shuma prej 200,000 KM (valutë e Bosnjës, e barabartë me përafërsisht 100,000 Euro).⁶³³

512. Gjykata konstatoi se nuk ka prova të besueshme se ishte arritur pajtimi ndërmjet N.K dhe personave të tjerë për të paguar një shumë të caktuar parash për vrasjen e R.D. Siç është cekur më lart, nuk është vërtetuar se N.K. dhe njerëz të tjerë të përmendur nga S.T. janë takuar në përbërje të tillë për të diskutuar këtë çështje. Dëshmitarët vendimtarë që kanë dëshmuar për këtë ngjarje janë S.T. dhe Z.T., dy persona që ishin thellësisht të interesuar për rrjedhën e rastit. Njohuria e Z.T.

³³² 15.03.2017, f. 20

mbështetet mbi atë çfarë ai kishte dëgjuar nga gruaja e tij. Dëshmia e saj nuk mbështetet me prova të tjera. Për më tepër, ajo dukshëm e ka ndryshuar dëshminë e saj krahasuar me ato që ajo ka i kishte dhënë në vitin 2011. Ky fakt e ka minuar në mënyrë plotësisht kredibilitetin e kësaj dëshmitare.

513. Dëshmia e dëshmitarit K1 sa i përket kësaj rrethane është konstatuar të jetë e pambështetur dhe fabrikim i pastër. Versioni i tij nuk mbështetet me prova të

⁶²⁹ 15.03.2017, f. 21

⁶³⁰ 15.03.2017, f. 23

⁶³¹ 15.03.2017, f. 22

⁶³² 15.03.2017, f. 23

⁶³³ S.T., 23.05.2013, f.3 [Regjistratori 3, f.378].

tjera dhe është në kundërshtim madje edhe me deklaratën e S.T. në lidhje me elementet vendimtare. Para së gjithash, ai tregoi se M.A.G. ishte i përfshirë gjersa S.T. ishte konsekuente se ai nuk kishte marrë pjesë në të. Së dyti, ai nuk e përmendi Ek.L. si dikë që e kishte sjellë pjesën e tij të parave, ndërsa sipas S.T. edhe ai duhej të paguante për këtë. Së treti, S.T. asnjëherë nuk e përmendi K1 si të pranishëm të paktën aty pari gjersa grupi diskutonte për këtë çështje.

Përmbledhje e provave relevante

514. Sipas S.T., N.K. ka thënë se vrasësit i donin 100.000 euro. Ai e informoi grupin për këtë gjatë takimit në restorantin rrotullues. Të gjithë ata ishin të pranishëm, por ajo nuk është e sigurt nëse S.S. ishte me ta në atë rast. ³³³

515. Gjatë marrjes së tërthortë në pyetje ajo u ballafaqua me dëshminë e saj të dhënë më 18 mars 2011, kur ajo kishte thënë se vrasësit kishin kërkuar 200.000 KM. Kur u pyet për këtë mospërputhje S.T. shpjegoi se ajo gjatë gjithë kohës po fliste

³³³ 18.03.2015, f. 28

për euro, ndërsa policia dhe prokuroria po flisnin për KM. Për ta mbështetur qëndrimin e saj, ajo nënvizoi se markat konvertibile nuk mund të përdoren në Serbi, kështu që ajo e mori me mend se kjo është arsyeja se pse ata filluan të flisnin për euro.

516. Shuma e parave që duhet të paguheshin për vrasjen u konfirmua nga **Z.T.** i cili kishte dëgjuar për këtë nga gruaja e tij. Ai tha se rreth 200.000, por ai nuk ishte i sigurt nëse ishin euro ose KM. Kur kjo çështje po diskutohej në restorantin rrotullues, të pranishëm ishin N.K., F.R., vëllezërit L. dhe N.O., por Z.T. nuk e dinte nëse ky i fundit ishte i përfshirë në këtë.³³⁴ Ai kishte dëgjuar për këtë takim po të njëjtën ditë, ishte rreth 10 ditë para vrasjes.³³⁵
517. Dëshmitari tjetër që dëshmoi lidhur me shumën e parave, e u pajtua që të paguhej për vrasjen e R.D. ishte **K1**. Sipas tij, ai dhe R.K. ishin të pranishëm në Radon Plaza, në restorantin rrotullues. Në këtë rast, K1 kishte dëgjuar një bisedë kur u dakorduan se shuma prej 200.000 euro për vrasjen do të paguhej gjysmë/gjysmë nga F.R. dhe N.K. Personat në vijim ishin të pranishëm gjatë këtij takimi: N.K., F.R., M.A.G., S.T. dhe ai nuk dinte se kush tjetër.³³⁶ Ata ishin të ulur në tavolinën afër tyre; mbase ishte një metër ndërmjet tyre. Kjo bisedë ishte 2 – 3 muaj para vdekjes.³³⁷ Ishte pasdite.³³⁸ N.K. tha se për vrasjen ishin

³³⁴ 17.06.2015, f. 16

³³⁵ 17.06.2015, f. 16

³³⁶ 09.11.2016, f. 31

³³⁷ 09.11.2016, f. 31

³³⁸ 09.11.2016, f. 33

dakorduar me L.B.C, K1 nuk i kujtohej se kush i kishte treguar për shumën që duhej të paguhej.³³⁹ Atij nuk i kujtohej se çfarë kishin thënë F.R. dhe M.A.G. Ishte e vështirë të dëgjohej sepse ata po flisnin në mënyrë të qetë.³⁴⁰

3.17. Mbledhja e parave

Sipas Aktakuzës:

Rreth një muaj përpara vrasjes, S.T. mori pjesë në një takim në një restorant rrotullues në Hotel 'Radon Plaza' ku N.K. dhe anëtarët e tjerë të "grupit" ishin të pranishëm. N.K. kishte sjellë një valixhe të vogël të zezë që e kishte vendosur mbi tavolinë pas shpinës së tij dhe kishte thënë se ai dhe N.O. kishin sjellë paratë për vrasjen e R.D. dhe se të tjerët tani duhej të ofronin pjesën e tyre të pagesës. Ek.L. pas kësaj kishte hequr nga shpatulla e tij një çantë të vogël të zezë "Samsonite" dhe ja kishte dhënë atë N.K. që kishte nxjerrë prej saj një shumë të madhe parash dhe i kishte futur ato në valixhen e tij. F.R. i kishte nxjerrë paratë nga një çantë e gjelbër PVC dhe ja kishte dhënë ato N.K. që i kishte futur edhe këto para brenda valixhes së tij.

518. Kjo është një ngjarje tjetër e cila është përshkruar ekskluzivisht nga **S.T.**³⁴¹ Nuk ka prova të besueshme për t'i mbështetur pretendimet e S.T. Përveç tjerash, versioni i saj se paratë për vrasjen ishin marrë në një vend publik, që ishte në dispozicion për njerëz të tjerë, përfshirë mysafirët e hotelit, është krejtësisht i paarsyeshëm. Duhet të nënvizohet se në disa raste ajo pretendonte se F.R. ishte "një person paranoik", i cili kishte frikë nga çdo gjë, se po përgjohej. Andaj, nuk ishte e mundur të besohej se ai do ta kryente një operacion të tillë në këtë mënyrë,

³³⁹ 09.11.2016, f. 33

³⁴⁰ 09.11.2016, f. 34

³⁴¹ 18.03.2015, f. 18, 26 -29, 13.05.2015, f. 31

në vend se ta mbante atë sekret dhe të fshehur; sidomos kur ai ka mundur ta bënte këtë në zyrën e tij ose apartamentin privat që ai e kishte në dispozicion.

3.18. Marrja e parave për vrasësit Sipas

Aktakuzës:

Pasi kishte dalë vullnetar për t'i identifikuar dhe angazhuar vrasësit në Serbi, N.K. kishte udhëtuar personalisht për në Serbi për t'ia dorëzuar paratë një ndërmjetësi, i cili më pas do t'ua dorëzonte ato vrasësve pasi të kryhej puna. Duke u kthyer nga Serbia, S.T. ka qenë personalisht e pranishme kur N.K. i kishte njoftuar pjesëtarët e tjerë të grupit të organizuar kriminal se ai ia kishte dorëzuar paratë personit me pseudonimin 'M.J.K.' që ai të angazhonte më pas dy vrasës të mirë-njohur serbë me pagesë, M.M. dhe S.R. për të vrarë R.D.

519. Dëshmitarja e vetme për ta mbështetur këtë pretendim të prokurorit ishte **S.T.**³⁴²

Është interesante se, **Z.T.** deklaronte se ai nuk kishte njohuri se si paratë u ishin dhënë vrasësve por sipas tij, M.L. duhet ta dijë këtë. Ai e dinte vetëm se paratë i ishin dhënë N.K. Ai nuk donte të spekulonte për të tjerët, ai e dinte për këta të dy sepse ata po përpiqeshin ta vrisnin R.D. duke i përdorur kurdët.³⁴³

520. Nuk ka prova bindëse se pagesa për vrasjen e R.D. ishte kryer siç është përshkruar nga S.T. dhe njerëzit e përmendur nga ajo. Asnjëri prej dëshmitarëve të cilët kanë dëshmuar për këtë nuk kanë pasur dijeni të drejtpërdrejtë; ata vetë u

³⁴² 18.03.2015, f. 26; 14.05.2015, f. 41

³⁴³ 17.06.2015, f. 16

referoheshin disa thashethemeve ose bindjeve të tyre personale.

3.19. Para vrasjes– S.R.

521. Sipas **K5 dhe K4**, S.R. ishte plagosur në një pritë në Shabac rreth 09 -10 prillit 2007, dhe kishte qëndruar në spital për 15 – 17 ditë ku ai iu nënshtrua një ndërhyrje kirurgjike.³⁴⁴ Pastaj ai u kthye në shtëpi, ai ishte rraskapitur, merrte infuzione. Ai kishte disa plagë në bark. Ai e kaloi rreth një muaj në shtëpi.³⁴⁵
522. Gjatë marrjes së tërthortë në pyetje, **K4** dëshmoi se pasi që S.R. doli nga spitali dhe para vrasjes, ai kishte udhëtuar për në Bosnjë 3 – 4 herë. Ai e dinte se vrasja e R.D. ishte kryer në qershor.³⁴⁶
523. **K4** dëshmoi se me gjithë plagët S.R. kishte shëndet të plotë kur ai kishte shkuar në Sarajevë për ta kryer vrasjen e R.D.³⁴⁷ Ai kishte udhëtuar atje vetëm, dhe pastaj në Bosnjë, M.Os. i kishte siguruar atij çdo gjë. Tashmë atje ishte N.V. i cili jetonte atje.³⁴⁸ An.Ku. kishte aranzhuar një banesë për të, si zakonisht.³⁴⁹
524. **K5** përshkroi se S.R. dhe N.V. e kishin transportuar armën me një varkë përtej Drinës. M.M. e përdori një veturë, sepse ai nuk kishte dosje penale dhe ai mund ta kalonte kufirin legalisht. N.V. kishte kryer shumë punë përpara me S.V.; ai ishte njeriu i tij i besuar.³⁵⁰ M.M. po i priste ata me veturë në anën tjetër.³⁵¹ M.M. ishte në Sarajevë si partner i S.R., ai ishte përgjegjës për logjistikë.³⁵²

³⁴⁴29.07.2015, f. 40

³⁴⁵ 27.07.2015, f. 13-19

³⁴⁶ 27.07.2015, f. 25

³⁴⁷ 28.07.2015, f. 15

³⁴⁸ 29.06.2015, f. 23

³⁴⁹ 29.06.2015, f. 7

³⁵⁰ 29.07.2015, f. 17

³⁵¹ 29.07.2015, f. 20

³⁵² 29.07.2015, f. 3

525. **M.M.** e konfirmoi se ai e njihte S.R. por ai e mohoi çdo përfshirje në vrasjen e R.D. Në qershor 2007 ai ishte në Serbi. Në atë periudhë ai ishte i përfshirë në gjykim para gjykatës speciale në Serbi.³⁵³ Ai dëshmo se ai asnjëherë nuk kishte udhëtuar me S.R. për në Sarajevë sepse ai nuk i kishte dokumentet e tij personale.³⁵⁴

Përfundim

526. Gjykata e gjeti si të vërtetuar se S.R. në prill të vitit 2007 ishte plagosur rëndë në një pritë dhe për shkak të kësaj ai qëndroi në spital. Ky fakt rezulton jo vetëm nga deklarata e K4 dhe K5 por po ashtu mbështetet me prova dokumentare nga spitali në Shabac ku S.R. qëndroi disa ditë. Gjykata e vlerësoi po ashtu si të besueshme dëshminë e K4 i cili e përshkroi gjendjen e dobët të S.R. pas këtij lëndimi.

527. Po ashtu u vërtetua se M.M. dhe S.R. e njihnin njëri-tjetrin dhe ndodhte që ata t'i kryenin disa aktivitete kriminale së bashku.

528. Nuk ka prova për të vërtetuar versionin e K5 se si S.R. udhëtoi për në Sarajevë në maj/qershor të vitit 2007. Kjo nuk është e mbështetur me prova të tjera; M.M. e mohoi përfshirjen e tij në këtë rast. Përveç tjerash, K4 dhe K5 paraqiti versione kundërthënëse sa i përket asaj se kush ishte i përfshirë në organizimin e këtij udhëtimit, çka edhe më tej e minon kredibilitetin e tyre.

529. Po ashtu ka dyshime nëse S.R. fare kishte shkuar në Sarajevë, çfarë do të paraqitet më poshtë.

³⁵³ 18.05.2016, f. 30

³⁵⁴ 18.05.2016, f. 32; 19.05.2016, f. 19, 23

3.20. Vrasësit në Sarajevë

Sipas Aktakuzës,

Përveç S.R. dhe M.M., ishte kontraktuar edhe një person i tretë për këtë vrasje. Ky person ishte N.V., me pseudonimin 'N.V.', një person i lidhur ngushtë me familjen S.R. (...)

Personat e angazhuar nga N.K.dhe pjesëtarët e tjerë të grupit të organizuar kriminal arritën në Sarajevë pak kohë përpara vrasjes. N.K.u kishte gjetur paraprakisht vendet se ku do të banonin përmes ndërmjetësit B.H., duke marrë me qira një banesë në Rrugën A.A.G. Secirbegovic për ekipin e vrasësve.

530. Prokurori nuk paraqiti prova bindëse për të vërtetuar nëse S.R. fare kishte ardhur në Sarajevë për të kryer vrasjen e R.D. Dëshmitarët e përmendur më lart, përveç S.T. dhe Z.T., paraqitën versione të ndryshme të ngjarjeve, duke qenë në kundërthënie jo vetëm me njëri-tjetrin, por edhe brenda për brenda. Shembulli i mirë është K5 i cili dëshmoi një herë se S.R. u mirëprit në Sarajevë nga N.K. dhe në rastin tjetër ai përmendi vetëm M.A.G., i cili sipas S.T. nuk ishte i përfshirë fare. Ai gjithashtu paraqiste kornizë të ndryshme kohore sa i përket ardhjes së tij. Njëherë, K5 po thoshte se ishte disa ditë më parë, ndërsa në rastin tjetër ai tha se ishte vetëm një ditë para vrasjes.

531. Në anën tjetër, edhe S.T. nuk ishte konsekuente në versionin e saj sidomos sa i përket momentit kur ajo gjeti emrat e vrasësve. Nëse ajo do të ishte e pranishme kur u diskutua për këta emra, ajo nuk do të ishte e frikësuar ose e brengosur për sigurinë e saj për shkak të ardhjes së supozuar të M.M. dhe S.R. në Sarajevë. Edhe një herë, kjo e minon kredibilitetin e saj.

532. Gjykata konstatoi se dëshmia e K1 sa i përket njohurisë së tij lidhur me vrasjen e R.D. ishte fabrikuar nga ai për të forcuar vlerën e saj provuese dhe relevancën e vet personale. Kjo pjesë e deklaratës së tij që i referohet njohjes së tij me S.R. është një argument tjetër për të mbështetur një vlerësim të tillë kritik. Ai e përshkruante atë si një burrë të moshës 35 – 36 vjeçare në vitin 2007, ndërsa S.R. ishte i moshës vetëm 22 vjeçare. Mospërputhja në vlerësimin e moshës së një personi nuk mund të justifikohet në mënyrë të arsyeshme posaçërisht se më vonë K1 kishte thënë se në vitin 2002 – 2003 kur e kishte parë S.R. për herë të parë ai ishte shumë i ri. Ky perceptim i S.R. del edhe nga deklaratat e K4 dhe K5 që e përshkruanin djalin e tyre si vrasës me fytyrë fëmije.

Përmbledhje e provave relevante

533. **S.T.** dëshmoi se para vrasjes ajo i kishte parë dy herë M.M. dhe S.R. Së pari, ajo e kishte parë M.M. 25 - 20 ditë para vrasjes kur ajo ishte në shëtitje me burrin e saj, afër shtëpisë së R.D. Ai ishte mbi një skuter, duke e pastruar helmetën e tij. Kur ata ishin kthyer në shtëpi, ajo kishte kërkuar për fotografinë e tij në internet, dhe pastaj ajo ishte e sigurt se ishte ai.³⁵⁵

534. **Z.T.** konfirmoi se ata e kishin parë M.M. në rrethana të tilla. Ai nuk e njihte atë personalisht por ai e kishte njohur atë menjëherë, a po e ngiste një motoçikletë me ngjyrë të kaltër që ishte në pronësi të Da.E., dhe ai ishte anëtarë i grupit të tij.

³⁵⁵ 19.03.2015, f. 9

Ai e njohu fytyrën e tij nga gazetatat. Ai e njohu këtë motoçikletë dhe kjo është arsyeja se pse ai e njohu atë, ai po ashtu i pa fotografitë e M.M.³⁵⁶ Vetëm gjatë marrjes të tërthortë në pyetje Z.T. e pranoi se ai e njohte atë personalisht.³⁵⁷

535. **S.T.** dëshmoi se ajo e kishte parë S.R. në Radon Plaza para ashensorit. Ishte brenda një muaji para vrasjes së R.D.³⁵⁸ Për herë të dytë, ajo i kishte parë M.M. dhe S.R. në restorantin Magarac, përballë ndërtesës ku ata ishin akomoduar.³⁵⁹ **Z.T.** pretendon se ai ishte me të.³⁶⁰

536. Në momentin kur ajo i kishte parë ata, **S.T.** nuk ishte në dijeni se ata ishin të angazhuar për ta vrarë R.D. Ajo i kishte thënë F.R. se e kishte parë M.M. sepse ajo ishte e shqetësuar se ai kishte ardhur për të për shkak se ajo kishte shkruar artikuj që kishin të bënin me të. F.R. i kishte thënë se ky njeri nuk kishte ardhur këtu për të, dhe kishte shtuar se ata ishin personat të cilët kishin ardhur për shkak të R.D.³⁶¹ Ajo nuk i kishte treguar atij se ajo e kishte parë edhe S.R. Kur ajo e kishte parë atë, tashmë ishte e qartë se ata do të jenë vrasësit.³⁶²

537. Gjatë rrjedhës së marrjes së tërthortë në pyetje, ajo dëshmoi se ajo ishte e pranishme kur u vendos që S.R. dhe M.M. duhej të angazhoheshin për ta vrarë R.D.³⁶³ Ajo nuk ishte në gjendje t'i përgjigjej pyetjes se sa kohë para vrasjes ajo i dinte emrat e vrasësve.³⁶⁴

³⁵⁶ 17.06.2015, f. 10 - 11

³⁵⁷ 22.06.2015, f. 20

³⁵⁸ 19.03.2015, f. 9 - 10

³⁵⁹ 19.03.2015, f. 10

³⁶⁰ 17.06.2015, f. 10; 23.06.2015, f. 56

³⁶¹ 19.03.2015, f. 11, 13.05.2015, f. 36 - 37

³⁶² 19.03.2015, f. 11

³⁶³ 19.03.2015, f. 10

³⁶⁴ 13.05.2015, f.39

538. **Z.T.** dëshmoi se ai i kishte mësuar emrat e vrasësve vetëm pas vdekjes së R.D. Ai e kishte marrë këtë informatë nga Shabaci, U.A., i cili i kishte thënë se njerëzit nga Shabaci e kishin kryer këtë vrasje. Sipas tij, ishin S.R. dhe Da.E.³⁶⁵ Gjatë marrjes së tërthortë në pyetje ai pranoi se Da.E. po dëshmonte kundër tij në gjykimin e tij.³⁶⁶ Gjatë marrjes së tij të tërthortë në pyetje, ai e pranoi se ka pasur pretendime në media se ishte njeriu i tij, M.L., ai i cili e vrau R.D. Sipas tij, kjo e tëra ishte fabrikuar nga F.R.³⁶⁷
539. **K5** e mohoi se S.R. kishte qenë ndonjëherë në Avaz ose ndonjë në ndërtesë tjetër të ndonjë gazete, madje edhe në Serbi.³⁶⁸ Sipas tij, gjatë marrjes së tërthortë në pyetje, ai kishte ardhur në Sarajevë për ta vlarë R.D. vetëm 2 ditë para vrasjes.³⁶⁹ Gjatë këtyre ditëve, ata i kishin ndërruar tre apartamente.³⁷⁰ Më vonë, K5 nuk e përjashtonte që S.R. erdhi në Sarajevë madje në ditën e vrasjes.⁶⁷² Ai nuk e dinte se kush po i priste ata në Sarajevë, por që nuk ishte shofer i taksisë. Ai nuk e takoi askë tjetër atje.³⁷¹
540. K5 u ballafaqua me dëshminë e tij të mëhershme të dhënë në Beograd, ku ai po ashtu kishte thënë se M.A.G. po i priste ata. Ai e konfirmoi se ishte kësisoj; megjithatë, ai mendonte se mbrojtja do ta pyeste atë për L.B.C. dhe M.Os.³⁷² Me

³⁶⁵ 17.06.2016, f. 9

³⁶⁶ 22.06.2015, f. 21

³⁶⁷ 22.06.2015, f. 29

³⁶⁸ 30.06.2015, f. 35

³⁶⁹ 30.09.2015, f. 29 - 30

³⁷⁰ 30.09.2015, f. 31

⁶⁷² 30.09.2015, f. 32

³⁷¹ 30.09.2015, f. 33

³⁷² 30.09.2015, f. 33

gjasë të tjerët, të cilët paguan për vrasjen, po e prisnin atë.³⁷³ Ai ishte i sigurt se M.A.G. po i priste.³⁷⁴

541. K5 po ashtu u ballafaqua me deklaratën e tij të dhënë më 24 shtator 2014, kur ai u dëgjua nga prokurori i EULEX-it, K5 tha se S.R. u mirëprit nga N.K. pasi ai kishte arritur në Sarajevë për ta vrarë R.D. K5 tha se atij nuk i kujtohej ta kishte thënë këtë.³⁷⁵ Atij i kujtohej se ai kishte thënë se ai e kishte një fotografi të N.K dhe S.R. e kishte marrë në të njëjtën ditë kur S.R. erdhi në Sarajevë. Ai pretendoi se kishte shumë fotografi të N.K dhe S.R.³⁷⁶

542. Po ashtu **K1** dëshmoi se ai e kishte parë S.R. dy herë në Sarajevë. Megjithatë, ai e lidhi këtë me periudhën kur Z.T. po përpiquej ta vraste R.D. që ishte në fund të vitit 2006 – fillimi i vitit 2007 kur S.R. po jetonte në apartamentin e An.Ku. Kur u pyet lidhur me përshkrimin e S.R., K1 tha se ai ishte i gjatë, i bukur dhe i moshës rreth 35 – 36 vjeçare.³⁷⁷ Gjatë marrjes në pyetje të nesërmen, K1 pretendonte se e njohte S.R. nga Serbia që nga viti 2002 – 2003 dhe në atë periudhë ai ishte shumë i ri.³⁷⁸

543. **M.M.** dëshmoi se ai asnjëherë nuk kishte udhëtuar me S.R. për në Sarajevë sepse ai nuk i kishte dokumentet e tij personale.³⁷⁹

544. Kur M.M. po dëshmonte në këtë gjykim ai ishte në burg, ishte privuar nga liria që nga 14 tetori 2009, i shpallur fajtor për vjedhje me thyerje. Ai dëshmoi se ai nuk

³⁷³30.09.2015, f. 34

³⁷⁴ 30.09.2015, f. 34

³⁷⁵ 30.09.2015, f. 35

³⁷⁶ 30.09.2015, f. 35

³⁷⁷ 09.11.2016, f. 45-46

³⁷⁸ 10.11.2016, f. 45-46

³⁷⁹ 18.05.2016, f. 32

e njihte N.K. Ai nuk e njihte R.D., vetëm kishte dëgjuar për të.³⁸⁰ Ai nuk e njihte Z.T.³⁸¹ M.M. nuk e njihte A.V., vetëm kishte dëgjuar për të. Ai nuk i njihte S.Ro., E.S. Ai e njihte Da.E., por që asnjëherë nuk e kishte diskutuar me të vrasjen e R.D.³⁸²

3.21. Paralajmërimi për R.D.

545. Analiza e dëshmive të dhëna nga dëshmitarët çon në konkluzionin se S.T. e kishte paralajmëruar R.D. se e ashtuquajtura “mafia shqiptare” ishte duke e përgatitur vrasjen e tij. Një konstatim i tillë mbështetet nga dëshmia e saj e vërtetuar nga deklaratat e dëshmitarëve të tjerë në këtë rast. Dëshmitari më relevant në këtë pjesë ishte Al.H. që dëshmoi lidhur me paralajmërimin nga S.T. tashmë menjëherë pas vdekjes së R.D. Këto dëshmi po ashtu tregojnë se S.T. nuk kishte dhënë emra të njerëzve që po e planifikonin vdekjen e R.D.
546. Provat e mbledhur konfirmuan se R.D. kishte marrë paralajmërim nga burime të ndryshme.

Përmbledhje e provave

547. **S.T.** dëshmoi se ajo e kishte paralajmëruar R.D. dy herë. Ajo kishte frikë t’i tregonte atij se kush ishte duke u përgatitur për ta vrarë atë, sepse ishte e mundur që R.D. do t’ia raportonte këtë policisë çfarë do ta ekspozonte atë ndaj rrezikut. Nëse N.K. dhe të tjerët do të zbulonin se ajo e kishte treguar këtë, ata do ta

³⁸⁰ 18.05.2016, f. 29

³⁸¹ 18.05.2016, f. 34

³⁸² 18.05.2016, f. 40

“vrisnin atë si lepurin”.³⁸³

548. Ajo pretendon se e kishte paralajmëruar R.D. në marrëveshje me burrin e saj pasi ishin dhënë paratë. Ajo i përshkroi në hollësi rrethanat në të cilat ajo e informoi R.D. lidhur me vrasjen e planifikuar.³⁸⁴ Ajo e bëri këtë dy herë, herën e dytë tashmë pasi vrasësit ishin në Sarajevë kur ajo e takoi R.D. te “dyqani Markale”. Edhe një herë ajo e këshilloi atë të qetësohej sepse ai në mënyrë të vazhdueshme po i tregonte shtypit gjëra kundër F.R. dhe N.K, dhe ata do t’i viheshin pas tij.³⁸⁵³⁸⁶

549. Gjatë marrjes së tërthortë në pyetje, S.T. dëshmoi se ishte R.D. ai i cili i kishte thënë asaj se F.R. dhe N.K. po planifikonin ta vrisnin atë. Ai kishte marrë informata nga Beogradi. Në këtë mënyrë, ajo ishte në kundërthënie me vetveten.
688

550. **Z.T.** dëshmoi se sipas mendimit të tij S.T. e kishte paralajmëruar R.D.³⁸⁷ Më vonë, gjatë marrjes së tërthortë në pyetje, ai nuk kishte asnjë dyshim se ata të dy e kishin paralajmëruar atë por ai nuk e dinte se cili e kishte bërë këtë i pari.³⁸⁸ Ai po ashtu pretendonte se ai e kishte paralajmëruar R.D. pasi që atij i kishin thënë vëllezërit L. që të kontrollonte për vrasës.³⁸⁹ Gjatë marrjes së tërthortë në pyetje, ai e sqaroi se ai e paralajmëroi R.D. pasi ai e kishte parë M.M. në qytet.³⁹⁰ Vetëm atëherë ai shtoi se i kishte thënë R.D. se N.K. dhe F.R. ishin prapa planit për ta

³⁸³ 18.03.2015, f. 30

³⁸⁴ 18.03.2015, f. 30

³⁸⁵ 18.03.2015, f. 21, 31, 19.03.2015, f. 11

³⁸⁶ 16.05.2015, f. 19

³⁸⁷ 16.06.2015, f. 37

³⁸⁸ 19.06.2015, f. 36; 23.06.2015, f. 5

³⁸⁹ 16.06.2016, f. 33 - 34

³⁹⁰ 19.06.2015, f. 28; 22.06.2015, f. 13

vrarë atë. Ai nuk i tregoi emrat e vrasësve sepse ai nuk i njihte ata. S.T. nuk i tregoi atij emrat, sepse as ajo nuk i njihte ata.³⁹¹ Ai e paralajmëroi atë sepse ai ishte në marrëdhënie të mira me të dhe se ai nuk donte të hynte në konflikt me ndonjërin prej tyre.³⁹²

551. **E.D.** dëshmoi se S.T. ishte një mikeshë e burrit të saj për një kohë të gjatë. Sipas saj, S.T. nuk e informoi burrin e saj se po planifikohej vrasja. Nëse ajo do ta kishte bërë këtë, burri i saj do t'i kishte treguar asaj sepse nuk ishte vetëm siguria e tij por edhe e tërë familjes. Nëse ajo do t'i kishte informuar ata, A.P. nuk do të plagosej dhe R.D. – nuk do të vritej.³⁹³

552. **A.P.** dëshmoi se ata kishin marrë informata nga S.T. se F.R. dhe N.K. do ta vrisnin R.D. Ajo kishte ardhur përafërsisht në 20 raste dhe ia kishte thënë këtë R.D.; A.P. ishte i pranishëm në 10 raste. Kjo ishte para dhe pas vrasjes së S.L.³⁹⁴ Më vonë ai sqaroi se e kishte parë S.T. 20 – 30 herë, dhe se ajo e kishte paralajmëruar R.D. 2 – 3 herë.³⁹⁵ Ai asnjëherë nuk e kishte dëgjuar atë vetë personalisht, atij vetëm i kishte treguar R.D., por ai nuk tha asnjëherë se e kishte dëgjuar këtë nga S.T. Për A.P. ishte e qartë se ishte ajo. Një herë ai kishte thënë

³⁹¹ 22.06.2015, f. 5

³⁹² 23.06.2015, f. 10

³⁹³ 11.12.2015, f. 48

³⁹⁴ 27.11.2015, f. 11-12;

³⁹⁵ 27.11.2015, f. 11

se F.R. po përgatiste diçka kundër tij; herën e dytë – “ata kanë paguar për vrasjen time”.³⁹⁶

553. **Al.H.** dëshmoi se pas vrasjes së S.L., R.D. ishte paralajmëruar nga S.T. Kjo bisedë u zhvillua afër një kiosku në lagjën Grbavica. Al.H. nuk e kishte dëgjuar këtë bisedë por R.D. tha se ai kishte disa informata se dikush donte ta vriste atë. Ai nuk i besoi kur ajo e tha.³⁹⁷ R.D. nuk e tregoi se kush po planifikonte ta vriste atë.⁷⁰⁰ Dy javë më vonë afër supermarketit Sarajevo, në pjesën verore të kafenesë, S.T. ishte e ulur së bashku me nënën e saj. Ajo e ndali R.D. përsëri, dhe ajo fjalë për fjalë i tha atij se ajo ishte në ‘Casa Grande’ dhe se ajo kishte dëgjuar se një marrëveshje ishte bërë për vrasjen e tij. R.D. nuk e mori këtë seriozisht madje edhe atëherë sepse ajo ishte gazetare dhe sepse ajo ishte femër, dhe ai konsideronte se ajo nuk mund ta dinte këtë. Pastaj R.D. i tha Al.H. se mafia shqiptare kishte planifikuar ta vriste atë. Ai nuk kishte treguar se kush i përkiste mafisë shqiptare.³⁹⁸ S.T. nuk kishte treguar ndonjë emër të personave të përfshirë në përgatitjen e vrasjes së R.D.³⁹⁹
554. Al.H. po ashtu dëshmoi se tre ose katër ditë para vdekjes së tij, R.D. ishte thirrur nga miku i tij D.Z. i cili qartazi i tregoi atij se njerëz kishin ardhur për t’i varur të dy ata. D.Z. tha se ai do të fshihej, dhe kërkoi nga R.D. që edhe ai ta bënte të njëjtën gjë.⁴⁰⁰

³⁹⁶ 08.12.2015, f.29

³⁹⁷ 27.01.2016, f. 12, 13

⁷⁰⁰ 27.01.2016, f. 13

³⁹⁸ 27.01.2016, f. 12, 13

³⁹⁹ 29.01.2016, f. 8

⁴⁰⁰ 27.01.2016, f. 12

555. Al.H. u ballafaqua me dëshminë e tij të mëparshme ku ai nuk e kishte përmendur paralajmërimin nga D.Z. Ai shpjegoi se e kishte bërë këtë për shkak të sigurisë së tij personale. Ishte e rrezikshme të flisje për disa njerëz, përfshirë D.Z. Ai i tregoi policisë lidhur me të gjitha këto paralajmërimet.⁴⁰¹
556. Kur ai ishte marrë në pyetje menjëherë pas vdekjes së R.D., ai i kishte treguar policisë lidhur me paralajmërimet e S.T. Policia pastaj ishte më shumë e interesuar në M.A.G. Ai nuk e kishte lexuar deklaratën e tij, vetëm e kishte nënshkruar atë. Ai e përmendi konfliktin ndërmjet R.D. dhe N.K. Ai po ashtu e përmendi se R.D. kishte një konflikt me N.Sp. R.D. mendonte se ai ka mund të ketë hedhur bombë në shtëpinë e tij. Ai po ashtu e përmendi se R.D. nuk ishte në marrëdhënie të mira me Z.T.⁴⁰²
557. Ai e pranoi se nuk i kishte përmendur paralajmërimet e marra nga S.T. në gjykimin e G. për shkak se ata ishin udhëzuar nga Oleg Cavka se ata do të duhej t'i përmbaheshin vetëm M.A.G. Para se të hynte në sallën e gjyqimit atij i ishte dhënë deklarata e tij e mëparshme dhe i ishte thënë t'u përmbahej atyre.⁴⁰³
558. Ai pohonte se fakti se S.T. e kishte paralajmëruar R.D. u bë relevant vetëm gjatë gjyqimit kundër N.K. Përpara, atij nuk i dukej kjo informatë e rëndësishme sepse ai nuk kishte vlerësim për këtë person dhe ai mendonte se ajo nuk e thoshte të vërtetën. R.D. nuk i besonte asaj. Ai i besoi vetëm paralajmërimin të D.Z. Al.H. i tregoi për këtë policisë.⁴⁰⁴

⁴⁰¹ 22.02.2016, f. 15 - 16

⁴⁰² 29.01.2016, f. 15 – 16

⁴⁰³ 22.02.2016, f. 3 - 4

559. Nëse ai nuk do të udhëzohej nga Oleg Cavka, nuk do të thotë se ai do të dëshmonte rreth S.T. dhe D.Z.⁴⁰⁵⁴⁰⁶ Al.H. nuk tregoi se S.T. e paralajmëroi R.D. sepse “gjykimi këtu po mbahej kundër M.A.G., dhe se të gjitha faktet që kishin të bënin me të e për të cilat ne ishim në dijeni, ne ua prezantuam atyre. S.T. nuk tha “dëgjo, unë isha me M.A.G. dhe ai tha se ai do të të vrasë ty”, por S.T. tha se ajo ishte në hotel Casa Grande dhe se shqiptarët po përgatiten për të të vrarë ty.”

⁷⁰⁹

560. Përveç tjerash, ai nuk e përmendi S.T. në gjykimi e M.A.G. sepse kjo ishte kundër M.A.G. Ai nuk donte të kishte probleme me Z.T. dhe si rrjedhojë nuk e përmendi S.T. Pra, ai mendoi se paralajmërimi i saj ishte informatë e rreme sepse kur S.T. e informoi R.D. se ajo ishte në Hotel Casa Grande, se ajo i jepte informata të rreme R.D. dhe se ajo qëllimisht donte ta fuste atë në telashe me qëllim që ai të reagoje kundër N.K. Ajo donte ta provokonte R.D. kundër N.K.⁴⁰⁷ Al.H. beson, edhe tani, se S.T. e kishte paralajmëruar rrejshëm R.D. për ta provokuar atë. Ai nuk e dinte se pse por nënvizoi se ajo ishte gazetare dhe ishte gruaja e Z.T.⁴⁰⁸ Ajo donte ta provokonte R.D. sepse ai ishte grindavec, reagoje shpejt, dhe para se ajo ta paralajmëronte atë, A.P. ishte plagosur.⁴⁰⁹

561. **M.U.** dëshmoi se pas vdekjes së S.L., R.D. filloi të merrte kërcënime nga shumë anë. Ai po ashtu mësoi se dikush kishte paguar 250.000 euro për vdekjen e tij.⁴¹⁰

⁴⁰⁴ 22.02.2016, f. 5

⁴⁰⁵ 22.02.2016, f. 6

⁴⁰⁶ 22.02.2016, f. 7

⁴⁰⁷ 22.02.2016, f. 17

⁴⁰⁸ 22.02.2016, f. 18

⁴⁰⁹ 22.02.2016, f. 18

⁴¹⁰ 04.04.2016, f. 12-13

3.22. R.D. pak para vrasjes

562. Provat e mbledhura e mbështesin konstatimin e Gjykatës se pak para vdekjes së tij, R.D. kishte marrë kërcënime dhe informata se po përgatitej vrasja e tij. Megjithatë, në dritën e dëshmisë së Al.H., Gjykata vërtetoi se R.D. nuk e informoi as ky dëshmitar, e as A.P. se kush qëndronte prapa këtyre kërcënimeve dhe përgatitjeve. Nëse ai do t'u kishte treguar atyre për këta persona, A.P. dhe Al.H. do t'i kishin dhënë emrat e tyre tashmë gjatë dëshmive të tyre të para që u dhanë menjëherë pas vdekjes së R.D. Çka ishte po ashtu karakteristike, Al.H. i përmendi disa persona të cilët ishin të rrezikshëm për R.D., por në këtë kontekst nuk e përmendi N.K.
563. Analiza e dëshmisë së A.P. çon në përfundimin se ai nuk ka pasur njohuri të drejtpërdrejtë se kush qëndronte prapa vrasjes së R.D. Në shumë raste, ai i ndau me Gjykatën vetëm spekulimet dhe thashethemet e tij të cilat ai i kishte dëgjuar në tërë Sarajevën. Në gjykimin kundër M.A.G., ai e fajësonte atë për vdekjen e R.D., dhe ai e ndërroi mendjen vetëm më vonë kur ai mësoi për rastin kundër N.K, po ashtu nga dëshmitë e dëshmitarëve të tjerë në këtë lëndë dhe nga gjykimi kundër Z.T. Ai pohoi se ai kishte kryer hetimin e vet. Ai e pranoi se njohuria e tij bazohej mbi atë çfarë ai kishte dëgjuar nga njerëzit e tjerë, lexuar në media si dhe nga deklaratat e S.T. të dhëna në këtë shqyrtim gjyqësor. Ai konfirmoi se ata ishin miq të mirë me të dhe ata bisedonin rreth R.D. dhe vdekjes së tij.

564. **S.T.**e mohoi ta ketë njohur A.P. dhe të ketë pasur kontakte me të. Gjykata vlerësoi se në këtë mënyrë ajo përpiquej ta fshihte se ajo qëndroi në kontakt me dëshmitarët në këtë rast.

Përmbledhje e provave relevante

565. **A.P.** dëshmoi se R.D. e dinte se ata donin ta vrisnin atë dhe se ata po e përcillnin atë. Sipas tij, R.D. po i referohej N.K.⁴¹¹ Ai po vishte jelek anti-plumb, por ai e përdorte atë edhe më përpara. Ai kishte armë.⁴¹²

566. Gjatë marrjes së tërthortë në pyetje, A.P. tha se para dëshmisë së tij në gjykimin kundër M.A.G., prokurori Cavka i kishte thënë atij që të mos e përmendte fare N.K. sepse aktakuza nuk ishte kundër tij. Ky udhëzim ishte dhënë me gojë, jashtë gjykatës. Megjithë këtë, në atë gjykim ai e kishte përmendur N.K. në disa raste, edhe si person i cili e kishte ndihmuar M.A.G. për t'i gjetur kurdët.⁴¹³ Kur u pyet për këtë mospërputhje, ai pohoi se ai kishte dëshmuar gjatë gjithë kohës njësoj.⁴¹⁴

567. Kur A.P. u pyet në gjykimin e tanishëm se kush e kishte vrarë R.D. ai nuk e përmendi M.A.G. fare, me gjithë faktin se në gjykimin e tij A.P. ishte i sigurt se ishte ai. Kur u pyet për këtë, ai tha ndoshta M.A.G. kishte marrë pjesë me para, kur u paguan paratë për këtë vrasje.⁴¹⁵

568. Ai nuk i përmendi F.R. dhe Ek.L. në gjykimin e G. A.P. shpjegoi se prokurori po i bënte atij pyetje sugjestive. Ai ishte në botën e tij; andaj ai nuk i përmendi F.R.

⁴¹¹ 28.10.2015, f. 14

⁴¹² 28.10.2015, f. 16

⁴¹³ 28.10.2015, f. 30

⁴¹⁴ 28.10.2015, f. 28 - 29

⁴¹⁵ 27.11.2015, f. 6

dhe Ek.L. me gjithë faktin se askush nuk i kishte thënë të mos i përmendte ata.⁴¹⁶ Në shqyrtimin gjyqësor kundër N.K, ai ndjente se ishte detyrë e tij ta thoshte të vërtetën.⁴¹⁷ A.P. nuk ishte në gjendje të shpjegonte se çfarë kishte ndodhur pas gjykimit të M.A.G. që e kishte bindur atë të dëshmonte kundër F.R., N.K dhe Ek.L.⁴¹⁸

569. Ai pohoi se kishte zbuluar pas vrasjes si ishin F.R., N.K. dhe Ek.L. ata të cilët e kishin urdhëruar vrasjen e R.D.⁴¹⁹ Ai u ballafaqua me deklaratën e tij të mëparshme ku ai tha se ishte N.K. dhe mafia shqiptare por ai nuk i përmendi F.R. dhe Ek.L. si të përfshirë në këtë vrasje. Ai tha se ai kishte ndërmend t'i përmendte ata në dëshminë e tij të mëtejme.⁴²⁰ Më vonë, ai dha një shpjegim tjetër se pse ai e kishte ndërruar dëshminë e tij, dhe ai tha se donte të dëshmonte të vërtetën tashmë në gjykimin e M.A.G. por që ai nuk ishte në gjendje të dëshmonte kundër F.R. si një person i pushtetshëm.⁴²¹
570. Ai dëshmoi se kur ai e vizitonte E.D., ata flisnin për vrasjen e R.D. Me sa i kujtohej atij, ata flisnin për njerëzit e përfshirë. Ai tha se shteti ka mund të jetë i përfshirë në këtë⁴²² dhe se ai besonte se F.R. është shteti dhe N.K. ishte ushtar i tij.⁴²³

⁴¹⁶ 27.11.2015, f. 6 – 7, 27

⁴¹⁷ 27.11.2015, f. 27

⁴¹⁸ 27.11.2015, f. 9

⁴¹⁹ 27.11.2015, f. 9

⁴²⁰ 27.11.2015, f. 24

⁴²¹ 27.11.2015, f. 33

⁴²² 08.12.2015, f. 3 - 5

571. **E.D.** e mohoi që **A.P.** i ka thënë asaj ndonjëherë se **N.K.** qëndronte prapa vrasjes së **R.D.** Ai i tha asaj se ishte **M.A.G.** dhe **L.By.**⁴²⁴
572. **A.P.** pohoi se gjithmonë ishte i sigurt se prapa vrasjes së **R.D.** ishin **N.K.** dhe **F.R.**, dhe më vonë ai gjeti se i përfshirë ishte edhe **Ek.L.** Ai po zhvillonte një hetim të vetin deri në këtë gjykim. Ai i bëri lidhjet, për përfshirjen e **Ek.L.** mësoi nga mediat dhe nga deklaratat e **S.T.** që ishin në dispozicion në YouTube. Ai e mësoi këtë nga shumë njerëz që ai i njihte personalisht, duke përfshirë **S.T.** Ai po përcillte shumë gjëra, duke përfshirë gjykimin e **Z.T.**, ai mësoi shumë nga kjo. Me sa i kujtohej, ai i kishte lexuar deklaratat e **S.T.** se i përfshirë ishte **N.O.**⁴²⁵ Më vonë ai pohonte se ai vetëm i kishte shikuar ato shkurtimisht.⁴²⁶
573. Pas situatës në Turqi kur **A.P.** e kishte parë **S.T.**, ata u bënë miq të mirë dhe e shihnin njëri tjetrin në shumë raste të tjera. Kjo marrëdhënie ende është aktiv, ajo i telefonon atij herë pas here. Ai pohoi se ata nuk kishin folur asnjëherë për dëshminë e saj.⁴²⁷ Ai nuk takohej me të rregullisht. Në periudhën 2009 – 2012 ai ishte në burg. Nganjëherë e mbështeste atë financiarisht.⁴²⁸
574. **A.P.** ishte i sigurt se **N.K.** po e provokonte **R.D.**, megjithatë ai asnjëherë nuk i kishte parë ata së bashku.⁴²⁹ Ai nuk ishte në dijeni nëse **R.D.** kishte ndonjë konflikt me dikë në Serbi. Ai kishte konflikt vetëm me **N.K.** Ai nuk kishte konflikt me **Z.T.**⁴³⁰

⁴²³ 08.12.2015, f. 5

⁴²⁴ 11.12.2015, f. 46

⁴²⁵ 08.12.2015, f. 9 - 11

⁴²⁶ 08.12.2015, f. 11

⁴²⁷ 27.11.2015, f. 12

⁴²⁸ 27.11.2015, f. 12-13

⁴²⁹ 08.12.2015, f. 23

⁴³⁰ 08.12.2015, f. 24 - 25

575. Gjatë rrjedhës së mëtejme të marrjes në pyetje, A.P. e pranoi se ai i dinte këto konfrontimet e vogla ndërmjet Z.T. dhe R.D. Në vitin 2006, A.P. dhe R.D. kishin ardhur në shtëpinë e Z.T. dhe ata e kishin sulmuar mikun e tij D.S.⁴³¹ Ky incident ndodhi rreth 6 – 7 muaj para vrasjes së R.D.⁴³² Që nga situata kur ishte rrahur D.S., R.D. nuk kishte folur me Z.T. A.P. ende fliste me të.⁴³³
576. M.U. tha se tre ditë para vrasjes ai u takua me R.D., i cili i tha atij se ai kishte informata se gjatë këtyre ditëve djemtë L. do ta sulmonin atë dhe se kërcënimet e tyre nuk ishin të pafajshme. R.D. i kishte përmendur Ek.L., Se.L., Me.L. dhe Ed.L.⁴³⁴
577. Në ditën e vrasjes, M.U. u takua me R.D. në kafenenë Kiborg. Ai i tha se po balla A.P. hej me probleme të mëdha, se jeta e tij ishte e kërcënuar. Ai e këshilloi M.U. të jetë i kujdesshëm. Ai po ashtu tha se kërcënimet vinin nga anë të ndryshme. Ai e mori këtë informatë nga një imam. M.U. insistoi t’i merrte emrat e njerëzve të cilët e kishin kërcënuar R.D.⁴³⁵ Ai i dha emrat e mëposhtëm: F.R., N.O., Mafia Shqiptare, Ek.L. dhe S.S. Sa i përket Ek.L., R.D. tha se me siguri Esref L. dhe Se.L. ishin me të. Kur ai dëshmoi menjëherë pas vdekjes së R.D., ai nuk dha asnjë emër të caktuar nga e ashtuquajtura mafia shqiptare.⁴³⁶

⁴³¹ 10.11.2015, f. 42 -43

⁴³² 27.11.2015, f. 3

⁴³³ 27.11.2015, f. 3

⁴³⁴ 04.04.2016, f. 15 - 16

⁴³⁵ 04.04.2016, f. 13

⁴³⁶ 04.04.2016, f. 13-14, 17 - 18

578. Në gjykimin e G., M.U. nuk i kishte përmendur gjithë këta emra. Kur u pyet për këtë, ai tha se ai kishte vërejtur se pastaj çdo gjë ishte drejtuar kah M.A.G. dhe kur ai donte të thoshte diçka tjetër, ata i thonin se kjo nuk ishte e nevojshme.⁴³⁷
579. Ai u ballafaqua me deklaratën e tij të parë të dhënë më 29 qershor 2007, në të cilin ai nuk e përmendi F.R. Ai tha se ai ishte nën presion, dhe atij i kishin thënë se gjykimi ishte vetëm ndaj M.A.G.⁴³⁸
580. Gjatë marrjes së tërthortë në pyetje M.U. ishte ballafaquar me deklaratën e tij të 30 qershorit 2007 kur ai tha: *“sa i përket R.D., pesë gjashtë ditët e fundit ai ishte shumë nervoz dhe i kujdesshëm, ai më tha se duhet të jem i kujdesshëm kur të shkoj në shtëpi, që të mos shkoja vetëm, të isha i kujdesshëm nga “Bo.” [J.C.] në veturën time dhe nga pritat, ai ishte jashtëzakonisht i kujdesshëm dhe ai kishte marrë edhe thirrje kërcënuese. Megjithatë, ai asnjëherë nuk tha se kush e kërcënonte atë, por zakonisht ky ishte stili i tij.”* Ai e pranoi se ishte deklarata e tij, por ai refuzoi të përgjigjej në pyetjen nëse ai qëndronte parapa kësaj deklarate, posaçërisht se ishte stili i R.D. që të mos fliste. Ai tha se kjo varej nga momenti. Ai nuk desh të përgjigjej në pyetje sepse sipas tij mbrojtja po e provokonte.⁴³⁹
581. Më vonë, ai tha se nuk ishte e vërtetë se R.D. nuk i kishte treguar atij se kush e kërcënonte atë.⁴⁴⁰ Kur u pyet nëse e kishte thënë të vërtetën në deklaratat e tij të mëparshme, ai tha se kjo ishte e vërteta, atëherë dhe tani.⁴⁴¹

⁴³⁷15.04.2016, f. 12; 14

⁴³⁸ 15.04.2016, f. 14

⁴³⁹ 18.07.2016, f. 46

⁴⁴⁰ 18.07.2016, f. 46

⁴⁴¹ 18.07.2016, f. 47

582. Pastaj atij iu rikujtua se në gjykimin e G. ai tashmë kishte përmendur emra të disa njerëzve të cilët kinse e kishin kërcënuar R.D. Tashmë atëherë, ai u pyet se pse ai nuk ia kishte treguar këtë prokurorit, dhe ai u përgjigj: *“Sepse në atë kohë, nuk e kisha komplet trurin, nuk mund të mbaja mend çdo gjë, unë isha në një lloj konfuzioni, sepse jetën e kisha në një problem, e dini, kur një veturë e blinduar të vjen në Rrugën Strass Meier dhe ndalet dhe ata t’i lëshojnë dritat në dritare dhe pastaj kthehet prapa, shkon përpara, dhe pastaj kthehet prapa, shkon përpara, dhe pastaj ata e hapin dritaren për dy cm, duke e ditur se ajo është e blinduar”*. Ai e konfirmoi këtë deklaratë.⁴⁴²

583. Sipas **Al.H.**, R.D. po merrte informata se po përgatitej vrasja e tij.⁴⁴³ Ai shpesh i ndërronte apartamentet.⁴⁴⁴ R.D. ishte i shqetësuar për sigurinë e tij, andaj vitin e fundit ai nuk po qëndronte në shtëpi.⁴⁴⁵ Ai filloi të shprehte shqetësime lidhur me sigurinë e tij nëntor/ dhjetor 2006. Ai nuk i shpjegoi arsyet.⁴⁴⁶

584. Më vonë Al.H. dëshmoi se ndryshimet në sjelljen e R.D. filluan rreth një muaj para vrasjes së tij. Ai ishte nën presion për shkak të gjyimit për vrasjen e mysafirit serb, vrasjen e S.L.; ai priste t’i merrte më së paku 10 vjet. Ai ishte i tensionuar, nervoz. Ai ishte i sigurt se nuk mund t’i përballonte 10 vjet në burg.⁴⁴⁷ R.D. ishte gjithmonë i armatosur, për sigurinë e tij personale. Gjatë ditës

përdorte një beretë italiane. Natën kishte një 38 Smith

⁴⁴² 18.07.2016, f. 48

⁴⁴³ 27.01.2016, f. 12

⁴⁴⁴ 27.01.2016, f. 12

⁴⁴⁵ 27.01.2016, f. 16

⁴⁴⁶ 27.01.2016, f. 17

⁴⁴⁷ 27.01.2016, f. 27

& Wesson special.⁴⁴⁸ Ai po e përgatiste ikjen e tij, për shkak se ai ishte i frikësuar për rezultatin e gjyqimit në lidhje me vrasjen e një mysafiri serb, dhe për shkak të informatave se po përgatitej vrasja e tij. Ai kishte bërë gati paratë për t'i marrë me vete. Në ditën e vdekjes së tij Al.H. i këmbëu 100.000 KM në euro. A.S. dinte për planin e tij sepse ajo është dashur të shkonte me të.⁴⁴⁹ Ai nuk e përmendi ikjen e planifikuar të R.D. në gjykimin e G. Ai mendon se ai nuk e ka përmendur fare S.L.⁴⁵⁰

585. **A.S.** konfirmoi se pak para vrasjes R.D. kishte filluar të vishte jelek anti-plumb. Ishte nja 4 – 5 ditë para vrasjes. Ai tha se ai po kërcënohej nga dikush. Ai kishte marrë kërcënime përmes sms-ve. Ai nuk kishte treguar se nga kush.⁴⁵¹ Ai ishte nervoz ditëve të fundit, ata nuk e shihnin shumë shpesh në atë kohë.⁴⁵²

586. **E.D.** dëshmoi se ata ishin shumë të shqetësuar lidhur me sigurinë e tyre. Ajo ishte e shqetësuar për shkak të M.A.G. dhe disa njerëzve rreth tij. Ajo nuk mund t'i tregonte emrat e tyre, sepse ata ishin shqiptarë.⁴⁵³ R.D. frikësohej nga M.A.G. Ai e merrte me vete armën çdo ditë. Ai po ashtu përdorte një jelek anti-plumb.⁴⁵⁴ Ai i tha asaj se ishte thirrur nga D.Z. ose Elez që e kishte paralajmëruar atë për vrasjen që po përgatitej. Ai e kishte thënë këtë dy muaj para vrasjes.⁴⁵⁵

587. **M.U.**, si mik i R.D., i interesonte që ta zbulonte se kush ishte përgjegjës për vdekjen e tij. Megjithatë, dëshmia e tij nuk kontribuoi për këtë sepse ai nuk kishte

⁴⁴⁸ 27.01.2016, f. 22, 25 – 26; 29.01.2016, f. 11 - 12

⁴⁴⁹ 27.01.2016, f. 22 - 23

⁴⁵⁰ 22.02.2016, f. 9

⁴⁵¹ 18.01.2016, f. 31

⁴⁵² 13.01.2016, f. 17 - 18

⁴⁵³ 11.12.2015; f. 14-16, f. 16 - 17

⁴⁵⁴ 11.12.2015; f. 17

⁴⁵⁵ 11.12.2015, f. 25, 50

njohuri të drejtpërdrejtë për atë se kush e kishte planifikuar vrasjen. Ai nuk e njihnte N.K., ai vetëm e dinte se ekzistonte një lloj konflikti ndërmjet tij dhe R.D. por ai nuk e dinte asnjë detaj. Për më tepër, ai konfirmoi se ekzistonte një marrëveshje për ndërprerje të mosmarrëveshjeve ndërmjet N.K. dhe R.D. Çfarë është po ashtu relevante, ai tashmë dëshmoi në gjykimin kundër M.A.G. ku ai nuk kishte thënë se N.K. ishte i përfshirë në këtë vrasje.

588. Sipas tij, M.A.G. dhe R.D. po e shmangnin njëri-tjetrin në Sarajevë, për shkak se gjithmonë kishin pasur grindje, tensione dhe konflikte. M.A.G. jepte para hua dhe e rriste kamatën; njerëzit ankoheshin tek R.D.⁴⁵⁶ Ai vetëm kishte dëgjuar për konfliktin ndërmjet N.K dhe R.D.⁴⁵⁷ Ai e lidhte atë me një shqiptar tjetër, “Bj.”, por ai nuk dinte ndonjë detaj tjetër.⁴⁵⁸ Disa vite më vonë R.D. dhe N.K. u ulën së bashku dhe diskutuan.⁴⁵⁹

589. Ai dëgjoi se R.D. po e përdorte termin “mafia shqiptare” dhe “klani shqiptar”. Ka mund të ketë ndodhur para 8 – 9 vitesh. Ai e përdorte atë duke iu referuar M.A.G., N.K dhe të tjerëve. M.U. nuk dinte emra të tjerë.⁴⁶⁰

590. Kujtesa e tij u rifreskua me deklaratat e tij të mëparshme nga 04 korrik 2007, kur ai tha se “Për disa vite të shkuara R.D. ishte në konflikt të hapur me të ashtuquajturin klani shqiptar në Sarajevë” që përfshinte N.K., M.A.G., L.K., B.Ke. dhe E.Ke. M.U. tha se ai mund ta ketë thënë në këtë mënyrë, por që atij

⁴⁵⁶18.03.2016, f. 9

⁴⁵⁷ 18.03.2016, f. 11

⁴⁵⁸ 18.03.2016, f. 11

⁴⁵⁹ 18.03.2016, f. 16

⁴⁶⁰ 18.03.2016, f. 13

nuk i kujtohej kjo saktësisht. Ai nënvizoi se ka kaluar një kohë e gjatë, përveç kësaj ai ishte i sëmurë nga diabeti.⁴⁶¹

591. Ai nuk e dinte se pse F.R. ishte aq kundër R.D. dhe atij. Sipas M.U., R.D. asnjëherë nuk e kishte përmendur F.R., dhe se ai nuk kishte asnjë indikacion se ai nuk i pëlqente R.D. F.R. nuk i pëlqente R.D.⁴⁶²
592. Gjatë marrjes së tërthortë në pyetje, M.U. u ballafaqua me dëshmitë e tij të dhëna pak kohë pas vdekjes së R.D. Pastaj ai ishte i sigurt se M.A.G. ishte përgjegjës për këtë. Kur ai po jepte deklaratat në prokurori, në MPB dhe sa herë që ai donte ta elaboronte më tej rrëfimin e tij, të tregonte se çfarë kishte dëgjuar, parë dhe ditur, ata i thonin se ky rast ka të bëjë vetëm me M.A.G., dhe se të tjerët do të përfshihen në rastet e tjera dhe se ai do të duhej të fokusohet në këtë temë.⁴⁶³
593. M.U. pohoi se ai nuk e kishte thënë tërë rrëfimin, për arsye se situata atëherë ishte e tensionuar dhe çdo gjë ishte drejtuar kah M.A.G. Ai po ashtu në atë kohë ishte i kërcënuar nga familja L.⁴⁶⁴ Ai kishte shmangur përgjigjen në pyetjen nëse ai kishte fshehur ndonjë informatë në lidhje me vdekjen e R.D. Atij nuk i kujtohej çdo gjë për arsye se familja e tij kishte marrë shumë kërcënime.⁴⁶⁵
594. Më tej, M.U. dëshmoi se një nga personat kryesorë i cili kishte paguar për vrasjen e R.D. ishte M.A.G. R.D. po ashtu i kishte treguar atij se ishte F.R., por nuk e tha këtë në gjykimin e G. sepse “ai nuk ishte budalla”.⁴⁶⁶ Ai u ballafaqua me këtë deklaratë nga gjykimi i M.A.G. ku ai tha se R.D. i kishte thënë atij se

⁴⁶¹ 18.03.2016, f. 13

⁴⁶² 15.04.2016, f. 13

⁴⁶³ 15.04.2016, f. 17-18

⁴⁶⁴ 18.07.2016, f. 42

⁴⁶⁵ 18.07.2016, f. 43

M.A.G. kishte paguar 250 000 Euro dhe se ai kishte informata të besueshme lidhur me të.⁴⁶⁷ Kur kjo pjesë u lexua, dëshmitari u largua nga salla e gjykimit dhe ai nuk deshi të kthehej ta përfundonte dëshminë e tij. Trupi gjykues kishte vendosur që të mos e thërriste atë përsëri.⁴⁶⁸

595. M.U. e nënvizonte vazhdimisht se policia dhe prokuroria nuk i lejonin ata që të elaboronin më gjerë për të gjitha ngjarjet që çuan në vrasjen e R.D.⁴⁶⁹ Ai pohoi se ai nuk u lejua të fliste më gjerë kur u iniciuan procedurat kundër F.R. sepse ai nuk ishte më aq i pushtetshëm dhe njerëzit filluan të flisnin. Ai shmangu të përgjigjej se cilët njerëz. Vetëm 9 vjet pas vrasjes së R.D., ai ishte në gjendje të tregonte tërë të vërtetën.⁴⁷⁰

596. Duhet të shtohet se më 18 mars 2016, M.U. e ndërpriti marrjen e tij në pyetje për shkak të gjendjes së tij shëndetësore. Ai tha se nuk ishte në gjendje t'u përgjigjej pyetjeve sepse ishte i sëmurë me diabet dhe se shtypja e tij e gjakut ishte rritur në mënyrë të konsiderueshme. Kjo ndodhi pasi kujtesa e tij u rifreskua me deklaratat e mëparshme që kishin të bënin me pajtimin ndërmjet N.K dhe R.D.⁴⁷¹

597. Më 04 prill 2016, ndodhi e njëjta situatë. Marrja në pyetje u ndërpre për shkak të gjendjes shëndetësore të dëshmitarit. Ai e ndërpreu marrjen në pyetje në momentin kur ai e përshkroi takimin e tij të fundit me R.D., pak para vdekjes së

⁴⁶⁶ 18.07.2016, f. 49

⁴⁶⁷ 18.07.2016, f. 50

⁴⁶⁸ 18.07.2016, f. 50-51

⁴⁶⁹ 18.07.2016, f. 444

⁴⁷⁰ 18.07.2016, f. 44

⁴⁷¹ 18.03.2016, f. 16-17,

- tij.⁴⁷²
598. Më 15 prill 2015, M.U. veç u largua nga salla e gjykimit qysh në fillim të marrjes së tërthortë në pyetje kur mbrojtja e pyeti atë se pse nuk e përmendi askë, e vetëm M.A.G. si ai që ishte përgjegjës për vdekjen e R.D.⁴⁷³

3.23. Vrasja

599. Siç u përmend në pjesën e parë të këtij aktgjykimi, fakti i vdekjes së dhunshme të R.D. nuk ishte kontestuar nga palët. Kjo u mbështet në mënyrë shtesë nga provat e marra në vendin e ngjarjes gjë që ishte vlerësuar dhe analizuar nga autoritetet boshnjake.
600. Dëshmitarët e vetëm të cilët dëshmuuan në detaje lidhur me vrasjen e R.D. ishin K4 dhe K5. Pyetja vendimtare lidhur me dëshmitë e tyre ishte nëse ata vërtet dinin drejtpërdrejt lidhur me ta nga S.R. ose ata kishin mësuar nga burimet e tjera. Përgjigja në këto pyetje do të ndihmonte të përcaktohej nëse ishte S.R. ai i cili e kishte vrarë R.D. Gjykata e konsideron të arsyeshme që t'i paraqesë dëshmitë e këtyre dëshmitarëve në mënyrë më të detajuar dhe përshkruese.
601. Fillimisht **K5** dëshmoi se vrasja kishte ndodhur natën,⁴⁷⁴ rreth orës 21.00 ose 21.30.⁴⁷⁵ Gjatë marrjes së tërthortë në pyetje ai e ndërroi versionin e tij dhe tha se vrasja kishte ndodhur rreth mesnatës. Ai nuk kishte parë asnjë problem me këtë mospërputhje. **Është e nevojshme të nënvizohet se K5 tha se nëse ai donte, ai thjesht do të mund ta mbante në mend kohën sepse kur ai ishte në Sarajevë ai i mori atje të gjitha informatat rreth kohës, vendit të vrasjes. Ai e mori**

⁴⁷² 04.04.2016, f. 19

⁴⁷³ 15.04.2016, f. 19

⁴⁷⁴ 27.07.2015, f. 20

⁴⁷⁵ 29.07.2015, f. 23

atë nga personeli i ASHHM-së.⁴⁷⁶

602. K5 e përshkroi se për ta vranë R.D., po përdoreshin Heckler dhe Koch dhe Magnum 38 special. Heckler ishte nga shtëpia e K5 dhe i përkiste M.Os.; Magnum i përkiste K5.⁴⁷⁷ K5 dëshmoi se S.R. e përdori armën e tij për ta vranë R.D. Ai e kishte marrë atë nga shtëpia. Ai përdori Heckler dhe Koch 5, pistoletën 38 Special Magnum. Pistoleta ishte përdorur për të shtënë e mëshirës. Heckler ishte sjellë në vendin e tyre nga M.Os. Pas kësaj, ai u la në Bosnjë në Sokolac, ndërsa pistoleta u soll prapa në shtëpi.⁴⁷⁸
603. Shurdhuesi nuk ishte përdorur për shkak se S.R. po hidhte shurdhuesit sepse nëse do ta përdorte shurdhuesin, ai do ta përdorte atë për armët me tytë të shkurtër, gjersa në këtë rast ai po e përdorte Heckler dhe Koch 5 gjë që nuk kishte nevojë për shurdhues.⁴⁷⁹ S.R. asnjëherë nuk përdorte shurdhuesit. Ai e kishte bërë vetëm një herë kur ai kishte tentuar ta vriste D.Z.⁴⁸⁰
604. Sipas K5, S.R. e la shurdhuesin në vendin e ngjarjes për t'i ç'orientuar hetimet.⁴⁸¹ K5 nuk u kishte treguar autoriteteve lidhur me këtë sepse ai nuk kishte parë arsye për ta bërë këtë.⁴⁸² Ai nuk e dinte se mostrat e ADN-së ishin nxjerrë nga shurdhuesi.⁴⁸³

⁴⁷⁶ 29.09.2015, f. 30 - 31

⁴⁷⁷ 29.07.2015, f. 12

⁴⁷⁸ 30.07.2015, f. 23-24

⁴⁷⁹ 29.07.2015, f. 20

⁴⁸⁰ 30.07.2015, f. 26

⁴⁸¹ 30.07.2015, f. 26 - 27

⁴⁸² 29.09.2015, f. 45

605. Gjatë marrjes së tërthortë në pyetje, K5 u ballafaqua me deklaratën nga 29 gushti 2012, kur ai tha se S.R. e gjuajti aty afër Heckler & Koch, por jo shurdhuesin, dhe ai besonte se ishte gjetur. Ai nuk e mbështet këtë, duke thënë se ndoshta ai po tallej me Campara.⁴⁸⁴
606. Qysh në fillim të dëshmisë së tij, K5tha se nëse shikohet ADN-ja e gjetur në vendin e ngjarjes, nuk ishte e djalit të tij por kjo nuk do të thoshte asgjë.⁴⁸⁵ Më vonë ai tha se nëse nuk ishte i S.R. atëherë ishte e tij, sepse M.Os. e mbushi një armë automatike të quajtur Igram, gjersa e mbushi Heckler dhe Koch.⁴⁸⁶ Gjurmët e gishtërinjve në plumba mund t'i përkisnin vetëm atij.⁴⁸⁷
607. Gjatë rrjedhës së marrjes së tërthortë në pyetje, K5 dëshmoi se ai e kishte mbushur Heckler me 27 plumba. Pastaj ai u ballafaqua me këtë deklaratën e tij të mëparshme kur ai tha se M.Os. solli Heckler i cili tashmë ishte mbushur me 27 plumba. Përsëri ai tha se ishte ai i cili e kishte mbushur armën; ndoshta gabimi ishte bërë nga njerëzit të cilët e kishin marrë atë në pyetje në Beograd.⁴⁸⁸ K5 pohoi se ai e kishte testuar Heckler para se ata të shkonin në Sarajevë. Ai po ashtu e kishte testuar shurdhuesin, por ai e dinte se ai nuk po punonte mirë. S.R. e mori atë për ta kurdisur atë, për t'i humbur gjurmët. ADN-ja e K5 do të duhej të jetë në shurdhues dhe në ato armë.⁴⁸⁹
608. Fakti se ADN-ja e S.R. nuk ishte gjetur në shurdhues në vendin e ngjarjes ishte

⁴⁸³ 29.09.2015, f. 46

⁴⁸⁴ 30.09.2015, f. 49

⁴⁸⁵ 29.07.2015, f. 12

⁴⁸⁶ 29.07.2015, f. 16, 29.09.2015, f. 43

⁴⁸⁷ 30.07.2015, f. 26

⁴⁸⁸ 30.09.2015, f. 18-19

⁴⁸⁹ 29.09.2015, f. 44 - 45

konfirmuar nga raportet e ekspertit, si dhe nga ai i paraqitur nga mbrojtja.⁴⁹⁰

609. Sipas K5, në vendin e ngjarjes, ishin S.R. dhe N.V. i cili ishte tutje vendit të ngjarjes rreth 15 metra. Ai ishte personi i cili kishte paralajmëruar me fishkëllimë për mbërritjen e R.D. S.R. ishte përkulur nën shkallët. Ai i përdori të dyja armët, revolen t'u siguruar. Ai shtiu me HK në gjoks, dhe me revole – në kokë. Ai nuk e plaçkiti R.D. sepse ata dëgjuan se ai kishte pasur me vete 30.000 euro.⁴⁹¹

610. Gjatë marrjes së tërthortë në pyetje, K5 e mohoi se ai kishte thënë ndonjë gjë lidhur me fishkëllimën. Ai vetëm tha se S.R. dhe N.V. ishin të përfshirë në shumë biznese bashkë.⁴⁹²

611. K5 Po ashtu dëshmoi se S.R. e kishte përshkruar në detaje se si kishte ndodhur vrasja. Ai e përmendi po ashtu se në një ulëse të veturës së tij kishin qenë 35.000 euro, në momentin kur ai u qëllua. R.D. ishte qëlluar me 27 plumba kur ai kishte dalë nga vetura dhe kishte kyçur atë.⁴⁹³ Vetura ishte e parkuar pikërisht para apartamentit.⁴⁹⁴ Pasi S.R. e kishte vrarë R.D. ai nuk e kishte hapur veturën e tij, por ai mund t'i shihte paratë brenda.⁴⁹⁵

⁴⁹⁰ Ekspertiza e paraqitur nga mbrojtja më 12.10.2015; Qendra Klinike e Universitetit të Sarajevës – Raportet e ADN-së, Regjistratori i hetimeve nr. 4, f. 233-254

⁴⁹¹ 29.07.2015, f. 21, 22

⁴⁹² 30.09.2015, f. 38

⁴⁹³ 30.09.2015, f. 28

⁴⁹⁴ 30.09.2015, f. 29

⁴⁹⁵ 30.09.2015, f. 6 - 7

612. Kjo pjesë e dëshmisë së K5 kur ai pohoi se R.D. ishte vrarë afër veturës së tij është në kundërtënie me provat e tjera objektive që qartazi treguan se ai ishte vrarë në oborr afër shkallëve që çonin për në ndërtesë.
613. Ai më tej dëshmoi se njëri nga policët në Beograd i fishkëlleu atij, dhe K5 besonte se ai e kishte bërë këtë për të sugjeruar emrin e N.V. si personi që kishte marrë pjesë në vrasje. Polici po ashtu e kishte përmendur pseudonimin e tij – N.V. K5 ishte tronditur dhe donte ta dinte se si e dinte ai këtë. Në këtë moment, K5 nuk e dinte se i biri i tij ishte paralajmëruar për mbërritjen e R.D. Kur ai i fishkëlleu atij për herë të parë, K5 nuk kishte asnjë ide se për çfarë bëhej fjalë.⁴⁹⁶
614. Edhe një herë, K5 konfirmoi se ai kishte mësuar për detajet e vrasjes së R.D. nga polici dhe djali i tij siç pretendonte në pjesën tjetër të dëshmisë së tij.
615. **K4** po ashtu dëshmoi për hollësitë e vrasjes, megjithatë edhe njohuritë e saj nuk janë të drejtpërdrejta, por se ato vijnë nga burime të ndryshme. Sipas saj, N.V. e kishte paralajmëruar S.R. për mbërritjen e R.D.⁴⁹⁷

K5 dhe se si ai mësoi për vrasjen e R.D.

616. Me gjithë dëshmitë e tij të mëhershme se ai lidhur me detajet e vrasjes së R.D. kishte mësuar nga zyrtarët eASHHM-së, K5 dëshmoi se kishte mësuar për këtë sapo ajo kishte ndodhur, rreth orës 22 ose 23 kur S.R. e thirri atë dhe i tha “*rodio se mis, tresla se gora*” (polli miu, u trondit mali). Ata e thoshin këtë sa herë që kryhej ndonjë punë e madhe.⁴⁹⁸
617. Ai nuk e përjashtonte se edhe M.M. mund t’i ketë telefonuar atë natë. Zakonisht, sa herë që ai e kryente një punë, ai gjithmonë kishte ndërmend ta thirrte atë sepse

⁴⁹⁶ 30.09.2015, f. 6 - 7

⁴⁹⁷ 29.06.2015, f. 7 - 12

⁴⁹⁸ 29.07.2015, f. 23

qëllimi i tij ishte të mburrej për gjërat që ai i kishte kryer. Ai e përdorte këtë shprehje “rodio se mis, tresla se gora” (polli miu, u trondit mali”), dhe atë tjetrën “*Pukla Splitska Posta*” (u thye posta).⁴⁹⁹

618. Kur u kthye S.R., ai ia tregoi K5 detajet e vrasjes.⁵⁰⁰ Gjatë marrjes së tërthortë në pyetje, K5 shpjegoi se djali i tij e kishte përshkruar në detaje se si kishte

ngjarë vrasja, duke përfshirë faktin se në një ulëse të veturës së tij gjendeshin 35.000 euro, si dhe momentin kur ai u qëllua. R.D. ishte qëlluar me 27 plumba kur ai kishte dalë jashtë veturës dhe e kishte kyçur atë.⁵⁰¹

619. Në rrjedhën e marrjes së mëtejme në pyetje, K5 dëshmoi se ai “sinqerisht” nuk e dinte nëse S.R. fliste për N.K. kur ai u kthye nga Sarajeva. S.R. nuk i tregoi K5 se ai foli me N.K. kur ai shkoi për ta vrarë R.D.⁵⁰² Pastaj ai u ballafaqua me deklaratën e tij të mëparshme ku ai tha “po, po”, dhe këtë herë ai tha se nuk i kujtohej⁵⁰³

Si mësoi për këtë M.M.

620. **M.M.** dëshmoi se ai mësoi për vrasjen e R.D. nga S.R., i cili e kishte thirrur atë rreth orës 8 të mëngjes dhe i kishte thënë atij që t’i shikonte lajmet, duke mos i dhënë atij më shumë detaje. Atëherë, M.M. ishte në Serbi.⁵⁰⁴ Sipas tij, S.R. kishte

⁴⁹⁹ 29.07.2015, f. 23

⁵⁰⁰ 29.07.2015, f. 24

⁵⁰¹ 30.09.2015, f. 28

⁵⁰² 30.09.2015, f. 35

⁵⁰³ 30.09.2015, f. 35

⁵⁰⁴ 18.05.2016, f. 32, 33

thirrur edhe njerëz të tjerë për t'u treguar atë çfarë ai kishte bërë.⁵⁰⁵ Kur ai e thirri atë, M.M. nuk e dinte se për çfarë ishte fjala, ai e zbuloi vetëm kur e shikoi TV-në.⁵⁰⁶ S.R. nuk i kishte treguar se kush kishte paguar për këtë vrasje dhe pse ai e kishte bërë këtë.⁵⁰⁷ Më vonë, M.M. tha se S.R. po mburrej se ai kishte marrë 100.000 euro për këtë vrasje.⁵⁰⁸ K4 dhe K5 thanë se ai po ashtu kishte marrë disa vetura të përdorura, ndoshta ai ishte Citroen, një veturë mjaft e lirë. S.R. nuk i kishte marrë të gjitha paratë, prandaj ai e kishte marrë një veturë.⁵⁰⁹

621. M.M. u ballafaqua me këtë deklaratë të tij që ai e kishte dhënë më 15 tetor 2009 pasi ishte arrestuar. Gjatë kësaj dëshmie ai tha se S.R. e kishte vrarë R.D., të gjitha negociatat ishin bërë nga M.Os., dhe se ishte bërë me urdhër të M.A.G. dhe të vëllezërve N.K. nga Sarajeva.⁵¹⁰ Në deklaratën e dhënë më 14 tetor 2009 ai kishte deklaruar ndryshe se kjo ishte urdhëruar nga tre vëllezërit Ra. dhe njëfarë M.A.G. Ai nuk ishte në gjendje të shpjegonte se si figuruan këta emra në deklaratën e tij. Ai po ashtu tha se nëse ai do ta akuzonte dikë ai do të përdorte emër të njëjtë gjatë gjithë kohës.⁵¹¹

622. M.M. pohoi se ai nuk kishte dhënë deklaratë, ajo ishte përgatitur që përpara dhe i ishte lexuar atij. Avokati nuk ishte i pranishëm.⁵¹² Ai shpjegoi se kur u arrestua atij i ishte ofruar të bëhej dëshmitar bashkëpunues gjë të cilën ai e kishte refuzuar, deklaratat nga ajo kohë nuk e pasqyronin të vërtetën.⁵¹³

⁵⁰⁵ 18.05.2016, f. 33

⁵⁰⁶ 18.05.2016, f. 33

⁵⁰⁷ 18.05.2016, f. 41

⁵⁰⁸ 19.05.2016, f. 30

⁵⁰⁹ 19.05.2016, f. 31

⁵¹⁰ 19.05.2016, f. 23

⁵¹¹ 19.05.2016, f. 24

⁵¹² 19.05.2016, f. 5

623. Ai e nënvizoi se ai asnjëherë nuk kishte folur me askë për vrasjen e R.D. Ai e pranoi se si serb ai mund të ketë disa arsye të dëshmojë kundër shqiptarëve por se ai nuk e njihte N.K., asnjëherë nuk kishte dëgjuar për të.⁵¹⁴
624. Ndodhte që ai të vizitonte shtëpinë e S.R., ai asnjëherë nuk diskutonte për ndonjë nga aktet kriminale me prindërit e tij.⁵¹⁵ Ai e njihte N.V., ai e dinte se ishte përmendur nga K4 dhe K5 si pjesëmarrës në vrasjen e R.D.⁵¹⁶
625. M.M. e pa vendin ku ishte vrarë R.D. kur ai erdhi në Sarajevë për t'u takuar me mikun e tij An.Ku. Ai donte ta verifikonte rrëfimin që atij ia kishte treguar S.R.⁵¹⁷ Të vetmen njohuri që ai kishte për vrasjen e R.D. e kishte nga S.R. Ai nuk e dinte se cilat rrëfime të treguar nga S.R. dhe prindërit e tij ishin të vërteta.⁵¹⁸
626. M.M. ishte liruar nga akuza e pjesëmarrjes në grupin e Shabacit. Ai ishte dënuar nga gjykata e Kroacisë për grabitje të postës së Splitit. Ai e pranoi se këtë e kishte kryer me S.R.⁵¹⁹
627. Ai u ballafaqua me pretendimet e S.T., K4 dhe K5 se ai ishte përfshirë në vrasjen e RD, dhe tha se kjo ishte krejtësisht gënjeshtër.⁵²⁰

K4 dhe si mësoi ajo për vrasjen e R.D.

⁵¹³ 19.05.2016, f. 10 - 11

⁵¹⁴ 18.05.2016, f. 41

⁵¹⁵ 18.05.2016, f. 42

⁵¹⁶ 18.05.2016, f. 42

⁵¹⁷ 19.05.2016, f. 25

⁵¹⁸ 19.05.2016, f. 35

⁵¹⁹ 19.05.2016, f. 12-13

⁵²⁰ 19.05.2016, f. 517-18

628. **K5** dëshmoi se ai nuk e dinte se si gruaja e tij kishte mësuar për vrasjen, ndoshta ajo e kishte dëgjuar këtë. Kur kjo ndodhi, ajo u tërbua. Ai nuk e dinte se kur kishte ndodhur kjo, ndoshta atëherë kur ai personi i solli paratë.⁵²¹
629. Gjatë dëshmisë së saj në shqyrtimin gjyqësor, **K4** pohoi se për vrasjen e R.D. asaj i kishte treguar djali i saj. Ai po fliste me K5 dhe i tha se ai e kishte kryer këtë vrasje me urdhër të M.Os. Ai nuk kishte përmendur ndonjë emër por vetëm kishte thënë se ai e kishte një mbështetje në Sarajevë.⁵²² Ajo e kishte dëgjuar vetëm një pjesë të bisedës. Më vonë, në po të njëjtën ditë S.R. i kishte treguar asaj shkurtimisht se çfarë kishte ndodhur por pa detaje dhe pa emrat e njerëzve të përfshirë.⁵²³
630. Në rrjedhën e dëshmisë së mëtejme, K4 e ndërroi mendjen dhe tha se për detajet e vrasjes kishte dëgjuar nga S.R. dhe N.V. Djali i saj ia kishte treguar asaj detajet gjatë bisedës së tij të parë.⁵²⁴
631. K4 u ballafaqua edhe me një pjesë tjetër të deklaratës së 24 shtatorit 2014 kur ajo u pyet për atë se si e dinte ajo për vrasjen e R.D. Atëherë ajo tha *“menjëherë pas vrasjes kur erdhi S.R., ndoshta ishte një ose dy ditë pas kryerjes së krimit kur ai u kthye nga Bosnja. Mandej M.Os. erdhi me vëllain e tij B.Os. dhe i solli paratë në qese, çfarë unë nuk dija deri (ata⁵²⁵) dolën, ata shkuan në shtëpinë e tretë që gjendet në ngastrën e tokës në të cilën gjenden 3 ndërtesa.”*⁸²⁹ Nga kjo deklaratë rrjedh se ajo mësoi për vdekjen e R.D. vetëm pasi M.Os. dhe vëllai i tij ia sollën paratë S.R. Sipas K4, ishte hera e dytë që ajo kishte dëgjuar për këtë rast. Ajo e

⁵²¹ 29.07.2015, f. 24

⁵²² 29.06.2015, f. 3 - 4

⁵²³ 29.06.2015, f. 21 - 22

⁵²⁴ 29.06.2015, f. 22

⁵²⁵ Është shtuar duke e krahasuar me transkriptin në serbisht të marrjes në pyetje të mbajtur më 24 shtator 2014

⁸²⁹ Faqe 2 të transkriptit në anglisht të marrjes në pyetje të mbajtur më 24 shtator 2014

shpjegoi këtë kundërthënie duke thënë se me siguri ajo nuk ia kishte treguar prokurorit se ajo kishte mësuar për këtë nga biseda ndërmjet S.R. dhe K5 për arsye se kjo nuk ishte e rëndësishme për të.⁵²⁶ Më vonë, ajo pohoi se ishte logjike që S.R. erdhi i pari dhe i tregoi asaj.⁵²⁷

632. Në dëshminë e saj nga viti 2014 ajo ishte konsekuente se për vrasjen ajo kishte mësuar vetëm kur u sollën paratë, ndërsa para gjykatës ajo tha se ajo kishte mësuar për të nga biseda që kishte dëgjuar ndërmjet S.R. dhe K5.⁵²⁸

633. Kur ajo dëshmoi në Beograd, K4 tha se *“ai nuk na tregoi se përmes cilëve njerëz, ai tha vetëm se M.Os. kishte disa lidhje të cilët e kishin urdhëruar këtë vrasje dhe disa ditës pasi Strahinjes iu dhanë këto 100 000, pas kryerjes së vrasjes që M.Os. ...”*⁵²⁹

634. Gjatë marrjes së tërthortë në pyetje, K4 pohoi se ajo i kishte dëgjuar ata sepse ata po flisnin me zë të lartë. Ajo nuk pyeti se kush kishte paguar për vrasjen. Emri i N.K figuroi si personi kryesor i cili e urdhëroi vrasjen. Ajo nuk foli me S.R. për këtë, ai e dëgjoji atë duke folur me K5 dhe M.Os. Ajo nuk e kishte dëgjuar asnjëherë S.R. duke folur me K5 për këtë.⁵³⁰

635. K4, në dëshminë e saj të dhënë në vitin 2014, kur u pyet për motivin për të vrarë R.D., ajo tha se ai dhe N.K. ishin takuar papritur në trafikimin e narkotikëve. Ajo shpjegoi se ishte përfundimi i saj, se ose ishte konflikt që lidhej me shpërndarje të

⁵²⁶ 28.07.2015, f.32

⁵²⁷ 28.07.2015, f.33

⁵²⁸ 28.07.2015, f.34

⁵²⁹ 27.07.2015, f. 39

⁵³⁰ 27.07.2015, f. 23

drogës, ose ai ishte pengesë për N.K.⁵³¹ Ajo pohoi se ajo kishte dëgjuar në shtëpinë e saj se R.D. kishte qenë pengesë, tashmë pas vrasjes. Ajo nuk ia përmendi këtë prokurorit, sepse me K5 ata vendosen se ata do të duhej ta thoshin këtë këtu.⁸³⁶

636. Një dëshmitar tjetër i cili e përmendi S.R. si kryes të vrasjes së R.D. ishte **S.Ro.**

637. Ai mësoi për vdekjen e R.D. nga mediat. Ishte në qershor të vitit 2007, atij i kujtohej muaji pasi që në atë kohë kishte lindur vajza e tij.⁵³² Ai dëshmoi se ndoshta një muaj pas vdekjes së R.D. ai e kishte marrë A.V. dhe një person me pseudonimin “Se.” në Rr. Aziz Serbegovic dhe i kishte çuar ata deri në Vrace, afër Sarajevës, ku jetonte D.Z. Ata po diskutonin për S.R. dhe përfshirjen e tij të pretenduar në vdekjen e R.D.⁵³³ Kur po ktheheshin nga Vrace, këtë herë pa “Se.”, A.V. i tha atij se ishin ata personat që e kishin vrarë R.D. Sipas të gjitha gjasave ai po u referohej S.R. dhe “Se.”. A.V. ishte i zemëruar se Da.E. nuk e kishte informuar atë për vrasjen. Ai po ashtu e kishte pyetur S.Ro. nëse ishte ai personi i cili i kishte vozitur vrasësit.⁵³⁴

638. Sipas S.Ro., çdo gjë ndodhi sipas udhëzimeve të Da.E.⁵³⁵ Disa ditë më vonë, S.Ro. kishte mësuar nga El.A. se ka pasur një shkëndijë ndërmjet Da.E. dhe A.V. Ai u kishte treguar atyre se si A.V. ishte zemëruar në Da.E. në lidhje me vrasjen R.D.⁵³⁶

⁵³¹ 28.07.2015, f.35

⁸³⁶ 28.07.2015, f. 26

⁵³² 18.04.2016, f. 5 - 6

⁵³³ 18.04.2016, f. 10-11

⁵³⁴ 18.04.2016, f. 11, 14

⁵³⁵ 18.04.2016, f. 16

⁵³⁶ 18.04.2016, f. 16

639. S.Ro. nuk i kujtohej nëse ai e kishte përmendur emrin e N.K në dëshminë e tij. Kujtesa e tij u rifreskua me deklaratën e dhënë në mars të vitit 2016 ku ai tha: “Të nesërmen E.Ah. më tha se A.V. pas bisedës në veturë me M.M. kishte shkuar në apartamentin ku ishte Da.E. dhe e kishte sulmuar atë pse ai nuk i kishte treguar atij se ai e dinte se S.R. dhe M.M. e kishin likujduar R.D.”. Ai konfirmoi se ai kishte dhënë një deklaratë të tillë. Ai gjithashtu tha se “ai e dinte se S.R. dhe M.M. e kishin ekzekutuar R.D., të cilën Da.E. e konfirmoi se ishte e vërtetë, por se ata e kishin bërë këtë për N.K. e jo për Da.E.”. Ai konfirmoi se ishte shkruar në deklaratë, por se kjo i ishte transferua atij nga El.A. i cili tha se Da.E. e tha këtë.⁵³⁷
640. Emri “M.M.” nuk do të thoshte asgjë për të. Nëse ishte personi me pseudonimin “Se.” atëherë ai e njohte atë.⁵³⁸

E.Ah. – dëshmitar i mbrojtjes

641. Për ta kundërshtuar dëshminë e S.Ro., mbrojtja e propozoi si dëshmitar E.Ah. Ai ishte dënuar me 5 vjet burgim për pjesëmarrje në grupin e organizuar kriminal të Da.E. Vëllai i tij El.A. ishte pjesë e këtij grupi.⁵³⁹
642. Ai e njohte A.V., ata kishin kryer vepra penale së bashku.⁵⁴⁰ A.V. e njohte S.R. Ai kishte bashkëpunuar ngushtë me Da.E.⁵⁴¹

⁵³⁷ 18.04.2016, f. 17

⁵³⁸ 18.04.2016, f. 8

⁵³⁹ 22.07.2016, f. 4

⁵⁴⁰ 22.07.2016, f. 11

⁵⁴¹ 22.07.2016, f. 12

643. E.Ah. e njihte R.D. si komandant legjendar të luftës në BeH. Ai e mohoi çfarëdo lidhje me vrasjen e tij.⁵⁴² Ai nuk e njihte S.R., por kishte dëgjuar për të nga vëllai i tij El.A. Ai e dinte se S.R. ishte i përfshirë në tentim vrasjen e D.Z. dhe ishte plagosur me atë rast. Kjo kishte ndodhur në shkurt ose mars të vitit 2007, S.R. ishte plagosur rëndë me atë rast.⁵⁴³ Da.E. e kishte angazhuar S.R. për ta vrarë D.Z. i cili po ashtu e kishte grupin e tij kriminal.⁵⁴⁴ Sipas tij N.K. nuk ishte përmendur asnjëherë në lidhje me grupin e Da.E.⁵⁴⁵
644. Kur S.R. ishte në Sarajevë, ai i shfrytëzonte dy apartamente në lagjen Malta. E.Ah. e dinte se ai ishte larguar nga Bosnja pasi a ishte plagosur. Me sa dinte ai, ai nuk ishte kthyer më vonë sepse kishte frikë nga D.Z.⁵⁴⁶ Da.E. po ashtu po i ndihmonte S.R. kur ai ishte në Bosnje në atë kohë.⁵⁴⁷ S.R. e njihte S.R.; ai i kishte ndihmuar atij kur ai ishte plagosur gjatë tentim vrasjes së D.Z. ⁵⁴⁸ E.Ah. e dinte këtë vetëm nga vëllai i tij.⁵⁴⁹
645. E.Ah. nuk i njihte N.V., M.M., dhe N.K. Vëllai i tij ose anëtarët e tjerë të grupit nuk e përmendën asnjëherë N.K.⁵⁵⁰ Ai nuk e njihte Z.T. ⁵⁵¹ Ai nuk i njihte N.O., F.R., S.S. dhe S.T.⁵⁵²

⁵⁴² 22.07.2016, f. 7

⁵⁴³ 22.07.2016, f. 7 - 8

⁵⁴⁴ 22.07.2016, f. 20-21

⁵⁴⁵ 22.07.2016, f. 21

⁵⁴⁶ 22.07.2016, f. 9

⁵⁴⁷ 22.07.2016, f. 10

⁵⁴⁸ 22.07.2016, f. 9

⁵⁴⁹ 22.07.2016, f. 14

⁵⁵⁰ 22.07.2016, f. 10

⁵⁵¹ 22.07.2016, f. 12

⁵⁵² 22.07.2016, f. 11, 13

646. Ai mësoi për vrasjen e R.D. nga “Dnevni Avaz” kur shkoi me S.Ro., të nesërmën në mëngjes.⁵⁵³ S.Ro. ia dha atij atë gazetën dhe i tha se R.D. ishte vrarë.⁵⁵⁴
647. Më vonë S.Ro. i tha atij se ai ishte duke u vozitur me A.V. dhe me një person të panjohur i cili i tregoi atij se ai e kishte vrarë R.D. Kjo bisedë kishte ndodhur disa muaj pas vrasjes së R.D. A.V. e tha këtë.⁵⁵⁵ Ky person po e tregonte një armë, Colt, e cila ishte përdorur për ta vrarë R.D.⁵⁵⁶
648. E.Ah. e kishte mohuar çfarëdo përfshirje në vrasjen e R.D.⁵⁵⁷ Ai nuk besonte se kjo ishte bërë nga S.R. ⁵⁵⁸ Vëllai i tij do t’i tregonte nëse kjo do të ishte e vërtetë. Për të R.D. ishte hero.⁵⁵⁹
649. Gjykata konstaton se dëshmia e E.Ah. është besueshme në pjesën në të cilën ajo përkon me deklaratën e S.Ro. Ajo mundëson verifikimin e kredibilitetit dhe të vërtetësisë së dëshmitarit të prokurorisë. Megjithatë, Gjykata konstaton se deklarata e S.Ro. ka pak relevancë për këtë rast.
650. S.Ro. ishte i vetmi dëshmitar në këtë rast i cili e përfshinte Da.E. në vrasjen e R.D. Së treti, dëshmia e tij duhet të vlerësohet si thelbësisht e pambështetshme sepse ai vetëm përsëriste ato që aji kishte dëgjuar nga njerëz të tjerë pa pasur mundësinë për të verifikuar saktësinë e kësaj informate.

⁵⁵³ 22.07.2016, f. 11

⁵⁵⁴ 22.07.2016, f. 15

⁵⁵⁵ 22.07.2016, f. 11

⁵⁵⁶ 22.07.2016, f. 13

⁵⁵⁷ 22.07.2016, f. 15

⁵⁵⁸ 22.07.2016, f. 16

⁵⁵⁹ 22.07.2016, f. 17

Përfundim

651. Versioni i ngjarjeve të paraqitura nga dëshmitari K5 sa i përket mënyrës se si ishte vrarë R.D. në përgjithësi është në pajtim me gjetjet në vendin e ngjarjes të bëra nga hetuesit, rezultatet e autopsisë së R.D. dhe raportet e tjera të ekspertëve që kanë të bëjnë me vrasjen. Megjithatë, dëshmia e tij është përplot mospërputhje sidomos sa i përket mënyrës se si ai kishte mësuar për këtë vrasje dhe asaj gjoja se kush ishte prapa saj.
652. K5 madje pranoi se ai i kishte mësuar të gjitha detajet e vrasjes nga zyrtarët e ASHHM-së. Ky fakt e minon thellësisht kredibilitetin e dëshmisë së tij. Për më tepër, ai e përmendi emrin e N.K dhe të F.R. si përgjegjës për vrasjen e R.D. vetëm në vitin 2014, kështu që menjëherë pasi u vu në dispozicion të publikut aktakuza në këtë rast.
653. Njohuria e tij për këto ngjarje duket se ishin të detajuara dhe gjatë marrjes së tërthortë në pyetje, ai ishte mjaft konsekuent lidhur me rrjedhën e veprimit. Ai madje dëshmoi në një mënyrë që ishte inkriminuese për të, ndonëse u udhëzua në mënyrë të duhur, sepse ai e pranoi se ishte ai personi që e kishte mbushur armën, ai kishte marrë pjesë në negociatat fillestare dhe po ashtu ishte ai i cili u informua menjëherë pasi vrasja ishte kryer. Ai po ashtu pohoi se arma e cila ishte përdorur për ta vrarë R.D. ende ishte në posedim të tij dhe se mbahej në pronën e tij. Në atë fazë të procedurave, Gjykata nuk ishte kompetente për ta urdhëruar kontrollin e objekteve që i përkisnin K5, e sidomos ajo që ndodhej jashtë juridiksionit të gjykatës së Kosovës.

654. Gjykata vërejti se të dy dëshmitarët K4 dhe K5 ishin të vendosur ta bindnin gjykatën se ishte biri i tyre ai i cili e kishte vrarë R.D. Ata madje edhe bënë përshtypjen se ata ishin krenarë për këtë. Në rastin e K5, ai shpesh u referohej arsyeve patriotike.
655. Në anën tjetër, Gjykata ka dëgjuar dëshminë e M.M. i cili konfirmoi se S.R. e kishte informuar atë se ai ishte personi i cili e kishte vrarë R.D. Ai e kishte thirrur atë që t'i shihte lajmet kur u shfaq informata për vrasjen. Ka pasur edhe dëshmitarë të tjerë si S.Ro., i cili po ashtu e drejtonte gishtin kah S.R. si vrasës i R.D.
656. Prandaj, nuk ka prova direkte që do ta vërtetonin se ishte S.R. ai që e ka vrarë R.D. Ky supozim kryesisht bazohet mbi dëshmitë e njerëzve të cilët kishin dëgjuar nga burime të ndryshme se ai ishte personi që e kishte kryer këtë vrasje. Gjykata konstaton se të vërtetuarit se a kishte ndodhur kështu do të kërkonte veprime hetimore, të cilat janë jashtë objektit të këtij shqyrtimi dhe kompetencës së autoriteteve të Kosovës.
657. Megjithatë, Gjykata duhet të nënvizojë se madje edhe konstatimi se S.R. e ka vrarë R.D. nuk do të ishte e mjaftueshme për të ardhur në përfundimin se kush e kishte organizuar këtë vrasje dhe kush ka paguar për të. Vrasësi nuk ka vepruar i vetëm, por nuk ka prova të mjaftueshme për ta vërtetuar se kush i kishte ndihmuar atij.
658. Më tej, Gjykata nuk e ka gjetur të vërtetuar se persona të tjerë e kanë përmendur K5 dhe K4 se kanë marrë pjesë në këtë ekzekutim. Para së gjithash, njerëzit e

përmendur nga ta si bashkë-kryerës janë dëgjuar gjatë rrjedhës së shqyrtimit gjyqësor, ata e kanë paraqitur versionin e tyre të ngjarjeve dhe e kanë mohuar çfarëdo përfshirje në vrasjen e R.D. Gjykata konstaton se ky mohim nuk ishte vetëm çështje e të drejtës për t'u mbrojtur, por mbështetet nga rrethanat e rastit. Kur e arriti deri te një përfundim të tillë, Gjykata mori parasysh motivimin e K4 dhe K5 të cilët janë në dijeni të shumë aktiviteteve kriminale që ndodhën në pronën e tyre, dhe ata vendosën të dëshmonin vetëm kur djali i tyre kishte vdekur. Ata ishin mjaft të qartë se ata po kërkonin hakmarrje për vdekjen e tij, dhe caqet e tyre fillestare ishin njerëzit që ata i njihnin nga Shabaci (M.Os., vëllai i tij të cilin ata e quanin “Bg.”, M.M., M.J.K. dhe L.B.C.).

659. Gjykata vlerësoi se K4 dhe K4 nuk kanë pasur asnjë njohuri lidhur me personin ose personat që kishin urdhëruar dhe paguar për vrasjen e R.D. Deklaratat e tyre në të cilat ata sugjeronin se ishte N.K., i ndihmuar nga njerëz të tjerë të përmendur nga ata, janë përplot me mospërputhje dhe kundërthënie, si të jashtme ashtu edhe të brendshme. Është simptomatike se gjatë dëshmive të tyre të dhëna në vitin 2014 ata nuk e kishin përmendur N.K. në këtë kontekst.

3.24. Marrja e informatave për vrasjen e R.D. në Sarajevë

Sipas aktakuzës:

S.T. kishte marrë një mesazh SMS nga F.R. natën e vrasjes, ku e njoftonte atë se R.D. ishte vrarë. Ajo e kishte marrë këtë mesazh me SMS si një paralajmërim që të mos i thoshte asgjë policisë nëse ata e kontaktonin e meqë ajo kishte dijeni për komplotin për të vrarë R.D.

3.24.1. Si mësuan S.T.ët për vdekjen e R.D.

660. Analiza e provave të paraqitura në lidhje me momentin kur S.T. dhe Z.T. mësuan për vdekjen e R.D. çon në përfundimin se ata u informuan për këtë ngjarje pak kohë pasi ndodhi ajo.
661. Përfundimi i tillë rrjedh nga deklarata e Z.T. e dhënë gjatë ditës së parë të dëshmisë së tij gjatë marrjes së drejtpërdrejtë në pyetje kur ai nuk kishte dyshime se ishte informuar për vdekjen e R.D. pak kohë pasi ndodhi ajo. Ai pohon se atij nuk i kujtohet se kush ia kishte përcjellë këtë mesazh, por me gjasë atë e kishin thirrur në telefon. Ai po ashtu shtoi se ai e informoi S.T. për këtë dhe se ata të dy ishin të hutuar me këtë situatë. Përveç tjerash, ai dëshmoi se kishte marrë një mesazh sms lidhur me këtë nga F.R. një orë më vonë. Duke marrë parasysh se R.D. ishte vrarë rreth 23.30 dhe S.T. e kishte marrë këtë mesazh në orën 00.33, kjo e vërteton në mënyrë shtesë dëshminë e Z.T. se ai kishte mësuar për vdekjen e R.D. gati menjëherë pasi ajo kishte ndodhur.
662. Dëshmia e Z.T. në këtë pjesë po ashtu mbështetet nga deklarata e K1 i cili nuk kishte dyshime se Z.T. e kishte informuar atë për vdekjen e R.D. pak kohë pasi ajo kishte ndodhur. Madje K1 shtoi se Z.T. ishte aq i lumtur për vdekjen e tij sa që ai po thirrte në telefon shumë njerëz për t'ju bërë të ditur. Çfarë është e rëndësishme, Z.T. e konfirmoi se ai dhe K1 ishin miq.
663. Ishte e dukshme se gjatë rrjedhës së marrjes së mëtejme në pyetje të mbajtur në ditët pasuese, Z.T. u përpoq të tërhiqej nga deklarata e tij kategorike për momentin se si ka mësuar për vdekjen e R.D. Ai pretendon se atij nuk i kujtohet

se kur ishte informuar, nëse ishte gjatë natës ose ndoshta në mëngjes, nëse ishte ai që e mësoi i pari apo S.T. Gjykata e gjen këtë sjellje si hutim i shtirur të dëshmitarit i cili e kuptoi se dëshmia e tij e parë mund të jetë e dëmshme për të ose njerëzit e tij të afërm dhe ai po përpiquej me dëshpërim ta dobësonte efektin e saj.

664. Gjykata i vlerësoi si të pambështetshme pretendimet e S.T. se ajo dhe Z.T. e njihnin K1 vetëm në mënyrë sipërfaqësore. Fakti se K1 po punonte së bashku me Z.T. rrjedh jo vetëm nga dëshmitë e tij por mbështetet nga deklaratat e dëshmitarëve të tjerë në këtë rast të cilët kanë dëshmuar në lidhjet me akuzat për drogë. Përveç tjerash, deklarata e saj është në kundërtënie me dëshminë e Z.T. i cili konfirmon se ata tre ishin miq.
665. Si pasojë e këtyre gjetjeve, Gjykata e vlerësoi dëshminë e S.T. duke iu referuar momentit kur ajo mësoi për vdekjen e R.D. si jo kredibile. Para së gjithash, deklarata e saj se ajo kishte mësuar për këtë vetëm në mëngjes rreth orës 8.00 është në kundërtënie me dëshmitë e Z.T. dhe K1. Së dyti, S.T. shpesh e nënvizonte se ajo ishte gazetare profesionale dhe e përkushtuar për të cilën ishte shumë me rëndësi për të publikuar lajmet si e para. Prandaj, do të ishte e paarsyeshme për të që ta shkyçte telefonin për tërë natën.
666. Provat e paraqitura në këtë shqyrtim nuk e mundësojnë vërtetimin përtej dyshimeve të arsyeshme ku po qëndronin S.T. dhe Z.T. në momentin kur ata mësuan për vdekjen e R.D. Si rrjedhojë S.T. dëshmoi se të dy ata ishin në shtëpi, dhe se atje ishte edhe nëna e saj e cila ishte larguar më herët. Fillimisht Z.T. tha se kishte qenë vetëm; pastaj ai ndërroi mendje dhe dëshmoi se ai ishte me S.T. por në shtëpinë e tij në Grbavicë. Ky element ishte relevant për të dy ata pasi që më vonë S.T. i dha alibi Z.T. për natën e vrasjes së R.D. sepse ajo pretendonte

se ata ishin së bashku në atë kohë.

667. Është interesante, K5 ishte dëshmitari i vetëm i cili e përmendi edhe

“Grbavicën”, pa ndonjë shpjegim dhe pyetje për këtë.

B.B.: Ju e përmendët Grbavicën; a ishte ai vendi ku ai u ekzekutua, në Grbavicë?

K5: Nuk e di, duhet të jetë në periferi të qytetit, por unë i dua sportet dhe i përcjell këto ngjarje.

B.B.: Dhe pse e përmende Grbavicën pasi që kjo nuk ka të bëjë asgjë me vrasjen e R.D.?

K5: A ka ndonjë lidhje?

B.B.: Pse e përmende atë?

K5: Unë thashë se i di detajet e periferisë së Sarajevës ku gjenden fushat e sportit.⁵⁶⁰

Përveç tjerash, gjatë marrjes së tërthortë në pyetje, K5 tha se sipas të gjitha

gjasave R.D. ishte vrarë nga Z.T.⁵⁶⁶

668. ⁵⁶¹Sipas **K1**, Z.T. nuk ishte në raporte të mira me R.D., ata ishin kundër njëri-tjetrit. Z.T. po sillte njerëz në Sarajevë për ta vrarë R.D. Ai mori me qira një apartament për ta afër spitalit ushtarak ku ata po qëndronin. Ai, M.L. nga Bosnja, një person i cili kishte kryer vrasje për Z.T.⁵⁶²dhe një person tjetër nga Serbia.

⁵⁶⁰ 30.09.2015, f. 29

⁵⁶¹ 29.09.2015, f. 10

⁵⁶² 10.11.2016, f. 8

Ishin 4 persona në apartament.⁵⁶³ Ata ishin sjellë në fund të vitit 2006.⁵⁶⁴ K1 dëshmoi po

ashtu se në fillim të vitit 2007, Z.T. kërkoi nga M.To. dhe Em.H. që të angazhonin njerëz të aftë për ta vrarë R.D.⁵⁶⁵

669. Sipas K1, Z.T. ishte përpjekur ta vriste R.D. disa herë, vazhdimisht. Ai madje kishte pasur një grindje me S.T. për këtë. K1 ishte i pranishëm atëherë.⁵⁶⁶ Kur u pyet për kornizën kohore kur Z.T. u përpoq ta vriste R.D., ai shmangu një përgjigje të qartë por K1 tha se apartamenti ku këta njerëz qëndruan ishte marrë me qira në vitin 2006 dhe 2007.⁵⁶⁷

670. K1 pohoi se Z.T. kishte frikë nga R.D., për shkak të parave që ata kishin marrë nga N.K. Ai po përpiqje ta vriste atë deri në vdekjen e tij. Ai dëshironte ta vriste atë për shkak se ai kishte frikë nga R.D., ai ishte në marrëdhënie me S.T., për shkak të parave, dhe ai kishte shumë arsye për ta bërë këtë gjë.⁵⁶⁸ K1 nuk kishte dëgjuar asnjëherë se R.D. donte ta vriste Z.T.⁵⁶⁹

671. **M.L.**, po ashtu i thirrur si dëshmitar në këtë rast, refuzoi të dëshmonte.

Përmbledhje e provave relevante

672. **S.T.** dëshmoi se natën e vrasjes së R.D, në orën 0.33 ajo kishte marrë një mesazh sms nga F.R. ku thuhej se *“Dikush e ka vrarë R.D.”*⁵⁷⁰. Ajo e lexoi këtë mesazh

⁵⁶³ 09.11.2016, f. 39-40

⁵⁶⁴ 09.11.2016, f. 41

⁵⁶⁵ 09.11.2016, f. 40

⁵⁶⁶ 09.11.2016, f. 40

⁵⁶⁷ 09.11.2016, f. 40

⁵⁶⁸ 09.11.2016, f. 41 - 42

⁵⁶⁹ 09.11.2016, f. 41;

⁵⁷⁰ 19.03.2015, f. 921; f. 362 – 363

vetëm në mëngjes, pasi që gjatë natës telefoni i saj ishte i shkyçur. Gjatë natës, ajo ishte në shtëpinë e saj me Z.T. Më herët, atje ishte edhe nëna e saj me ta por ajo ishte larguar sepse ajo jetonte aty afër.⁵⁷¹

673. **Z.T.** dëshmoi se me sa i kujtohej ai ishte në shtëpinë e tij kur ndodhi vrasja e R.D. Ai ishte vetëm por nuk i kujtohej me siguri.⁵⁷² Ai ishte i informuar për vrasjen një orë më herët se S.T., rreth orës 23.00, me gjasë dikush e kishte thirrur atë. Ai menjëherë i tregoi S.T. për këtë. Ata të dy ishin të hutuar. Sipas tij, S.T. mori një mesazh nga F.R. rreth mesnatës. Ai nuk ishte i sigurt nëse ai e kishte thirrur atë ose i kishte dërguar një SMS, megjithatë më vonë ai tha se kur F.R. e thirri atë ajo i tregoi atij se ajo tashmë e dinte. Më vonë ai deklaroi se ai në atë kohë ishte në shtëpinë e tij në Grbavicë, me gruan e tij S.T.⁵⁷³

674. Kur u pyet për këtë moment gjatë marrjes së tërthortë në pyetje, Z.T. nuk ishte i sigurt se cili kishte mësuar i pari për vrasjen e R.D., ai apo S.T. Megjithatë, ai konfirmoi se ai kishte marrë shumë thirrje telefonike në atë kohë, nuk ishte i sigurt nëse kjo ishte gjatë natës apo në mëngjes. Ishte e mundur që ajo të kishte mësuar e para, dhe pastaj ai. Ai nuk donte ta shpjegonte pse ai e kishte paraqitur këtë fakt ndryshe gjatë marrjes së drejtpërdrejtë në pyetje. Ai nuk ishte i sigurt se ajo ishte thirrur nga F.R. Ai merrte telefonata gjatë natës. Ai e pranoi se ai kishte diskutuar për këtë vrasje me të po atë natë, në shtëpi. Kur u pyet më tej, ai u

⁵⁷¹ 19.03.2015, f. 13;

⁵⁷² 17.06.2015, f. 3 - 4

⁵⁷³ 17.06.2015, f. 8 - 9

tërhoq nga kjo duke thënë se kjo bisedë mund të ketë qenë atë natë apo në ndonjë tjetër.⁵⁷⁴ Ai nuk ishte në gjendje të jepte përgjigje të qartë se kur u informua për vrasjen e R.D., nëse ishte natë, të nesërmen në mëngjes, ditën tjetër, apo në mëngjesin pas saj. Ai kishte marrë shumë thirrje telefonike, ai nuk e dinte se kush e kishte thirrur atë i pari. Ai e shpjegoi se ai mori disa telefonate sepse ky ishte lajm.⁵⁷⁵

675. Kur po dëshmonte në ditën e 3-të, gjatë marrjes së tërthortë në pyetje, ai tha se sipas mendimit të tij, F.R. ishte i pari që e kishte thirrur në telefon gruan e tij.⁵⁷⁶ Më vonë ai tha se mendon se S.T. e mori sms-in e para.⁵⁷⁷

676. **S.T.** pohoi se ajo e trajtoi mesazhin nga F.R. si paralajmërim sepse me siguri ai ishte i bindur se dikush nga policia do të kontaktonte me të, ndërsa ajo nuk ishte në dijeni se R.D. do të vritej pikërisht atë natë. Kështu që, ai e dërgoi këtë ashtu që ajo të ishte në dijeni dhe se ajo duhet ta mbante gojën e mbyllur.⁵⁷⁸ Në parim, F.R. kryesisht komunikonte me telefon, jo me sms.⁵⁷⁹ Ajo e trajtoi atë si paralajmërim sepse sipas saj kishte diçka më të shkruar.⁵⁸⁰

677. Kur u mor në mënyrë të tërthortë në pyetje ajo pohoi se ishte i vetmi sms të cilin ajo e kishte marrë atë natë. Në mëngjes ajo dhe burri i saj ishin thirrur në telefon nga shumë njerëz të cilët donin ta informonin atë për këtë vrasje.⁵⁸¹ Ajo po ashtu

⁵⁷⁴19.06.2015, f. 30-32

⁵⁷⁵ 22.06.2015, f. 9

⁵⁷⁶ 22.06.2015, f. 7 - 8

⁵⁷⁷ 22.06.2015, f. 10

⁵⁷⁸ 16.05.2015, f. 27

⁵⁷⁹ 23.03.2015, f. 5

⁵⁸⁰ 19.03.2015, f. 12

⁵⁸¹ 16.05.2015, f. 29 - 30

shtoi se ajo nuk kishte marrë mesazhe sms për vrasje të tjera ose vepra penale. Shpesh ndodhte që ajo e informonte F.R. lidhur me ngjarje kriminale interesante duke i dërguar atij mesazhe sms. Pastaj ai përgjigjej me sms, ajo çfarë ishte në kundërtënie me deklaratën e saj të mëparshme për mënyrën se si ata komunikuan. Synimi i këtij shkëmbimi ishte që të jesh i pari me informatën e publikuar. Nganjëherë ndodhte që ajo vihej personalisht në kontakt me një gazetar kujdestar.⁵⁸²

678. **Z.T.**, kur u mor në mënyrë të tërthortë në pyetje, u pyet nëse ata e kishin diskutuar me S.T. se ata duhet të rrinin të heshtur në lidhje me atë se kush e kishte vrarë R.D. Ai u përgjigj se ata në të vërtetë nuk e dinin se kush kishte marrë pjesë në të. Ata nuk e dinin se kush ishin vrasësit.⁵⁸³ Një moment më vonë, ai e ndërroi mendjen dhe tha se ai e dinte se kush qëndronte prapa vrasjes: L., F.R., D.B..⁵⁸⁴

679. Z.T. e pranoi se F.R. komunikoi përmes sms me S.T. gjë që sipas tij nuk ishte e pazakonshme sepse gazetarja e informoi atë. Në këtë rast, ai donte t'i jepte S.T. informatën.⁵⁸⁵

680. **K1** dëshmoi se ai ishte i informuar për vdekjen e R.D. pak kohë pasi kishte ndodhur ajo, së pari nga Z.T. dhe pastaj nga E.Ke. Z.T. e thirri atë në telefon kur K1 ishte në spital ku ai po merrte një infuzion. Atij nuk i kujtohej koha e saktë

⁵⁸² 16.05.2015, f. 27 - 28

⁵⁸³ 22.06.2015, f. 9

⁵⁸⁴ 22.06.2015, f. 10

⁵⁸⁵ 22.06.2015, f. 9

por ishte natë. Z.T. e thirri atë sepse ai nuk ishte në raporte të mira me R.D.⁵⁸⁶

681. K1 mendon se Z.T. nuk i tregoi se kush e kishte vrarë R.D., ai vetëm tha se ai ishte vrarë.⁵⁸⁷ Atij nuk i kujtohet se kur e kishte thirrur Z.T. Është e mundur që ishte ora 11.30 – 00.00. Ai nuk mendon se Z.T. e tregoi atij se ku ishte ai në atë kohë.⁵⁸⁸ Z.T. e thirri atë për ta informuar se ishte i lumtur që R.D. ishte i vdekur, dhe se ai nuk duhej të kishte frikë nga ai. Ai i thirri të gjithë për ta ndarë lumturinë e tij.⁵⁸⁹
682. S.T. pohoi se ajo e njohte K1 vetëm në mënyrë sipërfaqësore si dëshmitar që kishte dëshmuar kundër burrit të saj. Sipas saj, ai punonte me N.K. në biznesin e tij të drogës.⁵⁹⁰ S.T. dhe Z.T. u ishte afruar në shumë raste K1 që donte t'i bënte ata miq. Ajo nuk donte të afrohej me të sepse ai po merrej me drogë. Nganjëherë ata ndërhyjnë kur ai e keqtrajtonte gruan e tij.⁵⁹¹
683. Z.T. konfirmoi se K1 ishte miku i tij dhe i S.T. Ai i vizitonte ata në shtëpi. Z.T. ishte shoqëruar në dasmën e K1. K1 dëshmoi në gjykimin e Z.T. por ai nuk e kishte thënë të vërtetën.⁵⁹²

3.24.2. Si kishin mësuar njerëzit e tjerë për vrasjen e R.D.

684. F.R. dëshmoi se ai ishte i informuar për vrasjen nga dikush në telefon. Ishte viti 2007, rreth mesnatës. Ai u dërgoi sms njerëzve përgjegjës për shtypjen e gazetave (ky proces bëhet ndërmjet orës 23.00 dhe 3.00), kështu që ai e informoi

⁵⁸⁶ 09.11.2016, f. 39

⁵⁸⁷ 09.11.2016, f. 44

⁵⁸⁸ 09.11.2016, f. 42

⁵⁸⁹ 09.11.2016, f. 44 - 45

⁵⁹⁰ 20.04.2015, f. 21

⁵⁹¹ 20.04.2015, f. 24

⁵⁹² 19.06.2015, f.19-21

redaktorin e rubrikën e krimit të gazetave ditore, redaktorin e të përditshmëve, redaktorin e Express-it. Ai i dërgoi sms edhe S.T. sepse Express duhej të botohej të nesërmen. Sipas tij R.D. ishte vrarë të mërkurën, ndërsa Express-i është botuar të enjten. Ndodhi që ishte tepër vonë, gazetat tashmë ishin shtypur dhe shpërndarë.⁵⁹³

685. Përveç S.T., atij i kujtohej emri i redaktorit të rubrikës së krimit në AVAZ – R.Lub.⁵⁹⁴ Ai konfirmoi se e kishte thirrur në telefon S.T. për ta informuar atë për disa krime nëse ishte para se të redaktohej Express-i.⁵⁹⁵

686. **N.O.** dëshmoi se natën kur u vra R.D., ai ishte në shtëpinë e tij verore në Olovo. Për vdekjen e tij ai mësoi nga gazeta.⁵⁹⁶ Ai nuk e dinte nëse ishte takuar me S.T. pas vrasjes së R.D.⁵⁹⁷

687. **Ek.L.** për vdekjen e R.D. mësoi nga gruaja e tij. Ajo i tregoi atij rreth orës 11 të paradites pasi ai u zgjua nga gjumi. Ai nuk kishte shkuar në varrimin e tij për shkak se ata nuk ishin aq të afërt. Ai nuk kishte botuar ndonjë njoftim për vdekjen e tij.⁵⁹⁸ Ai nuk kishte parë dikë t'i priste me gërshërë njoftimet për vdekje. Asnjëherë nuk i kishte shkuar ndër mend diçka e tillë.⁵⁹⁹

688. **S.S.** për vdekjen e R.D. mësoi nga media, ishte në vitin 2007, atij nuk i kujtohej

⁵⁹³ 28.10.2016, f. 33

⁵⁹⁴ 28.10.2016, f. 34

⁵⁹⁵ 28.10.2016, f. 34

⁵⁹⁶ 22.07.2016, f. 39

⁵⁹⁷ 22.07.2016, f. 39

⁵⁹⁸ 19.07.2016, f. 29, 40

⁵⁹⁹ 19.07.2016, f. 30

se në cilën pjesë të vitit.⁶⁰⁰

689. Prokurori nuk kishte dhënë asnjë provë të besueshme për t'i demantuar pretendimet e dëshmitarëve sa i përket momentit kur ata mësuan për vdekjen e R.D. Prandaj, Gjykata i gjeti ato si të vërteta dhe të besueshme.

3.25. Arrestimi i Z.T. dhe lirimi i tij

690. Gjykata e konstatoi si të vërtetuar se Z.T. ishte arrestuar në lidhje me vrasjen e R.D., por ai ishte liruar sepse S.T. i kishte dhënë atij alibinë me pretendimin se në natën e vrasjes ata ishin së bashku.

Përmbledhje e provave relevante

691. S.T. dëshmoi se një ditë pas vdekjes së R.D., Z.T. ishte arrestuar nga policia me qëllim që të jepte deklaratën lidhur me atë se çfarë ishte duke bërë ai gjatë kohës së vrasjes. Ai tregoi se ishte me të dashurën e tij, por ai refuzoi ta jepte emrin e saj. Pas kësaj interviste, S.T. e kishte thirrur Shefin e Departamentit Penal në Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe ajo e pyeti atë nëse ishte e mundur që prokurori ta intervistonte Z.T. në të njëjtën ditë.⁶⁰¹

692. Ajo ishte thirrur në telefon nga prokurori Cavka dhe ishte pyetur nëse ajo kishte qenë me Z.T. gjatë kohës kur ishte vrarë R.D. Ajo e konfirmoi.⁶⁰²

693. Gjatë marrjes së tërthortë në pyetje, ajo shtoi se ajo e thirri P.Ku. për ta pyetur atë nëse Z.T. do të merrej në pyetje menjëherë. Z.T. nuk donte ta vinte atë në rrezik,

⁶⁰⁰ 07.12.2016, f. 8

⁶⁰¹ 19.03.2015, f. 16

⁶⁰² 19.03.2015, f. 14, f. 21, 23.03.2015, f. 23; 13.05.2015, f. 7; 18.05.2015, f. 4 5

⁹⁰⁸ 13.05.2015, f. 5 - 6

ai pretendonte se ai e njihete atë vetëm zyrtarisht.⁹⁰⁸ Z.T. e kaloi natën në paraburgim, në mëngjes pas marrjes në pyetje ai u lirua. Asaj nuk i kujtohet të ketë dhënë deklaratë ajo vetë.⁶⁰³

694. **Z.T.** nuk i kujtohej se kur ishte arrestuar në lidhje me vrasjen e R.D. Ai nuk ishte i sigurt nëse ishte të nesërmen në mëngjes apo një ditë apo dy ditë pas kësaj. Ai ishte me S.T. kur policia e ndali atë në një qendër tregtare, rreth orës 18 – 19. Në atë kohë S.T. ishte në veturë.⁶⁰⁴

695. Ai e pranoi se ai ishte marrë në pyetje nga policia. Fillimisht ai tha se gjatë kohës kur kishte ndodhur vrasja ai ishte vetëm në shtëpi, sepse ai nuk donte ta vinte në rrezik S.T., në fund ai tha se ai ishte me të. Ai e pranoi para policit, nuk donte që kjo të vihej në procesverbal. Ai nuk e dinte nëse polici e kishte verifikuar këtë informatë në çfarëdo mënyre.⁶⁰⁵ Gjatë marrjes së tërthortë në pyetje, Z.T. e sqaroi se policia po e verifikonte alibinë e tij, kush ishte ai gjatë natës së vrasjes. Alibia i ishte dhënë atij nga S.T. Ai nuk kishte avokat, ai nuk u dërgua para gjyqtarit hetues.⁶⁰⁶ Në mëngjes ai ishte liruar. Cavka po vinte atje. Pasdite ai u takua me S.T. Ajo ishte e shqetësuar por e kënaqur që ai ishte i lirë.⁶⁰⁷

3.26. Takimi në Radon Plaza pas vrasjes së R.D.

Sipas aktakuzës:

⁶⁰³ 13.05.2015, f. 7

⁶⁰⁴ 17.06.2015, f. 4 - 5

⁶⁰⁵ 17.06.2015, f. 4-6

⁶⁰⁶ 19.06.2015, f. 33

⁶⁰⁷ 23.06.2015, f. 7-8

Pas kthimit në Sarajevë, disa ditë pas vrasjes së R.D., N.K. dhe grupi i tij i organizuar kriminal organizuan një darkë të përbashkët gjatë së cilës u diskutua se si të drejtohej hetimi mbi vrasjen tek persona të tjerë. Elementë të këtyre tentativave për shmangien e hetimit mund të gjenden në prova dhe ato janë denoncuar si të tilla nga dëshmitarë të ndryshëm. Nga ana tjetër, Prokuroria nuk zbuloi ndonjë provë që do të mbështeste zërat për një vrasës tjetër me pagesë që mund ta kishte vrarë R.D. në vend të S.R. Në atë kohë, N.K. dhe pjesëtarët e tjerë të grupit të organizuar kriminal ishin relaksuar së tepërmi lidhur me hetimin në vazhdim e sipër dhe bile ndjeheshin të fuqizuar meqenëse kishin pasur sukses në vrasjen e R.D.

696. Nuk ka prova të besueshme që ta mbështesin deklaratën e S.T. se ndonjë takim i tillë kishte ndodhur fare menjëherë pas vdekjes së R.D. I vetmi person që t'i vërtetojë pretendimet e saj është Z.T. që vetëm kishte dëgjuar për këtë nga ajo, dhe kjo ndodhi vetëm pas arrestimit të tij.
697. Siç është përmendur tashmë më herët, Gjykata nuk e gjen të vërtetuar se “grupi i miqve” siç përshkruhet nga S.T. ka ekzistuar fare.
698. Andaj, Gjykata nuk e gjen të vërtetuar se të nesërmen pas vrasjes së R.D. ka pasur një takim në Radon Plaza me pjesëmarrjen e personave të përmendur që gjoja kanë diskutuar për zhvillimin e situatës, duke përfshirë hetimin në vazhdim në rastin e vrasjes së R.D.

Përmbledhje e provave relevante

699. **S.T.** dëshmoi se dy ditë pas vrasjes (*fillimisht ajo tha se ishte në mëngjesin pas vrasjes*) ka pasur një takim në restorantin Radon Plaza në mëngjes mes orës 10.00 dhe 12.00, N.O., F.R., Ek.L. dhe një mik i N.O. ishin të pranishëm. N.K. ishte në Ulqin. Gjatë këtij takimi prokurorët zbuluan se ajo po takohej me Z.T., çfarë ajo

e kishte fshehur nga ata.⁶⁰⁸

700. Sipas saj, N.O. sugjeroi që hetimet të drejtoheshin kundër Z.T. Ajo i bindi ata që të mos e bënin këtë.⁶⁰⁹ Një “kandidat” tjetër potencial ishte D.Z., një person nga Sarajeva lindore, një mik i N.K, u sugjerua nga ai.⁹¹⁶
701. **Z.T.** dëshmoi se ai dinte për këtë takim nga S.T., ishte në të njëjtën ditë kur ai ishte ndaluar. Gjatë këtij takimi ata e kuptuan se S.T. dhe Z.T. ishin në lidhje. Ata e pyetën atë se sa ndjente ajo për të, ajo tha se mjaft që të mos drejtohej hetimi kundër tij. Ai u lirua, nuk u thirr sërish, nuk u iniciua asnjë hetim kundër tij.⁶¹⁰ Më voni ai ndërroi mendje sepse ai tha se ai vetëm se kishte dëgjuar nga S.T. se ishte një takim gjatë të cilit u diskutua që hetimi të drejtohej kundër dikujt, pa asnjë detaj. Ai madje nuk ishte i sigurt nëse ajo ishte atje, ai vetëm mendonte kësisoj.⁶¹¹
702. Kur u mor në mënyrë të tërthortë në pyetje, Z.T. deklaroi se gjatë këtij takimi të pranishëm ishin: N.K., N.O. dhe Ek.L. Ai mendon se edhe F.R. ishte atje.⁶¹² Ai e konfirmoi këtë sërish gjatë dëshmisë së radhës.⁶¹³ Vetëm kur u ballafaqua me deklaratën e S.T., ai tha se ishte e mundur që N.K. ishte në Ulqin dhe ajo kishte folur me të në telefon.⁶¹⁴

⁶⁰⁸ 19.03.2015, f. 14, f. 21, 23.03.2015, f. 23; 13.05.2015, f. 7; 18.05.2015, f. 4 5

⁶⁰⁹ 19.03.2015, f. 14, 15 -17; f. 21, 23.03.2015, f. 12

⁹¹⁶ 23.03.2015, f. 11

⁶¹⁰ 17.06.2015, f. 7, 22.06.2015, f. 32

⁶¹¹ 17.06.2015, f. 12

⁶¹² 22.06.2015, f. 33

⁶¹³ 23.06.2015, f. 7

⁶¹⁴ 23.06.2015, f. 7

703. Në atë rast, S.T. kishte folur me N.K. (i cili ishte në Ulqin) në telefon. Ajo po përpiquej ta bindte atë se çdo gjë për të cilën ata po bisedonin do të mbetej mes tyre. N.K. ishte zemëruar në të.⁶¹⁵
704. **Z.T.** pohoi se të dy ata kishin shqetësime për jetën e tyre pasi u zbulua lidhja sepse ata e dinin për përfshirjen e N.O., N.K. dhe F.R. në vrasjen e R.D. Z.T. ishte më shumë i brengosur për gruan e tij.⁶¹⁶
705. Gjatë marrjes së tërthortë në pyetje, **S.T.** e pranoi se ajo i kishte treguar burrit të saj për këtë takim vetëm kur ajo u arrestua pasi ajo nuk donte që të thellonte ose krijonte konflikt ndërmjet tij, F.R. dhe N.K.⁶¹⁷
706. **S.T.** pohoi se gjatë këtij takimi F.R., Ek.L., N.O. dhe N.K. e zbuluan se ajo ishte në lidhje me Z.T. Me gjithë faktin se të gjithë këta njerëz e mohuan se kishte ndodhur një takim i tillë fare, ata po ashtu i paraqitën rrethanat se si kishin zbuluar ata se S.T. dhe Z.T. ishin bashkë.
707. Në dëshminë e tij, **F.R.** e quante S.T., ai kryesisht e përdorte mbiemrin e saj të vajzërisë. Ai nuk e dinte se kur ishte martuar ajo me Z.T. Ai mendon se kjo ndodhi pas vdekjes së R.D. sepse ajo u martua pasi ajo e kishte lënë kompaninë e tyre.⁶¹⁸
708. Ai nuk ishte i sigurt se kur kishte mësuar se S.T. është në lidhje me Z.T., me gjasë pasi u martuan ata. Ai mësoi për këtë para se ajo të shkarkohej.⁶¹⁹ Ai asnjëherë nuk ishte prezantuar me Z.T.⁶²⁰ Ai e mohoi të kishte dhënë ndonjë zarf

⁶¹⁵ 19.03.2015, f. 17 – 18, 23.03.2015, f. 23

⁶¹⁶ 17.06.2015, f. 11

⁶¹⁷ 18.05.2015, f. 48

⁶¹⁸ 31.10.2016, f. 19

⁶¹⁹ 31.10.2016, f. 20

⁶²⁰ 31.10.2016, f. 24

për Z.T. përmes S.T.⁶²¹

709. **N.O.**dëshmoi se ai kishte pirë kafe me S.T. dhe ajo i kishte thënë atij se ajo kishte gjetur dashurinë e jetës së saj – Z.T. Ai ishte i shokuar sepse ai e konsideronte atë si një femër me moral. N.O. nuk ishte i sigurt se kur saktë kishte mësuar për këtë, por ai shpjegoi se ai besonte se ishte para vdekjes së R.D. sepse kur ai mendonte se kush mund ta kishte vrarë R.D., Z.T. i erdhi në mend për shkak të xhelozisë së tij për S.T.⁶²²
710. N.O. nuk e kishte ndarë këtë informatë me askë. Ai ishte i shokuar, nuk mund ta besonte. Më vonë u bë e ditur, dhe madje ishte publikuar se S.T. dhe Z.T. e kishin kaluar natën së bashku kur u vra R.D.⁶²³
711. **Ek.L.** dëshmoi se ai nuk kishte dalë nga shtëpia e tij ditën kur kishte mësuar se ishte vrarë R.D. Ai nuk kishte shkuar në restorantin rrotullues. Ai kishte pasur dhimbje koke atë ditë.⁶²⁴ Ai nuk kishte ardhur atë ditë të takohej me F.R. në zyrën e tij.⁶²⁵ Për të ishte e pazakontë të zgjohej aq vonë. Atij nuk i kujtohej se pse kishte ndodhur kjo, mbase ai kishte pirë tepër shumë. Atij i kujtohej kjo ditë për arsye se kishte fjetur më gjatë.⁶²⁶ Më vonë ai e shpjegoi se një ditë më përpara ai kishte pasur një takim në një klub të quajtur April 92, ku ai i kishte takuar

⁶²¹ 31.10.2016, f. 34

⁶²² 22.07.2016, f. 32

⁶²³ 22.07.2016, f. 33

⁶²⁴ 19.07.2016, f. 30

⁶²⁵ 19.07.2016, f. 38

⁶²⁶ 19.07.2016, f. 31

miqtë e tij (Z.L., R.Ha. dhe J.V.). Ata po pinin prej orës 2 pasdite deri në 9 - 9.30.

Pasi u zgjua nga gjumi, gruaja e tij i tregoi se ishte vrarë R.D.⁶²⁷

712. Ai kishte dëgjuar për lidhjen e S.T. me Z.T., ishte diçka e pazakonshme. Sipas të gjitha gjasave ai tashmë kishte dëgjuar për këtë para vdekjes së S.L.⁶²⁸ Për të ishte jo relevante se S.T. dhe Z.T. ishin në lidhje.⁶²⁹

713. **S.S.** dëshmoi se ai mësoi se S.T. ishte martuar me Z.T. pasi ata ishin martuar.⁶³⁰

714. **N.K.** dëshmoi se ai zbuloi se S.T. ishte bashkë me Z.T. të paktën në vitin 2005, nëse jo më herët. Që nga ajo kohë ai asnjëherë nuk kishte pirë kafe me të, as privatisht, e as në prani të të tjerëve.⁶³¹

3.27. Takimet tjera pas varrimit të R.D.

715. Nuk u vërtetua se kanë ndodhur takimet e përshkruara nga S.T. Edhe një herë, provë e vetme mbështetëse është dëshmia e burrit të saj. Për më tepër, Gjykata gjeti se nuk ka gjasa që kryerësi të organizonte darkë për të festuar vrasjen e dikujt dhe që secilit aty t'ia bënte me dije arsyen.

Përmbledhje e provave relevante

716. Sipas **S.T.**, pas varrimit të R.D., kur N.K. u kthye nga Ulqini, u mbajt takimi tjetër ku morën pjesë ajo, N.O., F.R., N.K. dhe Ek.L. Pastaj njoftimet për vdekjen e R.D. u prenë nga të gjithë atë.⁶³² Gjatë këtij takimi ata po flisnin se

⁶²⁷ 06.12.2016, f. 8

⁶²⁸ 19.07.2016, f. 20

⁶²⁹ 19.07.2016, f. 22-23

⁶³⁰ 07.12.2016, f. 10

⁶³¹ 04.10.2017, f. 16

⁶³² 19.03.2015, f. 24 – 25; eksp. F. 38 - 41

kush do të duhej të vritej me radhë.⁶³³

717. Disa ditë më vonë, u organizua një darkë për të festuar vdekjen e R.D. U mbajt në Restoranin Rrotullues. S.T. nuk ishte e pranishme atje për shkak të obligimeve të tjera të saj. Çdo kush e dinte se për çka ishte darka. Ek.L., N.K., F.R., N.O. dhe disa gazetarë ishin të pranishëm. S.T. i kishin treguar se kush ishte i pranishëm, dhe ishin bërë edhe fotografi gjatë kësaj darke, të cilat ishin publikuar në 'rrjetin e gazetarëve' ku kishin qasje vetëm gazetarët.⁶³⁴
718. Gjatë marrjes së tërthortë në pyetje, ajo dëshmoi se çdo kush e dinte se cila ishte arsyeja e këtij festimi, por qëndronin të heshtur.⁶³⁵ Ajo ishte e ftuar personalisht nga F.R. Ai i kishte thënë asaj që të vinte për darkë. Ajo ishte mjaft inteligjente që ta kuptonte nga mënyra e tij se kjo ishte për shkak të vdekjes së R.D.⁶³⁶ Ajo nuk ishte e sigurt nëse Ek.L. kishte marrë pjesë në këtë takim. Ajo nuk e dinte se me çfarë merrej ai. Ajo nuk e dinte nëse R.D. ishte përzier në biznesin e tij.⁶³⁷⁶³⁸
719. Një version tjetër ishte paraqitur nga Z.T. Sipas tij, kjo darkë u mbajt në restorantin Golf: F.R., N.K. dhe M.Dj. ishin atje. Ai kishte dëgjuar për të nga gruaja e tij e cila nuk ishte atje. Sipas të gjitha gjasave ajo i dinte detajet nga F.R.
- 945

720. **F.R.** e mohoi këtë, dhe nënvizoi se nuk ka pasur arsye për të bërë festë në AVAZ

⁶³³ 19.03.2015, f. 23 - 24

⁶³⁴ 23.03.2015, f. 4; 16.05.2015, f. 30 - 31

⁶³⁵ 16.05.2015, f. 30

⁶³⁶ 16.05.2015, f. 32

⁶³⁷ 22.04.2015, f. 31

⁶³⁸ 22.06.2015, f. 33

për të festuar për vdekjen e R.D.⁶³⁹

721. Për ta mbështetur këtë pretendim, prokuroria paraqiti jo vetëm prova nga Z.T. dhe S.T. por edhe disa njoftime për vdekje për R.D. që ishin gjetur në shtëpinë e N.O.
722. **N.O.** shpjegoi se pse ai i kishte njoftimet për vdekjen e R.D. në shtëpinë e tij. Ai e arsyetoi se ai koleksiononte jo vetëm ato, por edhe artikujt për vdekjen e R.D. sepse ai donte të zbulonte se pse ishte vrarë ai. Si ish-komandant i armatës së Bosnje dhe Hercegovinës, ai kishte frikë për jetën e vet, sepse vdekja e R.D. nuk ishte e vetmja.⁶⁴⁰
723. Gjykata konstatoi se shpjegimi i N.O. për arsyet se pse ai i kishte njoftimet për vdekjen e R.D. është i mbështetshëm.

3.28. Pagesa për vrasjen e R.D.

Sipas Aktakuzës::

S.R. dhe N.V. ishin kthyer në Serbi dhe pas disa ditësh, M.Os. dhe vëllai i tij B.Os. erdhën tek shtëpia e K5 me një çantë plot me të holla dhe i paguan Strahinjës 100,000 euro. N.V. u pagua me 20,000 euro dhe mori edhe një veturë Alfa Romeo. Prindërit e S.R. i kishin parë ata tek vinin tek shtëpia e tyre me të hollat.

724. Për t'i mbështetur pohimet e S.T. sa i përket shumës së parave për vrasjen e R.D. dhe mënyrës së pagesës së tyre, prokurori propozoi dëshmitarët K4 dhe K5. Dëshmitë e tyre do të paraqiten në mënyrë më të detajuar për të treguar se si ato janë zhvilluar dhe ndërruar.

⁶³⁹ 31.10.2016, f. 22

⁶⁴⁰ 22.07.2016, f. 28 – 30, 05.12.2016, f. 26 - 32

725. Mbi bazën e dëshmive të dhëna nga K4 dhe K5 nuk është e mundur të vërtetohet se kush ka paguar, çfarë shume, për çfarë dhe në çfarë mënyre. Ata i ndërronin versionet e tyre në mënyrë të përhershme, shtonin njerëz të rinj si të përfshirë, dhe jepnin shuma të ndryshme të parave ose lloje të shpërblimit. Për më tepër, sipas K5, gruaja e tij K4 nuk kishte qenë asnjëherë e pranishme kur ishte në pyetje çështja e parave. Analiza e dëshmive të tyre çon në përfundimin se ata nuk kanë pasur njohuri të drejtpërdrejtë lidhur me pagesën e pretenduar ndaj S.R. për vrasjen e R.D. Edhe një herë, u bë e dukshme se ata dëshmitë e tyre i bazonin mbi informata të cilat ata i kishin marrë nga burime të ndryshme, përfshirë zyrtarët e ASHHM-së.
726. Përveç tjerash, dëshmitarët e tjerë të cilët siç pretendohet ishin të përfshirë në pagesë e kishin mohuar çfarëdo pjesëmarrje në të dhe ka pretenduar në mënyrë kategorike se ata nuk kishin asgjë të përbashkët me familjen e S.R.
727. Prandaj, Gjykata e gjeti të pavërtetuar se sa, në çfarë mënyrë dhe nga kush u pagua vrasja e R.D. Po ashtu nuk ka prova bindëse për të mbështetur pretendimin se S.R. ishte paguar për këtë vrasje pasi që nuk ishte vërtetuar se ai ishte angazhuar për ta kryer atë.

Përmbledhje e provave relevante

728. **K5** dëshmoi se L.B.C. mori para nga N.K. Pastaj ai ia dha atë M.J.K.⁶⁴¹ Më vonë ai dëshmoi se N.K. e kishte paguar për vrasjen drejtpërdrejt M.J.K. Siç pohohet paratë ishin dhënë nga M.A.G. dhe N.K. Dëshmitari nuk donte të përmendte

⁶⁴¹ 29.07.2015, f.12

emra të tjerë.⁶⁴² Kur ai u mor në mënyrë të tërthortë në pyetje, K5 tha se ai nuk e dinte nëse L.B.C. kishte paguar ndonjë para për vrasjen e R.D.⁶⁴³

729. Sipas K5, S.R. ishte dashur të merrte 200.000 euro por në fund ai mori vetëm 100.000, sepse 100.000 euro ai ia dha M.Os. S.R. po ashtu duhej të merrte një veturë të blinduar sikurse M.Os. Këtë herë ai tha se shuma tashmë ishte përmendur gjatë takimit të parë.⁶⁴⁴

730. Gjatë rrjedhës së marrjes në mënyrë të tërthortë në pyetje, K5 e pranoi se ai vërtet besonte se vrasja ishte paguar me 5.000.000 euro. Kur u pyet për burimin e informatave ai e pranoi se atij i kishin treguar zyrtarët e ASHHM-së.⁶⁴⁵ Kur K5 e kishte përmendur gjatë bisedës me zyrtarin e ASHHM-së shumën prej 600.000, ky i fundit kishte filluar të qeshte. Prandaj, K5 kishte filluar të numëronte: ishin dy vetura të blinduara në shumën prej 400.000, 200.000, dhe 100.000 që biri i tij ia kishte dhënë M.Os. Ishte edhe M.J.K.; prandaj duhet të ketë qenë e përfshirë një shumë më e madhe.⁶⁴⁶ K5 nuk i kujtohej nëse zyrtari SIPA i kishte dhënë atij detaje të tjera të vrasjes. Ai kishte kaluar me të dy ose tre ditë.⁶⁴⁷ Zyrtari i ASHHM-së i kishte treguar atij për vendin e vrasjes, por ai nuk e dinte se N.K. e kishte urdhëruar vrasjen e R.D.⁶⁴⁸

731. Në këtë mënyrë K5 binte në kundërtënie me deklaratën tjetër të tij. kur ai shkoi për të dëshmuar për herë të parë në Beograd, ai nuk tregoi për vrasjen e R.D. sepse avokatët mbrojtës të M.Os. dhe të tjerët ishin të pranishëm. Vetëm kur ai

⁶⁴² 30.07.2015, f. 15

⁶⁴³ 30.09.2015, f. 15

⁶⁴⁴ 29.07.2015, f. 13 - 14

⁶⁴⁵ 29.09.2015, f. 18

⁶⁴⁶ 29.09.2015, f. 19

⁶⁴⁷ 29.09.2015, f. 19

⁶⁴⁸ 29.09.2015, f. 26

erdhi në Sarajevë dhe u takua me prokurorin Dubravko Campara, pastaj ai mori vesh për rastin Ll. Ai tha se ai kishte biseduar me ASHHM-në dhe kishte zbuluar se N.K. ishte bërë bashkë-pjesëmarrësi i 33^{-të} në këtë vrasje.⁶⁴⁹

732. Sipas **K4**, M.Os. kishte përmendur 5.000.000 euro por që ajo nuk e dinte nëse kjo ishte pagesa për këtë vrasje apo për diçka tjetër.⁶⁵⁰ Gjatë marrjes së tërthortë në pyetje ajo e pranoi se ajo nuk e kishte përmendur këtë shumë më parë, por kishte dëgjuar se S.R. dhe M.Os. diskutonim për këtë.⁶⁵¹

733. Të dy **K4** dhe **K5** ishin konsekuent se S.R. nuk kishte marrë ndonjë para në avans. Gjatë rrjedhës së dëshmisë së mëtejme **K5** tha se ai nuk e dinte se për çfarë saktë ishin 200.000. M.Os. i kishte sjellë për disa biznese.⁶⁵²

734. **K5** dëshmoi se S.R. kishte marrë 200.000 euro por 100.000 ai i dha për M.Os.⁶⁵³ Më vonë ai tha se paratë për M.Os. se ato ishin vetëm hua.⁶⁵⁴ **K5** me gjasë ishte i pranishëm atëherë.⁶⁵⁵ Kjo nuk kishte ndodhur në shtëpinë e tyre, por në qytet, ai nuk ishte i pranishëm atje. Atij i kishin treguar S.R. dhe M.Os.⁶⁵⁶ Ai këmbëngulte se S.R. i kishte dhënë M.Os. 100.000 si hua dhe kjo ishte arsyeja e vetme se pse djali tyre ishte vrarë.⁶⁵⁷

735. **K5** e ndërroi mendjen sërish gjatë marrjes së tërthortë në pyetje kur ai tha se S.R.

⁶⁴⁹ 29.09.2015, f. 15

⁶⁵⁰ 29.06.2015, f. 21

⁶⁵¹ 27.07.2015, f. 26

⁶⁵² 29.06.2015, f. 24; 29.07.2015, f. 27

⁶⁵³ 29.07.2015, f. 27

⁶⁵⁴ 29.09.2015, f. 20

⁶⁵⁵ 29.09.2015, f. 22

⁶⁵⁶ 29.09.2015, f. 27

⁶⁵⁷ 30.09.2015, f. 19

kishte marrë afërsisht 450.000 më pak se të tjerët. Ai supozonte se N.V. kishte marrë më shumë. Ai kishte marrë 450.000, dhe S.R. i kishte dhënë atij Alfa dhe 20.000.⁶⁵⁸ Kjo veturë ishte në posedim të të dashurës së N.V.⁶⁵⁹

736. Fakti se N.V. mori Alfa Romeo dhe paratë u konfirmuan nga K4.⁶⁶⁰ K5 dëshmoi më ndryshe sepse ai tha se N.V. e kishte marrë Alfa Romeo nga M.Os.⁶⁶¹

737. K5 kur u përball me informatën se kush e kishte dhënë Alfa Romeo, ai tha se ai nuk ishte duke dëgjuar mirë. M.Os. nuk ishte në gjendje të jepte ndonjë gjë dikujt, ai ishte në burg. Ai asnjëherë nuk kishte pasur Alfa, dhe kjo informatë mund të ketë ardhur nga S.Pr. Ishte gënjeshtër se ai kishte thënë kështu. K5 ishte ai që kishte blerë këtë Alfa.⁶⁶²

738. Në rrjedhën gjatë marrjes së tërthortë në pyetje, K5 nuk e dinte se sa para kishte marrë M.Os. për vrasjen. Ai vetëm e pa se ai kishte blerë AUDI Q7 ose BMW. Ai nxori nga xhepi i tij 110.000 euro. Kur u pyet për sqarim nëse këto para ishin për vrasjen e R.D., K5 tha “po”.⁶⁶³ Një moment më vonë ai tha se ishte M.M. Ai po ashtu nuk ishte i qartë nëse M.M. kishte marrë ndonjë para fare, sepse pak më vonë K5 tha se ai nuk dinte për këtë.⁶⁶⁴

739. Prapë gjatë marrjes së tërthortë në pyetje, kur u pyet përsëri, K5 tha se ai nuk dinte se si i kishte marrë paratë S.R. për vrasjen e R.D., por p.sh., ai kishte fituar një moto-barkë të shpejtë.⁶⁶⁵ Ai pretendon se i kishte parë paratë në çantë. Ai e

⁶⁵⁸ 30.09.2015, f. 5

⁶⁵⁹ 30.09.2015, f. 53

⁶⁶⁰ 29.06.2015, f. 9 – 11, 24

⁶⁶¹ 29.07.2015, f. 32

⁶⁶² 30.09.2015, f. 53 - 54

⁶⁶³ 30.09.2015, f. 8

⁶⁶⁴ 30.09.2015, f. 9

⁶⁶⁵ 30.09.2015, f. 22

dinte se ato ishin për vrasjen e R.D. nga djali i tij. S.R. nuk kishte folur për paratë që ai kishte marrë për vrasjen e R.D. Kur u ballafaqua me deklaratën se ai nuk e dinte se S.R. kishte marrë para për vrasjen e R.D., ai tha se nuk i interesonte.⁶⁶⁶

740. Sipas K5, S.R. kishte marrë para nga M.J.K. Kur u pyet se ku i kishte marrë ato, K5 u përgjigj “ku ta di unë?”⁶⁶⁷.

Mënyra e pagesës

741. **K5** pohon se M.J.K. ia solli 200.000 euro M.Os., siç pretendohet nga N.K. dhe M.A.G.⁶⁶⁸

742. Gjatë marrjes së tërthortë në pyetje, K5 dëshmoi se N.K. ose M.A.G. i kishin dhënë para M.J.K.⁶⁶⁹, një miku të vjetër të familjes K5. Kur u pyet se si dinte ai për këtë, K5 tha “kush tjetër mund t’i kishte ato? L.B.C. nuk do të guxonte sepse ai kishte frikë, M.Os. nuk ishte më i mençuri dhe ai ishte i varur nga droga.”⁶⁷⁰ Kjo ishte ajo çfarë ai kishte dëgjuar në shumë raste. Nuk kishte sekrete, ata ishin si familje. Disa rreshta më poshtë, ai tha se ai nuk ishte anëtar e kësaj familje “kriminale”.Megjithatë, ai e di sepse ai ishte anëtar i ekipit të parë ku kishte djelmosha të këqij, jo si aktualisht.⁶⁷¹

⁶⁶⁶ 30.09.2015, f. 27, 28

⁶⁶⁷ 30.09.2015, f. 28

⁶⁶⁸ 29.07.2015, f. 13

⁶⁶⁹ 29.09.2015, f. 20

⁶⁷⁰ 29.09.2015, f. 20 - 21

⁶⁷¹ 29.09.2015, f. 21

743. Më tej, K5 shpjegoi se ai e mori me mend se shuma e parave ishte mbledhur nga N.O., N.K., M.A.G., dhe me gjasë nga F.R.⁶⁷²
744. Më vonë K5 dëshmoi se M.J.K. po priste që 7 ditë për paratë për vrasjen për shkak se në atë kohë N.K. ishte në bregdet për t'i siguruar alibi vetes së tij. ai nuk e dinte se ku po priste M.J.K., por ai e dinte sepse atij “i pëlqenin sportet”. Ai e mori sinjalin se N.K. ishte kthyer dhe pastaj paratë u mblodhën. Ai e dinte këtë nga M.J.K.⁶⁷³
745. Gjatë rrjedhës së marrjes së mëtejme të tërthortë në pyetje, K5 dëshmoi se M.J.K. erdhi tek N.O. për t'i marrë paratë.⁶⁷⁴ Ishte hera e parë kur K5 e përmendi N.O.; ai nuk ishte në gjendje ta shpjegonte se pse ai nuk kishte folur për të më parë.⁶⁷⁵ M.J.K. erdhi 7 ditë pas vrasjes. Ai e dinte këtë nga M.J.K.⁶⁷⁶ K5 nuk e dinte se kush i dha paratë, një nga dy N.-ët. Ishin rreth 1.5 milion euro. Ai e bazonte këtë përlllogaritjen në përvojën e tij.⁶⁷⁷
746. Ai u ballafaqua me dëshminë e tij të dhënë në Beograd ku ai tregoi se a ishte L.B.C. i cili kishte urdhëruar dhe paguar për vrasjen e R.D. K5 tha se kishte diçka mes tyre dhe si rrjedhë L.B.C. po e ndiqte R.D. në Turqi.⁶⁷⁸ Kur më tej u përball me përgjigjen e tij se N.K. i kishte dhënë 200.000, në fillim ai nuk e

⁶⁷²30.09.2015, f. 12

⁶⁷³ 30.09.2015, f. 11

⁶⁷⁴ 29.09.2015, f. 22

⁶⁷⁵ 29.09.2015, f. 22

⁶⁷⁶ 29.09.2015, f. 23

⁶⁷⁷ 29.09.2015, f. 24

⁶⁷⁸ 30.09.2015, f. 17

kuptoi pyetjen, dhe pastaj ai tha se “*si mund ta di se ai do të jepte aq shumë para*”.⁶⁷⁹ Një moment më vonë, Ai shpjegoi se N.K. mori 200.000 nga M.J.K.⁶⁸⁰ Disa minuta më vonë, kur u ballafaqua përsëri, ai u tërhoq nga deklarata e tij. Këtë herë ai pohoi se ishte N.K. kush e pagoi dhe e urdhëroi vrasjen.⁶⁸¹

747. Gjatë rrjedhës së mëtejme të marrjes së tërthortë në pyetje, K5 tha se N.K. e kishte paguar S.R. për vrasjet e tjera përveç asaj të R.D., por ai nuk donte të jepte ndonjë detaj. Ai e dinte këtë nga një person i cili kishte marrë 400.000 euro për N.K.⁶⁸² Ai nuk desh të hynte në detaje të tjera, pasi që ai ishte i interesuar në faktin se ata e kishin vrarë djalin e tij. Megjithatë, ai nuk e fajësoi N.K. për këtë, por besonte se kishte indikacione se ai ishte i përfshirë. Ai e fajësoi miqtë e N.K për këtë, duke përfshirë L.B.C.⁶⁸³

748. **K4** dëshmoi se disa ditë pas vrasjes së R.D. dhe kthimit të S.R. nga Sarajeva, M.Os. dhe vëllai i tij erdhën me një çantë plastike ngjyrë kivi, jo transparente, me një mbishkrim Benetton në të dhe ata i sollën paratë – 100.000 euro, në bankënota të mëdha. Ata shkuan me të te shtëpia e tretë me S.R. Kur erdhën ata, në shtëpi ishin K5, Ivica Stanojevic, e bija dhe ajo. Kur u larguan, S.R. e solli çantën dhe e zbrazti atë. Ai u tha atyre se ishin. Ai u tha atyre se ishin 100.000

⁶⁷⁹ 30.09.2015, f. 17

⁶⁸⁰ 30.09.2015, f. 17

⁶⁸¹ 30.09.2015, f. 21

⁶⁸² 29.09.2015, f. 24-25

⁶⁸³ 29.09.2015, f. 28-29

euro.⁶⁸⁴ Ai i dha secilit prej tyre nga 10.000 euro, me gjithë faktin se M.Os. tashmë kishte marrë 100.000 euro.⁶⁸⁵ Në të vërtetë ata kishin marrë 200.000 euro, 100.000 euro për M.Os. dhe 100.000 euro për S.R.⁶⁸⁶ K5 e konfirmoi këtë shumë parash dhe ndarjen në pjesë të parave.⁶⁸⁷

749. Sipas **K5**, K4 nuk ishte i pranishëm kur u sollën paratë. Ai ishte 100 % i sigurt se ajo nuk e kishte parë çantën.⁶⁸⁸
750. K5 dëshmoi se S.R. i mori paratë në shtëpi. Ato ishin sjellë nga M.J.K. nga Sarajeva. 100.000 euro ishin sjellë nga M.Os., K5 ishte i pranishëm atëherë. Erdhën vëllezërit M.Os. erdhi, paratë në një çantë të tejdukshme me bankënota të reja u hodhën mbi tavolinën që gjendej nën ballkon. S.R. ishte atje. K4 dhe vajza e tij nuk ishin të pranishme. Ai nuk ishte i sigurt për sa i përket valutës, nëse ishin euro, apo marka gjermane. M.Os. tregoi se ai kishte sjellë 100.000 euro, dhe ai i mori për vete 100.000 euro të tjera, por ai premtoi se do t'i kthente.⁶⁸⁹ S.R. nuk ia dha atij paratë, ai vetëm i mori ato.⁶⁹⁰ Ishte një bisedë e zakonshme mes tyre, asgjë e veçantë.⁶⁹¹ N.V. i mori paratë, atij nuk i kujtohej sa para.⁶⁹²
751. Gjatë marrjes së tërthortë në pyetje, K5 dëshmoi se erdhën M.J.K., M.Os. dhe S.R. Një çantë e dorës me para u hodhën mbi një shtrat. Mbase i pranishëm ishte

⁶⁸⁴ 29.06.2015, f. 9 – 11, 24

⁶⁸⁵ 29.06.2015, f. 9 – 11, 17

⁶⁸⁶ 29.06.2015, f. 21,

⁶⁸⁷ 29.07.2015, f. 14

⁶⁸⁸ 30.09.2015, f. 25-26

⁶⁸⁹ 29.07.2015, f. 27-29

⁶⁹⁰ 29.07.2015, f. 32

⁶⁹¹ 29.07.2015, f. 36

⁶⁹² 29.07.2015, f. 32

edhe vëllai më i ri i M.Os. Kjo e tëra ndodhi në shtëpinë e parë nga tre shtëpitë në oborr. Divani ku ishin hedhur paratë gjendej në dhomën e ndejës. M.Os. i hodhi ato, askush nuk i numëroi paratë. Ata po bisedonin për tema të ndryshme. Ishte një qese plastike e tejdukshme me ngjyrë të bardhë.⁶⁹³ K5 rregullisht e kishte parë këtë mënyrë pagese, nuk ishte asgjë e jashtëzakonshme. Megjithatë, ai asnjëherë nuk ishte përfshirë në punët e S.R. Ai asnjëherë nuk e kishte pyetur atë se sa ishte paguar për një vrasje të caktuar. S.R. asnjëherë nuk i tregoi atij se sa kishte marrë.⁶⁹⁴

752. Sipas K5, kur ata i sollën paratë, ata po bisedonin se kush kishte paguar për vrasjen. Pastaj K5 kishte pyetur për arsye patriotike. Këtë herë ai tha se vetëm ata duhet t'i tregonin atij se kush ishte përfshirë në vrasjen e R.D., por K5 nuk përmendi ndonjë emër, duke thënë se “ata ishin përpjekur diçka me kurdët”. K5 tha se nëse ai do ta kishte ditur që nga fillimi se për çfarë ishte fjala ai nuk do ta lejonte birin e tij ta bënte këtë, për të thënë në fjalinë e radhës se ai nuk ishte në gjendje të ushtronte kontroll mbi të birin e tij.⁶⁹⁵ Më vonë, K5 u tërhoq nga deklarata e tij se ai ka mundur ta ndalte S.R. Ai po ashtu shtoi se vrasja e R.D. ishte e vetmja për të cilën ai kishte diskutuar me birin e tij.⁶⁹⁶ S.R. nuk i numëroi paratë. Ai nuk çante kokën fare për paratë.⁶⁹⁷

753. Kur u mor në mënyrë të tërthortë në pyetje, K5 dëshmoi se M.J.K. ishte mik i

⁶⁹³ 30.09.2015, f. 23

⁶⁹⁴ 30.09.2015, f. 23 - 24

⁶⁹⁵ 30.07.2015, f. 18

⁶⁹⁶ 30.07.2015, f. 20-21

⁶⁹⁷ 29.07.2015, f. 30

vëllait të tij, por më vonë edhe i S.R. ⁶⁹⁸

754. Kur u pyet nëse ai e kishte parë L.B.C. duke i dhënë para M.Os., ai tha “ndoshta po”, dhe pak më vonë kur u pyet sërish, ai u përgjigj - “shumë herë” dhe “herë të panumërta”.⁶⁹⁹ Ai e dinte se paratë për R.D. ai i kishte sjellë në shtëpi, ndërsa për veprat e tjera penale ai nuk dinte. Ai i kishte sjellë paratë në kafe bar te sheshi. Në parim ai do të ulej me ta në një tavolinë, por në këtë rast L.B.C. i shkante në nerva, andaj u ul aty afër. L.B.C. i dha M.Os. 400.000 euro në një thes, një qese. Ai i lidhi këto para me biznesin e drogës, ai nuk e dinte se çfarë kishte ndodhur me këtë. ⁷⁰⁰

755. Më vonë K5 e ndërroi deklaratën e tij përsëri. Ai e pa M.Os. dhe vëllain e tij duke marrë paratë për vrasjen e R.D. në shesh. Në këtë periudhë S.R. ishte në paraburgim. Kjo ishte tashmë pas vrasjes. Pak më vonë ai iu kthye situatës kur paratë u hodhën mbi divan, atëherë M.Os. tha se kjo është për punën nga Bosnja dhe filloi me diçka tjetër. Më tej ai tha, se ata po diskutonin për këtë për më shumë se gjysmë ore, dha një përshkrim se sa i madh ishte R.D., etj. ⁷⁰¹

756. Kur u pyet për paratë e dhëna te sheshi, ai tha se ato ishin për vrasjen e R.D. Ai ishte i pranishëm në atë kohë, e po ashtu D.Pe., një mik nga Austria. Ai nuk dinte se sa para mori në këtë rast M.Os. për këtë vrasje. ⁷⁰²

⁶⁹⁸ 29.09.2015, f. 41

⁶⁹⁹ 30.09.2015, f. 39

⁷⁰⁰ 30.09.2015, f. 40-41

⁷⁰¹ 30.09.2015, f. 42

⁷⁰² 30.09.2015, f. 44

757. **K4** dëshmoi se S.R. nuk kishin marrë ndonjë gjë nga L.B.C., ndërsa M.Os. mori një veturë të blinduar Audi A8.⁷⁰³ M.Os. e vizitoi S.R. me këtë veturë në burg. Ai i tha S.R. se ai do ta merrte të njëjtë pas lirimit.⁷⁰⁴
758. **K5** tha se ai mendon se M.Os. mori një veturë.⁷⁰⁵ K5 nuk mendon se K4 i kishte parë paratë. Nuk ka ndodhur që ai ose S.R. do t'i tregonin paratë K4 për shërbimet e tyre. Ai nuk guxonte ta bënte këtë sepse ajo e njihte atë, se ajo ishte kundër grupit të Shabacit, se ajo i urrente ata haptazi.⁷⁰⁶
759. K5 e përmendi vetëm gjatë marrjes së tërthortë në pyetje se M.M. ishte paguar. Ai nuk e dinte se sa.⁷⁰⁷ Ai nuk e kishte parë kur ai i mori paratë.⁷⁰⁸
760. **K4** dëshmoi se S.R. i kishte ndarë 20.000 euro për N.V., por në fund ai ia dha atë M.M. në Beograd sepse ai ishte pjesë e këtij grupi dhe ai ia shpëtoi jetën atij kur S.R. ishte plagosur gjatë përpjekjes për ta vrarë D.Z. M.J.K. mori nga ai 5000 euro, sepse ata gjithmonë prisnin para nga ai.⁷⁰⁹ Pjesën tjetër ai e shpenzoi në veturë, pushime, etj.⁷¹⁰
761. Sipas saj, S.R. ishte dashur të merrte më shumë para. Rreth një vit pas vrasjes, ajo ishte takuar një herë me B.Os., ai po i fërkonte duart pasi që ai po priste për

⁷⁰³ 29.06.2015, f. 15 - 16

⁷⁰⁴ 28.07.2015, f. 12, 36

⁷⁰⁵ 29.07.2015, f. 32

⁷⁰⁶ 29.07.2015, f. 31

⁷⁰⁷ 30.09.2015, f. 7

⁷⁰⁸ 30.09.2015, f. 8

⁷⁰⁹ 29.06.2015, f. 11

⁷¹⁰ 29.06.2015, f. 12

paratë nga shqiptarët. Ata dëgjuan se ata i kishin sjellë paratë për S.R. Në atë kohë, ai tashmë ishte në paraburgim.⁷¹¹ Ajo nuk ishte e sigurt nëse paratë lidheshin me vrasjen e R.D.⁷¹² Gjatë marrjes së tërthortë në pyetje, ajo sqaroi se B.Os. i kishte thënë se ai ishte duke pritur paratë nga “Shipci” për mbrojtjen e S.R.⁷¹³

762. Sipas **K5**, S.R. asnjëherë nuk kishte biseduar me nënën e tij për punën që ai bënte, paratë që ai i fitonte. Nuk guxonte.⁷¹⁴

763. **M.M.** dëshmoi se S.R. fliste shumë dhe i pëlqente të mburrej. Ai e kishte vizituar atë në shtëpinë e tij. Ai ia njihte prindërit e tij, ai fliste me ta. Në gjykimin e tij në Beograd, ata kishin dëshmuar për vrasjet që ata kishin kryer së bashku me S.R., i cili ishte ekzekutuesi kryesor. Ata flisnin për detajet për 4 – 5 vrasje.⁷¹⁵ Në fillim, K5 e përfshiu edhe M.M. në vrasjen e S.R., por pas 4 vjet gjykimi ai erdhi dhe tha se kjo nuk ishte e vërtetë, se ai kishte njëfarë konfuzioni në kokën e tij. Të dy, K4 dhe K5 janë ekzaminuar nga psikiatrit.⁷¹⁶⁷¹⁷ K5 e pranoi se ai kishte dëshmuar kundër M.M. sepse e fajësonte atë për vdekjen e birit të tij.

1024

764. S.R. mburrej për vrasjen e R.D., megjithatë ai nuk kishte dhënë asnjë detaj, vetëm se ishin shkallët.⁷¹⁸ Ai madje mburrej se kishte kryer disa vrasje të cilat

me siguri nuk ishin kryer nga ai.⁷¹⁹ S.R. nuk kishte përmendur M.Os. në

⁷¹¹ 29.06.2015, f. 13

⁷¹² 29.06.2015, f. 24 - 25

⁷¹³ 27.07.2015, f. 7-8

⁷¹⁴ 30.09.2015, f. 25-26

⁷¹⁵ 18.05.2016, f. 36 - 37

⁷¹⁶ 19.05.2016, f. 28-29

⁷¹⁷ 19.05.2016, f. 46

⁷¹⁸ 19.05.2016, f. 14

⁷¹⁹ 18.05.2016, f. 41

kontekstin e kësaj vrasje.⁷²⁰

765. **M.Os.** e mohoi se ai ia kishte dorëzuar paratë S.R. për vrasjen e R.D.⁷²¹

3.29. Vdekja e S.R.

766. Prokurori u përpoq të bënte një lidhje ndërmjet vdekjes së S.R. dhe vrasjes së R.D. Sipas tij, S.R. u vra sepse donte më shumë para për kryerjen e kësaj vrasje.

767. U vërtetua se S.R. vdiq më 27 dhjetor 2008 në Beograd, gjersa ai po vinte eksploziv nën veturën që i përkiste M.M. Ky konstatim rrjedh nga provat që përkojnë në mënyrë reciproke të K5, K5 dhe M.M.

768. Gjykata konstatoi se nuk ka prova të cilat do të arsyetonin lidhjen ndërmjet vdekjes së S.R. dhe vrasjes së R.D. Prokurori u përpoq ta dëshmonte këtë lidhje mbështetur mbi dëshmitë e dhëna nga S.T., Z.T. dhe K1, por Gjykata i vlerësoi ato si të pambështetshme.

769. Para së gjithash, nuk ka prova se ka pasur ndonjë takim ku janë diskutuar çështja e pagesës dhe e kërkesave shtesë të S.R. Madje S.T., e vetmja dëshmitare që e përmend këtë, nuk ishte konsekuente nëse ajo ishte e pranishme atje ose jo. Së dyti, ajo ishte aq e vendosur për të bindur se ekzistonte një lidhje ndërmjet këtyre dy ngjarjeve saqë ajo dha një datë të gabuar të vdekjes së S.R. Rrjedh nga prova të tjera objektive se ai ishte vrarë në dhjetor të vitit 2008, ndërsa ajo tha se kjo kishte ndodhur një muaj pas vrasjes së R.D. Së treti, dëshmia e saj është në kundërtënie me versionet e K5 dhe K5 të cilët ishin mjaft konsekuent kur thanë se S.R. nuk brengosej shumë për paratë, dhe siç e nënvizoi K4 – ai “nuk

⁷²⁰ 19.05.2016, f. 33

⁷²¹ 26.09.2016, f. 14

llomotiste” vërdallë për atë çfarë bënte ai.

770. Dëshmitarët e tjerë të cilët folën për këtë lidhje të pretenduar ndërmjet vdekjes së S.R. dhe vrasjes së R.D. (Z.T., K1) i mbështetën deklaratat e tyre në thashetheme, çfarë i bënte dëshmitë e tyre thelbësisht të pambështetshme.
771. Duhet të nënvizohet se vdekja e S.R. ishte faktor vendimtar që i detyroi K4 dhe K5 që të dëshmonin kundër njerëzve të cilët ata të dy i fajësonin për humbjen e djalit të tyre. Ata ishin mjaft të qartë në dëshmitë e tyre se ata po kërkonin hakmarrje për atë që kishte ndodhur.

Përmbledhje e provave relevante

772. **S.T.** dëshmoi se gjatë takimeve të mëtejme ku merrnin pjesë ajo, F.R., N.K., N.O. dhe Ek.L., N.K. po ankohej se “S.R. kishte filluar me lehtë, duke u mburrur për këtë, pastaj ai u mashtrua dhe ai nuk mori mjaft para, dhe se ai do të duhej të hiqej qafe. Ky takim ishte brenda një muaji pas vdekjes së R.D.⁷²² Më vonë u arrit pajtimi që bijtë e N.K. dhe N.O. do të shkonin te Hotel Sunce në Vogosca afër Sarajevës, ku do ta takonin Da.E., të cilin ata do ta angazhonin, atë ose njerëzit e tij, për ta vrarë S.R.⁷²³
773. Gjatë marrjes së tërthortë në pyetje, ajo dëshmoi se ajo ishte e pranishme kur ata po largoheshin nga Radon Plaza për të arritur atje, por nuk ishte e pranishme gjatë takimit në hotel Sunce. U diskutua se pse ata po shkonin atje.⁷²⁴ Më vonë

⁷²² 23.03.2015, f. 5

⁷²³ 23.03.2015, f. 6; 16.05.2015, f. 15

⁷²⁴ 16.05.2015, f. 15- 16; 16.05.2015, f. 32

ajo e tërhoqi deklaratën se ajo ishte e pranishme kur ishte planifikuar vrasja e S.R. Ajo pohoi se ajo kishte mësuar për këtë nga N.O., dhe se për detajet e vdekjes së tij ajo kishte lexuar në media.⁷²⁵

774. Sipas saj, S.R. ishte vrarë rreth një muaj pas vrasjes së R.D., pra në korrik/gusht 2007.⁷²⁶ Më vonë, duke u përgjigjur në pyetjen e prokurorit, S.T. tha se një kohë e caktuar kishte kaluar ndërmjet vdekjes së R.D. dhe takimit kur u tha se S.R. po “llomotiste”.⁷²⁷

775. **Z.T.** dëshmoi se ai kishte dëgjuar për vrasjen e S.R. dhe se Da.E., M.M. dhe N.K. ishin të përfshirë. Aranzhimet ishin bërë në hotel Sunce.⁷²⁸ Kur ai u mor në mënyrë të tërthortë në pyetje, ai tha se ai kishte dëgjuar për këtë takim nga Uglesa.

776. **K5** nuk e konfirmoi se S.R. po ankohej se nuk ishte paguar. Djali i tij i kishte thënë se ai do të paguhej 200.000 euro dhe se nuk kishte nevojë të brengosej. Përveç kësaj, ai nuk ishte person që sillej e mburrej për ndonjë vrasje që ai kishte kryer.⁷²⁹

777. **K4** dëshmoi se S.R. ishte vrarë më 27 dhjetor 2008.⁷³⁰ Ai vdiq në shpërthimin e veturës që i përkiste M.M.⁷³¹

⁷²⁵ 16.05.2015, f. 32-33

⁷²⁶ 23.03.2015, f. 6; 16.05.2015, f. 15

⁷²⁷ 23.03.2015, f. 7

⁷²⁸ 17.06.2015, f. 13; 22.06.2015, f. 20

⁷²⁹ 30.07.2015, f. 38

⁷³⁰ 29.06.2015, f. 2

778. **K1** dëshmoi se e dinte se S.R. ishte vrarë në vitin 2008. Ai e dinte se ai po shantazhonte dhe po kërkonte më shumë para. Ai e dinte këtë nga N.K. S.R. qëndroi më gjatë pas vrasjes së R.D., 15 ditë, në Bosnje dhe kërkonte paratë. Ai kishte dëgjuar për këtë nga ata, pa e specifikuar kush.⁷³² Pak më vonë, ai tha se e kishte dëgjuar nga N.K. i cili kishte thënë *“le t’i kërkojë paratë tani”*. Ai nuk ishte në gjendje të jepte ndonjë detaj, se kur kishte ndodhur kjo; ai vetëm e përsëriti se dinte për këtë.⁷³³

779. **M.M.** dëshmoi se më 27 ose 29 dhjetor 2008, S.R. kishte tentuar ta vriste atë në Beograd. Më vonë doli që i tërë grupi i “Shabacit” ishte i përfshirë në këtë. Nën veturën e tij ishte vënë një pajisje shpërthyesë.⁷³⁴ K5 e fajësoi atë për vdekjen e djalit të tij. Ai e kishte thirrur atë dhe i kishte thënë atij *“E kam humbur djalin për shkak tëndin dhe tani ti do t’i humbësh të dy djemtë e tu që i ke në Suboticë”*. Pas kësaj, M.M. nuk kishte pasur më kontakte me K4 dhe K5.⁷³⁵

780. **M.Os.** dëshmoi se në janar të vitit 2009, ai e kishte takuar K5 në qytet, i cili e fajësonte atë për vdekjen e djalit të tij. K5 i kishte thënë atij se *“nëse do t’ia kishe dalë ta pajisje atë me dokumente, ai do të largohej nga vendi, ai nuk do të vritej”*.⁷³⁶

3.30. I.B. dhe L.B.C.

781. **I.B.** ishte një dëshmitar tjetër i propozuar nga prokurori për t’i mbështetur pretendimet lidhur me përfshirjen e N.K në vrasjen e R.D. Ajo u paraqit në këtë

⁷³¹ 29.06.2015, f. 15 - 16

⁷³² 10.11.2016, f. 4

⁷³³ 10.11.2016, f. 6

⁷³⁴ 19.05.2016, f. 36-37, 40

⁷³⁵ 19.05.2016, f. 39

⁷³⁶ 10.10.2016, f. 25

rast në fazën e shqyrtimit gjyqësor pasi ajo kishte mbajtur një konferencë shtypi në Beograd në maj të vitit 2015, ku ajo e kishte akuzuar bashkëshortin e saj L.B.C. për shumë vepra penale, duke përfshirë edhe për pjesëmarrjen në vrasjen e R.D. Ata ishin në procesin e shkurorëzimit.⁷³⁷

782. I.B. i përshkroi në detaje problemet me bashkëshortin e saj L.B.C. Ajo e pranoi se ata ishin drejt procedurës së shkurorëzimit dhe nuk mund të arrinin marrëveshje, po ashtu për fëmijën e tyre. Ajo kishte paraqitur shumë kallëzime kundër tij, ai e kishte bërë të njëjtën gjë në lidhje me të.⁷³⁸ Ajo vendosi të dëshmonte kundër tij sepse ajo nuk e lejonte atë që ta linte, ai po e ndiqte, shantazhonte dhe e kërcënonte atë.⁷³⁹

783. Gjatë marrjes së tërthortë në pyetje ajo u ballafaqua me padinë për shkurorëzim të paraqitura nga L.B.C. nga e cila rezultonte se ai ishte personi që e kishte kërkuar atë (23 shkurt 2015). Kur u pyet për këtë, ajo tha se se ai vazhdon të mos e aprovojë shkurorëzimin nga ai. Ajo e pranoi se ajo nuk kishte shkuar në gjykatë për seancën e shkurorëzimit.⁷⁴⁰ Ajo pohoi se ajo nuk e dinte nëse kishte shkuar te media pasi ai kishte paraqitur kërkesë për shkurorëzim.⁷⁴¹ L.B.C. në dëshminë e tij ishte i qartë se ishte ai që kishte paraqitur kërkesë për shkurorëzim, procedura është në vazhdim e sipër.⁷⁴²

⁷³⁷ 20.10.2015, f. 30-31, 21.10.2015, f. 12

⁷³⁸ 21.10.2015, f. 11-12, 18 - 19

⁷³⁹ 21.10.2015, f. 19

⁷⁴⁰ 21.10.2015, f. 55

⁷⁴¹ 21.10.2015, f. 55

⁷⁴² 16.05.2016, f. 27

784. L.B.C. konfirmoi se aktualisht ai kishte marrëdhënie të këqija. Ai po ashtu e akuzoi atë se ajo e kishte shantazhuar atë për para dhe se e kishte thyer kasafortën e tij.⁷⁴³ Ai e përshkroi në detaje në marrëdhënien e tij me I.B. dhe nënvizoi se problemet e tyre kishin filluar në vitin 2008 dhe kishin të bënin me shëndetin e saj kur ajo mbeti shtatzënë. Ajo ishte trajtuar nga doktor B.Dj. Për një periudhë prej më shumë se 6 muaj ajo nuk doli fare nga shtëpia.⁷⁴⁴
785. **I.B.** po e akuzonte L.B.C. se ai ishte përfshirë në dy vrasje të dy personave emrat e të cilëve ajo i dha.⁷⁴⁵ Çfarë ishte interesante, në këtë pjesë të dëshmisë së saj, I.B. nuk e përmendi përfshirjen e pretenduar të bashkëshortit të saj në vrasjen e R.D. Kur u mor në mënyrë të tërthortë në pyetje, ajo pohoi se ishte e pranishme kur L.B.C. kishte folur për këto vrasje me miqtë e tij.⁷⁴⁶ Ajo po fliste për këto vrasje gjatë konferencës së saj për shtyp.⁷⁴⁷
786. Ajo e pranoi se në shumë raste ajo e kishte raportuar sjelljen e dhunshme të L.B.C. ndaj saj. Asaj nuk i kujtohej se sa herë.⁷⁴⁸ Ajo e konsideroi konferencën për shtyp si mënyrën e vetme që t'u tregonte të gjithëve se bashkëshorti i saj po gënjente në lidhje me të.⁷⁴⁹
787. I.B. dëshmoi se ajo e njihnte N.K., një mik ky i bashkëshortit të saj. Ajo e kishte takuar atë në Sarajevë, hotel Casa Grande në vitin 2004 për herë të parë. Ata ishin takuar disa herë, edhe me dy djemtë e tij. Ajo e kishte takuar edhe bashkëshorten

⁷⁴³ 16.05.2016, f. 29 - 30

⁷⁴⁴ 16.05.2016, f. 30--33

⁷⁴⁵ 20.10.2015, f. 6

⁷⁴⁶ 21.10.2015, f. 32-33

⁷⁴⁷ 21.10.2015, f. 34

⁷⁴⁸ 22.10.2015, f. 12 - 13

⁷⁴⁹ 22.10.2015, f. 28 -30

ose të dashurën e N.K.⁷⁵⁰ Ata ishin takuar me njëri tjetrin deri 3 – 4 vjet më parë, shpeshësia e takimeve ishte e njëjtë si para ashtu edhe pas vrasjes së R.D. Sipas saj, L.B.C. dhe N.K. ishin vazhdimisht në kontakt. Ajo nuk e dinte se kur y vunë ata në kontakt për herë të parë pas vrasjes së R.D.⁷⁵¹ Ata e vizitonin atë mjaft shpesh në Casa Grande, madje një herë në javë. Ata e kishin takuar atë edhe në Ulqin dhe në Turqi. Ai nuk i kishte vizituar ata asnjëherë në Serbi, vetëm djali i tij “Bs.”⁷⁵²

788. Ata bisedonin për biznes, çështje familjare, për personat që ishin pengesë për ta.⁷⁵³ Sa herë që ata takoheshin me N.K., së paku ishte njëri nga djemtë e tij ose N.O.⁷⁵⁴ Ajo pohoi se ndodhte që ata të takoheshin madje edhe për çdo javë.⁷⁵⁵ Kur ata e vizituan atë në Sarajevë, ata qëndruan në hotel. Një herë ata po ashtu qëndruan në shtëpinë e tij, por asaj nuk i kujtohej viti.⁷⁵⁶
789. Ajo e pranoi se pas e lindi fëmijën e saj ajo po vuante nga probleme që lidheshin me oksitocin. Në këtë periudhë ajo nuk mund të udhëtonte shumë, ajo kryesisht rrinte në shtrat.⁷⁵⁷ Asaj nuk i kujtohet se kur u ndal së udhëtuarit me bashkëshortin e saj për në Sarajevë.⁷⁵⁸

⁷⁵⁰ 20.10.2015, f. 7 - 9

⁷⁵¹ 20.10.2015, f. 25

⁷⁵² 20.10.2015, f. 25

⁷⁵³ 20.10.2015, f. 33, 21.10.2015, f. 3

⁷⁵⁴ 20.10.2015, f. 13

⁷⁵⁵ 22.10.2015, f.5

⁷⁵⁶ 21.10.2015, f. 38-39

⁷⁵⁷ 22.10.2015, f. 4 - 5

⁷⁵⁸ 22.10.2015, f. 11

790. Sipas saj, N.K. dhe L.B.C. një herë kishin biseduar për R.D., dhe bashkëshorti i saj tha se ky njeri po e ndiqte atë në Turqi në përpjekje për ta vrarë atë. L.B.C. ishte në Turqi në atë kohë sepse ata donin ta vrisnin atë në Serbi (Z.C. i përfshirë në vrasjen e kryeministrit të Serbisë).⁷⁵⁹
791. Ajo pohoi se R.D. ishte angazhuar nga Z.C. për ta vrarë L.B.C. dhe ajo dinte për këtë nga bashkëshorti i saj.⁷⁶⁰ Me sa dinte ajo, nuk kishte kontakt të drejtpërdrejtë ndërmjet bashkëshortit të saj dhe R.D. në Turqi, vetëm se ky i fundit kishte mësuar se në cilin hotel po qëndronte L.B.C., por që ai kishte ikur përpara. Kjo ishte arsyeja e vetme për konfliktin e tyre.⁷⁶¹
792. Ekzistenca e konfliktit ndërmjet R.D. dhe L.B.C. ishte mohuar nga **A.P.** i cili dëshmoi se R.D. nuk ishte angazhuar nga Z.C. për ta vrarë L.B.C.⁷⁶²
793. Sipas **L.B.C.**, R.D. nuk ishte angazhuar nga Z.C. për ta vrarë atë. Kishte njerëz të tjerë të cilët ishin duke e kërkuar për ta bërë këtë. Ata donin ta vrisnin atë sepse ai dinte çdo gjë lidhur me veprimtarinë e tyre kriminale.⁷⁶³ Shumë njerëz ishin në kërkim të tij për ta informuar Z.C. se ku qëndronte ai dhe pastaj ata do ta vrisnin atë.⁷⁶⁴ Ai kishte dëgjuar se R.D. po e kërkonte atë, ai kishte dëgjuar për këtë me gjasë para vrasjes së Z.D., nga një mik i tij 5 – 6 njerëz po bisedonin për të, por që ai nuk e kishte marrë këtë shumë seriozisht.⁷⁶⁵ Ai asnjëherë nuk kishte pasur kontakt personal me R.D. ⁷⁶⁶

⁷⁵⁹ 20.10.2015, f. 9 – 10

⁷⁶⁰ 20.10.2015, f. 11; 21.10.2015, f. 5

⁷⁶¹ 21.10.2015, f. 5

⁷⁶² 08.12.2015, f. 27

⁷⁶³ 19.05.2016, f. 8

⁷⁶⁴ 19.05.2016, f. 9

⁷⁶⁵ 19.05.2016, f. 19, 21

⁷⁶⁶ 19.05.2016, f. 19

794. Sipas **I.B.**, N.K. dhe L.B.C. po flisnin me fjalë të ndyta për R.D.⁷⁶⁷ Ishte L.B.C. ai i cili tha se R.D. do të duhej të vritej.⁷⁶⁸ N.K. e ndante opinionin e tij se R.D. është njeri i keq, dhe ai u pajtua me çdo gjë që tha L.B.C.⁷⁶⁹ Asaj nuk i kujtohej se në çfarë mënyre e kishte thënë ai këtë. Ai ka mundur të thotë, “*Po, ashtu është*”. Ajo nuk e kishte komentuar këtë, nuk ishte përpjekur që ta parandalonte vrasjen.⁷⁷⁰ Asaj nuk i kujtohej nëse bashkëshorti i saj kishte diskutuar për këtë hakmarrje ndaj R.D. me M.Os. dhe M.J.K.⁷⁷¹
795. Ata po planifikonin ta vrisnin atë. Kur u pyet kur, ajo e lidhi këtë me periudhën e shtatzënisë së saj. Fëmija kishte lindur më 15 janar 2008, ajo ishte 2 – 3 muaj shtatzëne kur ata po e planifikonin atë.⁷⁷² Ajo nuk i dinte detajet se për çfarë po flisnin ata, por asaj i kujtohet që një herë N.K. kërkoi nga bashkëshorti i saj të gjente njerëz nga Serbia për t’i kryer vrasjet e caktuara (në shumës) në Bosnje.
- 1080
796. Pas këtij takimi fillestar ku u diskutua plani për ta vrarë R.D., ata më nuk kishin biseduar për këtë përsëri.¹⁰⁸¹ Ajo nuk ishte në gjendje të tregonte se sa kohë pasi që ajo e kishte takuar N.K. kishte ndodhur kjo biseda se R.D. duhej të vritej. Më vonë ajo ndërroi mendje sa i përket shpeshësisë së bisedave lidhur me vrasjen e

⁷⁶⁷ 20.10.2015, f. 12

⁷⁶⁸ 21.10.2015, f. 3

⁷⁶⁹ 21.10.2015, f. 3

⁷⁷⁰ 22.10.2015, f.9-10, 11

⁷⁷¹ 21.10.2015, f. 60

⁷⁷² 20.10.2015, f. 12 ¹⁰⁸⁰

20.10.2015, f. 13 ¹⁰⁸¹

20.10.2015, f. 33

planifikuar të R.D. dhe ajo tha se ata kishin folur për këtë në disa raste.⁷⁷³

797. Gjatë marrjes së tërthortë në pyetje, ajo dëshmoi se L.B.C. nuk kishte kërkuar ndihmë në vrasjen e R.D. Sipas saj, ai kishte burime të mjaftueshme që ta bënte këtë vetë, ai po ashtu mund të kërkonte nga S.Cl.⁷⁷⁴ Sipas saj, L.B.C. mund t'i dërgonte njerëzit për ta kryer cilëndo vrasje në Sarajevë.⁷⁷⁵ Ajo pohoi se në disa raste L.B.C. i kishte thënë asaj se ai do të merrte hak ndaj R.D. Asaj nuk i kujtohej se kur kishte ndodhur ky diskutim. Kjo ishte bërë para se ajo të takonte N.K. Ai nuk kishte treguar se si do ta bënte ai këtë.⁷⁷⁶
798. Më tej, ajo shpjegoi se N.K. kishte kërkuar nga L.B.C. që dërgonte njerëz të caktuar për “likuidime të caktuara”.⁷⁷⁷ Asaj nuk i kujtohej nëse gjatë bisedës ndërmjet N.K dhe L.B.C. ishte përdorur fjala “vrasje”.⁷⁷⁸
799. Ajo pranoi se ajo asnjëherë nuk kishte dëgjuar që N.K. ka thënë: *Dua që R.D. të vritet dhe më dërgo disa njerëz për ta ekzekutuar atë.*⁷⁷⁹ Ajo nuk e kishte raportuar planin për ta vrarë R.D. sepse në atë kohë ajo ishte ende e martuar me bashkëshortin e saj.⁷⁸⁰
800. Sipas saj, L.B.C. kishte dërguar disa njerëz nga Shabaci in Serbi tek N.K. Ishte M.Os. dhe M.J.K. Ajo e dinte këtë sepse bashkëshorti i saj ishte në kontakt të vazhdueshëm telefonik me të, dhe se ajo ishte afër tij gjatë gjithë kohës. Kjo

⁷⁷³ 21.10.2015, f. 6-7

⁷⁷⁴ 22.10.2015, f. 41 - 42

⁷⁷⁵ 22.10.2015, f. 19, 42

⁷⁷⁶ 21.10.2015, f. 59 - 60

⁷⁷⁷ 22.10.2015, f. 42+

⁷⁷⁸ 22.10.2015, f. 11

⁷⁷⁹ 22.10.2015, f. 42

⁷⁸⁰ 21.10.2015, f. 21

kishte ndodhur menjëherë pasi ata u kthyen në Beograd nga takimi me N.K.⁷⁸¹
Gjatë marrjes së tërthortë në pyetje, ajo dëshmoi se ajo nuk i kishte parë se kur
ata ishin nisur për në Sarajevë. Ajo nuk e dinte se si dhe se ku saktësisht kishin
shkuar ata. Ajo nuk ishte e pranishme në takimin e tyre me N.K.⁷⁸²

801. Ajo zbuloi se M.Os. dhe M.J.K. kishin gjetur disa bashkëpunëtorë të rinj që t'u
bashkoheshin atyre në udhëtimin për Sarajevë. Ata u ishin bashkuar atyre gjatë
udhëtimit të dytë (u përgjigj në pyetjen sugjestive të prokurorit). Ajo dinte për
këtë sepse ajo kishte dëgjuar nga bashkëshorti i saj rrëfime për një burrë të ri nga
Shabaci.⁷⁸³ Ajo e dinte emrin e S.R., ajo i dinte pseudonimet e M.J.K. dhe
M.Os.⁷⁸⁴ I.B. shpjegoi se ajo e kishte dëgjuar emrin e vrasësit. Asaj i kujtohej
sepse ai ishte i rrallë në Serbi. Ajo e kishte dëgjuar këtë nga bashkëshorti i saj,
por asaj nuk i kujtohej se kur. Ajo e di që S.R. ishte vrarë.⁷⁸⁵ Ajo kishte lexuar
në media emrin e N.K në lidhje me S.R.⁷⁸⁶
802. Ajo pohoi se ishte takuar me M.Os. dhe M.J.K. në shumë raste.⁷⁸⁷ Ajo e kishte
takuar S.R. vetëm një herë në shoqërinë e tyre.⁷⁸⁸
803. **M.Os.** dëshmoi se ai nuk e njohte I.B., por ai tha se çdo kush në Serbi dinte për
konfliktin e saj me bashkëshortin e saj.⁷⁸⁹

⁷⁸¹ 20.10.2015, f. 14 - 15

⁷⁸² 22.10.2015, f. 19

⁷⁸³ 20.10.2015, f. 16

⁷⁸⁴ 20.10.2015, f. 16

⁷⁸⁵ 22.10.2015, f. 15-16

⁷⁸⁶ 22.10.2015, f. 48

⁷⁸⁷ 20.10.2015, f. 16 – 17

⁷⁸⁸ 20.10.2015, f. 17

804. Gjatë marrjes së tërthortë në pyetje, ajo dëshmoi se ajo nuk kishte folur me M.Os. dhe M.J.K. lidhur me përmbajtjen e diskutimeve të tyre me N.K. Ata nuk e kishin bërë këtë në praninë e saj. Asaj nuk i kujtohej nëse ata e kishin bërë këtë me telefon. Ajo kishte folur me M.Os. me telefon, por asaj nuk i kujtohet nëse kishin folur për krime apo vetëm biseda normale.⁷⁹⁰ M.Os. nuk ia kishte përmendur R.D. asaj.⁷⁹¹
805. Më tej, ajo tha se M.Os. asnjëherë nuk kishte folur me të se ai kishte në Sarajevë për ta vrarë R.D. M.J.K. nuk kishte folur për qëllimin e vizitës së tij në Sarajevë. M.Os. asnjëherë nuk kishte thënë se M.J.K. ishte i përfshirë në këtë vrasje. Ajo asnjëherë nuk e kishte dëgjuar dikë duke folur në praninë e saj se R.D. duhej të vritej dhe se ata janë ata që do ta bënin këtë.⁷⁹²
806. Ajo po ashtu pranoi se ajo nuk kishte dëgjuar se N.K. pagoi për vrasjen e R.D.⁷⁹³ Ajo nuk ishte asnjëherë e pranishme kur ata kishin folur për vrasjen e R.D. Ajo nuk ishte e pranishme kur N.K. negocioni me M.Os. dhe M.J.K.⁷⁹⁴
807. Ajo mësoi për vdekjen e R.D. menjëherë nga mediat. Në atë kohë ajo ishte vetëm, bashkëshorti i saj ishte në qytet. Ajo bisedoi me të për këtë, por më vonë, asaj nuk i kujtohet se kur.⁷⁹⁵ Bashkëshorti i saj po i lavdëronte personat të cilët e

⁷⁸⁹ 10.10.2016, f. 26

⁷⁹⁰ 22.10.2015, f. 19-20

⁷⁹¹ 22.10.2015, f. 21

⁷⁹² 22.10.2015, f. 47

⁷⁹³ 22.10.2015, f. 47

⁷⁹⁴ 22.10.2015, f. 19

⁷⁹⁵ 20.10.2015, f. 20

- kishin vrarë R.D. Asaj nuk i kujtohet se kush kishte filluar të fliste për këtë. Ishte në media.⁷⁹⁶ Sipas I.B., edhe N.K. po i lavdëronte vrasësit, ai kishte thënë se ata personat ishin të shkëlqyeshëm, ai u pajtua me L.B.C.⁷⁹⁷
808. **L.B.C.** mohoi çfarëdo përfshirje në vrasjen e R.D. Ai nuk kishte folur me bashkëshorten e tij për këtë, ai nuk i kishte lavdëruar vrasësit.⁷⁹⁸
809. **I.B.** dëshmoi se L.B.C. i kishte dhënë M.Os. një Audi A8 të blinduar e cila më vonë ishte konfiskuar nga policia.⁷⁹⁹ Ajo ishte në shtëpi kur M.Os. kishte ardhur ta merrte veturën, megjithatë ajo mbeti e regjistruar në emër të bashkëshortit të saj.⁸⁰⁰ M.Os. nuk kishte dhënë ndonjë para për veturën.⁸⁰¹ Gjatë marrjes së tërthortë në pyetje, ajo pretendoi se edhe M.J.K. ishte i pranishëm kur L.B.C. ia kishte dhënë veturën M.Os.⁸⁰²
810. Ajo nuk e dinte se pse bashkëshorti i saj ia dha veturën M.Os.⁸⁰³ gjatë marrjes së tërthortë në pyetje, ajo ndërroi mendje sepse ajo tha se ajo asnjëherë nuk e kishte dëgjuar bashkëshortin e thënë të thoshte M.Os. se ai e kishte dhënë këtë veturë, e as që e kishte dhënë atë për vrasjen e R.D. Ajo nuk e dinte se pse kjo veturë ishte me M.Os. dhe pastaj i ishte kthyer bashkëshortit të saj.⁸⁰⁴ Kjo veturë ishte

⁷⁹⁶ 20.10.2015, f. 22

⁷⁹⁷ 21.10.2015, f. 15

⁷⁹⁸ 19.05.2016, f. 12

⁷⁹⁹ 20.10.2015, f. 19 - 21, 22.10.2015, f. 43

⁸⁰⁰ 20.10.2015, f. 22

⁸⁰¹ 20.10.2015, f. 24

⁸⁰² 22.10.2015, f. 18

⁸⁰³ 20.10.2015, f. 24

⁸⁰⁴ 22.10.2015, f. 45

konfiskuar nga policia, pastaj ishte liruar dhe i ishte kthyer L.B.C.⁸⁰⁵

811. **L.B.C.** dëshmoi se ai i kishte tre Audi të blinduara. Ai i kishte shitur dy në Beograd, dhe të tretën e kishte ende vetë. Ai nuk ia kishte dhënë Audi M.Os.¹¹¹⁵

Para dy ose tre vjetësh (2013 – 2014), një veturë ishte konfiskuar për shkak të taksë doganore por që i ishte kthyer atij. Ishte konfiskuar nga auto servisi.⁸⁰⁶ Ai ende e kishte veturën, ajo i ishte kthyer atij më vonë.⁸⁰⁷

812. Ai i çonte veturat te mekaniku në Shabac, njerëzit e tij vinin për ta marrë veturën.⁸⁰⁸ Miku i tij e kishte rekomanduar këtë vend.⁸⁰⁹ Atij nuk i kujtoheshin emrat e njerëzve të cilët kishin ardhur për ta marrë veturën. Ai i lejonte ta ngisnin veturën e tij vetëm njerëzit e dërguar nga mekaniku.⁸¹⁰ Ai i kishte 10 – 15 fatura nga mekaniku të cilat ai ia dha Gjykatës.⁸¹¹

813. **M.Os.** dëshmoi se ai nuk e njohte L.B.C., ai asnjëherë nuk kishte punuar për të. Ai nuk kishte blerë, ose marrë ndonjë gjë nga ai.⁸¹² Ai e konfirmoi se disa herë ai e ngiste Audi-n e tij të blinduar kur kjo i ishte kërkuar atij nga pronari i Auto Centre “Petrovic” në Shabac i cili i riparonte veturat në pronësi të L.B.C. Ai e nget këtë veturë në rrugën prej dhe deri në Surcin ku L.B.C. e kishte vendin e tij të banimit.⁸¹³ Nganjëherë ndodhte që ai ta përdorte këtë veturë për t’u vozitur për

⁸⁰⁵ 22.10.2015, f. 19

¹¹¹⁵ 16.05.2016, f. 35

⁸⁰⁶ 16.05.2016, f. 35 - 36

⁸⁰⁷ 18.05.2016, f. 20-22

⁸⁰⁸ 18.05.2016, f. 22-23

⁸⁰⁹ 18.05.2016, f. 23

⁸¹⁰ 18.05.2016, f. 23

⁸¹¹ 18.05.2016, f. 25 - 26

⁸¹² 26.09.2016, f. 8, 10

⁸¹³ 26.09.2016, f. 9 - 10

qejf sepse ajo qëndronte për disa ditë në punëtori. M.Os. i ndihmoi mikut të tij, pronari i punëtorisë, edhe me vetura të tjera.⁸¹⁴ Ai ishte parë nga shumë njerëz kur e ngiste veturën e blinduar të L.B.C.⁸¹⁵ Ai nuk ishte marrë në pyetje nga policia për këtë veturë kur ajo ishte konfiskuar.⁸¹⁶

814. Sipas saj, M.J.K. ishte kreu i S.Cl. Ajo asnjëherë nuk kishte biseduar me të për vrasjen e për vrasjen e R.D. Ajo nuk e kishte takuar atë pas konferencës së saj për shtyp. Ai asnjëherë nuk i kishte thënë asaj se ai e kishte ndihmuar L.B.C. që ta vriste R.D. Ajo nuk kishte folur për këtë me M.Os.⁸¹⁷

815. Ajo pohoi se ajo e njihte S.T. nga media dhe nga ajo çfarë i kishte thënë asaj bashkëshorti i saj. Ajo nuk ishte takuar asnjëherë me të, e as nuk kishte folur me të. Ajo kishte dëgjuar se N.K. dhe Z.T. ishin në raporte të këqija sepse ata po luftonin për tregun e drogës. Ajo nuk kishte biseduar për këtë me askë tjetër.⁸¹⁸

816. I.B. konfirmoi se ajo kishte llogari në Facebook. Ajo kurrë nuk kishte hyrë në llogarinë në FB të S.T.⁸¹⁹

817. L.B.C. dëshmoi se dy ditë para konferencës së saj për shtyp I.B. i kishte kaluar mesazhin atij se në rast se ai nuk do t'i jepte asaj 1.000.000 euro ajo do të organizonte një konferencë për shtyp gjatë të cilës ajo do të tregonte çdo informatë të vetme të pavërtetë në lidhje me të dhe të gjithë miqtë e tij, e

⁸¹⁴ 26.09.2016, f. 10 - 11

⁸¹⁵ 26.09.2016, f. 11

⁸¹⁶ 10.10.2016, f. 29

⁸¹⁷ 22.10.2015, f. 45-46

⁸¹⁸ 21.10.2015, f. 16-17

⁸¹⁹ 21.10.2015, f. 17

sidomos për N.K. pasi që ajo kishte gjetur në media çdo gjë që po ndodhte në rastin e tij, ajo shkroi “1.000.000” në një copë letër.⁸²⁰ Kur ai e refuzoi kërkesën e saj, ajo i tha atij se ai do të duhej t’i jepte asaj 3 milion.⁸²¹ Ai paraqiti kallëzim kundër saj më 12 maj 2015. Konferenca për shtyp ishte pasi ajo e shantazhoi atë, nja 12 – 15 ditë.⁸²²

818. **I.B.** e mohoi se ajo e shantazhoi L.B.C. Ajo asnjëherë nuk e kishte shkruar se kishte kërkuar.⁸²³ Megjithatë, asaj nuk i kujtohej të kishte shkruar 1.000.000

euro, ajo nuk e dinte se për çfarë lloj letre po fliste ai.¹¹³⁴

819. ⁸²⁴ Gjykata nuk e pranoi si provë kopjen e një cope letre në të cilën ishte shkruar

“100.000.000” të propozuar nga mbrojtja, si thelbësisht të pambështetshme (neni 259 i KPP-së).

820. L.B.C. e raportoi faktin te policia se ishte shantazhuar nga I.B.⁸²⁵

Konferenca për shtyp

821. Si figurë publike (këngëtare në Serbi), **I.B.** kishte thirrur një konferencë për shtyp për të shpjeguar, siç tha ajo, çdo gjë në lidhje me martesën dhe shkurorëzimin e saj. Ajo e lexoi një deklaratë. Ishte më 30 maj 2015.⁸²⁶ Ajo po përgatitej për këtë konferencë që rreth 10 ditë, ajo e shkroi deklaratën, dhe e

⁸²⁰ 16.05.2016, f. 33; 18.05.2016, f. 8

⁸²¹ 18.05.2016, f. 7-8

⁸²² 18.05.2016, f. 5

⁸²³ 22.10.2015, f. 13

⁸²⁴ 22.10.2015, f. 13

⁸²⁵ 22.10.2015, f. 38

⁸²⁶ 21.10.2015, f. 13-15

konsultonte atë. Në fund gazetaret u lejuan të parashtronin pyetje. Deklarata e saj zgjati rreth 40 minuta.⁸²⁷ Kur u pyet se me kë ishte konsultuar për deklaratën e saj, ajo ndërroi mendje dhe e mohoi se e kishte bërë këtë.⁸²⁸

822. Video – incizimi nga konferenca për shtyp e I.B. ishte pranuar si provë dhe ishte paraqitur gjatë seancës së shqyrtimit gjyqësor të mbajtur më 03 tetor 2017. Gjykata vërejti se I.B. lexoi deklaratën e cila ishte e përgatitur paraprakisht.

823. Kur u mor në mënyrë të tërthortë në pyetje, ajo shpjegoi se ajo nuk do të kishte vendosur të dilte publikisht nëse bashkëshorti i saj do t'i jepte divorcin dhe do të ndalej e të mos e përcillte, kërcënonte dhe shantazhonte atë.⁸²⁹

824. Gjatë marrjes së tërthortë në pyetje, I.B. dëshmoi lidhur me problemet e saj shëndetësore që kishin të bënin me nivelin e oksitocin.⁸³⁰ Ajo e pranoi se ishte takuar me B.Dj. Sipas saj, L.B.C. i kishte dhënë atij ryshfet që të përgatiste vërtetime mjekësore të rreme.⁸³¹ Ajo kishte udhëtuar që ta vizitonte B.Dj. në Suboticë. Ajo e përshkroi në detaje terapinë që ajo mori nga ai.⁸³² Ajo nuk kishte marrë asnjë raport nga ky mjek, ai ia kishte dhënë ata L.B.C.⁸³³

825. Ajo u takua me prokurorin Hughes një herë në Beograd, pak para dëshmisë së saj. Ai e thirri atë në numrin e saj privat të telefonit për të aranzhuar takimin i cili u zhvillua pas konferencës për shtyp. Ata folën për ardhjen e saj në Kosovë dhe

⁸²⁷ 22.10.2015, f.49-50

⁸²⁸ 22.10.2015, f. 50

⁸²⁹ 21.10.2015, f. 54

⁸³⁰ 21.10.2015, f. 61

⁸³¹ 21.10.2015, f. 66-69

⁸³² 22.10.2015, f. 31 - 38

⁸³³ 22.10.2015, f. 34

për sigurinë e saj personale.⁸³⁴ Para takimit me prokurorin Hughes, ajo ishte takuar një herë edhe me një prokuror të Bosnjës, asaj nuk i kujtohej emri i tij. Ajo ishte thirrur në Gjykatën Speciale në Beograd.⁸³⁵

826. Ajo mendon se ajo foli për vrasjen e R.D. në publik për herë të parë, madje edhe para konferencës për shtyp. Herën e parë kur ajo foli për përfshirjen e N.K dhe L.B.C. në veprimtaritë kriminale ishte në gazetën *Informer*. Ishte zgjedhja e saj që të shkonte në media së pari.⁸³⁶ Ajo e bëri këtë pasi ishte arrestuar N.K. Ajo lexoi për këtë në mediat e serbe që raportnin se “lordi i drogës N.K. ishte arrestuar në Kosovë”. Në atë kohë ajo nuk e dinte se N.K. ishte akuzuar edhe për vrasjen e R.D.⁸³⁷ Asaj nuk i interesonin detajet.⁸³⁸ Kur u arrestua N.K. ajo ishte ende në marrëdhënie të mira me bashkëshortin e saj.⁸³⁹
827. Ajo kishte mësuar për akuzën e vrasjes “kohëve të fundit” por kjo ishte para se ajo të jepte intervistë për *Informer*.⁸⁴⁰ Ajo kishte mësuar për këtë nga avokati S.Pr. i cili i kishte thënë asaj se kishte shumë gjëra në aktakuzë. Ai e kishte pyetur bashkëshortin e saj për këshilla se si ta mbronte M.Os. në lidhje me akuzën e vrasjes së R.D.⁸⁴¹ S.Pr. nuk e kishte përmendur M.J.K., S.R. si njëri nga të dyshuarit. Ai e përmendi vetëm N.K. dhe M.Os.⁸⁴² Ajo pranoi se S.Pr. po ashtu

⁸³⁴ 21.10.2015, f. 41 - 42

⁸³⁵ 21.10.2015, f. 42-43

⁸³⁶ 21.10.2015, f. 46 - 47

⁸³⁷ 21.10.2015, f. 47, 57

⁸³⁸ 21.10.2015, f. 57 - 58

⁸³⁹ 21.10.2015, f. 57

⁸⁴⁰ 21.10.2015, f. 47 - 48

⁸⁴¹ 21.10.2015, f. 48

⁸⁴² 21.10.2015, f. 49

kishte thënë se L.B.C. ishte akuzuar si bashkë-kryerës në vrasjen e R.D. Asaj nuk i kujtohet nëse ai kishte dhënë ndonjë detaj të kësaj.⁸⁴³

828. Ajo po ashtu kishte dëgjuar emrin e S.R. nga avokati S.Pr. kur ata po bisedonin për M.Os. Pastaj ata po flisnin për aktakuzën e N.K. Ajo kishte dëgjuar se N.K. do të akuzohej për vrasjen e R.D. dhe se do të kishte një hetim. Ajo dëgjoji për këtë kur u arrestua N.K. Gjatë kësaj bisede u përmend emri i M.Os., ajo nuk e kishte dëgjuar këtë më parë.⁸⁴⁴ Në atë kohë nuk doli emri i S.R.⁸⁴⁵

829. Ajo pohoi se shpesh ndodhte që aktivitetet e paligjshme të L.B.C. diskutoheshin në praninë e saj. Aty përfshiheshin edhe vrasjet. Asaj nuk i kujtoheshin vrasjet e tjera përveç atyre dyjave që u përmendën në fillim të marrjes së saj në pyetje (ajo nuk e përmendi sërish vrasjen e R.D.).⁸⁴⁶

830. Ajo i njohu në fotografi M.Os. dhe “Bk.” M.Os. Ajo nuk i njohu S.R. ose babain e tij.⁸⁴⁷ Ajo nuk ishte takuar asnjëherë me K5. Ajo u ballafaqua me deklaratën e tij se ai e njohte atë. Bashkëshorti i saj nuk e kishte përmendur atë asnjëherë.¹¹⁵⁸

831. ⁸⁴⁸ Gjatë ri-marrjes në pyetje, ajo pranoi se ajo kishte dyshime nëse N.K. dhe L.B.C.

donin ta vrisnin R.D.⁸⁴⁹ Ajo nuk e dinte se pse R.D. kishte marrëdhënie të këqija me N.K.⁸⁵⁰

⁸⁴³ 21.10.2015, f. 55-56

⁸⁴⁴ 22.10.2015, f. 16 -17

⁸⁴⁵ 22.10.2015, f. 17

⁸⁴⁶ 22.10.2015, f. 40

⁸⁴⁷ 22.10.2015, f. 48 - 49

⁸⁴⁸ 22.10.2015, f. 51

832. **L.B.C.** nuk ishte marrë në pyetje gjatë hetimit. Ai e dha dëshminë e tij vetëm gjatë shqyrtimit gjyqësor.
833. Ai dëshmoi se që nga fundi i vitit 2002, ai ishte dëshmitar i mbrojtur në rastin e vrasjes së kryeministrit të Serbisë, kundër Z.C. Ai gjithmonë shoqërohej nga më së paku tre zyrtarë, nganjëherë edhe 12 sish.⁸⁵¹ Ai kishte marrë mbrojtje tashmë edhe para vrasjes së Z.D. (12 mars 2003), sepse ai kishte informuar autoritetet serbe lidhur me planifikimin e vrasjes.⁸⁵² në momentin e vdekjes së tij ai ishte në Sllovaki, ai kishte qenë në Turqi para 5 – 6 muajsh.⁸⁵³
834. L.B.C. e konfirmoj se ai e njeh N.K. gati që nga lindja. Baballarët e tyre kanë qenë kumbarë. Ai asnjëherë nuk kishte pasur marrëdhënie biznesore me të.⁸⁵⁴ Gjatë marrjes së tërthortë në pyetje, ai shpjegoi se ai i njihte djemtë e N.K, ata e respektonin njëri-tjetrin. Kur ata takoheshin, ata bisedonin kryesisht për çështje familjare.⁸⁵⁵ Ai asnjëherë nuk i kishte treguar atij se ai ishte anëtar i Z.C.⁸⁵⁶ Ai nuk kishte kërkuar nga N.K. që t'i ndihmonte kur ai kishte probleme me Z.C. sepse ai asnjëherë nuk donte ta keqpërdorte atë.⁸⁵⁷
835. L.B.C. e vizitoi N.K. në Sarajevë, një herë në Mal të Zi dhe një herë në Stamboll.⁸⁵⁸ Ai nuk e vizitonte atë enkas, kjo zakonisht ishte rrugës së tij për në Mal të Zi dhe pastaj ndalej në hotelin e tij. Ai e vizitonte atë edhe me gruan e tij

⁸⁴⁹ 22.10.2015, f.54

⁸⁵⁰ 22.10.2015, f.55

⁸⁵¹ 16.05.2016, f. 27 - 28

⁸⁵² 19.05.2016, f. 18-19

⁸⁵³ 19.05.2016, f. 18-19

⁸⁵⁴ 16.05.2016, f. 28

⁸⁵⁵ 19.05.2016, f. 6-7

⁸⁵⁶ 19.05.2016, f. 8

⁸⁵⁷ 19.05.2016, f. 12

⁸⁵⁸ 16.05.2016, f. 28

I.B. Kjo ndodhte që nga viti 2006, vetëm një herë në vit. Ai e vizitoi N.K. me të vetëm 2 – 3 herë.⁸⁵⁹ Ai e mohoi se e kishte takuar atë çdo javë.⁸⁶⁰ N.K. asnjëherë nuk e kishte vizituar atë në shtëpinë e tij ose në zyrë në Serbi. Ai nuk e dinte se kur kishte qenë N.K. për herë të fundit në Serbi.⁸⁶¹

836. N.K. asnjëherë nuk i kishte thënë atij se ai kishte pasur ndonjë problem me R.D. I vetmi problem që ai e ndau me të ishte me një muxhahedin nga Syria.⁸⁶²

837. L.B.C. konfirmoi se e njohte M.J.K. por vetëm nga pseudonimi i tij. Ai nuk kishte pasur ndonjë kontakt me të ose të kishte punuar me të.⁸⁶³ Ai nuk e njohte R.D. Ai nuk kishte pasur ndonjë konflikt interesi me të. Ai asnjëherë nuk foli për të me N.K. Ai asnjëherë nuk kishte thënë se ai do ta vriste atë.⁸⁶⁴ Atij nuk i kishte kërkuar N.K. që të gjente vrasës për të vrarë disa njerëz në Sarajevë.⁸⁶⁵ Ai nuk ishte i përfshirë në gjetjen e vrasësve për R.D.

838. Ai e njohte N.O., e kishte takuar atë një herë në Casa Grande.⁸⁶⁶ Ai asnjëherë nuk kishte diskutuar me të për vrasjen e R.D. Ai nuk e kishte çuar S.R. në Casa Grande për të diskutuar për vrasjen e R.D.⁸⁶⁷

839. Ai nuk e njohte M.Os. por ai kishte dëgjuar për të. Ai asnjëherë nuk kishte folur me të.⁸⁶⁸ Ai nuk e njohte B.Os.⁸⁶⁹ Ai e dënoi atë çfarë kishte thënë gruaja e tij se

⁸⁵⁹ 16.05.2016, f. 28-29; 18.05.2016, f. 15

⁸⁶⁰ 19.05.2016, f. 10-11

⁸⁶¹ 16.05.2016, f. 38

⁸⁶² 18.05.2016, f. 15

⁸⁶³ 16.05.2016, f. 33

⁸⁶⁴ 16.05.2016, f. 34; 18.05.2016, f. 15

⁸⁶⁵ 16.05.2016, f. 34

⁸⁶⁶ 18.05.2016, f. 16

⁸⁶⁷ 18.05.2016, f. 17

ata i vizitonin ata në shtëpinë e tyre.⁸⁷⁰ Ai nuk i njihte M.A.G., S.S., N.V., M.M., M.M., B.H., E.Ah., F.R. dhe S.T.⁸⁷¹

840. Ai nuk i njihte K5, K4 dhe S.R.⁸⁷² Kur u ballafaqua me deklaratën e K5 se ai i kishte vizituar ata, ai u përgjigj se kjo ishte e pamundur sepse secila lëvizje e tij në Serbi po monitorohej nga afër nga policia, se telefonat e tij përgjoheshin.⁸⁷³

841. **M.M.** ishte i sigurt se S.R. nuk ishte takuar asnjëherë me L.B.C. dhe se ky i fundit nuk kishte qenë asnjëherë në shtëpinë e prindërve të tij. K4 dhe K5 asnjëherë nuk e kishin përmendur atë.⁸⁷⁴

842. **L.B.C.** dëshmoi se ai nuk e njihte K1. Ai u ballafaqua me deklaratën e tij se K1 vinte në lokalet e tij, fabrikat, dhe se atje ai kishte marrë qindra kilogramë heroinë. Ai e mohoi këtë.⁸⁷⁵ Në mënyrë të njëjtë ai e komentoi deklaratën e dëshmitarit se ai ishte i pranishëm në Casa Grande kur atij i ishte kërkuar të gjente vrasësit e R.D.⁸⁷⁶⁸⁷⁷ Ai nuk ishte i përfshirë në biznesin e drogës me N.K.

1187

843. Gjatë marrjes së tërthortë në pyetje, L.B.C. shpjegoi se ai kishte njohuri vetëm për Z.C., dhe asnjë grup tjetër kriminal.⁸⁷⁸ Ai nuk e dinte nëse gruaja e tij i njihte anëtarët e S.Cl.⁸⁷⁹

⁸⁶⁸ 16.05.2016, f. 34

⁸⁶⁹ 16.05.2016, f. 35

⁸⁷⁰ 18.05.2016, f. 3

⁸⁷¹ 18.05.2016, f. 16 - 17

⁸⁷² 16.05.2016, f. 34

⁸⁷³ 16.05.2016, f. 35

⁸⁷⁴ 19.05.2016, f. 34

⁸⁷⁵ 16.05.2016, f. 36-37, 38

⁸⁷⁶ 16.05.2016, f. 37

⁸⁷⁷ 16.05.2016, f. 37; 18.05.2016, f. 17

⁸⁷⁸ 19.05.2016, f. 4

⁸⁷⁹ 19.05.2016, f. 6

844. Ai i mohoi të gjitha pretendimet e prokurorit se ai donte ta vriste R.D., se kishte folur për këtë me N.K., ishte vënë në kontakt me M.J.K. dhe se ai kishte dëgjuar se S.R. po ankohej se ai nuk ishte paguar.⁸⁸⁰ Ai e shpjegoi sërish situatën me veturat e blinduara.⁸⁸¹
845. Ai i shpjegoi marrëdhëniet me gruan e tij, e pranoi se ai ishte dënuar se e kishte sulmuar një pjesëtar zyrtar të mbrojtjes së I.B. Ai kishte paraqitur shumë kallëzime kundër I.B. Ishin disa aktakuza kundër saj.⁸⁸²

⁸⁸⁰ 19.05.2016, f. 11-13

⁸⁸¹19.05.2016, f. 13-14

⁸⁸² 19.05.2016, f. 15-16

B.Dj. – dëshmitar i mbrojtjes

846. B.Dj. ishte mjeku i cili i kishte dhënë ndihmë mjekësore I.B. Ai ishte marrë në pyetje për t'i verifikuar disa prej pretendimeve të saj që kishin të bënin me karakterin e mbështetjes që ai i kishte dhënë asaj. Sipas saj, ai ishte vetëm një këshilltar martesash për t'i ndihmuar asaj dhe L.B.C. në problemet e martesës, ndërsa ai dëshmoi se ai ishte mjeku i saj, dhe se kishte filluar ta trajtonte atë për shkak të problemeve me oksitocin.
847. Gjatë seancës së mbajtur më 22 tetor 2015, I.B. dha pëlqimin e saj që në këtë rast të dëgjohej B.Dj. Ajo madje e dha numrin e tij të telefonit.⁸⁸³ B.Dj. e kishte marrë një fragment nga kjo pjesë e procesverbalit kur ai erdhi për të dëshmuar në Kosovë.
848. Prokurori e kundërshtoi dëgjimin e B.Dj. në cilësinë e dëshmitarit, sepse sipas mendimit të tij ai do të duhej të dëgjohej në cilësinë e dëshmitarit ekspert.⁸⁸⁴ Megjithatë, Gjykata vendosi ta thërrasë B.Dj. jo në cilësinë e dëshmitarit ekspert, por si dëshmitar që të dëshmojë për raportet e tij me I.B. dhe L.B.C. Ai nuk ishte thirrur të paraqesë opinionin e tij si ekspert mbi shëndetin e I.B. Mbrojtja e propozoi këtë dëshmitar për ta vërtetuar kredibilitetin e dëshmitarit të prokurorit.
849. B.Dj. si mjek ishte i obliguar profesionalisht që të mbajë sekrete çdo gjë që ai kishte mësuar gjatë kryerjes së detyrave dhe obligimeve të tij mjekësore. Ky detyrim rrjedh edhe nga neni 127 (1.5) i KPP-së, që parasheh se mjeku lirohet nga obligimi për të dëshmuar për atë që ai ka mësuar gjatë ushtrimit të

⁸⁸³ 22.10.2015, f. 37

⁸⁸⁴ 10.11.2015, f. 22

profesionit të tij, nëse detyrohet nga detyra për të mbajtur sekret atë që ai ka mësuar, dhe kjo vlen për çdo mjek. Megjithatë, sipas nenit 127 (2) të KPP-së, dëshmitari i tillë nuk mund të refuzojë të dëshmojë kur ekziston baza ligjore për lirim të tij nga detyrimi për ruajtje të konfidencialitetit. Duke marrë parasysh se gjatë seancës së shqyrtimit gjyqësor të mbajtur më 22 tetor 2015 dëshmitarja I.B. kishte hequr dorë nga e drejta e saj për të mbajtur sekret ekzaminimin dhe shënimet e saj mjekësore dhe ajo kishte dhënë pëlqimin e saj që B.Dj. të dëgjohej si dëshmitar lidhur me raportin e lëshuar nga ai dhe trajtimin që ai

kishte ofruar.

850. Gjatë marrjes së tij në pyetje, ai dëshmoi se ai nuk ishte këshilltar martesash i I.B. dhe bashkëshortit të saj, por se ai i kishte ofruar asaj ndihmë mjekësore. Ai po ashtu i përshkroi në detaje vëzhgimet e tij në lidhje me situatën në këtë familje të cilat ai ka mundur t'i vëzhgonte gjatë kontakteve me ta.

Përfundim

851. Gjykata konstaton se dëshmia e I.B. nuk është e besueshme dhe e vërtetë. Para së gjithash, kur u vlerësua kredibiliteti i saj, ishte e nevojshme të merret parasysh se kjo dëshmitare ishte e përfshirë thellë në konflikt personal me L.B.C., i cili sipas prokurorisë kishte marrë pjesë në vrasjen e R.D. Dëshmia e saj e justifikon përfundimin se ajo vendosi ta akuzojë bashkëshortin e saj publikisht për shumë vepra penale sepse në këtë mënyrë ajo u përpoq të siguronte pozitë më të mirë në procedurat që kishin të bënin me shkurorëzimin. Nuk mund të përjashtohet se ajo madje ishte e gatshme ta shantazhonte atë dhe të kërkonte para nga ai që të mos

dëshmonte në këtë shqyrtim. Kur u pyet për 1.000.000 euro të shkruara në një copë letër, ajo nuk e mohoi se ajo nuk e kishte bërë këtë. Ajo tha vetëm se asaj nuk i kujtohej ky fakt.

852. Versioni i saj i ngjarjeve para vdekjes së R.D. dallonte në mënyrë të konsiderueshme nga ai i paraqitur nga dëshmitarët e prokurorisë. Në të vërtetë, ajo e paraqiti një motiv tjetër për vrasjen e R.D. – sipas saj ishte bashkëshorti i saj ai i cili donte ta vriste atë për hakmarrje sepse R.D. po përpiqej ta vriste atë kur ai ishte i fshehur në Turqi nga Z.C. Ajo ishte personi i vetëm i cili e përmendi këtë motiv dhe deklarata e saj nuk është vërtetuar me ndonjë provë tjetër. L.B.C. e mohoi këtë kategorikisht dhe nënvizoi se në këtë periudhë shumë njerëz, sidomos nga vendet e Ballkanit, po përpiqeshin ta gjenin dhe ta vrisnin atë. Kjo do të thoshte se nëse ky ishte motivi i tij, ai duhet ta kishte planifikuar që të bënte hakmarrje kundër shumë njerëzve.
853. I.B. ishte po ashtu e vetmja dëshmitare e cila tha se ishte L.B.C. personi i cili donte ta vriste R.D. dhe si rrjedhojë kishte kërkuar ndihmë nga N.K. Sipas prokurorisë, ishte e kundërta, N.K. kishte kërkuar nga L.B.C. që ta ndihmonte në ekzekutimin e R.D.
854. Ajo po ashtu nuk ishte konsekuente me akuzat e saj kundër përfshirjes së pretenduar të L.B.C. në vrasjet. Kur u pyet për këtë, ajo tha se ai ishte i përfshirë në dy sosh, madje ajo i përmendi emrat e viktimave, por asnjëri prej tyre nuk ishte R.D. Vetëm më vonë ajo shtoi se L.B.C. kishte planifikuar që ta vriste edhe atë. Megjithatë, gjatë marrjes së mëtejme në pyetje ajo tha se N.K. kishte kërkuar nga ai që t'i gjente vrasës për kryerjen e disa vrasjeve në Sarajevë, pa treguar emrat e viktimave të mundshme. Në fund të dëshmisë së saj, ajo erdhi në

përfundim se në të vërtetë ajo nuk e dinte nëse L.B.C. dhe N.K. donin ta vrisnin R.D.

855. Nuk ka prova që ta mbështesin pohimin e I.B. se L.B.C. ia kishte dhënë veturën e blinduar M.Os. Ky pretendim ishte mohuar nga L.B.C. dhe M.Os. të cilët e shpjeguan në detaje se pse kishte ndodhur që ai e kishte shfrytëzuar veturën e blinduar të L.B.C. Dëshmia e tij është vërtetuar me deklaratën e L.B.C. i cili konfirmoi se vetura e tij ishte për servisim në Surcin, dhe punëtorë nga atje kishin ardhur për ta marrë atë. Më tej, I.B. pranoi se vetura gjatë gjithë kohës ishte e regjistruar në emër të bashkëshortit të saj, dhe më pastaj ajo u konfiskua nga policia, e më vonë i ishte kthyer atij.
856. Gjykata konstaton se prokurori nuk ka paraqitur prova bindëse dhe të besueshme për t'i mbështetur pohimet e I.B. Përveç kësaj, ka prova se I.B. kishte qëndruar në kontakt me S.T. dhe K6. Kjo mbështetet me mesazhet të cilat janë postuar në llogarinë në Facebook të S.T. kur ata të tre po rrinin së bashku dhe e quanin veten si "Treshja e Zezë". Kjo e mbështet dyshimin se ata po i koordinonin dëshmitë e tyre.

3.31. Kërcënimet/ndikimi mbi S.T.

857. **S.T.** dëshmoi se në fund të vitit 2010 ose në fillim të vitit 2011, disa oferta për biseda dhe para nga F.R. për tërheqje të dëshmisë së saj i ishin bartur S.T. nga një gazetar dhe kushëri i tij.⁸⁸⁵

⁸⁸⁵ 23.03.2015, f. 16

858. Në vitin 2012 ose 2013, S.T. ishte takuar me bashkëshorten e F.R. e cila i ishte afruar asaj dhe i kishte ofruar ndihmë. Ajo kishte refuzuar dhe kishte thënë “edhe nëse bashkëshorti im do të ishte në burg për 100, dhe nëse unë dhe fëmija im do të vdisnim nga uria, unë asnjëherë nuk do të ulem me të në tavolinë të njëjtë dhe dërgoja atij mesazhin tim se pa marrë parasysh se sa shumë ai po përpiqet të më shkatërrojë mua psikologjikisht, kjo nuk do të ndodhë dhe unë do të dëshmoj kundër tij”.⁸⁸⁶

859. Ajo pohoi se kishte marrë kërcënime dhe se për shkak të kësaj ajo ishte nën mbrojtje të policisë. Ajo nuk kishte dhënë asnjë detaj për këtë çfarë do të bënte të mundur identifikimin e burimit të kërcënimeve të pretenduara.⁸⁸⁷

860. **Z.T.** dëshmoi se ai nuk ishte në dijeni të ndonjë kërcënimi që kishte marrë S.T. Ai vetëm tregoi se ata po ndiqeshin dhe po u bëhej presion.⁸⁸⁸

Përfundim

861. Gjykatës nuk i është paraqitur ndonjë provë bindëse se S.T. ishte kërcënuar në ndonjë mënyrë. Çfarë është po ashtu e rëndësishme, ajo dëshmoi para Gjykatës disa herë, secilën ditë për disa orë dhe ajo fliste lirisht. Nganjëherë ndodhte që ajo sillej në mënyrë emocionale, megjithatë reagimet e saj nuk e tejkalonin sjelljen standarde të dëshmitarëve të tjerë.

3.32. A.S.

862. A.S. ishte në lidhje me R.D. që nga gushti/shtatori 2006.⁸⁸⁹ Sipas saj, R.D. ishte

⁸⁸⁶ 23.03.2015, f. 13

⁸⁸⁷ 23.03.2015, f. 15 - 16

⁸⁸⁸ 17.06.2015, f. 17

⁸⁸⁹ 13.01.2016, f. 8

i respektuar në qytet. Ai nuk respektohej vetëm nga G.-ët, K.-ët dhe Z.T. ⁸⁹⁰

863. Kur u mor në mënyrë të tërthortë në pyetje, ajo tha se emrin N.K. e kishte mësuar kur ajo kishte filluar të dilte në takim me R.D. ⁸⁹¹ Ajo nuk kishte biseduar me R.D. për ekzistimin e tyre. Gjatë lidhjes së saj me R.D., asnjë N.K. nuk ishte parë gjersa ata ishin së bashku. R.D. nuk kishte foluar me të për N.K. Faktin se ai ishte në relacione të këqija me N.K., ajo e kishte kapur kur ai po diskutonte me A.P. lidhur me konfliktin e tij me N.K. ⁸⁹² Asaj nuk i kujtohet nëse R.D. kishte folur ndonjëherë lidhur me E.Ke. ⁸⁹³
864. A.S. pohoi se ajo e dinte se R.D. dhe N.K. kishin një konflikt. Megjithatë, asaj nuk i kujtohej saktësisht nëse R.D. i kishte thënë këtë. ⁸⁹⁴
865. Gjatë marrjes së tërthortë në pyetje, ajo pranoi se asaj i kujtohej deklarata e dhënë para Oleg Cavka se R.D. e kishte thirrur E.Ke. dhe e kishte pyetur nëse ata ishin në konflikt apo jo. ⁸⁹⁵ Ajo shpjegoi se sipas të gjitha gjasave ishte A.P. ose Al.H. ai i cili i kishte treguar asaj. Ajo shtoi se R.D. i kishte kryer të gjitha bisedat e rëndësishme larg saj. ⁸⁹⁶
866. A.S. thas e R.D. asnjëherë nuk kishte folur me të se N.K. gjoja ishte i përfshirë në aktivitete me drogë. Ai i tha asaj se ai kishte një konflikt me N.K. për shkak të

⁸⁹⁰ 18.01.2016, f. 39

⁸⁹¹ 13.01.2016, f. 33

⁸⁹² 13.01.2016, f. 33

⁸⁹³ 13.01.2016, f. 37

⁸⁹⁴ 18.01.2016, f. 9

⁸⁹⁵ 18.01.2016, f. 10-11

⁸⁹⁶ 18.01.2016, f. 11

marrëveshjeve të tij me drogë.⁸⁹⁷ Andaj, ajo u ballafaqua me deklaratën e saj të mëparshme – 13 janar – ku ajo ishte pyetur nëse R.D. kishte folur me të rreth N.K. në ndonjë mënyrë, dhe ajo ishte përgjigjur “jo me mua”. Këtë herë ajo u përgjigj se ishte A.P. dhe Al.H. me ta, dhe se ai kryesisht po diskutonte me ta.⁸⁹⁸ Gjatë lidhjes së tyre, ajo nuk kishte diskutuar për K.-ët. Ajo vetëm e dinte se konflikti ekzistonte.⁸⁹⁹

867. R.D. nuk ia kishte bërë të ditur asaj se pse ai ishte i brengosur për sigurinë e tij.⁹⁰⁰ Ajo kishte dëgjuar nga ai për konfliktin në Stamboll që G.-ët, domethënë “Zu.”, dhe dy ose tre persona të tjerë të cilët kishin ardhur ta vrisnin atë, por ai e kishte zbuluar këtë dhe i kishte rrahur ata.⁹⁰¹
868. Ajo dëshmoi se një herë ata ishin duke u vozitur në një veturë dhe po kalonin kah shtëpia e M.A.G. dhe R.D. po e shikonte shtëpinë dhe po e ngadalësonte. Ai tha se “Unë duhet t’i bëj diçka atij, ose për të, sepse ata po përgatisin diçka për mua”. Kur ajo e pyeti kush, ai tha *Shiptari* dhe ai po mendonte për M.A.G. dhe N.K.⁹⁰² Kjo ishte pesë ditë para vdekjes së tij.⁹⁰³
869. R.D. i kishte thënë asaj se M.A.G. dhe N.K. ishin në relacione të mira. Grupi i N.K. ishte më i fuqishëm, më në numër. Ajo e dinte këtë sepse pas vdekjes së R.D., ajo i kishte parë ata në qytet.⁹⁰⁴ R.D. dhe K.-ët ishin armiq. R.D. i kishte thënë asaj se kishte pasur mosmarrëveshje në lidhje me drogën.⁹⁰⁵

⁸⁹⁷ 18.01.2016, f. 25

⁸⁹⁸ 18.01.2016, f. 26

⁸⁹⁹ 18.01.2016, f. 26

⁹⁰⁰ 13.01.2016, f. 10

⁹⁰¹ 13.01.2016, f. 9

⁹⁰² 13.01.2016, f. 11 - 12

⁹⁰³ 13.01.2016, f. 13

⁹⁰⁴ 13.01.2016, f. 12

870. Gjatë marrjes së tërthortë në pyetje, A.S. nuk e besonte bindjen e vet se N.K. ishte një armik në këtë situatë kur ata po kalonin pranë shtëpisë së M.A.G. Me sa kishte dijeni ajo ata ishin në konflikt qysh para lidhjes së tyre.⁹⁰⁶ R.D. e mbronte atë nga informatat e tilla. Fakti se ai ishte në konflikt me N.K. ishte njohuri e përgjithshme. R.D. vazhdimisht mbante armë, jetonte nën frikë, shikonte nën veturë. Ai mbante të veshur jelek anti-plumb por nuk ishte për shkak të N.K. Kjo ishte për shkak të armiqve të tij.⁹⁰⁷
871. R.D. e njihte Z.T. Me sa di A.S. ata nuk kishin pasur ndonjë kontakt.⁹⁰⁸ Ajo e kishte parë mosmarrëveshjen mes atyre të dyve në Natën e Vitit të Ri, 2006 – 2007. R.D. këmbëngulte që në njeri në shoqërinë e Z.T. duhet të largohet nga lokalet – e diskotekës Aqua.⁹⁰⁹ Ata kishin pasur një mosmarrëveshje, por asnjëri nuk ishte larguar nga lokali.⁹¹⁰ Ajo dëshmoi se R.D. nuk kishte frikë nga Z.T.⁹¹¹ Ai nuk ia kishte thënë këtë asaj.⁹¹²
872. R.D. e njihte N.O., por ishte i zhgënjyer me të sepse ai kishte kaluar në anën e N.K.⁹¹³ R.D. asnjëherë nuk kishte folur me të për F.R.⁹¹⁴

⁹⁰⁵ 13.01.2016, f. 13

⁹⁰⁶ 18.01.2016, f. 21

⁹⁰⁷ 18.01.2016, f. 21

⁹⁰⁸ 13.01.2016, f. 13

⁹⁰⁹ 13.01.2016, f. 14

⁹¹⁰ 13.01.2016, f. 29

⁹¹¹ 18.01.2016, f. 37

⁹¹² 18.01.2016, f. 40

⁹¹³ 13.01.2016, f. 15

⁹¹⁴ 13.01.2016, f. 19, 29

873. A.S. e kishte takuar S.T. në ditëlindjen e saj në vitin 2006 kur ajo kishte ardhur me R.D., A.P. dhe një njeri tjetër të quajtur “Pa.”. Ajo nuk e dinte nëse R.D. dhe S.T. ishin miq.⁹¹⁵ Disa muaj para vrasjes së R.D., A.S., S.T. dhe dy ose tre persona të tjerë kishin ngrënë drekë së bashku.⁹¹⁶
874. Ajo asnjëherë nuk kishte pasur kontakte personale me N.K. dhe M.A.G.⁹¹⁷ Asaj i kujtohet që më 13 korrik 2007, ishin arrestuar të bijtë e N.K.⁹¹⁸ Sipas të gjitha gjasave ishte E.Ke. i cili ishte arrestuar në lidhje me vrasjen e R.D.⁹¹⁹ Kur u pyet lidhur me arrestimin e Z.T. pak pas vdekjes së R.D., ajo tha se asaj nuk i kujtohej çdo person që ishte arrestuar.¹²³⁰
875. Ajo i kishte ndërprerë kontaktet me A.P. menjëherë pas vrasjes së R.D., sepse ai e kishte thirrur atë po të njëjtën natë dhe kishte filluar ta kërcënonte atë. Ai me të vërtetë ndjehej keq për vdekjen e mikut të tij më të mirë, dhe ai kishte thënë se ai do ta vriste atë dhe do ta varroste atë afër tij.⁹²⁰
876. A.S. e pranoi se ajo ishte shumë e interesuar për rezultatet e këtij shqyrtimi por që ajo nuk i kishte lexuar deklaratat që të mos ndikohej.⁹²¹ Në anën tjetër, ajo vetëm i kishte parë titujt në Avaz dhe ajo supozoi se në kuptimin e plotë të fjalës po bëhej një masakër ndaj S.T. Ajo e dinte këtë nga nëna e saj e cila i lexonte ato. Nëna e saj herë pas here ka mundur t’i ketë treguar asaj se çfarë kishte dëshmuar S.T. në lidhje me vrasjen, se ajo po e akuzonte F.R, se ka pasur një

⁹¹⁵ 13.01.2016, f. 19

⁹¹⁶ 13.01.2016, f. 28-29

⁹¹⁷ 13.01.2016, f. 27

⁹¹⁸ 13.01.2016, f. 28

⁹¹⁹ 18.01.2016, f. 13 ¹²³⁰

13.01.2016, f. 33

⁹²⁰ 18.01.2016, f. 31 - 32

⁹²¹ 18.01.2016, f. 32

marrëveshje ndërmjet tij dhe N.K. ⁹²²

877. Ajo asnjëherë nuk kishte diskutuar ose ishte takuar me S.T. me qëllim. ⁹²³

878. Gjatë marrjes së tërthortë në pyetje, ajo u ballafaqua me deklaratën e saj nga viti 2014 kur ajo u pyet lidhur me armiq të e R.D. Atëherë ajo përmendi N.K., vëllezërit G., M.A.G. dhe A.A.G. dhe Z.T. Kur u pyet se ajo nuk kishte bërë dallime ndërmjet tyre, ajo shpjegoi se ata nuk i kishin shtruar pyetje shtesë.⁹²⁴ Ajo qëndroi prapa kësaj deklaratë.⁹²⁵ Arsyeja e vetme pse Z.T. dhe R.D. ishin armiq ishte ajo situata me rastin e Vitit të Ri të cilën ajo e kishte përshkruar.⁹²⁶

879. Ajo nuk kishte dëgjuar asnjëherë për pajtimin ndërmjet R.D. dhe Z.T. Pas vdekjes së R.D., Z.T. erdhi tek ajo për t'i thënë se ata ishin pajtuar por ajo nuk donte të fliste me të. ⁹²⁷ Ajo nuk ishte e sigurt por mund të ketë qenë dy vjet pas vdekjes së R.D. ⁹²⁸ Ata ishin takuar në një kafene, ajo ishte me mikun e saj, Z.T. ishte me S.T. Ajo ishte përshëndetur me S.T., por e kishte injoruar Z.T. i cili tha se nuk kishte nevojë për këtë sepse ai ishte pajtuar me R.D. Ajo e injoroi atë sepse pas vdekjes së R.D. ajo i kishte ndërprerë të gjitha kontaktet me njerëzit nga kjo botë. ⁹²⁹ Ajo i kishte ndërprerë kontaktet edhe me S.T. por kur ajo e pa atë, ato vetëm e përshëndetën njëra-tjetrën. Ajo e kishte parë atë vetëm tre herë

⁹²² 18.01.2016, f. 33

⁹²³ 18.01.2016, f. 33

⁹²⁴ 13.01.2016, f. 32

⁹²⁵ 18.01.2016, f. 18

⁹²⁶ 18.01.2016, f. 20

⁹²⁷ 18.01.2016, f. 18

⁹²⁸ 18.01.2016, f. 19

⁹²⁹ 18.01.2016, f. 19

në publik.⁹³⁰

880. R.D. asnjëherë nuk kishte folur me të për Z.T. Ai nuk e kishte përmendur atë asnjëherë se ai dyshonte në të se ai i kishte gjuajtur bombë në shtëpinë e tij. ajo e dinte se kishte pasur njëfarë konflikti mes tyre por ajo nuk e dinte se nga cila kohë. ⁹³¹
881. Ajo tha se ajo i dinte emrat e të bijve të N.K. por ajo nuk i tregoi ata. Ajo e kishte parë njërin prej tyre në Sarajevë para pak muajsh. Natyrisht, ai nuk e kishte kërcënuar atë ose i ishte afruar asaj.⁹³² Vetëm pas vdekjes së R.D. ajo i lidhi emrat e Kelmendëve me fotografitë e tyre.⁹³³
882. Ajo asnjëherë nuk e kishte dëgjuar R.D. duke thënë se N.K. ose ndonjëri nga K.-ët donte ta vriste atë. ⁹³⁴ Vetëm kur ata po kalonin kah shtëpia e M.A.G., R.D. kishte thënë në lidhje me *Shqiptarët*.⁹³⁵ Ajo nuk e dinte nëse M.A.G. është shqiptar. ⁹³⁶
883. Ajo nuk kishte lexuar asgjë në lidhje me këtë shqyrtim. Ajo nuk ishte e interesuar. Ajo nuk i kishte lexuar artikujt e S.T.⁹³⁷ Ajo nuk ka asnjë kontakt me A.P. Ata e injoronin njëri-tjetrin. Ai e fajësonte atë për vdekjen e R.D. ⁹³⁸
884. R.D. i kishte thënë asaj pak ditë para vdekjes se ai kishte marrë një sms me kërcënime. Ai nuk kishte treguar se nga kush. ⁹³⁹

⁹³⁰ 18.01.2016, f. 19

⁹³¹ 13.01.2016, f. 32-33

⁹³² 13.01.2016, f. 34

⁹³³ 18.01.2016, f. 425

⁹³⁴ 18.01.2016, f. 15

⁹³⁵ 18.01.2016, f. 15-16

⁹³⁶ 18.01.2016, f. 16

⁹³⁷ 18.01.2016, f. 29

⁹³⁸ 18.01.2016, f. 30

Përfundim

885. A.S. nuk ka ndonjë njohuri të drejtpërdrejtë se kush qëndronte prapa vdekjes së R.D. Ajo e kishte të qartë se R.D. po e mbronte atë nga informatat në lidhje me problemet e tij. Ajo pohimet e veta se R.D. kishte një konflikt me shqiptarët i bazon në ato çfarë ajo kishte dëgjuar kryesisht nga A.P. Prandaj, kjo pjesë e dëshmisë së saj nuk paraqesin prova për të mbështetur rastin e prokurorisë.

3.32.1. Ndikimi mbi A.S.

886. A.S. dëshmoi se më 14 dhjetor 2015 asaj i ishte kërkuar nga menaxheri i saj që ta mbronte F.R. Ajo ishte përgjigjur se do ta thonte të vërtetën. Ajo tha se qëndronte prapa deklaratës së saj nga viti 2014.⁹⁴⁰

887. Më 15 dhjetor 2015 ajo ishte takuar me B.Da. dhe gruan e tij jashtëmartesore. Ata i kishin bërë presion asaj që ta mbronte F.R. në gjykimin kundër N.K. sa më shumë që të ishte e mundur. Ajo u kishte thënë atyre se ishin tre pyetje rreth F.R., ajo u përgjigjur shkurt dhe se ajo do ta përsëriste të njëjtën gjë.⁹⁴¹

888. Më 17 dhjetor 2015 asaj edhe një herë i ishte afruar gruaja e njëjtë, e cila e kishte thirrur atë, dhe ato ishin takuar në mbrëmje para Hotel Parkut. Kjo zonjë “Bi.” e ka bartur mesazhin që F.R. kishte kërkuar që të mbrohej edhe N.K. A.S. e përsëriti se ajo do të qëndronte prapa dëshmisë së saj, por ajo po ashtu ishte kureshtare se çfarë donin ata saktësisht nga ajo. “Bi.” e tregoi fletoren e saj me fjalitë që duhet të rishkruhen.⁹⁴²

⁹³⁹ 18.01.2016, f. 31

⁹⁴⁰ 13.01.2016, f. 20-21

⁹⁴¹ 13.01.2016, f. 22

889. Ajo duhej të dëshmonte se R.D. nuk ishte në lidhje me të, dhe se ajo vetëm kishte qëndruar në shtëpinë e tij me bashkëshorten e tij dhe familjen e tij. Nga ajo pritej të konfirmonte se R.D. asnjëherë nuk kishte pasur një aferë me gruan e F.R. Ajo duhej të thoshte se R.D. kishte pasur një konflikt vetëm me G.-ët dhe Turkovic dhe se ai ishte në raporte miqësore me N.K. Ajo duhej të thoshte se R.D. nuk kishte asnjë kontakt me S.T.⁹⁴³ A.S. tha se se ajo nuk do të gënjente, ajo do të tregonte të vërtetën. “Bi.” kishte thënë se shefi (F.R.) do të bënte diçka për të, nëse ishte e nevojshme. N.K. ishte i rrezikshëm dhe se ai do të dërgonte dikë për ta vrarë atë. A.S. nuk u pajtua. Të nesërmen ajo refuzoi të dëshmonte në Kosovë. Ajo e raportoi këtë ngjarje tek autoritetet.⁹⁴⁴
890. Gjatë marrjes në pyetje, A.S. dëshmoi se ajo kishte përshtypjen se “Bi.” po e përcillte tek ajo mesazhin e F.R. dhe të N.K. Ajo nuk tregoi se ajo ishte në kontakt me N.K.⁹⁴⁵
891. **F.R.** dëshmoi se ai nuk kishte folur, e as kush tjetër në emër të tij, me A.S..⁹⁴⁶
892. Një ditë para dëshmisë së tij në Kosovë, autoritetet e Bosnjes kishin dorëzuar një regjistror me transkriptet të thirrjeve telefonike të F.R. me njerëz të tjerë. Tashmë ato ishin të përkthyer në anglisht. Duhet të nënvizohet se ai ishte dërguar pa kërkesë nga pala e Kosovës, pasi që Gjykata nuk ishte në dijeni të ekzistencës së tij, dhe prokurori nuk kishte informuar se ai kishte ditur për këtë.

⁹⁴² 13.01.2016, f. 23

⁹⁴³ 13.01.2016, f. 24

⁹⁴⁴ 13.01.2016, f. 24-25

⁹⁴⁵ 13.01.2016, f. 30 - 31

⁹⁴⁶ 31.10.2016, f. 16

893. Mbrojtja e kundërshtoi pranimin e këtyre transkripteve, megjithatë Gjykata pas këshillimit e pranoi atë. Si rrjedhojë, F.R. refuzoi t'i përgjigjej çfarëdo pyetje që kishte të bënte me bisedat e përgjuara duke pretenduar se vëzhgimi ka qenë i paligjshëm.

Përfundim

894. Gjykata nuk i ka dëgjuar dëshmitë e njerëzve të cilët gjoja i janë afruar A.S. në emër të F.R. dhe N.K. Fakti se më 16 dhjetor 2016, A.S. refuzoi të dëshmonte dhe ishte dukshëm nervoze tregon se duhet të ketë pasur ndonjë arsye për një sjellje të tillë. Megjithatë, çfarë është relevante për këtë rast, A.S. nuk kishte asnjë njohuri të drejtpërdrejtë lidhur me atë se kush qëndronte prapa vrasjes.
895. Në të njëjtën kohë, Gjykata vërejti se në dëshminë e saj të mëparshme të dhënë pak pas vdekjes së R.D., A.S. nuk e kishte përmendur N.K. si potencialisht të përfshirë në këtë vrasje. Ajo e kishte përdorur emrin e tij vetëm kur u pyet për personat me të cilët R.D. kishte pasur konflikt dhe ajo kishte përmendur disa sish. Prandaj, i akuzuari objektivisht nuk ka pasur arsye të përpiqej t'i afrohej asaj në çfarëdo mënyrë për të ndikuar në dëshminë e saj.
896. Dëshmitarja A.S. dëshmoi përmes video-lidhjes. Duhet të përmendet se në seancën e mbajtur më 13 janar 2016 Gjykata e pranoi kërkesën e saj që t'i bënte zoom kamerës gjatë marrjes së tërthortë në pyetje mbi mbrojtjen, që i akuzuari të mos ishte i dukshëm për të. Në atë moment, vendimi ishte marrë pa e vlerësuar kredibilitetin e dëshmitares, por Gjykata mori parasysh se ajo bëri të ditur njëfarë rrethane që e justifikonte frikën e saj nga Z. N.K. Sipas ligjit, gjykata madje mund të vendosë që i akuzuari të largohet nga salla e gjykimit gjatë marrjes në pyetje të dëshmitarit, kështu që Gjykata gjeti se asnjë nga të drejtat e tij nuk ishin shkelur kur ai ishte vendosur në atë mënyrë që të mos ishte i dukshëm për dëshmitaren përmes video-lidhjes.

3.33. E.D.

897. Sipas E.D., gjatë dimrit të fundit para vrasjes, në shtëpinë e tyre ishte hedhur një bombë. R.D. kishte menduar se kjo ishte nga Z.T. sepse ata kishin pasur një konflikt që përpara luftës, mes atyre të dyve kishte pasur gjithmonë urrejtje.⁹⁴⁷ Para luftës, Z.T. kishte shtënë mbi bashkëshortin e saj, ai ishte gjykuar për këtë. Ai po ashtu e kishte sulmuar atë afër ndërtesës së presidencës.⁹⁴⁸
898. Sipas E.D., bashkëshorti i saj nuk kishte folur asnjëherë për F.R.⁹⁴⁹ Ai nuk kishte pasur ndonjë relacion me të.⁹⁵⁰ Ai nuk ishte i përfshirë në marrëdhënie intime me gruan e F.R.⁹⁵¹
899. Pas arrestimit të Z.T., S.T. erdhi te E.D. dhe i tha se F.R. dhe N.K. kishin paguar për vrasjen e R.D.; ata e bënë këtë para saj. E.D. nuk deshi të dëgjonte për këtë.⁹⁵² Ajo nuk i besonte asaj sepse ajo erdhi tre vjet pas vrasjes, dhe ajo nuk kishte ardhur t'i shprehte ngushëllimet e saj. E.D. nuk i besonte asaj sepse ajo nuk kishte ardhur më asnjëherë.⁹⁵³
900. Gjatë marrjes së tërthortë në pyetje, E.D. tha se ajo i besonte bashkëshortit të saj. Ajo ishte e informuar për të gjitha ngjarjet në jetën e tij, konfliktet dhe

⁹⁴⁷ 11.12.2015, f. 31

⁹⁴⁸ 11.12.2015, f. 44

⁹⁴⁹ 11.12.2015, f. 32

⁹⁵⁰ 11.12.2015, f. 41

⁹⁵¹ 11.12.2015, f. 42

⁹⁵² 11.12.2015, f. 37

⁹⁵³ 11.12.2015, f. 51

kërcënimet.⁹⁵⁴ Marrëdhënia e tij me një femër tjetër nuk kishte ndikuar në këtë besim.⁹⁵⁵ Ajo i njihte bashkëpunëtorët e tij: A.P., J.C., por mikja e vërtetë ishte ajo.⁹⁵⁶ Me sa dinte ajo R.D. nuk kishte qenë asnjëherë në konflikt me N.K.¹²⁶⁸ Ajo e mohoi kategorikisht se ⁹⁵⁷R.D. donte të krijonte një rrjet të trafikimit të drogës.⁹⁵⁸

Përfundim

901. Dëshmitë e E.D. nuk ofruan prova për ta mbështetur rastin e prokurorisë së N.K. ishte i përfshirë në vrasjen e R.D. Duhet të nënvizohet se grua e R.D. ajo ishte palë e dëmtuar në këtë rast, veçanërisht e interesuar në rezultatin e tij. Ajo nuk kishte interes të dëshmonte në favor të të pandehurit.

3.34. Al.H.

902. Al.H. ishte imam, të paktën gjatë rrjedhës së edukimit të fetar.⁹⁵⁹

903. Ai ishte mik i ngushtë i R.D. Ai ishte i ngarkuar për objektet dhe dyqanet e tij. Ai gjente apartamente për R.D., duke e paguar qiranë e tij, etj.⁹⁶⁰ Ai e shihte R.D. çdo ditë.⁹⁶¹

904. Gjatë shqyrtimit, Al.H. dëshmoi se R.D. ishte në konflikt me M.A.G. gjë që filloi në Turqi. R.D. e sulmoi njërin nga vëllezërit G., dhe ai e kishte akuzuar N.K. për dërgimin e kurdëve për ta vrarë atë.⁹⁶²

⁹⁵⁴ 11.12.2015, f. 38-39

⁹⁵⁵ 11.12.2015, f. 39

⁹⁵⁶ 11.12.2015, f. 39-40

⁹⁵⁷ 11.12.2015, f. 40

⁹⁵⁸ 11.12.2015, f. 41

⁹⁵⁹ 27.01.2016, f. 8

⁹⁶⁰ 27.01.2016, f. 8

⁹⁶¹ 27.01.2016, f. 9

905. Gjatë marrjes së tërthortë në pyetje, Al.H. e pranoi se ai nuk i kishte përmendur akuzat e R.D. kundër N.K se ai kishte dërguar kurdët në gjykimin G. sepse këto informata i ishin paraqitur atij para shumë kohësh, ndërsa më të freskëtat ishin rreth L.By. që kishte shtënë në A.P.⁹⁶³
906. Sipas Al.H., A.P., M.Al., D.Ce., J.C. dhe El.H. ishin shumë të lidhur me R.D.⁹⁶⁴ Të gjithë ata i përkisnin grupit të R.D. i cili merrej me aktivitete kriminale. R.D. nuk ishte shefi, por ata i gjendeshin atij.⁹⁶⁵
907. Gjatë marrjes së mëtejme në pyetje, Al.H. u tërhoq nga deklarata e tij se R.D. ishte i përfshirë në aktivitete kriminale. Dëshmitari nënvizoi se R.D. ishte person religjioz, hero i Sarajevës.¹²⁷⁷
908. R.D. kishte më shumë frikë nga N.K., me gjasë sepse ai ishte më i fuqishëm. M.A.G. kishte frikë nga R.D., ai po fshihej para tij.⁹⁶⁶ Sipas Al.H., R.D. e konsideronte N.K. si mbrojtës të M.A.G.⁹⁶⁷ Sa herë që R.D. e keqtrajtonte M.A.G., ai shkonte dhe ankohej te N.K. R.D. po e përcillte M.A.G.⁹⁶⁸

⁹⁶²27.01.2016, f. 9; 29.01.2016, f. 6-7

⁹⁶³ 22.02.2016, f. 11

⁹⁶⁴ 27.01.2016, f. 10

⁹⁶⁵ 29.01.2016, f. 9 – 10 ¹²⁷⁷

27.01.2016, f. 14

⁹⁶⁶ 27.01.2016, f. 10, 11

⁹⁶⁷ 29.01.2016, f. 6

⁹⁶⁸ 29.01.2016, f. 7

909. Al.H. nuk mendonte se ka pasur ndonjë konflikt drejtpërdrejt ndërmjet R.D. dhe N.K.⁹⁶⁹ Ai asnjëherë nuk kishte qenë dëshmitar i ndonjë konflikti ndërmjet tyre.⁹⁷⁰ Ai e konfirmoi se ai e kishte dëgjuar R.D. ta thirrte në telefon N.K. pas aksidentit të djalit të tij. Ishte disa muaj para vdekjes.⁹⁷¹
910. Ai e pranoi se R.D. nuk i pëlqenin shqiptarët, e veçanërisht M.A.G.⁹⁷² Al.H. nuk ishte në dijeni të armiqve të tjerë të R.D.⁹⁷³
911. Al.H. nuk e njihte Z.T. Ai e dinte se R.D. e njihte Z.T., por R.D. e përmendte atë shumë rrallë. Ai e kishte përmendur Z.T. në vitin 2006; në fillim të vitit 2006, kur ai ishte i ulur në një kafe bar të quajtur “Bohemia” në rrugën “V.P.”, i cili udhëhiqej nga “Vo.”, mik i R.D., M.U. R.D. ishte thirrur të vinte sepse Z.T. kishte ardhur atje me mikun e tij M.Me. Fatkeqësisht, problemi kishte ndodhur para se të mbërrinte atje R.D., gjë që ishte shkaktuar nga M.Me., dhe me atë rast ai dhe disa mysafirë të tjerë ishin plagosur. Policia erdhi dhe e arrestoi atë.⁹⁷⁴ Sipas Al.H., ishte vetëm një mosmarrëveshje që R.D. and Z.T. kishin pasur vitet e kaluara.⁹⁷⁵
912. Al.H. e njihte Ek.L. nga qyteti. Ai asnjëherë nuk foli në lidhje me të me R.D. asnjëherë nuk kishte folur për gruan e F.R.⁹⁷⁶
913. Ai i konfirmoi deklaratat e tij të dhëna në gjykimin kundër M.A.G. ku ai kishte thënë se njerëzit shkuan në Beograd me 250.000 euro për vrasjen e R.D. dhe

⁹⁶⁹ 27.01.2016, f. 10

⁹⁷⁰ 22.02.2016, f. 25

⁹⁷¹ 22.02.2016, f. 26

⁹⁷² 29.01.2016, f. 7

⁹⁷³ 27.01.2016, f. 15

⁹⁷⁴ 27.01.2016, f. 16

⁹⁷⁵ 27.01.2016, f. 17

⁹⁷⁶ 29.01.2016, f. 5

50.000 euro për A.P. Ai mendon se ishte një njeri me pseudonimin “P.”.⁹⁷⁷ Atij po ashtu i ishte thënë nga R.D. se M.A.G. u kishte ofruar njerëzve në Beograd 200.000 KM për R.D., dhe 100.000 KM për A.P. Ai e kishte marrë këtë informatë nga E.P., dhe këto duhet të paguheshin nga njeriu me pseudonimin “Zu.”.⁹⁷⁸

914. Al.H. e kishte një mik S.El. i cili i kishte thënë atij se L.By. i cili kishte ikur për në Kosovë po mburrej në Prizren se ai e kishte vrarë bosin më të madh enë Sarajevë. Ai kishte dëshmuar për këtë në gjykimin M.A.G.⁹⁷⁹ Al.H. në atë kohë kishte ardhur në përfundim se ishte L.By. personi i cili e kishte vrarë R.D. Megjithatë, ai e pranoi se ai më nuk ishte i sigurt për këtë. Ai komentoi se secili person i arrestuar në Bosnje ishte i akuzuar për vrasjen e R.D. Ai ndërroi mendje për shkak se gjykata e kishte liruar nga akuzat M.A.G.⁹⁸⁰ Në gjykimin e G., ai nuk e përmendi S.L. fare sepse atij nuk i ishte dukur kjo relevante. Ai nuk e dinte se pse nuk e kishte përmendur këtë më herët.⁹⁸¹

915. Ai e pranoi se ai kishte lexuar se S.T. e kishte akuzuar F.R. dhe N.K. për vdekjen e R.D. Ai po ashtu kishte lexuar se ajo po e akuzonte Ek.L. e ishte i përfshirë në këtë. Ai nuk kishte lexuar se cili ka qenë motivi sipas saj, por ia mendonte se nuk kishte tjetër, vetëm fakti se ata ishin vëllezër.⁹⁸²

⁹⁷⁷ 29.01.2016, f. 18 -19; 22.02.2016, f. 22

⁹⁷⁸ 22.02.2016, f. 123

⁹⁷⁹ 29.01.2016, f. 21; 22.02.2016, f. 23

⁹⁸⁰ 22.02.2016, f. 24 - 25

⁹⁸¹ 22.02.2016, f. 9 – 10

⁹⁸² 22.02.2016, f. 10

916. Ai e pranoi se ka ndarë në këtë gjykim më shumë informata se në gjykimin e G. sepse ai tani di më shumë. Pak më vonë, ai tha se nuk ishte se ai nuk dinte, por ai nuk kishte dashur t'i ndante me ta për shkak të sigurisë së tij personale.⁹⁸³
917. Ka pasur edhe informata se Z.T. e kishte vrarë R.D. por sipas tij këto ishin të pakuptimta sepse ata asnjëherë nuk kishin pasur mosmarrëveshje të tilla që do të mund të përfundonin në varr. Sipas mendimit të tij, Z.T. kishte frikë më shumë se kushdo.⁹⁸⁴

Përfundim

918. Al.H. ishte njëri nga shumë dëshmitarët, të lidhur ngushtë me R.D., i vendosur që të gjenden njerëzit përgjegjës për vdekjen e tij. ai kishte qenë mik dhe bashkëpunëtor i tij i ngushtë, andaj ai kishte njohuri mjaft të gjera për të.
919. Ishte e dukshme se ai e përshtaste dëshminë e tij sipas zhvillimi të situatës. Gjatë procedurës kundër M.A.G., Al.H. ishte i bindur se ai ishte prapa vrasjes. Ai e humbi bindjen pas lirit të tij nga akuzat. Gjatë gjyqimit të tanishëm ai shmangte çdo deklaratë të qartë se kush duhej të fajësohej për këtë, çfarë tregonte se ai nuk kishte njohuri të drejtpërdrejta. Ai nënvizoi se ai nuk ishte në dijeni për ndonjë konflikt ndërmjet R.D. dhe N.K. Si shumë dëshmitarë të tjerë, ai ndau me Gjykatën spekulime dhe thashetheme.
920. Çfarë ishte me relevancë të veçantë në rastin e dëshmisë së tij, ishte konfirmimi se R.D. ishte i përfshirë në aktivitete kriminale dhe se ai kishte shumë armiq rreth vetes. Ai tregoi për disa incidente me njerëz të ndryshëm kur R.D. kishte hyrë në konflikt, gjë që nganjëherë për pasojë kishin përdorimin e armëve. Ishte e dukshme se gjatë marrjes në pyetje ai përpiqej ta zbuste deklaratën e tij të ashpër

⁹⁸³ 22.02.2016, f. 15

⁹⁸⁴ 22.02.2016, f. 27

në lidhje me R.D. duke lënë për t'u nënkuptuar se ai ishte njëri i mirë, baba i familjes dhe hero i Sarajevës, por ai nuk u tërhoq nga pretendimet e tij se ai ishte i përfshirë në aktivitete kriminale.

3.36. K6, B.L., F.R. – informata shtesë

921. Një dëshmitar tjetër i propozuar nga prokurori për t'i vërtetuar akuzat për vrasje ishte **K6**. Ky dëshmitar ishte propozuar tashmë pas fillimit të shqyrtimit gjyqësor.

922. **K6** filloi të punonte për AVAZ në tetor të vitit 2006.⁹⁸⁵ Ai pohoi se kishte dhënë dorëheqje nga puna e tij në dhjetor të vitit 2014.⁹⁸⁶ Për shkak të përvojës së tij në polici, ai punonte si shofer i F.R.⁹⁸⁷ Ai punonte me ndërrime,¹³⁰⁰ edhe gjatë fundjavave⁹⁸⁸⁹⁸⁹ Përveç vozitjes, ai ishte edhe zyrtar për mbrojtje. Ai zakonisht e priste F.R. në dhomën me kamera të vëzhgimit.⁹⁹⁰

923. Ai e voziste F.R. nga shtëpia në punë dhe anasjelltas, më vonë edhe për në restorane. F.R. gjithmonë ulej në ulësen e përparme, pa marrë parasysh se kjo ishte kundër rregullave.⁹⁹¹ Ai i lexonte gazetat, fliste në telefon. Ai rrallë fliste me shoferin.⁹⁹²

⁹⁸⁵ 15.09.2015, f. 5; librezë e punës

⁹⁸⁶ 15.09.2015, f. 42;

⁹⁸⁷ 15.09.2015, f. 6;

⁹⁸⁸ 15.09.2015, f. 9;

⁹⁸⁹ 15.09.2015, f. 12;

⁹⁹⁰ 15.09.2015, f. 12;

⁹⁹¹ 15.09.2015, f. 10;

⁹⁹² 15.09.2015, f. 10;

924. **F.R.** konfirmoi se kur ai shkonte në punë, ai zakonisht ulej në ulësen e përparmë për shkak se e mundonte rruga. Ai nuk flet me shoferin, ai flet përmes telefonit.⁹⁹³ Anëtarët e familjes së tij udhëtojnë me veturë me të. Miku i tij e kishte veturën e vet. Ai mendon se S.T. asnjëherë nuk ishte ulur në këtë veturë, e as Ek.L., e as N.K.⁹⁹⁴
925. **K6** pohoi se kur F.R. po fliste në telefon ai përdorte pseudonime. Ai po ashtu e përdorte pseudonimin *Stari* për N.K.⁹⁹⁵ Kur u pyet për pseudonimin e N.K më parë, ai tha se nuk i kujtohej nëse ai kishte ndonjë pseudonim.⁹⁹⁶ Gjatë marrjes së tërthortë në pyetje, ai tha se ai nuk ishte i sigurt në lidhje me pseudonimin, se më shumë ishte hamendje e tij.⁹⁹⁷
926. Përveç F.R. ai e voziste edhe S.Ba.. Atij nuk i kujtoheshin njerëz të tjerë.⁹⁹⁸ Ai shtoi më vonë: S.T., Ek.L., edhe të dy ata në të njëjtën kohë. S.T. vozitej në veturën e blinduar.⁹⁹⁹ Pak më vonë, ai tha se mysafirët nuk voziteshin me veturën e blinduar, por me atë të zakonshmen.¹⁰⁰⁰ Gjatë marrjes në pyetje, ai ndërroi mendje dhe tha se S.T. vozitej me ta rregullisht çdo ditë, njësoj sikurse edhe Ek.L.¹⁰⁰¹
927. **Ek.L.** e pranoi se K6 ishte ndihmës shofer i FR. Ai ishte vozitur nga ai. Ai kishte lexuar për dëshminë e tij në media.¹⁰⁰² Ai nuk do ta njilhte K6.¹⁰⁰³ Ai i kishte

⁹⁹³ 31.10.2016, f. 14 - 15

⁹⁹⁴ 31.10.2016, f. 15

⁹⁹⁵ 15.09.2015, f. 32-33;

⁹⁹⁶ 15.09.2015, f. 27;

⁹⁹⁷ 16.09.2015, f. 47

⁹⁹⁸ 15.09.2015, f. 12;

⁹⁹⁹ 15.09.2015, f. 14;

¹⁰⁰⁰ 15.09.2015, f. 15;

¹⁰⁰¹ 15.09.2015, f. 26;

parë fotografitë e tij në portale.¹⁰⁰⁴

928. K6 vlerësoi se F.R. ishte shumë i frikësuar, paranoik dhe hipokondriak. Prandaj, ai shpesh ndërhynte në punën që bëhej nga zyrtarët e sigurisë, ai kishte frikë.¹⁰⁰⁵ F.R. ishte person i cili frikësohej lehtë. Kur ai kishte hyrë në restorantin rrotullues, ai e skanonte tërë lokalin. Nëse e ndjente se në restorant ishin ulur persona të panjohur ai do të kthehej në kabinetin e tij. Nëse ai rrinte, ai zgjidhte një tavolinë larg nga mysafirët e tjerë.¹⁰⁰⁶ K6 besonte se F.R. ishte shumë i kujdesshëm; ai asnjëherë nuk kishte biseduar në praninë e tij me askë lidhur me ndonjë aktivitet kriminal.¹⁰⁰⁷ Ai ishte shumë i kujdesshëm, edhe kur ai fliste me dikë. Kur ai e çonte telefonin në veturë, ai thoshte se do të kthente thirrjen për disa minuta kur ai do të ishte në zyrë. Kur ai kishte takime zyrtare në vende publike, ai kërkonte nga mbrojtja e tij që të ishte diskrete. Atij i pëlqente të mburrej për suksesin e tij.¹⁰⁰⁸
929. Në dritën e një deklarate të tillë për F.R., Gjykata e gjeti si të pavërtetë deklaratën e K6 se ai e kishte dëgjuar atë duke folur në prani të K6 në telefon në lidhje për R.D., ai kishte shumë frikë nga ai, madje i obsesionuar me të. Ai zakonisht fliste për të si “ndërhyrës” or “çrregullues”, megjithatë kur ai e harronte veten, ai e thërriste atë me emrin “R.D.”.¹⁰⁰⁹ Ngjashëm, është plotësisht e pambështetshme

¹⁰⁰² 19.07.2016, f. 25 - 26

¹⁰⁰³ 19.07.2016, f. 35

¹⁰⁰⁴ 19.07.2016, f. 36

¹⁰⁰⁵ 15.09.2015, f. 21;

¹⁰⁰⁶ 15.09.2015, f. 26;

¹⁰⁰⁷ 16.09.2015, f. 30;

¹⁰⁰⁸ 16.09.2015, f. 36

¹⁰⁰⁹ 15.09.2015, f. 32;

që K6 një herë i kishte dëgjuar F.R. dhe Ek.L. duke folur në praninë e tij, gjersa ai po i voziste ata, për R.D., Vojvodën dhe grupin. Sipas tij,

F.R. kishte thënë “më lini të merrem unë me këtë, ma lini këtë mua”. Kjo bisedë ishte e vetmja që kishte dëgjuar ai nga grupi dhe e lejoi atë të vinte në përfundimin se diçka ishte duke ndodhur.¹⁰¹⁰ Ai nuk e kishte raportuar atë që kishte dëgjuar. Ai nuk e kishte trajtuar atë si informatë të qartë.¹⁰¹¹

930. Ai po ashtu dëshmoi se disa ditë pas vrasjes, F.R. dhe Ek.L. po flisnin për vdekjen e R.D. Ai tha “*Ju kam thënë se ai do të vihej në gjumë.*” Ek.L. ishte shumë i brengosur.¹⁰¹²¹⁰¹³ F.R. e kishte pranuar se ai qëndronte prapa vrasjes së R.D. edhe në prani të B.L., e cila po e zëvendësonte sekretaren e tij të rregullt. Ai e tha këtë në kabinetin e tij, në shoqëri të Ek.L. B.L. ia kishte përsëritur këtë K6.

1325

931. Ky element po ashtu nuk u vërtetua sepse ishte vetëm K6 ai që dëshmoi për këtë. Ndër të tjera, kjo ishte mohuar jo vetëm nga F.R. dhe Ek.L., por edhe nga “mikja emocionale” – B.L., dëshmitë e të cilës do të diskutohen më poshtë.

932. Gjatë marrjes së tërthortë në pyetje, K6 dëshmoi se ai ishte në lidhje emocionale me B.L., e cila kishte filluar të punonte në Avaz në qershor të vitit 2006 pas vdekjes së S.L. Ai e dinte se ajo do të ishte dëshmitare në këtë rast dhe se ajo dinte shumë.¹⁰¹⁴ Sipas tij, ajo po e zëvendësonte sekretaren kryesore të F.R.– “Sei.” Ajo punonte atje në departamentin ligjor deri në vitin 2009. Ajo ishte

¹⁰¹⁰ 16.09.2015, f. 34

¹⁰¹¹ 17.09.2015, f. 20

¹⁰¹² 15.09.2015, f. 41-42;

¹⁰¹³ 16.09.2015, f. 3;

¹⁰¹⁴ 16.09.2015, f. 26; 17.09.2015, f. 5

shkarkuar nga F.R. për shkak të lidhjes së saj emocionale me K6.¹⁰¹⁵

933. Pasi K6 u shkarkua nga AVAZ ai kishte shkuar vetë te ASHHM-ja për të dëshmuar lidhur me F.R. Ai ishte pyetur për aktivitetet e tij e paligjshme, dhe përfshirjen e tij të pretenduar në vrasjen e R.D.¹⁰¹⁶
934. K6 besoi se ai në mënyrë të përhershme ishte sulmuar nga F.R., po ashtu përmes mediave të tij¹⁰¹⁷ dhe përmes aksidenteve të trafikut kundër tij. Ai pohoi se F.R. kishte “paranojë” për shkak të tij, për shkak të vëllai të tij i cili punonte për kryetarin B.Iz., një kundërshtar politik i F.R..¹⁰¹⁸
935. Në dëshminë e tij ai u përqendruar në L.B.C., ishte e dukshme se K6 e fajësoi atë për shumë gjëra në jetën e tij.¹⁰¹⁹
936. Ai pohoi se ai asnjëherë nuk kishte folur me S.T.¹⁰²⁰ Megjithë këtë, ai nënvizoi se edhe ajo ishte keqtrajtuar dhe sulmuar nga F.R. pasi e kishte lënë AVAZ-in, njësoj sikurse B.L. e cila do të vijë “këtu” për të dëshmuar në këtë rast. Kur u pyet se si e dinte ai se ajo do të dëshmonte në Kosovë, ai e ndërroi deklaratën e tij dhe tha se po nënkuptonte se ajo do të dëshmonte në procedura të tjera.¹⁰²¹
937. K6 ndryshoi dëshminë e tij lidhur me kontaktet e tij me S.T., sepse ai pranoi se ai kishte biseduar me të. Ai pohoi se fillimisht ai donte të thoshte se ai nuk kishte

¹⁰¹⁵ 16.09.2015, f. 28-29

¹⁰¹⁶ 16.09.2015, f. 39

¹⁰¹⁷ 16.09.2015, f. 14-15

¹⁰¹⁸ 16.09.2015, f. 7

¹⁰¹⁹ 16.09.2015, f. 31

¹⁰²⁰ 16.09.2015, f. 9

¹⁰²¹ 16.09.2015, f. 41

folur me të vetëm kur punonte në Avaz, por se ai e kishte bërë këtë pasi ishte larguar. Kjo kishte ndodhur disa herë, dhe ai nuk kishte folur me të për përfshirjen në gjyqin kundër N.K. Ajo i tha atij se ajo kishte dëshmuar në Kosovë, por se ata nuk kishin hyrë në shumë detaje. Ajo e lexoi se çfarë i kishte ndodhur atij, dhe ata diskutuan për këtë. Ai i ofroi ndihmë asaj. Ai mohoi të jetë në kontakt të rregullt me të, por ai e konfirmoi se ata ishin miq në Facebook. Ai pranoi se kishte postuar në murin e Facebook-ut të saj komentin “*Shtatori po vjen, dhe frika e F.R. është gjithnjë e më e madhe*”. S.T. po publikonte fotot e tij.¹⁰²² Më voni doli se ky ishte një shkëmbim i komenteve ndërmjet tyre në një faqe të Facebook-ut “Stop Avaz”.¹⁰²³

938. Në shumë raste, ai theksoi se S.T. dinte më shumë dhe ai pohoi se ky vlerësim bazohej në vëzhgimet e tij sepse ajo tërë koha ishte e ulur me ta në tryezë me F.R. dhe të tjerët.¹⁰²⁴

939. K6 kishte dhënë një intervistë në prill të vitit 2015 në Bosnje kua i kishte thënë se ai do të dëshmonte për EULEX-in në rastin kundër N.K, në lidhje me F.R.¹⁰²⁵ Ai u takua me prokurorin e EULEX-it, ishte një herë, atij nuk i kujtohej nëse e

kishte nënshkruar procesverbalin, me siguri ai i kishte nënshkruar ata që mbaheshin nga ASHHM-ja¹⁰²⁶ Ai po ashtu pati një takim të shkurtër me prokurorin pasi arriti në Prishtinë.¹⁰²⁷

940. Kur u pyet lidhur me motivimin e tij për të dëshmuar, ai tha se ai ishte

¹⁰²² 16.09.2015, f. 42

¹⁰²³ 17.09.2015, f. 4; kopja e shtypur e llogarisë në facebook “Stop Avaz” me komentin e bërë nga K6 në përgjigje të S.T.

¹⁰²⁴ 17.09.2015, f. 5

¹⁰²⁵ 16.09.2015, f. 44

¹⁰²⁶ 16.09.2015, f. 44 - 45

¹⁰²⁷ 16.09.2015, f. 46-47

diskriminuar dhe keqtrajtuar nga F.R., dhe se ai e konsideronte këtë jo të drejtë. Më vonë, vetura e tij ishte demoluar, arma zyrtare i ishte vjedhur dhe disa gjëra nga dollapi i tij në punë ishin vjedhur. Ai e fajësonte F.R. për këto ngjarje dhe prandaj kishte dhënë dorëheqje. Ai i përshkroi ato në detaje të mëdha.¹⁰²⁸ Gjatë marrjes së tërthortë në pyetje, ai shpjegoi se ai nuk ishte keqtrajtuar, por ishte marginalizuar.¹⁰²⁹ Para se të largohej ai ia shkroi një letër menaxhmentit ku ai ankohej se si ishte trajtuar. Megjithatë, ai nënvizoi në atë letër se ai kishte mendim të mirë për F.R. Letra ishte nga tetori i vitit 2014. Ai kishte ardhur në përfundim se F.R. ishte gjithmonë i mirë me të.¹⁰³⁰

941. **F.R.** konfirmoi se ai e njihte K6; ai ishte në parkun e veturave të AVAZ-it. Ai ishte pushuar nga puna para 3 – 4 vjetësh. Ai e mohoi të jetë vozitur me të. K6 zakonisht e ngiste veturën e dytë, atë përcjellëse. Atij i kujtohej se K6 ishte pushuar nga puna sepse ai ishte informuar lidhur me keqpërdorimet e tij, përveç kësaj ai kishte marrë një letër private nga ai.¹⁰³¹

942. K6 kishte pasur disa detyra të nivelit të ulët si dërgimi me veturë i fëmijëve të F.R. për në shkollë, t'i shoqërojë ata, të përkujdeset për ta gjatë pushimeve, të sigurohej që ata të mos mbyteshin në ujë. F.R. i besonte atij në mënyrë absolute.¹⁰³² F.R. ia kishte përmbushur ëndrrën e tij që të udhëtonte me

¹⁰²⁸ 15.09.2015, f. 43 - 45;

¹⁰²⁹ 16.09.2015, f. 39

¹⁰³⁰ 17.09.2015, f. 25

¹⁰³¹ 28.10.2016, f. 26-27

¹⁰³² 28.10.2016, f. 28

aeroplan.¹⁰³³ Sipas tij, K6 ishte shkarkuar nga AVAZ për shkak të vjedhjes. F.R. nuk e dinte se cili ishte motivi i tij për të dëshmuar kundër tij.¹³⁴⁶

943. **B.L.** ishte propozuar si dëshmitare nga mbrojtja pasi që ajo kishte bërë një deklaratë noterit boshnjak ku ajo i mohonte faktet e paraqitura nga K6 në dëshminë e tij. Ajo kishte pasur marrëdhënie miqësore me K6 në të kaluarën.¹⁰³⁴ Ajo e mohoi se deklarata që kishte dhënë para noterit ishte përgatitur nga një person tjetër. Ajo e mohoi se ajo ishte paguar nga dikush tjetër.¹⁰³⁵
944. Ajo ishte gruaja e S.L.¹⁰³⁶ Kunati i saj ishte Ek.L.¹⁰³⁷ Nga mesi i vitit 2008 deri në vitin 2009 ajo ishte e punësuar në Avaz. Herë pas here ajo e zëvendësonte sekretaren e F.R. kur ajo ishte në pushim.¹⁰³⁸ Ajo nuk punoi në Avaz në vitin 2007.¹⁰³⁹ Nga punësimi i saj rezulton se ajo kishte filluar të punonte atje vetëm më 01 gusht 2008.¹⁰⁴⁰
945. Ajo mësoi për vdekjen e R.D. nga mediat. Ajo nuk diskutoi për këtë gjë as me kolegët nga Avaz, e as me F.R. Ajo nuk ishte asnjëherë e pranishme gjatë ndonjë takimi ku ai ishte diskutuar. Ajo nuk e kishte parë F.R. duke fërkuar duart dhe duke thënë “e sheh se si baba u përkujdes për R.D.”¹⁰⁴¹ Ajo asnjëherë nuk e kishte dëgjuar atë ose N.K. të flisnin për vrasjen e R.D.¹⁰⁴²

¹⁰³³ 28.10.2016, f. 28 dhe fotografitë; 31.10.2016, f. 24 – kontrata për blerjen e aeroplanit

¹³⁴⁶ 31.10.2016, f. 30

¹⁰³⁴ Deklarata para noterit 13 tetor 2015.

¹⁰³⁵ 16.05.2016, f. 9

¹⁰³⁶ 16.05.2016, f. 4

¹⁰³⁷ 16.05.2016, f. 7

¹⁰³⁸ 16.05.2016, f. 5

¹⁰³⁹ 16.05.2016, f. 11

¹⁰⁴⁰ Kontrata e punës e Znj. L., e datës 1 gusht 2008 e paraqitur gjatë seancës së mbajtur më 17.09.2015

¹⁰⁴¹ 16.05.2016, f. 6

¹⁰⁴² 16.05.2016, f. 8

946. Ajo nuk e njihte personalisht S.T.¹⁰⁴³ K6 paraqiste raporte të rreme kundër saj.¹⁰⁴⁴
Ajo asnjëherë nuk ishte thirrur nga autoritetet e Bosnjës për të dëshmuar
në rastin e vrasjes së R.D.¹⁰⁴⁵
947. **F.R.** dëshmoi se B.L. punonte në AVAZ si administrator teknik, korrier, në
shërbimin juridik, dhe kontrata e saj ishte ndërprerë me gjasë pas një viti. Ajo
kishte punuar atje para 10 – 12 vjetësh. Me gjasë ishte Ek.L. personi i cili kishte
kërkuar nga ai që ta punësonte atë për arsye sociale. Kjo ishte pas vdekjes së S.L.
¹⁰⁴⁶ Ajo asnjëherë nuk kishte qenë sekretarja e tij. Ai asnjëherë nuk i
zëvendësonte sekretaret e tij. ¹⁰⁴⁷ Gjatë pauzës në seancë F.R. u vu në kontakt me
zyrën e tij dhe zbuloi se B.L. kishte filluar të punonte në AVAZ në gusht të vitit
2008. ¹⁰⁴⁸

Përfundim:

948. Analiza e dëshmisë së K6 çon në përfundimin se ai nuk kishte informata për
vrasjen e R.D.
949. Para së gjithash, gjatë tërë dëshmisë së tij, ishte e dukshme se K6 vendosi të
dëshmojë kundër F.R. për shkak se ai e fajësonte atë për marginalizim në punën
e tij, dhe më vonë për ndërprerjen e punësimit të tij.

¹⁰⁴³ 16.05.2016, f. 6-7

¹⁰⁴⁴ 16.05.2016, f. 7

¹⁰⁴⁵ 16.05.2016, f. 7

¹⁰⁴⁶ 31.10.2016, f. 6 - 7

¹⁰⁴⁷ 31.10.2016, f. 8-9

¹⁰⁴⁸ 31.10.2016, f. 37

950. Së dyti, K6 nuk posedon ndonjë njohuri të drejtpërdrejtë lidhur me takimet e mbajtura nga N.K. dhe njerëz të tjerë. Gjatë marrjes në pyetje, ai kryesisht i përsëriste ato që ai i kishte dëgjuar nga njerëz të tjerë dhe lexuar në media. Gjatë shqyrtimit gjyqësor u vërtetua se ai e njohte S.T. dhe kishte qëndruar në kontakt me të. Ai e konfirmoi këtë vetë, duke e pranuar madje se ata bisedonin me njëritjetrin lidhur me dëshmitë e tyre në shqyrtimin e tanishëm. Për më tepër, ekzistenca e relacioneve mjaft të ngushta ndërmjet tyre u mbështet me kopje nga një llogari publike të S.T. ku ata postonin informata dhe fotografi dhe i komentonin ato. Fillimisht, ai tha se ai njihej me S.T., sepse kishte deklaruar se ai asnjëherë nuk kishte folur me të. Kur u pyet lidhur me kundërthënien e tij të mëvonshme sepse ai tha se e kishte pranuar se kishte folur me S.T. në raste të ndryshme, ai e shpjegoi se ai ishte pyetur për periudhën kur ata punonin së bashku në AVAZ. Megjithatë, Gjykata konstaton se kjo ishte një tentativë e pasuksesshme për të fshehur relacionin e tyre.
951. Së treti, ai nuk ishte konsekuent në dëshminë e tij dhe ishte në kundërshtim me vetveten. Fillimisht ai tha se F.R. ishte person shumë i vëmendshëm dhe i kujdesshëm, i cili nuk fliste në telefon në prani të tij. Ai madje e vlerësoi atë si 'paranoik' në lidhje me sigurinë e tij. S.T. e përshkroi atë në të njëjtën mënyrë. Më vonë, K6 ndryshoi versionin e tij dhe i përshkroi disa situata kur ai pati mundësi ta dëgjonte F.R. duke folur në telefon. E njëjta ndodhi kur ai po e përshkruante mënyrën se si ata po e mbronin F.R. Fillimisht, ai tha se zyrtarët e mbrojtjes ishin gjithmonë duke qëndruar në katin e poshtëm në zyrën e tyre dhe ata kurrë nuk kishin shkuar me të në restorant. Më vonë, ai e ndryshoi versionin e tij kur ai e kuptoi se nuk i përshtatej rrëfimit për takimet që do të mbaheshin në restorantin rrotullues.

952. Përveç kësaj, K6 nuk ishte konsekuent kur ai përshkroi takimet e tij të pretenduara me N.K. Në fillim ai tha se të pandehurin për herë të parë e kishte parë në vitin 2007 dhe pastaj se e kishte parë atë disa muaj më vonë. Kur e kuptoi se kjo nuk përputhej me datën e R.D., ai dëshmoi për shumë takime që siç pretendon ai i kishte vëzhguar.
953. Ai shtonte informata të reja gjatë gjithë kohës, shumicën prej të cilëve ai i kishte dëgjuar nga njerëz të tjerë, p.sh. nga sekretarja e F.R. Kur u pyetën për problemet me kujtesën, ai tha se ai thjesht ishte trullësuar me informata.¹⁰⁴⁹
954. Nga ana tjetër, Gjykata nuk kishte asnjë dyshim se në një kohë të caktuar K6 ishte një shofer i besuar i F.R. Kjo rrjedh nga dëshmitë e tij, të vërtetuara me fotografi, kur K6 dhe F.R. ishin së bashku. Përveç kësaj, ai konfirmoi se K6 po i voziste fëmijët e tij dhe se ai madje ia kishte plotësuar ëndrrën e tij për të udhëtuar me aeroplan.

3.37. Da.E.

955. Da.E. ishte dëshmitari tjetër i propozuar nga mbrojtja. Ai ishte dënuar me 9 vjet burgim nga gjykata në Serbi.¹⁰⁵⁰
956. Ai dëshmoi se ai nuk e njohte N.K. Ai e njeh A.V.¹⁰⁵¹
957. Ai asnjëherë nuk foli ose e përmendi emrin e N.K.¹⁰⁵² Ai e njohte R.D. në mënyrë sipërfaqësore. Ai kishte dëgjuar vetëm rrëfime ose thashetheme për vrasjen e tij. Ai tregoi për një grup nga Zagrebi ose Novi Pazari, por asgjë

¹⁰⁴⁹ 15.09.2015, f. 30;

¹⁰⁵⁰ 16.05.2016, f. 16

¹⁰⁵¹ 16.05.2016, f. 16

specifike. Kishte pasur rrëfime madje edhe për përfshirjen e inteligjencës së Bosnjës.¹⁰⁵³ Kishte pasur shumë rrëfime në media se N.K. ishte i përfshirë në këtë.¹⁰⁵⁴

958. Ai nuk e njihte M.Os., asnjëherë nuk kishte biseduar me të për vrasjen e R.D.¹⁰⁵⁵ Ai e njeh El.A. vetëm si një të njohur. Ai personalisht asnjëherë nuk ishte takuar me S.Ro. Ai kishte dëgjuar për të. Ai asnjëherë nuk kishte biseduar me ta për vrasjen e R.D.¹⁰⁵⁶ Ai kishte dëgjuar për M.M.¹⁰⁵⁷, por ai nuk e dinte nëse ai ose ekipi i tij kishin qenë të përfshirë në vrasjen e R.D.¹⁰⁵⁸
959. Ai kishte lexuar për S.R. në media.¹⁰⁵⁹ Ai ishte liruar nga akuza për vrasjen në tentativë të D.Z.¹⁰⁶⁰
960. Sa i përket A.V., ai tha se *gjitha* transkriptet nga gjykimi i tij të cilat janë mbajtur në Beograd ishin gjetur në qelinë e A.V. në burgun qendror në Sarajevë. Ato i ishin dërguar nga S.T. Da.E. i kishte informuar autoritetet për këtë. Sipas tij, S.T. në bashkëpunim me zyrtarët e ASHHM-së po mblidhte informata lidhur me rastin e tij me qëllim që të konstruktonte raste kundër tij dhe N.K.¹⁰⁶¹
961. Ai e mohoi se kishte dhënë dëshmi para prokurorit të BeH më 12 shtator 2012. Ishte bërë vetëm një shënim zyrtar.¹⁰⁶² Ai e pranoi se kishte biseduar me ta por që kjo nuk ishte marrje zyrtare në pyetje. Kjo lidhej me një diskutim për

¹⁰⁵²16.05.2016, f. 16

¹⁰⁵³ 16.05.2016, f. 16

¹⁰⁵⁴ 16.05.2016, f. 17

¹⁰⁵⁵ 16.05.2016, f. 17

¹⁰⁵⁶ 16.05.2016, f. 17

¹⁰⁵⁷ 16.05.2016, f. 17

¹⁰⁵⁸ 16.05.2016, f. 18

¹⁰⁵⁹ 16.05.2016, f. 18

¹⁰⁶⁰ 16.05.2016, f. 18

¹⁰⁶¹ 16.05.2016, f. 18

transferimin e tij në Bosnje.¹⁰⁶³ Ai nuk u kishte treguar atyre se R.D. ishte vrarë nga anëtarët e grupit të tij. Ata po bisedonin vetëm për transferimin e tij në Bosnje. Kjo ishte me kërkesë të tij. Në fund, ata nuk kishin arritur asnjë marrëveshje.¹⁰⁶⁴

962. Sipas Da.E., ata po e përdorin këtë shënim zyrtar për të ndërtuar një rast kundër N.K. Ata po kurdisnin prova dhe bënë presion mbi dëshmitarët për të zhvilluar një proces kundër tij. Ai e kishte lexuar këtë shënim zyrtar ndoshta 6 muaj përpara se të jepte dëshmi në Kosovë. Kjo nuk ishte dëshmia e tij.¹⁰⁶⁵

963. Da.E. e njihnte në mënyrë sipërfaqësore S.T. Ajo po dërgonte transkriptet e gjykimit të tij tek A.V. Ajo po e bënte këtë për të konstruktuar një rast kundër tij dhe N.K. Ky e dinte këtë nga të dënuarit e tjerë që ishin në të njëjtën qeli me A.V. A.V. donte ta bënte këtë për shkak se ai ishte dënuar 10 vjet dhe donte të merrte lirim të parakohshëm. S.T. donte ta bënte këtë me shumë gjasa, sepse ajo dëshironte ta mbronte burrin e saj, i cili qe dënuar 40 vjet.¹⁰⁶⁶

964. Përveç tjerash ai tha:

Gjatë periudhës mes viteve 2006 dhe 2009 kam pasur probleme të mëdha pavarësisht a e kam dashur këtë apo jo, kam qenë i detyruar që të kem

informacion në lidhje me të gjitha grupet kriminale për sigurinë time personale.

Pra, në atë kohë kam folur dhe kam pasur dy persona nga secili grup kriminal të

¹⁰⁶² Është një shënim zyrtar, i nënshkruar vetëm nga policët që përmban përshkrime të ngjarjeve që lidhen me vrasjen e RD (regjistratori 3, faza paraprake)

¹⁰⁶³ 16.05.2016, f. 18 – 19

¹⁰⁶⁴ 16.05.2016, f. 19 - 20

¹⁰⁶⁵ 16.05.2016, f. 20 - 21

¹⁰⁶⁶ 16.05.2016, f. 20 – 21, 22

afërt me mua, dhe kam dëgjuar shumë rrëfime, disa prej tyre të vërteta dhe disa prej tyre jo. Ka qarkulluar një histori që hetimi është drejtuar qëllimisht kundër N.K për të mbrojtur personat e vërtetë që e kanë urdhëruar vrasjen dhe që ta bëjnë situatën ku grupi R.D. do hakmerrej dhe ta vrasin N.K. ose ta heqin atë nga Sarajeva. Në atë kohë, emri i cili ishte shumë i njohur është një person me mbiemrin S.R., ai thjesht ishte përfshirë ose futur në një farë mënyre në këtë histori. Ai nuk jeton më, por unë mund të deklaroj tani nga këtu se ai nuk e ka vrarë atë. Duke marrë në konsideratë fillimin e hetimeve për vrasje menjëherë pas vrasjes, duke lëshuar urdhër ndërkombëtar në bazë të ADN-së e cila dyshohet se është gjetur në vendin e ngjarjes, flet në favor të faktit që hetimi nuk ishte i drejtuar kah S.R., por dikush tjetër.¹⁰⁶⁷

965. Da.E. pohoi se askush nuk kishte ndikuar në dëshminë e tij.¹⁰⁶⁸ Ai e mohoi se ai kishte kërkuar nga prokurorët disa herë që të bënte një deklaratë në rastin Ll. Ai theksoi se raporti zyrtar ishte falsifikuar.¹⁰⁶⁹
966. **M.A.G.** dëshmoi se ai ishte këshilluar në burg që të mos dëshmojë fare. Atij i ishin afruar njerëz nga bashkësia ndërkombëtare që të dëshmonte kundër F.R., N.K dhe B.Iz.. Kjo ishte para zgjedhjeve shtetërore në vitin 2014. Ata ende ushtrojnë presion mbi të. Ai refuzoi të jepte emra, duke thënë se ai nuk donte të rrezikonte ndëshkim disiplinor.¹⁰⁷⁰ Dubravko Campara po përpiqej ta bindte atë që të dëshmonte kundër N.K. ¹⁰⁷¹ Campara donte që ai të dëshmonte kundër N.K,

¹⁰⁶⁷ 16.05.2016, f. 21

¹⁰⁶⁸ 16.05.2016, f. 21

¹⁰⁶⁹ 16.05.2016, f. 22-23

¹⁰⁷⁰ 07.12.2016, f. 19-20

¹⁰⁷¹ 07.12.2016, f. 21

dhe ai nuk donte që të thoshte gënjeshtër kundër tij. Ata kishin ardhur në burgun e Zenicës dhe publikisht kishin hulumtuar për dëshmitarë në rastin e N.K. Ata i kishin ofruar lirinë K2 për dëshminë e tij. I tërë burgu po flet për këtë gjë.¹⁰⁷²

3.38. B.H.

967. Dëshmitë e B.H. ishin me pak relevancë për këtë rast. Ai nuk i njihte N.K., N.O., F.R., Ek.L., S.S., S.R. dhe N.V. Ai e kishte parë një herë ose dy herë M.M.¹⁰⁷³ Ai asnjëherë nuk i kishte parë S.R. dhe N.V., ai e mohoi të kishte marrë me qira për ta një apartament.¹⁰⁷⁴ Ai e njihte R.D., ai ishte miku i tij dhe ai nuk kishte asnjë motiv për ta vrarë atë.¹⁰⁷⁵

Konkluzioni përfundimtar në lidhje me akuzat për vrasje

968. Prokurori nuk paraqiti prova të besueshme që e mbështesin rastin e tij se N.K. me njerëzit e tjerë të cekur në aktakuzë kishin planifikuar dhe organizuar vrasjen e R.D., kishin paguar për të dhe e kishin ekzekutuar këtë gjë përmes vrasësve të angazhuar.

Pjesa 4 Gjetjet faktike në lidhje me akuzat për drogë.

4.1. Vërejtje të përgjithshme

969. Dëshmitë e dëshmitarëve K1 dhe K2 ishin pjesë shumë të rëndësishme të provave për të mbështetur rastin e prokurorit në lidhje me akuzat për drogë. Si K1 ashtu edhe K2 kishin status të dëshmitarëve bashkëpunues në këtë rast, gjë që

¹⁰⁷² 07.12.2016, f. 23

¹⁰⁷³ 19.07.2016, f. 8-9

¹⁰⁷⁴ 19.07.2016, f. 9

¹⁰⁷⁵ 19.07.2016, f. 9

- kërkonte vërtetimin e dëshmive të tyre me prova të tjera. Vetëm këto pjesë të dëshmisë së tyre që u vërtetuan me prova të tjera, mund të shërbenin si bazë për gjetjet faktike.
970. Duhet nënvizuar se dëshmitarët K1 dhe K2 dëshmuan për disa ditë para kësaj Gjykate. Ai ishte marrë në pyetje edhe nga autoritetet boshnjake në procedurat kundër Z.T. dhe në një hetim tjetër në të ashtuquajturin rasti “Lutka”. Prandaj ka pasur një material voluminoz për t'u vlerësuar dhe krahasuar gjë që mundëson një analizë të duhur të vërtetësisë dhe besueshmërisë së këtij dëshmitari.
971. Gjatë vlerësimit të vlerës së dëshmive të dhëna nga dëshmitarët K1 dhe K2, Gjykata kishte parasysh se ata kishin interesa dhe motive që ta inkriminonin N.K. Prandaj, ishte e një rëndësie të veçantë që depozitimet e tyre të vlerësoheshin me kujdes.
972. Për më tepër, në rastin e dëshmitarit K1 kishte një pikë kthese në dëshminë e tij kur u konstatua se atij iu premtua imuniteti që nuk ishte parashikuar në Kod. Gjykata vendosi ta përsërite tërë marrjen në pyetje të K1, pasi dëshmitarit iu dha udhëzimi i duhur. Kishte mospërputhje dhe jo konsekuenca të shumta dhe të mëdha ndërmjet versioneve të ngjarjeve të paraqitura para dhe pas dhënies së imunitetit të ligjshëm dhe dhënies së udhëzimit të duhur. Ishte qartësisht e dukshme se dëshmitari K1 u tërhoq nga deklaratat fajësuese kundër N.K, gjë që ndër të tjera shkaktoi një qasje skeptike ndaj depozitimeve të tij.
973. Problemi me imunitetin e dhënë nga prokurori ndaj këtij dëshmitari u zbulua në fazën përfundimtare të marrjes së tërthortë në pyetje. Deri në atë moment, Gjykata nuk e kishte vënë re se dëshmitari ishte i frikësuar ose i shqetësuar për sigurinë e tij. Ai dëshmoi lirisht, e përshkroi në detaje përfshirjen e tij në shumë aktivitete kriminale, duke përfshirë vrasjet në të cilat ai kishte marrë pjesë së

bashku me Z.T. Vetëm pas lëshimit të imunitetit, gjatë marrjes së tërthortë në pyetje, kur K1 e kuptoi se sa shumë e kishte ndryshuar versionin e tij të ngjarjeve, ai ngriti argumentin se atij i ishin afruar nga familja e A.Ka. dhe mbrojtja, të cilët pretendohet se u përpoqën ta ndikonin mbi atë për të mos dëshmuar. Gjykata konstatoi se dëshmia e K1 ishte një gënjeshtër e pastër dhe një përpjekje e dëshpëruar për të shpëtuar rrëfimin e tij dhe si pasojë - statusin e dëshmitarit të mbrojtur dhe bashkëpunues.

974. Vlen të theksohet se edhe prokurori e vuri re këtë ndryshim rrënjësor në dëshmitë e dëshmitarit K1, gjë që rezultoi në propozimin e tij për ta shpallur atë si dëshmitar armiqësor. Prokurori e tërhoqi atë propozim vetëm kur u udhëzua nga kryetarja e trupit gjykues për pasojat e një propozimi të tillë dhe vazhdoi me marrjen e drejtpërdrejtë në pyetje të dëshmitarit K1. Në fjalën e tij përmbyllëse, prokurori pohoi se ndryshimi i dëshmisë rezultoi nga fakti se dëshmitari ishte kërcënuar nga mbrojtja dhe familja e A.Ka., gjë që ndikoi negativisht në deklaratën e tij.
975. K1 e pranoi se ai ishte takuar me prokurorin dhe kishte diskutuar për rastin. Atij nuk i kujtohej saktësisht se sa herë, megjithatë ai tha se ishte në disa raste. Asnjë procesverbal i këtyre takimeve nuk i ishte paraqitur ndonjëherë Gjykatës. Për më tepër, hetuesit po e shihnin dëshmitarin çdo ditë, madje 10 sish në ditë.¹⁰⁷⁶

¹⁰⁷⁶ 23.03.2017, f. 22

4.2. Përpjekja e pretenduar për të ndikuar mbi dëshmitarin K1

976. Siç u cek më lart, dëshmitari K1 dëshmoi për disa ditë, gjë që i mundësoi Gjykatës vëzhgimin e plotë të veprimeve të tij, sjelljes, mënyrës së të folurit. Megjithatë, asnjëherë nuk është vërejtur se ai kishte frikë ose ndihej i kërcënuar në ndonjë mënyrë. Gjykata vërejtë se K1 i besonte prokurorit në këtë rast, gjë që e përmendi në disa raste në dëshminë e tij, ai madje iu drejtua atë në një mënyrë të njohur, ndonëse ai ia gabo i emrin duke i thënë (“Henry” në vend të “Andrew”). Shqetësimi i vetëm që ai ndau me Gjykatën dhe prokurorin ishte pakënaqësia e tij me kushtet e dhëna atij brenda programit të mbrojtjes së dëshmitarit, pasi nuk i pëlqente akomodimi i ofruar, ai u ankua për sasinë e parave që kishte marrë, ai nuk ishte i kënaqur me statusin ligjor që i ishte dhënë atij dhe familjes së tij nga shteti i tretë ku ata po qëndronin.
977. Në deklaratën e tij përfundimtare, prokurori pohoi se gjatë marrjes së dytë në pyetje, pasi ai mori udhëzimin e duhur për imunitetin, dëshmitari K1 u tërhoq nga shumë prej dëshmive të tij të mëparshme, fajësuese për të akuzuarin sepse ai ishte i kërcënuar. Prokurori kërkoi që deklaratat e tij të mëparshme (para imunitetit) të përdreshin për vërtetimin e fakteve të rastit. Ky propozim u refuzua si dukshëm *contra legem*. Gjykata ka elaboruar tashmë mbi këtë çështje në paragrafët 70-71 të Pjesës 1 të Aktgjykimit.
978. Sidoqoftë, Gjykata gjeti se nuk ka asnjë provë të besueshme që do të konfirmonte kërcënimet dhe përpjekjen për të ndikuar mbi K1, pasi ai ishte udhëzuar siç duhet. Ka shumë arsye që e mbështesin këtë qëndrim.
979. Dëshmitari K1 kishte qëndruar nën Programin e Mbrojtjes të EULEX-it. Ai dhe anëtarët e familjes së tij të ngushtë jetonin në vendin e tretë, të cilin nuk e dinte

as Gjykata.

980. Ai përmendi përpjekjen për të ndikuar tek ai nga ana e mbrojtjes vetëm gjatë raundit të dytë të dëshmisë së tij, pasi ai ishte udhëzuar siç duhet rreth imunitetit dhe të drejtave dhe detyrave të tij, gjatë marrjes së tërthortë në pyetje nga mbrojtja. Ai përmendi këtë përpjekje kur ai u mor në mënyrë të tërthortë në pyetje sa i përket përdorimit të godinës së dyqanit Renta – a – Car në Pejë, dhe u bë e qartë se dëshmia e tij në këtë pjesë ishte e dyshimtë. Gjykata erdhi në përfundim se pretendimet për përpjekje për të ndikuar mbi të u paraqitën për të zbutur përshtypjen e dëshmisë së rreme.
981. K1 pretendoi se ai kishte folur në telefon me A.Ka. dhe se njëkohësisht ai e dëgjoji bisedën e tij telefonike me “Bs.” Berishën i cili i kishte ofruar 5 ose 10 milionë euro për t’u tërhequr nga deklaratat e mëparshme. Versioni i ngjarjeve i K1 është plot kundërthënie, mospërputhje dhe nuk ka logjikë në të. Gjatë marrjes në pyetje, ai u tërhoq nga deklarata e tij fillestare se ai kishte dëgjuar mbrojtjen duke ofruar para, dhe në fund tha se ishte vetëm A.Ka. ai i cili e kishte informuar për këtë.¹⁰⁷⁷
982. K1 pohoi gjithashtu se me këtë rast ai e kishte thirrur familjen e tij nga një telefon publik nga aeroporti në Amsterdam. Ai gjoja këtë e kishte bërë rrugës e tij duke u kthyer nga Kosova në gusht të vitit 2017. Ai ishte i vetëdijshtë për kufizimet që i ishin vënë atij si dëshmitar i mbrojtur në lidhje me thirrjet telefonike. Ai shpesh e nënvizonte se kishte nevojë për leje nga njësia mbrojtëse që të bënte thirrje

¹⁰⁷⁷ 11.11.2016, f. 17 - 29

telefonike. Atij nuk i lejohej të përdorte telefon publik, sidomos gjatë udhëtimit të tij nën mbrojtje nga Kosova deri në vendin e qëndrimit të tij. Ai e dinte se çdo thirrje telefonike nga telefoni i ofruar nga mbrojtja e dëshmitarit, mund të ishte verifikuar lehtë.

983. Duhet të theksohet se A.Ka. ka mohuar të jetë zhvilluar fare një bisedë e tillë.
984. Me një udhëzim të qartë të Gjykatës, prokurori i autorizoi hetuesit e EULEX-it që t'i merrnin të gjitha masat e nevojshme për të verifikuar deklaratat e K1 lidhur me përpjekjen e supozuar nga mbrojtja për të ndikuar tek ai nëpërmjet familjes së tij. Pas kontaktit me nënën dhe vëllain e K1, u konstatua se ata nuk kishin folur me të në gusht të vitit 2017, dhe biseda e tyre e fundit telefonike ishte zhvilluar disa vjet më parë.¹⁰⁷⁸
985. Kur u pyetën nëse ai e kishte informuar dikë për këtë situatë, K1 tha se kishte dërguar SMS te prokurori Campara dhe ishte përpjekur disa herë të vihej në kontakt me të, por ai nuk ishte përgjigjur. Ai nuk kishte informuar prokurorin e EULEX-it për këtë, ose njësinë për mbrojtjen e dëshmitarëve, sepse ai pretendonte se kishte pritur që Campara ta bënte këtë kur K1 më në fund ta shpjegonte se çfarë kishte ndodhur. Gjykatës, ky shpjegim i është dukur si jo bindës.

4.3. Pika 3 e Aktakuzës

Sipas Aktakuzës:

të paktën nga viti 2000 deri 2012, N.K., si kreu dhe drejtuesi i grupit të tij të gjerë kriminal të strukturuar dhe të organizuar që përfshinte K1 (përgjegjës për menaxhimin

¹⁰⁷⁸ 15.02.2017

dhe përzierjen e narkotikëve për N.K.), K2 (ka udhëhequr dërgesat ndërmjet Turqisë, rajonit të Ballkanit dhe Holandës), K3 (shpërndarës i drogës në Beograd, Serbi), L.K. (menaxher për shpërndarjen e drogës për Serbi dhe për vendet e tjera evropiane), H.M. (vozitës dhe trupprojë), S.A. (vozitës), Z.B. (automekanik, krijonte hapësira të fshehta në automjete për drogat), H.K. (kontakte në Turqi), I.K. (kontakti në Turqi), A.KA. (koordinatori i dërgesave të drogës) dhe të tjerë, ka menaxhuar dhe drejtuar blerjen, përgatitjen, transportin, shitjen dhe shpërndarjen e një sasive të madhe heroine, ekstazie, spid [Speed] dhe droga të tjera, si dhe substanca droge të tilla si acid anhidrid acetik, përmes një rrjeti kriminal të organizuar. I pandehuri N.K.ka koordinuar përmes individëve të lartpërmendur dhe shumë të tjerëve import/eksportin e tonelataveme këto narkotikë të rrezikshëm dhe të paligjshme të fshehura në hapësira sekrete në automjete, për shembull hapësira të modifikuara brenda rezervuarëve të lëndës djegëse, mobile me zgavra të thelluara, dysheme artificiale në kamionë, fruta, veshje/tekstile dhe duke përdorur metoda të tjera. Përmes rrugëve të koordinuara mirë për trafikimin e narkotikëve, dërgesa të mëdha me pilula ekstazi janë marrë nga Holanda dhe janë transportuar për në Bosnjë Hercegovinë dhe Kosovë, ku janë ri-paketuar dhe transportuar më tej për në Stamboll/Turqi, ku ekstazia shkëmbehet për heroinë dhe droga të tjera. Droga e pranuar në Stamboll pastaj transportohet përsëri përmes Bosnjës dhe Hercegovinës dhe Kosovës dhe pastaj dërgohet dhe shitej tek tregtarët dhe shpërndarësit nëpër tërë Evropën.

986. Kjo pikë e aktakuzës u mbështet nga provat të dala nga dëshmitari K1, jo vetëm nga dëshmia e tij, por edhe nga fletorja që ai iu dorëzoi hetuesve të EULEX-it në vitin 2015. Dëshmia e tij në pjesën vendimtare u gjet nga Gjykata si jo e

besueshme dhe jo e vërtetë. Dëshmitari K1 ishte i vetmi dëshmitar që dëshmonte për përfshirjen e tij të pretenduar në trafikun e drogës me të pandehurin N.K. për të paktën disa vjet. Dëshmitarët e tjerë që dëshmuan për trafikimin e drogës përshkruanin veprime që kishin ndodhur qysh në vitin 2003.

987. Gjykata e gjeti të vërtetuar se nuk ishte kontestuese se K1 ishte përfshirë në trafikun e drogës, që përfshinte pjesëmarrjen e tij në transport, dërgim, shpërndarje, blerje dhe shitje të drogës. Ai ishte i specializuar në përzierjen e heroinës. Përveç kësaj, në periudhën prej së paku 2005 deri në vitin 2010, ai ishte i përfshirë në trafikun e drogës që lidhej me kokainën. Këto fakte u paraqitën në detaje nga dëshmitari K1.

4.4. Bashkëpunimi i K1 me N.K. në trafikimin e drogës – korniza kohore

988. Gjykata nuk ka gjetur prova se K1 kishte filluar të punonte me N.K. në vitin 1986. Së pari, vetë dëshmitari nuk është në konsistent me periudhën. Së dyti, nuk ka asnjë provë tjetër që do t'i mbështeste dëshmitë e tij mbi këtë çështje, veçanërisht se A.Ka. dhe M.Ka. i mohuan faktet e paraqitura nga K1. Së treti, K1 dëshmoi në mënyrë jo konsistente sa i përket numrit të takimeve me N.K. në atë periudhë fillestare. Për më tepër, ai e ndryshoi versionin e tij sa i përket asaj nëse ai ishte paguar për marrjen e pakove të dërguara me autobusë në Pejë, të cilat duhet të përmbanin heroinë. Të gjitha këto rrethana e justifikojnë konstatimin e dëshmimeve të K1 duke iu referuar fillimit të bashkëpunimit me N.K. si të pabesueshme.

Përmbledhje e provave relevante

989. K1 ishte shumë jo konsistente lidhur me periudhën kur ai siç pretendon ka punuar për N.K. Gjatë dëshmisë së tij ai ka përmendur vite të ndryshme kur ai e kishte filluar dhe përfunduar këtë bashkëpunim.
990. Gjatë shqyrtimit gjyqësor, K1 tha se ai ishte takuar me N.K. në vitin 1986 kur ai ishte punësuar nga i afërmi i tij M.Ka. si kamerier dhe kuzhinier në restorantin e tij në Rozhajë.¹⁰⁷⁹ Në atë kohë, K1, sipas udhëzimit të M.Ka. kishte filluar t'i merrte pakot me heroinë të sjella në Rozhajë nga shoferët e autobusit. Ai u jepte shoferëve zarfe me një shumë parash që për ishte e panjohur në shkëmbim të tyre. Fillimisht, ai nuk ishte në dijeni se çfarë kishte brenda pakove, por një herë ai e kishte hapur atë he kishte zbuluar se aty kishte heroin gjë që më vonë ishte konfirmuar nga M.Ka..¹⁰⁸⁰ Pakot, me madhësi dhe peshë të ndryshme, zakonisht vinin 2 – 3 herë në muaj, një pako një herë. Ato ishin të vogla, të bëra nga kartoni, të mbyllura dhe asgjë nuk ishte e shkruar mbi to.¹⁰⁸¹
991. Fillimisht ai tha se para vitit 1986 ai nuk kishte pasur asnjë kontakt me droga, ndërsa pak më vonë ai dëshmoi se atij nuk i kujtohej nëse situata në vitin 1986 ishte takimi i tij i parë me heroinën.¹⁰⁸²

¹⁰⁷⁹01.11.16, f. 4; 19.02.2016, f. 4

¹⁰⁸⁰01.11.16, f. 4 – 5, 19.02.2016, f. 5 - 6

¹⁰⁸¹01.11.16, f. 6

¹⁰⁸²10.11.2016, f.24

992. K1 po ashtu e ndërroi dëshminë e tij sa i përket kompensimit që ai merrte për marrjen e pakove të sjella nga Peja. Kur dëshmonte për këtë rrethanë pasi mori imunitet të rregullt, ai tha se ai nuk ishte paguar për këtë por në vend të kësaj ai po gostitej, sa herë që i merrte pakot përveç herës kur M.Ka. ishte jashtë vendit.¹⁰⁸³ Kur ai e përshkruante këtë bashkëpunim para imunitetit, K1 tha se ai filloi të paguhej për këtë shërbim pas njëfarë kohe.¹⁰⁸⁴¹⁰⁸⁵ Fillimisht, ai ishte paguar

nga Muniri, më vonë nga N.K.¹³⁹⁸

993. K1 dëshmoi se ai e kishte takuar N.K. personalisht për herë të parë në vitin 1986 në Pejë, në afërsi të një qendre tregtare. Ai ishte dërguar atje nga M.Ka., dhe

sipas të gjitha gjasave ai shoqërohej nga A.Ka..¹⁰⁸⁶ Ky takim ishte 4 – 5 muaj para se ai t'i bashkohej ushtrisë, gjë që kishte ndodhur në dhjetor të vitit 1986, dhe ai atje kishte kaluar një vit.¹⁰⁸⁷

994. **A.Ka.** e përjashtoi se ai kishte marrë pjesë në takime të tilla. Ai shpjegoi se po ashtu ishte e mundur sepse në vitin 1986 ai ishte në Gjermani nga ku ai ishte kthyer vetëm në shkurt ose mars të vitit 1987 dhe i ishte bashkuar ushtrisë.¹⁰⁸⁸ Përveç tjerash, ai nuk e

¹⁰⁸³ 01.11.16, f. 6 - 7

¹⁰⁸⁴ 19.02.2016, f. 5 - 6

¹⁰⁸⁵ 9.02.2016, f. 8

¹⁰⁸⁶ 01.11.2016, f. 10

¹⁰⁸⁷ 01.11.16, f. 10, 19.02.2016, f. 7-8

¹⁰⁸⁸ 27.02.2017, f. 6

njihte N.K.¹⁰⁸⁹ Sipas tij deri në vitin 2003, K1 nuk e njihte N.K. sepse ai asnjëherë nuk e kishte përmendur emrin e tij, por ai nuk e dinte se si ishte më vonë.¹⁰⁹⁰

995. Fillimisht, **K1** ka dëshmuar se ai ia kishte dorëzuar paratë N.K. në disa raste, ndërsa pasi u udhëzua siç duhet për imunitetin, ai e përshkroi vetëm këtë ngjarje. Tashmë në atë kohë ata ishin duke diskutuar për drogat.¹⁰⁹¹ Gjatë marrjes së tërthortë në pyetje, K1 përsëri dëshmoi vetëm për një takim me N.K. kur ai ia kishte dhënë një zarf. Ndër të tjera, ai tha se ata nuk kishin folur për drogat.¹⁰⁹²

996. **M.Ka.** e mohoi se ai e dërgonte K1 për të marrë pakot e drogës. Ai e komentoi deklaratën e K1 se ai jo vetëm që nuk ishte përfshirë në transportin e drogës dhe pagesën për shoferëve të autobusëve si gënjeshtër më të madhe. Ai e mohoi

përzierjen e drogave në bodrum, tharjen e heroinës në stufë.¹⁰⁹³
997. M.Ka. mohoi ta ketë njohur N.K. Ai tha se ai asnjëherë nuk e kishte parë atë. Njohuria e tij për të bazohet në informatat nga mediat. Ai tha se ishte gënjeshtër

se ai ka punuar me N.K. së paku që nga viti 1986.¹⁰⁹⁴

¹⁰⁸⁹ 27.02.2017, f. 4

¹⁰⁹⁰ 27.02.2017, f. 8

¹⁰⁹¹ 19.02.2016, f. 7

¹⁰⁹² 19.02.2016, f. 7

¹⁰⁹³ 28.03.2017, f. 8

¹⁰⁹⁴ 28.03.2017, f. 8-10

998. Pas vitit 1984 ai kishte filluar ta drejtonte një restorant të quajtur V.I. in Rozhajë. Ai kishte 8 tavolina, një kuzhinë të vogël, ai kishte punësuar njerëz atje. Në bodrum ai i mbante pijet. Ai i përdorte stufat me gaz të cilat ai i kishte në kuzhinë. Kur u pyet se për çfarë, ai u përgjigj se vetëm për zierje. Ai nuk kishte

asnjë ide se për çfarë qëllimesh të tjera mund të përdorej ajo. ¹⁰⁹⁵

999. M.Ka. konfirmoi se ai e njihte K1, ata ishin kushërinj. Me kërkesë të motrës së tij, ai e kishte punësuar K1 në restorantin e tij V.I., mbase ishte në vitin 1985 por që ai nuk ishte i sigurt, mund të ketë qenë viti 1982 ose 1983. Në këtë periudhë K1 ishte 12 ose 11, ndoshta 13. Detyra e tij ishte të sillte ushqime dhe pije nga depoja poshtë, të qëndronte prapa barit dhe ta pastronte restorantin. Si fëmijë ai

nuk mund të bënte gjëra të tjera. ¹⁰⁹⁶

1000. Dy ose tre muaj pasi K1 filloi të punonte në restorant, M.Ka. zbuloi nga halla e tij se K1 po vidhte alkool nga depoja dhe po e shiste aty pari. Prandaj, ai erdhi së bashku me vëllain e tij me veturë dhe e morën K1. Kur ata e pyetën për vjedhjen K1 ia doli ta hapte derën e prapme dhe kërceu jashtë veturës. Pas kësaj, M.Ka. nuk e kishte parë kurrë më K1. ¹⁰⁹⁷ Ai vetëm kishte lexuar në media se K1 ishte dëshmitar i mbrojtur. ¹⁰⁹⁸

1001. M.Ka. e njihte A.Ka. të cilin çdokush në Rozhajë e njihte si “A.”. ¹⁰⁹⁹

¹⁰⁹⁵ 28.03.2017, f. 5 - 6

¹⁰⁹⁶ 28.03.2017, f. 6-7

¹⁰⁹⁷ 28.03.2017, f. 7

¹⁰⁹⁸ 28.03.2017, f. 16

1002. Gjatë rrjedhës së dëshmisë së tij të mëtejme, **K1** tha se në vitin 1986 ai e kishte takuar jo vetëm N.K., por edhe R.K. (R.K.) kjo kishte ndodhur në Pejë ose Vitomiricë. Sipas tij, N.K. dhe R.K. ishin vazhdimisht në kontakt, që do të thotë se ata gjatë gjithë kohës ishin së bashku. Ata ishin së bashku me droga dhe cigare.¹¹⁰⁰ Pak më vonë, K1 u tërhoq nga kjo deklaratë dhe tha se R.K. nuk ka punuar me cigare me N.K.¹¹⁰¹

1003. Version i ndryshëm sa i përket vitit kur K1 kishte filluar bashkëpunimin me N.K.

ishite paraqitur nga ai gjatë marrjes së parë në pyetje nga hetuesit e EULEX-it gjë që kishte ndodhur më 20 shkurt 2013. Pastaj ai tha se ai e njihnte të akuzuarin nga periudha kur ai ishte në moshën 16 ose 17 vjeçare, dhe ai e kishte takuar atë në Rozhajë, në Kosovë. Në atë kohë, K1 nuk merrej me drogë, por vetëm si tregtues në treg të zi të valutave të huaja. Ai kishte filluar të punonte me drogë në vitin 1996, pas luftës.¹¹⁰² Përveç kësaj K1 tha se ai punonte për N.K. deri në momentin kur ai shkoi në burg, diku në vitin 2004.¹¹⁰³ Kur u pyet për mospërputhjet sa i përket periudhës kur ai punonte me N.K., K1 nuk ishte në gjendje t'i shpjegonte arsyet sepse ai kishte dëshmuar ndryshe. Ai vetëm tha se këto nuk ishin fjalët e tij (ato nga marrja në pyetje e kryer nga hetuesit e EULEX-it në vitin 2013). Sipas

¹⁰⁹⁹ 28.03.2017, f. 10-11

¹¹⁰⁰ 01.11.16, f. 15

¹¹⁰¹ 01.11.16, f. 16

¹¹⁰² 25.01.2017, f.27-28

¹¹⁰³ 25.01.2017, f.27-28

tij, fakti se ai nuk kishte dëshmuar në këtë mënyrë mbështetëj nga një deklaratë se ai ishte arrestuar në vitin 2004, ndërsa në fakt kjo kishte ndodhur qysh në vitin 2003.¹¹⁰⁴ Megjithatë, gjatë marrjes së tërthortë në pyetje, K1 konfirmoi se në vitin 1986 ai punonte me valuta. Në këtë mënyrë ai i minonte në mënyrë shtesë deklaratat e tij të mëparshme lidhur me përfshirjen në droga.¹¹⁰⁵

1004. **A.Ka.** dëshmoi se ai e njihte N.K. vetëm nga mediat.¹¹⁰⁶¹¹⁰⁷

1005. Ai e pranoi se ai e njihte K1, që nga viti 1991 ose 1992. Ai e kishte takuar atë në Rozhajë dhe në këtë periudhë K1 shiste vetura të cilat ai i sillte nga Gjermania dhe Holanda. Ata u shoqëruan për një vit ose një vit e gjysmë, pastaj ata kishin pasur ndërprerje të kontakteve deri në vitin 2001 ku ata u takuan përsëri. Në këtë periudhë, A.Ka. jetonte dhe punonte në Gjermani, ndërsa K1 ishte në burg për trafikim të drogës dhe ai ishte ekstraduar për në Bosnje dhe Hercegovinë atë vit.

1420

1006. Ata u takuan në Sarajevë përsëri, ata shoqëroheshin me njëri tjetrin, megjithatë ata nuk kishin asnjë biznes të përbashkët. A.Ka. për herë të fundit e kishte parë K1 në vitin 2003. Më vonë, ata mund të kenë pasur disa biseda telefonike. Ai i kishte telefonuar gruas së K1 dhe fëmijëve kur ai ishte në burg për të mësuar nëse ata kishin nevojë

¹¹⁰⁴25.01.2017, f.27-28, 48 - 49

¹¹⁰⁵25.01.2017, f. 28 - 29

¹¹⁰⁶ 27.02.2017, f. 3, 7

¹¹⁰⁷ 27.02.2017, f. 4

për ndonjë gjë.¹¹⁰⁸ Fakti se A.Ka. ishte në kontakt me bashkëshorten e K1 ishte arsyeja për konfliktin e tyre sepse K1 dyshonte se ai

kishte pasur një aferë me të. Ata nuk e kishin zgjidhur këtë çështje mes tyre.¹¹⁰⁹

1007. A.Ka. e mohoi që të ketë punuar ndonjëherë me K1 ose këdo tjetër në trafikimin

me drogë.¹¹¹⁰ Ai asnjëherë nuk ka pasur grupin e vet kriminal që merrej me droga.¹¹¹¹ Ai asnjëherë nuk ishte dënuar ose paraburgosur për veprat që ndërliidhen me drogë.¹¹¹² Ai e mohoi se shënimet në fletoren e K1 ku ishte përmendur emri i tij ishin të vërteta.¹¹¹³

1008. A.Ka. e konfirmoi se ai e njihte M.Ka. por që ai asnjëherë nuk kishte punuar me të ose për të. Ai nuk kishte punuar me të në biznesin e drogës.¹¹¹⁴ Ai e njihte Sulo Husic nga Rozhaja.¹¹¹⁵

1009. Ai nuk e njihte R.K.¹¹¹⁶ Ai nuk e njihte K2, por e kishte dëgjuar emrin e tij në media në shumë raste. Ai asnjëherë nuk ishte ulur atë në një tavolinë.¹¹¹⁷ Ai nuk kishte pasur asnjë lidhje biznesi me të, ai

¹¹⁰⁸ 27.02.2017, f. 5

¹¹⁰⁹ 27.02.2017, f. 5

¹¹¹⁰ 27.02.2017, f. 6, 14

¹¹¹¹ 27.02.2017, f. 9 - 10

¹¹¹² 27.02.2017, f. 10

¹¹¹³ 27.02.2017, f. 13-16

¹¹¹⁴ 27.02.2017, f. 6

¹¹¹⁵ 27.02.2017, f. 15

¹¹¹⁶ 27.02.2017, f. 6

¹¹¹⁷ 27.02.2017, f. 8

nuk e kishte vizituar atë, nuk kishte blerë asnjë armë nga ai.¹¹¹⁸ Ai nuk e dinte motivin e K2 për të dëshmuar kundër tij. Pas bisedës që ai kishte pasur me prokurorin, ai supozoi se ndoshta K2 i

kishin premtuar lirim të parakohshëm ose zbutje të dënimit.¹¹¹⁹

1010. A.Ka. nuk e njihte E.A. dhe S.Ban. Ai asnjëherë nuk kishte dëgjuar për hotelet Park dhe Jusaj në Pejë. Ai nuk i dinte këto vende: *Koridor* në Bosnje, “Ban.” Center në dalje të Pejës. Ai e dinte vendin e quajtur Hrasnica në Sarajevë.¹¹²⁰ Ai

nuk e njihte S.A..¹¹²¹

1011. Kur u pyet për njeriun me pseudonimin “Kr.”, A.Ka. tha se ai e njihte H.H., ish-kampionin e xhudos të ish-Jugosllavisë. Ai e mohoi ta ketë njohur dikë me pseudonimin “St.”¹¹²²

1012. A.Ka. mohoi çfarëdo përfshirje në trafikimin e drogës. Ai e pranoi se ai ishte marrë në pyetje nga hetuesit e EULEX-it. Atij nuk i kujtohej me këtë rast i ishin

treguar fotografitë e ndonjë lokacioni.¹¹²³

1013. Ai e kishte një apartament në Sarajevë dhe ndodhi që K1 e vizitoi atë atje. Miqtë tjerë nuk e vizituan atë.¹¹²⁴ Ai e konfirmoi se ai e dinte Restorantin Brajlovic por

që ai asnjëherë nuk e kishte takuar atje K1.¹¹²⁵

¹¹¹⁸ 27.02.2017, f. 13

¹¹¹⁹ 27.02.2017, f. 16

¹¹²⁰ 27.02.2017, f.14

¹¹²¹ 27.02.2017, f. 13

¹¹²² 27.02.2017, f. 15

¹¹²³ 27.02.2017, f. 7 – 8, 12 - 13

¹¹²⁴ 27.02.2017, f. 8

1014. Gjatë dëshmisë së tij, A.Ka. e konfirmoi se ai e njihte familjen e K1. Kishte ndodhur nganjëherë që ata e shihnin njëri tjetrin në Rozhajë. Ai e përshkroi situatën kur një vit/një vit e gjysmë para dëshmisë së tij para gjykatës në Kosovë atij i ishte afruar djali i K1 me emrin An.Ku., i cili ia kishte përcjellë atij një mesazh nga K1 se çdo gjë që ai ishte duke i thënë prokurorit ishte gënjeshtër.¹¹²⁶
1015. Kur u pyet për motivin se pse K1 kishte dëgjuar kundër tij, A.Ka. tha se ai ishte duke menduar për këtë që një kohë të gjatë por që ai nuk e dinte. I vetmi justifikim të cilin ai e propozoi ishte situata me gruan e K1. Sipas njohurisë së tij, ajo e kishte lënë K1 pasi që ai u arrestua.¹¹²⁷ Ai pohoi se K1 ishte i varur nga droga.¹¹²⁸
1016. Gjatë marrjes së tërthortë në pyetje, A.Ka. e pranoi se ai e kishte pseudonimin “A.”. Sipas tij, K2 e njohu atë në fotografi vetëm sepse dikush ia tregoi fotografinë atij.¹¹²⁹ Ai e shpjegoi se nga vinin të ardhurat e tij (furra).¹¹³⁰¹¹³¹ Edhe një herë ai kategorikisht e përjashtoj çfarëdo përfshirje në operacione të drogës.

1444

¹¹²⁵27.02.2017, f. 9

¹¹²⁶ 27.02.2017, f. 10

¹¹²⁷ 27.02.2017, f. 12

¹¹²⁸ 27.02.2017, f. 13

¹¹²⁹ 27.02.2017, f. 18

¹¹³⁰ 27.02.2017, f. 19

¹¹³¹ 27.02.2017, f. 19-21

4.4. Periudha totale e bashkëpunimit të pretenduar ndërmjet N.K dhe dëshmitarit K1

1017. Siç është përmendur më lart, K1 ishte dëshmitari i vetëm që dëshmonte në këtë rast lidhur me grupin e organizuar kriminal që pretendohet se udhëhiqej nga N.K. në periudhën prej vitit 2000 deri në vitin 2012 siç është cekur në aktakuzë.
1018. Gjykata nuk gjeti prova për t'i mbështetur këto pretendime pasi që dëshmia e K1 ishte vlerësuar si e pabesueshme. Prokurori nuk kishte ofruar asnjë provë kredibile për të vërtetuar dëshminë e dëshmitarit bashkëpunues K1.
1019. Gjatë rrjedhës së procedurave u bë e qartë se K1 nuk mund të ketë bashkëpunuar me të pandehurin gjatë gjithë kësaj kohe, dhe ai nuk ka njohuri për aktivitetet e tij. Ekzistojnë shumë rrethana të cilat në njërin anë tregojnë se një bashkëpunim i tillë nuk ka ndodhur, ndërsa në anën tjetër – the prokurori nuk kishte paraqitur prova për të vërtetuar se në këtë periudhë kohore K1 po punonte me ose për N.K.¹¹³²

*Përmbledhje e provave relevante*¹¹³³

1020. Në vitin 1988, kur K1 u kthye nga ushtria, ai ishte dërguar për trajnim se si t'i përziende drogat¹⁴⁴⁶ nga M.Ka., R.K. dhe ai nuk e dinin nga kush tjetër.¹¹³⁴ R.K. dhe të tjerët kishin paguar për biletat e aeroplanit, akomodimi po ashtu ishte

¹¹³² 27.02.2017, f. 12

¹¹³³ .11.16, f. 13

¹¹³⁴ 01.11.16, f. 4,9

paguar nga A.Ka. dhe R.K.¹¹³⁵ Para imunitetit, ai kishte dëshmuar ndryshe sepse ai tha se ishin A.Ka. dhe R.K. ata që ia kishin propozuar këtë trajtim atij, megjithatë ai nënvizoi se ata po punonin për N.K.¹¹³⁶ Gjatë marrjes së tërthortë në pyetje, ai dëshmoi se M.Ka. i kishte thënë atij se N.K. ishte i përfshirë.¹¹³⁷

1021. K1 po ashtu dëshmoi ndryshe në lidhje me vendin kryesor të trajnimit. Para imunitetit, ai tha se i kishte kaluar disa ditë në Pakistan, ndërsa i tërë trajnimi ishte mbajtur në Turqi. Pas imunitetit, ai dëshmoi në mënyrë të kundërt – disa ditë ishte në Stamboll dhe pastaj 6 – 8 muaj në Pakistan.¹¹³⁸

1022. Gjatë dëshmisë së tij, K1 nuk ishte konsekuent në lidhje me emrat e njerëzve që e kishin trajnuar atë. Pas imunitetit, ai tha se atij i kujtohej vetëm Sukru Ecen,¹¹³⁹ i cili ishte personi kontaktues që nga fillimi, K1 shkonte tek ai në Turqi, ai e vizitonte atë.¹¹⁴⁰ Para imunitetit, ai tha se atje ishin 10 – 15 njerëz të cilët po e trajnonin atë por atij nuk i kujtohej ndonjë emër. Nën presion të pyetjeve, ai i përmendi Z.C. dhe H.B..¹¹⁴¹ Vetëm gjatë marrjes së tërthortë në pyetje, ai ia

rikujtoi vetes se ai e kishte parë Sukru me N.K. në Sarajevë dhe se ai vinte shpesh.¹¹⁴²

Kur Sukru vinte në Sarajevë, ata të gjithë (R.K., A.Ka. dhe shumë të tjerë) uleshin në një

¹¹³⁵ 19.02.2016, f.11, 01.11.16, f. 14

¹¹³⁶ 19.02.2016, f. 11

¹¹³⁷ 10.11.2016, f.27

¹¹³⁸ 01.11.16, f. 13 - 14

¹¹³⁹ 01.11.16, f. 14

¹¹⁴⁰ 01.11.16, f. 19

¹¹⁴¹ 19.02.2016, f. 14

¹¹⁴² 10.11.2016, f.29

tavolinë, përfshirë N.K.¹¹⁴³ Kjo ishte në vitin 1989, pastaj e korrigjoi veten duke thënë se ishte vetëm në vitin 1999, për t'u kthyer në një moment tek 1989.¹¹⁴⁴

1023. In 1990 – 2002, K1 jetonte në Gjermani, Ulm ku ai e hapi një kompani ndërtimi dhe një dyqan të quajtur Las Vegas e cila përdorej si diskotekë.¹¹⁴⁵ Ai i përzierte drogat atje për R.K., A.Ka., K.Ku. dhe Sulo¹¹⁴⁶, dhe ai po ashtu udhëtonte nëse kishte nevojë, përmes Gjermanisë dhe për në Zvicër.¹¹⁴⁷ Ai kishte shkuar për përzierje të drogave në Hamburg dhe Frankfurt. Atje përziheshin sasi të më të mëdha të drogave.¹¹⁴⁸

1024. Në këtë periudhë ai shpesh udhëtonte për në Ballkan, sa herë që kishte nevojë, të paktën një herë në javë, nganjëherë nga dy herë në javë. Ai merrte udhëzime se kur të vinte dhe ai kryesisht thirrej nga A.Ka. Ai udhëtonte me aeroplan, paguante për biletat, dhe më vonë kompensohej nga A.Ka. dhe R.K.¹¹⁴⁹

1025. K1 shkonte shpesh vetëm për të përzier droga në Zvicërr, në Ramosen në kufi me Gjermaninë, në Cyrih dhe Bern.¹¹⁵⁰ K1 bënte përzierje edhe në Austri, në lokacione të ndryshme, p.sh., Vjenë përmes Sulko Covic dhe B.Ka.¹¹⁵¹

1026. Në vitin 1999 K1 ishte dënuar në Gjermani me 6 vjet burgim, dhe si rrjedhojë ishte privuar nga liria që nga ajo kohë, deri me lirimin e tij vetëm në janar të vitit

¹¹⁴³ 10.11.2016, f.30

¹¹⁴⁴ 10.11.2016, f.30

¹¹⁴⁵ 02.11.2016, f. 8

¹¹⁴⁶ 02.11.2016, f. 8

¹¹⁴⁷ 02.11.2016, f. 8

¹¹⁴⁸ 02.11.2016, f. 10

¹¹⁴⁹ 02.11.2016, f. 9

¹¹⁵⁰ 02.11.2016, f. 10-11

¹¹⁵¹ 02.11.2016, f. 11

2002 kur ai u shpërngul për në Sarajevë.¹¹⁵² K1 e pranoi se në këtë periudhë ai merrej me drogë, megjithatë nuk kishte asnjë provë për të vërtetuar ndonjë lidhje ndërmjet këtyre aktiviteteve dhe N.K.

1027. Më 05 nëntor 2003, K1 ishte arrestuar në Bosnje dhe kishte qëndruar në burg deri në vitin 2008. Pa dyshim, ai ishte liruar herë pas here nga burgju, por kjo filloi në vitin 2005, kur ai u transferua nga objekti i paraburgimit në Sarajevë në burg në Kula.¹¹⁵³ Ai e pranoi se ato pauza ishin të shkurtra, zakonisht një ditë ose madje një natë. Duke marrë parasysh faktin e mirënjohur se sa kohë nevojitet për të udhëtuar nëpër vendet e ish-Jugosllavisë, Gjykata konstaton K1 nuk kishte kohë të mjaftueshme për të shkuar jashtë gjatë këtyre pauzave.¹¹⁵⁴

1028. Në kontekst të lirimeve të K1 nga burgju në Bosnje, po ashtu duhet të përmendet se K1 paraqiti versionin të ndryshme sa i përket asaj se kush i mundësoi atij një trajtim të tillë të veçantë. Në gjykimin kundër Z.T., K1 dëshmoi se çdo gjë ishte e organizuar nga i, ndërsa në këtë rast ai dëshmoi se ishin N.K. dhe F.R. të cilët e përdoren ndikimin e tyre për t'i mundësuar atij të dilte nga burgju gati çdo herë kur ai dëshironte. K1 nuk ishte në gjendje të shpjegonte arsyet e mospërputhjeve në deklaratat e tij.

1029. K1 u ballafaqua me vendimin mbi imunitetin e lëshuar nga autoritetet e Bosnjes, që iu dha atij edhe për veprat penale që lidheshin me trafikimin e drogës, të kryera nga ai në periudhën 2005 – 2010. Sipas përshkrimit të kësaj akuze në këtë

¹¹⁵² 02.11.2016, f. 11-12, 25.02.2015, f. 22 - 23

¹¹⁵³ 02.11.2016, f.29, 24.01.2017, f. 22-23

¹¹⁵⁴ 02.11.2016, f.29

periudhë ai u paraburgos në institutin korrektues në Sarajevë, dhe pastaj në institutin korrektues Kula; roli i Z.T. ishte që t'i mundësonte K1 përmes të njohurve dhe lidhjeve të tij që të mungonte shpesh nga objekti korrektues. Kur u pyet për arsyen se pse aty ishte përmendur vetëm Z.T., K1 tha se ai gjykim ishte vetëm kundër tij dhe ai nuk ishte lejuar që të fliste kundër të tjerëve.¹¹⁵⁵

1030. Gjatë marrjes së tërthortë në pyetje, K1 e pranoi se që nga viti 2005 kur ai punonte me Z.T. të cilin ai e kishte takuar në burg, ku ishin bërë miq. Bashkëpunimi i tyre i gjerë kishte vazhduar deri në vitin 2010 kur K1 vendosi të dëshmonte kundër Z.T. para prokurorisë në Bosnje, pasi ai e kishte marrë statusin e dëshmitarit të mbrojtur.¹¹⁵⁶ Sipas dëshmisë së tij, që nga viti 2010 ai ishte i përfshirë në trafikimin me drogë. Në vitin 2011 ai ishte larguar nga vendi.¹¹⁵⁷

1031. Pikërisht analiza e këtyre datave të rëndësishme në jetën e K1 tregon se ai nuk kishte njohuri të drejtpërdrejtë lidhur me përfshirjen e N.K në krimin e organizuar të lidhur me trafikimin me drogë në periudhën prej 2000 – 2012.

4.5. Bashkëpunimi i K1 me të tjerët, përfshirë Z.T.

1032. Gjykata i gjeti si të pambështetshme deklaratat e K1 se ai kishte punuar në të njëjtën kohë për Z.T. dhe N.K. Deklarata e tij se S.T. qëndronte në baza ditore me N.K. në restorantin rrotullues është në kundërshtim me provat e tjera të mbledhura në këtë rast. Profiti i bërë nga K1 në bashkëpunim me Z.T. ishte shumë më i lartë se ai i fituar si pagesë për përzierje të drogave, kështu që nuk kishte justifikim të arsyeshëm për t'u përfshirë në biznes me njerëz të tjerë,

¹¹⁵⁵ 23.03.2017, f. 42

¹¹⁵⁶ 08.11.2016, f. 35-36

¹¹⁵⁷ 08.11.2016, f. 33; 10.11.2016, f. 16 - 17

sidomos të tillë që qëndronte në konflikt me Z.T. Përveç kësaj, nuk ekziston asnjë dëshmitar tjetër i cili do t'i vërtetonte pohimet e K1.

Përmbledhje e provave relevante

1033. Rasti i prokurorit ishte se N.K. ishte udhëheqës i grupit të organizuar kriminal të përfshirë në trafikun e drogës. Një nga aktivitetet specifike të asaj veprimtarie është fakti se një grup që e kryen atë është i mbyllur, anëtarët e tij janë “Bs.”ë ndaj njëri-tjetrit, ka një detyrim për t'i mbajtur sekrete aktivitetet e tij dhe ndërveprimet me grupet e tjera janë shumë të kufizuara. Çka rezulton nga dëshmitë e dhëna nga dëshmitari K1, është në kundërshtim me këtë *modus operandi*, gjë që Gjykata e konsideron si diçka që fuqishëm e minon kredibilitetin dhe vërtetësinë e këtij dëshmitari.

1034. K1 dëshmoi se në të njëjtën kohë kur ai ishte anëtar i grupit të organizuar kriminal të drejtuar nga N.K., ai punonte me ose për grupe të ndryshme të përfshira në trafikun e drogës që vepronin në Ballkan dhe jashtë rajonit. Ai shpjegoi se ai ishte një njeri “për t'u angazhuar”, i cili po i përzinte drogat për këdo që e paguante për këtë. Përveç N.K ai përmendi bashkëpunimin e tij me: R.K., Hamdo Daçiq, Z.T., L.B.C. dhe Velja Hot. Gjatë marrjes së tërthortë në pyetje, ai gjithashtu pranoi se ishte anëtar i grupit të A.Ka. dhe se gjithashtu punoi për D.Sa.. Në lidhje me këtë të fundit, ai tha se kishte filluar të punonte me të vetëm pasi kishte përfunduar së punuari me N.K., por një moment më vonë tha se po punonte për të gjithë ata në të njëjtën kohë.¹¹⁵⁸

¹¹⁵⁸ 26.01.2017, f. 19 - 20

1035. K1 ishte i qartë se partnerët e tij më të rëndësishëm në trafikun e drogës ishin Z.T. dhe gruaja e tij S.T. Ai i përshkroi në detaje operacionet e tyre kryesisht të lidhura me trafikimin e kokainës që i solli K1 shumë më tepër të ardhura se sa përzierja e drogave. Ata punonin së bashku në periudhën prej 2005 - 2009. Ishte një grup i strukturuar mirë, aty ishin të përfshirë rreth 50 njerëz. Ai pranoi se ndodhte që të kishte disa mosmarrëveshje ndërmjet tij në njërën anë dhe Turkovic në anën tjetër lidhur me ndarjen e parave dhe për këtë pjesë të biznesit përgjegjëse ishte S.T. Sipas K1, në fakt ishte ajo që e drejtonte organizatën.¹¹⁵⁹ Gjatë marrjes së tërthortë në pyetje K1 e pranoi se ata shisnin edhe heroinë në Bosnje, por gjithsesi në sasi më të vogla se kokainë.¹¹⁶⁰
1036. K1 dëshmoi se Z.T. nuk kishte asgjë kundër punës së tij me N.K., sidomos se S.T. takohej gati çdo ditë në Radon Plaza. Megjithatë, Z.T. dhe N.K. ishin në marrëdhënie të këqija, sepse N.K. dyshonte se Z.T. së bashku me R.D. ia kishin plaçkitur apartamentin e tij.¹¹⁶¹ Dëshmi e qartë e këtij tensioni midis tyre ishte përpjekja për të vrarë N.K. e ndërmarrë nga Z.T., gjë që ai e pranoi në gjyqin e tij në Bosnje dhe Hercegovinë.
1037. Duhet nënvizuar se Z.T. u dënua me aktgjykim të formës së prerë të gjykatës së Bosnjës dhe Hercegovinës, d.m.th., për vrasjen në tentativë të N.K, krim të organizuar dhe trafikim të drogës. Një nga dëshmitarët më të rëndësishëm në rastin e tij ishte K1.¹¹⁶²

¹¹⁵⁹ 08.11.2016, f. 35-36, 38 – 41; 10.11.2016, f. 16 - 17

¹¹⁶⁰ 10.11.2016, f.22

¹¹⁶¹ 08.11.2016, f. 44

¹¹⁶² Aktgjykimi i gjykatës së BeH kundër Z.T.

¹⁴⁷⁶ 19.02.2016, f. 15 - 16

4.6. Organizimi

1038. Gjykata e gjeti si të vërtetuar se K1 ishte marrë me drogë. Në dëshminë e tij ai e përshkroi në detaje mënyrën se si drogat presoheshin, paktoheshin dhe fshiheshin në dhomëza speciale në kamionë të mëdhenj, kombibusë dhe vetura të tjera.¹⁴⁷⁶ Ai i paraqiti rrugët të cilat shfrytëzoheshin për të sjellë drogat dhe se ku i shpërndanin ata më tej.¹¹⁶³ Përveç përzierjes, ai ishte po ashtu përgjegjës për paketimin e drogave nëpër valixhe, aty ngjitej letra se ku duhej të shkonte valixhja.¹¹⁶⁴ Ai e përshkroi mënyrën se si drogat paktoheshin, transportoheshin, fshiheshin¹¹⁶⁵ si dhe rrugët.¹¹⁶⁶

1039. Sidoqoftë, çështja thelbësore në këtë rast ishte të vërtetohej nëse kishte ndonjë lidhje midis drogave për të cilat po fliste K1 dhe N.K. Gjykata vuri në dukje se dëshmitë e K1 në lidhje me këtë çështje ishin të paqëndrueshme, ato ndryshuan në mënyrë të konsiderueshme pas situatës me imunitetin. Ishte e dukshme që ai u tërhoq nga shumë deklaratat fajësuese kundër N.K, pasi që ndaloi ta lidhte atë me dërgesat e drogës, ose nënvizoi se ai nuk ishte kompetent për t'i ditur detajet.

Përmbledhje e provave

1040. K1 dëshmoi se pas kthimit të tij nga Turqia, ai po i përzierte drogat.¹¹⁶⁷ K1 punonte për N.K. në përzierjen e drogave prej vitit 1988 deri në vitin 2009. Të

¹¹⁶³ 01.11.16, f. 14 - 20

¹¹⁶⁴ 01.11.2016, f. 24

¹¹⁶⁵ 01.11.16, f. 16-18, 25; 02.11.2016, f. 4, 5

¹¹⁶⁶ 01.11.16, f. 21

¹¹⁶⁷ 01.11.2016, f. 16

gjitha udhëzimet për përzierje ai i merrte nga A.Ka. and R.K.¹¹⁶⁸ Kur u pyet nëse ai kishte parë ndonjë para nga N.K., ai u përgjigj se ai punonte për R.K., dhe ai nuk e dinte se çfarë fitonte ai.¹¹⁶⁹

1041. K1 në përgjithësi tha se drogat i përkisnin N.K dhe R.K. sepse për një kohë të gjatë ai po merrte pjesë në takime dhe kishte dëgjuar rrëfime.¹¹⁷⁰ Para imunitetit, ai ishte më i qartë duke thënë se N.K. ishte numri një në grup, ndërsa R.K. ishte pas tij.¹¹⁷¹ Gjatë marrjes së tërthortë në pyetje ai e pranoi se R.K. merrej me çdo gjë, dhe vetëm në rast se disa gjëra shkonin gabim ai shkonte dhe fliste me N.K.¹¹⁷² Sipas tij, ata të gjithë e dinin se për kë po punonin ata. N.K. ishte udhëheqësi, të gjitha ata punonin për të, çdo kush i kishte detyrat e tij.¹¹⁷³

1042. Gjatë marrjes së tërthortë në pyetje K1 në shumë raste u ballafaqua me dëshmitë e tij të mëparshme dhënë para autoriteteve boshnjake. Më 20 shkurt 2013, ai u pyet për bashkëpunimin e tij me N.K. dhe zinxhirin komandues. Fillimisht ai tha se në atë kohë ishte e ndaluar të flitej për të dhe F.R. Megjithatë, analiza e kësaj dëshmie tregon se nuk kishte asnjë ndalesë për të dëshmuar për N.K. sepse tashmë në atë kohë K1 e kishte përmendur emrin e N.K në kontekst të trafikimit me drogë. Kur K1 ishte pyetur se përse ai e përmendi N.K. pavarësisht nga udhëzimi i pretenduar i një prokurori boshnjak që të mos e bënte një gjë të tillë, ai shpjegoi se ishte e ndaluar të flitej për shumat. Atij i lejohej të fliste vetëm për gjëra pozitive, asgjë negative dhe jo për droga.¹¹⁷⁴

¹¹⁶⁸ 08.11.2016, f. 32

¹¹⁶⁹ 01.11.2016, f. 17

¹¹⁷⁰ 02.11.2016, f. 5

¹¹⁷¹ 19.02.2016, f. 24

¹¹⁷² 10.11.2016, f.35

¹¹⁷³ 11.11.2016, f.32

1043. Në të njëjtën dëshmi nga shkurti i vitit 2013, K1 tha se e njihte N.K., të gjithë ata e quanin *Stari* (Plaku) dhe ai merrej me drogë. Ai e pranoi se ai e zbuloi atë, megjithatë nuk përmendi ndonjë sasi. Por një moment më vonë ai u përball me një fragment ku ai e përshkroi në detaje sasinë e drogës dhe mënyrën se si u transportua.¹¹⁷⁵ Gjatë gjykimit kundër Z.T. në vitin 2011 të njëjtët prokurorë i thanë atij që të mos e përmendte N.K. dhe F.R.¹¹⁷⁶
1044. Gjykata gjeti se nuk ishte e vërtetë që K1 dhe dëshmitarëve të tjerë u ishte ndaluar të flisnin për përfshirjen e N.K në trafikun e drogës në Bosnje. Nuk është vetëm kundërthënëse me përmbajtjen e dëshmisë së dhënë nga K1 para autoriteteve boshnjake kur së paku në disa raste ai përmend N.K. dhe përfshirjen e tij në trafikun e drogës, por sjellja e tillë e prokurorëve do të shkelte jo vetëm dispozitat e procedurës penale , por edhe kodin e etikës profesionale.
1045. Në shumë raste, kur fliste për organizatën që merrej me drogë, K1 përmendte vetëm emrat e R.K., A.Ka., K.Ku. dhe Sulo. Ai gjithashtu theksoi se ishte R.K. ai i cili ishte përgjegjës për organizimin dhe të gjitha operacionet.¹¹⁷⁷ Kur K1 po punonte në të gjithë Evropën, ai shpesh ishte në kontakt me shefat e tij R.K., A.Ka. dhe Florimin.¹¹⁷⁸ K1 nuk e përmendi N.K. në këtë kontekst.

¹¹⁷⁴ 24.01.2017, f. 23 - 26

¹¹⁷⁵ 24.01.2017, f. 31

¹¹⁷⁶ 24.01.2017, f. 26 - 27

¹¹⁷⁷ 01.11.16, f. 13

¹¹⁷⁸ 02.11.2016, f. 13

1046. Ai pohoi se sa herë që R.K. do të ballafaqohej me ndonjë problem, ai do të fliste me “St.”, domethënë me N.K.¹¹⁷⁹ Sipas K1, R.K. ishte shef më i madh në aspektin e organizimit, por shefi kryesor ishte N.K. R.K. ishte gjithmonë përgjegjës për organizimin, ai ishte gjithmonë me ta, iu jepte informatat se ku të shkonin, në cilin lokacion.¹¹⁸⁰
1047. Gjatë dëshmisë së tij të mëtejshme, K1 theksoi se R.K. ishte përgjegjës për gjithçka; ai ishte ai që u jepte atyre udhëzimet. Ai mbante shënime për t'i raportuar “St.” për atë që ishte marrë dhe dorëzuar. Pas dorëzimit R.K. u kërkonte atyre të dhënat e tyre të cilat i dërgoheshin N.K. K1 nuk ishte konsekuent në dëshminë e tij, sepse një moment më vonë ai shpjegoi se R.K. nuk i dërgonte raporte, por ai takohej me N.K. dhe i transmetonte ato. Duhet nënvizuar se K1 vetëm kishte dëgjuar për ato takime nga R.K. Ai gjithashtu shpjegoi se ai rrallë ishte i pranishëm kur kjo ndodhte, sepse zakonisht R.K. shkonte vetëm për të takuar N.K.¹¹⁸¹
1048. K1 dëshmoi ndryshe, gjatë marrjes së tërthortë në pyetje, lidhur me raportimin që bëhej nga R.K. Këtë herë ai tha se ai e shkruante nëse gjithçka ishte në rregull me dorëzimin dhe e informonte R.K.n. Më pas, kjo i fundit i afrohej N.K., p.sh. në Casa Grande ose Restorant Brajlovic. Gjatë kësaj dëshmie K1 tha se ishte i pranishëm në raste të tilla, megjithatë ai nuk ulej gjithmonë me ta në tavolinë. Ai nënvizoi gjithashtu se nuk ishte detyrë e tij ta informonte N.K., prandaj ai nuk e bënte këtë vetë.¹¹⁸²

¹¹⁷⁹ 01.11.16, f. 15-16

¹¹⁸⁰ 01.11.2016, f. 24

¹¹⁸¹ 01.11.2016, f. 30 – 31; 07.11.2016, f. 28 – 29, 31; 25.01.2016, f. 15

¹¹⁸² 25.01.2017, f. 15-16

1049. Gjatë marrjes së mëtejme në pyetje në kuadër të marrjes së tërthortë në pyetje K1 e ndryshoi versionin e tij përsëri sepse ai tha se gjatë gjithë operacionit të tij me atë grup ai ishte dëshmitar i asaj se R.K. i kishte raportuar N.K vetëm dy deri në tre herë.¹¹⁸³ Kur u pyet lidhur me drogat që vinin në një lokacion të caktuar (178), K1 tha se lidhur me raportimin para N.K ai kishte mësuar vetëm nga rrëfimet e R.K.t.¹¹⁸⁴

1050. K1 nuk i kujtohej se sa herë ishte i pranishëm kur R.K. i raportonte N.K, por pak a shumë ishte 2 – 3 herë. Kur u pyet nëse iu referua periudhës prej 1996 - 2009, ai tha se nuk e dinte. Pastaj, ai ndërroi mendje dhe tha se ata kishin takime shumë shpesh, por se ata ishin të lidhur vetëm me listat e dërgesave, sepse sa herë që përfundonte dorëzimi ata e kontrollonin nëse gjithçka përputhej. Pas një

kohe, K1 ndërroi mendje përsëri sepse ai tha se këto 2 – 3 takime ishin gjatë kohës kur ata komunikonin me shkrim, përveç kësaj ata të gjithë janë takuar shumë herë: A.Ka., N.K., R.K. dhe Sulo.¹¹⁸⁵ Ishte e dukshme që dëshmitari po e shmangte dhënien e përgjigjes së qartë në një pyetje të thjeshtë dhe po përpiqej të fitonte në kohë për të përgatitur një përgjigje.

1051. Gjatë marrjes së tërthortë në pyetje K1 u pyet për dëshminë e tij të mëparshme lidhur me zinxhirin komandues, të dhënë në shkurt të vitit 2013. Me këtë rast ai tha se zinxhiri përbëhej nga: A.Ka., K.Ku. Kasim, Hysic Sulo, shqiptari nga Kosova që kishte marrë pjesë në vrasje me K2, Samir dhe H.Kr. nga Novi Pazari.

¹¹⁸³ 24.01.2017, f. 38

¹¹⁸⁴ 25.01.2017, f. 22-23

¹¹⁸⁵ 01.11.2016, f. 30 - 31

- Lista e emrave nuk përmbante N.K. dhe R.K. Kur u pyet për këtë, K1 tha se nuk ishte dëshmia e tij dhe se kjo ka shumë mundësi të ishte fabrikuar. Ai nuk ishte në gjendje të shpjegonte se pse ai nuk e kishte përmendur R.K. dhe N.K.¹¹⁸⁶
1052. K1 nuk e dinte nëse R.K. e kishte organizatën e vet kriminale, por A.Ka. me siguri sepse ai e kishte parë personalisht në Turqi.¹¹⁸⁷ Megjithatë, A.Ka.po e fshihte atë nga R.K.¹¹⁸⁸
1053. Sipas K1, që nga viti 1988 N.K. jetonte në Bosnje, ai e kishte një apartament në Hrasno, në Rrugën Trg Heroja, një shtëpi në Ilidza dhe hotelin Casa Grande.¹¹⁸⁹ Gjatë marrjes së tërthortë në pyetje ai tha se në këtë periudhë N.K. po merrej me drogë dhe punonte për sigurimin e Serbisë.¹¹⁹⁰
1054. Në atë kohë shefat e tij ishin R.K., A.Ka. dhe Florimi nga Peja, por që atij nuk i kujtohej emri i tij. Më vonë ai ishte rrëmbyer së bashku me M.Ka. nga K2. Ata të gjithë punonin për N.K. dhe ata i jepnin udhëzime atij.¹¹⁹¹
1055. K1 i përmendi po ashtu se shënimet mbaheshin nga ai, A.Ka. dhe R.K.¹¹⁹² për të ditur se çfarë sasive të drogave ata merrnin dhe dërgonin, si dhe për ta ditur bilancin në fund.¹¹⁹³
1056. Gjatë dëshmisë së tij K1, dëshmoi se si grupi i organizuar kriminal siç pretendohet i udhëhequr nga N.K. funksiononte, megjithatë mund të vërehet se njohuritë e dëshmitarit ishin shumë të kufizuara dhe në shumë raste ai i referohej

¹¹⁸⁶ 24.01.2017, f. 29-31

¹¹⁸⁷ 02.11.2016, f.28

¹¹⁸⁸ 24.01.2017, f. 37

¹¹⁸⁹ 01.11.16, f. 20, 24

¹¹⁹⁰ 10.11.2016, f.31

¹¹⁹¹ 02.11.2016, f. 13

¹¹⁹² 01.11.2016, f. 25

¹¹⁹³ 01.11.2016, f. 30; 07.11.2016, f.17

asaj që ai kishte dëgjuar. Shpesh, ai nuk ishte në gjendje të tregonte burimin e informatave dhe kur u pyet lidhur me këtë ai vetëm tha se e dinte ashtu. Një dallim i dukshëm në mënyrën se si ai dëshmoi thjesht mund të ishte vërejtur mes të asaj çfarë kishte thënë ai para çështjes së imunitetit dhe pasi që ajo ndodhi. Para imunitetit ai ishte më i prirë ta tregonte N.K. si udhëheqës të grupit, ndërsa pas imunitetit ai i shmangte deklaratat që qartazi çonin kah N.K. si personi i cili ishte i përfshirë në këtë operacion kriminal.

4.7. Fletorja e K1

1057. Një pjesë e konsiderueshme e dëshmisë së K1 i referohej fletores, ose madje edhe bazohej në të. Fletorja ishte dorëzuar nga dëshmitari K1 vetëm në prill të vitit 2015, kur shqyrtimi gjyqësor në këtë rast tashmë kishte filluar, me gjithë faktin se K1 u bë dëshmitar bashkëpunues në vitin 2010. Gjykata dhe mbrojtja u informuan për këtë provë të re më 21 prill 2015 kur prokurori paraqiti propozim për ta zbardhur atë.
1058. Gjatë seancës së shqyrtimit gjyqësor të mbajtur më 22 shkurt 2016, kur propozimi për pranimin e fletores si provë u diskutua, mbrojtja e kundërshtoi propozimin e prokurorisë dhe kërkoi që ajo të refuzohej si e papranueshme mbi bazën e asaj se ajo ishte paraqitur pas aktakuzës, pa urdhër të rregullt të gjykatës dhe pa pasur mundësinë që ajo të sfidohej.¹¹⁹⁴
1059. Gjykata erdhi në përfundim se prokurori kishte mësuar për këtë provë më vonë, në vitin 2015. Andaj, Gjykata e trajtoi atë jo si zbardhje të provës por si propozim

¹¹⁹⁴ 22.02.2016, f. 38 – 39; 23.02.2016, f. 2-3

të ri për të. Sipas nenit 329 të KPP-së, palëve u lejohej të paraqesin prova të reja deri në përmbyllje të shqyrtimit gjyqësor. Gjykata gjeti se nuk kishte bazat që parashihen në nenet 258 dhe 259 të KPP-së, që do të mund ta arsyetonin një vendim për ta penguar këtë provë.¹¹⁹⁵

1060. Në vitin 2016, gjatë seancës për të vendosur mbi fletoren, prokurori refuzoi të jepte procesverbalin nga marrja në pyetje ku K1 e pranonte për herë të parë ekzistencën e fletores, për shkak të fshehtësisë së procedurave të tjera ku ishte marrë deklarata. Megjithatë, ajo u sigurua më vonë dhe K1 u ballafaqua me atë çfarë ai kishte thënë në atë kohë.¹¹⁹⁶

1061. Fletorja përmban disa shënime të shkruara me dorë (të diskutuara në detaje më poshtë) që përfshin periudhën prej prillit 2002 deri në vitin 2009.

1062. Vërtetësia dhe besueshmëria e fletores u kontestuan nga mbrojtja gjatë rrjedhës së shqyrtimit gjyqësor. Mbrojtja paraqiti në disa raste propozimin për ta deklaruar atë si thelbësisht të pambështetshme. Me kërkesë të mbrojtjes fletorja ishte ekzaminuar nga një ekspert për vjetërsinë e bojës, dhe në fund ishin përgatitur tre ekspertiza.

4.7.1. Përcaktimi i vjetërsisë së bojës

1063. Raporti i parë i ekspertit mbi përcaktimin e vjetërsisë së bojës ishte përgatitur nga një ekspert i caktuar nga gjykata pas kërkesës së mbrojtjes¹¹⁹⁷, E.H.S. nga the E.H.S. Forensics, LLG. Raporti i tij ishte dorëzuar më 11 korrik 2016 dhe u ishte dorëzuar palëve.

¹¹⁹⁵ 23.02.2016, f. 4

¹¹⁹⁶ 23.02.2016, f. 3-4

¹¹⁹⁷ 24.02.2016

1064. Qëllimi i këtij opinioni të ekspertit ishte që të vërtetojë nëse shënimet në fletore ishin bërë në atë kohë me datat e tyre të regjistrimit. Për t’iu përgjigjur kësaj pyetjeje, eksperti i ekzaminoi vizualisht faqet e përzgjedhura nga fletorja, dhe kishte aplikuar metodat e mëposhtme të përcaktimit të vjetërsisë së bojës: kromatografia me gaz, krahasimi i bojës me kromatografi të shtresës – së hollë dhe gjurmët e shtypura të shkrimit ESDA. Në përmbyllje, eksperti, eksperti kishte cekur se:

“Nuk ekzistojnë prova nga testi i kryer se faqet janë shkruar në ndonjë kohë tjetër përveç datave të tyre të pretenduara.”¹¹⁹⁸

1065. Mbrojtja nuk u pajtuam me konkluzionin e ekspertit dhe e paraqiti raportin e ekspertit të përgatitur nga Dr. V.N.A. për t’i kundërshtuar konstatimet e paraqitura nga E.H.S.. V.N.A. nuk u pajtua aspak me konkluzionet që përmbante raporti i E.H.S., kryesisht mbi baza metodologjike. Pasi ka kryer analizën e këtij raporti ai mbajti këtë opinion:

*“(…) se konkluzioni në të cilin kishte arritur Z. E.H.S. sa i përket vjetërsisë së bojërave në fjalë në fletore (“**jam i mendimit se nuk ekziston asnjë provë nga testi i kryer, se faqet janë shkruar në ndonjë kohë tjetër përveç datave të tyre të pretenduara**”) nuk mund të mbështeten shkencërisht nga të dhënat e siguruara, ishte arritur përmes procedurës metodologjikisht të pamatur (kjo nuk ka asgjë të bëjë me metodat e publikuara, të shqyrtuara nga kolegët, si dhe të testuar/të validuar të vjetërsisë së bojës që analizojnë 2-PE), dhe si rrjedhojë konkluzioni i*

¹¹⁹⁸ Raporti i ekspertit i Erich J. Speckin, f. 5

*përcaktimit të vjetërsisë së kësaj boje nuk mund të konsiderohet as i saktë e as i besueshëm.*¹¹⁹⁹

1066. E drejta e të pandehurit për të siguruar dhe paguar për ekspertizë të veten nga neni 141 (2) i KPP-së. Aty parashihet që eksperti duhet të veprojë në përputhje me nenin 139 të KPP-së dhe prokurori i shtetit merr një kopje të raportit të ekspertit të mbrojtjes brenda 14 ditësh pas përfundimit të tij.
1067. Gjykata konstatoi se raporti i ekspertit i paraqitur nga mbrojtja i plotëson kushtet e përshkruara në ligj dhe si i tillë është provë e pranueshme.
1068. Duke marrë parasysh dy opinione të ekspertëve me përfundime kundërshtuese, Gjykata e konsideroi të nevojshme të angazhojë një ekspert tjetër për dokumente dhe grafologji. Eksperti R.Lu. nga *Asociacioni i Forenzikës i Polonisë* ishte thirrur për të paraqitur dhe shpjeguar metodat ekzistuese që aplikohen për analizën e përcaktimit të vjetërsisë së bojës së dokumenteve.¹²⁰⁰ Ai po ashtu e mori fletoren për ekzaminim.
1069. Vendimi për caktimin e këtij eksperti të veçantë u parapri nga një përpjekje për të marrë këtë opinion të ekspertit përmes Agjencisë Forenzike të Kosovës. Prandaj, gjatë seancës së shqyrtimit gjyqësor të mbajtur më 31 korrik 2017, H.Bo., kreu i divizionit për dokumente dhe shkrime me dorë, dëshmoi nëse ishte e mundur të bëhej ekzaminimi i përcaktimit të vjetërsisë së bojës në Kosovë. Ai shpjegoi se Instituti në Kosovë nuk ishte në gjendje të kryente një analizë të tillë. Nga informatat që ai kishte marrë nga institute të tjera evropiane ai zbuloi se pak prej tyre e aplikojnë metodën e përcaktimit të vjetërsisë së bojës, por se kjo kufizohet

¹¹⁹⁹ Raporti i ekspertit i Valery N. Aginsky, f. 6

¹²⁰⁰ Aktvendimi i datës 04 gusht 2017

në shënime që janë jo më të vjetra se 6 muaj. Një metodë tjetër që përdoret për këtë qëllim bazohet në krahasimin e ngjyrave me ato që kanë qenë në dispozicion në treg në datën e saktë.¹²⁰¹

1070. Informatë e ngjashme se përcaktimi i vjetërsisë së bojës mund të kryhet efektivisht vetëm në rastin e dokumenteve jo më të vjetra se 6 muaj ishte siguruar edhe nga Universiteti i Wroclav në Poloni.

1071. Eksperti R.Lu. e paraqiti raportin e tij me shkrim. Raporti i përmbush të gjitha kushtet e specifikuara në nenin 138 të KPP-së. Ai kreu ekzaminimin e fletores, e cila i ishte dorëzuar atij. Ndër të tjera, ai i mori për analizë edhe raportet e ekspertëve të përgatitur nga E.H.S. dhe V.N.A.. Z. Łuczak prezantoi metodat në dispozicion sa i përket përcaktimit të vjetërsisë së bojës, si dhe u mor me konkluzionet e të dy ekspertëve. Ai erdhi në përfundim:

“Si rezultat i analizës së shkrimit që daton nga periudha 2002 – 2008 (sipas dokumentit) në fletoren në fjalë, aty thuhet se:

1)Është praktikisht e pamundur të përcaktohet koha kur janë bërë shënimet e veçanta, andaj nëse ato janë përgatitur në datat e pretenduara, ose më vonë, si një akt i krijimit;

Sipas shkencës së forenzikës, nuk është e mundur të konfirmohet ose të mohohet besueshmëria e shkrimeve sa i përket kohës dhe rendit se kur janë bërë ato.”

¹²⁰¹ Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor më 31.07.2017, f. 3 - 6

1072. Eksperti Łuczak në raportin e tij të hollësishëm dhe të detajuar ka paraqitur metodat e aplikuara aktualisht për vlerësimin e “vjetërsisë së dokumentit”. Ai ka theksuar se të gjitha metodat e njohura dhe të verifikuara të përcaktimit të vjetërsisë së bojësjellin rezultate pozitive vetëm në rast të bojave “të freskëta”. Ai, në tabelë ka paraqitur gjetjet e ekspertëve të ndryshëm për përcaktimin e vjetërsisë së bojës të cilat tregojnë “vjetërsinë” e bojës e cila lejon vlerësimin:

Viti	Autori/Autorët	Periudha e përcaktimit të vjetërsisë	Publikimi
1996	V.N.A.	Disa muaj	V.N.A., V. N. Përcaktimi i vjetërsisë dhe karakterizimi i shkrimit, vulës, jastëkut të bojës, bojës së printerëve përmes kromatografisë me gaz/spektrometrisë masive. Revista Ndërkombëtare e Ekzaminerëve Forenzik të Dokumenteve, vol. 2, nr. 2 103–116, 1996

2002	V.N.A.	Deri në 6 muaj	V.N.A., V. N. <i>Metodat aktuale të përcaktimit të datës së bojës në dokumente</i> . Seanca e 60-të e konferencës vjetore të Shoqatës Amerikane të Ekzaminerëve të Dokumenteve të Kontestuara, San Diego, Kaliforni, 14-19 gusht 2002, dhe takimi i Shoqatës Midwestern të Shkencëtarëve të Forenzikës, vjeshtë 2002, Milwaukee, Wisconsin, 15-20 shtator 2002.
2002	Gaudreau & Brazeau	Deri në 18 muaj	Gaudreau M., Brazeau L. Përcaktimi i vjetërsisë së bojës duke përdorë metodën e Metoda e humbjes së koeficientit të tretësve, konferenca e 60-të vjetore e Shoqatës Amerikane të Ekzaminerëve të Dokumenteve të Kontestuara, San Diego, 2002
2002	Łuczak & Krawczyk	12 – 18 muaj	Łuczak, R., Krawczyk, W. <i>Metodyka badań dokumentów. Problemy Kryminalistyki</i> 236, 18-22, 2002

2003	Andrasko	4 – 6 muaj	Andrasko J. Përcaktimi i vjetërsisë së bojës duke e përdorë SPME dhe nxjerrjen e metanolit, takimi i 3-të i Rrjetit Evropian të Instituteve të Shkencës Forenzike, Stamboll 2003.
2006	Wang	Deri në 3 muaj	Y. Wang, L. Yao, P. Zhao, J. Wang, Y. Wang, Përcaktimi i vjetërsisë relative të bojës së stilolapsit me kromatografi me gaz, Kufijtë e Kimisë në Kinë 2 (223–226), 2006
2008	Bugler	Deri në 6 muaj	Bügler, J. Buchner H., Dallmayer A. Përcaktimi i vjetërsisë së bojës së stilolapsit përmes desorbimit termik dhe kromatografisë me gaz – spektrometrisë masive. Revista e Shkencave Forenzike 53, 982–988, 2008
2014	Aginski	Deri në 6 muaj	Aginski V. N. Testimi i përcaktimit të vjetërsisë së bojës – A ndikojnë gjurmët e ekzaminimeve paraprake në parametrat e përcaktimit të bojës? Revista e Shoqatës Amerikane të Ekzaminerëve të Dokumenteve të Kontestuara, vol. 17, nr 2, 49-63, 2014

2015	Koenig, Weyermann, Kohler, Kirsch, Bugler	Deri në 6 muaj	Koenig A, Weyermann C., Kohler F., Kirsch D., Bugler J. Përcaktimi i vjetërsisë së bojës përmes desorbimit termik dhe kromatografisë me gaz dhe spektrometrisë duke krahasuar rezultatet e marra nga dy laboratorë, 2015
------	---	-------------------	--

1073. Eksperti ka theksuar se bojat e stilolapsit janë ekzaminuar më së miri dhe janë paraqitur në literaturë, dhe mund të analizohen për të përcaktuar datën kur është bërë shënimi. Siç është konstatuar përmes ekzaminimit fillestar të shënimeve në fletoren në fjalë, ato janë bërë me këtë lloj të bojës. Sidoqoftë, nga informatat e marra rezulton se ky dokument i është dorëzuar gjykatës më 21 prill 2015. Prandaj, metodat e lidhura me analizën e humbjes së tretësve (2-PE) nuk kanë qenë të aplikueshme sepse ato nuk do të ishin të dobishme për mbishkrimet të cilat tashmë ishin dy vjet e pesë muaj të vjetra në kohën kur është kërkuar mendimi (08 shtator 2017). Ky përfundim i referohet të dy mundësive të përcaktimit të vjetërsisë absolute të shënimeve në fletore dhe përcaktimit të kohës së regjistrimit të shënimeve në lidhje me njëra-tjetrën.

1074. Në mendimin e tij si ekspert, R.Lu. ka adresuar një nga një gjetjet që përmban raportin i përgatitur nga E.H.S.. Duhet theksuar se mendimi i tij është në përputhje të plotë me vlerësimin kritik të paraqitur nga eksperti. Të dy ekspertët janë pajtuar:

Ad. Përcaktimi i vjetërsisë së bojës përmes kromatografisë me gaz

Raporti i z. E.J. E.H.S. është përgatitur më 11 korrik 2016, prandaj ekzaminimi me siguri është kryer pak më parë. Dokumenti në fjalë është paraqitur në gjykatë më 21 prill 2015, pra ekzaminimi është bërë pas më shumë se një viti e tre muaj. Siç është paraqitur në pjesën teorike, pas një periudhe të tillë, përcaktimi i vjetërsisë së bojës nuk duhet të bëhet, sepse nuk lejon një përfundim të arsyeshëm. Vetëm për rikujtim, sipas rregullave të respektuara nga ekspertët, koha për tu bërë ekzaminime të tilla është vetëm gjatë maksimum 6 muajve nga data kur shënimet janë bërë apo zbuluar për të kryer një ekzaminim të tillë.

E.J. E.H.S. ka zbuluar nivel të “ulët” të 2-PE në boja ku ai ka gjetur si një konfirmim të besueshmërisë së periudhës kohore kur janë bërë shënimet (2002 – 2008). Sidoqoftë, nivelet e ulëta të 2-PE nuk autorizojnë për të bërë ndonjë përfundim. Është një gabim metodologjik. Është një interpretim më i gjerë, një deklaratë pa asnjë bazë shkencore se nëse një rezultat përsëritet për disa boja të ndryshme në një dokument, atëherë përfundimi se shkrimet janë të besueshme (sepse janë të “vjetra”) është i vërtetë. Deklarimi shkrime të “vjetra” mund t’i referohen shkrimeve nga viti 2002, 2008 dhe nga viti 2014 gjithashtu. Sipas mendimit të tij, E.J. E.H.S. as nuk ka paraqitur çfarë metode analitike ka përdorur, e as ndonjë të dhënë/rezultat të marrë nga ekzaminimi. Prandaj, është e mundur të vlerësohet cilësia dhe saktësia e analizës së kryer dhe interpretimi i nocioneve të përdorura si “nivele të ulëta të 2-PE” dhe “nivel i stabilizuar”.

Ad. Krahasimi i bojës përmes shtresës së hollë të kromatografisë

Deklaratat e paraqitura nga z. E.J. E.H.S. janë formalisht të sakta, por janë të parëndësishme për rastin. Në parim, ekzaminimet përmes shtresës së hollë të kromatografisë lejojnë vetëm vërtetimin e pajtueshmërisë ose dallimit midis përbërjes së bojërave dhe substancave të tjera. Analiza TLC e bërë nga z. E.J. E.H.S. nuk ka mundur të shpie në një përfundim lidhur me rendin dhe kohën e shënimeve në fletore. Siç e kam përmendur tashmë në pikën B. Ekzaminimi paraprak, nuk mund të përjashtohet se janë përdorur stilolapsat e njëjtë, madje edhe brenda periudhës 6 –vjeçare. Edhe po ta pranojmë tezën se shënimeve u është vënë një datë e mëparshme dhe janë bërë brenda një periudhe të shkurtër kohore, ndryshe nga ajo e treguar, nuk çon në ndonjë përfundim.

Ad. ESDA

Përfundimet e z. E.J. E.H.S. nga ekzaminimi ESDA janë jo relevante për këtë lëndë. Metoda ESDA nuk aplikohet për të përcaktuar kur janë bërë shkrimet dhe kur i kanë lënë gjurmët e tyre.

Kur janë bërë shkrimet në fletore, me siguri janë paraqitur gjurmët tipike të shkrimit në faqet vijuese të cilat kanë shërbyer si “mbështetëse” për shkrim. Në të dy rastet e analizuara, p.sh. kur janë bërë shkrimet në datat e treguara ose shkrimeve u janë vënë datat e mëparshme, gjurmët/zgavrat të cilat paraqiten gjatë shkrimit do të ishin të njëjta, në të njëjtat faqe vijuese.

1075. Gjykata pajtohet me përfundimet e paraqitura në raportet e ekspertëve V.N.A.

dhe Łuczak, të cilët ishin të qartë me vlerësimin se nuk ka qenë e mundur të përcaktohet vjetërsia e bojës në fletore (p.sh. sa të vjetra ishin shënimet në të).

Ata, gjithashtu kanë sqaruar në hollësi se pse nuk pajtohen me gjetjet e E.H.S.. Të dy ekspertët kanë arsimim, kualifikim dhe përvojë relevante në vlerësimin e dokumenteve, ata kanë paraqitur analizën e hollësishme të temës, arsyetimin dhe përfundimet.

1076. Duke konstatuar si më lart, duhet theksuar se nuk ka qenë e mundur të vërtetohet përmes metodave për përcaktimin e vjetërsisë së bojës, nëse shënimet në fletoren e paraqitur nga K1 janë bërë në datat siç janë paraqitur në të. Sidoqoftë, ky fakt nuk mund të ishte arsye për ta shpallur këtë provë të papranueshme mbi bazën se ajo ishte thelbësisht e pambështetshme siç ishte kërkuar nga mbrojtja. Duke vendosur lidhur me këtë, gjykata ka marrë parasysh përkufizimin ligjor “thelbësisht të pambështetshme” të përcaktuar me nenin 19 (1.29) të KPP-së i cili përcakton se prova apo informata është e tillë nëse origjina e saj është e panjohur, bazohet në thashetheme, apo në dukje të parë është e pamundshme ose e pabesueshme. Në lëndën në fjalë, origjina e fletores ka qenë e njohur (vjen nga K1), nuk është thashetheme dhe as nuk është e pamundur ose e pabesueshme në dukje të parë.

1077. Prandaj, besueshmëria, saktësia dhe vlera provuese e fletores duhet patjetër të vlerësohet në dritën e provave dhe rrethanave tjera të rastit.

4.7.2. Mbajtja dhe dorëzimi i fletores nga K1

1078. Dëshmitari K1 është marrë në pyetje disa herë për rrethanat që kanë të bëjnë me fletoren, në veçanti lidhur me logjikën e bërjes së shënimeve, ku është mbajtur, kë e ka njoftuar në lidhe me atë. Pyetja tjetër shumë e rëndësishme ka qenë

arsyeja pse e ka dorëzuar atë aq vonë.

1079. K1 ka dëshmuar se këtë fletore e kishte mbajtur në disa lokacione, në Sarajevë, në lagjen Hrasno, në një apartament të marrë me qira ku ai dhe të tjerët kanë mbajtur gjëra të ndryshme.¹²⁰² Fletorja rregullisht lëvizte në lokacione të ndryshme sepse apartamentet ndërroheshin shpesh. Në Hrasno mbahej në kasafortë, ku gjithashtu fshiheshin edhe gjëra të tjera.¹²⁰³
1080. Gjatë marrjes së tërthortë në pyetje, K1 ka thënë se edhe kur lirohej nga burgu për ta kryer punën, ka ndodhur që të shkonte në këtë apartament në Hrasno për t'i vënë shënimet në fletore. Ai nuk kishte frikë të shkonte atje sepse ishte e organizuar mirë sepse njerëzit në “krye të shtetit” punonin me ata.¹²⁰⁴
1081. K1 fillimisht ka dëshmuar se para se të largohet nga Bosnja në vitin 2011, ai e ka marrë fletoren dhe disa dokumente të tjera me vete.¹²⁰⁵ Atij nuk i kujtohej nëse i kishte njoftuar hetuesit në Bosnje lidhur me fletoren e cila sipas tij e dokumentonte bashkëpunimin e tij me N.K. Në të njëjtën kohë, ai e ka pranuar se dokumentet dhe shënimet e tij në lidhje me Z.T. janë marrë nga hetuesit menjëherë pasi ka filluar të bashkëpunojë me autoritetet e Bosnjës.¹²⁰⁶
1082. Ai e ka pranuar se fletoren ua kishte dorëzuar hetuesve të EULEX-it vetëm më 2015¹²⁰⁷. Kur është pyetur pse nuk e ka bërë këtë më parë, K1 ka thënë se nuk

¹²⁰² 07.11.2016, f.19

¹²⁰³ 08.11.2016, f. 32-33

¹²⁰⁴ 24.01.2017, f. 20

¹²⁰⁵ 08.11.2016, f. 33

¹²⁰⁶ 08.11.2016, f. 34

¹²⁰⁷ 08.11.2016, f. 33

takohej shumë shpesh me hetuesit. Në një rast ai i kishte njoftuar ata se e kishte në posedim një listë të transaksioneve, por se i ishte thënë se do t'i kthehemi kësaj më vonë. Pastaj, ai i kishte treguar prokurorit për fletoren, i cili ka kërkuar që t'ia dorëzojë, dhe pastaj ai e kishte bërë këtë.¹²⁰⁸ Ai gjithashtu ka thënë se ka menduar se e kishte njoftuar prokurorin Campara lidhur me fletoren dhe se ka pasur një marrëveshje që të takoheshin në një vend të pazbuluar, por ishte shtyrë.¹²⁰⁹

1083. Gjatë marrjes së tërthortë në pyetje, K1 ka paraqitur një version të ndryshëm. Ai ka thënë se sapo kishte dashur t'ia tregojë fletoren Camparas, por konvoji me të cilin po transportohej ai ishte qëlluar nga snajperi. Prandaj, ai nuk është kthyer në gjykatë ku do të duhej të takohej me prokurorin dhe t'ia dorëzojë fletoren.¹²¹⁰

1084. Gjykata e ka verifikuar këtë informatë me autoritetet e Bosnjës. Nga deklarata me shkrim e policit të përfshirë në mbrojtjen e K1 në Bosnje ka rezultuar se nuk ka pasur të shtëna mbi veturën e cila ishte përdorë për ta transportuar K1.¹²¹¹

1085. K1 gjithashtu ka dëshmuar se ai kishte biseduar me siguri me prokurorin Campara lidhur me fletoren, mirëpo nuk ishte futur në procesverbal. Mes tyre ishin pajtuar që të takoheshin jashtë zyrës dhe pastaj ai do ta plotësonte dëshminë e tij.¹²¹² Më vonë, ai ka thënë se nuk ia kishte dhënë fletoren Camparas gjatë marrjes së parë në pyetje sepse nuk e kishte me vete, pasi ishte në një shtet

¹²⁰⁸ 08.11.2016, f. 33

¹²⁰⁹ 08.11.2016, f. 34

¹²¹⁰ 25.01.2017, f. 5-6

¹²¹¹ 25.01.2017, f. 5-6

¹²¹² 25.01.2017, f. 5-6

tjetër.¹²¹³

1086. Me këtë rast K1 është ballafaquar me deklaratën e tij të mëparshme (të dhënë më 17.03.2016) kur kishte thënë se duhej t'ia tregonte fletoren Camparas atë ditë në gjykatë kur i kishte treguar atij për atë, mirëpo gjersa po ktheheshin nga gjykata me njësinë për mbrojtjen e dëshmitarëve ishin qëlluar nga një snajper. K1 nuk e ka vërejtur kundërthënien në deklaratën e tij (një herë ka thënë se në këtë rast fletorja ka qenë në shtetin e tretë, kurse në rastin e dytë ai ka thënë se e kishte pasur me vete por thjeshtë nuk kishte arritur t'ia tregojë atë).¹²¹⁴

1087. Pasi u ballafaqua me pjesën përkatëse të deklaratës së dhënë nga ai në mars 2016, u lexua përsëri, K1 e ka komentuar atë se nuk e kupton se si ka mundur ta thotë këtë.¹²¹⁵

1088. Përveç kësaj, K1 ka sqaruar se nuk e ka përmednur fletoren gjatë dhënies së deklaratës, por vetëm kur ishte takuar me prokurorin Campara në pyll, Ribljak, Sarajevë ku ishte sjellë në mënyrë të posaçme nga njësia për mbrojtjen e dëshmitarëve nga një shtet tjetër. Ai, nuk e kishte fletoren me vete atëherë. Ata duhej të takoheshim përsëri më vonë për t'ia dorëzuar fletoren, por përfundimisht një takim i tillë nuk kishte ndodhur.¹²¹⁶

¹²¹³ 25.01.2017, f. 34 - 35

¹²¹⁴ 25.01.2017, f. 39

¹²¹⁵ 25.01.2017, f. 40-41

¹²¹⁶ 25.01.2017, f. 35-37

1089. Gjatë marrjes në pyetje, K1 përsëri e ka ndryshuar versionin e tij. Me këtë rast, ai ka pohuar se fletorja me dokumentet tjera po mbahej në kasafortë nga njësia për mbrojtjen e dëshmitarëve.¹²¹⁷ Ai madje ka thënë se fletorja ka qenë gjatë gjithë kohës në këtë njësi në cilindo shtet që ka qëndruar.¹²¹⁸
1090. K1 e ka pranuar se ka dëshmuar disa herë para prokurorëve të EULEX-it, duke filluar nga viti 2013. Ai nuk ishte në gjendje të shpjegonte pse nuk e kishte dorëzuar fletoren tashmë gjatë marrjes së parë në pyetje, por vetëm në vitin 2015. Ai e ka sqaruar këtë vonesë me frikën e mundshme për veten dhe familjen e tij.¹²¹⁹ Pasi e ka njoftuar prokurorin e EULEX-it lidhur me fletoren, prokurori e ka njoftuar Njësinë për Mbrojtjen e Dëshmitarëve (NJMD) dhe ata i kanë kontaktuar homologët e tyre dhe e kanë organizuar dorëzimin. Ata e kanë sjellë, dhe e kanë pyetur K1 a është kjo fletorja dhe ai e ka konfirmuar.¹²²⁰
1091. Gjatë marrjes së më tutjeshme në pyetje K1 ka thënë se së pari e kishte njoftuar hetuesin me emrin “Gr.” në lidhje me fletoren, dhe jo prokurorin siç kishte dëshmuar më parë. Atij nuk i kujtoheshin rrethanat e sakta të kësaj, por e ka pranuar se ka qenë vetëm një bisedë joformale. Ai nuk i kishte treguar “Gr.” se e kishte fletoren, por vetëm e kishte njoftuar se i kishte shkruar sasinë e drogës.¹²²¹ Kur është ballafaquar me procesverbalin e deklaratës së tij të mëparshme, K1 përsëri ka thënë se e kishte njoftuar hetuesin dhe prokurorin më parë, dhe deklarata është dhënë kur është dashur ta sjellë fletoren. Atij i janë dashur disa

¹²¹⁷ 25.01.2017, f. 42

¹²¹⁸ 25.01.2017, f. 43 - 44

¹²¹⁹ 25.01.2017, f. 41 -42

¹²²⁰ 25.01.2017, f. 44

¹²²¹ 26.01.2017, f. 8-9

muaj për ta sjellë fletoren dhe ishte planifikuar që Njësia për Mbrojtjen e Dëshmitarëve (NjMD) do ta takonin atë për ta dorëzuar.¹²²²

1092. K1 ka dëshmuar se u kishte treguar hetuesve të parë në lidhje me fletoren sepse ata kanë insistuar që ai t'ua jap sasinë e drogës që e kishte shkruar. Në këtë moment, fletorja ka qenë në një lokacion të largët.¹²²³ Ai gjithashtu e ka pranuar se ai ka dashur që t'ua lejoj atyre që vetëm ta bëjnë një kopje të fletores për ta përdorë gjatë gjykimit, por ai theksoi se në fund ua kishte dhënë origjinalin.¹²²⁴

1093. K1 ka pohuar se kishte dhënë deklaratë të plotë vetëm para prokurorit të EULEX-it në vitin 2014, por nuk ka dashur t'i zbulojë të gjitha rrethanat derisa mos t'i sqaroj të gjitha me Camparan. Prandaj, në këtë rast ai nuk e ka njoftuar prokurorin e EULEX-it që e kishte fletoren. Më vonë, Campara i kishte thënë atij se K1 do të mund t'i zbulonte të gjitha dhe pas këtij konfirmimi, ai e ka njoftuar prokurorin e EULEX-it se e kishte në posedim këtë fletore dhe se do të mund ta dërgonte atë.

1094. K1 nuk e ka ditur saktësisht, por ka qenë pas 4 ose 5 muaj kur ka ardhur në Kosovë dhe në këtë rast ai ia ka dhënë fletoren njësisë për mbrojtjen e dëshmitarëve. Ai nuk e dinte se kur ata ia kanë dorëzuar atë prokurorit.¹²²⁵ Pak më vonë, ai e ka pranuar se ka qenë ai personalisht që e ka bërë.¹²²⁶ Gjatë marrjes

¹²²² 26.01.2017, f. 10

¹²²³ 26.01.2017, f. 12

¹²²⁴ 26.01.2017, f. 11

¹²²⁵ 25.01.2017, f. 34 - 35

¹²²⁶ 25.01.2017, f. 45-46

së mëtutjeshme në pyetje, ai ka thënë se është dashur ta sjellë fletoren vetëm në vitin 2016, por para pak kohe kanë ardhur zyrtarët nga njësia për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe e kanë marrë atë.¹²²⁷

1095. Në deklaratën e shkurtit 2015, ai ka thënë se gruaja e tij e ka ditur për fletoren. Ai nuk ka përmendur persona të tjerë në këtë kontekst. Ai nuk e di pse nuk ka treguar për këtë më parë. Ai gjithashtu nuk e di pse nuk e ka përmendur Camparan si personin i cili e ka ditur për fletoren. Gruaja e tij kishte mësuar për këtë kur janë pranuar në programin për mbrojtjen e dëshmitarëve.¹²²⁸

1096. Duke marrë parasysh ndryshimet dhe mospërputhjet në versionet e paraqitura nga K1 lidhur me fletoren, gjykata sipas *detyrës zyrtare* ka ndërmarrë hapa shtesë për të vërtetuar deri në një shkallë sa më të saktë që është e mundur, se çfarë po ndodhte me fletoren, posaçërisht lidhur me përfshirjen e zyrtarëve të njësisë për mbrojtjen e dëshmitarëve.

1097. Nga informatat e pranuar nga Njësia për Mbrojtjen e Dëshmitarëve, të paraqitura më 15 shkurt 2017, rezulton se fletorja definitivisht nuk ishte marrë nga dëshmitari K1. Më tutje, rrethanat e dorëzimit të saj janë diskutuar në hollësi në bazë të procesverbalit të bërë nga zyrtarët. Sipas tij:

Pasditën e vonë të enjten më 26 shkurt 2015, prokurori Andrew Hughes (AH) e ka ftuar një zyrtar nga EULEX WS, AH e kishte kaluar ditën me K1. Gjatë rrejdhës së diskutimeve të tyre K1 e kishte njoftuar AH se gruaja e tij e kishte në posedim një fletore e cila kishte detaje për shpërndarje të drogës në mes të viteve 2002 dhe 2008. Prokurori ka bërë një kërkesë për ta mundësuar një telefonatë ndërmjet K1 dhe gruas së tij në mënyrë që të organizohej dërgimi i

¹²²⁷ 26.01.2017, f. 13-14

¹²²⁸ 26.01.2017, f. 13

fletores.

AH e ka njoftuar zyrtarin e NJMD se ky libër i transaksioneve ishte i rëndësishëm në atë që EULEX-i e kishte konfiskuar tashmë një libër të ngjashëm të transaksioneve me shkrim me kode të tilla (që përfaqësonin shitjet e drogës si blerje të shtëpive dhe bizneseve) dhe ajo në posedim të K1 ishte provë e shkëlqyeshme vërtetuese në disa mënyra relevante për rastin kundër N.K. Si e tillë, është jashtëzakonisht e dëshirueshme që prokurorët ta marrin këtë libër.

AH ka shtuar se kur kanë biseduar gjerësisht me K1 ai hezitonte që ata ta marrin pasi që përmbante materiale që kishin të bëjnë me çështje të tjera (të pa elaboruara) dhe se K1 ka thënë se do t'i vinte në rrezik anëtarët e familjes të cilët jetojnë në Gjermani. K1 kishte refuzuar që t'i telefonojë gruas së tij për ta udhëzuar që t'ia jap fletoren homologëve të NJMD në mënyrë që ta organizojnë që t'i sillen atij ndërsa ishte akoma në Kosovë.

K1 dëshironte që vetë ta kopjonte këtë libër dhe t'i redaktojë pjesët që nuk janë relevante. Kjo nuk është e pranueshme ligjërisht pasi që origjinali është prova më e mirë dhe se çfarëdo redaktimi duhet të bëhet brenda procedurave ligjore.

Gjatë pasdites, të premten më 10 prill 2015, një zyrtar nga NJMD e EULEX-it është takuar me K1 dhe zyrtarët nga vendi mbështetës. Zyrtari duhej ta shoqëronte K1 përsëri në Kosovë, në këtë kohë K2 ishte në posedim të fletores së tij, ajo asnjëherë nuk kishte qenë në përkujdesje të shtetit mbështetës.

Më vonë pasditen e së dielës 12 prill 2015, AH së bashku me hetuesin Phil Weston kanë marrë pjesë në ambientet e sigurta të EULEX WSD ku u është dorëzuar fletorja nga K1 i cili e kishte larguar atë nga zarfi i mbyllur dhe i vulosur.¹²²⁹

1098. Prokurori Andrew Hughes ka konfirmuar se përmbajtja e deklaratës është e saktë.¹⁵⁴⁴

1099. Informatat e marra nga Njësia për Mbrojtjen e Dëshmitarëve e kanë bërë të domosdoshme dëgjimin e K1 përsëri për ta ballafaquar me atë. Marrja e fundit në pyetje e këtij dëshmitari është bërë më 23 mars 2017 dhe në parim ka qenë e kufizuar tek fletorja, ku dhe si është mbajtur, në çfarë rrethanash është zbuluar, kur dhe si është dorëzuar.

1100. Gjatë kësaj marrje në pyetje, K1 ka thënë se në momentin e arrestimit në vitin 2003 fletorja është mbajtur në një apartament në Sarajevë, në Trg Heroja 5 i cili ishte marrë me qira nga K.K. dhe A.KA. Çelësat e këtij apartamenti i kishin ata dhe K1.¹²³⁰ Fletorja është mbajtur në kasafortë e cila gjendej nën shtrat në dhomën e fjetjes së bashku me dokumentet tjera, përfshirë pasaporta të falsifikuara.¹²³¹ Ky lokacion nuk është bastisur nga policia pas arrestimit të K1.¹²³² Më vonë, kasaforta me fletoren janë dërguar në një apartament në Ilidza.¹²³³

1101. Fletorja ka qëndruar në këtë apartamentin e fundit deri në momentin kur K1 është larguar nga Sarajeva në vitin 2011.¹²³⁴ Para se të ndodhë, K1 ka shkuar në

¹²²⁹Informata me shkrim nga Njësia për Mbrojtjen e Dëshmitarëve e paraqitur më 15 shkurt 2017 ¹⁵⁴⁴ 23.03.2017, p. 48

¹²³⁰ 23.03.2017, p. 3 - 4

¹²³¹ 23.03.2017, p. 4

¹²³² 23.03.2017, p. 5

¹²³³ 23.03.2017, p. 5-6

këtë apartament dhe ka marrë dokumente të ndryshme nga aty, përfshirë fletoren. Në këtë rast, ai ka shkuar aty me zyrtarët e mbrojtjes së tij.¹²³⁵ Ai i ka mbajtur të gjitha dokumentet me vete në një çantë të lëkurës.¹²³⁶ Sidoqoftë, ai e ka pranuar se para se t'i merrte dokumentet, e kishte marrë kasafortën nga aty të cilin e kishte vendosur në apartamentin e tij. Në këtë periudhë, dokumentet dhe fletorja ende mbaheshin në apartamentin në Ilidza, por në një vend tjetër.¹²³⁷

1102. Më pas, ai e ka marrë fletoren dhe dokumentet tjera me vete.¹²³⁸ Të gjitha këto dokumente ai i mbante në çantë dhe gjithmonë e kishte me vete.¹²³⁹

1103. Një herë ka ndodhur që kur është zhvendosur në vendin e tretë, ai ia ka dhënë të gjitha këto dokumente zyrtarëve të njësisë për mbrojtjen e dëshmitarëve. Kur është pyetur nëse e kishte këtë fletore, K1 është përgjigjur pozitivisht, por nuk ishte i sigurt. Më vonë, zyrtarët ia kanë kthyer fletoren. Ai ka thënë se sigurisht ka ndodhur në vitin 2014.¹²⁴⁰ Kjo ka ndodhë pasi e ka njoftuar prokurorin se e kishte këtë fletore, ata i kanë thënë atij se mund të shkonte atje dhe ta merrte. Sidoqoftë, pak më vonë ka thënë se ata e kanë marrë fletoren, e kanë vendosur në një zarf dhe ia kanë dhënë njërit nga hetuesit e EULEX-it– Chris.¹²⁴¹

¹²³⁴ 23.03.2017, p. 6

¹²³⁵ 23.03.2017, f. 10

¹²³⁶ 23.03.2017, f. 11

¹²³⁷ 23.03.2017, f. 11

¹²³⁸ 23.03.2017, f. 12

¹²³⁹ 23.03.2017, f. 20

¹²⁴⁰ 23.03.2017, f. 20

¹²⁴¹ 23.03.2017, f. 20-21

1104. K1 është pyetur përsëri se kur e ka njoftuar dikë për herë të parë lidhur me ekzistimin e kësaj fletoreje. Ai ka thënë se për këtë i kishte treguar prokurorit të këtij rasti kur ai dhe hetuesit kanë pyetur për sasinë e saktë të drogës e cila ishte shitur. Në këtë rast, ai u ka thënë atyre se të gjitha i kishte të shkruara në fletore.¹²⁴² Edhe një herë ka ndodhur që nuk ka qenë konsekuent me deklaratën e tij sepse kur i është kërkuar që ta konfirmojë se personi i parë të cilin e ka njoftuar lidhur me fletoren ka qenë prokurori i EULEX-it (i quajtur nga dëshmitari “Henry”), K1 është përgjigjur se prokurori Campara ka qenë i njoftuar më parë për këtë kur janë takuar në pyll.¹²⁴³
1105. Gjatë takimit me Camparan, K1 nuk kishte menduar për dorëzimin e fletores. Ai e ka arsyetuar këtë duke thënë se prokurori i EULEX-it në shumë raste e ka pyetur atë në lidhje me sasinë, por ai i ka thënë se nuk ka mundur t’i llogariste dhe se nuk e dinte.¹²⁴⁴
1106. K1 rregullisht takohej me prokurorin dhe hetuesit të cilët gjatë gjithë kohës e pyesnin atë lidhur me sasinë e drogës e cila po vinte. Pastaj ai u ka thënë se nuk ka mundur ta llogarisë por se i mbante të gjitha me shkrim.¹²⁴⁵
1107. K1 është pyetur përsëri pse e ka njoftuar prokurorin e EULEX-it dhe hetuesit vetëm në vitin 2015. Ai ka thënë se ka pasur dyshime për atë që po ndodhte sepse prokurori nga Bosnja ka premtuar se do të vijë në një shtet tjetër por nuk e kishte

¹²⁴² 23.03.2017, f. 21

¹²⁴³ 23.03.2017, f. 21

¹²⁴⁴ 23.03.2017, f. 21

¹²⁴⁵ 23.03.2017, f. 22

bërë këtë. Ai ende kishte dyshime edhe kur është marrë përsipër nga EULEX-i sepse një herë i kishte dëgjuar se ata po flisnin në telefon me djalin e N.K.¹²⁴⁶

1108. Pak para dorëzimit të fletores te EULEX-i, K1 ka biseduar edhe një herë me prokurorin Campara i cili e ka këshilluar atë që të veprojë kështu.¹²⁴⁷

1109. Gjatë kësaj marrje në pyetje K1 është ballafaquar edhe një herë me dëshminë e tij të dhënë para hetuesve të EULEX-it në një rast tjetër më 26 shkurt 2015, kur ai e kishte përmendur fletoren për herë të parë. Në këtë rast, ai ka thënë se ai do t'i lejojë hetuesit që ta bëjnë një kopje të ditarit, por se ai duhet të jetë i pranishëm gjatë kësaj. Kur është pyetur për arsyen, K1 ka thënë se nuk i kujtohet, sidoqoftë, ai ka theksuar se e ka dorëzuar fletoren.¹²⁴⁸ Ai e ka mohuar se kishte frikë se prokurori në fletore mund të gjente informata të rrezikshme për të apo për familjen e tij. Sipas tij, me siguri ka pasur një gabim në përkthim.¹²⁴⁹ Gjatë marrjes së tërthortë në pyetje, sidoqoftë, K1 ka pranuar se dorëzimi i fletores do të mund ta vinte në rrezik familjen e tij, jo vetëm në Gjermani.¹²⁵⁰

1110. Kur është pyetur lidhur me vonesën prej dy muajve për dorëzimin e fletores, K1 për këtë ka fajësuar zyrtarët e njësisë për mbrojtjen e dëshmitarëve të cilët do të duhej ta merrnin fletoren dhe më vonë t'ia dorëzojnë atij.¹²⁵¹ Sipas tij, fletorja është sjellë nga njësia për mbrojtjen e dëshmitarëve nga një shtet tjetër në të njëjtën ditë kur ai është kthyer nga Kosova në shkurt të vitit 2015. Me këtë rast, i

¹²⁴⁶ 23.03.2017, f. 21-22

¹²⁴⁷ 23.03.2017, f. 22-23

¹²⁴⁸ 23.03.2017, f. 23

¹²⁴⁹ 23.03.2017, f. 23

¹²⁵⁰ 23.03.2017, f. 30

¹²⁵¹ 23.03.2017, f. 23 - 24

është dhënë njësisë për mbrojtjen e dëshmitarëve të EULEX-it.¹²⁵²

1111. Kur është ballafaquar me informatën se njësia për mbrojtjen e dëshmitarëve asnjëherë nuk e ka pasur fletoren në posedim. Ai ka thënë se nuk është e vërtetë, dhe ka pohuar se madje edhe gruaja e tij i ka parë kur kanë ardhur dhe e kanë marrë fletoren.¹²⁵³

1112. Ai e ka mohuar se ka dashur ta rishkruaj fletoren dhe e ka mohuar ta ketë bërë këtë për ta mbrojtur familjen e tij në Gjermani. Ai ka pohuar se e kishte dorëzuar atë në versionin origjinal.¹²⁵⁴ Atij nuk i kujtohej se i është kërkuar që të kontaktojë me gruan e tij kur e kishte njoftuar EULEX-in për fletoren për ta organizuar dërgimin e saj në Kosovë.¹²⁵⁵ Ai ka theksuar se nuk e din pse njësia për mbrojtjen e dëshmitarëve e ka krijuar një tregim kundër tij. Ai theksoi se ata kanë qenë në konflikt sepse ai nuk i kishte pranuar kushtet që i ishin ofruar.¹²⁵⁶

1113. K1 ka thënë se i beson plotësisht prokurorit të EULEX-it. Me këtë rast, ai është ballafaquar me informatën e pranuar nga njësia për mbrojtjen e dëshmitarëve (e cituar më lart). Ai ka kërkuar që të lexohet dy herë.¹²⁵⁷ Në fund, ai e ka pranuar se do ta vinte familjen e tij në rrezik nëse do ta dorëzonte fletoren e pa redaktuar.¹²⁵⁸

1114. K1 ka konfirmuar se ka refuzuar ta telefonojë gruan e tij për të organizuar me të dërgimin e fletores.¹²⁵⁹ Më vonë, ai e ka pranuar se fletoren e ka pasur në posedim gruaja e tij, e jo njësia për mbrojtjen e dëshmitarëve siç kishte dëshmuar

¹²⁵² 23.03.2017, f. 24

¹²⁵³ 23.03.2017, f. 25

¹²⁵⁴ 23.03.2017, f. 25, 26

¹²⁵⁵ 23.03.2017, f. 26

¹²⁵⁶ 23.03.2017, f. 27

¹²⁵⁷ 23.03.2017, f. 28-29

¹²⁵⁸ 23.03.2017, f. 30

¹²⁵⁹ 23.03.2017, f. 30 - 31

më parë. Edhe një herë, në fjalinë e ardhshme kur është marrë në pyetje të tërthortë në këtë pikë, ai ka mohuar të ketë thënë se gruaja e tij e ka pasur në posedim fletoren dhe ka fajësuar për përkthim të gabuar. Ai ka pohuar se ajo nuk ka pasur qasje në fletore sepse ajo është mbajtur nga njësia për mbrojtjen e dëshmitarëve.¹²⁶⁰

1115. K1 nuk i kujtohet t'i ketë thënë prokurorit se ka dashur ta redaktojë fletoren para se ta dorëzojë atë, por nuk e ka mohuar. Sidoqoftë, ai e ka pranuar se prokurori asnjëherë nuk e ka gënjyer atë.¹²⁶¹ Fillimisht, ai ka dashur vetëm t'ia tregojë fletoren për ta ndihmuar prokurorin që ta llogarisë se çfarë sasive e drogës ishte shitur.¹²⁶²

1116. K1 i kujtohet se prokurori i kishte thënë që redaktimi i fletores nuk është ligjërisht i pranueshëm.¹²⁶³ Ai nuk ka mundur të shpjegojë se pse e kishte pyetur prokurorin nëse është e mundur të redaktohet fletorja. Ai ka theksuar se është marrë në pyetje gjatë gjithë ditës, nga mëngjesi deri në mbrëmje dhe se “nuk e dinte se ku e kishte kokën”.¹²⁶⁴ Ai në shumë raste takohej me hetuesit, ata po e diskutonin rastin.¹²⁶⁵

1117. Pastaj, ai ka thënë se po brengosej për personat e përmendur në fletore.¹²⁶⁶ Ai gjithashtu kishte frikë nga Z.T., por prokurorisë ia ka dorëzuar dokumentet në

¹²⁶⁰ 23.03.2017, f. 31, 35

¹²⁶¹ 23.03.2017, f. 33

¹²⁶² 23.03.2017, f. 37

¹²⁶³ 23.03.2017, f. 34

¹²⁶⁴ 23.03.2017, f. 35

¹²⁶⁵ 23.03.2017, f. 38 - 39

¹²⁶⁶ 23.03.2017, f. 35

lidhje me atë.¹²⁶⁷

1118. K1 ka konfirmuar gjithçka që është shkruar në informatën e njësisë për mbrojtjen e dëshmitarëve në lidhje me fjalët e prokurorit.¹²⁶⁸

4.7.3. Mënyra se si është mbajtur fletorja

1119. K1 ka dëshmuar se arsyeja pse ka vendosur t’ia tregoj apo jap fletoren prokurorit ka qenë për t’i ndihmuar atij në llogaritjen e sasisë së drogës që është shitur.¹²⁶⁹

Ai ka thënë se po e shënonte në fletore se sa mall ishte dërguar në vendet në Pejë, Kosovë, Vitimiricë, Mitrovicë, Sarajevë dhe madje edhe në Serbi. Ai ka mbajtur shënime të transaksioneve. Ai e bënte këtë sepse personat po raportnin probleme.¹²⁷⁰

1120. K1 ka shpjeguar se së pari e bënte një shënim në një copë letër, dhe pastaj kur kthehej në Sarajevë e shkruante në fletore. Ai shkruante me kode.¹²⁷¹ Gjithashtu nganjëherë ka ndodh që K1 të shënonte në një copë letër dhe pastaj t’ia jep atë p.sh A.Kur., A.Ka.. Ai nuk e din nëse ata i kanë vënë shënimet në fletoren e njëjtë.¹²⁷²

1121. Sipas tij jo e gjithë periudha e punës së tij me N.K. është mbuluar në fletore. Sidoqoftë, duke filluar prej prillit 2002, ka përfshirë të gjitha aktivitetet e lidhura

¹²⁶⁷ 23.03.2017, f. 37-38

¹²⁶⁸ 23.03.2017, f. 40

¹²⁶⁹ 23.03.2017, f. 37

¹²⁷⁰ 07.11.2016, f.17; 10.11.2016, f. 21

¹²⁷¹ 07.11.2016, f.18 – 19, 08.11.2016, f. 6

¹²⁷² 08.11.2016, f.19

me N.K.¹²⁷³ Më vonë, ai e ka kundërshtuar veten sepse ka thënë se në disa pjesë siç është shënuar në fletore, ai po punonte për N.K., kurse në rastet tjera ka përmendur se ka punuar për A.Ka. dhe R.K.¹²⁷⁴

1122. K1 e ka pranuar se shënimet për Z.T. janë mbajtur në të njëjtën mënyrë. Ato shënime kanë treguar sasinë e mallit, destinacionin e tij, sa para do të merrte S.T. etj. Ai i është shmangur përgjigjes në pyetjen se cilat shënime kanë qenë më të detajuara.¹²⁷⁵ Këto shënime janë mbajtur në afërsi të shtëpisë së tij, në apartamentet e marra me qira nga Z.T.¹²⁷⁶

1123. Kur K1 dëshmoi në lidhje me përmbajtjen e fletores, ai i shmangej deklaramit të qartë se e kujt ishte droga. Ai vazhdimisht ka dëshmuar se është paguar nga R.K. dhe udhëzimet i ishin dhënë nga ai dhe A.Ka.¹²⁷⁷ K1 ka thënë se nëse N.K. nuk është përmendur në shënime, do të thotë se ai nuk ka qenë i përfshirë.¹²⁷⁸ K1 i shmangej dhënies së përgjigjeve të qarta se e kujt ishte droga. Ai ishte bishtnues, duke e ndryshuar shpesh versionin e tij.¹²⁷⁹ Kur është marrë në pyetje të tërthortë, K1 ka shpjeguar se ai asnjëherë nuk ka pyetur se e kujt ishte droga. Nuk ishte punë e tij.¹²⁸⁰

¹²⁷³ 08.11.2016, f. 35

¹²⁷⁴ 08.11.2016, f. 31

¹²⁷⁵ 08.11.2016, f. 34

¹²⁷⁶ 08.11.2016, f. 34-35

¹²⁷⁷ 07.11.2016, p. 34-37

¹²⁷⁸ 10.11.2016, p. 34

¹²⁷⁹ 08.11.2016, p. 13, 15

¹²⁸⁰ 11.11.2016, p.4; 24.01.2017, p. 37

1124. K1 ka sqaruar se ai gjithashtu nuk i kishte investuar paratë e tij në drogën e përmendur në fletore.¹²⁸¹ Nganjëherë i shihte paratë të cilat silleshin nga vozitësit. Ai personalisht i jepte paratë në Zvicër, p.sh Florimit nga Peja dhe M.Ra. nga Bujanovci. Ai asnjëherë nuk ka marrë para nga N.K.¹²⁸²
1125. Gjatë marrjes së tërthortë në pyetje, ai e ka pranuar se R.K. dhe A.Ka. i kanë thënë atij që të mbajë shënime. Nëse kishte ndonjë problem, K1 do ta njoftonte R.K.n dhe pastaj ai do t'ia përcillte shefit të tij, por ai nuk e ka përmendur emrin. Ai shkonte vetëm për ta takuar atë.¹²⁸³ K1 gjithashtu e ka pranuar se nuk e dinte se kush dhe sa ka investuar në drogën e përmendur gjatë takimeve të cilat janë shënuar në fletore. Ai ka qenë i pranishëm, por droga nuk ka qenë e tij.¹²⁸⁴

4.7.4. Shënimet specifike në fletore

1126. Dëshmitari K1 ka dëshmuar lidhur me shënimet specifike të cilat janë bërë në fletore. Çdo herë ai e kishte përpara, gjë që e ka ndihmuar që të flasë lidhur me ngjarjet e pretenduara.
1127. *Shënim nga fletorja (e përkthyer):*

Prill 2002 – Peja, R-a-C

(Takimi në Pejë “Rent a Car)

N.K.

Ag.K.

R.K., Aslani

¹²⁸¹ 10.11.2016, p.34 -35

¹²⁸² 10.11.2016, p.34 -35

¹²⁸³ 11.11.2016, p. 5

¹²⁸⁴ 10.11.2016, p.36

“Be.”

S.Ban.

Qazim Osmani

Dhe dy të tjerë

Prill 270 KM

70 c për Angli

200 M 400

100 Gjermani

100 Zvicër

50 Austri

150 Danimarkë (problem)

K1 ka thënë se çdoherë kur fliste në lidhje me R-a-C gjithmonë ka qenë vendi i njëjtë.¹²⁸⁵ Shënimi i referohej heroinës. Gjatë takimit të pranishëm ishin: N.K., Ag.K., R.K., “Be.”, S.Ban. dhe Qazim Osmani dhe dy burra të tjerë nga Austria.¹²⁸⁶ N.K. ka qenë i pranishëm aty për shkak të Qazim Osmanit dhe S.Ban.¹²⁸⁷ Ag.K. ka qenë gjithashtu një bashkëpunëtor, i përfshirë në diçka në lidhje me

¹²⁸⁵ 15.03.2016, f. 17

¹²⁸⁶ 15.03.2016, f. 17

¹²⁸⁷ 15.03.2016, f. 29

drogat, në lidhje familjare me N.K. “Be.” ka qenë përgjegjës për transport, njëjtë sikur S.Ban.¹²⁸⁸¹²⁸⁹ Takimi është mbajtur në zyre në katin e parë.

1604

1128. Gjatë marrjes në pyetje, K1 e ka pranuar se nuk është i sigurt nëse të gjithë personat emrat e të cilëve kanë qenë të shkruar kanë marrë pjesë në këtë takim. Ndoshta ka harruar ndonjë emër.¹²⁹⁰ Në këtë mënyrë, ai më tutje e minoj besueshmërinë e deklaratës së tij dhe saktësinë e shënimit.

1129. Tema e takimit ka qenë si në vijim: malli duhet të shpërndahet në disa ditët në vijim, dhe kanë diskutuar kush ka porositur çfarë sasive. K1 ka thënë se është diskutuar një problem por se nuk e din se për çfarë ishte.¹²⁹¹ Kur është pyetur përsëri, ai ka thënë se problemet shënoheshin, por në fletore të tjera të cilat mbaheshin nga R.K. dhe A.Ka..¹²⁹² Njerëzit ankoheshin për mallin, lidhur me cilësinë, sasinë.¹²⁹³ Ai nuk ka qenë në gjendje të tregojë se çfarë lloji të problemeve kishin.¹²⁹⁴

1130. Para se ti jepej imuniteti i duhur, K1 ka dëshmuar se është përmendur vetëm shpërndarja e drogës dhe një problem në Danimarkë ku droga ishte dërguar nga E.A. Sipas K1, grupi ka vendosur se ai duhej t’ia paguante prapa R.K.t sepse ishte përgjegjësi e tij. Asllani i ka shitur të gjitha për t’ia paguar.¹²⁹⁵

¹²⁸⁸ 15.03.2016, f. 18 - 19

¹²⁸⁹ 16.03.2016, f. 12

¹²⁹⁰ 11.11.2016, f.14

¹²⁹¹ 15.03.2016, f. 19

¹²⁹² 15.03.2016, f. 20

¹²⁹³ 07.11.2016, f. 21

¹²⁹⁴ 07.11.2016, f. 23

¹²⁹⁵ 15.03.2016, f. 21

1131. **Ag.K.** dhe **E.A.** të dëgjuar në cilësi të dëshmitarëve, kanë mohuar pjesëmarrjen në cilindo takim (dëshmia e tyre do të diskutohet më poshtë); K1 ka komentuar se ka qenë e qartë se ata nuk do ta praninin.¹²⁹⁶
1132. Me këtë rast, K1 ka shpjeguar se është takuar me Ag.K.n në disa raste. Sidoqoftë, më vonë gjatë deklaratës së dhënë në shkurt 2016, ai ka thënë se atë e kishte parë vetëm një apo dy herë, në Bosnje dhe Kosovë dhe ai madje ka thënë se po mbante një kapelë sportive. Atij nuk i kujtohej pse kishte thënë kështu. Ai kishte bërë një gabim.¹²⁹⁷ K1 nuk i kujtohej kur ishte takuar me Ag.K.n për herë të parë, mund të ketë qenë në vitin 2008.¹²⁹⁸ Ky pohim sa i përket vitit kur mund të jenë takuar ata është në kundërtënie të plotë me shënimet në fletore, ku është thënë se Ag.K. ka marrë pjesë në takim në vitin 2002.
1133. Gjatë marrjes së tërthortë në pyetje, K1 e ka pranuar se nuk ka qenë i pranishëm kur është blerë malli, nuk e dinte sa është paguar për të dhe kush e kishte bërë. Ka qenë R.K. ai i cili e ka pranuar drogën. Interesante, ai nuk e ka përmendur N.K. në këtë kontekst.¹²⁹⁹
1134. *Në lidhje me shënimin nga fletorja (e përkthyer):*

Maj 2002

Pejë 300 KM

300 M 600

¹²⁹⁶ 11.11.2016, f.16-17

¹²⁹⁷ 26.01.2017, f. 16 -17

¹²⁹⁸ 26.01.2017, f. 20

¹²⁹⁹ 11.11.2016, f.31

150 Spanjë

100 Zvicër

100 Gjermani

100 Francë

100 Austri

50 Serbi

K1 ka dëshmuar se shënimi i referohej përzierjes së 300 kg të heroinës në 600 kg, dhe ishte bërë për N.K., R.K. dhe tërë grupin. Kur është pyetur se si e dinte, ai ka thënë për shkak të pranisë së R.K.s. Ai e ka pranuar se nuk ishte shkruar por ka qenë e ditur se ka qenë R.K. ai i cili ia ka dhënë udhëzimet.¹³⁰⁰ Atij nuk i kujtohej nëse ka pasur ndonjë problem dhe ku po e përziante.¹³⁰¹

1135. Kur ka dëshmuar para imunitetit të duhur, K1 ka thënë se emrat nuk janë shkruar sepse ngarkesa ishte planifikuar tu dërgohet personave përgjegjës për shpërndarje në shtetet specifike.¹³⁰² Në fakt nuk ka qenë takim, vetëm po dërgohej malli.¹⁶¹⁸

1136. Në lidhje me shënimin në vijim nga fletorja (e përkthyer):

Maj 2002,

Sarajevë Stup

400 M 800

¹³⁰⁰ 07.11.2016, f. 27

¹³⁰¹ 07.11.2016, f. 28

¹³⁰² 15.03.2016, f. 23

¹⁶¹⁸ 15.03.2016, f. 24

150 Serbi

200 Holandë

170 Zvicër

130 Itali

100 Gjermani

50 Slloveni

K1 ka thënë se në këtë rast ai ka përzier drogë në Sarajevë në shtëpinë e Kasimit. Stup është përmendur sepse malli ka arritur aty. Atij nuk i kujtohej ndonjë problem me këtë situatë. Kur është pyetur për kë ka përzier, ai ka thënë se i merrte udhëzimet nga R.K.¹³⁰³

1137. Kur ka dëshmuar para imunitetit, K1 ka thënë se arsyeja e bërjes së këtij shënimi ka qenë për t'iu shmangur ankesave.¹³⁰⁴ A.Ka., R.K. dhe K1 kanë qenë të pranishëm. Ai nuk ka mundur ta shpjegojë se pse nuk i ka shkruar emrat.¹³⁰⁵

1138. Në lidhje me shënimin në vijim nga fletorja (e përkthyer):

Maj 2002, Tregu i bagëtime

150 km – C Angli

Pakistan

Të pranishëm ishin:

¹³⁰³ 07.11.2016, f. 28-29

¹³⁰⁴ 15.03.2016, f. 24

¹³⁰⁵ 15.03.2016, f. 27

N.K.

Gasi- “Zu.”

N.Z.

K1 nuk ishte i sigurt nëse personi nga Pakistani ka qenë i pranishëm aty.¹³⁰⁶ Ai nuk e dinte pse M.A.G. ishte i pranishëm në këtë takim. Ai ka dëgjuar se “Zu.” kishte disa borxhe nga biznesi me cigare.¹³⁰⁷ Aty ka pasur persona të tjerë të pranishëm në këtë takim por nuk e din se pse nuk janë përmendur. Takimi ka qenë në lidhje me heroinën. N.K. dhe R.K. kanë qenë pronarë të saj.¹³⁰⁸ M.A.G. ka bashkëpunuar me N.K. në lidhje me cigaret dhe kishte disa probleme në lidhje me atë.¹³⁰⁹

1139. Para se ti jepej imuniteti i duhur, K1 ka dëshmuar se N.K. është paraqitur në këtë takim sepse personi nga Pakistani ishte shumë i rëndësishëm për të. Ai nuk e ka sqaruar pse.¹³¹⁰ Përveç kësaj, ai ka thënë se M.A.G. ishte komshi i tij. Ata kishin marrëdhënie të mira me N.K., i kishin për një kohë të shkurtër.¹³¹¹

1140. Në lidhje me shënimin në vijim nga fletorja (e përkthyer):

Korrik 2002,

Vitomiricë 350 km

350 M 700

100 Danimarkë

¹³⁰⁶ 07.11.2016, f. 30

¹³⁰⁷ 07.11.2016, f. 30 - 31

¹³⁰⁸ 07.11.2016, f. 30-31

¹³⁰⁹ 07.11.2016, f. 31

¹³¹⁰ 15.03.2016, f. 29

¹³¹¹ 15.03.2016, f. 29 - 30

60 Suedi

140 Spanjë

400 Holandë

200 Gjermani

100 Zvicër

K1 ka dëshmuar se shënimi ishte në lidhje me heroinën. N.K. nuk ka qenë i pranishëm aty, vetëm A.Ka. dhe R.K. Ai nuk ka përmendur asnjë problem në lidhje me këtë rast.¹³¹²

1141. Në lidhje me shënimin në vijim nga fletorja (e përkthyer):

Korrik 2002,

Mitrovicë 200 km

Br.P.

Hotel "Beli Dvor"

200 M 400

Hamburg

Frankfurt

Hanau

Enko Kalender

¹³¹² 07.11.2016, f. 31

1142. K1 ka dëshmuar se është treguar vendi i dërgimit të drogës. Br.P. ka qenë i pranishëm aty. Ai e ka marrë mallin nga R.K. dhe të tjerët. Ai ka shënuar vendin se ku duhej të dërgohej droga, ai nuk ka mundur ta shpjegojë se pse e ka bërë këtë në këtë mënyrë. Nuk ka qenë vetëm për Enko Kalender por gjithashtu edhe për një person tjetër por ka harruar ta përmend emrin tjetër.¹³¹³

1143. Gjykata vëren se, para se ti jepej imuniteti i duhur, K1 nuk ka përmendur emrat e personave të tjerë të cilët pretendohet ta kenë pranuar drogën. E tërë sasia i është dërguar Enko Kalender, vëllai i Munirit, i cili pretendohet të ketë qenë shpërndarësi më i madh i drogës në Gjermani.¹³¹⁴

1144. Në lidhje me shënimin në vijim nga fletorja (e përkthyer):

Korrik 2002,

Vitomiricë 300 km

Shpërndarë në 3 hotele

Marrë Ag.K.

K1 ka dëshmuar se e kishte shënuar se malli ishte dërguar në tre hotele, por nuk i kujtohen emrat e tyre. Ag.K. ka qenë përgjegjës për shpërndarjen e tyre tek vozitësit. Roli i tij ka qenë që të garantojë se malli do të arrijë në destinacionin final. Atij nuk i kujtohej ndonjë problem në lidhje me këtë dërgesë. Ai ka bërë një shënim sepse i kishte pranuar këto 300 kilogramë dhe duhet t'i dërgonte ato diku.¹³¹⁵

1145. Në lidhje me shënimin në vijim nga fletorja (e përkthyer):

¹³¹³ 07.11.2016, f. 32

¹³¹⁴ 15.03.2016, f.31

¹³¹⁵ 07.11.2016, f. 34 - 35

Gusht 2002

Pejë

R.K. 250 km

Drguar në Serbi

R.K. 150 km për Rozhajë

Dërguar nga shtëpia e tij

K1 nuk ka mundur ta shpjegojë se pse është bërë shënimi. Sa i kujtohej, 150 kg heroinë është dërguar tek L.B.C. Roli i K1 ka qenë të jetë i pranishëm kur të arrijë malli dhe ta përziejë sipas udhëzimeve. A.Ka., R.K. dhe të tjerët kanë qenë të pranishëm. Atij nuk i kujtohet se kujt i është dërguar droga.¹³¹⁶ Ai ka dhënë detaje të sakta se ku janë takuar me R.K.n i cili e ka sjellë mallin (vazhdimi i rrugës, ai ka ardhur me veturën caddy, e ka futur drogën në dy çanta sportive), sidoqoftë atij nuk i kujtohet kush ka qenë blerësi.¹³¹⁷

1146. Në lidhje me shënimin në vijim nga fletorja (e përkthyer):

Shtator 2002

Korridori 350 km ka arritur

Tuzla 50 km

Çeki – 120

Kroaci 50

¹³¹⁶ 07.11.2016, f. 35-36

¹³¹⁷ 07.11.2016, f. 36

Slloveni 70

Itali 110

50 km kontestuese (B.H.) K2 i ka marrë

K1 e ka paraqitur situatën me 50 kg të cilat kanë qenë të kontestueshme me K2. K2 ka thënë se H.Kr. e ka vjedhur atë menjëherë pasi e ka pranuar mallin dhe ka shkuar në shtëpi me to. K2 në të njëjtën natë e ka thirre K1 për t'i treguar lidhur me këtë.¹³¹⁸ Ai e ka pranuar se mund të ketë bërë gabim në llogaritje (400 në vend të 350).¹³¹⁹

1147. Ai nuk e ka ditur se kush ka qenë pronar i drogës, sidoqoftë ai i ka marrë udhëzimet nga Rexhep R.K. dhe A.Ka..¹³²⁰

1148. Në lidhje me shënimin në vijim nga fletorja (e përkthyer):

Nëntor 2002

Sarajevë, Hrasno

70 km

Nga Turqia përmes Mu.D. Bejlava

(veturë që vepron si kamion)

Su.Ku. Huskic

K.Ku. K.Ku.

Për Irland – Dublin

¹³¹⁸ 07.11.2016, f. 36 - 37

¹³¹⁹ 07.11.2016, f. 38

¹³²⁰ 07.11.2016, f. 37

K1 ka dëshmuar se Mu.D. ka qenë i përfshirë në trafikimin e drogës. Ai po transportonte pjesë rezervë për vetura nga Turqia. K1 është ftuar pastaj nga K.Ku. për të shkuar në Hrasno. Kur ai ka ardhur aty, K.Ku. i ka thënë të shkojë tek shtëpia e Mu.D.¹³²¹ Su.Ku. dhe K.Ku. i kanë thënë K1 mos të shkojë në Hrasno, por të shkojë në Bejlava. K1 ka shkuar atje me ta pasi që ata donin që ai ta bëjë përzierjen. Pastaj, Su.Ku. dhe K.Ku. kanë biseduar me dikë, kanë negociuar dhe e kanë rritë çmimin e drogës. Ata nuk ishin kompetent që ta bëjnë vetë, prandaj më parë e kanë thirrë dikë për të marrë leje.¹³²² Mu.D. ka pranuar udhëzime nga R.K. dhe paguhej nga ai.¹³²³

1149. K1 nuk ka mundur ta shpjegojë se pse ka pasur zbrazëtirë në shënime prej nëntorit 2002 deri në mars 2003.¹³²⁴ Ai ka dëshmuar ndryshe para imunitetit, sepse ai ka thënë se atëherë në muajt që mungojnë prej dhjetorit 2002 – shkurt 2003 shënimet janë bërë nga K.Ku. dhe A.KA.¹³²⁵

1150. Në lidhje me shënimin në vijim nga fletorja (e përkthyer):

Mars 2003

Nga Holanda Amsterdam në Sarajevë (garazhi në Hrasnica)

200.000 copë (bulldog, Ferrari)

A.Ka. Su.Ku. K.Ku.

¹³²¹ 07.11.2016, f. 38

¹³²² 07.11.2016, f. 39-40

¹³²³ 07.11.2016, f. 40

¹³²⁴ 07.11.2016, f. 41

¹³²⁵ 16.03.2016, f. 25

K1 ka shpjeguar se i referohet ekstazisë të sjellë nga Holanda në garazhet në Hrasnica. A.Ka., Su.Ku. dhe K.Ku. atëherë po punonin për K2 i cili kishte bërë një marrëveshje në Turqi.¹³²⁶ Me këtë rast, K1 ka udhëtuar për në Amsterdam

dhe ka qenë në ditën kur ëshët vrarë Kryeministri i Serbisë Z.D..¹³²⁷

1151. Ai nuk ka mundur të shpjegojë se sa tableta kanë ardhur.¹³²⁸ Ai ka shkruar

“bulldog, Ferrari” sepse A.Ka.dhe R.K. i kanë thënë se duhet të shikojë se si t’i shënjojë drogat. Emrat janë përmendur sepse deri në momentin kur ka shkuar në Hrasnica A.Ka., Su.Ku. dhe K.Ku. kanë qenë përgjegjës për këtë dërgesë.¹³²⁹

1152. Në lidhje me shënimin në vijim nga fletorja (e përkthyer):

Prill 200.000 copë

Pastaj 300.000 copë

500.000 copë

Holandë, Amsterdam

Sa.K.

Sarajevë Hrasnica (garazhi)

E njëjta kompani

K1 nuk ka mundur të shpjegojë sa tableta kanë ardhur, ai edhe vetë ishte në konfuzion lidhur me sasinë. Vlerësimi i tij në bazë të shënimit të cilin vetë e kishte bërë ndryshonte prej 500.000 deri në 1.200.000.¹³³⁰

¹³²⁶ 07.11.2016, f. 42

¹³²⁷ 07.11.2016, f. 42

¹³²⁸ 07.11.2016, f. 43

¹³²⁹ 07.11.2016, f. 42

¹³³⁰ 07.11.2016, f. 43-44

1153. Ai ka sqaruar se e kishte shkruar emrin e Sa.K. sepse ai ka qenë përgjegjës për transport dhe dërgesa. Kuc atëherë jetonte në Amsterdam. K1 me të arritur është dashur të tregoj se është dërguar nga A.Ka. dhe R.K. Ai gjithashtu ka shtuar se:

*Kush e di kujt tjetër i shiste ai!*¹³³¹

1154. Në lidhje me shënimin në vijim nga fletorja (e përkthyer)
Takimet në Hrasnica te garazhet

Të pranishëm ishin:

“Ok.”

N.K.

Mekaniku

A.Ka.

K.Ku.

Su.Ku.

H.Kr.

Në Turqi janë dërguar: 100.000 copë

(voztësi S.A.)

K2 ka marrë 50.000 copë për Turqi

Hakija 40.000 copë

Pjesa e mbetur te N.K. dhe A.Ka.

¹³³¹ 07.11.2016, f. 44; 08.11.2016, f. 4 - 5

Probleme në mes N.K. dhe K2

K2 nuk ka paguar

Ka vendosur se do ta linte peng apartamentin në Tuzëll

1155. K1 ka thënë se N.K. sigurt nuk ka qenë aty, ai ka dashur të thotë momentin kur po përgatitej dhe po bëhej gati droga për t'u dërguar në Turqi. Në këtë shënim ai e ka pasur fjalën për një takim tjetër afër garazheve¹³³² kur po diskutoheshin

gjërat tjera. Ai e ka shkruar në fletore sepse S.A. dhe H.Me. do të vinin për të diskutuar në mënyrë që ta sqarojnë se kush ka porositur 10 kg heroinë nga Turqia. Ka qenë në lidhje me këtë, kush e ka porositur S.A. që t'i ngarkojë 10 kg heroinë (ajo e përzierë me kafe), nëse ka qenë N.K. apo K2. H.Me. dhe Akelic nuk kanë ardhur. Takimi ka zgjatur disa minuta. K1 është ftuar përsëri që ta sqarojë situatën sepse K2 po thoshte se ka qenë N.K. ai i cili ia kishte kurdisur me heroinë.¹³³³

1156. K1 nuk ka mundur ta shpjegojë se cila ka qenë arsyeja e këtij takimi afër garazheve. Ai ka thënë se nuk i kujtohet, por ka shtuar se ka pasur shumë arsye

të ndryshme për këtë.¹³³⁴

1157. K1 ka dëshmuar ndryshe para dhënies së imunitetit. Atëherë ai ka thënë se i ka shkruar këta emra sepse ata e kanë numëruar ekstazinë në rast se mungon diçka. Ai ka shtuar se aty kanë qenë 4 garazhe, 1 për ekstazi dhe

¹³³²07.11.2016, f. 45; 08.11.2016, f. 4 - 5

¹³³³ 08.11.2016 f. 3 - 4

¹³³⁴ 07.11.2016, f. 46

dy për vetura, shumë persona i kanë pasur çelësat për këto garazhe dhe për këtë arsye janë shkruar emrat në rast se mungon ndonjë gjë.¹³³⁵ 100.000 copë kanë shkuar për Turqi, S.A. ka qenë vozitës i Mercedesit, K2 ka marrë 50.000 për në Tuzëll, Hakia ka marrë 40.000; pjesa e mbetur e cila është dashur të shkojë në Turqi ka mbetur me N.K. dhe A.Ka..¹³³⁶

1158. Sipas këtij versioni të dëshmisë, N.K. ka qenë i pranishëm për shkak se R.K. nuk ka qenë aty.¹³³⁷

1159. Në lidhje me shënimin në vijim nga fletorja (e përkthyer):
Qershor 2003

Vitomiricë

90 km me Ragipin, N.K., "Dk.", "Be.", Ag.K.

Dërguar në Austri

Kompania "rent a car" Vienë

Transportimi S.B.

Gjatë takimit, heroinë e pastër është marrë dhe është dërguar si e tillë në Austri. K2 e ka shkruar këtë shënim sepse fillimisht ka ekzistuar mundësia që do ta përzinte heroinën, por në vend të kësaj është vendosur që të dërgohet e papërzier.¹³³⁸

¹³³⁵ 16.03.2016, f. 29

¹³³⁶ 16.03.2016, f. 29 - 30

¹³³⁷ 16.03.2016, f. 29

1160. Në lidhje me shënimin në vijim nga fletorja (e përkthyer):

Pejë, Kosovë, 2003

Në shtëpinë e "Dk." të pranishëm ishin:

Ag.K.

Ragip

"Dk."

110 km

Dërguar në Gjermani Hamburg për Qazimin

K1 ka dëshmuar se është vërejtur se N.K. ka qenë i pranishëm dhe 110 kg heroinë kanë qenë të përfshira. K1 më tutje ka thënë se nuk e dinte saktësisht nëse N.K. ka qenë i përfshirë në këtë, por siç e ka shkruar, me siguri ka qenë. Ai nuk është përgjigjur në pyetjen se kush ka qenë shefi në këtë rast, nuk ka qenë detyrë e tij të pyes për këtë. Edhe një herë ka theksuar se është ftuar dhe ka marrë udhëzime nga R.K.¹³³⁹

1161. Në lidhje me shënimet në vijim nga fletorja:

2003, Sarajevë, Stup

230 km

Në kamion (Muhovic, fruta, perime nga Turqia)

Të pranishëm:

¹³³⁸ 08.11.2016, f. 13

¹³³⁹ 08.11.2016, f. 13 - 14

Naser

A.Ka.

Su.Ku.

K.Ku.

“Zu.”

Dërguar në Angli, Spanjë, Gjermani

K1 ka shpjeguar se në këtë shënim ka shkruar se si ka ardhur malli, kush ka qenë përgjegjës për transport dhe kush ka qenë i pranishëm. Ky mall nuk ka qenë i përzier dhe është dërguar si i tillë. N.K. ka qenë i pranishëm aty. Ai nuk ka mundur të shpjegojë pse nuk ka treguar sasitë specifike të dërguara në shtete të ndryshme.¹³⁴⁰

1162. Në lidhje me shënimet në vijim nga fletorja (e përkthyer):

Nëntor 2006

Takimi në Casa Grande në lidhje me problemin i cili ka ndodhur më parë

(cilësia) Të

pranishëm:

N.K.

Ag.K.

R.K.

Aslani

¹³⁴⁰ 08.11.2016, f. 15-16

“Be.”

S.B.

Qazim Osmani

Dhe dy të tjerë, njerëz të N.K.

1163. K1 ka shpjeguar se asnjë shënim nuk është bërë ndërmjet vitit 2003 dhe nëntorit 2006 sepse atëherë ai ka qenë në burg në Sarajevë.¹³⁴¹
1164. Sipas tij, të gjithë personat e përmendur në shënim kanë qenë të pranishëm aty. Atij nuk i kujtoheshin emrat e këtyre dy njerëzve të N.K. Ai nuk ishte i sigurt nëse kanë qenë burrat e njëjtë si në shënimin e bërë në prill 2002 në takimin në Pejë.¹³⁴²
1165. Ai nuk ka mundur të tregojë në mënyrë specifike se cilat probleme janë diskutuar në këtë rast. Ai vetëm ka thënë se ka pasur ankesa nga gjithandej, por se ai nuk e dinte saktë nga kush dhe si.¹³⁴³
1166. Takimi është mbajtur në hotel Casa Grande në Sarajevë në pronësi të N.K në zyrën e konferencave.¹³⁴⁴
1167. Në lidhje me shënimet në vijim nga fletorja (e përkthyer):

2007

Serbi Vrsac

Fabrika e tekstilit

¹³⁴¹ 08.11.2016, f. 16

¹³⁴² 08.11.2016, f. 17

¹³⁴³ 08.11.2016, f. 17, 18

¹³⁴⁴ 08.11.2016, f. 17

350 km pranuar

Të pranishëm: N.K.

Predrag Pejovic

L.B.C.

Inspector S.

K1 ka dëshmuar e malli ka ardhur në një fabrikë të vjetër. Në mes të tjerëve, L.B.C. ka qenë i pranishëm. K1 e ka parë në disa raste në Sarajevë dhe Serbi. Ai vinte shpesh në Casa Grande, K1 e ka takuar atë disa herë, nuk i kujtohet sa herë. L.B.C. ka qëndruar aty për shumë ditë me gruan e tij. Ai ka pasur marrëdhënie të mira me N.K.¹³⁴⁵

1168. K1 nuk e ka ditur se kush saktësisht e ka organizuar takimin në këtë vend. Ai vetëm është udhëzuar të shkojë atje. L.B.C. e ka marrë atë në Beograd me veturë Audi A8 të blinduar. Vetura tjetër i ka përcjellë, K1 nuk i ka njohur personat brenda saj.¹³⁴⁶ Më vonë e ka kuptuar arsyen pse L.B.C. po vinte këtu, ka qenë diçka për vrasjen e R.D.¹³⁴⁷

1169. N.K. ka qenë i pranishëm aty. L.B.C. e ka sjellë një burrë tjetër për ta ndihmuar K1 me përzierje. K1 beson se N.K. ka pasur pjesën e tij të drogës së dërguar

¹³⁴⁵ 08.11.2016, f. 19-21

¹³⁴⁶ 08.11.2016, f. 22

¹³⁴⁷ 08.11.2016, f. 21

atje.¹³⁴⁸ L.B.C. dhe njerëzit e tij i jepnin udhëzime K1 se si ta përzierte.¹³⁴⁹

Predrag Pejovic e ka blerë drogën.¹³⁵⁰

1170. Me këtë rast ai ka shpjeguar se shpesh ishte takuar me L.B.C. në Casa Grande, ai vinte aty shpesh, sepse ata punonin aty. ¹³⁵¹K1 ka përzier drogë në shumë raste për atë në Vrsac dhe në lagjen Krneca në Beograd. Ai ka punuar për të që nga

viti 2002, të paktën deri në vitin 2007.¹³⁵²

1171. Në lidhje me shënimet në vijim nga fletorja (e përkthyer):

2007

Serbi

Krnjaca afër Beogradit

140 km pranuar

L.B.C.

K.Dr.

N.K.

K1 ka thënë se me këtë rast ka ardhur 140 kg heroinë e cila i takonte L.B.C. N.K. ka qenë aty sepse K1 mendon se ai e ka pasur pjesën e tij në këtë. K1 ka përzierë drogë në apartament. L.B.C. ka paguar për përzierjen aty.¹³⁵³

¹³⁴⁸ 08.11.2016, f. 23

¹³⁴⁹ 08.11.2016, f. 24

¹³⁵⁰ 08.11.2016, f. 17

¹³⁵¹ 08.11.2016, f. 21

¹³⁵² 08.11.2016, f. 21

1172. Në lidhje me shënimet në vijim nga fletorja (e përkthyer):

2007

Zenicë

N.Z.

80 km

Për N.K.

Zvicër

K1 ka dëshmuar se 80 kg heroinë ka ardhur për N.K. nga Zenica. K1 është informuar lidhur me këtë dërgesë nga A.Ka. dhe R.K. N.K. nga Zenica i ka thënë atij që duhet të jetë i kujdesshëm me përzierjen sepse malli po dërgohej në Zvicër për N.K.¹³⁵⁴

1173. Në lidhje me shënimet në vijim nga fletorja (e përkthyer):

2007

Bihac

Ve.H.

110 KM

Për N.K.

Spanjë

¹³⁵³08.11.2016, f. 25

¹³⁵⁴08.11.2016, f. 27

K1 ka dëshmuar se malli ishte dërguar në Bihac, për Ve.H. nga Rozhaja. Ai ka qenë i pushtetshëm dhe merrte mall nga të gjitha vendet, ai blinte nga R.K., D., nga N.K. nga Turqia. Ai shiste në Spanjë, Gjermani.¹³⁵⁵ Ve.H. i ka thënë K1 se po e bënte për N.K.¹³⁵⁶

1174. Në lidhje me shënimet në vijim nga fletorja (e përkthyer):

2008

Bosnje dhe Hercegovinë

Ilidza

Mala Aleja M.Li.

Fr N.K. 120 KM

Për Gjermani

Republikën Çeke

K1 ka dëshmuar se malli ka ardhur në Mala Ilidza për M.Li. Ai punonte me N.K., me heroinë, marihuanë, cigare. K1 e dinte këtë sepse shpeshherë mbledheshin në shitoren e tij. Kur është pyetur nga K1, Licina ka thënë se ai ka punuar për N.K.¹³⁵⁷

1175. Në lidhje me shënimet në vijim nga fletorja (e përkthyer):

2008 Sarajevë

Miku i N.K.

¹³⁵⁵ 08.11.2016, f. 28

¹³⁵⁶ 08.11.2016, f. 29

¹³⁵⁷ 08.11.2016, f. 29

“Bs.”

M.Li.

Mu.D.

100 km

M.Li., miku i N.K. i quajtur “Zu.” dhe Mu.D., “Bs.” – djali i N.K. kanë qenë të pranishëm. “Bs.” e ka dërguar K1 në këtë lokacion. Ai nuk ka qenë prezent gjatë pjesës së mëtutjeshme të takimit. Ai është përmendur në shënim për shkak se K1 nuk ka mundur ta gjejë lokacionin.¹³⁵⁸

4.7.5. Përfundimet në fletore

1176. Edhe pse gjykata e gjen fletoren provë të pranueshme, është vlerësuar si jo e besueshme dhe nuk mund të përbëjë bazë për gjetjet faktike në këtë rast. Një vlerësim i tillë rezulton nga rrethanat në vijim:

- Ka pasur dyshime të pashpjegueshme lidhur me autenticitetin e fletores. Pavarësisht se ishte dëshmitar i mbrojtur/bashkëpunues që nga viti 2010, duke pasur kontakte intensive me hetuesit, dëshmitari K1 e ka njoftuar prokurorin për ekzistencën e fletores vetëm në vitin 2015;
- Ekzistojnë gjasa reale që fletorja është fabrikuar nga dëshmitari K1 kur ka mësuar se dëshmia e tij duhet të vërtetohet. Së pari, ai e ka pranuar se ka dashur ta redaktojë apo rishkruajë atë për shkak të rrezikut për familjen e tij në Gjermani; ky dyshim mbështetet edhe nga fakti se ka pasur dy palë shënime të cilat gjoja janë marrë në një periudhë të konsiderueshme kohore

¹³⁵⁸ 08.11.2016, f. 30-31

ku emrat dhe radhitja e tyre janë saktësisht të njëjta (prill 2002, nëntor 2006), gjë që jep përshtypjen se ato janë shkruar në të njëjtën kohë;

- Përfundimet e raportit të ekspertëve të përpiluar nga V.N.A. dhe Łuczak nuk japin bazë për të vërtetuar se shënimet në fletore janë bërë në të njëjtën kohë me datat e përmendura aty; të dy ekspertët ishin të qartë se nuk ka metoda shkencore që do të mundësonin përcaktimin e vjetërsisë së bojës. Ata në mënyrë efektive kanë kundërshtuar gjetjet e ekspertit E.H.S.;
- Nuk ka logjikë dhe model të ndjekur në shënimet e marra; K1 shpeshherë nuk ishte në gjendje të shpjegonte se pse e kishte bërë një shënim specifik aty;
- Ka prova të tjera të cilat e kundërshtojnë përmbajtjen e një shënimi specifik që do të trajtohen më tutje më poshtë.

4.8. Komunikimi me N.K.

1177. Kur është pyetur në mënyrë specifike në lidhje me kontaktet e tij me N.K., K1 ka qenë i qartë se ato kanë qenë të kufizuara. Sidoqoftë, ai shpeshherë ka qenë në kundërthënie me vetveten, posaçërisht kur ka shpjeguar domethënien e shënimeve në fletore. Në atë rast, ai ka treguar se është takuar me N.K. disa herë.

Ky fakt edhe më tutje e minon besueshmërinë e dëshmitarit.

1178. Kur K1 ka dëshmuar në lidhje me temën e komunikimit me N.K. para se të udhëzohej lidhur me imunitetin, ai ka thënë se ka qenë në kontakt me R.K. dhe A.Ka. në baza ditore. Ai ka theksuar se nuk kanë kontaktuar me N.K. sepse R.K. ka qenë përgjegjës, ai ka vendosur se çfarë të bëjmë. Ka qenë gjatë periudhës

kohore kur ai ka jetuar në Zvicër, Austri dhe Gjermani. Ata e dinin që N.K. ka qenë bos.¹³⁵⁹

1179. K1 nuk e dinte nëse kishte komunikuar ndonjëherë me N.K. në lidhje me drogën e cila kishte arritur në lokacione të caktuara. Atij nuk i kujtohej të kishte komunikuar drejtpërdrejtë me të.¹³⁶⁰ K1 nuk i kujtohej sa herë ka komunikuar drejtpërdrejtë me N.K. Atij i kujtohej se një herë e kishte takuar atë në Hrasnica, dhe një herë në Tuzëll.

1180. Takimi në Hrasnica ka ndodhur më 2003 dhe lidhje me dërgimin e tabletave ekstazi.¹³⁶¹ Atij nuk i kujtohen rrethanat e takimit në Tuzëll, aty ka pasur shumë njerëz. Ka qenë në rastin kur është nënshkruar kontrata për apartamentin.¹³⁶² Gjatë marrjes së pyetje në lidhje me apartamentin pas imunitetit, K1 ka thënë se N.K. nuk kishte asgjë të bënte me apartamentin dhe nuk ka qenë në dijeni që K1 kishte nënshkruar kontratë për atë. (*Shtjelluar në detaje në pjesën tjetër të aktgjykimit*).

1181. K1 fillimisht ka pohuar se ka qenë menaxher për N.K. Të gjitha marrëveshjet që ai i ka bërë ndonjëherë, ai i ka bërë ato në prani të N.K dhe R.K.t. Pak më vonë, ai e ka pranuar se detyrat e tij kanë qenë të kufizuara në përzierjen e drogës. Kur

¹³⁵⁹ 25.02.2016, f. 24

¹³⁶⁰ 23.02.2016, f. 34

¹³⁶¹ 23.02.2016, f. 34-35

¹³⁶² 23.02.2016, f. 35

është pyetur për shpjegime të mëtutjeshme, ai nuk e ka kuptuar fjalën “menaxher” të cilën e kishte përdorë.¹³⁶³ Ai ka shpesh ka pasur takime me R.K.n dhe A.Ka. të cilët paraprakisht kanë qenë të informuar në lidhje me arritjen e kamionit me drogë.¹³⁶⁴ Kur ka qenë në Gjermani, Zvicër dhe Austri, ai ka komunikuar me A.Ka. përmes telefonit për çdo ditë. Ai gjithashtu ka pasur kontakte të shpeshta me R.K.n, madje dy deri tri herë në ditë. Gjatë kësaj kohe ata nuk e kanë kontaktuar N.K., sepse R.K. ka qenë përgjegjës dhe ai vendoste. Nga Gjermania ai e ka thirrë R.K.n, A.Ka., Sulo dhe K.Ku..¹³⁶⁵

1182. K1 e ka mohuar ta ketë thirrë ndonjëherë N.K. Ai ka theksuar se N.K. ka qenë shumë lart në hierarki për ta thirrë atë.¹³⁶⁶

1183. Komunikimi me telefon me N.K. është prezantuar ndryshe nga K2 i cili ka pohuar se e ka thirrë N.K. dhe ky i fundit e thërriste atë. Sidoqoftë, N.K. shpesh e ndërronte numrin e telefonit. Sipas tij, ka qenë e vështirë të kontaktohej me N.K. Kushdo që donte ta thërriste atë, së pari duhej të kontaktonte me K1, A.Ka. ose Sa.Ku.¹³⁶⁷

4.9. Lokacionet

Vërejtje të përgjithshme

1184. Një pjesë e rëndësishme e dëshmisë së K1 i referohet lokacioneve të ndryshme në Kosovë, ku ai gjoja ka marrë pjesë në aktivitetet që lidhen me trafikimin e drogës për ose me N.K. dhe grupin e tij. K1 ua ka treguar ata hetuesve të EULEX-it, sidoqoftë, sipas tij ka pasur shumë të tjerë të cilët ai nuk i ka treguar

¹³⁶³ 23.02.2016, f. 34

¹³⁶⁴ 24.02.2016, f. 25

¹³⁶⁵ 25.02.2016, f. 23-24

¹³⁶⁶ 25.02.2016, f. 27

¹³⁶⁷ 09.03.2017, f. 21

sepse i kishin thënë se nuk është e nevojshme. Më vonë ai ka theksuar se i kishin thënë se nuk ishte e sigurt. Njëra nga arsyet pse nuk ishte e sigurt kishte të bënte me përkthyesin i cili nuk dëshironte “të tregonte fytyrën e tij”.¹³⁶⁸

1185. Kur K1 është marrë në pyetje pas udhëzimit të duhur mbi imunitetin dhe kur është ballafaquar përsëri me fotografitë e lokacioneve të ndryshme në Kosovë, të paraqitura nga prokurori, ai shpesh dukej i hutuar dhe nuk ishte në gjendje t’i njihje vendet. Kishte një ndryshim të konsiderueshëm në mënyrën se si ka dëshmuar në lidhje me këto lokacione në krahasim me dëshminë e tij paraprake. Kur është dëgjuar për herë të parë, ai ka folur për këto lokacione me siguri dhe vendosmëri, zakonisht nuk kishte dyshime se për cilin lokacion po fliste. Pas çështjes së imunitetit, K1 dukej i humbur kur ka dëshmuar për këtë temë. Ai ka thënë se fotografitë ishin bërë gjatë vozitjes dhe nga kënde të ndryshme.¹³⁶⁹ Ai e ka shpjeguar konfuzionin e tij edhe me faktin se ishte i lodhur, nuk ndihej mirë, nuk mund të shihte me syrin e majtë, truri nuk i funksiononte mirë.¹³⁷⁰

1186. Vetëm atëherë prokurori e ka pranuar se fotografitë e lokacioneve që janë përdorë gjatë shqyrtimit gjyqësor për marrjen në pyetje të dëshmitarëve nuk ishin bërë në prani të K1.¹³⁷¹

¹³⁶⁸ 25.01.2017, f. 16-17

¹³⁶⁹ 25.01.2017, f. 18-31

¹³⁷⁰ 25.01.2017, f. 32-33

¹³⁷¹ 25.01.2017, f. 50

1187. Gjatë seancës së shqyrtimit gjyqësor të mbajtur më 23 shkurt 2016, mbrojtja ka paraqitur një kundërshtim kundër disa fotografive të lokacionit Kingpin 19 të cilat ishin bërë brenda ndërtesës në bazë të shkeljes së të drejtës për privatësi të pronarit të atij lokali.
1188. Pas analizës së përmbajtjes së fotografive, gjykata vendosi t'i përjashtojë nga provat fotografitë të cilat janë bërë brenda pronës private pasi që ato janë bërë pa pëlqimin e pronarit të pronës dhe pa një urdhër të duhur për bastisje që është në shkelje të së drejtës kushtetuese të privatësisë dhe mbrojtjes së pronës private. Në lidhje me lokacionin 19, fotografitë në vijim me numër: 124, 125, 126, 127, 128, 129, 130, 131, 132 dhe 133 janë shpallur të papranueshme.¹³⁷²

4.9.1.Lokacionet specifike

4.9.1.1. Lokacionet në Bosnje

1189. Sipas K1, nga viti 1989 heroinë është dërguar në Sarajevë në lokacione të ndryshme: Hrasnica, Stup afër aeroportit, tregut të bagëtive dhe shumë lokacione.¹³⁷³
1190. Droga vinte në Stup një ose dy herë në muaj, por varej. Ajo sillej me kamionë të gjatë dhe me kamionë me ftohje Volvo.¹³⁷⁴ Dërgesat bëheshin gjatë natës.¹³⁷⁵ Ky lokacion ishte i përshtatshëm sepse kamionët e gjatë mund të vinin aty me lehtësi.¹³⁷⁶

¹³⁷² 23.02.2016, f. 24

¹³⁷³ 01.11.16, f. 20; 02.11.2016, f. 4

¹³⁷⁴ 02.11.2016, f. 4, 6

¹³⁷⁵ 02.11.2016, f. 7

¹³⁷⁶ 02.11.2016, f. 6

1191. Ishin të pakët vozitësit që vinin në Stup: “Mj.” i cili tregtonte fruta dhe perime, R.Ma. dhe M.Dja.¹³⁷⁷
1192. Droga e cila vinte në Sarajevë shkarkohej dhe dërgohej në shtëpinë e K.Ku.¹³⁷⁸
Shtëpia e tij gjendej në Carsia, ku përzihej dhe nga aty dërgohej tutje.¹³⁷⁹
1193. Në shumë raste janë përdorë tri garazhe në Hrasnica, ato ishin karakteristike sepse në dyer kishin gjurmë të të shtënave (vrime). K1 i ka njohur ato në fotografitë e treguara, sidoqoftë cilësia e tyre nuk ka qenë më e mira. Pronari i njërit nga këto garazhe ka qenë A.Ka., kurse të tjerat ishin të kushëririt të tij “Sm.”¹³⁸⁰
1194. K1 ka dëshmuar se gjatë luftës në Bosnje sigurisht droga nuk vinte në këto vende. Ai ka shtuar se gjatë kësaj periudhe ajo vinte në Serbi, Kroaci dhe shtete tjera, por nuk e ka përmendur Kosovën. Ai e ka bërë këtë vetëm kur është udhëzuar me pyetjen e prokurorit.¹³⁸¹
1195. K1 ka thënë se droga gjithashtu vinte edhe në tregun Arizona në Tuzëll të cilin ai e përshkruan si tregun më të madh në afërsi të Tuzllës, ku shumë mallra dhe tekstil vinte nga Turqia. Ky ka qenë vendi ku droga vinte vazhdimisht, K1 nuk e dinte që nga kur. Droga vinte aty për të gjithë.¹³⁸²

¹³⁷⁷ 02.11.2016, f. 7-8

¹³⁷⁸ 02.11.2016, f. 4

¹³⁷⁹ 02.11.2016, f. 5

¹³⁸⁰ 02.11.2016, f. 25 - 26

¹³⁸¹ 01.11.2016, f. 31 - 32

¹³⁸² 01.11.2016, f. 29 - 30

Përfundim

1196. Gjykata e gjeti të vërtetuar se droga sillej në vendet e përmendura në Sarajevë dhe Tuzëll. K1 ishte konsekuent në dëshminë e tij në lidhje me këto vende të dërgimit. Ato gjithashtu janë përmendur nga dëshmitarë të tjerë në këtë lëndë. Për më tepër, gjetjet e njëjta gjithashtu janë konstatuar edhe nga Gjykata në Bosnje dhe Hercegovinë në aktgjykimet kundër K2 dhe Z.T. të cilat janë pjesë e materialit provues në këtë lëndë.

4.9.1.2. Lokacionet në Kosovë

1197. Sipas K1, në Kosovë heroina sillej në Vitomiricë, Mitrovicë dhe Pejë. Këto vende kanë filluar të përdoren pak kohë pasi K1 është kthyer nga ushtria (fondi i vitit 1987).¹³⁸³ Ka zgjatur deri më 2009.¹³⁸⁴

1198. Kur është marrë në pyetje të tërthortë, ai ka thënë se përkundër pranisë së forcave ndërkombëtare në Kosovë ka qenë e mundur të sillet droga për shkak të lidhjeve të N.K.¹³⁸⁵ Ai gjithashtu është ballafaquar me deklaratën e tij nga viti 2013 kur ai nuk e ka përmendur ndonjë lokacion në Kosovë. K1 ka shpjeguar se nuk ka treguar për këtë për shkak se K2 tashmë i kishte treguar të gjitha detajet. Roli i tij ka qenë vetëm të konfirmojë atë që K2 tashmë e kishte thënë.¹³⁸⁶ Kur është pyetur në lidhje me një pjesë të dëshmisë së tij (faqe 3 e procesverbalit nga shkurti i vitit 2013) ku ai kishte përmendur dërgesat në Angli, Austri, Zvicër, Kroaci, Slloveni, Holandë, Gjermani dhe Turqi, por jo Kosovën, K1 është

¹³⁸³ 01.11.2016, f. 22, 19.02.2016, f. 7-8

¹³⁸⁴ 02.11.2016, f. 3

¹³⁸⁵ 24.01.2017, f. 44

¹³⁸⁶ 24.01.2017, f. 32-33

përgjigjur se nuk e kishte përfunduar deklaratën e tij.¹³⁸⁷

4.9.1.3. Pejë, R-a-C i E.A., lokacioni 17, fotografitë 84 – 92

1199. Sipas K1, droga ka filluar të vinte aty më 1988 – 1989. Kur arrinin dërgesat shumica prej tyre ishin të pranishëm: R.K., E.A., A.Ka., “Rg.” nga Vitomirica dhe të tjerë.¹³⁸⁸

1200. Lokali Rent – a Car në Pejë ishte në pronësi të E.A. dhe droga ka filluar të vijë aty më 1995 ose 1996 deri më 2009 kur Asllani është burgosur në Austri. K1 e ka njohur ndërtesën nga druri në fotografi. Gjatë takimeve aty, N.K., R.K., A.Ka., E.A. dhe shumë të tjerë kanë qenë të pranishëm.¹³⁸⁹ K1 e ka pranuar se kanë qenë dy lokale R-a-C në Kosovë të cilat ata i kanë përdorë, sidoqoftë takimet mbaheshin vetëm në atë nga druri e cila është treguar në fotografitë e prezantuara gjatë gjyqimit. Ai e ka përshkruar se si të gjithë 10 personat kanë arritur të jenë të pranishëm aty në një kohë.¹³⁹⁰

1201. K1 ka përshkruar në detaje interiorin e lokalit R-a-C. Ata kanë përzierë drogë në katin e parë ku kanë qenë dy dhoma, një zyrë e madhe dhe një dhomë më e vogël. Në katin e poshtëm ka qenë një zyrë. Ai i ka përshkruar mobilet, mënyrën e përzierjes, kohën e shfrytëzuar për këtë, rrobat e përdorura, simptomat (si marramendje), jogurtin që e ka pirë për t’iu shmangur dhe normalisht sprejin për ta larguar erën e heroinës. Ai ka filluar të përziejë aty më 2002 dhe ka zgjatur

¹³⁸⁷ 24.01.2017, f. 32-33

¹³⁸⁸ 02.11.2016, f. 3-4

¹³⁸⁹ 23.02.2016, f. 10 - 11

¹³⁹⁰ 07.11.2016, f. 23 – 24

deri në fund.¹³⁹¹

1202. K1 ka thënë se me siguri ka pasur një lokal tjetër R-a-C dhe një pompë benzine në Vitomiricë, e cila gjithashtu i është treguar hetuesve.¹³⁹² Sidoqoftë, kur ka folur për shënimet në fletoren e tij, ai ka thënë se ata e kanë përdorur vetëm këtë lokal të veturave me qira.¹³⁹³

1203. K1 është takuar me E.A. (i cili ka lindur më 1972) pasi K1 është larguar nga ushtria (1988). Ata janë takuar në Pejë për herë të parë në stacionin e trenit, pastaj ata kanë shkuar në lokalin R-a-C. R.K., A.Ka. dhe të tjerët kanë qenë të pranishëm në këtë rast.¹³⁹⁴ A.Ka. dhe R.K. kanë punuar me E.A. edhe para se K1 të fillonte punën, para kohës kur ka qenë në ushtri. Ata kanë punuar me atë në trajnim, gjithashtu babai dhe vëllai i tij dhe dikush tjetër, por K2 nuk i dinte emrat.¹³⁹⁵

1204. Gjatë marrjes së tërthortë në pyetje, K1 e ka përjashtuar se E.A. ka qenë 16 vjeç kur e kishte takuar për herë të parë.¹³⁹⁶ Kur ai është njoftuar se në vitin 1988 E.A. ka qenë vetëm 16 vjeç, K1 ka thënë se ai nuk punonte i vetëm, por me babanë e tij, vëllain.¹³⁹⁷

1205. Sipas K1, N.K. e njihte E.A. Një herë ka ndodhur që ata kanë qenë të gjithë së bashku, dhe E.A. vinte shpesh në Sarajevë.¹³⁹⁸ E.A. blinte drogë për ata, dhe

¹³⁹¹ 16.03.2016, f. 3 - 8

¹³⁹² 01.11.2016, f. 32

¹³⁹³ 15.03.2016, f. 17

¹³⁹⁴ 01.11.2016, f. 26

¹³⁹⁵ 01.11.2016, f. 27

¹³⁹⁶ 24.01.2017, f. 11

¹³⁹⁷ 24.01.2017, f. 11

¹³⁹⁸ 07.11.2016, f. 25

pastaj e shiste në Danimarkë.¹³⁹⁹ Vozitësit e E.A. janë ndaluar në Gjermani. R.K. ka paguar për mbrojtjen.¹⁴⁰⁰

Versioni i E.A. dhe A.Ka. – dëshmitarë të mbrojtjes

1206. **E.A.** ka mohuar çfarëdo përfshirje në biznesin e drogës.¹⁴⁰¹ Kur është ballafaquar me deklaratën e K1 i cili ka pohuar se që nga viti 1990 dëshmitari ka marrë pjesë në të, ai ka thënë se prej vitit 1991 deri më 1999 ose 2000 ai nuk ka qenë në Kosovë. Ai ka qëndruar në Gjermani ku ka aplikuar për azil sepse në vitin 1991 ai ka dezertuar nga ushtria e Jugosllavisë,¹⁴⁰² të cilës i ishte bashkuar më 19 mars 1991.¹⁴⁰³ Në Gjermani ai u martua dhe i ka marrë dokumentet e Gjermanisë. Ai ka dashur të kthehet në Kosovë qysh në vitin 1997, por babai i tij e paralajmëroi që mos ta bënte këtë sepse policia e Serbisë ende po e kërkonte.¹⁴⁰⁴

1207. Pasi është kthyer, ai ka transportuar mobile nga Gjermania.¹⁴⁰⁵ Kompania quhej “Armendi trans”.¹⁴⁰⁶

1208. Dëshmitar e ka përshkruar përfshirjen e tij në biznes. Ai gjithashtu ka dëshmuar se që nga viti 2005 ose 2006 ai ka pasur një R-a-C në Pejë i cili gjendej afër

¹³⁹⁹ 01.11.2016, f. 27

¹⁴⁰⁰ 01.11.2016, f. 28

¹⁴⁰¹ 17.05.2016, f. 5, 12 - 13

¹⁴⁰² 17.05.2016, f. 5

¹⁴⁰³ 17.05.2016, f. 20

¹⁴⁰⁴ 17.05.2016, f. 20

¹⁴⁰⁵ 17.05.2016, f. 6

¹⁴⁰⁶ 17.05.2016, f. 14

stacionit të autobusëve. Atij i janë treguar fotografitë e lokacionit 17, faqe 91 dhe ai e ka njohur atë si njërin nga lokalet R-a-C.¹⁴⁰⁷ Ai ka theksuar se objekti nuk është rindërtuar ose ndryshuar që nga fillimi. Ka pasur vetëm një kat.¹⁴⁰⁸

1209. Objekti gjendej në tokën të cilën E.A. e kishte marrë me qira nga ndërmarrja e hekurudhave. Dëshmitari ka paraqitur dokumentet që e vërtetojnë këtë. Më parë, nuk ka pasur asgjë në këtë lokacion, vetëm një hapësirë e zbrazët ku hidheshin mbeturinat.¹⁴⁰⁹

1210. E.A. është ballafaquar me deklaratën e K1 se më parë në të njëjtin vend ka qenë një objekt i cili është shkatërruar për t'i fshehur gjurmët e drogës. Ai ka thënë se nuk është e vërtetë.¹⁴¹⁰

1211. Ag.K. ka mohuar se e njihte N.K. Ai e dinte se të dy vinin nga Peja.¹⁴¹¹ Ai nuk ka pasur ndonjë kontakt me R.K.n. Ai vetëm e dinte se ai ishte nga Peja. Ai nuk është takuar me S.Ban., ai e dinte se kishte një biznes. Ai nuk e njihte Bedrijën nga Deçani. Ai nuk e njihte A.Ka. dhe K1.¹⁴¹²

1212. Ata asnjëherë nuk kanë pasur ndonjë kontakt ose lidhje biznesi.¹⁴¹³ Ai asnjëherë nuk ka udhëtuar në Bosnje.¹⁴¹⁴ Ai asnjëherë nuk ka qenë i përfshirë në narkotikë.¹⁴¹⁵

1213. Ag.K.t i janë treguar fotografitë e R-a-C në Pejë. Ai e ka mohuar të ketë qenë

¹⁴⁰⁷ 17.05.2016, f. 4

¹⁴⁰⁸ 17.05.2016, f. 6

¹⁴⁰⁹ 17.05.2016, f. 4 – 5, 14; Certifikata nga komuna e Pejës; Kontrata e qirasë me Hekurudhat e Kosovës; Projekti i objektit;

¹⁴¹⁰ 17.05.2016, f. 8

¹⁴¹¹ 29.07.2016, f. 28

¹⁴¹² 29.07.2016, f. 29-30

¹⁴¹³ 29.07.2016, f. 29

¹⁴¹⁴ 29.07.2016, f. 30

¹⁴¹⁵ 29.07.2016, f. 316

ndonjëherë aty.¹⁴¹⁶

4.9.1.3.1. Fotografitë e reja të lokalit Rent - a – Car në Pejë

1214. Pas analizës së përshkrimit të vendit dhe fotografive të bëra, gjykata kishte dyshime serioze se ka qenë e mundur që disa persona të përziejnë drogë në një objekt të vogël nga druri në të njëjtën kohë. Një mundësi e tillë gjithashtu është kontestuar vazhdimisht nga mbrojtja. Prandaj, gjykata ka vendosur që të urdhërojë hetuesit të bëjnë fotografi të vendit. E.A. ka dhënë pëlqimin për të bërë fotografi brenda objektit.
1215. Fotografitë janë bërë nga hetuesit e EULEX-it në prani të prokurorit dhe mbrojtjes.
1216. K1 është ballafaquar me këto fotografi të pjesës së brendshme i cili në mënyrë të qartë ka treguar se nuk është e mundur që në të njëjtën kohë kanë qenë disa persona duke përzier drogë. Nuk ka pasur asnjë dhomë në katin e parë të cilin e ka përshkruar ai. K1 ka shpjeguar se me siguri është ndërtuar objekti i ri për t'i hequr qafe gjurmët e drogës.
1217. Duhet të përmendet se K1 ka deklaruar se para se t'i tregohen fotografitë e reja atij, prokurori është takuar me të dhe e ka informuar se pjesa e brendshme e lokalit të R-a-C në Pejë nuk përputhet me përshkrimin e dhënë nga K1 gjatë dëshmisë së tij të mëparshme. Ky veprim i prokurorit është vlerësuar nga gjykata si një shembull i papranueshëm i udhëzimit të dëshmitarit, pasi që e ka privuar gjykatën dhe mbrojtjen nga mundësia për ta vërejtur reagimin spontan të

¹⁴¹⁶ 29.07.2016, f. 29

dëshmitarit K1 ndaj fotografive të cilat e kundërshtojnë versionin e tij.

Përfundim

1218. Pas shqyrtimit si më lart, gjykata e gjeti të pa provuar se po përzihej drogë në lokalit të R-a-C në Pejë. Lokali nuk ka ekzistuar në vitin 1987 kur K1 pretendonte se droga kishte filluar të vinte. Nuk ka qenë fizikisht e mundur të veprohet me drogë aty, posaçërisht nga një grup i madh njerëzish.

4.9.1.4. Hotel Park në Pejë, lokacioni 18, fotografitë 97 - 107

1219. **K1** e ka përshkruar në detaje se si sillej droga në hotelin Park në Pejë dhe nga aty shpërndahej përmes vozitësve.¹⁴¹⁷ Sipas tij, N.K. me siguri ka qenë i njoftuar për këtë, sepse R.K. ka qenë gjithmonë aty, dhe gjithçka organizohej nga aty. Valixhet me drogë silleshin aty. Të pranishëm ishin: R.K., E.A. dhe A.Ka.. K1 nuk i kujtohej nëse N.K. ishte aty.¹⁴¹⁸

1220. Gjatë marrjes së tërthortë në pyetje K1 ka dëshmuar se ata kanë filluar ta shfrytëzojnë këtë vend pas lokalit R-a-C në Pejë. Ata e kanë shfrytëzuar atë gjithashtu edhe gjatë “Bo.” [J.C.]rdimeve të NATO-s më 1998, 1999 dhe më vonë. K1 nuk e ka përjashtuar se mund të kenë gabuar nëse ky vend ka qenë vetëm një shtëpi private atëherë.¹⁴¹⁹ Ai ka theksuar se ata nuk e kanë shfrytëzuar dhomën e vogël gjatë gjithë kohës. Ata qëndronin aty vetëm një natë, arrinin pasdite dhe largoheshin në mëngjes. Era e cila rezultonte nga përzierja e heroinës përhapej përreth. Ai e ka përshkruar dhomën, të vogël, tipike dhe mobilet e

¹⁴¹⁷ 01.11.2016, f. 32

¹⁴¹⁸ 19.02.2016, f. 29, 23.02.2016, f. 12-13

¹⁴¹⁹ 24.01.2017, f. 36

saj.¹⁴²⁰¹⁴²¹¹⁴²² Nuk ka pasur nevojë të rinovohet për t'i hequr qafe gjurmët e drogës. Ka qenë ndryshe nga rasti i apartamentit të S.T. i cili është shfrytëzuar pafundësisht.¹⁷³⁷

1221. **E.A.**, i cili gjithashtu kishte ardhur në Hotel Park me drogë, e ka mohuar të kishte ardhur ndonjëherë në këtë vend me K1, R.K., A.Ka. dhe personat e tjerë.

¹⁷³⁸

1222. Mbrojtja ka propozuar si dëshmitar **Milazim Shalën**, pronar i hotelit Park. Ai e ka mohuar se e njeh N.K.,¹⁴²³ R.K. dhe A.Ka..¹⁴²⁴

1223. Ai e ka pranuar se e njohte E.A., ishte mik i tij. Ai e ka konfirmuar se gjatë luftës E.A. ka qenë në Austri dhe nga atje është kthyer në vitin 2006, 2007 ose 2008. E.A. nuk e ka vizituar hotelin e tij.¹⁴²⁵ Ai e dinte këtë sepse kishin lidhje familjare.¹⁴²⁶

1224. M.Sh. ka qenë në Zvicër prej vitit 1989 deri më 2001.¹⁴²⁷

1225. Hoteli Park është hapur vetëm më 31 tetor 2003. Më parë, ka qenë një shtëpi private e një personi të quajtur Kahremon Villa dhe M.Sh. e ka blerë atë nga ai në

¹⁴²⁰ 24.01.2017, f. 45-46

¹⁴²¹ 24.01.2017, f. 45 - 46

¹⁴²² 17.05.2016, f. 11 - 12

¹⁴²³ 16.02.2017, f. 4

¹⁴²⁴ 16.02.2017, f. 6

¹⁴²⁵ 16.02.2017, f. 6

¹⁴²⁶ 16.02.2017, f. 8

¹⁴²⁷ 16.02.2017, f. 7

vitin 2002. Atëherë objekti nuk ka qenë i përfunduar, ka qenë vetëm skeleti. M.Sh. është pronari i parë i hotelit.¹⁴²⁸ Vetëm kati i parë ka qenë tashmë i përfunduar në vitin 2000.¹⁴²⁹

1226. Hotel Park ka qenë biznes familjar. Kanë qenë 10 dhoma. Kati i parë ka qenë i një pronari tjetër, ishte blerë qysh para luftës. M.Sh. e ka pasur katin e dytë – katërt. Në katin e parë ka qenë një auto shkollë, një berber dhe një shitore e ashtuquajtur “gjithçka një euro”. Në katin e dytë ka qenë një sallë, në katin e tretë– shtatë dhoma, dhe në katin e katërt– tri dhoma.¹⁴³⁰ Ai e ka njohur pronën e tij në fotografi– lokacioni 18, f. 104.¹⁴³¹ Nuk ka pasur një reception të ndarë. Banakieri i shërbente mysafirët, ua jepte çelësat, etj.¹⁴³²

1227. Dhomat në hotel nuk kanë qenë më të mëdha se 4 x 4 m. Në secilën dhomë ka qenë, shtrati, një dollap i madh dhe një dollap i vogël me TV. Ventilimi ka qenë vetëm në banjë. Hyrja ka qenë nga rruga. Dyshemeja ka qenë e mbuluar me pllaka të qeramikës. Nuk ka pasur tapet. Nuk ka pasur shumë hapësirë në mes të shtratit dhe mobileve të tjera, mjaftueshëm vetëm sa për të shkuar në banjë.¹⁴³³

1228. Asnjë drogë nuk është përzier në këtë vend.¹⁴³⁴ As ai, as ndonjë anëtarë i familjes së tij nuk është akuzuar apo dënuar për trafikim të drogës.¹⁴³⁵

1229. Në periudhën 2003 – 2007 shumica e mysafirëve të tij kanë qenë ndërkombëtar, përfshirë policët. Disa prej tyre kanë qëndruar madje për disa muaj.¹⁴³⁶

¹⁴²⁸ 16.02.2017, f. 4 - 5

¹⁴²⁹ 16.02.2017, f. 6

¹⁴³⁰ 16.02.2017, f. 5

¹⁴³¹ 16.02.2017, f. 7

¹⁴³² 16.02.2017, f. 10

¹⁴³³ 16.02.2017, f. 9-10

¹⁴³⁴ 16.02.2017, f. 6

¹⁴³⁵ 16.02.2017, f. 7

1230. Gjatë marrjes së tërthortë në pyetje, M.Sh. ka thënë se nuk ka qenë në dijeni që E.A. ishte dënuar për drogë. Ai e ka pranuar se jo vetëm policët kanë qëndruar në hotelin e tij.¹⁴³⁷

Përfundim

1231. Pas shqyrtimit të provave të paraqitura në lidhje me Hotelin Park, gjykata ka gjetur të pa provuar se droga është sjellë, përzier apo shpërndarë në këtë vend. Ndërtesa nuk është përdorë si hotel në periudhën e përmendur nga K1 si pikënisje për sjellje. Do të ishte gjithashtu e paarsyeshme që për përzierjen e heroinës të përdoret një vend si një hotel i cili në parim është lehtësisht i qasshëm për njerëzit e tjerë. Është fakt i njohur se përzierja e heroinës me acid acetik siç është përshkruar nga K1 prodhon një erë të veçantë të fortë të uthullës.

4.9.1.5. Depoja në Dobrush, lokacioni 19, fotografitë 108 - 133

1232. Sipas **K1**, një pompë e benzinës dhe një ndërtesë e vjetër në afërsi të fshatit Dobrush është shfrytëzuar për përzierjen dhe paketimin e drogës në vitet 2002-2003. K1 nuk e ka njohur pronarin e ndërtesës.¹⁴³⁸

1233. Me propozim të mbrojtjes, është dëgjuar dëshmitari **Ar.E.**. Ai dhe familja e tij janë pronarë të kompanisë të quajtur Mercom e cila gjendet në Dobrush, në rrugën kryesore midis Pejës dhe Mitrovicës. Ata e kanë filluar këtë biznes në vitin 1989, merret me prodhimin e dyerve dhe dritareve. Aty gjithashtu është

¹⁴³⁶ 16.02.2017, f. 7

¹⁴³⁷ 16.02.2017, f. 8

¹⁴³⁸ 19.02.2016, f. 29; 23.02.2016, p. 23

edhe një pompë e benzinës. Ka të punësuar 40 deri 60 punëtorë, hapësira ruhet 24/7. Ai asnjëherë nuk i ka dhënë askujt objektet e kompanisë me qira. Familja e tij gjithashtu shet Peugeot në Prishtinë.¹⁴³⁹

1234. Ai ka kaluar në lokacionin në Dobrush në vitin 1992. Nuk ka vepruar gjatë luftës, ai është kthyer aty më 1999. Pompa e benzinës është hapur vetëm më 2003. Asnjëherë nuk është vizituar nga autoritetet për zbatimin e ligjit.¹⁴⁴⁰

1235. Ar.E. e ka mohuar njohjen e R.K., A.Ka., E.A. dhe K1.¹⁴⁴¹ Gjatë marrjes së tërthortë në pyetje ai ka sqaruar se e ka njohur N.K. vetëm nga media. Ata asnjëherë nuk kanë pasur ndonjë biznes së bashku. Ata madje asnjëherë nuk kanë pirë kafe.¹⁴⁴²

1236. Ar.E.t i janë treguar fotografitë 116 – 127 (lokacioni 19) ku ai i ka njohur objektet të cilat gjenden në Dobrush të cilat i takojnë kompanisë së tij.¹⁴⁴³ Ai kategorikisht e ka mohuar se ndonjë person (N.K., R.K., E.A., A.Ka. dhe K1) kanë mundur të vijnë në hapësirat e kompanisë së tij dhe të bëjnë diçka në lidhje me drogën. Ai ka theksuar se raportet në mes familjes Elshani dhe familjes N.K. janë të këqija që nga viti 1999, dhe prandaj një gjë e tillë nuk ka mundur të lejohet nga ai apo familja e tij. Ai as nuk do ta lejonte këtë sepse është një biznesmen serioz, baba i familjes me shtatë fëmijë.¹⁴⁴⁴ Sidoqoftë, emri i N.K nuk është përdorë në këtë kontekst. Ai nuk ka dashur të hyjë në detaje të kësaj

¹⁴³⁹ 17.05.2016, f. 23, 29

¹⁴⁴⁰ 17.05.2016, f. 29

¹⁴⁴¹ 17.05.2016, f. 24

¹⁴⁴² 17.05.2016, f. 28

¹⁴⁴³ 17.05.2016, f. 24-25

¹⁴⁴⁴ 17.05.2016, f. 25-26, 27

marrëdhënie. Ata janë më të afërt me R.K.¹⁴⁴⁵

1237. Ar.E. asnjëherë nuk është marrë në pyetje në lidhje me pretendimet e bëra nga K1.¹⁴⁴⁶

Përfundim

1238. Duke e marrë parasysh si më lart, gjykata gjen të pa provuar se droga është përzier, sjellë dhe shpërndarë në depon në Dobrush.

4.9.1.6. Hotel Jusaj, lokacioni 20, fotografitë 134 - 141

1239. K1 ka dëshmuar se R.K. e aranzhuar për t'i dërguar vozitësit atje; hapësira përdorej për përzierjen e drogës dhe ndarjen e tyre në valixhe për t'u dërguar në shtetet tjera. Ata po i shfrytëzonin dhomat e hotelit.¹⁴⁴⁷ Droga vinte përmes S.B., dërgoheshin në Mitrovicë, vozitësit prisnin në hotele.¹⁴⁴⁸ Ky lokacion ka filluar të përdoret jo shumë kohë pas kthimit të K1 nga ushtria.¹⁴⁴⁹ Ai gjithashtu ka thënë se N.K. e dinte për këtë lokacion, por R.K. ka qenë më i informuar sepse N.K. ka ikur nga Peja në vitin 1988. Në këtë hotel qëndronin A.Ka., R.K. dhe E.A. Ata vinin aty duke filluar nga viti 2001-2002 deri më 2009.¹⁴⁵⁰

1240. E.A. e ka mohuar të ketë qëndruar ndonjëherë në këtë hotel me K1, R.K., A.Ka. dhe personat e tjerë.¹⁴⁵¹ As ai, as vëllai i tij nuk e kanë njohur R.K.n, A.Ka. dhe

¹⁴⁴⁵17.05.2016, f. 26

¹⁴⁴⁶ 17.05.2016, f. 27

¹⁴⁴⁷ 01.11.2016, f. 24

¹⁴⁴⁸ 01.11.2016, f. 24

¹⁴⁴⁹ 01.11.2016, f. 25

¹⁴⁵⁰ 19.02.2016, f. 22, 23.02.2016, f. 25-26

N.K. (këtë të fundit e ka njohur vetëm nga mediat).¹⁴⁵²

Përfundim

1241. Gjykata e ka gjetur të pa provuar se droga ishte sjellë, përzier dhe ose dërguar nga hoteli Jusaj.

4.9.1.7. “Ban.” qendra(t), lokacionet 21, fotografitë 163 – 183 (“Ban.” Qendra, “Ban.” S.H. Istog)

1242. **K1** ka dëshmuar se S.Ban. vazhdimisht ka transportuar drogë nga Turqia. Ai përdorte kamionë të gjatë me të cilët transportonte fruta dhe perime. Heroina paketohej në topa, të përzier me fruta. Gjithashtu vendosej brenda dyerve, brenda lavatriçeve.¹⁴⁵³

1243. **K1** është takuar me S.Ban. në shumë raste. Për herë të parë, me atë është takuar rrugës prej Pejës në Deçan në anën e djathtë ku e kishte një pikë të madhe për shitjen e frutave dhe ku heroina sillej nga Turqia.¹⁴⁵⁴

1244. S.Ban. ka pasur objektet e tij të biznesit në Pejë, në Deçan, në gjithë Kosovën. Ai i njihte N.K. dhe R.K. të cilët ishin kryesorët. **K1** ka qenë në shumë takime me S.B. në lokacione të ndryshme.¹⁴⁵⁵

1245. Gjatë marrjes së tërthortë në pyetje **K1** e ka pranuar se ai u ka thënë hetuesve se lokacioni “Ban.” ka qenë në Pejë, kurse ata e kanë korrigjuar atë dhe kanë thënë se ka qenë në anën e djathtë të rrugës për Deçan. Ai ka shpjeguar se për të ai

¹⁴⁵¹ 17.05.2016, f. 11

¹⁴⁵² 29.07.2016, f. 11

¹⁴⁵³ 01.11.2016, f. 22 - 23

¹⁴⁵⁴ 01.11.2016, f. 23

¹⁴⁵⁵ 01.11.2016, f. 23

lokacion nuk ka qenë i rëndësishëm, por emri “Ban.” ka qenë i rëndësishëm.¹⁴⁵⁶ Hetuesit i kanë thënë se ata duan të shohin vetëm vendet ku është vendosur tabela me shenjën

“Ban.”^{1457/1458}

1246. Gjatë marrjes së tërthortë në pyetje në lidhje me lokacionin King Pin21/171 (qendra tregtare “Ban.”), K1 nuk i është kujtuar sa herë ka qenë atje. Sidoqoftë, ai nuk kishte dyshime se S.Ban. ka qenë pronari. Ky lokacion është përdorë prej vitit 1988. K1 ka thënë se ai asnjëherë nuk është takuar me S.Ban. aty, ai është tërhequr nga deklarata e tij e bërë gjatë marrjes së drejtpërdrejtë në pyetje.

Dorëzimi i drogës është bërë aty në parking.¹⁷⁷⁴

1247. K1 është ballafaquar me provat që tregojnë se qendra tregtare “Ban.” është ndërtuar vetëm më 2012, por ai ende këmbëngulte se ai kishte ardhur në këtë vend më parë. Ka qenë një ndërtesë, por me sa duket është vazhduar dhe rrethuar. Ai e ka pranuar se ndërtesa dukej ndryshe, nuk ishte e përfunduar atëherë. Ai e ka njohur sepse në shumë raste ai e kishte marrë rrugën e njëjtë. Ai i është shmangur përgjigjes nëse ka pasur ndonjë shenjë në ndërtesë. Në pyetjen udhëzuese nëse ka qenë shenja “Ban.”, ai ka thënë se nuk është i sigurt, sepse aty vinte natën. Ai e ka njohur vendin në bazë të rrugës.¹⁴⁵⁹

¹⁴⁵⁶ 11.11.2016, f. 8 - 11

¹⁴⁵⁷ 25.01.2017, f. 12-16

¹⁴⁵⁸ .01.2017, f. 12-16

¹⁴⁵⁹ 25.01.2017, f. 17-20

1248. E.A. (dëshmitar i mbrojtjes) ka thënë se ai nuk e njihete qendrën “Ban.” në Istog. Ai ka thënë se asnjëherë nuk ka qenë atje.¹⁴⁶⁰ Ai ka dëshmuar se ai dhe vëllai i tij C.H. kanë qenë pronarë të kompanisë së quajtur “NT Ban.”. Ata e kanë filluar në vitin 2000, dhe fillimisht kanë qenë 4 pronarë: E.H., S.H., R.H. dhe C.H. Në vitin 2001 ata kanë filluar shitjen në lagjen “Lidhja e Prizrenit” në Istog e cila funksionon deri më tani. Në vitin 2012, ata kanë hapur një qendre tjetër, gjithashtu në Istog. Të dyja quhen “Ban. Centre”.¹⁴⁶¹
1249. E.H. i janë treguar fotografitë e faqes 171, lokacioni numër 21. Ai e ka njohur si ato në pronësi të E.H. dhe C.H.¹⁴⁶² Ndërtimi ka filluar në mars 2012, dhe ata kanë filluar të punojnë aty në tetor 2012.¹⁴⁶³ Ai e ka mbështetur këtë me dokumentet në vijim: ka ofruar një kontratë për blerjen e tokës në vitin 2012 dhe kontratën e ndërtimit dhe lejen. Ai e ka mohuar se S.Ni. (S.Ban.) ka pasur ndonjë lidhje me objektet e tij në Istog. Kur ata e kanë blerë tokën në vitin 2012, aty nuk ka pasur asnjë objekt në këtë ngastër.¹⁴⁶⁴
1250. Atij gjithashtu i është treguar lokacioni nga faqja 177 i cili ishte i vëllait të tij S.H. Ndërtesa aty është ndërtuar në vitin 2012, maj ose qershor. Ky objekt është dhënë me qira nga S.H.¹⁴⁶⁵
1251. Vetëm në vitin 2002 ata i kanë pasur dy kamionët e tyre për dërgesa, të regjistruar në Ulqin. Kanë qenë dy vozitës: A.N. dhe S.Ka.. Ata e sillnin mallin nga Zrenjanini, Serbia.¹⁴⁶⁶ Ata gjithashtu blinin fruta dhe perime në Podgoricë;

¹⁴⁶⁰ 17.05.2016, f. 12

¹⁴⁶¹ 29.07.2016, f. 4-5

¹⁴⁶² 29.07.2016, f. 8

¹⁴⁶³ 29.07.2016, f. 8

¹⁴⁶⁴ 29.07.2016, f. 8-10; Kontrata e blerjes së tokës në vitin 2012 dhe kontrata e ndërtimit dhe leja

¹⁴⁶⁵ 29.07.2016, f. 12

ata asnjëherë nuk kanë pasur dërgesa nga Turqia.¹⁴⁶⁷

1252. E.H. e ka njohur S.Ban., ata kanë pasur kontakte në Tiranë në vitin 2001. Ata kanë blerë lëngje nga fabrika e tij të cilat shiteshin vetëm në Ulqin. Ato nuk silleshin në Kosovë fare. Ato transportoheshin nga vozitësi F.Fer.. Gjithsej kanë qenë tri transporte.¹⁴⁶⁸ Ai e ka parë atë vetëm një herë.¹⁴⁶⁹ Në periudhën 2001 – 2011 E.H. nuk është takuar me S.Ban.¹⁴⁷⁰

1253. Kompania merrte mall kryesisht nga kompanitë vendore si: ELC – ELKOS, Dauti Commerce, Meridian. Transporti organizohej nga ata.¹⁴⁷¹

1254. E.H. ka mohuar se ndonjë kamion nga Turqia ka ardhur në vendin e tyre. Ai nuk e njohte K1, nuk ka pasur asnjë përfshirje në drogë.¹⁴⁷²

1255. E.H. ka mohuar ta ketë quajtur biznesin e tij “Ban.” për shkak të bashkëpunimit me S.Ban. Ai nuk ishte asgjë të përbashkët me atë. Ai ka shpjeguar se fillimisht biznesi i tij është quajtur “Drenica” por në vitin 1988 ai ka lëvizur me të në Ulqin dhe për shkak të presionit nga serbët dhe malazezët ai ka vendosur ta riemërojë në “Ban.”.¹⁴⁷³ Ndërmjet viteve 1988 – 1995 ata nuk kanë pasur asnjë biznes në Istog, ata kanë vepruar vetëm në Ulqin. Në vitin 1995 vëllezërit e tij Skenderi dhe Rexhepi janë kthyer në Kosovë të parët dhe kanë hapur një shitore

¹⁴⁶⁶ 29.07.2016, f. 5

¹⁴⁶⁷ 29.07.2016, f. 18-19

¹⁴⁶⁸ 29.07.2016, f. 6

¹⁴⁶⁹ 29.07.2016, f. 18

¹⁴⁷⁰ 29.07.2016, f. 7

¹⁴⁷¹ 29.07.2016, f. 7

¹⁴⁷² 29.07.2016, f. 10

¹⁴⁷³ 29.07.2016, f. 13

ushqimore. E.H. është kthyer në vitin 2002. ¹⁴⁷⁴

1256. E.H. ka shpjeguar se ai ka të punësuar rreth 100 persona. Kur e kishte filluar biznesin e tij në vitin 2000 ai kishte punësuar 5 – 6 punëtorë. Ai e ka përjashtuar se droga sillej në lokacionin e tij. Ai e ka mohuar njohjen e K1, N.K, E.A. dhe R.K. ¹⁴⁷⁵

1257. Mbrojtja ka propozuar gjithashtu të dëgjohej **S.Ni.**, me nofkën Ban. Ai ka dëshmuar se ka shitur fruta dhe perime në ish Jugosllavi për 50 vite. Aktualisht është i pensionuar. Ai i ka pasur kompanitë me emrat: Hit, Prerada, Fructis dhe Visnica. ¹⁴⁷⁶

1258. Ai ka importuar banane, portokaj, kivi, etj., kryesisht nga Evropa, Azia dhe gjithashtu nga Kuba. Ai ka porositur dërgesa të cilat janë sjellë përmes anijeve kryesisht në Rijekë, Split dhe Budvë. Ai asnjëherë nuk ka sjellë fruta me kamionë nga Turqia. ¹⁴⁷⁷ Kur po punonte me fruta dhe perime, ai ka pasur 47 degë në tërë Jugosllavinë. Ai i ka pasur kamionët e tij. ¹⁴⁷⁸ Gjatë periudhës 1991 – 1998 ai ka pasur 10 – 15 kamionë DAV, 10 – 15 furgonë dhe rreth 50 limuzina. ¹⁴⁷⁹

1259. Ai gjithashtu blinte lloje të ndryshme të frutave arnore nga Turqia. Ato nuk silleshim me kamionë por me anije. Ai asnjëherë nuk ka blerë një ngarkesë të plotë nga Turqia i vetëm, por ka bashkëpunuar me partnerë të tjerë nga kjo pjesë

¹⁴⁷⁴ 29.07.2016, f. 14

¹⁴⁷⁵ 29.07.2016, f. 16-17

¹⁴⁷⁶ 17.03.2017, f. 4

¹⁴⁷⁷ 17.03.2017, f. 7-8

¹⁴⁷⁸ 17.03.2017, f. 6

¹⁴⁷⁹ 17.03.2017, f. 6

e Evropës. Një pjesë e dërgesës merrej nga njëri, kurse pjesa tjetër nga tjetri. Anijet shkarkoheshin në Greqi dhe Mal të Zi.¹⁴⁸⁰

1260. Në vitin 1991, ai e ka filluar biznesin e tij gjithashtu edhe në Shqipëri. Në vitin 1992, ai i ka mbyllur të gjitha bizneset e tij në Jugosllavi.¹⁴⁸¹ Prej vitit 1992 deri më 1998 ai po kërkonte mundësi në Shqipëri. Në vitin 1994, ai e ka blerë një objekt atje, ka prodhuar ambalazhe për qumësht dhe lëngje. Ai ka punësuar rreth 300 - 400 punëtorë. Kur ka filluar lufta në Kosovë ai gjithashtu ka punësuar refugjatë nga atje.¹⁴⁸²

1261. Prej vitit 1993 deri më 1996, ai ka punuar me kompaninë e Maqedonisë të quajtur “Macedonia Tabak”. Ai u dërgonte atyre filtra për prodhimin e cigareve të cilat i blinte nga një kompani serbe e quajtur “El Nis”. Ai ka bashkëpunuar me Ek.L. i cili e ka në pronësi [kompaninë D].¹⁴⁸³

1262. Kur është pyetur lidhur me lidhjet me Turqinë, ai ka thënë se ai asnjëherë nuk ka dërguar kamionët me mall në Turqi.¹⁴⁸⁴

1263. Gjatë periudhës 1999 – 2010 S.Ni. nuk ka pasur supermarket në Kosovë.¹⁴⁸⁵ Deri në vitin 2003 ai ka qëndruar në Shqipëri, vetëm atëherë ai është kthyer në

¹⁴⁸⁰ 17.03.2017, f. 8

¹⁴⁸¹ 17.03.2017, f. 5

¹⁴⁸² 17.03.2017, f. 5

¹⁴⁸³ 17.03.2017, f. 5 - 6

¹⁴⁸⁴ 17.03.2017, f. 9

¹⁴⁸⁵ 17.03.2017, f. 9

Kosovë. ¹⁴⁸⁶ Pastaj, ai i ka sjellë makinat nga Shqipëria dhe ka filluar prodhimin në Pejë. ¹⁴⁸⁷

1264. Atij i janë treguar fotografitë e lokacionit 21 (151, 161, 156, 157) dhe ai nuk i ka njohur ato. ¹⁴⁸⁸ Atij gjithashtu i janë treguar fotografitë e lokacionit 17 (lokalit Ra-C në Pejë). Ai nuk e ka njohur, ka pyetur nëse është restorant apo kafeteri. Ai asnjëherë nuk ka qenë aty. ¹⁴⁸⁹

1265. Ai e ka mohuar çfarëdo përfshirje në drogë, se kamionët e tij janë dërguar në Turqi për të transportuar drogë. ¹⁴⁹⁰ Ai ka mohuar se i njeh: Ag.K.n, R.K., E.A. dhe Bedrinë.

1266. Ai e ka pranuar se e njohte N.K. ¹⁴⁹¹ S.Ni. ia ka shitur një shtëpi N.K i cili ka marrë një objekt me qira afër tij. Ka qenë para 30 – 35 viteve. ¹⁴⁹² Ai ka thënë se ka qenë shok i N.K. ¹⁴⁹³ Ata kanë pasur lidhje afariste– N.K. këmbente për S.Ni. Dinarët serb në Franka të Zvicrës. Përveç kësaj, më vonë N.K. ka blerë cigare nga ai, dhe më shumë nga Ekrem Lluka. ¹⁴⁹⁴ Gjatë marrjes së tërthortë në pyetje S.Ni. ka sqaruar se N.K. ka marrë cigare vetëm nga Ekrem Lluka. ¹⁴⁹⁵

¹⁴⁸⁶17.03.2017, f. 9

¹⁴⁸⁷ 17.03.2017, f. 10

¹⁴⁸⁸ 17.03.2017, f. 10

¹⁴⁸⁹ 17.03.2017, f. 11

¹⁴⁹⁰ 17.03.2017, f. 10, 12 - 13

¹⁴⁹¹ 17.03.2017, f. 11

¹⁴⁹² 17.03.2017, f. 11

¹⁴⁹³ 17.03.2017, f. 12

¹⁴⁹⁴ 17.03.2017, f. 11- 12

¹⁴⁹⁵ 17.03.2017, f. 14

1267. Në fund të vitit 2002 ose në fillim të vitit 2003, S.Ni. ka udhëtuar në Sarajevë. Duke filluar nga viti 2003 ai më nuk ka shkuar asnjëherë atje.¹⁴⁹⁶ Vizita e tij e fundit në Sarajevë lidhej me biznesin me plastikë.¹⁴⁹⁷
1268. S.Ni. është intervistuar 7 – 8 vite më parë nga EULEX-i në barakat në Fushë Kosovë. Ata e kanë lënë të shkojë dhe më asnjëherë nuk është ftuar përsëri.¹⁴⁹⁸
1269. Gjatë marrjes së tërthortë në pyetje S.Ni. ka thënë se për herë të fundit N.K. e kishte para 5 – 6 viteve¹⁴⁹⁹ Herën e fundit është takuar me N.K. gjatë vizitës së tij në Sarajevë në vitin 2002/2003. Ata kanë ngrënë darkë së bashku dhe kanë biseduar për vetura. Nganjëherë ka ndodhur që S.Ni. ka blerë vetura nga N.K.¹⁵⁰⁰ S.Ni. nuk ka mundur të tregojë se sa shpesh është takuar me N.K. Ai e thërriste atë sa herë që i duhej diçka nga ai. Ai e thërriste atë kur kishte nevojë për Franga të Zvicrës. Ai gjithashtu i shiste cigare sepse e dinte që N.K. do t'i paguante.¹⁵⁰¹
1270. Ai e ka pranuar se gjithmonë e ka pasur prë zemër N.K., përkundër faktit se ai ka qenë më i ri se ai dhe kishte stil tjetër të jetës.¹⁵⁰²
1271. Ai e ka mohuar njohjen e K1. Kur është pyetur se si është e mundur se K1 e njohte atë, ai është përgjigjur se të gjithë e njihnin atë, kurse ai nuk ka pasur nevojë t'i njohë të gjithë. Ai ka qenë biznesmeni më i madh në ish Jugosllavi. Ai nuk është quajtur vetëm S.Ban., por gjithashtu edhe S.Po.ja. Aktualisht, ai punon

¹⁴⁹⁶ 17.03.2017, f. 12

¹⁴⁹⁷ 17.03.2017, f. 12

¹⁴⁹⁸ 17.03.2017, f. 13

¹⁴⁹⁹ 17.03.2017, f. 14

¹⁵⁰⁰ 17.03.2017, f. 16

¹⁵⁰¹ 17.03.2017, f. 14

¹⁵⁰² 17.03.2017, f. 14

në telekomunikim dhe urrehet për bashkëpunimin me Serbinë.¹⁵⁰³

Përfundim

1272. Gjykata gjen se prokurori nuk ka paraqitur prova për të vërtetuar se qendrat “Ban.” janë shfrytëzuar për trafikimin e drogës. Duhet theksuar se nga dëshmia e K1 rezulton se ai nuk ishte i sigurt nëse i ka njohur vendet e dhura si ato ku është sjellë droga. Mbrojtja ka paraqitur prova të cilat në mënyrë efektive i kanë kundërshtuar pretendimet e K1. Ato nuk kanë qenë vetëm dëshmi të dëshmitarëve të përmendur më lart, por gjithashtu edhe dokumente të paraqitura nga ta. Përveç kësaj, në rastin e qendrave “Ban.” është bërë e dukshme se fotografitë e vendeve me shenjën “Ban.” janë bërë, pavarësisht nëse këto lokacione kanë pasur ndonjë lidhje me trafikimin e drogës.

4.9.1.8. Mitrovicë, Vitomiricë, Pejë, lokacioni 22, fotografitë 184 – 192, Market Florenti I, lokacioni 23, fotografitë 193-200, Market Florenti II

1273. **K1** në dëshminë e tij e ka përshkruar Mega Marketin Florenti si një vend tjetër ku sillej droga. Sipas tij, ajo i takonte K.V.t.¹⁵⁰⁴

1274. Mbrojtja ka propozuar **K.B.n** si dëshmitar, pronar i Mega Marketit Florenti I dhe II në Mitrovicë. Ai i ka njohur fotografitë e këtyre objekteve. Ai është pronar i këtyre objekteve prej vitit 2007. Ai vetë nuk importon produkte, ai shet gjëra ushqimore, fruta dhe perime të cilat kryesisht i blen në tregun e gjelbër në Prishtinë dhe drejtpërdrejtë nga fshatarët. Ai ka përdorë kamionë për transport por vetëm në Kosovë. Ai asnjëherë nuk ka importuar nga Turqia.¹⁵⁰⁵

¹⁵⁰³ 17.03.2017, f. 15

¹⁵⁰⁴ 23.02.2016, f. 10 – 11, 27

¹⁵⁰⁵ 29.07.2016, f. 22-23

1275. K.B. nuk i njihte K1, R.K., A.Ka. dhe N.K. Ai e njihte E.A. i cili ka qenë mjek në Mitrovicë. Ai e njihte K.V.n si figurë publike në Kosovë. Ai nuk ka pasur ndonjë lidhje biznesi me atë. Ai ka dëgjuar për S.Ban. si një burrë i cili punon në treg. Ai nuk kishte ndonjë biznes të përbashkët me atë.¹⁵⁰⁶

1276. Ai ka theksuar se marketet monitorohen me video dhe gjithashtu kishte sistem të sigurisë i cili ishte aktiv gjatë natës. Punonte 7 ditë në javë, prej orës 7 deri në mesnatë.¹⁵⁰⁷ Gjatë marrjes së tërthortë në pyetje ai ka sqaruar se monitorimi ishte instaluar 5 deri 6 vite më parë. Sigurimi bëhej nga kompania “Black Panther”.
1508

1277. Ai e ka mohuar çfarëdo përfshirje në biznesin e drogës, ai e ka përjashtuar se objekti i tij mund të jetë shfrytëzuar për këtë qëllim.¹⁵⁰⁹

1278. Ai asnjëherë nuk është dënuar për asgjë, ai ka theksuar se nuk e kupton se pse është ftuar të dëshmojë.¹⁵¹⁰

Përfundim

1279. Prokurori nuk ka paraqitur asnjë provë për ta vërtetuar deklaratën e K1 në lidhje me dërgimin e drogës në marketet Florenti në Mitrovicë. Gjykata nuk sheh asnjë arsye mos t’i besojë dëshmitarit K.B.. Prandaj, nuk është vërtetuar se ka ndodhur ndonjë veprim në lidhje me trafikimin e drogës në këto lokacione.

¹⁵⁰⁶ 29.07.2016, f. 24 - 25

¹⁵⁰⁷ 29.07.2016, f. 25

¹⁵⁰⁸ 29.07.2016, f. 26

¹⁵⁰⁹ 29.07.2016, f. 25

¹⁵¹⁰ 29.07.2016, f. 25

4.10. “Acid ujë”

1280. K1 ka dëshmuar se N.K. dhe Z.T. kanë dërguar në Turqi 6 tonë të substancës së lëngët të quajtur “acid ujë” i cili përdoret për procesimin e heroinës. K1 ka qenë i pranishëm kur ka arritur acidi në Turqi. Është bërë nga një kompani e regjistruar tek një person gjerman, emrin e të cilit K1 nuk e dinte.¹⁵¹¹

1281. Prokurori nuk ka paraqitur asnjë provë për ta vërtetuar dëshminë e K1 në mënyrë që ta mbështesë pretendimin e tij, prandaj gjykata e ka gjetur si të pa provuar.

4.11. Dëshmitari K3

1282. Dëshmitari K3 është propozuar nga prokuroria për t’i mbështetur pretendimet e përshkruara në pikën 3 të aktakuzës. Në shumë raste gjatë marrjes në pyetje, K3 ka pohuar se duhet të konsultohet me prokurorin për përgjigjet e tij. Gjykatës i ka dhënë përshtypjen se dëshmia e tij nuk ishte as e sinqertë e as spontane.

1283. Gjatë gjykimit është bërë e qartë se K3 ka vepruar me qëllim të marrjes së imunitetit dhe mundësisht përfitimeve të tjera në këmbim të dëshmisë së tij. Ka krijuar një rrezik të qartë që dëshmitari ka përgatitur dëshminë e tij për ta fituar statusin e dëshiruar. Megjithatë, ai nuk ka thënë pothuajse asgjë në lidhje me përfshirjen e pretenduar të N.K në trafikimin e drogës përveç thashethemeve të pa verifikuara dhe jo të hollësishme.

¹⁵¹¹ 01.11.2016, f. 28-29

1284. K3 ka përshkruar në detaje përfshirjen e tij në biznesin e drogës. Ai ka filluar punën me drogë kur ka qenë 13 vjeç, në vitin 2000. Në fillim ai ka vepruar vetëm në Beograd. Pastaj, ai ka shitur drogat e ashtuquajtura rekreacionale: marihuan dhe të tjera në bazë të metamfetaminës. Më vonë ai gjithashtu është marrë me heroinë, kokainë dhe droga të tjera. Ai e ka përshkruar strukturën dhe hierarkinë e grupit me të cilin ka punuar.¹⁵¹² Ai ka shpjeguar se ka fituar shumë para me këtë, nuk kishte nevojë që të punonte.¹⁵¹³

1285. Ai ka filluar të merret me drogë pasi që i është afruar Al.Ki.¹⁵¹⁴ i cili i takonte grupit i cili vepronte në Serbi, Republikën Srpska dhe në Bosnjë dhe Hercegovinë.¹⁵¹⁵ E gjithë droga e cila vinte në Ballkan arrinte përmes Kosovës.¹⁵¹⁶

1286. K3 ka paraqitur në detaje sasinë e drogës të cilën e kishte shitur. Kur është bërë 18 vjeç, shkalla e biznesit është bërë më e madhe.¹⁵¹⁷ Ai ishte përfshirë në shitjen e drogës gjatë ngjarjeve të mëdha muzikore.¹⁵¹⁸ Pozita e tij ka qenë menaxher i mesëm; ai nuk ka dashur të ngritët më lart sepse e konsideronte të rrezikshme.¹⁵¹⁹

1287. Gjatë periudhës 2000 – 2009 ai ka pranuar drogë nga H.Ha., D.Ri. dhe M.Lu.¹⁵²⁰

1288. K3 ka thënë se vjehri i tij, S.Pe., ka qenë në dijeni të biznesit të tij me drogë dhe

¹⁵¹² 14.10.2015, f. 4 – 41;15.10.2015, p. 4-5

¹⁵¹³ 15.10.2015, f. 23-24

¹⁵¹⁴ 14.10.2015, f. 9

¹⁵¹⁵ 14.10.2015, f. 7

¹⁵¹⁶ 14.10.2015, f. 8; 15.10.2015, p. 6

¹⁵¹⁷ 14.10.2015, f. 13

¹⁵¹⁸ 14.10.2015, f. 9-10

¹⁵¹⁹ 14.10.2015, f. 11

¹⁵²⁰ . 7

më vonë, ai edhe vetë është përfshirë në atë. Ai posedonte klube nate në Beograd të cilat menaxhoheshin nga K3, ku shitej droga. Ka qenë një klub nate i quajtur Star.¹⁵²¹ K3 ka refuzuar që t'i jap emrat e të gjitha klubeve ku shitej droga, sepse ka thënë se kishte frikë se personat e caktuar do të mund lëndoheshin nga personat të cilët ishin ende aktiv në biznes.¹⁵²²

1289. Sipas K3, S.Pe. ka aranzhuar kontaktet me N.K. i cili është dashur t'i ndihmojë K3 për ta zhvilluar biznesin e tij sepse "ata" gjithmonë kishin mall, ndërsa K3 me grupin e tij e kontrollonte tregun. K3 ka shpjeguar se me "ata" e kishte fjalën për N.K., L.K., njerëzit rreth tij dhe të tjerët me të cilët bashkëpunonte. Kur është pyetur për detaje, ai i ka përmendur dy emra: D.Ri. dhe H.Ha..¹⁵²³

1290. Sidoqoftë, K3 nuk ka treguar asnjë veprim të vetëm i cili përbënte ndihmën të cilën ai e ka përmendur. Në veçanti, ai nuk ka paraqitur asnjë rast ku N.K. e ka furnizuar atë me drogë.

1291. Kur është pyetur nëse L.K. ka punuar me N.K., K3 ka thënë se ai besonte se po. Kur është pyetur pse, ai ka thënë se përfundimin e tij e bazon në atë çfarë ka dëgjuar nga njerëzit.¹⁵²⁴ Sipas K3 ka qenë një bindje e përbashkët se N.K. e dinte për përfshirjen e L.K. në trafikimin e drogës.¹⁵²⁵

¹⁵²¹ 14.10.2015, f. 17 – 18

¹⁵²² 14.10.2015, f. 19

¹⁵²³ 14.10.2015, f. 29

¹⁵²⁴ 14.10.2015, f. 30

¹⁵²⁵ 14.10.2015, f. 30

15.10.2015, f

1292. K3 ka dëgjuar se organizata e N.K përziende drogë diku në Pejë dhe në Bosnje. Kur është pyetur se si e di këtë, ai është përgjigjur se duhet ta pyes prokurorin nëse mund t'i zbulojë emrat.¹⁵²⁶
1293. Kur është pyetur lidhur me kryesuesin e kësaj organizate, K3 është përgjigjur se N.K. ka qenë në anën e tij, dhe gjithashtu kishte njerëz edhe në Beograd.¹⁵²⁷
1294. Në dëshminë e tij K3 ka dhënë fakte në shumta lidhur me veprimet që pretendohet se janë kryer nga Liridion N.K. Ai nuk ka paraqitur asnjë veprim të kryer nga N.K.
1295. Në shkurt të vitit 2011, ai për herë të parë ka qenë në Ilidza, Sarajevë, kur është përzierë droga. Ai ka shkuar atje me dikë i cili duhet ta merrte mallin, por nuk ka dashur t'ia tregojë emrin pa u konsultuar me prokurorin. Ata kanë marrë një qese plastike me drogën e quajtur “speed” nga N.Cu., anëtar i grupit të Da.E. K3 ka shkuar atje vetëm një herë.¹⁵²⁸
1296. Kur është pyetur për lidhjen midis N.Cu., N.K dhe L.K., K3 ka thënë se ata merrnin drogë nga i njëjti vend.¹⁵²⁹
1297. K3 ka dëshmuar gjerësisht lidhur me veprimet e Liridion N.K. Në vitin 2009, S.Pe. e kishte drejtuar atë tek ai, i cili i ka thënë se dikush do ta thërriste dhe se ai do të duhej t'i përmbahet udhëzimeve. S.Pe. ka shpjeguar se kjo thirrje do të jetë në lidhje me punën.¹⁵³⁰

¹⁵²⁶ 14.10.2015, f. 38

¹⁵²⁷ 15.10.2015, f. 18

¹⁵²⁸ 14.10.2015, f. 38-39

¹⁵²⁹ 14.10.2015, f. 39

¹⁵³⁰ 14.10.2015, f. 25-26; 15.10.2015, p. 7 - 9

1298. Në të njëjtën ditë, K3 është thirrë nga dikush i cili nuk është prezantuar. Ai e ka lidhur këtë thirrje me bisedën e mëhershme me S.Pe. Në biseda të tilla askush nuk ka përdorë emra, gjithashtu SIM kartelat ndërroreshin shpesh.¹⁵³¹

¹⁵³¹ . g
15.10.2015, f

1299. K3 ka udhëtuar nga Beogradi, sigurisht në mars 2009. Ai është shoqëruar nga një person tjetër, por ka refuzuar që ta tregoj emrin për shkaqe të sigurisë, siç thoshte ai. Dikush ishte duke i pritur ata në Kosovë. Ata kanë shkuar në Graçanicë¹⁵³²ku K3 u takua me L.K. K3 ka ardhur me veturë me një person tjetër, por përsëri K3 ka refuzuar ta tregoj emrin e tij përndryshe ky person do t'i ekspozohet rrezikut.¹⁵³³
1300. K3 është takuar me L.K. në një shtëpi private në Graçanicë. Takimi ka zgjatur 30 – 45 minuta. Me këtë rast, ata i janë prezantuar njëri tjetrit, sidoqoftë K3 e dinte nga më parë se si dukej L.K. sepse e kishte parë atë në qarqe të njëjta në Beograd.¹⁵³⁴ K3 ka qenë paksa i befasuar për ta takuar L.K. sepse nuk e dinte se çfarë të priste.¹⁵³⁵
1301. Gjatë takimit L.K. ka bërë pyetje në lidhje me ahengjet e organizuara nga K3, sa drogë do të mund të shitej aty. K3 nuk i ka bërë ndonjë pyetje atij. L.K. nuk ka thënë asgjë në lidhje me biznesin e tij. Gjatë këtij takimi ata kanë shkëmbyer sim kartelat dhe më vonë njëri nga bashkëpunëtorët e K3 ka qenë në kontakt me njerëzit e L.K. L.K. ka thënë se ata do të pranonin një thirrje nga ai dhe kështu është krijuar bashkëpunimi.¹⁵³⁶
1302. Në fund, L.K. ia ka dhënë atij 1 kg drogë të quajtur “speed” si shenjë e vullnetit të mirë. Nga ky moment bashkëpunimi i tyre është bërë i rregullt. Ai rregullisht merrte nga ai ekstazi, heroinë, përfshirë të bardhë dhe speed. Ka qenë 1 kg në

¹⁵³² 15.10.2015, f 10

¹⁵³³ 14.10.2015, f. 25-26; 15.10.2015, f. 8

¹⁵³⁴ 14.10.2015, f. 26 – 27; 15.10.2015, f. 11

¹⁵³⁵ 15.10.2015, f. 12

¹⁵³⁶ . 12 - 13

15.10.2015, f

muaj, zakonisht është paguar paraprakisht. Çmimi për heroinë ka qenë 2 – 7 euro për gram, speed – 3000 – 3500 euro për kilogram. ¹⁵³⁷

1303. K3 i ka njoftuar bashkëpunëtorët e tij më të afërt lidhur me këtë bashkëpunim me L.K. ¹⁵³⁸

1304. Në kontrast me tregimin e detajuar të cili e kishte dhënë lidhur me Liridion N.K., K3 nuk ka dhënë ndonjë fakt të veçantë në lidhje me N.K.

1305. K3 ka thënë se ka qenë i bindur se N.K. e ka ditur që K3 po bashkëpunonte me L.K., sepse ka qenë gjoja e pamundur që ai mos ta dinte. ¹⁵³⁹ Ai nuk e ka shpjeguar se pse nuk ka pasur një mundësi të tillë.

1306. K3 ka thënë në mënyrë të përgjithësuar se ai blinte drogë nga N.K. dhe L.K. në vitet 2009 – 2012. ¹⁵⁴⁰ Ai ka marrë drogë nga ky burim më rrallë se sa nga vendet tjera. Atij nuk i kujtohej saktësisht sa herë. ¹⁵⁴¹ Herën e fundit ai ka marrë drogë nga L.K. dy ose tri ditë para ikjes së tij. ¹⁵⁴² Ai nuk ka përshkruar ndonjë rast kur ai ka blerë drogë nga N.K.

1307. Përkundër deklaratës së përgjithshme se N.K. po trafikonte drogë, K3 ka thënë se në fakt askush nuk i kishte treguar atij në lidhje me bashkëpunimin me N.K. K3

¹⁵³⁷ 14.10.2015, f. 26 – 27, 28

¹⁵³⁸ 15.10.2015, f. 18

¹⁵³⁹ 14.10.2015, f. 29

¹⁵⁴⁰ 14.10.2015, f. 34

¹⁵⁴¹ 15.10.2015, f. 3

¹⁵⁴² 15.10.2015, f. 4

15.10.2015, f

asnjëherë nuk ka takuar ndonjë person i cili ka bashkëpunuar drejtpërdrejtë me N.K. ose njerëzit përreth tij. ¹⁵⁴³

1308. Ai ka dëgjuar nga Da.E. dhe anëtarët e grupit të tij, nga D.Ri. dhe H.Ha. se N.K. ka qenë në biznesin e drogës. Ai gjithashtu e ka bazuar këtë informatë në atë çfarë ka dëgjuar nga polici A.Kar..¹⁵⁴⁴Kjo thashetheme është konsideruar nga gjykata si e pavërtetuar. Në të njëjtën kohë ai nuk ka paraqitur asnjë fakt të veçantë që vërteton se N.K. ka qenë i përfshirë në trafikimin e drogës.

1309. K3 ka dëshmuar se në pranverën e vitit 2012, pas aranzhimit nga S.Pe., ai ka marrë pjesë në një takim në restorantin e quajtur Lozovacka Cesta, në autostradën Nish – Beograd. N.K. dhe djali i tij Liridoni kanë qenë të pranishëm atëherë. Aty gjithashtu kanë qenë edhe persona të tjerë, sidoqoftë K3 ka refuzuar t'i tregojë emrat pasi thoshte se do ta rrezikonte sigurinë e tij. ¹⁵⁴⁵

1310. K3 nuk e ka ditur temën e takimit. Ai nuk ka dashur të tregojë se kush e kishte ftuar atë për këtë takim. Ai ka ardhur dhe i ka përshëndetur të gjithë. Ai nuk e ka njohur N.K., ata nuk ishin prezantuar me njëri tjetrin. Ata nuk kanë biseduar me njëri tjetrin. Ai ka folur pak me Liridion N.K., por asgjë në lidhje me biznesin. ¹⁵⁴⁶ Ka qenë hera e vetme kur K3 e ka takuar N.K. Ai asnjëherë nuk ka biseduar me atë. ¹⁵⁴⁷

1311. K3 nuk e ka paraqitur çfarë ka ndodhur gjatë atij takimi. Në veçanti, ai nuk ka paraqitur asgjë që do të mund të vërtetonte përfshirjen e N.K në trafikimin e

¹⁵⁴³ . 14

¹⁵⁴⁴ 15.10.2015, f. 18

¹⁵⁴⁵ 14.10.2015, f. 20-21

¹⁵⁴⁶ 14.10.2015, f. 21-22

¹⁵⁴⁷ . 16

15.10.2015, f

drogës.

1312. K3 ka thënë se takimi ka qenë i domosdoshëm sepse shumë dërgesa janë kapur dhe se kishte probleme në kufij. Gjatë kësaj periudhe kishte trazira në veri të Kosovës, kishte më shumë policë, gjithashtu ishin përfshirë edhe helikopterë.

Prandaj, më shumë drogë ishte konfiskuar¹⁵⁴⁸ Ai nuk ka shpjeguar se si ky takim do të duhej ta ndryshonte situatën.

1313. Pretendimet e K3 në lidhje me rastin e vetëm kur është takuar me N.K. janë konfuze dhe shumë të paqarta për të shërbyer si një shembull i aktivitetit të pretenduar kriminal të N.K.

1314. K3 ka thënë se a njihnte K1 dhe dinte gjëra për të. Ai ka thënë se ai po bashkëpunonte me N.K. me drogë. Kur është pyetur se si e dinte këtë, ai ka thënë se së pari duhet të konsultohet me prokurorin.¹⁵⁴⁹ Në fund, ai nuk ka paraqitur asnjë fakt lidhur me bashkëpunimin e K1 me N.K.

1315. Sipas K3, S.Pe. e njihnte N.K. për një kohë të gjatë dhe lidhja e tyre ka qenë e karakterit kriminal. Kur është pyetur lidhur me detajet, K3 ka thënë vetë ai e ka njohur L.K. prej vitit 2009 dhe kishte marrë drogë nga ai. Prandaj, ai ka përfunduar se vjehri i tij dhe N.K. me siguri kanë pasur lidhje të njëjtë.¹⁵⁵⁰ Ai nuk ka dhënë asnjë arsye bindëse për këtë përfundim.

1316. K3 është larguar nga organizata e tij në tetor 2012 për shkak të një konflikti të brendshëm. Ka rezultuar nga fakti se prej vitit 2008 ai ka bashkëpunuar me policinë dhe konkurrentët e tij në biznesin e drogës i kishte raportuar tek ata. Përveç kësaj, dikush që ka punuar me të është bërë i varur nga droga dhe kishte filluar biznesin e tij. K3 ka rënë në konflikt dhe ka ikur nga shteti, gjithashtu për

¹⁵⁴⁸ 14.10.2015, f. 33-34

¹⁵⁴⁹ 14.10.2015, f. 42-43

¹⁵⁵⁰ 14.10.2015, f. 24-25

shkak se njerëzit e tjerë ishin informuar në lidhje me bashkëpunimit të K3 me policinë.¹⁵⁵¹

1317. Ai ka rënë në kontakt me EULEX-in përmes policisë së Suedisë ku e njihnte një person. Ai e ka bërë këtë sepse ishte duke u ndjekur nga ish bashkëpunëtorët e tij. Madje ka pasur edhe të shtëna dhe disa persona janë plagosur. Ai ka rënë në kontakt me policinë dhe prokurorinë disa muaj pas ikjes së tij. Policia në ndërkohë po e verifikonte informatën e pranuar nga ai. Ai nuk ka dashur ta jap emrin e këtij personi sepse nuk donte ta ekspozonte atë ndaj rrezikut. Pastaj, ai është drejtuar në organizatën emrin e së cilës nuk ka mundur ta zbulojë.¹⁵⁵²

1318. Nuk ka pasur asnjë hetim penal kundër tij për pjesëmarrje në organizatën e drogës. Gjykimi kundër N.K ka qenë i pari kur ai ka dëshmuar.¹⁵⁵³

1319. Gjatë marrjes së tërthortë në pyetje, K3 ka dëshmuar se ai nuk ka qenë në kontakt me S.Pe. prej 22 tetorit 2012, për herë të fundit.¹⁵⁵⁴ Vjehri i tij me gruan dhe vajzën e tij e kanë vizituar K3 dhe gruan e tij në Beograd për herë të fundit në korrik të vitit 2011, pas lindjes së djalit të tyre.¹⁵⁵⁵ Fillimisht, askush nuk e ka ditur që ai është martuar. Aty ka pasur vetëm dëshmitarë të pranishëm në ceremoni. Ai e ka bërë këtë për ta mbrojtur veten dhe gruan e tij. Ai kishte

¹⁵⁵¹ 14.10.2015, f. 35 - 36

¹⁵⁵² 14.10.2015, f. 36-37

¹⁵⁵³ 14.10.2015, f. 37

¹⁵⁵⁴ 15.10.2015, f. 23

¹⁵⁵⁵ 27.10.2015, f. 3

frikë nga arrestimi. ¹⁵⁵⁶

1320. K3 e ka mohuar se gruaja e tij nuk ka folur me S.Pe. gjatë periudhës 2006 – 2011. S.Pe. ka qenë njëra prej arsyeve se pse i është dashur të ikë. ¹⁵⁵⁷

1321. K3 është pyetur nga mbrojtja nëse ka aplikuar për statusin e imigrantit në Suedi dhe nëse i është dashur të gënjejë për ta marrë statusin e dëshmitarit të mbrojtur nga EULEX-i. K3 është përgjigjur në mënyrë të paqartë se nuk ka qenë ashtu, por në të njëjtën kohë ai e ka pranuar se ka qenë pjesërisht e vërtetë. Ai ka kërkuar një pauzë para se të përgjigjej. ¹⁵⁵⁸

1322. Dhe pas pauzës ai nuk ka qenë në gjendje të dëshmojë për shkak të hiperventilimit. Pauza është zgjatur. ¹⁵⁵⁹

1323. Pas rifillimit të procedurës, K3 ka refuzuar të flasë në lidhje me arsyet e aplikimit të tij për statusin e imigrantit në Suedi. Më vonë, ai ka thënë se ka kërkuar azil dhe mbrojtje. Ai ka shpjeguar se i ishte refuzuar azili sepse Serbia konsiderohej si shtet i sigurt. Më tutje, ai ka kontaktuar me policinë e Suedisë, u ka dhënë disa informata të cilat janë verifikuar me autoritetet e Serbisë. Ai ka aplikuar për azil për shkak se është kërcënuar nga ish bashkëpunëtorët e tij. ¹⁵⁶⁰
Në aplikacionin e tij, ai ka treguar aktivitetet e tij kriminale dhe konfliktet me njerëzit e tjerë. Atij nuk i kujtohej nëse e ka përmendur N.K. ose djalin e tij

¹⁵⁵⁶ 27.10.2015, f. 12 -13

¹⁵⁵⁷ 27.10.2015, f. 13

¹⁵⁵⁸ 15.10.2015, f. 29

¹⁵⁵⁹ 15.10.2015, f. 30

¹⁵⁶⁰ 15.10.2015, f. 31

aty.¹⁵⁶¹

1324. Ai është kthyer nga Suedia në qershor të vitit 2013. Ai nuk ka dashur të përgjigjet në pyetjen nëse më pas e ka kontaktuar EULEX-in në mënyrë të drejtpërdrejtë. Ai ka qenë në kontakt me EULEX-in përmes organizatave të ndryshme. Ai ka shpjeguar se tashmë ka qenë në kontakt me EULEX-in gjatë qëndrimit të tij në Suedi. Ai u ka dërguar atyre email. Ai e ka bërë këtë gjatë negociatave me përfaqësuesit e policisë së Suedisë që ka çuar në bashkëpunimin e mëtutjeshëm me EULEX-in dhe me dy organizata tjera për zbatimin e ligjit.¹⁵⁶² Ai ka refuzuar t'i tregojë emrat e tyre. Ai është inkurajuar nga anëtarët e këtyre dy organizatave që të kontaktojë me EULEX-in.¹⁵⁶³ Ai ka dërguar shumë emaila EULEX-it.¹⁵⁶⁴ Ai gjithashtu ka biseduar me personat nga EULEX-i përmes telefonit.¹⁵⁶⁵ Më vonë ai e ka pranuar se ka biseduar me A.Ha..¹⁵⁶⁶

1325. Ai ka refuzuar t'i përgjigjet pyetjes se çfarë po negocionte me policinë e Suedisë. Ai e ka pranuar se prokuroria e ka ditur këtë.¹⁵⁶⁷

1326. Ai ka vendosur të dëshmojë kundër N.K pasi është kthyer në Beograd dhe pas diskutimeve me organizatat tjera. Atij i janë afruar ata.¹⁵⁶⁸

¹⁵⁶¹ 15.10.2015, f. 39

¹⁵⁶² 15.10.2015, f. 33

¹⁵⁶³ 15.10.2015, f. 40

¹⁵⁶⁴ 15.10.2015, f. 42

¹⁵⁶⁵ 15.10.2015, f. 43

¹⁵⁶⁶ 15.10.2015, f. 44

¹⁵⁶⁷ 15.10.2015, f. 34

¹⁵⁶⁸ 15.10.2015, f. 32-33

1327. Ai e ka pranuar se ka marrë disa garanci nga autoritetet e Serbisë se nuk do të burgosej.¹⁵⁶⁹ Ai gjithashtu e ka pranuar se ka marrë garanci se nuk do të akuzohet nga organizatat tjera me të cilat ka negociuar.¹⁵⁷⁰
1328. K3 ka pohuar se nuk e ka ditur kur është arrestuar N.K. Sidoqoftë, ka ndodhur pas negociatave të tij.¹⁵⁷¹ Ai nuk ka dashur të tregojë nëse e ka përemndur emrin e N.K. elemndit gjatë negociatave. Ai ka thënë se ata kanë diskutuar shumë gjëra, dhe emri i N.K nuk ka qenë relevant në atë kohë. Atij nuk i kujtohej se kur është bërë relevant.¹⁵⁷² K3 i kujtohej se N.K. është arrestuar kur K3 ka ardhur në Beograd. Atij nuk i kujtohej kush i ka treguar për këtë arrestim.¹⁵⁷³
1329. Atij nuk i kujtohej kur e ka përmednur N.K. dhe L.K. për herë të parë. Fillimisht, K3 i është shmangur bisedës në lidhje me N.K. sepse ka qenë në situatë ekstreme, shumë i pasigurt kur shumë persona po mundoheshin ta gjejnë atë. Ai po mendohej të kuptonte se çfarë opsione kishte atëherë.¹⁵⁷⁴
1330. Në ditën e fundit të dëshmisë së tij, gjatë rimarrjes në pyetje K3 ka shpjeguar se atij i është dhënë statusi i dëshmitarit të mbrojtur në shtator të vitit 2013.¹⁵⁷⁵ Institucionet në vijim janë përfshirë në negociatat me atë: EULEX-i, policia e Suedisë, INTERPOL, policia e Serbisë– Departamenti për Narkotikë dhe Drogë. Ai e ka pranuar se gjithashtu edhe FBI dhe DEA kanë qenë të përfshira në këtë

¹⁵⁶⁹ 15.10.2015, f. 35

¹⁵⁷⁰ 15.10.2015, f. 35-36

¹⁵⁷¹ 15.10.2015, f. 45

¹⁵⁷² 15.10.2015, f. 45

¹⁵⁷³ 15.10.2015, f. 46

¹⁵⁷⁴ 15.10.2015, f. 46-47

¹⁵⁷⁵ 28.10.2015, f. 37

proces.¹⁵⁷⁶

1331. K3 ka pohuar se ai u ka dorëzuar hetuesve shumë dokumente. Ai është i befasuar që ato nuk i janë dhënë gjykatës.¹⁵⁷⁷

1332. Tregimi i K3 lidhur me negociatat e tij me autoritetet e ndryshme për zbatimin e ligjit tregojnë qartë se ai i ka përdorë deklaratat e tij si një kartë për negociata për të përfituar avantazhe të caktuara.

Dëshmitari i mbrojtjes– S.Pe.

1333. Mbrojtja ka propozuar që të dëgjohet si dëshmitar S.Pe., i cili është përmendur në shumë raste në kontekst kriminal nga dëshmitari K3. S.Pe. nuk është marrë në pyetje gjatë fazës së hetimit.

1334. S.Pe. ka dëshmuar se ka qenë vjehëri i K3. Ai nuk ka asnjë kontakt me vajzën e tij që nga viti 2006. Ata kanë rikrijuar një lloj lidhje vetëm në vitin 2011 e cila ka zgjatur vetëm për disa muaj. Që nga atëherë ata nuk kanë pasur asnjë kontakt.

¹⁵⁷⁸ Gjatë kësaj periudhe, ata janë takuar tri apo katër herë. Ai ka mësuar një vit më vonë nga djali i tij, se vajza e tij ishte martuar.¹⁵⁷⁹ Ata nuk kanë pasur marrëdhënie të mira, për shkak se K3 ishte i prirë ndaj narkotikëve. Ata nuk kanë pasur asnjë lidhje biznesi.¹⁵⁸⁰

¹⁵⁷⁶ 28.10.2015, f. 37 – 38, 40

¹⁵⁷⁷ 28.10.2015, f. 40

¹⁵⁷⁸ 10.11.2015, f. 6, 7, 19

¹⁵⁷⁹ 10.11.2015, f. 7

¹⁵⁸⁰ 10.11.2015, f. 7

1335. S.Pe. e ka mohuar njohjen e N.K. Ai për herë të parë e ka takuar atë gjatë seancës gjyqësore. Ai ka dëgjuar për të nga mediat. Ai nuk e ka njohur asnjë anëtarë të familjes së N.K.¹⁵⁸¹ Ai nuk e ka vënë K3 në kontakt me N.K. ose me ndonjë anëtarë të familjes së tij.¹⁵⁸² Ai nuk e ka vënë në kontakt K3 me L.K. Ai e ka mohuar të ketë pasur ndonjë bisedë me K3 lidhur me N.K. Ai e ka mohuar çfarëdo përfshirje në biznesin e drogës apo ndonjë aktivitet tjetër kriminal.¹⁵⁸³

1336. S.Pe. ka mohuar të ketë qenë i përfshirë në biznesin e drogës. Ai nuk i ka ndihmuar K3 në asnjë biznes. K3 nuk i ka dhënë para atij, ai nuk ka qenë në gjendje ta mbajë familjen e vet.¹⁵⁸⁴

1337. S.Pe. ka qenë i sigurt se K3 asnjëherë nuk është takuar me N.K.¹⁵⁸⁵¹⁵⁸⁶ Ai ka thënë se N.K. njihej si biznesmen serioz dhe K3 nuk ka pasur shanse t'i afrohet atij.

¹⁹⁰²

1338. **N.K.** e ka mohuar njohjen e K3 dhe S.Pe. Ai asnjëherë nuk është takuar me asnjërin prej tyre, e as nuk kishte bërë ndonjë biznes me ta. Ai ka shpjeguar se që nga viti 2004 ai asnjëherë nuk ka qenë në Serbi.¹⁵⁸⁷

Përfundim – K3

1339. Gjykata ka gjetur se dëshmia e K3 nuk ka asnjë vlerë provuese për lëndën në

¹⁵⁸¹ 10.11.2015, f. 8

¹⁵⁸² 10.11.2015, f. 9

¹⁵⁸³ 11.11.2015, f. 4-6

¹⁵⁸⁴ 10.11.2015, f.11-12

¹⁵⁸⁵ 11.11.2015, f. 10-11

¹⁵⁸⁶ 11.11.2015, f. 11

¹⁵⁸⁷ 18.01.2018, f. 54

fjalë. Dëshmitari ka përshkruar përfshirjen e tij në trafikimin e drogës, sidoqoftë, ai nuk ka dhënë asnjë detaj për operacionet e N.K.

1340. Është bërë e qartë se K3 nuk kishte njohuri të drejtpërdrejtë në lidhje me përfshirjen e pretenduar të N.K. në trafikimin e drogës. Ai i referohej disa supozimeve të cilat i ka bërë ose të ashtuquajtura njohuri të përgjithshme. Ai ka pohuar se është takuar me N.K. një herë në Serbi, sidoqoftë prokuroi nuk ka paraqitur asnjë provë për ta mbështetur këtë pretendim. I akuzuari ka mohuar të ketë hyrë në Serbi që nga viti 2004, dhe nuk ka asnjë arsye për mos t'i besuar atij, sidomos për shkak të situatës politike të njohur mirë në rajon.

1341. Gjykata nuk ka gjetur asnjë arsye që ta diskreditojë dëshminë e S.Pe.

1342. Autoritetet kompetente të Mbretërisë së Suedisë nuk i kanë paraqitur gjykatës dokumentet për procedurën e azilit në rastin e K3.¹⁵⁸⁸

Përfundim – pika 3

1343. Pas vlerësimit të provave të paraqitura nga prokurori për ta mbështetur pikën 3 të aktakuzës e cila i referohet krimit të organizuar në lidhje me trafikimin e drogës, gjykata ka gjetur se prokurori nuk ka paraqitur prova të mjaftueshme për t'i mbështetur pretendimet e tij. Ky pretendim është bazuar në dëshmitë e dëshmitarit bashkëpunues K1, e cila është vlerësuar si e pavërtetë dhe jo e besueshme. Fletorja e K1 e cila është paraqitur për ta vërtetuar deklaratën e këtij

¹⁵⁸⁸ NJN kërkesa për Suedinë, 20.10.2015;

dëshmitari është vlerësuar si jo e besueshme pasi që ekzistojnë indikacione të fuqishme se është fabrikuar posaçërisht për këtë gjykim. Dëshmia e K3 nuk kishte asnjë vlerë provuese.

4.12. N.K. dhe njohja e tij me K2

1344. Gjykata ka përfunduar se K2 dhe N.K. e kanë njohur njëri tjetrin. Kjo gjetje mbështetet me dëshminë e besueshme të J.J., e cila është vërtetuar me pjesët korresponduese të deklaratës së R.L., K1 dhe K2. Prandaj, gjykata e ka vlerësuar mohimin e N.K. për njohjen e tij me K2 si të jo të besueshme dhe me qëllim për ta mbrojtur vetën.

Përmbledhje e provave

1345. I akuzuari vazhdimisht e ka mohuar të ishte takuar ndonjë herë me K2 dhe se ka pasur ndonjë kontakt me të.

1346. **K2** ka dëshmuar se kishte dëgjuar në lidhje me N.K. në vitin 1990, kur ai ka qenë në burg. Ai e ka takuar atë në vitin 1993 në stacionin e policisë në Pejë dhe me këtë rast N.K. ka intervenuar dhe K2 është liruar nga arresti.¹⁵⁸⁹ Ata kanë qenë fqinjë në Pejë. 2 - 3 ditë pas situatës në stacionin e policisë, K2 e ka falënderuar N.K. për ndihmën dhe kanë pasur një bisedë të shkurtër.¹⁵⁹⁰ Pas kësaj, ai ka pasur kontakte të shumta me N.K. në lidhje me valutat dhe arin të cilat N.K. i ka blerë nga K2 në 3 raste. Herën e fundit, ai nuk i ka pranuar paratë për këtë, por 10 pasaporta të zbrazëta të Jugosllavisë dhe një pistoletë. Ka qenë

¹⁵⁸⁹23.02.2017, f. 4-5

¹⁵⁹⁰23.02.2017, f. 4-5

më 1994 ose 1995. Të gjitha këto situata kanë ndodhur në Pejë.¹⁵⁹¹

1347. **N.K.** i ka mohuar këto rrethana. Ne deklaratën e tij ai ka theksuar se ai nuk ka mundur ta ndihmojë K2 nga burgu sepse ai as nuk ka qenë polic, e as nuk ka bashkëpunuar me autoritetet e asaj kohe. Për ta mbështetur pretendimin e tij, ai ka treguar se më 1993 ai është burgosur për 39 ditë për shkak të disa problemeve në lidhje me cigaret me të cilat po merrej.¹⁹⁰⁸

1348. **K2** është larguar nga Kosova në vitin 1997 dhe ka shkuar në Mostar. Ai e ka takuar N.K. në Bosnje në vitin 1998 në restorantin Mlin. Ka qenë një problem sepse dikush ishte rrëmbyer. Të pranishëm ishin: Fadili, njerëzit e N.K, R.Ka. nga Tuzlla. Kishte një lloj feste aty.¹⁵⁹² Në atë kohë K2 por trafikonte armë, por jo drogë.¹⁵⁹³

1349. Sipas **K2**, N.K. ka qëndruar në Kosovë deri në fillim të luftës. Pastaj ai ka shkuar në Bosnje, ai ka jetuar midis Tuzllës dhe Sarajevës. K2 është takuar me atë në shumë raste në takime joformale.¹⁵⁹⁴ Ai ka specifikuar se kanë qenë rreth 5 - 10 takime në periudhën 1997 – 2001. Ai asnjëherë nuk e ka parë N.K. vetëm, atij nuk i kujtoheshin emrat e personave të cilët ishin me atë, sepse nuk kishin ndonjë rëndësi për të. Asnjëri nga këto takime nuk ishte i lidhur me aktivitete

¹⁵⁹¹23.02.2017, f. 6 ¹⁹⁰⁸

18.01.2018, f. 13 - 14

¹⁵⁹²23.02.2017, f. 8-9

¹⁵⁹³23.02.2017, f. 9

¹⁵⁹⁴23.02.2017, f. 10

kriminale.¹⁵⁹⁵

1350. Në vitin 2000, K2 dhe N.K., i shoqëruar nga një person tjetër janë takuar në Sarajevë, në restorantin “Papagaj” ose “Gaj” në lagjen Kiseljak. Atëherë, N.K. i ka kërkuar ta vozisë një burrë të ri në një vend ku ishte planifikuar të hidhej një bombë për shkak të disa çështjeve të pazgjidhura. K2 ka refuzuar dhe ka bërë shaka se do të mund të dërgohej për ta hequr dikë, por jo për të hedhur bombë në oborr. Më vonë kanë ardhur S.L. dhe E.Dz. Gjatë takimit K2 u ka dhënë atyre një revole, ndërsa burri i cili e shoqëronte N.K. u ka dhënë një kuti të vogël me kokainë.¹⁵⁹⁶ S.L. dhe E.Dz. kanë ardhur sepse kishte nevojë që të rregullohen disa borxhe.¹⁵⁹⁷¹⁵⁹⁸

1351. Në vitin 2001 ata janë takuar në Rozhajë, në picerinë ”Still” në pronësi të një burri me nofkën “Me.”. N.K. i ka ofruar atij një punë që përbënte transportimin e heroinës nga Bosnja në Angli. K2 ka refuzuar. N.K. nuk ka dhënë ndonjë detaj.

1915

1352. N.K. merrej me naftë, dizell, cigare dhe çfarëdo aktiviteti profitabil. K2 nuk e din nëse ai është marrë me ndonjë aktivitet tjetër ilegal përveç drogës.¹⁵⁹⁹

1353. N.K.ka mohuar të ketë ndodhur ndonjëri nga takimet ndonjëherë. Ai ka qenë konsekuent në pohimin se asnjëherë nuk e ka takuar K2.

Përfundim

¹⁵⁹⁵23.02.2017, f. 11 - 12

¹⁵⁹⁶23.02.2017, f. 16-18

¹⁵⁹⁷28.02.2017, f. 5

¹⁵⁹⁸23.02.2017, f. 12-14

¹⁵⁹⁹28.02.2017, f. 7 -8

1354. Gjykata ka përfunduar se nuk është vërtetuar se K2 dhe N.K. janë takuar në rrethanat e përmendura nga dëshmitari K2. Nuk ka asnjë provë e cila e vërteton dëshminë e K2.

Udhëtimi i K2 në Turqi, 2001

1355. Sipas **K2**, në vitin 2001 ai ka udhëtuar me R.L. në Turqi, Stamboll. Ai ka shkuar atje me kërkesë të N.K. Kur është nisur për në Turqi, K2 nuk e ka ditur se çfarë ka dashur N.K. nga ai.¹⁶⁰⁰
1356. N.K. dhe K2 janë takuar në hotel Zagreb në Stamboll. R.L. dhe “Me.” kanë qenë në restorant; ata kanë përshëndetur njëri tjetrin, por ishin ulur në tavolina të ndara, në kabina të ndara. N.K. i ka ofruar K2 100.000 KM për ta vrarë një person i cili nuk kishte paguar për heroinë. K2 ka refuzuar.¹⁶⁰¹ **R.L.**
1357. R.L. është propozuar si dëshmitar nga mbrojtja.
1358. Ai është zejtar, merrej me stoli të çmuara në Gjakovë prej vitit 1993.¹⁶⁰² Ai është takuar me K2 në Gjakovë në vitin 2000. K2 ka qenë myshteri i tij i cili ka blerë ari nga ai. Lidhja e tyre ka qenë miqësore, ata nuk kanë pasur ndonjë biznes së bashku.¹⁶⁰³
1359. R.L. ka konfirmuar se më 2001 ose 2002 ka udhëtuar së bashku me K2 në Stamboll me aeroplan nga Prishtina. Ata kanë qëndruar atje 3 – 4 ditë në hotelin “Zagreb”. Ata nuk kanë kaluar shumë kohë së bashku, vetëm kur janë kthyer në dhomën e hotelit të cilën e ndanin. Gjatë ditës ka qenë e qartë se ata shkonin në pazar.¹⁶⁰⁴

¹⁶⁰⁰23.02.2017, f. 15, 17

¹⁶⁰¹23.02.2017, f. 18 -19; 28.02.2017, f. 5

¹⁶⁰² 27.01.2017, f. 21

¹⁶⁰³ 27.01.2017, f. 21-22

¹⁶⁰⁴ . 23

27.01.2017, f

1360. Ata e kanë takuar N.K. në një argjendari. R.L. nuk e ka njohur atë, por K2 i ka treguar se është N.K.¹⁶⁰⁵ Pas një pushimi të shkurtër në seancën e shqyrtimit gjyqësor, R.L. i pyetur nga mbrojtja ka thënë se N.K. e ka parë vetëm në TV. Ai ka theksuar se K2 asnjëherë nuk ia ka përmendur atij N.K.¹⁶⁰⁶
1361. Gjatë marrjes së tërthortë në pyetje R.L. është ballafaquar me këtë deklaratë të bërë gjatë marrjes së drejtpërdrejt në pyetje kur ka thënë se e kishte parë N.K. në Stamboll dhe ka qenë K2 ai i cili i kishte thënë se është N.K. Kur është pyetur në lidhje me këtë përgjigje e cila e kundërshtonte atë që ka thënë më vonë, R.L. ka thënë se e kishte keqkuptuar pyetjen. Ai ka menduar ishte në lidhje me atë që prokurori e kishte pyetur më parë.¹⁶⁰⁷ Kur është pyetur se pse menjëherë ka folur për N.K., madje edhe duke i treguar atij me kokë, ai është përgjigjur se vetëm për një moment të shkurtër atij i është kujtuar se prokurori e kishte pyetur nëse e njeh N.K. Ai e kishte parë atë vetëm në TV.¹⁶⁰⁸
1362. R.L. gjithashtu është ballafaquar me deklaratën e tij të mëparshme të dhënë më 31 mars 2014, f. 206. Atëherë, ai ka thënë se me këtë rast gjatë udhëtimit në Turqi me K2 ai është takuar me N.K. për herë të parë. Gjatë marrjes së tërthortë në pyetje, R.L. ka shpjeguar se nuk është takuar me N.K. për herë të parë, por vetëm kishte dëgjuar për të për herë të parë. Në pyetjen se kur ka dëgjuar për herë të parë për N.K., ai ka thënë se nuk i kujtohet, sepse nuk ka qenë e rëndësishme për atë, por se ishte i sigurt se kishte dëgjuar nga K2. Atij nuk i

¹⁶⁰⁵ 27.01.2017, f. 23

¹⁶⁰⁶ 27.01.2017, f. 21-22

¹⁶⁰⁷ 27.01.2017, f. 25

¹⁶⁰⁸ 27.01.2017, f. 25

27.01.2017, f

kujtohej konteksti në të cilin K2 kishte folur për N.K.¹⁶⁰⁹
1363. Ai është ballafaquar më tutje me deklaratën e tij nga viti 2014 kur ka thënë se ata e kanë takuar N.K. në një dyqan të cilin e përshkruan si me shumë njerëz. Atij nuk i kujtohet ta ketë thënë këtë, nuk ka qenë e rëndësishme për të. Kur është pyetur përsëri nëse K2 është takuar me N.K. në një argjendari, ai ka thënë se nuk e kishte parë këtë dhe nuk e besonte.¹⁶¹⁰

Përfundim

1364. Gjykata nuk kishte asnjë dyshim se R.L. e ka thënë të vërtetë kur ka dëshmuar në mënyrë spontane se e kishte parë N.K. dhe K2 së bashku gjatë udhëtimit të tyre në Stamboll. Madje, është vërejtur se ai kishte bërë me kokë në drejtim të të akuzuarit kur e ka bërë këtë deklaratë. Tërheqja e tij e mëvonshme nga kjo pjesë e dëshmisë së tij ishte vetëm një përpjekje e papërshtatshme të dëshmojë siç ishte pritur nga mbrojtja. Për më tepër, gjatë marrjes së tij në pyetje gjatë hetimit, ai është ballafaquar me dëshmitë e tij të dhëna gjatë hetimit kur nuk ka pasur dyshime se e kishte parë K2 dhe N.K. së bashku në Stamboll.

1365. Prandaj, gjykata e konsideron të provuar se K2 dhe N.K. e kanë njohur njëri tjetrin dhe janë takuar në Stamboll. Kjo rezulton nga pjesa e dëshmisë së K2 e cila është konfirmuar nga dëshmitari R.L.

1366. Rrethanat tjera të takimit, posaçërisht subjektin e ofertës së bërë nga N.K. për K2, gjykata e ka gjetur të pa provuar. Nuk ka asnjë provë për t'i vërtetuar pretendimet e K2.**J.J.**

¹⁶⁰⁹ . 27-28

¹⁶¹⁰ . 28

27.01.2017, f

1367. J.J. ka qenë një dëshmitar tjetër relevant për të vërtetuar nëse K2 dhe N.K. e kanë njohur njëri tjetrin. Ai është propozuar nga prokuroria.
1368. **K2** ka dëshmuar se e ka njohur J.J. i cili ka qenë gjeneral i ushtrisë së Bosnjës dhe Hercegovinës. Ai e njeh N.K. Një herë K2 ka qenë së bashku me J.J. në Pejë ku janë takuar me N.K. në një pompë të benzinës, kjo ka ndodhë para shkuarjes së K2 në Turqi. J.J. dhe N.K. kanë pasur një bisedë të shkurtër. K2 ka pohuar se ai ka insistuar që mos t'i afrohet N.K. sepse sipas tij, askush nuk mund t'i afrohet atij pa e pasur miratimin paraprak.¹⁶¹¹
1369. **J.J.** ka qenë ushtar në Armatën e Jugosllavisë. Aktualisht ai është profesor i universitetit.¹⁶¹²
1370. Ai është takuar me N.K. në vitin 1998, në kompaninë e burrit të tezës së tij, H.H.K. Ka qenë në Sarajevë, në një kafeteri ku kanë qenë të pranishëm 5 – 6 persona.¹⁶¹³¹⁶¹⁴ Ata asnjëherë nuk kanë pirë kafe së bashku, ka mund të ndodhë që të takohen diku rastësisht, ata e kanë përshëndetur njëri tjetrin, por N.K. asnjëherë nuk ka qenë në rrethin e tij të shokëve.¹⁹³¹ H.H.K. ka ndërtuar apartamente në Ulqin dhe N.K. shkante aty për pushime me familjen e tij.¹⁶¹⁵
1371. J.J. e ka takuar K2 në Mostar në vitin 1997 ose 1998. K2 shiste vetura në Jabllanicë, kurse J.J. e kishte dyqanin e tij në Sarajevë. Ka ndodhur që kur J.J.

¹⁶¹¹ 23.02.2017, f. 28-29

¹⁶¹² 03.04.2017, f. 4

¹⁶¹³ 03.04.20

¹⁶¹⁴ ,f. 4 - 5

¹⁹³¹ 03.04

.2017, f. 5

¹⁶¹⁵ 03.04

nuk e kishte një veturë specifike në stok, ai i kontaktonte shitësit e tjerë.¹⁶¹⁶ J.J. nganjëherë shoqërohej me K2.¹⁶¹⁷

1372. J.J. ka qenë dy herë në Kosovë, në periudhën ndërmjet vitit 2000 dhe 2002. Në rastin e dytë, ai ka shkuar atje me K2 të cili ia kishte kërkuar këtë sepse K2 e dinte rrugën. Ata kanë udhëtuar në Prishtinë me Mercedes 123 ose 124. J.J. është ftuar aty nga shoku i tij A.Has. Me këtë rast, K2 i ka treguar J.J. vende të ndryshme në Kosovë.¹⁶¹⁸

1373. J.J. nuk e ka kontaktuar N.K. kur ka qenë në Kosovë. Ai e ka takuar atë një herë në një pompë të benzinës ku ishin ndalur rastësisht për të shkuar në tualet. Ky takim ka zgjatur 15 – 20 minuta. Biseda ka qenë shumë e përgjithshme. K2 ka qenë i pranishëm gjithashtu, ai është përshëndetur me N.K. J.J. nuk e ka pasur përshtypjen se ata ishin shokë të ngushtë por vetëm të njohshëm. N.K. ka qenë i ulur në tavolinën e tij, kurse ata në tavolinën e tyre.¹⁶¹⁹

1374. Më vonë J.J. ka dëgjuar që N.K. ka qenë pronar i asaj pompe të benzinës.¹⁶²⁰

1375. Ky ka qenë takimi i fundit me N.K., J.J. mund ta ketë parë atë përreth. Pas këtij udhëtimit në Kosovë, ai gjithashtu nuk është takuar me K2 përsëri. Në vitin 2002, J.J. është zhvendosur në Mostar.¹⁶²¹

1376. J.J. ka thënë se nuk ka qenë aq i afërt me K2, ai ka qenë vetëm një klient. Ai

¹⁶¹⁶ 03.04.2017, f. 6-7

¹⁶¹⁷ 03.04.2017, f. 7

¹⁶¹⁸ 03.04.2017, f. 7

¹⁶¹⁹ 03.04.2017, f. 8

¹⁶²⁰ 03.04.2017, f. 9

¹⁶²¹ 03.04.2017, f. 9, 12

vinte tek ai një herë në 3 – 4 muaj. Ata kanë udhëtuar vetëm një herë së bashku. Ai nuk ka qenë një klient i madh. Ai nuk e ka ditur se K2 ka shkuar me atë në Turqi, ai ka menduar se ai e ka një butik.¹⁶²²

1377. J.J. e ka mohuar se gjatë takimit të tij të rastësishëm në pompën e benzinës, K2 ka insistuar që mos të ulet me N.K., ndërsa J.J. ka dashur ta bëjë këtë.¹⁶²³

4.12.1. Përfshirja e K2 në trafikimin e drogës

1378. Pavarësisht nga dënimi përfundimtar për trafikim të drogës¹⁶²⁴, gjatë dëshmisë para gjykatës në Kosovë, **K2** vazhdimisht e ka paraqitur veten si luftëtar kundër drogës në Bosnje dhe Itali.¹⁹⁴² Gjykata nuk kishte asnjë dyshim se ai ka qenë thellësisht i përfshirë në trafikimin e drogës, e cila në mënyrë të qartë ka rezultuar veçanërisht nga dëshmitë e K1, S.A., H.Mu., M.Ha. të cilët në mënyrë konsistente e kanë paraqitur përfshirjen e tij në këtë aktivitet.

1379. Gjykata gjithashtu ka konstatuar se K2 në shumë raste e ka prezantuar veten si polic. Është konfirmuar nga dëshmitari Sa.Ku. i cili ka dëshmuar se K2 ka pasur një vizitë-kartë me emrin e tij, fotografinë dhe mbishkrimin “policia”¹⁶²⁵ dhe J.J. i cili ka thënë se K2 e ka përdorë një certifikatë e cila konfirmonte se ai ishte polic.¹⁶²⁶ Gjithashtu, H.Me. ka thënë se K2 e prezantonte veten si ish polic.¹⁶²⁷

¹⁶²²27.01.2017, f. 26-27

¹⁶²³ 03.04.2017, f. 11

¹⁶²⁴ Aktgjykimi i gjykatës së Bosnjës dhe Hercegovinës i datës 22 nëntor 2005

¹⁹⁴² 09.03.2017, f. 48

¹⁶²⁵ 17.03.2017, f. 25

.2017, f. 5

¹⁶²⁶ 03.04.2

¹⁶²⁷ 11.04.2017, f. 8-9

Përmbledhje e provave relevante

1380. **S.A.**ka dëshmuar se me K2 është takuar me Tuzëll në vitin 2003 ose 2004. Ai ka punuar për të, fillimisht ka transportuar argjend dhe drogë.¹⁶²⁸ Ai ka udhëtuar në Stamboll dhe Amsterdam.¹⁶²⁹ Ai i ka përshkruar në detaje situatat kur ai ka bartur argjend dhe drogë për K2. S.A. ka qenë një herë Amsterdam, dhe 3 – 4 herë në Turqi duke transportuar gjëra për K2.¹⁶³⁰
1381. Kur S.A. është përfshirë në drogë, emri i N.K. nuk është paraqitur asnjëherë. Ai nuk e ka njohur atë, ai kishte dëgjuar për N.K. vetëm nga mediat. Ai nuk është kërcënuar nga askush.¹⁶³¹
1382. Dëshmia e S.A. është vlerësuar nga gjykata si e besueshme. Ky dëshmitar është dukur të jetë i sinqertë dhe i besueshëm. Ai nuk ka pasur ndonjë motiv për të dëshmuar në mënyrë specifike, posaçërisht kur ai tashmë ishte dënuar për vepra penale në lidhje me trafikim të drogës. Ai i ka paraqitur rrethanat e përfshirjes së tij në trafikimin e drogës në mënyrë objektive, pa ekzagjerime. Në shumë raste, dëshmia e tij është përdorë në këtë aktgjykim për t'i vërtetuar provat e tjera të paraqitura në këtë gjykim, që është përmendur në pjesët relevante të këtij dokumenti. Ai gjithashtu ka qenë i bindur se N.K. nuk ka punuar me K2 në trafikimin e drogës.
1383. **M.Ha.** ka dëshmuar se e njihje K2 për më tepër 20 vite. Ata kanë qenë në

¹⁶²⁸ 30.01.2017, f. 5

¹⁶²⁹ 30.01.2017, f. 6

¹⁶³⁰ 30.01.2017, f. 24

¹⁶³¹ 30.01.2017, f. 23

marrëdhënie miqësore deri në rrëmbimin e shokut të saj Hasic Nadil.¹⁶³² K2 e ka pasur grup e tij kriminal. Sipas saj, anëtarë të tij kanë qenë K1 i cili gjithashtu ka qenë në grupin e Z.T. dhe H.Me.. Asaj nuk i kujtoheshin emrat e tjerë.¹⁶³³ K2 gjithmonë ka punuar në mënyrë të pavarur dhe gjithmonë ka qenë ai i cili e ka udhëhequr lojën. Ajo asnjëherë nuk ka takuar dikë tjetër në afërsi të tij që do të ishte mbi të.¹⁶³⁴

1384. Gjykata ka vlerësuar dëshminë e M.Ha. si të besueshme. Dëshmia e saj në shumë aspekte korrespondon me dëshmitë e dëshmitarëve të tjerë në këtë lëndë – posaçërisht me atë të H.Mu. dhe S.A.. Ajo nuk ka pasur asnjë dyshim se K2 ka qenë udhëheqës i grupit të tij i cili ka qenë i përfshirë në trafikimin e drogës.
1385. **H.Me.** është dënuar për trafikim të drogës, pjesëmarrje në vrasje, rrëmbim, posedim të paautorizuar të armëve.¹⁶³⁵
1386. Kur është pyetur nëse K2 ka qenë luftëtar kundër drogës, ai ka thënë se ai ka qenë diler i drogës. Ai ka thënë se do të dëshironte të largohet nga gjykatorja për të qeshur për 2 minuta pasi ka dëgjuar se K2 e ka prezantuar veten si luftëtar i drogës.¹⁶³⁶
1387. Ai ka dëshmuar në hollësi në lidhje me përfshirjen e tij në trafikimin e drogës me K2. Ai e ka takuar atë më 1998 ose në fillim të vitit 1999 në Tuzëll. K2 po kërkonte dikë për të punuar me të. Takimi është aranzhuar nga një i njohur i tyre i përbashkët. K2 dhe H.Me. janë pajtuar që të punojnë së bashku.¹⁶³⁷

¹⁶³² 31.01.2017, f. 6 – 7

¹⁶³³ 31.01.2017, f. 9 - 10

¹⁶³⁴ 31.01.2017, f. 37

¹⁶³⁵ 07.04.2017, f. 4 - 5

¹⁶³⁶ 11.04.2017, f. 8

1388. Fillimisht, H.Me. ka transportuar armë nga Bosnja dhe Herzegovina në Kosovë. Ata e kanë bërë këtë deri në vitin 1998 dhe 1999 deri në momentin kur K2 është arrestuar për rrëmbimin e “Md.”.¹⁶³⁸ Pas lirim të K2 nga burgu, ata kanë filluar me grabitjen e bankave dhe postave. Më pas, ata kanë hyrë në biznesin e drogës, ekstazisë dhe heroinës. Ka qenë pak a shumë në prill të vitit 2003.¹⁶³⁹
1389. Ideja për të filluar me drogë ka ardhë nga K1 dhe K2. K1 ka pasur më shumë përvojë në këtë fushë. K2 ka pasur një lloj reputacioni në botën e krimit, kështu që ka përfunduar në takimin me K1 dhe F.K.. K2 nuk zgjidhte kur bëhej fjalë për aktivitete kriminale.¹⁶⁴⁰ K2 i është bërë ofertë për të hyrë në biznesin e drogës nga K1, nga F.K. dhe një grup i ngushtë i njerëzve përreth tyre. Ata ishin Florin, “Va.”, Sami Kuci dhe disa Italianë.¹⁶⁴¹
1390. Kur është pyetur se si e dinte se K2 i ishte bërë ofertë, H.Me. ka thënë se ai e dërgonte K2 në takime, por ai qëndronte në veturë. Ai nuk ka qenë i pranishëm gjatë takimit të tyre të parë.¹⁶⁴²
1391. K1 u ofronte atyre informata në lidhje me bizneset tjera potenciale p.sh., që duhej rrëmbyer ose grabitur. Personat e tillë zakonisht ishin të përfshirë gjithashtu edhe në drogë.¹⁶⁴³ Kur i është kërkuar që t’i jap disa emra, ai ka thënë se e kishte të vështirë t’i kujtonte ata; sidoqoftë ai ka thënë se ka qenë

¹⁶³⁷ 07.04.2017, f. 5-6

¹⁶³⁸ 07.04.2017, f. 6-7

¹⁶³⁹ 07.04.2017, f. 8-9

¹⁶⁴⁰ 07.04.2017, f. 15

¹⁶⁴¹ 07.04.2017, f. 15, 18

¹⁶⁴² 07.04.2017, f. 15

¹⁶⁴³ 07.04.2017, f. 16

Shabani nga Prishtina, Milaimi nga Prishtina. Atij i kujtoheshin vetëm këta dy emra.¹⁶⁴⁴

1392. K2 ka pasur një Mercedes me një rezervuar special (1/3 për derivate dhe pjesa tjetër për kontrabandim të mallrave). Ai gjithashtu ka pasur një golf. Droga paketohej në shishe 0,5 l të coca – cola. Për paketim ata përdornin një shirit special, siç e përdorin hidraulikët.¹⁶⁴⁵
1393. H.Me. ka theksuar se ai asnjëherë nuk e ka parë N.K. K2 nuk ka punuar për N.K.¹⁶⁴⁶
1394. Gjatë marrjes së tërthortë në pyetje, H.Me. ka shpjeguar se ai ka dëshmuar në gjykimin kundër K2 dhe të tjerëve dhe se e ka thënë të vërtetën atëherë. K1 dhe K2 kanë qenë partner në biznesin me ekstazi dhe heroinë. K2 ka përfunduar në borxhe ndaj K1 kështu që ai ka dhënë si kompensim– të paktën një veturë, dhe e ka vendosur apartamentin e tij si hipotekë. Ky fakti i fundit ka qenë arsyeja pse është ndarë nga gruaja e tij Mi.Me.¹⁶⁴⁷
1395. Ai e ka përjashtuar të ketë qenë anëtar i grupit të N.K. Ai nuk e ka njohur atë, e as nuk ka qenë në dijeni se ai ka pasur ndonjë grup. Ai asnjëherë nuk ka transportuar drogë për atë. Ai i ka takuar grupit të K2 i cili ka qenë bos i të tjerëve, kurse H.Me. e shihte atë si partner. K1 ka qenë më tepër si bashkëpunëtor, njëjtë si H.Kr., E.Ko. dhe M.Ha.¹⁶⁴⁸

¹⁶⁴⁴ 07.04.2017, f. 16

¹⁶⁴⁵ 07.04.2017, f. 16-17

¹⁶⁴⁶ 07.04.2017, f. 26

¹⁶⁴⁷ 07.04.2017, f. 34

¹⁶⁴⁸ 11.04.2017, f. 5

1396. H.Me. është ballafaquar me deklaratat e tij të mëparshme nga viti 2013 – 2014 (faqet 273, 274 dhe 332). Atëherë ai ka thënë se e ka parë N.K. duke i shtrënguar duart me K2, e ka dëgjuar K2 duke e thirrë N.K. Ai e ka mohuar këtë.¹⁶⁴⁹ Ai gjithashtu e ka mohuar deklaratën e tij të mëparshme (f. 263) se N.K. i ka dhënë K2 60.000 euro për të paguar për ekstazi.¹⁶⁵⁰ Ai nuk ka dëshmuar i lirshëm atëherë, ai ka qenë nën presion nga K2 i cili gjithashtu i kishte dërguar disa njerëz për të ndikuar në të.¹⁶⁵¹
1397. **H.Mu.** e ka takuar K2 në vitin 2000 ose 2001 dhe kanë qenë shokë deri në dënimin e tij (2003 – 2004). Ata janë njoftuar me njëri tjetrin në Kosovë nga M.Be. i cili punonte për K2 si vozitës.¹⁶⁵²
1398. H.Mu. ka punuar për K2. Ai e ka vozitur K2 të paktën 15 herë nga Lukovac në Bosnje në Kosovë, kryesisht në Gjakovë, por gjithashtu edhe në Pejë. K2 ka qenë kontrabandues i armëve; ka qenë në vitin 2001 – 2003.¹⁶⁵³ Sipas H.Mu., K2 gjithashtu ka punuar për “Ro.,” “At.” dhe personin me nofkën “Te.”. “Ro.” ka pasur një dyqan të stolive të çmuara në Gjakovë.¹⁶⁵⁴
1399. H.Mu. e ka njohur H.Me. të cilin e ka takuar përmes K2 në Tuzëll. H.Me. dhe K2 kanë qenë shokë të mirë, H.Me. ka punuar për K2, ai i kryente të gjitha

¹⁶⁴⁹ 11.04.2017, f. 7

¹⁶⁵⁰ 11.04.2017, f. 7

¹⁶⁵¹ 11.04.2017, f. 8

¹⁶⁵² 27.01.2017, f. 5-6

¹⁶⁵³ 27.01.2017, f. 7-8

¹⁶⁵⁴ 27.01.2017, f. 8

llojet e punëve për të (grabitje, drogë, kontrabandim të armëve).¹⁶⁵⁵ Ai gjithashtu e ka njohur edhe dashnoren e tij, Larisa, sidoqoftë ai nuk e dinte nëse ajo ka punuar për K2.¹⁶⁵⁶

1400. H.Mu. e ka njohur S.A. të cilin e ka takuar përmes M.Be.. S.A. ka punuar për K2 si vozitës. Ai transportonte ari, para dhe armë.¹⁶⁵⁷

1401. Ai e ka takuar një herë K1 në Tuzël. Ata kanë pirë kafe së bashku me K2. Ka qenë në periudhën në mes të vitit 2001 dhe 2003. K1 dhe K2 po flisnin në gjuhën shqipe, prandaj H.Mu. nuk i kuptonte. Ky takim ka qenë një apo dy ditë para se S.A. të shkonte në Turqi. H.Mu. ka shpjeguar se e ka ditur emrin e K1 sepse e kishte dëgjuar shumë herë në gjykatë.¹⁶⁵⁸

1402. H.Mu. nuk e ka njohur N.K.¹⁶⁵⁹ H.Mu. asnjëherë nuk ka dëgjuar nga K2 ose ndonjë person tjetër për N.K.¹⁶⁶⁰

1403. K2 e thërriste H.Mu. kurdo që kishte nevojë për të. Nuk ka ndodhur që ata të kalojnë disa ditë së bashku. Më vonë, H.Mu. e ka njoftuar K2 me H.Me., dhe pastaj ata kanë kaluar më shumë kohë së bashku.¹⁶⁶¹

Përfundim

1404. Gjykata ka vlerësuar deklaratat e H.Mu. si të besueshme dhe të vërteta. Përmbajtja e tyre korrespondon me provat e tjera të mbledhura në këtë lëndë. Ky është dëshmitari i ardhshëm i cili ka mohuar njohurinë për veprimet e

¹⁶⁵⁵ 27.01.2017, f. 11

¹⁶⁵⁶ 27.01.2017, f. 11-12

¹⁶⁵⁷ 27.01.2017, f. 12

¹⁶⁵⁸ 27.01.2017, . 13-14

¹⁶⁵⁹ 27.01.2017, f. 15

¹⁶⁶⁰ 27.01.2017, f. 17

¹⁶⁶¹ 27.01.2017, f. 19

ndërmarra nga N.K.

4.13. Pika 4

Sipas aktakuzës:

Përafërsisht në shkurt të vitit 2003, N.K. vazhdimisht i është afruar K2, dhe i ka kërkuar atij që të transportojë heroinë për të në Angli. K2 përfundimisht ka udhëtuar me aeroplan për në Turqi, ka marrë 50 kilogramë “Heroinë të bardhë” nga një person i quajtur H.Kr., i ka fshehur ato në dy paketa të mëdha të rrobave dhe ka aranzhuar që ato të transportohen në Tuzëll në Bosnje dhe Hercegovinë. Vozitësi i K2, S.A., pastaj e ka transportuar “Heroinën e bardhë” nga Tuzlla në Sarajevë në mënyrë që t’i dorëzojë paketat, siç është udhëzuar nga Krlic, personit të quajtur A.Ka.. Pak kohë më pas, K2 i është kërkuar nga Kalac që të vinte në Sarajevë, ku K2 u takua me Kalac dhe të pandehurin N.K., i cili e ka informuar K2 se 50 kilogramët e “Heroinës së bardhë” të cilat K2 sapo i kishte dërguar nga Turqia i përkisnin atij.

1405. Gjykata ka gjetur se nuk ka pasur prova të mjaftueshme për të vërtetuar se N.K. ka qenë në ndonjë mënyrë i lidhur me 50 kg të heroinës së transportuar nga K2 nga Turqia.
1406. Së pari, kjo pikë bazohet vetëm në dëshminë e dëshmitarit bashkëpunues K2 e cila nuk është vërtetuar me asnjë provë tjetër. Ajo që është e rëndësishme, K1 vazhdimisht e ka mohuar se N.K. ka pasur të bëjë ndonjë gjë me atë. Përveç kësaj, një gjetje e tillë mbështetet me dëshminë e vetë K2, sepse sipas tij H.Kr. dhe A.Ka. po grindeshin për këtë dërgesë, dhe secili prej tyre pretendonte se i

takonte atij.

1407. Në parim, gjykata ka vlerësuar dëshminë e K2 si të besueshme në lidhje me shumicën e fakteve që lidhen me këtë dërgesë, me përjashtim të mungesës së dijenisë se me çfarë lloji të drogës po merrej dhe për rolin e N.K në këtë transaksion. Vlerësimi i dëshmisë së tij si e besueshme në pjesën e përmednur rezulton nga fakti se ai ka dëshmuar në lidhje me rrethanat që e inkriminojnë atë ashtu siç e ka pranuar pjesëmarrjen e tij në trafikimin e drogës. Kjo pjesë e deklaratës së tij përbënte deklaram kundër interesit të tij. Sidoqoftë, gjykata nuk i ka besuar se ai nuk ka qenë në dijeni se ka qenë heroinë dhe jo kokainë, posaçërisht kur e ka pranuar se e ka kontrolluar atë.

Përmbledhje e provave relevante

1408. Sipas **K2**, në shkurt të vitit 2003, ai është thirrë nga Ilir Kastrati/Krasniqi (ai ka qenë i njohur me dy emrat¹⁶⁶²) nga Turqia i cili i ka thënë se gruaja dhe fëmijët e tij janë rrëmbyer në Shqipëri. Kastrati i ka kërkuar K2 që menjëherë të vijë në Stamboll. K2 ka shkuar atje me shokun e tij P.C. dhe është takuar me Kastratin i cili ka qarë dhe ka thënë se ai i ka marrë 50 kg kokainë për t'i transportuar në Bosnje dhe Hercegovinë, ka marrë para nga disa njerëz, të cilat tashmë i ka shpenzuar. Prandaj, gruaja dhe fëmijët e tij kishin mbetur të bllokuar në Shqipëri, dhe se duhej të gjente një mënyrë për ta transportuar atë ngarkesë të kokainës në Bosnje. K2 e ka pyetur Kastratin përsëri nëse ka qenë me siguri kokainë dhe jo heroinë, dhe ai i ishte betuar se ishte kokainë. Për K2 nuk ka qenë relevante sepse ai nuk ka dashur të përfshihet në ndonjë gjë që lidhet me heroinën si narkotiku më i rrezikshëm. K2 e ka kontrolluar substancën

¹⁶⁶² 23.02.2017, f. 26

personalisht dhe edhe vetë është siguruar se ishte kokainë, prandaj, ai ka vendosur që t'i ndihmojë Kastratit.¹⁶⁶³

1409. Droga është vendosur në dy paketa të mëdha të rrobave të cilat ai i ka dërguar nga Turqia përmes shërbimit të transportit. Ato kanë arritur në Srebrenik në Bosnje, në vendin e quajtur Arizona, ku vozitësi i K2 M.Be. e ka marrë ngarkesën dhe ia ka dorëzuar atë K2.¹⁶⁶⁴

1410. Në fillim, K2 ka menduar se nuk ka asnjë lidhje midis drogës dhe N.K. Më vonë, A.Ka., i paralajmëruar nga Kastrati, e ka marrë atë nga Lipnica ku jetonte P.C..

Me këtë rast, K2 është takuar me A.Ka. për herë të parë.¹⁶⁶⁵

1411. Siç ishin pajtuar me Kastratin, K2 ia ka dhënë 50 kg të substancës narkotike A.Ka.. Vetëm atëherë ai ka kuptuar se nuk ka qenë kokainë, por heroinë. Pas kësaj A.Ka. është larguar.¹⁶⁶⁶

1412. Pas një kohe, A.Ka. e ka thirrë K2 që të vijë në Sarajevë. Ata janë takuar në qendrën tregtare Visa prej ku së bashku kanë shkuar në restorantin Brajlovic. Aty ka qenë N.K., ata janë përshëndetur. A.Ka. dhe N.K. po flisnin në lidhje me drogën. N.K. i ka thënë K2 *“e shihni, ju kam thënë se do të punoni për mua”*.

Sipas K2, ai e kishte fjalën për dërgimin e kësaj heroine.¹⁶⁶⁷

¹⁶⁶³ 23.02.2017, f. 20-21; 23.02.2017, p. 21 - 22

¹⁶⁶⁴ 23.02.2017, f. 24

¹⁶⁶⁵ 23.02.2017, f. 24

¹⁶⁶⁶ 23.02.2017, f. 25

¹⁶⁶⁷ 23.02.2017, f. 26

1413. Më vonë, H.Kr. i ka thënë K2 se ishte heroina e tij. Ai e ka pyetur K2 çfarë kishte bërë me të. K2 i ka thënë se ia kishte dhënë A.Ka.. H.Kr. ka kërkuar që të takohet me atë. K2 i ka thirrë A.Ka. duke i thënë se duhet të takoheshin sepse

kishte një problem.¹⁶⁶⁸

1414. Takimi ka ndodhur në Sarajevë, në një qendër tregtare. H.Kr. dhe A.Ka. janë grindur lidhur me atë se kujt i takon droga. Ata nuk kishin arritur ndonjë marrëveshje. K1 ka qenë gjithashtu i pranishëm gjatë këtij takimi, ai ka ardhur së

bashku me A.Ka..¹⁶⁶⁹

Versioni i K1

1415. Sipas K1, K2 ka sjellë në restorantin Brajlovic një mostër të vogël të heroinës së bardhë, pasi që nuk ishte në dijeni se çfarë ishte. Ai donte ta verifikonte nëse me të vërtetë ishte heroinë sepse A.Ka. i kishte thënë më parë. K2 e kishte marrë atë

nga Pakistani. Ka qenë një bisedë që N.K. e kishte mashtruar K2 dhe qarkullonin tregime të ndryshme në lidhje me këtë. K2 ka thënë se ai nuk besonte se në të vërtetë ka qenë heroinë. K1 ia ka konfirmuar K2 se ishte heroinë e bardhë. K1 nuk e dinte prej nga e kishte marrë atë K2. K2 ka pasur sasi më të madhe të saj dhe donte ta shiste atë.¹⁶⁷⁰

¹⁶⁶⁸ 23.02.2017, f. 34

¹⁶⁶⁹ 23.02.2017, f. 35

¹⁶⁷⁰ 02.11.2016, f. 14 - 16

1416. K2 ka pohuar se e kishte marrë nga N.K. dhe se ishte mashtruar sepse ishte i sigurt se nuk ka qenë heroinë e bardhë. Pastaj, K2 ka biseduar me R.K. dhe A.Ka., dhe ka thënë se si duket K2 po fliste në lidhje me sasinë, së pari për 20 kg, dhe pastaj për 50 kg.¹⁶⁷¹
1417. K1 ka konfirmuar se K2 po punonte për N.K., por jo me këtë heroinën e bardhë. Ai po trafikonte heroinë, armë, pistoleta dhe kontrabandë tjetër, por jo me këtë rast.¹⁶⁷²
1418. K2 e ka mbajtur këtë heroinën e bardhë në apartamentin e tij në Lukovac. Ai thoshte se N.K. e kishte mashtruar atë më këtë, por në fund ka dalë që N.K. nuk kishte asgjë të bënte me atë. K1 e dinte këtë nga A.Ka. dhe R.K. Sipas K1, nëse K2 e ka marrë atë nga N.K., ajo do t'i dërgohej të gjithëve, dhe se ai nuk besonte se N.K. do t'ia jepte K2 në mënyrë të fshehtë. K1 nuk e dinte se si ka përfunduar kjo situatë.¹⁶⁷³
1419. K1 ka qenë gjithashtu konsekuent gjatë marrjes së tërthortë në pyetje se N.K. nuk kishte asgjë të bënte me 50 kg të heroinës së bardhë.¹⁶⁷⁴ Më vonë, K1 ka thënë se N.K. ia kishte thënë këtë.¹⁶⁷⁵

4.14. Pika 5

Sipas aktakuzës:

¹⁶⁷¹ 02.11.2016, f. 16

¹⁶⁷² 02.11.2016, f. 16-17

¹⁶⁷³ 02.11.2016, f. 17 - 18

¹⁶⁷⁴ 10.11.2016, f. 11

¹⁶⁷⁵ 24.01.2017, f. 34-35

Pasi ishte kryer transporti i 50 kilogramëve të drogës për Rrjetin Kriminal të Organizuar të të Pandehurit N.K, nga fillimi i vitit 2003 K2 kishte pranuar, përmes A.Ka., bashkëpunëtor i të Pandehurit N.K., për të koordinuar transportin e 50,000 tableta Ekstazi për në Turqi. Shoferi i K2, S.A., e ka transferuar drogën nga Bosnja në Turqi me një ndarje të fshehtë në rezervuarin e lëndës djegëse të formuar nga mekaniku Z.B..

1420. Nuk ka asnjë provë për ndonjë lidhje të N.K me dërgesën e tabletave ekstazi në ngjarjen e përshkruar në pikën 5 të aktakuzës. K2 nuk e ka përmendur të akuzuarin në dëshminë e tij në lidhje me këtë transaksion specifik të drogës. Në anën tjetër, K1 ka qenë i qartë se K2 dhe N.K. nuk kishin biznes me ekstazi.

Përmbledhje e provave

Versioni i K2

1421. Pas argumentit në lidhje me ngarkesën e narkotikëve, e cila sipas K1 ka qenë kokainë, H.Kr. e ka pyetur K1 nëse e dinte se ku të gjente tableta ekstazi. K1 ka thirrë disa persona dhe ka marrë mostra, por ato nuk ishin të mira pasi që vinin nga Polonia ose Republika Çeke. Në fund, P.C. ka thënë se kishte një shok në Holandë i cili mund t'i ndihmojë ata. K2 e ka dërguar P.C. me 30.000 euro me aeroplan nga Sarajeva në Amsterdam. Ka qenë në mars/prill 2003.¹⁶⁷⁶

1422. P.C. ka gjetur ekstazi në Amsterdam por i mungonin 8000 euro për të marrë 50.000 tableta. Prandaj, K2 ka udhëtuar me S.A. me veturë në Amsterdam ku ia ka dhënë 8000 euro P.C.. Ata po prisnin për informata tërë natën dhe gjatë ditës së ardhshme. Më në fund, P.C. i ka thirrë gjersa ishin duke u kthyer dhe u ka thënë se ishte mashtruar sepse i kishin dhënë tableta të falsifikuara dhe i kishte

¹⁶⁷⁶ 23.02.2017, f. 36

humbur paratë. Pas kësaj K2 nuk ka pasur më kontakte me P.C..¹⁶⁷⁷

1423. Kur janë kthyer në Tuzëll, H.Kr. ka qenë ende në shtëpinë e K2. Ai ka thënë se e kishte një burim tjetër për ekstazi, ata do të mund të merrnin 50.000 tableta, por që K2 duhet të jetë garantues. Kjo është organizuar përmes K1 dhe A.Ka..¹⁶⁷⁸

1424. Ata kanë vendosur të blejnë 50.000 tableta nga 1.1 euro për një, dhe pastaj për t'i shitur ato në Turqi për 2.5 euro. K2 është pajtuar që të jetë garantues për K1 dhe A.Ka. për këtë transaksion dhe për të siguruar transportin për në Turqi. Në rast se H.Kr. nuk do të paguante për këtë, K2 ka qenë i obliguar që ta bëjë këtë. H.Kr. ka qenë i obliguar t'i paguaj 55.000 euro. K2 ka pasur para të mjaftueshme për ta paguar këtë.¹⁶⁷⁹ S.A. ka transportuar 50.000 tableta ekstazi në Turqi me S.To..¹⁶⁸⁰

1425. K1 e ka marrë ekstazinë në apartamentin e K1 në Sarajevë, ku gjithashtu edhe A.Ka. ka qenë i pranishëm. Tabletat janë paketuara në mbështjellës me flluska. K2 e ka dërguar atë me veturën e tij xhip ML në apartamentin e tij në Lukovac.¹⁶⁸¹ H.Kr. dhe K2 kanë ripaketuar tabletat në shishe të plastikës. 33 – 34 shishe janë vendosur në rezervuarin e derivateve të veturës Seat Toledo dhe S.A. ka shkuar me atë në Turqi. Kjo ka ndodhur në prill/maj 2003.¹⁶⁸²

1426. H.Kr. i ka aranzhuar të gjitha, S.A. i ka dërguar tabletat ekstazi në Turqi.¹⁶⁸³ 1427. Gjersa S.A. ishte ende në Turqi, H.Kr. ka vjedhur para dhe armën nga shtëpia e K2.

¹⁶⁷⁷ 23.02.2017, f. 37

¹⁶⁷⁸ 23.02.2017, f. 37

¹⁶⁷⁹ 23.02.2017, f. 38 - 39

¹⁶⁸⁰ 23.02.2017, f. 39

¹⁶⁸¹ 23.02.2017, f. 40

¹⁶⁸² 23.02.2017, f. 41

¹⁶⁸³ 23.02.2017, f. 42

Ai e kishte lënë një revole. ¹⁶⁸⁴

1428. S.A. është kthyer me asgjë nga Turqia, paratë ishin vjedhur. ¹⁶⁸⁵

1429. Më vonë, kur po organizohej dërgesa e ardhshme për 100.000 tableta ekstazi, K1 dhe A.Ka. i kanë thënë K2 se edhe këto 50.000 tableta i takonin N.K. K2 ka qenë paksa i befasuar sepse nuk e kishte ditur më parë. ¹⁶⁸⁶

1430. Gjatë marrjes së tërthortë në pyetje, K2 ka thënë se për këtë ekstazi ai ia ka dhënë K1 xhipin e tij, xhaketën e lëkurës dhe përzierjen të cilën e kishte marrë nga M.K. për përzierjen e drogës. ¹⁶⁸⁷

Versioni i S.A.

1431. **S.A.** e ka konfirmuar se K2 i kishte kërkuar që të shkojë në Amsterdam për ta marrë ekstazinë. Ai ishte pajtuar dhe kishte shkuar atje me Mercedes “Sytë” (*Okac*) i cili i takonte K2. ¹⁶⁸⁸ Me këtë rast, K2 ka bërë një marrëveshje me personin e quajtur “Pr.” i cili si duket i kishte dhënë atij para, por S.A. nuk e dinte sa. “Pr.” ka shkuar para tyre në Amsterdam. ¹⁶⁸⁹

1432. Sipas S.A., ata kanë qëndruar disa ditë në Amsterdam në hotelin Van Gogh. K2 ka blerë ujë në shishe të plastikës, më shumë se 50, i ka zbrazur ato dhe i ka tharë me tharëse flokësh. K2 është munduar të kontaktojë me “Pr.” por nuk kishte arritur. Në ditë në vijim, K2 i ka hedhur shishe te plastikës në kontejnerë dhe ka thënë se “Pr.” i kishte mashtruar, nuk kishte ekstazi. Ata janë kthyer në

¹⁶⁸⁴ 23.02.2017, f. 42-43

¹⁶⁸⁵ 23.02.2017, f. 43

¹⁶⁸⁶ 28.02.2017, f. 9 - 10

¹⁶⁸⁷ 16.03.2017, f. 31

¹⁶⁸⁸ 30.01.2017, f. 15-16

¹⁶⁸⁹ 30.01.2017, f. 16

Tuzëll pa asgjë. Gjersa po ktheheshin, ata janë kontaktuar nga “Pr.” i cili u kishte thënë se ishte arrestuar.¹⁶⁹⁰

Versioni i K1

1433. K1 ka qenë konsekuent se K2 nuk kishte biznes me N.K. në lidhje me dërgesën e ekstazisë.¹⁶⁹¹

4.15. Pikat 6 dhe 7

Përmbledhje e pretendimeve:

(Pika 6) K2 rregulloi transportin e 100,000 tableta të tjera ekstazi për në Turqi, në emër të të Pandehurit N.K. Për të siguruar këtë marrëveshje, K2 ia ka nënshkruar banesën e gruas së tij te K1, në emër të të Pandehurit N.K. para se të pranoheshin 100,000 pilula për tu dërguar në Turqi. Avokatja A.Pr. përgatiti një shënim premtues që u nënshkrua nga palët. Pas dhënies së kësaj garancie, i Pandehuri N.K. arriti me burrat e tij dhe 100,000 pilula Ekstazi, tek një garazh në Sarajevë, ku K2 kishte modifikuar rezervarin e Mercedesit të tij nga mekaniku, Z.B., ku ishte ndërtuar një ndarje speciale e veçantë për të vendosur drogën. Nën mbikëqyrjen e të Pandehurit N.K, Ekstazia është ngarkuar në Mercedesin e K2 dhe pastaj është transportuar për në Turqi nga vozitësi i besuar i K2, S.A..

(Pika 7) Pas dorëzimit të 100,000 tabletave Ekstazi për në Turqi, rezervuari i ndryshuar i lëndës djegëse të Mercedesit të K2 që kishte bartur tabletat Ekstazi, ishte mbushur me 25 kilogramë Heroinë në drejtim të N.K dhe GKO-së së tij. Kjo Heroinë pastaj është transportuar përsëri nga S.A. nga Turqia për në Tuzla/Bosnjë

¹⁶⁹⁰ 30.01.2017, f. 16-17, 25

¹⁶⁹¹ 10.11.2016, f. 11, 14; 24.01.2017, f. 35

Hercegovinë.

1434. Gjykata e gjeti të vërtetuar se Akelic, pas udhëzimeve të K1 dhe K2 ka udhëtuar për në Turqi me veturën Mercedes të mbushur me 100.000 tableta ekstazi. Kur është kthyer ai ka sjellë heroinë dhe ka marrë 10.000 euro për këtë. Këto gjetje janë bazuar në dëshminë e vërtetë të S.A., të mbështetur nga H.Mu. dhe H.Me.. Ato gjithashtu janë vërtetuar me deklaratat e K1 dhe K2 të cilat janë vlerësuar si të vërteta në pjesën ku i referohen aspektit logjistik të dërgimit të ekstazisë nga Holanda në Sarajevë.
1435. Gjykata ka vlerësuar se deklaratat e K2 ku ai thekson se N.K. ka qenë i përfshirë në dërgesën e ekstazisë nuk janë të vërteta, dhe ato janë fabrikuar nga ai për ta inkriminuar të pandehurin dhe për ta përfshirë atë në këtë rast. Këto pohime nuk janë mbështetur me prova tjera. Posaçërisht, dëshmitari K1, kur ka dëshmuar përsëri pasi që ishte udhëzuar si duhet në lidhje me fushëveprimin imunitetit, ka qenë i qartë se N.K. nuk ka qenë i përfshirë në këtë dërgesë, ai nuk ka qenë i pranishëm tek garazhet në Hrasnica ku është ringarkuar ekstazia dhe është dërguar për në Turqi. K1 ka qenë konsekuent se N.K. nuk kishte asgjë të bënte me ndonjë dërgesë të ekstazisë.
1436. Gjykata i gjeti si të besueshme deklaratat e S.A., H.Me. dhe H.Mu.. Të dy dëshmitarët nuk ishin të interesuar për rezultatin e lëndës dhe dëshmuan në mënyrë të sinqertë në lidhje ngjarjet në të cilat kishin marrë pjesë. Ata kanë vërtetuar deri në një masë të caktuar deklaratën e K2 (dërgimi i konfirmuar i ekstazisë në Turqi, mënyrën si është transportuar, kush ka qenë i përfshirë, çfarë është sjellë në këmbim– kafe e përzier me heroinë). Ata nuk kishin asnjë dyshim se K2 ka qenë i përfshirë në tërë marrëveshjen, posaçërisht kur ai ishte në dijeni

se nga Turqia duhej të kthehej drogë, dhe jo para. S.A. gjithashtu ka konfirmuar rrethanat e nënshkrimit të marrëveshjes për apartamentin nga K1 dhe K2.

1437. Nuk ka asnjë provë e cila e vërteton faktin se N.K. ka qenë i përfshirë në dërgesën e ekstazisë nga Holanda dhe më vonë të heroinës nga Turqia. Është vetëm K2 ai i cili ka dëshmuar në këtë mënyrë, ndërsa nuk është vërtetuar nga dëshmitarët tjerë. Dëshmia e tij sa i përket lënies peng të apartamentit është në kundërtënie me provat tjera, posaçërisht vetë kontrata dhe deklaratat e K1 dhe S.A.. K1 ka qenë konsekuent duke thënë se N.K. nuk kishte asgjë të bënte me ekstazinë.

1438. Gjithashtu nuk ka asnjë provë në mbështetje të pretendimeve të K2 se N.K. ka qenë i përfshirë në dërgesën e heroinës së përzierë me kafe e cila është sjellë nga S.A. nga Turqia. Ai është i vetmi i cili ka dëshmuar në këtë mënyrë. K1 kategorikisht e ka mohuar se N.K. ka pasur ndonjë lidhje me këtë situatë.

Përmbledhje e provave

Versioni i K2

1439. Pak kohë pas ngjarjeve kur K2 ka marrë pjesë në dërgimin e 50.000 tabletave ekstazi në Turqi, K1 dhe A.Ka. i janë afruar K2 dhe i kanë ofruar ndihmë sepse ai kishte humbur shumë para për një kohë të shkurtër. Ata e kanë pyetur K2, nëse pajtohej të merrte 100.000 tableta të ekstazisë të cilat ata më vonë do të mund t'i shisnin për para të gatshme në Turqi për 2.2 euro.¹⁶⁹² K2 kishte nevojë për para, prandaj e ka pranuar këtë ofertë.¹⁶⁹³

¹⁶⁹² 28.02.2017, f. 9

¹⁶⁹³ . 9 - 10

28.02.2017, f

4.15.1. Apartamenti

1440. Gjykata ka vërtetuar se kontrata për hipotekimin e apartamentit në Lukovac i cili i takonte gruas së K2, e nënshkruar më 02 qershor 2003 në zyrën e avokates A.Pr., ishte e lidhur me këtë transaksion të drogës.
1441. Dëshmitarët K1 dhe K2 kanë dhënë shpjegime të ndryshme lidhur me atë se pse është nënshkruar kjo kontratë.

Versioni i K2

1442. K2 ka theksuar se ai ka bërë marrëveshje për ekstazi me N.K., me këtë rast A.Ka. dhe K1 kanë qenë të pranishëm. N.K. ka kërkuar garanci për dërgimin. K2 ka thënë se ai nuk kishte asgjë për të ofruar, N.K. i ka thënë atij se ai e ka një apartament.¹⁶⁹⁴ K2 është pajtuar për këtë zgjidhje.¹⁶⁹⁵
1443. Para se K2 të pajtohet për pjesëmarrje në këtë transaksion për ekstazi, H.Me. me të dashurën e tij kanë udhëtuar për në Turqi me mostra për të kontrolluar cilësinë e drogës. Ajo është pranuar nga blerësit potencial.¹⁶⁹⁶ K2 ka paguar për udhëtimin e tyre, të gjitha aranzhimet janë bërë nga K1.¹⁶⁹⁷
1444. N.K. nuk ka dashur ta nënshkruaj këtë kontratë në emër të tij. Fillimisht, A.Ka. është dashur ta nënshkruaj, por ka rezultuar se nuk është e mundur sepse nuk kishte shtetësi të Bosnjës, atëherë N.K. ka sugjeruar që kontrata për apartamentin duhet të nënshkruhet nga K1.¹⁶⁹⁸ Sipas K2, N.K. ka qenë shumë i mençur që ta

¹⁶⁹⁴ 28.02.2017, f. 9 - 10

¹⁶⁹⁵ 28.02.2017, f. 13

¹⁶⁹⁶ 28.02.2017, f. 11 - 12

¹⁶⁹⁷ 28.02.2017, f. 15

¹⁶⁹⁸ 28.02.2017, f. 13

28.02.2017, f

nënshkruaj vetë.¹⁶⁹⁹ Kontrata është nënshkruar në ditën në vijim në Tuzëll, në zyrën e avokatit. K1, A.Ka., S.A., F.K. dhe avokati kanë qenë të pranishëm.¹⁷⁰⁰

Para nënshkrimit të kontratës, K2 është konsultuar vetëm me gruan e tij, dhe ajo ka qenë kundër kësaj. Ai nuk i kishte treguar asaj se ishte garanci për drogë.¹⁷⁰¹

1445. **A.Ka.** ka dëshmuar se prej vitit 1998 ai ka pasur nënshtetësi të Bosnjës.¹⁷⁰²¹⁷⁰³

1446. **K2** ka theksuar se ndërmjet momentit kur është nënshkruar kontrata për apartamentin dhe marrjes së drogës, ai e ka njoftuar policinë në lidhje me dërgesën e planifikuar të ekstazisë. Nuk ka pasur reagim të duhur nga ana e tyre.²⁰²¹ Ai ka pritur që policia do ta arrestonin atë dhe personat e tjerë të përfshirë në marrëveshjen për ekstazi. Ai ka theksuar se ka qenë i gatshëm që të kaloj ca kohë në burg, sepse ai priste që të lirohet për bashkëpunim. Në anën tjetër, ai besonte se do ta kthente apartamentin prapa si shpërblim për mos dëshmim kundër N.K. dhe të tjerëve.¹⁷⁰⁴

1447. Gjatë marrjes së tërthortë në pyetje, K2 ka shpjeguar se pas arritjes së marrëveshjes me N.K. ai e kishte thirrë policinë dhe u kishte thënë atyre se do të mund t'i arrestojnë të gjithë prej tyre me 100.000 tableta ekstazi. Nuk ka pasur reagim të duhur për shkak të lidhjeve të N.K. K2 nuk kishte parë asgjë të pazakontë në lënien e apartamentit peng për luftën me drogën. Po ta arrestonin atë, dëshmitari K1, N.K. dhe A.Ka., të gjithë do të përfundonin në burg. Pastaj, ata do të pajtoheshin që t'ia kthejnë apartamentin K2, dikush do ta merrte

¹⁶⁹⁹ . 15

¹⁷⁰⁰ 28.02.2017, f. 14

¹⁷⁰¹ 28.02.2017, f. 14

¹⁷⁰² 27.02.2017, f. 5

¹⁷⁰³ 8.02.2017, f. 16

¹⁷⁰⁴ . 16, 18

28.02.2017, f

përgjegjësinë mbi vete, me siguri jo N.K., dhe atij do t'i ndërpriteshin ankthet.¹⁷⁰⁵

1448. Sipas K2, N.K. në fakt nuk ishte i interesuar në apartamentin i cili ishte peng, por më tepër në vetë K2 sepse donte ta angazhonte atë në transportimin e drogës. Kur është pyetur për arsyet, K2 ka thënë se N.K. e din më së miri pse. Sipas tij, N.K. ka dashur ta ketë një person të besueshëm dhe një vend të besueshëm ku do të mund ta mbante drogën. Përveç kësaj, K2 gjithashtu kishte familje në Kosovë.

¹⁷⁰⁶

1449. Gjatë marrjes së tërthortë në pyetje, K2 është ballafaquar me dëshminë e tij të dhënë gjatë gjykimit të tij para gjykatës në Bosnje dhe Hercegovinë (f. 172 e aktgjykimit kundër K2) kur ka thënë në lidhje me kontratën për apartamentin: *“ka qenë për shkak të 100.000 tabletave ekstazi, ai e ka bërë në emër të Hakia Krlic i cili ka qenë njeri i besueshëm dhe i cili kishte kaluar kohë me të në burg. K2 ka thënë se kjo nuk është e vërtetë. Sipas tij, është regjistruar gabimisht sepse ai nuk ka përmendur ekstazi, por vetëm tabletat captagon.”*¹⁷⁰⁷ Kur është pyetur përsëri pse nuk ka thënë gjatë gjykimit të tij se apartamenti është lënë peng për N.K., por e ka përmendur H.Kr. në këtë kontekst, ai ka shpjeguar se ka pasur frikë që ta përmend atë N.K.¹⁷⁰⁸

Versioni i K1

1450. K1 ka paraqitur dy versione të ndryshme se pse apartamenti i gruas së K2 është lënë peng. Ai e ka ndryshuar dëshminë e tij në mënyrë të konsiderueshme pasi që

¹⁷⁰⁵ 09.03.2017, f. 50

¹⁷⁰⁶ 09.03.2017, f. 21

¹⁷⁰⁷ 09.03.2017, f. 43

¹⁷⁰⁸ 09.03.2017, f. 43

është shpallur në mënyrë të duhur dëshmitar bashkëpunues në këtë lëndë.

1451. Pas udhëzimit të duhur lidhur me fushëveprimin e imunitetit, K1 ka dëshmuar se K2 dhe gruaja e tij kanë pasur një apartament në Lukavac i cili përbëhej prej tri apartamenteve në të njëjtën ndërtesë. Ai ka ardhur aty sepse është ftuar nga A.Ka. dhe R.K. i cili i ka thënë që të vijë në Tuzëll për t'i nënshkruar dokumentet. Ai ka shkuar atje dhe K1 e ka nënshkruar marrëveshjen.¹⁷⁰⁹ Më vonë, ai është ballafaquar me dëshminë e tij të dhënë në Bosnje në dhjetor të vitit 2004, ku ka thënë se është ftuar nga Hako dhe A.Ka. për ta nënshkruar marrëveshjen për ta siguruar ujdinë me K2 për ekstazi. K1 ka thënë se atij nuk i kujtohej. Ai e ka kontestuar saktësinë e procesverbalit. Ai ka theksuar se me siguri ka qenë A.Ka. dhe R.K. të cilët e kanë thirrë atë.¹⁷¹⁰
1452. Kontrata për banesën është nënshkruar më 2 qershor 2003, në Tuzëll pas dërgesës së ekstazisë nga Holanda.¹⁷¹¹ K2 e ka nënshkruar atë sepse askush nuk dëshironte që të bartej në emër të tyre. Ata gjithashtu kishin frikë se K2 nuk do të ishte person i besueshëm. R.K. dhe A.Ka. do të përfitonin nga kjo kontratë.¹⁷¹²
1453. Sipas K1, ky apartament ka qenë kolateral për ekstazinë të cilën K2 ka premtuar se do ta dërgojë në Turqi dhe pastaj t'ia kthejë paratë R.K.s dhe N.K.¹⁷¹³
1454. Në fund, ka ndodhë që K2 është mashtruar me ekstazinë e cila është dërguar përmes H.Kr., ai nuk kishte pranuar para për këtë dërgesë por kafe të përzier me substancë të paspecifikuar.¹⁷¹⁴

¹⁷⁰⁹ 02.11.2016, f. 26

¹⁷¹⁰ 10.11.2016, f.20 - 21

¹⁷¹¹ 02.11.2016, f.27

¹⁷¹² 02.11.2016, f.27 - 28

¹⁷¹³ 02.11.2016, f.26

1455. Gjatë rrjedhës së mëtutjeshme të dëshmisë, K1 ka thënë se kur është nënshkruar kontrata, K1 nuk ka menduar se N.K. ka qenë në dijeni për atë. Me siguri, ai e ka kuptuar këtë më vonë, por pak më pas K1 ka thënë se nuk ishte i sigurt për këtë dhe se N.K. duhej të pyetet për këtë.¹⁷¹⁵
1456. Kur K1 është pyetur lidhur me një shënim në fletoren e tij “*probleme midis N.K. dhe Ferid, Feridi nuk ka paguar, ai do t’i lë peng apartamentet në Tuzëll*”, ai ka shpjeguar se N.K. donte ta vinte emrin e tij në këtë marrëveshje sepse K2 i kishte borxh para. N.K. nuk e ka ditur se ata po nënshkruanin kontratë me K2. Apartamenti është ende në emër të K1. K2 i kishte borxh para K1, por K2 nuk mund ta shes këtë apartament.¹⁷¹⁶
1457. Më vonë, gjatë marrjes së tërthortë në pyetje K1 është tërhequr nga kjo deklaratë se kontrata për hipotekën e apartamentit duhej të garantonte borxhet e K2 ndaj N.K. Ai e ka pranuar se marrëveshja e nënshkruar me gruan e K2 nuk kishte asgjë të bënte me N.K. dhe madje ai nuk e dinte për këtë.¹⁷¹⁷ Qëllimi i kësaj kontrate ka qenë për të garantuar që K2 do t’ia kthente paratë K1 i cili ka investuar 60.000 euro në biznesin e K2. Në fund, K2 nuk e ka kthyer këtë borxh, prandaj K1 e ka mbajtur banesën. Nëse K2 do t’i kthente paratë, K1 do ta regjistronte banesën në emrin e gruas së K2.¹⁷¹⁸
1458. Para se t’i jepej dëshmitarit imuniteti i duhur, ai ka dëshmuar ndryshe sepse pastaj ai e ka përfshirë N.K. në marrëveshjet e lidhura me apartamentin. Gjatë

¹⁷¹⁴ 02.11.2016, f.26

¹⁷¹⁵ 02.11.2016, f.31

¹⁷¹⁶ 08.11.2016, f.8-10

¹⁷¹⁷ 10.11.2016, f. 14

¹⁷¹⁸ 10.11.2016, f. 15-16

marrjes së tërthortë në pyetje, K1 ka dëshmuar se K2 kishte në pronësi një apartament në Lukavac i cili ishte i regjistruar në emër të gruas së tij Mi.Me.. K2 e ka nënshkruar kontratën në Tuzëll, apartamenti duhej të merrej si kolateral.¹⁷¹⁹

1459. Ky apartament është vënë nga K2 si kolateral në emër të K1 sepse ai i kishte borxh para N.K për ekstazi. Fillimisht, K1 nuk e ka ditur se për çfarë bëhej fjalë, por ai është thirrë nga R.K. dhe A.Ka. të cilët i kanë thënë që të vijë në Tuzëll.¹⁷²⁰ Marrëveshja thoshte se apartamenti ka vlerë 110.000 euro. Nuk janë dhënë para. Është shkruar në këtë mënyrë pasi që kontrata nuk mund të tregonte se bëhej fjalë për ekstazi.¹⁷²¹

1460. Kontrata është nënshkruar me K1 sepse ata nuk donin që ta regjistronin në emër të tyre dhe më vonë të zbuloheshin nga gazetarët. “Ata” do të thotë A.Ka., R.K., N.K. Ndoshta, nëse K1 do ta kishte ditur më parë, ai nuk do të pajtohej për këtë. Apartamenti është ende i regjistruar në emër të K1.¹⁷²² Disa muaj më vonë, K1 i ka dhënë para K2 dhe gruas së tij sepse K2 donte ta ndërpriste kontratën, kurse K1 nuk e donte atë.¹⁷²³ *S.A., H.Me.*

1461. S.A. ka konfirmuar se ka qenë një marrëveshje ndërmjet K1 dhe K2 që K1 i ka huazuar para K2, dhe ky i fundit e ka marrë peng apartamentin e tij në Lukovac si garanci për këtë. Ai është pyetur nga ata në lidhje me mendimin e tij për vlerën e apartamentit. Ai ka thënë se vlen më shumë se 100.000 euro ose KM, por më parë euro. Ai ua ka rekomanduar atyre avokaten Alma Pernajovarac për ta

¹⁷¹⁹25.02.2016, f. 30, p. 32 -33

¹⁷²⁰ 25.02.2016, f. 31; 15.03.2016, p. 13, 30

¹⁷²¹ 25.02.2016, f. 34

¹⁷²² 25.02.2016, f. 35

¹⁷²³ 25.02.2016, f. 36

përgatitur kontratën për apartamentin.¹⁷²⁴

1462. Në ditën kur ëshët nënshkruar kontrata, S.A. ka ardhur në hotel ku gjendej zyra e avokates. Të pranishëm ishin: K2, gruaja e tij Mi.Me., K1 dhe F.K..¹⁷²⁵¹⁷²⁶

1463. Pasi është bërë kontrata për apartamentin për ta siguruar borxhin e K2 ndaj K1, janë pajtuar që S.A. do të udhëtonte për në Turqi me ekstazi dhe do të sillte mbrapa heroinë.²⁰⁴⁴

1464. Më vonë, K1 ka marrë nga K2 xhaketa të lëkurës dhe veturën Mercedes për shkak të borxheve të tij.¹⁷²⁷ Ai ka dëgjuar gjithashtu nga F.K. se ata janë takuar përsëri me Mi.Me., gruan e K2 dhe i kanë thënë asaj se duhet ta jap apartamentin për shkak të borxheve të K2.¹⁷²⁸¹⁷²⁹

1465. Gjithashtu, **H.Me.** ka dëshmuar se K2 ka përfunduar në borxhe ndaj K1 prandaj ai ka dhënë si kompensim– të paktën një veturë dhe e ka vënë apartamentin e tij si kolateral. Ky fakti i fundit ka qenë arsyeja e ndarjes nga gruaja e tij Mi.Me..

²⁰⁴⁷

Apartamenti – përfundim

1466. Në dritën e provave që lidhen me kontratën mbi lënien e apartamentit peng, gjykata e ka vërtetuar se ishte dhënë si kolateral për të garantuar borxhet midis K1 dhe K2. N.K. nuk ka qenë fare i përfshirë në këtë situatë, ai nuk ka qenë në

¹⁷²⁴ 30.01.2017, f. 18-19

¹⁷²⁵ 30.01.2017, f. 19-20

¹⁷²⁶ .01.2017, f. 30 - 31

¹⁷²⁷ 30.01.2017, f. 31-32

¹⁷²⁸ 30.01.2017, f. 32

¹⁷²⁹ 07.04.2017, f. 34

dijeni për këtë. Një përfundim i tillë nuk rezulton vetëm nga dokumentet provat-kontrata, por mbështetet edhe me deklaratën e K1 i cili përfundimisht e ka pranuar se cilat kanë qenë arsyet e vërteta për këtë marrëveshje. Përveç kësaj, pretendimi i K1 se kontrata është dashur t'i sigurojë borxhet e K2 ndaj tij është vërtetuar nga deklarata e dëshmitarit S.A., i cili në mënyrë objektive dhe pa paragjykim ka përshkruar se çfarë ka ndodhur. S.A. nuk kishte asnjë dyshim se qëllimi i asaj kontrate ka qenë për të garantuar se K2 do ta paguante borxhin që e kishte ndaj K1. Gjithashtu, H.Me. e ka konfirmuar këtë fakt.

4.15.2. Tabletat ekstazi nga Holanda

1467. Pas udhëzimit të duhur lidhur me fushëveprimin e imunitetit, K1 ka dëshmuar se ai ka udhëtuar për në Holandë në ditën kur është vrarë Z.D.. Është fakt i njohur se ka ndodhur më 12 mars 2003. Detyrat e K1 kanë qenë që t'i dorëzojë paratë për vozitësit dhe ta kontrollojë cilësinë e ekstazisë që do të dërgohej në Sarajevë. Në këtë ditë, të gjithë udhëtarët të cilët ishin duke udhëtuar nga Ballkani janë kontrolluar. Prandaj, K1 ka raportuar se kishte 100.000 euro me vete. Ai i ka marrë paratë nga A.KA. dhe R.K. Ai nuk e dinte se prej nga i kishin marrë paratë ata.¹⁷³⁰ Paratë kanë qenë vetëm për transport.¹⁷³¹

1468. Një pjesë e sasisë së ekstazisë është paguar, por nuk e dinte se në çfarë mënyre. Pjesa tjetër është kompensuar me heroinë dhe është paguar nga A.Ka. dhe R.K. Kjo dërgesë ishte e A.Ka., R.K. dhe K2.¹⁷³² Gjithçka ishte organizuar nga K2, A.Ka., S.A., H.Me. dhe R.K. K1 nuk e dinte se kujt i takonte ekstazia.¹⁷³³

¹⁷³⁰02.11.2016, f. 19-21

¹⁷³¹ 02.11.2016, f.24

¹⁷³² 02.11.2016, f.25

1469. K1 nuk ishte në dijeni nëse N.K. e dinte se ai kishte shkuar në Holandë.¹⁷³⁴ K1 nuk e dinte nëse N.K. ka qenë i përfshirë në këtë; ai nuk e kishte parë atë atje. Ai ka theksuar se N.K. nuk kishte marrëdhënie të mira me K2.¹⁷³⁵
1470. Në aeroport në Amsterdam K1 është takuar me Sead Lukac, Safet Kocic dhe dy shqiptarë. Pastaj, ai është dërguar në lokacionin ku po mbahej ekstazia. Ka qenë 30 – 40 km nga Amsterdami, ndoshta në vendin e quajtur Argen. Tabletat janë paketuar në shishe 0,5 l të coca cola. Një shishe mund të zinte 1000 tableta.¹⁷³⁶ K1 ia ka dhënë paratë Lukac dhe Kocic në veturë.¹⁷³⁷
1471. Ai nuk e ka testuar këtë ekstazi sepse nuk ishte specialist për këtë. Një person tjetër ka ardhur për ta kontrolluar cilësinë e saj dhe e ka konfirmuar. Pastaj, vozitësit (S.A., Remzo Manjduka dhe dy të tjerë me veturë VW Passat) i kanë dërguar tabletat në Sarajevë. Më parë, ata i kanë paketuar në qese të plastikës me vakum dhe i kanë ngarkuar në vetura. I tërë operacioni ka zgjatur 3– 4 ditë.¹⁷³⁸ 100.000 tableta ekstazi të paketuara në shishe të plastikës janë transportuar me 3 – 4 vetura, secila shishe përmbante 1000 tableta. Ka qenë edhe një dërgesë tjetër e cila ka ardhur me kamionë të gjatë, sasia ka qenë më e madhe se 100.000.¹⁷³⁹ K1 nuk ka qenë në gjendje të specifikojë sasinë e saktë të ekstazisë.¹⁷⁴⁰
1472. Kur 3- 4 ditë më vonë K1 është kthyer nga Amsterdami në Sarajevë, ekstazia

¹⁷³³ 08.11.2016, f.7

¹⁷³⁴ 02.11.2016, f.19 -21

¹⁷³⁵ 02.11.2016, f.25

¹⁷³⁶ 02.11.2016, f.19 -22

¹⁷³⁷ 02.11.2016, f. 23

¹⁷³⁸ 02.11.2016, f. 22, 23

¹⁷³⁹ 02.11.2016, f.29

¹⁷⁴⁰ 02.11.2016, f.23

ishte vendosur në një garazh afër picerisë në Hrasnica. Disa persona po paketonin në garazhe, disa ishin në piceri.¹⁷⁴¹ Garazhet ishin karakteristike sepse

kishin vrima nga plumbave në dyer.¹⁷⁴²

1473. Me këtë rast, kur ka ardhur ekstazia në Sarajevë, K1 nuk e ka parë N.K. aty rreth garazheve në Hrasnica ku po ringarkohej ekstazia. Prokurori i ka thënë atij se të gjithë dëshmitarët e tjerë kanë thënë se ata e kishin parë N.K. aty. Ai nuk e kishte parë atë aty, dhe nuk donte të thoshte diçka që nuk kishte parë. Ai ishte i sigurt se N.K. nuk ka qenë i pranishëm aty.¹⁷⁴³ Ai nuk e dinte se për kë ishte ekstazia, kush tjetër ka qenë i përfshirë në këtë.¹⁷⁴⁴

1474. Ai ka dëshmuar se në këtë rast, në garazhe të pranishëm kanë qenë: K2, A.Ka., Sulo, K.Ku., R.K., H.Me. dhe mekaniku i cili merrej me rezervarin e derivateve. Të gjithë prej tyre kanë qenë të përfshirë në paketim; ata gjithashtu kishin marrë udhëzime në lidhje me fluturimin e tyre për në Turqi.¹⁷⁴⁵

1475. Para se të udhëzohej si duhet në lidhje me imunitetin, K1 ka dëshmuar ndryshe në lidhje me dërgesën e ekstazisë nga Amsterdami. Detajet e këtij udhëtimi atje, si është organizuar, kush ia ka dhënë paratë, mënyra se si është paketuar ekstazia dhe më vonë transportuar për në Sarajevë, ai e ka paraqitur në mënyrë të njëjtë sikur gjatë dëshmisë së tij pas udhëzimit të duhur në lidhje me fushëveprimin e imunitetit.¹⁷⁴⁶ Versioni i tij ka qenë në mënyrë të konsiderueshme i ndryshëm sa i përket përfshirjes së N.K.

¹⁷⁴¹ 02.11.2016, f.22, 07.11.2016, f.5-6

¹⁷⁴² 02.11.2016, f.24

¹⁷⁴³ 02.11.2016, f.22

¹⁷⁴⁴ 02.11.2016, f. 22

¹⁷⁴⁵ 02.11.2016, f.22

¹⁷⁴⁶ 24.02.2016, f. 28 – 34, 16.03.2016, f. 28

1476. K1 e ka ndryshuar dëshminë e tij në mënyrë të konsiderueshme në krahasim me atë që e ka dhënë më parë. Gjatë asaj marrjeje në pyetje, ai ka thënë se pak kohë pasi K2 e ka vënë apartamentin e tij si kolateral, ai e ka marrë ekstazinë.¹⁷⁴⁷ Ka ndodhur në Hrasnica, aty kanë qenë shumë persona të pranishëm: K2, A.Ka., N.K., K2, H.Kr., Zeljko, dhe rreth 10 – 12 persona.¹⁷⁴⁸¹⁷⁴⁹ Ka pasur aq shumë njerëz të pranishëm sepse ata ishin personat të cilët kishin krijuar ndarjet e fshehta (Zeljko, të cilin e ka njohur), vozitësit të cilët duhej të shkonin në Turqi, Tuzëll.

2067

1477. Kjo ekstazi ishte e N.K., prandaj ai ka qenë i pranishëm.¹⁷⁵⁰ N.K. dhe R.K. ishin përgjegjës për këtë ekstazi. Ata gjithashtu kishin heroinë.¹⁷⁵¹

1478. Me këtë rast, K1 ka dëshmuar se plani ka qenë që K2 do t'i merrte paratë për ekstazi për t'ia kthyer N.K.¹⁷⁵² K1 nuk e dinte sa para do të paguheshin për këtë ekstazi, ishin në pyetje disa dërgesa, dhe ai ka menduar se kanë qenë 150 – 200.000 euro për një dërgesë.¹⁷⁵³ Çmimi i eksatzisë në Holandë–ka qenë 30 cent për një tabletë, kurse në Turqi– 10 euro.¹⁷⁵⁴ Dërgesa ka pasur vlerë rreth 110.000 – 120.000 euro.¹⁷⁵⁵

¹⁷⁴⁷ 25.02.2016, f. 39

¹⁷⁴⁸ 25.02.2016, f. 35

¹⁷⁴⁹ 5.02.2016, f. 37

¹⁷⁵⁰ 25.02.2016, f. 36, 39

¹⁷⁵¹ 15.03.2016, f. 6

¹⁷⁵² 15.03.2016, f. 4

¹⁷⁵³ 15.03.2016, f. 5

¹⁷⁵⁴ 15.03.2016, f. 6

¹⁷⁵⁵ 15.03.2016, f. 6

1479. Zeljko e ka krijuar një ndarje në veturën Mercedes e cila ishte e K2. K1 e ka parë kur ai po e montonte dhe çmontonte atë. Me atë rast, Zeljko ia ka treguar atë S.A. se si të merret me atë.¹⁷⁵⁶ Ekstazia ishte vendosur në shihte të coca – cola, e mbuluar me folie e cila ishte ngjitur me ngjitës për t’iu shmangur kontaminimit.¹⁷⁵⁷
1480. S.A. e ka vozitur Mercedesin për në Turqi. ¹⁷⁵⁸ Ekstazia është dërguar atje, pastaj është kthyer heroinë e përzier me kafe.¹⁷⁵⁹¹⁷⁶⁰
1481. Në fletore është treguar se 100.000 janë dërguar në Turqi nga S.A., 50.000 të tjera nga K2 në Tuzëll dhe 40.000 nga H.Kr.. Pjesa tjetër është dërguar në Turqi me një kamion me ftohje. Transportimi i 100.000 nuk është bërë me një dërgesë.
2078
1482. K1 ka dëshmuar se K2 nuk i ka bërë asnjë pagesë N.K. ¹⁷⁶¹ Ai nuk e dinte se cili ka qenë reagimi i N.K për këtë. Kur është pyetur për sqarim, edhe një herë ai ka sugjeruar se K2 duhet ta sqaroj këtë. K1 ka sugjeruar që të pyetet K2 lidhur me reagimin e N.K. Sidoqoftë, sipas tij, K2 ka filluar të sillet në mënyrë të padrejtë ndaj tyre, t’i mashtronte dhe të fshihet nga from N.K.¹⁷⁶²
1483. Në fletore, K1 ka treguar se midis N.K. dhe K2 kishte probleme dhe për këtë arsye ai është dashur ta lë apartamentin peng.¹⁷⁶³ Kur është pyetur lidhur me

¹⁷⁵⁶ 25.02.2016, f.37-38

¹⁷⁵⁷ 25.02.2016, f. 38

¹⁷⁵⁸ 25.02.2016, f. 39

¹⁷⁵⁹ 25.02.2016, f. 40

¹⁷⁶⁰15.03.2016, f. 629-30

¹⁷⁶¹ 15.03.2016, f. 14

¹⁷⁶² 15.03.2016, f. 16

¹⁷⁶³ 15.03.2016, f. 30

detajet, K1 ka thënë se preferon që mos të flasë lidhur me këtë dhe të pyetet K2.¹⁷⁶⁴

Versioni i K2

1484. Sipas K2, ekstazia është marrë në mbrëmje.¹⁷⁶⁵ Kjo ka ndodhur në garazhe, ato ishin karakteristike sepse në dyer kishin vrima nga plumbat.¹⁷⁶⁶ Mercedesi i K2 ishte futur brenda. Ajo e ka pasur një ndarje të veçantë e cila ishte ndërtuar nga Z.B.. Dy burra me golf e kanë sjellë ekstatinë e paketuar me mbështjellëse me flluska e cila është vendosur në ndarjen e fshehtë.¹⁷⁶⁷

1485. N.K. ka qenë i pranishëm në garazhe në Ilidza kur K2 ka marrë 100.000 tableta. Aty gjithashtu të pranishëm kanë qenë edhe A.KA., K1, Z.B., një person në xhip i cili nuk ka dalë jashtë, dhe dy persona me veturën golf. Ka qenë në pranverë.¹⁷⁶⁸

1486. K2 e ka vozitur Mercedesin e mbushur me ekstazi në Tuzëll. Pastaj, S.A. menjëherë e ka vozitur atë për në Turqi.¹⁷⁶⁹ Z.B. është dërguar nga H.Mu. në Zagreb për një fluturim për në Stamboll.¹⁷⁷⁰

1487. Ekstazia ka arritur në Turqi. S.A. është dashur të largohet, kurse Z.B. ka qëndruar. K2 e ka thirrë S.A. i cili i ka thënë se kishin vendosur disa topa të verdhë brenda në veturë. Pastaj, ai e ka thirrë K1 për të mësuar se çfarë ishte

¹⁷⁶⁴ 15.03.2016, f. 14

¹⁷⁶⁵ 28.02.2017, f. 19

¹⁷⁶⁶ 28.02.2017, f. 19

¹⁷⁶⁷ 28.02.2017, f. 20 - 23

¹⁷⁶⁸ 28.02.2017, f. 11

¹⁷⁶⁹ 28.02.2017, f. 23

¹⁷⁷⁰ 28.02.2017, f. 24

duke ndodhur. K1 i ka thënë atij se paratë gjendeshin në këta topa. ¹⁷⁷¹ S.A.,

H.Mu., H.Me.

1488. **S.A.** e ka konfirmuar se e ka vozitur Mercedesin nga Tuzlla në Stamboll. Ka qenë i ngarkuar me ekstazi; ai nuk e dinte sasinë e saktë të saj. Ai e ka marrë veturën nga shtëpia e F.K.. S.A. duhet të merrte 10.000 euro dhe ka pasur për detyrë të sjellë heroinë nga Stambolli. Ai po udhëtonte vetëm. ¹⁷⁷²

1489. Kur S.A. ka ardhur në Stamboll ai është kontaktuar nga personi me emrin “Ad.”. Ata janë takuar në hotel në Zagreb ose Santa Maria. S.A. ia ka dhënë atij çelësat e veturës. S.A. gjithashtu mund të jetë takuar atje edhe me H.Me. por nuk ishte i sigurt për këtë. Ai e ka konfirmuar se personi nga Tuzlla ka ardhur me aeroplan për ta hequr rezervarin sepse ai ishte i vetmi i cili mund ta çmontonte atë dhe ta vendoste heroinën brenda. ¹⁷⁷³ Pas 2 ose 3 ditëve, “Ad.”i ia ka sjellë atij veturën. Ai nuk e dinte se çfarë kishte brenda, sidoqoftë, ai duhej ta rimbushte çdo 100 – 150 km. Bagazhi ka qenë i ngarkuar me rroba atraktive të cilat i përdorte për t’i korruptuar zyrtarët e doganës gjatë kalimit të kufirit. ¹⁷⁷⁴

1490. **H.Mu.** ka konfirmuar se e kishte dërguar personin i cili e kishte bërë rezervarin në aeroport prej nga kishte udhëtuar me aeroplan për në Turqi, ndërsa S.A. e kishte vozitur Mercedesin. Prania e mekanikut ka qenë shumë e domosdoshme sepse ai ka qenë i vetmi që ka mundur ta montojë dhe çmontojë rezervarin. Ai vetëm ka dëgjuar se ata do të transportonin drogë. ¹⁷⁷⁵ Sipas H.Mu., S.A. është

¹⁷⁷¹ 28.02.2017, f. 25

¹⁷⁷² 30.01.2017, f. 21

¹⁷⁷³ 30.01.2017, f. 21

¹⁷⁷⁴ 30.01.2017, f. 22

¹⁷⁷⁵ 27.01.2017, f. 13

- udhëzuar që të shkojë në Turqi nga K2 dhe me siguri gjithashtu edhe nga K1. ¹⁷⁷⁶
- Në pyetjen udhëzuese, H.Mu. është përgjigjur se është e mundur që emri i mekanikut ka qenë Zeljko. ¹⁷⁷⁷
1491. **H.Me.** ka dëshmuar se tabletat ekstazi ishin prodhuar në Holandë. H.Me. nuk i kujtoheshin datat e sakta; ndoshta ka qenë më 2001 ose 2002. ¹⁷⁷⁸
1492. H.Me. ka konfirmuar se S.A. nga Tuzlla ka udhëtuar për në Holandë. Ai ka sjellë nga Amsterdam në Tuzëll 100.000 tableta ekstazi. Më vonë, ai i ka transportuar ato për në Turqi, Stamboll. Ata kishin paguar 60 cent për një tabletë në Holandë, kurse në Turqi kushtonte 2,50 euro. S.A. i ka transportuar ato në një pjesë speciale të ndarë të fshehtë në veturën Mercedes “Okac”. ¹⁷⁷⁹
1493. Ai gjithashtu ka theksuar se nuk i kujtohen datat e sakta sepse nuk kishte mbajtur shënime se kur e kishte bërë këtë apo atë grabitje. ¹⁷⁸⁰
1494. H.Me. është njoftuar nga K2 lidhur me dërgesën e ekstazisë. Ai nuk e ka ditur si e kishte marrë atë K2, sidoqoftë H.Me. e ka ditur se K2 është ndihmuar nga K1 i cili kishte disa lidhje familjare në Holandë, ai e kishte një vëlla atje. K2 ka qenë ai që ka paguar për pjesën e ekstazisë dhe pas përfundimit të marrëveshjes për heroinë ai ka qenë i obliguar që ta paguajë pjesën e mbetur. ¹⁷⁸¹ Njëri nga garantuesit se ekstazia do të paguhej, ka qenë F.K.. ¹⁷⁸² Tjetri ka qenë vëllai i K1. Gjërat tjera si transporti, akomodimi janë paguar nga K2. ¹⁷⁸³

¹⁷⁷⁶ 27.01.2017, f. 13

¹⁷⁷⁷ 27.01.2017, f. 14

¹⁷⁷⁸ 07.04.2017, f. 10

¹⁷⁷⁹ 07.04.2017, f. 10

¹⁷⁸⁰ 07.04.2017, f. 10

¹⁷⁸¹ 07.04.2017, f. 11

¹⁷⁸² 07.04.2017, f. 11

1495. H.Me. është ballafaquar me deklaratat e tij të mëparshme nga viti 2013 – 2014 (faqet 273, 274 dhe 332) kur kishte thënë se e kishte parë N.K. duke i shtrënguar duart me K2, e ka dëgjuar K2 duke e thirrë N.K. Ai e ka mohuar këtë.¹⁷⁸⁴ Ai gjithashtu e ka mohuar edhe deklaratën e tij të mëparshme (f. 263) se N.K. ia ka dhënë K2 60.000 euro për ta paguar ekstazinë.¹⁷⁸⁵ Ai ka shpjeguar se ai atëherë nuk kishte dëshmuar i lirë, ai ishte nën presionin e K2 i cili gjithashtu kishte dërguar disa persona për të ndikuar në atë.¹⁷⁸⁶

Përfundim

1496. Gjykata ka përfunduar se N.K. nuk ka qenë i pranishëm tek garazhet në Hrasnica kur është sjellë ekstazia nga Holanda. Prova e vetme në mbështetje të këtij pretendimi ka qenë dëshmia e K1, dëshmitar bashkëpunues, e cila nuk është mbështetur me asnjë provë tjetër. Posaçërisht, K1 në mënyrë të qartë ka theksuar se N.K. nuk ka qenë i pranishëm atëherë dhe nuk kishte asgjë të bënte me këtë dërgesë të ekstazisë. Dëshmitarët S.A. dhe H.Mu. asnjëherë nuk kanë dëshmuar në lidhje me ndonjë përfshirje në transaksionet e drogës me N.K.

1497. Gjykata ka vërejtur se H.Me. është tërhequr nga deklarata e tij e mëparshme se N.K. ka qenë i përfshirë në pagesën për ekstazi. Gjykata ka gjetur dëshminë e tij të dhënë gjatë këtij gjykimi si të vërtetë sepse kanë qenë në përputhje me deklaratat e dëshmitarëve të tjerë, posaçërisht S.A. dhe K1. Përveç kësaj, është vërtetuar se H.Me. më herët ka qenë i përfshirë në shumë veprime me qëllim për rishikimin e procedurës kundër K2, të cilat janë paraqitur në hollësi në f. 4.17 të

¹⁷⁸³ 07.04.2017, f. 12

¹⁷⁸⁴ 11.04.2017, f. 7

¹⁷⁸⁵ 11.04.2017, f. 7

¹⁷⁸⁶ 11.04.2017, f. 8

aktgjykimit.

4.15.3. Heroina e përzier me kafe

1498. Sipas **K2**, vozitësi ka ardhur në Tuzëll me Mercedes në shtëpinë e F.K.. K2 nuk e dinte se kishte ardhur ai, ai e kishte kuptuar rastësisht. Ai e kishte parë Mercedesin e tij me rrota dhe amortizatorë të larguar. Kjo ishte bërë nga A.Ka., S.A., F.K. dhe K1. Rezervari i derivateve nuk ka mundur të largohet pa njohurinë e mekanikut i cili e kishte ndërtuar atë. Ai ende ishte në Turqi.¹⁷⁸⁷
1499. **S.A.** në dëshminë e tij ka konfirmuar se ai e ka sjellë veturën në Tuzëll. K1 dhe K2 kanë qenë të pranishëm dhe ata vetë e kanë larguar rezervarin, nuk e kanë pritur mekanikun të kthehet nga Turqia. K1 dhe K2 po bërtisnin dhe po grindeshin, të cilën Akelic e kishte dëgjuar gjersa ishte jashtë shtëpisë së K2. K1 e ka thirrë “Ad.”in sepse malli ishte i cilësisë së keqe. K2 ishte jashtë vetes. S.A. nuk ishte paguar për këtë udhëtim. Ai nuk e dinte saktësisht se çfarë nuk ishte në rregull me këtë heroinë, ai vetëm kishte dëgjuar se ishte e cilësisë së keqe.¹⁷⁸⁸ Gjatë marrjes së tërthortë në pyetje, ai ka sqaruar se kjo është bërë në garazhin e F.K.. K1 dhe K2 kanë qenë të pranishëm.¹⁷⁸⁹
1500. Sipas **K2**, me këtë rast ka pasur një grindje të vogël në mes tij dhe të tjerëve. Ata kanë nxjerrë nga rezervari 25 topa të mbushur me kafe të përzier me heroinë. A.Ka., K1 dhe F.K. përfunduan kështu. Përveç tyre, aty ka qenë S.A. i cili nuk ishte i familjarizuar me këtë.¹⁷⁹⁰

¹⁷⁸⁷ 28.02.2017, f. 25 -26

¹⁷⁸⁸ 30.01.2017, f. 22

¹⁷⁸⁹ 30.01.2017, f. 34

¹⁷⁹⁰ 28.02.2017, f. 26

1501. K2 nuk e ka kuptuar se çfarë po ndodhte. Ai e ka thirrë N.K. dhe i ka thënë se nuk ka ardhur e llojit të njëjtë sikur herën e parë, por kishte ardhur diçka me ngjyrë të ndryshme. N.K. ishte i zhurmshëm dhe ka thënë “pse po ma thua mua këtë, kjo nuk është punë e imja. Unë ua kam dhënë paratë dhe dua që të mi ktheni paratë.”¹⁷⁹¹
1502. K2 nuk e ka gjetur kush ka qenë përgjegjës për këtë dërgesë të kafesë së përzier me heroinë.¹⁷⁹²
1503. **K1** ka dëshmuar në lidhje me këtë situatë edhe para edhe pas situatës me imunitetin. Edhe një herë është e qartë se ai e ka ndryshuar dëshminë e tij.
1504. Kur K1 ka dëshmuar pasi është udhëzuar si duhet në lidhje me fushëveprimin e imunitetit, ai ka thënë se para se dërgesa të shkojë në Turqi, K2 ka njoftuar se tashmë kishte bërë një marrëveshje me H.Kr. për shitjen e saj dhe se do të merret para për këtë. Sipas K1, K2 ka dashur të merr drogë nga atje; ai e ka bërë fshehurazi dhe më vonë është mashtruar.¹⁷⁹³ K2 gjithashtu ka thënë se e kishte një marrëveshje në Turqi me çmimin i cili ka qenë 7 – 8 dollarë për një tabletë ekstazi. Ai ka bërë aranzhime të tilla i vetëm, dhe K1 me të vërtetë nuk i dinte detajet.¹⁷⁹⁴

¹⁷⁹¹ 28.02.2017, f. 27

¹⁷⁹² 09.03.2017, f. 23

¹⁷⁹³ 02.11.2016, f.32

¹⁷⁹⁴ 07.11.2016, f. 7

1505. S.A. ka sjellë heroinë nga Turqia.¹⁷⁹⁵ Ai ka ardhur me Mercedes në apartamentin e F.K.. Është ngritur për ta nxjerrë heroinën. Të pranishëm ishin: S.A., K2, A.Ka., H.Me. dhe shumë persona tjerë.¹⁷⁹⁶
1506. K1 e dinte se ekstazia ka ardhur në Turqi, sepse më vonë ka ndodhur që S.A. nuk i ka sjellë paratë por 10 kg të diçka që dukej si kafe. Ai e ka sjellë këtë në Tuzëll, dhe K1 ka qenë i pranishëm aty. Heroina ka qenë e paketuar në formë të topit, pastaj në foli të plastikës dhe ka qenë e vendosur në rezervar.¹⁷⁹⁷ Askush nuk mund ta ndante heroinën nga kafja. K1 ka qenë i sigurt se aty kishte heroinë.¹⁷⁹⁸ Ata e kanë bërë një test të kësaj heroine dhe kanë vërtetuar se nuk kishte aq shumë heroinë në të. K1 nuk e dinte se çfarë kishin bërë me këtë përzierje.¹⁷⁹⁹
1507. K1 ka dëshmuar se K2 ka thënë se nuk ishte N.K. ai i cili e kishte krijuar këtë problem në Turqi.¹⁸⁰⁰ K1 nuk e dinte se kush e kishte mashtruar K2; edhe një herë ai ka sugjeruar që K2 duhet të pyetet në lidhje me këtë.¹⁸⁰¹
1508. Gjatë marrjes së tërthortë në pyetje, K1 ka theksuar qartë se N.K. nuk kishte asgjë të bënte me këtë dërgesë të heroinës.¹⁸⁰²
1509. Para se të udhëzohet si duhet lidhur me imunitetin, K1 ka dëshmuar mjaft thjeshtë lidhur me rrethanat që lidhen me dërgesën e heroinës së përzier me kafe, sidoqoftë, atë herë ai e ka përshkruar përfshirjen e N.K. në ngjarjet.

¹⁷⁹⁵ 02.11.2016, f.31

¹⁷⁹⁶ 07.11.2016, f.6-7

¹⁷⁹⁷ 02.11.2016, f.31-32

¹⁷⁹⁸ 07.11.2016, f. 7

¹⁷⁹⁹ 07.11.2016, f. 8

¹⁸⁰⁰ 07.11.2016, f. 7

¹⁸⁰¹ 02.11.2016, f. 31-32

¹⁸⁰² 10.11.2016, f. 11, 14

1510. Ngarkesa është sjellë në shtëpinë e F.K. nga S.A.. Të pranishëm ishin: A.Ka., H.Me., F.K., Zeljko, dhe nuk i kujtohet kush tjetër. ¹⁸⁰³
1511. Kur është larguar rezervari, ata kanë gjetur kafe dhe një sasi shumë të vogël të heroinës, të mbështjellur në qese najloni, në formë të topave të vegjël të rrumbullakët. Përafërsisht ka qenë 1 kg heroinë e përzier me 15 kg kafe. K1 nuk brengosej shumë lidhur me këtë dërgesë, kjo ishte më e rëndësishme për K2 i cili duhej t'ia paguante paratë N.K. ¹⁸⁰⁴
1512. Heroina ishte hedhur sepse nuk ka qenë e mundur të ndahet nga kafja. ¹⁸⁰⁵ K2 ka reaguar keq kur ka kuptuar se çfarë ishte sjellë. K1 nuk ka dashur të shpjegojë se çfarë problemesh kishin ndodhur. ¹⁸⁰⁶
1513. K2 ishte fjalosur me N.K., R.K., A.Ka. dhe gjithë të tjerët sepse ai është dashur t'i sillte paratë dhe nuk e kishte bërë këtë. ¹⁸⁰⁷ Kur është pyetur pse N.K. e kishte mashtruar K2 me heroinë, K1 ka thënë se ai kishte mendim shumë të ulët për të, ai ishte një mashtrues dhe bataçqi. ¹⁸⁰⁸ N.K. dhe të tjerët nuk ishin zemëruar, ishte vetëm K2 ai që ishte zemëruar. ¹⁸⁰⁹ K2 ishte në konflikt me të gjithë, jo vetëm me N.K. ¹⁸¹⁰
1514. K1 nuk kishte shkruar lidhur me këtë problem në fletoren e tij, sepse ishte vetëm 1 kg heroinë, nuk kishte asgjë për të shkruar. ¹⁸¹¹

¹⁸⁰³ 15.03.2016, f. 3 - 4

¹⁸⁰⁴ 15.03.2016, f. 4

¹⁸⁰⁵ 15.03.2016, f. 5

¹⁸⁰⁶ 15.03.2016, f. 8

¹⁸⁰⁷ 15.03.2016, f. 8

¹⁸⁰⁸ 15.03.2016, f. 8`

¹⁸⁰⁹ 15.03.2016, f. 8

¹⁸¹⁰ 15.03.2017, f. 9 - 10

1515. **H.Mu.** e ka pranuar se kishte dëgjuar se ishin mashtruar dhe kishin marrë kafe në vend të drogës.¹⁸¹² Ai e kishte dëgjuar nga K2 i cili ka thënë se është dashur t'i lë dy apartamente në pronësi të gruas së tij si kolateral për të paguar për drogë, dhe pastaj ai është mashtruar. Gjatë gjykimit, H.Mu. ka mësuar se ai është mashtruar nga K1¹⁸¹³ ose të afërmit e tij, gjatë dëshmisë në marrjen e tërthortë në pyetje.¹⁸¹⁴

1516. Sipas **S.A.**, K2 ishte futur në telashe për shkak të kësaj dërgese. K2 nuk ishte në gjendje të paguante K1, gjithashtu edhe për paratë e huazuara nga ai. Ai nuk e dinte nëse ky problem ishte zgjedhur përfundimisht.¹⁸¹⁵ Pas kësaj situatë, S.A. më asnjëherë nuk ka punuar për K2.¹⁸¹⁶

Përfundim

1517. Nuk ka asnjë provë për ta mbështetur pretendimin e K2 se N.K. ka qenë i përfshirë në dërgesën e heroinës së përzier me kafe e cila ishte sjellë nga S.A. nga Turqia. Ai ka qenë i vetmi i cili ka dëshmuar në këtë mënyrë. K1 e ka mohuar kategorikisht se N.K. ka pasur ndonjë lidhje me këtë situatë.

4.16. Pikat: 8 dhe 9

Përmbledhje e pretendimeve

Në verën e vitit 2003, K2 kishte rënë dakord që të voziste për në Austri një automjet VW Caddy për të marrë një kamionë të madh me mushama atje për të Pandehurin N.K.

¹⁸¹¹ 15.03.2016, f. 31

¹⁸¹² 27.01.2017, f. 13

¹⁸¹³ 27.01.2017, f. 15

¹⁸¹⁴ 27.01.2017, f. 18

¹⁸¹⁵ 30.01.2017, f. 23

¹⁸¹⁶ 30.01.2017, f. 24

Edhe pse K2 kishte dyshuar se mund të kishte drogë në VW Caddy, mekaniku i tij nuk ka mundur të gjejë asgjë. Pasi vozitjes të automjetit për në Austri, K2 ka parë se si kishin nxjerrë drogë nga astari tavanit të brendshëm të automjetit në paketa në formë katrore, të paketuara me ngjitës. K2 e ka përshkruar këtë dërgesë si “sasi shumë më e madhe sesa ajo që kam transportuar nga Turqia” (dërgesa e mëparshme përmbante 25 kilogramë Heroinë). Kur është pyetur nga K2, dy shqiptarë të pranishëm në vendngjarje kanë konfirmuar që paketat përmbanin Heroinë. Kur K2 më vonë ka pyetur N.K., kur u kthye në Sarajevë, lidhur me Heroinën e fshehur në tavanin e VW Caddy, N.K. konfirmoi se ai kishte rregulluar për këtë transferim droge.

Më pas, K2 ka sjellë kamionin e lartpërmendur me pëlhurë të gomuar nga Austria për në Sarajevë ku i Pandehuri N.K. ka mbikëqyrur procesin e transferimit të mbi 2 ton acid anhidrid acetik me një numër i madh fuçish të kaltërta përmes një tubi të bardhë në gropëza të fshehura të përshtatura në pëlhurën e gomuar që ishte vendosur për të mbuluar kamionin. Duke mos e ditur se çfarë substancash ishin futur në gropëzat e fshehta në pëlhurën e gomuar, K2 i ishte djegur dora kur kishte prekur acidin. Ky acid është përdorur për procesin e “larjes” së Heroinës me qëllim që të rritet niveli i pastërtisë, dhe përfundimisht që të bëhet e ashtuquajtura “Heroina e Bardhë”, një formë shumë më e koncentruar e drogës. Pëlhura e mbushur me acid pastaj ishte transportuar drejt një vendi të panjohur për K2, megjithatë, me shumë gjasa për në Turqi.

1518. Në kontekstin e këtyre pikave, gjykata e konsideron të domosdoshme adresimin e disa situatave të cilat i kanë paraprirë ngjarjeve të prezantuara në këto akuza.

4.16.1 Takimi në pyll

1519. Përkundër armiqësisë së dukshme ndërmjet K1 dhe K2 të cilët në shumë raste kanë folur me përbuzje për njëri tjetrin dhe përkundër faktit që K1 është tërhequr nga pjesa relevante të dëshmive të tij para se t'i jepen udhëzimet e duhura në lidhje me imunitetin, ata të dy kanë dëshmuar në mënyrë të ngjashme lidhur me ngjarjet në pyllin Ingman në Sarajevë.
1520. Sipas **K2**, pas dërgesës së heroinës së përzier me kafe, ka ndodhur takimi në pyll në rrugën në drejtim të Mostarit. K1 dhe A.Ka. e kanë dërguar atë atje.¹⁸¹⁷
1521. N.K. ka ardhur atje me xhipin e tij. Personat që e shoqëronin atë ia kanë marrë K2 xhaketën dhe telefonin e tij. Me sa i kujtohet, ata gjithashtu i kanë marrë edhe telefonat celular të K1 dhe A.Ka.. K1 po qante dhe po e shpjegonte situatën. Ai ka thënë se më shumë ishte faji i tij sesa i K2.¹⁸¹⁸
1522. K2 u pajtuar që t'ia paguaj N.K 11.000 euro me këste mujore. Janë pajtuar që të paguhet deri të kthehet shuma e plotë prej 110.000 euro. Kësti i parë duhet të paguhej menjëherë. Ai e ka paguar, por jo me para të gatshme.¹⁸¹⁹
1523. Sipas **K1**, kjo situatë ka ndodhur në pyllin Ingman afër Sarajevës në verën e vitit 2003.¹⁸²⁰ Takimi është organizuar nga N.K., A.Ka., R.K., Su.Ku. dhe K.Ku.. Ata të gjithë kanë qenë të armatosur.¹⁸²¹ K1 është ftuar të vijë, sepse ai ka qenë i

¹⁸¹⁷ 28.02.2017, f. 28

¹⁸¹⁸ 28.02.2017, f. 28 -29

¹⁸¹⁹ 09.03.2017, f. 5

¹⁸²⁰ 15.03.2017, f. 11, 07.11.2016, f.8

¹⁸²¹ 07.11.2016, f.11, 07.11.2016, f.8

pranishëm kur ka ardhur heroina e përzier me kafe. Gjithashtu, edhe F.K. ka qenë i pranishëm.¹⁸²² K1 ka ardhur aty me A.KA. dhe R.K. Ata e kishin marrë atë nga restoranti Brajlovic.¹⁸²³

1524. Gjatë këtij takimi, N.K. e ka pyetur K2 kur do t'ia kthente paratë. Ai i ka thënë atij se i ka tejkalar të gjithë kufijtë. K2 është betuar se do t'ia kthente paratë, dhe ai po jepte premtime.¹⁸²⁴ Madje, ka ndodhur që N.K. e kishte nxjerrë revolen dhe e kishte kërcënuar që K2 duhet t'i ndërpriste gënjeshttrat dhe t'ia kthejë borxhin. Të tjerët kanë qëndruar në mes tyre dhe janë munduar ta qetësojnë situatën.¹⁸²⁵ K2 kishte frikë, ai nuk ndihej mirë. Ai po gënjente, jepte premtime, tregonte tregime.¹⁸²⁶ Ai gjithashtu ka premtuar se do t'i paguaj të gjitha borxhet e tij.¹⁸²⁷ N.K. e ka pranuar këtë premtim.²¹⁴⁶

1525. ¹⁸²⁸Borxhet e K2 ndaj N.K kanë rezultuar nga koha kur K1 ka qenë në Gjermani dhe ata kanë qenë të lidhur me punën e tyre që kanë pasur në lidhje me armët. K1 nuk e dinte se sa i kishte K2 borxh N.K., sidoqoftë ka qenë shumë e lartë, dhe rritej për shkak të kamatës.¹⁸²⁹

1526. Pas kësaj situatë në pyll, K1 ka marrë 60000 euro nga motra e tij dhe ia ka huazuar K2 për ta kthyer të paktën një pjesë të këtij borxhi. Ka qenë 15 ditë – 1 muaj pas situatës në pyll.¹⁸³⁰ K1 ka vendosur t'i huazoj para K2 sepse ai po i

¹⁸²² 15.03.2017, f. 11- 12

¹⁸²³ 15.03.2017, f. 12

¹⁸²⁴ 07.11.2016, f.9

¹⁸²⁵ 07.11.2016, f.11, 15.03.2017, f. 10

¹⁸²⁶ 07.11.2016, f.10, 11

¹⁸²⁷ 15.03.2017, f. 11

¹⁸²⁸ 15.03.2017, f. 13

¹⁸²⁹ 07.11.2016, f.8, 10

¹⁸³⁰ 07.11.2016, f. 9, 12 - 13

jepte premtime atij, dhe ai gjithashtu ishte bindur nga A.Ka. dhe R.K. duke thënë se ata do ta marrin përgjegjësinë për këtë borxh. Sidoqoftë, pastaj ka ndodhur që K1 nuk ia ka kthyer paratë.¹⁸³¹ Në vend se ta paguaj borxhin, K2 i ka përdorë paratë e marra nga K1 për të blerë disa xhaketa të lëkurës për butikun e tij.¹⁸³² Gjatë marrjes së tërthortë në pyetje, K1 e ka pranuar se ka investuar 60.000 euro në biznesin e K2, sidoqoftë pak më vonë, ai përsëri ka thënë se ia kishte huazuar.¹⁸³³

1527. K1 nuk e ka ditur nëse K2 i ka paguar borxhet e tij ndaj N.K. Ai ka paguar diçka, ai nuk ia ka kthyer borxhin atij, dhe po fshihej për një kohë.¹⁸³⁴ Ai nuk ia ka kthyer paratë K1, dhe pastaj me një rast në Sarajevë, K1 ia ka marrë K2 xhipin ML, pastaj ka vozitur tek butiku i tij dhe i ka marrë 200 – 300 xhaketa të lëkurës. Ka qenë një apo dy muaj pas huazimit të parave. K1 nuk ia ka kthyer xhipin.¹⁸³⁵

1528. K1 ka dëgjuar vetëm nga K2 se ai po punonte për N.K., ai e fajësonte atë për të gjitha problemet e tij. Ai i ka dëgjuar të gjitha këto tregime kur e ka takuar K2 në Ilidza, tashmë në vitin 2002.¹⁸³⁶ Ai gjithashtu ka dëgjuar nga A.Ka. dhe R.K. se K2 ishte pjesë e ekipit të tyre. Sidoqoftë, K2 asnjëherë nuk ka respektuar asnjë marrëveshje.¹⁸³⁷

¹⁸³¹ 07.11.2016, f.13

¹⁸³² 07.11.2016, f.13

¹⁸³³ 10.11.2016, f. 15

¹⁸³⁴ 07.11.2016, f.12

¹⁸³⁵ 07.11.2016, f.13

¹⁸³⁶ 07.11.2016, f.15

¹⁸³⁷ 07.11.2016, f.15, 16

1529. Gjatë këtij takimi K2 ka premtuar se do të jetë korrekt dhe i sinqertë, por ai ka vazhduar të bëjë gjëra të pista.¹⁸³⁸ Pas kësaj, ai e ka vrarë F.K., e ka rrëmbyer M.K. dhe të gjitha gjërat më të këqija.¹⁸³⁹

Përfundim

1530. Në dritën e dëshmive të dëshmitarëve K1 dhe K2, gjykata e konsideron të provuar se ka ndodhur takimi në pyllin Ingman gjatë të cilit K2 ka premtuar se do t'i paguaj borxhet e tij ndaj N.K. Borxhi nuk ka qenë i lidhur me drogën, por ka qenë si rezultat i një biznesi tjetër ndërmjet N.K dhe K2. Sidoqoftë, nuk ka qenë e mundur të vërtetohet shkaku i borxhit për shkak se dëshmitë e K1 dhe K2 në mënyrë të konsiderueshme dallojnë nga njëra tjetra. Njëra prej tyre thotë se kishte të bënte me armët, tjetra thoshte – me drogë). Nuk ka pasur prova vërtetuese për të mbështetur njërin nga versionet.

1531. Kjo pjesë e deklaratave vërtetuese reciproke të K1 dhe K2 konfirmon se N.K. dhe K1 e kanë njohur njëri tjetrin. Prandaj, gjykata nuk i ka besuar të akuzuarit ai ka mohuar të ketë pasur ndonjë kontakt me K1 përkundër situatës kur ai ka ardhur për ta paralajmëruar në lidhje me tentativën e Z.T. për të vendosur eksploziv gjatë dasmës së djalit të tij.¹⁸⁴⁰

1532. Në këtë kontekst, gjykata vëren se dëshmia e M.Ko., avokati i N.K, në lidhje me kontaktet e tij me K1 është vlerësuar si e vërtetë dhe e besueshme. Ky dëshmitar ka përshkruar në hollësi takimet e tij me K1 të cilat kanë ndodhur në rastet kur M.Ko. e ka vizituar burgun ku ai po i kryente detyrat e tij profesionale. Ai

¹⁸³⁸ 15.03.2017, f. 10

¹⁸³⁹ 15.03.2017, f. 13

¹⁸⁴⁰ 18.01.2018, f. 41 - 42

gjithashtu e ka paraqitur situatën kur K1 e ka kontaktuar atë për ta njoftuar në lidhje me sulmin kundër N.K. të planifikuar nga Z.T. Ai e ka pranuar se e ka dërguar K1 te N.K., sidoqoftë ai nuk ka qëndruar gjatë bisedës së tyre për shkak të obligimeve të tjera. Ai nuk e ka vërejtur se ata e kanë njohur njëri tjetrin.¹⁸⁴¹ Në dritën e provave të K1 dhe K2, gjykata ka vërtetuar se N.K. nuk e ka informuar M.Ko. se ai e ka njohur K1.

1533. Gjatë vlerësimit të kredibilitetit të dëshmitarëve K1 dhe K2 në këtë kontekst, gjykata ka vërejtur se ka qenë situata e vetme, sipas tyre, ku N.K. ka qenë i përfshirë dhe që të dy prej tyre e kanë përshkruar se çfarë po ndodhte në mënyrë shumë të ngjashme. Dallimi në lidhje me përshkrimin e gjendjes emocionale të secilit prej tyre sepse K2 pretendonte se K1 po qante, kurse K1 ka dëshmuar se ishte K2 ai i cili ka qenë shumë i frikësuar dhe po ndihej keq. Gjithashtu, duket theksuar se përkundër kësaj përputhjeje të versioneve, K1 e ka konsideruar të domosdoshme të përmend se pas kësaj situatë në pyll, K2 ka filluar të sillet në mënyrë të pandershme.

4.16.2. Pagesa e kësteve

1534. **K2** ka dëshmuar se K2 e kishte paguar këstin e parë në mënyrën si në vijim: një shqiptar (M.Le. nga Gjilani¹⁸⁴²) nga Kosova ka ardhur te K2 i shoqëruar nga një person tjetër. M.Le. ka thënë se kishte disa drogë në Kroaci dhe se duhej ta paguante vozitësin 85000 euro për ta sjellë atë në Bosnje. K2 është dashur ta jap

¹⁸⁴¹ 08.12.2016, p. 4 - 11

¹⁸⁴² 16.03.2017, f. 8

Mercedesin e tij si kolateral për t'i marrë 8,000 euro për të paguar për 7.5 kg të drogës që duhet të sillej nga Kroacia.¹⁸⁴³

1535. Kur ka ardhur droga, K2 ka kërkuar nga K1 dhe A.KA. që ta kontrollojnë cilësinë e saj. Ai e kishte dërguar te ata, ata e kanë marrë një kilogram dhe për atë kishin paguar 12.000 euro. Pastaj, ata e kanë thirrë N.K. për ta njoftuar se i kishin paratë për këstin e parë. Paratë kanë mbetur tek K1 dhe A.Ka..¹⁸⁴⁴

1536. Pagesën e dytë K2 e kishte bërë në të njëjtën mënyrë. A.Ka. dhe K2 e kanë kontaktuar atë me një person nga Banja Lluka i cili ishte i interesuar për të blerë heroinë. Ai e ka dërguar atje një mostër të drogës. Më pas, ai i ka dërguar 2 kg heroinë te Vahir Pajic në Banja Llukë përmes vozitësit të tij H.Mu.. Pastaj ka ndodhur një problem, sepse Vahir nuk ka ishte i kënaqur me cilësinë e heroinës dhe donte që t'i ktheheshin paratë. Ishte shumë vonë sepse K2 tashmë ia kishte dhënë paratë K1 dhe A.Ka. dhe gjithashtu edhe 2,5 kg heroinë. Problemi nuk është zgjidhur sepse K2 nuk ka pasur para dhe V.Pa. është arrestuar.¹⁸⁴⁵

1537. **H.Mu.** ka konfirmuar se e kishte sjellë një pako nga K2 në Banja Llukë dhe atë ia kishte dhënë një burri me nofkën "Do.". K2 i ka thënë atij se përmbajtja e kësaj pakoje është sekrete. H.Mu. ka marrë 8000 euro nga "Do." të cilat ia ka dhënë K2. Në ditën në vijim, pas dërgesës "Do." e ka hapur kutinë dhe i ka treguar H.Mu. çfarë kishte brenda. "Do." i ka treguar H.Mu. dy pako të mbështjella me plastikë me pluhur brenda.¹⁸⁴⁶ Gjatë udhëtimit të tij për në Tuzëll

¹⁸⁴³ 09.03.2017, f. 5

¹⁸⁴⁴ 09.03.2017, f. 5 - 6

¹⁸⁴⁵ 09.03.2017, f. 7

¹⁸⁴⁶ 27.01.2017, f. 9-10

ku “Do.” kishte shkuar për tu takuar me K2. Ai është ndalur nga policia.¹⁸⁴⁷

1538. K2 e ka paguar këstin e tretë në atë mënyrë që i kishte dhënë 11.000 euro një shqiptari me emrin “Ln.” në Sarajevë, Stup. Atij i kishte thënë N.K. që ta bënte këtë.¹⁸⁴⁸

1539. K2 e ka paguar edhe një këst me paratë të cilat i ka marrë për 2 kg heroinë të cilën ia ka shitur Hasic Nadil dhe Hadzic Margareta për 12.000 euro.¹⁸⁴⁹

Përfundim

1540. Gjykata ka përfunduar se janë paraqitur prova për ta vërtetuar dëshminë e K2 në lidhje me transaksionet e drogës të cilat ai i ka përshkruar në këtë pjesë. Këto fakte janë konfirmuar nga dëshmitarët M.Ha. dhe H.Mu.. Prandaj, gjykata e ka gjetur të provuar se transaksionet në fjalë kanë ndodhur vërtetë. Duhet theksuar se ato transaksione nuk e kanë konfirmuar as pjesëmarrjen e N.K e as ndonjë përfshirje tjetër.

1541. Në të njëjtën kohë, nuk ka pasur asnjë provë në mbështetje të deklaratës së K2 se paratë e fituara përmes këtyre transaksioneve të drogës janë përdorë për t'i paguar të paktën disa nga këstet e fundit të borxhit të tij ndaj N.K. Posaçërisht K1, dëshmitari i vetëm i cili e ka konfirmuar ekzistimin e këtij borxhi, nuk ka pasur njohuri në lidhje me pagesën e cila gjoja është bërë nga K2. Prandaj, gjykata e ka gjetur një pjesë të dëshmisë së K2 të pambështetur.

¹⁸⁴⁷ 27.01.2017, f. 10

¹⁸⁴⁸ 09.03.2017, f. 8

¹⁸⁴⁹ 09.03.2017, f. 7-8

4.16.3 Udhëtimi në Austri

1542. **K2** ka dëshmuar se në korrik /gusht 2003, N.K. i ka propozuar atij që të shkojë në Austri për ta sjellë një ceradë për një automjet të gjatë. Si shpërblim për këtë shërbim, K2 nuk do të kishte nevojë të paguante një kamatë dhe ishte më shumë se një muaj e gjysmë. K2 e ka pyetur N.K. nëse kishte të bënte ndonjë gjë me drogën, por N.K. e ka siguruar atë se jo. K2 e ka pranuar ofertën.¹⁸⁵⁰
1543. K2 e ka marrë veturën VW Caddy me të cilën duhej të shkonte në Austri nga pompa e benzinës në Zivinice. Ai e ka marrë autorizimin ndërkombëtar për ta vozitur këtë veturë jashtë vendit. Sipas K2, është e mundur që gjithashtu edhe A.Ka. ka qenë i pranishëm.¹⁸⁵¹¹⁸⁵²
1544. **A.Ka.** e ka mohuar se e ka njohur K2 dhe pjesëmarrjen në ndonjë aksion me atë.
2170
1545. K2 e ka dërguar veturën te mekaniku për të kontrolluar nëse ka pasur diçka të fshehur në të. Ai i ka thënë mekanikut se mund të ketë pasur armë të fshehura. Mekaniku e ka kontrolluar veturën dhe nuk ka gjetur asgjë.¹⁸⁵³
1546. K2 është nisur për në Austri. Ai ka qëndruar në kontakt përmes telefonit me një burrë shqiptar me të cilin duhej të takohej në Slloveni. Ai është takuar me atë në Slloveni në një pompë të benzinës dhe K2 i ka thënë që ta përcjellë atë. Në këtë mënyrë ata kanë udhëtuar për në Austri në një vend me hangarë.¹⁸⁵⁴

¹⁸⁵⁰ 09.03.2017, f. 8-9

¹⁸⁵¹ 09.03.2017, f. 9

¹⁸⁵² 27.02.2017, f. 19

¹⁸⁵³ 09.03.2017, f. 10

¹⁸⁵⁴ 09.03.2017, f. 10

1547. Në njërin nga hangarët kanë qenë dy burra, shtetas gjerman. K2 e ka lënë veturën aty. Ai është dërguar në një hotel, dhe vetëm atëherë e ka kuptuar se e kishte harruar telefonin në veturë. Prandaj, ai ka marrë një taksi dhe është kthyer tek hangarët. Kur ka hyrë aty, ai ka parë se shqiptari dhe dy gjermanët e kishin larguar tavanin e veturës dhe i kishin shkarkuar pakot të cilat ishin të ngjashme me pakot që përmbanin 25 kg heroinë të cilat i kishte sjellë nga Turqia më parë.¹⁸⁵⁵
1548. Pasi është kthyer në Sarajevë, N.K. e ka konfirmuar se kjo ka qenë drogë. Ai i ka thënë K2 “çfarë ke pritur, të sjellësh vetëm ceradë për 11.000 euro?”.¹⁸⁵⁶
1549. Një ditë pas situatës në hangar, K2 është kthyer në Sarajevë me ceradën e ngarkuar në veturën VW Caddy. Para se të largohet, ai ka kontrolluar me ata persona nëse ishte fshehur diçka në ceradë.¹⁸⁵⁷
1550. Në Sarajevë, K2 është takuar me A.Ka.. Ata kanë shkuar tek një depo shumë e madhe dhe kanë pritur që të vijë një kamion. Aty kanë qenë disa burra të ri. Kamioni ka ardhur, dhe pastaj ata e kanë vendosur ceradën e cila ishte sjellë nga K2 në atë kamion. Cerada kishte xhepa të cilët shërbenin si rezervar për masë të lëngshme. Ata kanë sjellë disa fuçi të kaltra nga depoja dhe përmes pompës kanë futur një lloj lëngu nga fuçitë në xhepat e ceradës. K2 ishte i bindur se ai lëng ishte një prekursor i caktuar për përpunimin e drogës, një lloj acidi.¹⁸⁵⁸
1551. K1 e ka konfirmuar se K2 është takuar me N.K. në lidhje me mbulesën e

¹⁸⁵⁵ 09.03.2017, f. 10 - 11

¹⁸⁵⁶ 09.03.2017, f. 11

¹⁸⁵⁷ 09.03.2017, f. 11

¹⁸⁵⁸ 09.03.2017, f. 12 - 13

plastikës e cila ishte planifikuar të transportohej në Austri.¹⁸⁵⁹ K2 i ka thënë K1 se N.K. e ka dërguar atë në Austri për ta marrë një ceradë për një kamionë të gjatë. K2 ka shkuar atje me veturën VW Caddy. Ai nuk ka qenë në dijeni se ka pasur heroinë të fshehur në veturë.¹⁸⁶⁰

Përfundim

1552. Gjykata ka gjetur të provuar se K2 me kërkesë të N.K ka transportuar në Austri 25 kg heroinë të fshehur në një pjesë të ndarë të krijuar në tavanin e veturës VW Caddy. Kjo gjetje rezulton nga pjesa e dëshmisë së dëshmitarit K2 e cila gjithashtu është vërtetuar nga deklaratat e K1. N.K. ka qenë në dijeni të plotë të ngarkesës të cilën K2 e ka dërguar në Austri.
1553. Pas udhëzimit të duhur për imunitetin, K1 është tërhequr nga shumica e deklaratave të tij në lidhje me bashkëpunimin në trafikimin e drogën në mes N.K dhe K2. K1 vazhdimisht e ka mohuar çfarëdo përfshirje të N.K në kontrabandimin e tabletave ekstazi nga K2. Përkundër kësaj, ai ka qenë këmbëngulës në konfirmimin se N.K. e ka dërguar K2 në Austri me veturën VW Caddy me ngarkesë të heroinës të fshehur në të.
1554. Dëshmia e K1 në lidhje me transportimi ne heroinës në Austri është bazuar në tregimin që i është paraqitur atij nga K2. K1 citonte thëniet e K2 të cilat përbënin deklaram kundër interesave të tij në atë kohë. Kjo deklaratë është bërë para fillimit të gjyqimit dhe ka qenë në kundërshtim të interesit personal të deklaruesit pasi që ka mundur ta ekspozojë atë ndaj rrezikut për përgjegjësi penale. Gjykata

¹⁸⁵⁹ 07.11.2016, f.10

¹⁸⁶⁰ 07.11.2016, f.12, 15.03.2017, f. 9

ka përfunduar se një person i arsyeshëm në pozitën e tij nuk do ta bënte këtë deklaratë po të mos ishte e vërtetë. Në të njëjtën kohë K2 e ka konfirmuar tregimin para gjykatës.

1555. Gjykata i ka vlerësuar si të paqëndrueshme pretendimet e K2 se ai nuk ka qenë në dijeni se në veturë ishte fshehur heroinë. Kjo pjesë e dëshmisë së tij ka pasur për qëllim që ta mbështesë versionin e tij se ai po luftonte kundër trafikimit të drogës dhe nuk ishte edhe vet diler i drogës. Së pari, është në kundërshtim me logjikën që të pritet pagesa prej 11.000 euro për një shërbim të tillë si transportimi i ceradës nga Austria. Së dyti, çdo mekanik, posaçërisht një profesionist si ai që e ka kontrolluar veturën VW Caddy për K2, duhet ta ketë vërejtur tavanin e salduar, posaçërisht pas një kontrolli të hollësishëm.

1556. Gjykata ka vërtetuar se ngarkesa e fshehur në veturë ka qenë 25 kg heroinë. Kjo gjetje është bërë në bazë të prezumimit faktik mbi këto premisa:

(1) Ngarkesa është fshehur në mënyrë të sofistikuar, duhet të ketë qenë e kundërligjshme;

(2) Ngarkesa ka qenë me vlerë të konsiderueshme sepse vetëm shpërblimi për transport ka qenë 11000 euro;

(3) K2 ka pasur përvojë me heroinë, prandaj gjykata është e bindur se ai e ka njohur si duhet substancën e cila ka qenë e fshehur në tavanin e veturës VW Caddy dhe peshën e paketës.

1557. Gjatë vlerësimit të sasisë të heroinës, gjykata ka marrë parasysh se K2 nuk i është kujtuar se sa paketa i ka parë në të vërtetë. Të gjitha dyshimet sa i përket numrit të paketave është dashur të merren parasysh në dobi të të akuzuarit.

Supozimi logjik ka qenë se K2 duhet të ketë parë të paktën një paketë pasi që ai ka qenë në gjendja ta njohë atë. Prandaj, pesha totale e ngarkesës është vërtetuar nga gjykata si 25 kg.

1558. Nuk ka pasur prova të mjaftueshme për ta mbështetur pikën 9 të aktakuzës. Dëshmia e K2 në lidhje me futjen me pompë të prekursorit të supozuar në xhepat brenda ceradës nuk është vërtetuar me asnjë provë tjetër. Në veçanti, nuk është mbështetur nga K1.

1559. Më 14 shtator 2017, mbrojtja ka paraqitur propozim për marrjen e provave të kopjeve të autorizimit për veturën VW Caddy e cila është përdorë nga K2. Gjykata e ka gjetur të parëndësishme se kush ka qenë pronar i kësaj veture.¹⁸⁶¹

4.16.4 Pas situatës me ceradë

1560. **K2** ka dëshmuar se pas situatës me ceradë, ai është takuar me N.K. në Tiranë në prani të Samir dhe B.Ku. Aty gjithashtu ka qenë edhe R.L. Ai donte ta aranzhonte me N.K. se do ta paguante borxhin deri në gusht të vitit 2004. B.Ku. si një burrë i moshuar duhej të ishte si një garantues moral i kësaj marrëveshjeje.¹⁸⁶²

1561. Me këtë rast, N.K. gjoja i ka ofruar K2 të zhvendoset në Holandë ku do të merrej me heroinë për ta transportuar në Angli. Çdo muaj ai do të merrte 100 kg heroinë. K2 nuk e ka pranuar ofertën. Sidoqoftë, ai është marrë vesh me N.K. se do t'ia kthente paratë deri në gusht 2004.¹⁸⁶³ Në parim, N.K. u pajtua që ta

¹⁸⁶¹ 03.10.2017

¹⁸⁶² 09.03.2017, f. 13-15

¹⁸⁶³ 09.03.2017, f. 15

shtyjë pagesën e pjesës së mbetur të borxhit, por sipas K2 ai nuk besonte se do t'ia arrinte.¹⁸⁶⁴ Sipas K2, ai ende i ka borxh N.K. rreth 50.000 euro.¹⁸⁶⁵

1562. K2 ka theksuar se ai do ta pranonte këtë ofertë të N.K. nëse do të ishte në Itali, sepse ai kishte më shumë besim në policinë e Italisë. Pastaj, ai do ta raportonte këtë aktivitet te autoritetet. Ai ka qenë luftëtar kundër drogës.¹⁸⁶⁶

1563. **Sa.Ku.** e ka mohuar njohjen e N.K. Ai e ka përjashtuar se situata në Tiranë ka ndodhur. Babai i tij B.Ku. nuk e ka njohur N.K.¹⁸⁶⁷

Përfundim

1564. Prokurori nuk ka paraqitur asnjë provë të besueshme për ta mbështetur deklaratën e K2 se ka ndodhur një takim në Tiranë në mes tij dhe N.K i mundësuar nga B.Ku. dhe Sa.Ku. Çështja nëse N.K. dhe Sa.Ku. e kanë njohur njëri tjetrin do të diskutohet në pjesën e më tutjeshme të aktgjykimit.

4.17. Komentet shtesë mbi dëshminë e K2

1565. K2 është dënuar me 26 vjet burgim në Bosnje dhe ky aktgjykim është tashmë i formës së prerë.

1566. Nga provat e mbledhura në këtë gjykim është bërë e qartë se që nga fillimi ai ka bërë përpjekje që të fitojë avantazhe që do ta përmirësonin situatën e tij si i dënuar. Kjo vërejtje është bërë nga gjykata gjithashtu edhe në bazë të dëshmive të paraqitura nga dëshmitarët e mbrojtjes: M.Ha., H.Mu., M.A.G., Sa.Ku. dhe pjesërisht I.H. Dëshmitë janë paraqitur si të logjikshme dhe e kanë plotësuar

¹⁸⁶⁴ 09.03.2017, f. 25

¹⁸⁶⁵ 09.03.2017, f. 25

¹⁸⁶⁶ 09.03.2017, f. 24 - 25

¹⁸⁶⁷ 17.03.2017, f. 31

njëra tjetrën dhe prandaj ato kanë qenë bindëse.

1567. Sipas M.A.G., K2 po thoshte përreth se kur të dënohet N.K., ai do të lirohet. Të gjithë e kanë ditur se K2 ka qenë dëshmitar në këtë gjykim. Sipas tij, K2 ende po merrej me drogë, madje edhe sa ka qenë në burg.

1568. Nga provat e mbledhura rezulton se K2 ishte në kontakt me ish bashkëpjesëmarrësit e tij dhe të njohshmit në lidhje me deklaratat e tij potenciale kundër N.K. Ai pretendonte se ka pasur përpjekje për të ndikuar në atë për të mos dëshmuar, kurse dëshmitarët e tjerë kanë thënë se ka qenë ai i cili i ka udhëzuar çfarë të thonë në procedurën kundër N.K.

Përpjekja për t'iu afruar K2 në burg

1569. **K2** ka theksuar se në vitin 2005, I.H. i cili sipas tij ka punuar për N.K., e ka vizituar atë i shoqëruar nga një burrë tjetër dhe i ka thënë që të mos dëshmojë kundër N.K., dhe të gjitha borxhet e tij do të shlyheshin. K2 nuk e ka njohur I.H. atëherë, sidoqoftë ai ka premtuar se nuk do ta përmend N.K.²¹⁸⁶

1570. Gjatë marrjes së tërthortë në pyetje, K2 ka shpjeguar se këta persona të cilët e kanë vizituar atë në burg kanë qenë të panjohur për të dhe ata i janë prezantuar me emra të rrejshëm. Ai i ka lexuar emrat e tyre vetëm më vonë në gazetë. Këta persona kanë qenë I.H. dhe Mehmeti. Kur ata e kanë vizituar atë, ata kanë marrë leje nga gjykata. Gati që nga fillimi ata flisnin se si të zgjidhet problemi me N.K. në lidhje me borxhin.²¹⁸⁷ Kur është pyetur se si ka qenë e mundur të ketë biseduar me persona tërësisht të panjohshëm në lidhje me problemet e tij me gjoja një person shumë të rrezikshëm, siç është portretizuar N.K. nga ai, K2 i

është shmangur përgjigjes. Ai vetëm ka thënë se ata i kanë thënë që mos ta përmend N.K.²¹⁸⁸

1571. **I.H.** e ka pranuar se e ka njohur K2. Ai e ka takuar atë në burg në Zenicë më 2009. I.H. ishte dënuar me 2 vjet dhe 9 muaj. 6 muajt e parë ai i ka vuajtur në Sarajevë, më pas është dërguar në Zenicë nga ku është larguar më 2010. Ai e ka takuar K2 gjatë pauzave.¹⁸⁶⁸ Ata janë bërë shokë në burg.¹⁸⁶⁹

1572. Vetëm më vonë, I.H. e ka përmendur se K2 e ka takuar më parë, dhe ka qenë qysh në vitin 2007. Ai ka ardhur për ta vizituar së bashku me shokun e tij Muhamet Mehmetin. I.H. nuk e ka njohur K2 atëherë, ai e ka vizituar atë si një shqiptar. K2 ka qenë tashmë i dënuar atëherë. Fillimisht, ai ka thënë se Muhamet Mehmeti e ka njohur K2 përmes Sa.Ku., sidoqoftë, pas një momenti ai ka thënë se nuk e dinte nëse Mehmeti e ka njohur atë, por besonte se po.¹⁸⁷⁰

1573. Kjo vizitë ka zgjatur rreth 45 minuta. Nuk ka pasur ndonjë temë specifike, ata kanë biseduar në përgjithësi për jetën në burg.¹⁸⁷¹ Kur është pyetur lidhur me arsyet e kësaj vizite, ai ka thënë se nuk i kujtohet se pse Muhamet Mehmeti ka dashur të shkojë atje, por ai ka shtuar se e kishte vizituar K2 sepse familja e Sa.Ku. ka qëndruar në shtëpinë e tij gjatë luftës dhe për shkak se ai ishte

¹⁸⁶⁸ 28.03.2017, f. 22-23

¹⁸⁶⁹ 28.03.2017, f. 30

¹⁸⁷⁰ 28.03.2017, f. 24 - 25

¹⁸⁷¹ 28.03.2017, f. 25

shqiptar. Ka qenë iniciativë e tyre e përbashkët për të shkuar atje.¹⁸⁷² Ata nuk i kanë ofruar K2 asgjë. Atij nuk i kujtohej nëse e ka vizituar K2 përsëri. Ai ka mohuar të ketë biseduar ndonjë gjë në lidhje me gjykimin e tij.¹⁸⁷³

1574. I.H. është ballafaquar me deklaratën e K2 i cili ka thënë se dy persona të panjohur e kishin vizituar më 2005 derisa ende ka qenë në paraburgim dhe i kanë kërkuar atij që të mos dëshmojë kundër N.K. Në këmbim ai duhej ta ndihmonte atë dhe familjen e tij. Me njërin nga këta persona ai më vonë ka përfunduar në burg. I.H. e ka mohuar këtë.¹⁸⁷⁴

Përfundim

1575. Gjykata e ka gjetur të provuar se K2 është vizituar nga I.H. dhe Muhamet Mehmeti. Sidoqoftë, kjo ka ndodhur vetëm më 2007 siç ka dëshmuar dëshmitari I.H. Arsyeja për vlerësimin e deklaratës së I.H. si më të besueshme sa i përket vitit kur ka ndodhur ngjarja rezulton nga fakti se në vitin 2005 gjykimi kundër K2 ka qenë ende në pritje. Ligji i Bosnjës dhe Hercegovinës është strikt sa i përket lejeve për vizita të paraburgosurve. Nuk ka qenë e mundur që një person i panjohur për të paraburgosurin dhe që nuk është në lidhje me atë të merrte leje për vizitë.

1576. Fakti se gjykata ka vërtetuar se vizita ka ndodhur në vitin e mëvonshëm se që është pretenduar nga K2, e kundërshton mundësinë e një përpjekje për ta bindur K2 që mos ta inkriminojë N.K. Në vitin 2007, gjykimi kundër K2 tashmë kishte përfunduar me aktgjykim të formës së prerë dhe ende nuk ka pasur asnjë

¹⁸⁷² 28.03.2017, f. 25

¹⁸⁷³ 28.03.2017, f. 4 - 5

¹⁸⁷⁴ 28.03.2017, f. 26-27

indikacion se do të ketë procedurë kundër N.K.

Thirrja telefonike nga Samir dhe B.Ku.

1577. K2 ka dëshmuar se është thirrë nga Sa.Ku. dhe babai i tij Bajrami i cili i ka kërkuar që të mos dëshmojë kundër N.K. Kjo situatë ka ndodhë në fillim të vitit 2016. Ai ka pohuar se ka biseduar disa herë me B.Ku. dhe Sa.Ku., gjithashtu edhe përmes telefonit të I.H.¹⁸⁷⁵¹⁸⁷⁶

1578. **Sa.Ku.** ka mohuar të ketë ndodhur një bisedë e tillë. Së pari, as ai, as babai i tij nuk e kanë njohur N.K. Së dyti, babai i tij ka vdekur në muajin e 4-të të 2015.
2197

1579. **I.H.** e ka ditur se B.Ku. ka vdekur në vitin 2015, sipas njohurive të tij– në gusht ose shtator. Në këtë periudhë ai tashmë ka qenë në paraburgim.¹⁸⁷⁷

Përfundim

1580. Në dritën e kësaj prove, gjykata e konsideron të pa provuar se një bisedë e tillë ka ndodhë fare.

Letra e dërguar B.Ke.

1581. Sa.Ku. fliste me K2, kur ai e ka thirrë I.H. Atij nuk i kujtohet saktë se kur kanë biseduar herën e fundit, sepse së pari ka thënë se ka qenë më 2013,¹⁸⁷⁸ pastaj – më 2011 ose 2012.¹⁸⁷⁹ kur është pyetur përsëri nga mbrojtja, Sa.Ku. ka thënë se

¹⁸⁷⁵ 09.03.2017, f. 15 - 16

¹⁸⁷⁶ 17.03.2017, f. 32-33

¹⁸⁷⁷ 28.03.2017, f. 42

¹⁸⁷⁸ 17.03.2017, f. 28

¹⁸⁷⁹ 17.03.2017, f. 29

K2 e thërriste atë më 2014-2015, ai e aranzhonte kohën e bisedës paraprakisht sepse ai e thërriste një ditë më herët për ta caktuar kohën për të kontaktuar me të. Gjatë bisedës e cila ka ndodhë më 2014 ose 2015, është ngritur tema e N.K.¹⁸⁸⁰

1582. K2 ka kërkuar nga Sa.Ku. që të kontaktojë me djalin e N.K dhe t'i thotë që nëse nuk dëshiron që ai të jetë dëshmitar për babanë e tij, atëherë ai duhet ta ndihmojë atë. I.H. ka qenë i pranishëm gjatë kësaj bisede telefonike dhe e ka bindur Sa.Ku. që ta bëjë këtë.¹⁸⁸¹

1583. K2 e ka dërguar një letër me udhëzime e cila ka ardhur në adresë të I.H. Sa.Ku. e ka marrë këtë letër, ka qenë në gjuhën boshnjake të cilën nuk e kishte të njohur, dhe prandaj I.H. e kishte përkthyer atë. K2 kishte kërkuar 500.000 euro për të mos dëshmuar kundër N.K.¹⁸⁸² Ai kishte nevojë për para për t'i korruptuar gjyqtarët.¹⁸⁸³

1584. Sa.Ku. ka shkuar te “Bs.”, djali i N.K. Ai ka kontaktuar me atë përmes shokut të tyre të përbashkët, E.G. i cili vetëm i ka njoftuar mes vete dhe kishte shkuar kur ata kanë filluar të bisedojnë. Sa.Ku. i ka thënë B.Ke. se e kishte një porosi për të– letrën nga K2. “Bs.” ka refuzuar ta përcjellë letrën dhe ka thënë se nuk do të paguaj shpërblesë sepse ai nuk ka asgjë të bëjë me këtë, dhe se ai nuk kishte asnjë kontakt me babanë e tij.¹⁸⁸⁴ Sa.Ku. nuk i kujtohet çfarë ka ndodhur me këtë letër, ku e kishte dërguar apo e kishte lënë te B.Ke. ¹⁸⁸⁵

¹⁸⁸⁰ 17.03.2017, f. 31

¹⁸⁸¹ 17.03.2017, f. 28 - 29, p. 31

¹⁸⁸² 17.03.2017, f. 28 - 29

¹⁸⁸³ 17.03.2017, f. 29

¹⁸⁸⁴ 17.03.2017, f. 28, 30

¹⁸⁸⁵ 17.03.2017, f. 31

1585. Tri ditë më vonë K2 e ka thirrë Sa.Ku. përsëri. Sa.Ku. e ka njoftuar atë se e ka dërguar letrën, sidoqoftë ata nuk do të paguanin para për të.¹⁸⁸⁶
1586. Sa.Ku. e ka mohuar njohjen e N.K personalisht. Ai e ka parë atë vetëm në TV. Ai kishte dëgjuar për S.Ni.¹⁸⁸⁷
1587. **I.H.** ka konfirmuar se ka qëndruar në kontakt me K2 i cili e thërriste atë, nganjëherë një herë në javë, nganjëherë një herë në muaj. Ata kanë biseduar lidhur me familjet e tyre. Ndonjëherë K2 pyeste për Sa.Ku.¹⁸⁸⁸ Përveç thirrjeve telefonike, ata nuk kanë përdorë ndonjë mënyrë tjetër për komunikim.¹⁸⁸⁹ Atij nuk i kujtohej nëse dikush ka qenë i pranishëm gjatë këtyre bisedave telefonike.¹⁸⁹⁰ Ai nuk e dinte nëse K2 e thërriste dikë tjetër në Kosovë, sidoqoftë ai nuk besonte që ai do ta thërriste Sa.Ku. sepse K2 e kishte të kufizuar numrin e personave të cilët mund t'i telefononte.¹⁸⁹¹
1588. Kur është pyetur për letrën, I.H. ka thënë se K2 ia kishte dërguar një herë. Ai besonte se ka qenë më 2014, kishte ardhur nga Bosnja në emër të tij përmes DHL. Ai nuk e dinte përmbajtjen e kësaj letre sepse nuk e kishte hapur atë pasi që ishte për Sa.Ku. Ai nuk e dinte se çfarë kishte bërë Sa.Ku. me këtë letër. Kuçi asnjëherë nuk i kishte treguar I.H. se çfarë kishte të shkruar në të.¹⁸⁹² Ai e ka pranuar këtë letër 3 – 4 muaj para arrestimit të tij.¹⁸⁹³ Letra nuk ishte dërguar

¹⁸⁸⁶ 17.03.2017, f. 29

¹⁸⁸⁷ 17.03.2017, f. 31

¹⁸⁸⁸ 28.03.2017, f. 27

¹⁸⁸⁹ 28.03.2017, f. 28

¹⁸⁹⁰ 28.03.2017, f. 30

¹⁸⁹¹ 28.03.2017, f. 31

¹⁸⁹² 28.03.2017, f. 28 - 29

¹⁸⁹³ 28.03.2017, f. 43

nga Zenica por përmes një shoku të K2. ¹⁸⁹⁴

1589. I.H. ia ka dorëzuar letrën Sa.Ku. sepse K2 ia kishte kërkuar këtë. Ishte dërguar në adresë të Isufit sepse K2 e kishte atë. Ai nuk e kishte pyetur K2 se çfarë donte nga Sa.Ku., K2 nuk i ka treguar se për çfarë bëhej fjalë në letër. ¹⁸⁹⁵

1590. I.H. e ka mohuar se ia ka lexuar letrën Sa.Ku. në të cilën ishte shkruar se K2 po i kërkonte 500.000 euro për të mos dëshmuar kundër N.K. ¹⁸⁹⁶ Ai gjithashtu e ka mohuar që K2 e ka thirrë në telefonin e tij dhe ka biseduar me Sa.Ku. dhe B.Ku. të cilët do t'i ofronin atij 500.000 euro për të mos dëshmuar kundër N.K. ¹⁸⁹⁷

1591. I.H. e ka pranuar se ia kishte dërguar një letër K2. Duhet të ketë ndodhur pasi është burgosur, në gusht ose shtator 2015. Ai e kishte pyetur lidhur me shëndetin e tij, e kishte njoftuar se ishte në burg. I.H. e ka pyetur K2 nëse ka arritur të dalë nga burgu pas vuajtjes së gjysmës së dënimit. ¹⁸⁹⁸ Ky ka qenë kontakti i fundit në mes tyre, K2 nuk është përgjigj. ¹⁸⁹⁹

1592. I.H. e ka njohur letrën të cilën ia ka dërguar K2. Kujtesa e tij është rifreskuar me përmbajtjen e saj. Ai ka thënë se kishte shkruar për “Ba.” (që ka qenë nofka e Sa.Ku.) në kontekstin e një mashtrimi tjetër. K2 donte të dërgonte disa persona me drogë nga Bosnja, I.H. nuk donte të përfshihej në këtë. ¹⁹⁰⁰ Letra të cilën ai ia kishte dërguar K2 nuk kishte asgjë të bënte me ofertën prej 500.000 euro. ¹⁹⁰¹

¹⁸⁹⁴ 28.03.2017, f. 44

¹⁸⁹⁵ 28.03.2017, f. 31

¹⁸⁹⁶ 28.03.2017, f. 32-33

¹⁸⁹⁷ 28.03.2017, f. 30

¹⁸⁹⁸ 28.03.2017, f. 29

¹⁸⁹⁹ 28.03.2017, f. 33

¹⁹⁰⁰ 28.03.2017, f. 35 - 36

¹⁹⁰¹ 28.03.2017, f. 44-45

1593. Atij nuk i kujtohet nëse K2 e ka përmendur ndonjëherë N.K. Ndoshta e ka bërë, por I.H. nuk e ka ditur se kush është ai. K2 asnjëherë nuk ka folur lidhur me korrupsionin e gjyqtarëve.¹⁹⁰²

1594. Atij nuk i kujtohej nëse Sa.Ku. ka biseduar me K2 përmes telefonit të tij. Kur është ballafaquar me deklaratën e Sa.Ku. i cili i ka përmendur dy herë kur ka biseduar në këtë mënyrë me K2, I.H. ka thënë se rrinte shumë me Sa.Ku. kështu që ka pasur mundësi të ketë ndodhur, por se nuk e di për këtë.¹⁹⁰³ Atij nuk i kujtohej që K2 i ka thënë Sa.Ku. se ai do të dëshmonte në gjykimin kundër N.K.
2225

1595. Ai e ka mohuar përkthimin e letrës së dërguar nga K2 për Sa.Ku.²²²⁶ Ai e ka mohuar ta ketë dëgjuar bisedën ndërmjet Sa.Ku. dhe K2 lidhur me 500.000 euro për të mos dëshmuar kundër N.K.²²²⁷

1596. Ai nuk e dinte që Sa.Ku. ka shkuar te djali i N.K. Ai e ka parë Sa.Ku. duke ndenjur me djalin e N.K. Atij nuk i kujtohet sa shpesh, sidoqoftë ai i ka parë së bashku në restorantin Zahac afër fshatit të “Sm.”. Ai i ka parë më shumë se një herë, sipas tij ata kanë qenë shokë.²²²⁸

Përfundim

1597. Gjykata e ka gjetur të provuar se në vitin 2015, K2 e ka dërguar një letër përmes I.H. dhe Sa.Ku. të adresuar për B.Ke. në të cilën ai ka ofruar që të mos dëshmojë kundër N.K në këmbim të parave. Fakti se letra është dërguar është vërtetuar nga dëshmitari K2, I.H. dhe Sa.Ku. Këta dy të fundit kanë konfirmuar se letra i është dërguar B.Ke.

¹⁹⁰² 28.03.2017, f. 39

¹⁹⁰³ 28.03.2017, f. 39

1598. Gjykata nuk ka besuar se Sa.Ku. nuk e ka njohur “Bs.”n, sepse është në kundërtënie me deklaratën e I.H. i cili madje i ka quajtur shokë. Si duket Sa.Ku. i është shmangur përgjigjeve të cilat kanë mundur të tregojnë se ai e ka njohur familjen N.K.

1599. Gjykata gjithashtu e ka gjetur të pavërtetë deklaratën e I.H. kur ka dëshmuar se ai nuk e ka hapur letrën. Është dërguar në adresë të tij në emër të tij, kështu që

²²²⁵ 28.03.2017, f. 39-40

²²²⁶ 28.03.2017, f. 40

²²²⁷ 28.03.2017, f. 43

²²²⁸ 28.03.2017, f. 41

është e natyrshme dhe logjike që të hapet dhe shikohet se çfarë ka brenda. Më tutje, Sa.Ku. ka thënë se atij i është lexuar letra nga I.H. sepse ai nuk e dinte gjuhën.

1600. Gjykatës nuk i është siguruar letra e dërguar nga K2, sepse Sa.Ku. ka theksuar se ia kishte lënë B.Ke. Sidoqoftë, nuk ka qenë rasti i vetëm kur K2 po mundohej të ndikonte në njerëz për t'i bindur për të dëshmuar në interes të tij. Prandaj, në dritën e provave tjera të paraqitura më poshtë, gjykata ka vërtetuar se ka qenë K2 ai i cili është munduar të përfitojë nga N.K. për të mos dëshmuar kundër tij. Një gjetje e tillë gjithashtu arsyetohet me parimin *in dubio pro reo*.

Letrat e K2 të dërguara te M.Ha. dhe H.Me.

1601. **K2** ka dëshmuar se e ka pranuar një letër nga M.Ha. e cila përmbante një deklaratë të nënshkruar nga ajo ku e pranonte se kishte dëshmuar rrejshëm në

gjykimin e tij. Ai ka theksuar se nuk i ka shkruar asnjë letër asaj.¹⁹⁰⁴ Në bazë të letrës së pranuar nga M.Ha. avokati i tij ka paraqitur kërkesë për rishikimin e procedurës kundër tij, lënda është ende në pritje.¹⁹⁰⁵

1602. **M.Ha.** ka dëshmuar se ka pranuar letra nga K2 me udhëzime se çfarë duhej të bënte.¹⁹⁰⁶ Më 2012, ajo gjithashtu nga K2 ka pranuar një deklaratë të cilën ajo e ka nënshkruar dhe e ka kthyer tek avokati i tij në të cilën ajo është tërhequr nga dëshmitë e saj të mëparshme kundër tij. Kanë qenë 4 kopje, një e ka mbajtur për vete për ta mësuar përmbajtjen e deklaratës përmendësh.¹⁹⁰⁷

1603. Ajo, gjithashtu ka pranuar letra me udhëzime se si të dëshmojë kundër N.K.¹⁹⁰⁸ Këto letra nuk janë shkruar nga K2, por nga kolegu i tij. M.Ha. i është përgjigjur atyre gjithashtu përmes një kolegu.¹⁹⁰⁹ K2 e ka bërë këtë sepse donte që të lirohej me çdo çmim nga burgu. Atij i nevojitej dikush për ta konfirmuar tezën e tij, pa konfirmim dëshmia e tij nuk kishte vlerë.¹⁹¹⁰

1604. **H.Me.** ka dëshmuar se ka biseduar me S.A. lidhur me K2 i cili u dërgonte letra të dyve dhe gjithashtu edhe M.Ha.. Ata të gjithë kishin pranuar udhëzime se si të dëshmojnë kundër N.K, që do t'i ndihmonte K2 ta merrte statusin e njëjtë sikur K1, ose të paktën një zvogëlim të dukshëm të dënimit të tij.¹⁹¹¹

1605. H.Me. e ka pranuar këtë letër sigurisht më 2006 kur ka qenë në burg në Tuzëll. K2 e ka nënshkruar këtë letër, ka qenë e shkruar me dorë. Kur kanë qenë së

¹⁹⁰⁴ 09.03.2017, f. 28 - 29

¹⁹⁰⁵ 09.03.2017, f. 29

¹⁹⁰⁶ 31.01.2017, f. 15, 26

¹⁹⁰⁷ 31.01.2017, f. 18

¹⁹⁰⁸ 31.01.2017, f. 19

¹⁹⁰⁹ 31.01.2017, f. 21

¹⁹¹⁰ 31.01.2017, f. 40, 41

¹⁹¹¹ 07.04.2017, f. 19 - 21

bashku në burg (sigurisht më 2009¹⁹¹²) ata gjithashtu kanë diskutuar se çfarë do të ishte më së miri të bëhej me këtë letër. Qëllimi i të gjitha veprimeve ka qenë që të rishikohet procedura kundër K2. Gjatë kësaj bisede, gjithashtu është paraqitur emri i N.K.¹⁹¹³

Përfundim:

1606. Gjykata e ka gjetur të provuar se K2 i ka dërguar M.Ha. një deklaratë të cilën ajo ia ka kthyer atij, në të cilën ajo është tërhequr nga dëshmitë e saj të mëparshme kundër K2. Që të dy kanë dëshmuar lidhur me përmbajtjen e deklaratës, dhe dallimi i vetëm midis versioneve të tyre ka qenë lidhur me autorin e kësaj iniciative. Në dritën e provave tjera të mbledhura në këtë rast (I.H., Sa.Ku., H.Mu.) të cilat tregojnë se K2 ka qenë i gatshëm të ndër marr veprime të ndryshme për të dalë nga burgu, gjykata ka gjetur se ai ka qenë autori i deklaratës së dërguar te M.Ha. dhe të nënshkruar nga ajo.

1607. Gjithashtu, është vërtetuar se H.Me. ka pranuar letra nga K2 siç është përmendur nga dëshmitari. Kjo gjetje vërtetohet më tutje me veprimet e ndërmarra nga H.Me. dhe K2 me qëllim të njëjtë – për të rishikuar procedurën kundër K2 ose – të paktën – të fitojë zbutjen e dënimit.

1608. Në të njëjtën kohë, nuk ka asnjë provë se S.A. ka pranuar letra të tilla pasi që ai nuk i ka përmendur në dëshminë e tij.

Dëshmia e Harris H.Me.

1609. H.Me. ka dëshmuar se ai është transferuar në burgun e Zenicës me kërkesë të tij sepse ka dashur të jetë në të njëjtin vend me K2. Gjatë qëndrimit të tij në burg së

¹⁹¹² 07.04.2017, f. 22

¹⁹¹³ 07.04.2017, f. 21

bashku me K2, ata kanë diskutuar kryesisht lidhur me mënyrat për rishikimin e procedurës penale kundër K2. Ata kanë diskutuar shumë zgjidhje një nga një. Njëra prej tyre ka qenë letra e dërguar në prokurori në të cilën K2 ka ofruar që të dëshmojë kundër N.K. Kjo ide është paraqitur pak më vonë, kur emri i N.K. është paraqitur në media. Zgjidhjet tjera janë dukur të pasuksesshme.¹⁹¹⁴ Ideja për ta përdorë N.K. si një argument për ta rishikuar rastin është paraqitur në vitin 2005 ose 2006.¹⁹¹⁵

1610. K2 i ka thënë H.Me. se do të duhet të dëshmojë në këtë rast. Ideja ka qenë të përpiqen të gënjejnë dhe njollosin N.K. dhe si rezultat prokurorët e FBI-së ose të agjencive të tjera do të interesoheshin për këtë rast. K2 e ka parë këtë si një prej mundësive për të dalë nga burgu ose të paktën të rishikohet rasti. Ata gjithashtu kanë biseduar lidhur me emrat e personave të tjerë për t'u përdorë në të njëjtin kontekst.¹⁹¹⁶

1611. H.Me. ka dëshmuar se mënyra tjetër se si ata kanë dashur ta nxjerrin K2 nga burgu ka qenë që ta përdorin një dëshmitar okular në rastin e vrasjes së F.K. për të cilin K2 gjithashtu ka qenë i dënuar. Ata kanë kontaktuar me këtë dëshmitare dhe i kanë kërkuar asaj që të dëshmojë se e ka parë H.Me. në vendin e ngjarjes. Në fund, gruaja nuk ka vendosur të dëshmojë sepse kishte frikë nga pasojat.¹⁹¹⁷

1612. H.Me. madje e ka pranuar se ka qenë ai, i cili e ka vrarë F.K.. Ai e ka bërë këtë pas konsultimit me avokatin e K2 i cili ka thënë se nuk ishte e rrezikshme për të sepse ai tashmë ishte liruar nga akuza për vrasjen e F.K.. H.Me. gjithashtu i ka

¹⁹¹⁴11.04.2017, f. 4-5

¹⁹¹⁵ 11.04.2017, f. 6

¹⁹¹⁶ 07.04.2017, f. 23

¹⁹¹⁷ 07.04.2017, p. 23

dhënë deklaratë gazetarëve ku ai e ka pranuar se ka qenë ai i cili e ka kryer këtë vrasje. Deklarata është regjistruar me video dhe është transmetuar në TV, në programin e titulluar “Dosjet-X”.¹⁹¹⁸ Nuk ka pasur asnjë reagim nga prokuroria, procedura kundër K2 nuk është rishikuar si rezultat i deklaratës së H.Me..¹⁹¹⁹

1613. K2 gjithashtu ka marrë pjesë në këtë program televiziv ku ka theksuar se ai nuk ishte fajtor për veprat penale për të cilat është dënuar.¹⁹²⁰

1614. Kur është pyetur se pse ishte aq i përkushtuar për t’i ndihmuar K2, H.Me. ka thënë se është një person i ndjeshëm dhe i dhembshëm. Ai nuk ka pritur ndonjë shpërblim për ndihmën e tij. H.Me. mendonte se ai ka kontribuar në këtë dënim të rëndë për K2 dhe në këtë mënyrë ai po e luftonte padrejtësinë.¹⁹²¹

1615. Në pyetjen nëse e ka lajmëruar policinë se K2 e ka udhëzuar atë për të gënjyer kundër N.K, H.Me. është përgjigj se kjo nuk është mënyra se ai “ata” (do të thotë kriminelët) funksionojnë. Ata tentonin t’i zgjidhnin problemet në mes tyre dhe mos ta përfshijnë policinë.¹⁹²²¹⁹²³

1616. **K2**ka konfirmuar se ka kaluar gati një vit në një qeli me H.Me.. Disa fjali më poshtë, ai ka thënë se nuk ka kaluar shumë kohë me atë, ata bisedonin vetëm rastësisht. Ata kanë qenë në kolektive të ndryshme. Ai ka theksuar se ata nuk kanë diskutuar se çfarë të bëjnë për të fituar rishikimin e procedurës kundër tij.

2248

¹⁹¹⁸07.04.2017, f. 24; video nga programi i paraqitur gjatë seancës së shqyrtimit gjyqësor të mbajtur më 03 tetor 2017

¹⁹¹⁹ 07.04.2017, f. 25

¹⁹²⁰ video nga programi i paraqitur gjatë seancës së shqyrtimit gjyqësor të mbajtur më 03 tetor 2017

¹⁹²¹ 07.04.2017, f. 25 - 26

¹⁹²² 07.04.2017, f. 27

¹⁹²³ 09.03.2017, f. 39

Përfundim

1617. Gjykata e ka gjetur dëshminë e H.Me. si relevante, dhe në pjesën kryesore – të vërtetë dhe të besueshme. Dëshmitari e ka përshkruar në detaje përfshirjen e tij në operacionet kriminale me K2, dhe aktivitetet të cilat janë kryer nga ata. Ai gjithashtu ka qenë i sinqertë kur bëhej fjalë për prezantimin e të gjitha veprimeve të cilat i kishte ndërmarrë me K2 për t'i ndihmuar atij me rishikimin e rastit dhe /ose marrjen e imunitetit ose zbutjen e dënimit. Këto nuk kanë qenë vetëm letra me udhëzime se si dhe çfarë të dëshmonte, të cilat K2 ia ka dërguar H.Me. dhe M.Ha., por gjithashtu edhe një mënyrë më e sofistikuar për ta zgjidhur këtë situatë që ka qenë pranimi i përgjegjësisë nga H.Me. për vrasjen e F.K.. Ata kanë qenë aq të përkushtuar për ta arritur këtë qëllim sa që jo vetëm që e kanë kontaktuar prokurorinë, por gjithashtu kanë arritur të kontaktojnë me gazetarë të cilët kanë bërë një reportazh në lidhje me ata.

1618. Në dritën e dëshmisë së tij, të vërtetuar nga dëshmitarë të tjerë (përfshirë M.Ha. dhe S.A.), dhe gjithashtu të mbështetur me provat –programi televiziv ku ai e ka pranuar se ka qenë ai e jo K2 i cili e ka vrarë F.K., gjykata e ka gjetur shpjegimin e tij si të arsyeshëm, se e kishte bërë për ta ndihmuar K2 që ta fitojë një pozitë më të mirë ligjore në Bosnjë.

1619. Prandaj, gjykata ka gjetur deklaratat e K2 i cili ka mohuar çfarëdo bisede me H.Me. lidhur me mundësinë për të fituar një pozitë më të mirë ligjore për atë, si të paqëndrueshme.

Takimi i S.A. me H.Me.

1620. **S.A.** ka dëshmuar sepesë ose gjashtë muaj para dëshmisë së tij në Kosovë, ai është takuar me H.Me. i cili i kishte thënë se vëllai i N.K donte që ai të

nënshkruante diçka në zyrën e V.V.. Ai ka refuzuar që të takohet me këtë avokat dhe të nënshkruaj çfarëdo. H.Me. nuk i ka thënë atij se për çfarë ishte kjo deklaratë.¹⁹²⁴

1621. **H.Me.** ka konfirmuar se është takuar me S.A. në xhami në vitin 2016. Me këtë rast, ai i ka thënë atij se nuk donte t'i hakmerrej atij për denoncimin e tyre. Pas kësaj situatë, ka ndodhë që ata e kanë parë njëri tjetrin, por vetëm për një ose dy minuta.¹⁹²⁵

1622. H.Me. ka mohuar se i ka treguar S.A. lidhur me ofertën e V.V. i cili gjoja i ka premtuar se do ta paguaj atë për një deklaratë.¹⁹²⁶ Ai ka thënë se ka biseduar me atë, se nuk ishte e mundur ose e drejtë të thoshte diçka aq serioze kundër një personi i cili ka familje, kur ata nuk dinin asgjë.¹⁹²⁷ H.Me. e ka pranuar se e njihte V.V. i cili e mbronte N.O.¹⁹²⁸

1623. H.Me. fillimisht ka mohuar të ketë pasur ndonjë kontakt me vëllain e N.K.¹⁹²⁹ Sidoqoftë, pas një momenti ai e ka pranuar se e njihte. Vëllai i N.K kishte në fabrikë të lëngjeve dhe H.Me. është takuar me atë në lidhje me fillimin e një aktiviteti të ngjashëm. Ai e ka pranuar se tema e gjykimit kundër N.K. është paraqitur gjatë bisedës me vëllain e tij.¹⁹³⁰ Kjo ka qenë më 2015.¹⁹³¹

Përfundim

¹⁹²⁴ 30.01.2017, f. 23

¹⁹²⁵ 07.04.2017, f. 18

¹⁹²⁶ 07.04.2017, f. 28

¹⁹²⁷ 07.04.2017, f. 28

¹⁹²⁸ 07.04.2017, f. 32

¹⁹²⁹ 07.04.2017, f. 28

¹⁹³⁰ 07.04.2017, f. 30 - 31

¹⁹³¹ 11.04.2017, f. 14

1624. Gjykata ka vërejtur se H.Me. e ka pranuar se ka qenë në kontakt me vëllain e N.K me të cilin po planifikonte të ndërmerre disa aktivitete afariste. Sidoqoftë, prapëseprapëë nuk ka qenë e mjaftueshme për të përfunduar se aty ka pasur ndikim apo presion mbi dëshmitarin nga ana e tij për të ndikuar në dëshminë e tij gjatë procedurës.
1625. Gjithashtu, nuk ka pasur asnjë dyshim se H.Me. është takuar me S.A. dhe kanë biseduar lidhur me dëshmimin në rastin e N.K. Sidoqoftë, nuk ka asnjë provë për të vërtetuar se H.Me. ka bërë çfarëdo presioni ndaj S.A. që ta bëjë atë të dëshmojë në dobi të N.K. Përveç kësaj, duhet të përmendet se S.A., përkundër të qenit dëshmitar në gjykimin kundër K2, asnjëherë nuk e ka përmendur N.K. Prandaj, i akuzuari nuk ka pasur asnjë arsye apo nevojë të ndikojë në çfarëdo mënyre përmes askujt mbi këtë dëshmitar.

Pjesa. 5 Cilësimi juridik dhe dënimi

5.1 Përshkrimi i veprës penale që i atribuohet të akuzuarit

1626. Si rezultat i vlerësimit të fakteve që janë vërtetuar nga gjykata, vetëm veprimi që është subjekt i pikës 8 të aktakuzës i është atribuuar të akuzuarit. Sidoqoftë, pretendimet se i akuzuari e ka kryer këtë veprim si anëtar i grupit të organizuar kriminal (GOK), janë refuzuar si të paprovuara.
1627. Akuza relevante është paraqitur nga prokurori përmes citimit të fjalëpërfjalshëm të dispozitave ligjore që e përmbajnë përkufizimin e krimit Posedim i paautorizuar me qëllim të shpërndaj, shpërndarje ose shitje; dhe/ose eksport/import të drogave të rrezikshme narkotike në shkelje të nenit 228

paragrafëve 1,2 dhe 3 të KPK-së, të cilin prokurori e ka përdorë për cilësim juridik. Citimi është plotësuar me një përmbledhje të pretendimeve narrative të cilat e mbështetnin akuzën.

1628. Sipas nenit 360 paragrafi 2 i KPP-së cilësimi juridik i akuzës së paraqitur nga prokurori nuk ka qenë detyrues për gjykatën. Në të njëjtën kohë, aktgjykimi mund të lidhet vetëm me të akuzuarin dhe vetëm për një veprë e cila është subjekt i akuzës së përmbajtur në aktakuzë, siç është ngritur fillimisht apo siç është ndryshuar gjatë procedurës.

1629. Ka qenë detyrë e gjykatës që të paraqes veprën e cila i atribuohet të akuzuarit në atë mënyrë që përputhet me kushtin e përcaktuar me nenin 365 (1.1) të KPP-së. Prandaj, për qëllime të sqarimit dhe saktësisht, ka qenë e domosdoshme që të përpilohet një përshkrim i veprës në atë mënyrë që do të eliminonte faktet alternative, elementet alternative të krimit dhe specifikat alternative të shprehura inter alia në aktakuzë me përdorimi e lidhëzave gramatikore “dhe/ose”. Është e panevojshme të thuhet se përshkrimi i cili përmban alternativat nuk e specifikon se cilat veprime specifike janë kryer. Ngjashëm, shprehja “më shumë se 25 kg” është e pa definuar pasi që asnjë dyshim në lidhje me sasinë nuk mund të merret në dëm të të akuzuarit. Për më tepër, pasi që disa elemente të veprës në fjalë nuk janë provuar, ato është dashur të eliminohen nga përshkrimi i paraqitur në pjesën fajësuese të dispozitivit .

1630. Parimi i identiteti subjektiv të aktgjykimit mbi aktakuzën i cili është shpallur në nenin 360 (2) të KPP-së nuk do të thotë se gjykata është e detyruar me formulimin e fjalëpërfjalshëm të aktakuzës kur bëhet fjalë për elementet e krimit. Gjykata nuk mund t’i konsiderojë të provuara elementet të cilat nuk janë

përfshirë në aktakuzë, por mund të devijojë nga përshkrimi faktik i aktakuzës. Një praktike të tillë në teorinë e procedurës penale zakonisht i referohen si *përkufizim i aktakuzës*.

1631. Përshkrimi i veprës e cila i është artibuar të akuzuarit është paraqitur nën pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

5.2. Cilësimi juridik i veprës penale që i atribuohet të akuzuarit

1632. Sipas nenit 360 paragrafit 2 të KPP-së, gjykata nuk detyrohet me propozimet e prokurorit lidhur me cilësimin juridik të veprës.

Zbatimi i ligjit më të favorshëm

1633. Legjislacioni në vijim i cili e sanksionon veprën e cila i atribuohet të akuzuarit ka qenë i zbatueshëm në Kosovë gjatë periudhës nga kryerja e kësaj vepre deri te dënimi:

- a) Kodi Penal i Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (në tekstin e mëtejshëm: KPRSFJ) i cili ka hyrë në fuqi më 1 korrik 1977, ku të gjitha këto dispozita janë mbajtur në fuqi me anë të paragrafit 1.1 (b) të Rregullores së Administratës së Përkohshme të Misionit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë 1999/24, të 12 dhjetorit 1999;
- b) Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës (KPPK) i cili ka hyrë në fuqi më 4 qershor 2004, i cili më pas është riemëruar si Kodi Penal i Kosovës (amendamenti në fuqi prej 12 dhjetorit 2008);
- c) Kodi Penal i Republikës së Kosovës (KPRK) i cili ka hyrë në fuqi më 1 janar 2013.

1630. Krimi është kryer në maj 2003 dhe hetimi ka filluar në gusht 2013. Analiza e parashkrimit sipas të gjithë legjislacionit relevant ka shpie në përfundim se periudha e parashkrimit të ndjekjes penale nuk ka skaduar.

1631. Sipas KPRSFJ-së vepra e kryer nga i akuzuari i përmbush karakteristikat e krimit të përkufizuar në nenin 245:

(1) *Kush prodhon në mënyrë të paautorizuar, përpunon, shet ose ofron për shitje apo për qëllime shitjeje blen, mban ose transporton, ose ndërmjetëson në shitjen ose blerjen, apo në ndonjë mënyrë tjetër pa autorizim vën në qarkullim substanca ose preparate që janë shpallur si narkotikë ose substanca psikotropike, do të dënohet me gjashtë muaj deri në pesë vjet burg.*

(2) *Në qoftë se vepra penale nga paragrafi 1 i këtij neni është kryer nga disa persona që janë bashkuar për t'i kryer këto vepra apo kryerësi i kësaj vepre ka organizuar rrjetin e rishitësve ose të ndërmjetësuesve, ose në qoftë se vepra penale është kryer me narkotikë apo me substanca psikotropike veçanërisht të rrezikshme, kryerësi do të dënohet me një deri në dhjetë vjet burg.*

1632. Gjykata ka arritur në përfundim se veprimi të cilin e ka kryer N.K. duhet të konsiderohet si vënie e substancës narkotike në qarkullim. Nuk ka pasur prova të drejtpërdrejta të dashjes së tij për të shitur, ose ofruar për shitje, që do të thotë shkëmbimi i produktit me para ose me një produkt tjetër. Asnjë dëshmi për një shkëmbim ose ofertë të tillë nuk është paraqitur. Sidoqoftë, transferimi i posedimit të drogës e plotëson thelbin e konceptit të vënies në qarkullim. Kjo veprë është kryer së bashku nga disa persona: N.K., K2 dhe personat të cilët e kanë shkarkuar drogën. Secili prej tyre ka luajtur një rol thelbësor dhe veprimet e tyre kanë qenë të koordinuara dhe e kanë plotësuar njëra tjetrën. Nuk ka

përkufizim ligjor të substancës narkotike ose psikotropike veçanërisht të rrezikshme. Është fakt i njohur i përcaktuar në KPRSFJ. Prandaj, gjykata mori kuptimin e përbashkët juridik se heroina përbën një drogë narkotike veçanërisht të rrezikshme. Për këto arsye, gjykata ka arritur në përfundim se akti i kryer nga N.K. i përmbush karakteristikat e krimit të përkufizuar në nenin 245 paragrafët 1 dhe 2 të KPRSFJ-së dhe duhet të dënohet sipas sanksioneve të përcaktuara në paragrafin 2.

1633. Në lidhje me pretendimet e prokurorisë për cilësimin e veprës në fjalë si të kryer gjatë veprimtarisë së grupit të organizuar kriminal, duhet theksuar se KPRSFJ-së nuk e njih një koncept të tillë edhe pse një formë e caktuar e bashkëkryerjes së koordinuar është sanksionuar. Neni 253 paragrafi 1 i KPRSFJ-së e ka përkufizuar krimin Marrëveshje për kryerjen e veprave penale të caktuara me ligjin federativ:

Kush mirret vesh me tjetrin për të kryer vepër penale të parashikuar në ligjin federativ për të cilën mund të jepet dënimi me pesë vjet burg ose dënimi më i rëndë se ky, në qoftë se në ligjin federativ për marrëveshje të tillë nuk është parashikuar dënimi më i rëndë, do të dënohet deri në një vjet burg.

Sidoqoftë, marrëveshja me një person tjetër për të kryer një vepër penale është pashmangshëm i mishëruar në bashkimin për qëllime të kryerjes së veprës penale të përcaktuar me nenin 245 paragrafin 2 i cili e ka përjashtuar konsiderimin e marrëveshjes si krim të veçantë, pasi që marrëveshja konsumohet nga krimi i përcaktuar me nenin 245 paragrafët 1 dhe 2 të KPRSFJ-së si një vepër më e vogël e përfshirë. Në këtë rast të veçantë, të gjitha elementet e nevojshme për ta përcaktuar përgjegjësinë për marrëveshje janë gjithashtu

elemente të gjetura të një krimi të dënueshëm më rëndë.

1634. Gjithashtu, duhet theksuar se neni 254 paragrafi 1 i KPRSFJ-së e përcakton

veprën e Bashkimit për të kryer vepra penale të caktuara në ligjin federativ:

(1) Kush organizon grupin e personave që anë për qëllim kryerjen e veprave penale të caktuara me ligjin federativ, për të cilat mund të jepet dënimi me pesë vjet burg ose dënimi më i rëndë se ky, në qoftë se në ligjin federativ për organizim të tillë nuk është parashikuar dënimi më i rëndë, do të dënohet me tre muaj deri në pesë vjet burg.

Sidoqoftë, nuk ka asnjë provë se N.K. ka qenë ai i cili e ka organizuar grupin, që do të thotë se ai ka qenë personi i cili ua ka caktuar detyrat të gjithë personave të tjerë të cilët kanë qenë të përfshirë në kontrabandë.

1635. Sipas nenit 95, nenit 95 paragrafit 1.3 të KPRSFJ-së, në rast të kryerjes së veprës penale për të cilën ligji parasheh dënimin prej 5 deri në 10 vjet burg, siç është paraparë për krimet nën nenin 245 paragrafin 1 që është duke u shqyrtuar, ndjekja penale parashkruhet pas 10 vjetëve nga kryerja e krimit

KPPK

1636. Sipas KPPK-së, vepra e kryer nga i akuazuari i përmbush karakteristikat e veprës penale Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe e substancave psikotropike të përcaktuar në nenin 229

(1) Kushdo që pa autorizim blen ose posedon me qëllim shitje, shpërndarje ose ofron për shitje substanca a preparate të cilat janë shpallur të rrezikshme, narkotike dhe substanca psikotropike dënohet me gjobë dhe me burgim prej një deri në pesë vjet.

(2) Kushdo që pa autorizim shpërndan, shet, transporton ose dërgon substanca a preparate të cilat janë shpallur të rrezikshme, narkotike ose substanca psikotrope me qëllim shpërndarjeje, shitjeje ose ofertë për shitje dënohet me gjobë dhe me burgim prej një deri në tetë vjet.

(3) Kushdo që pa autorizim eksporton ose importon substanca a preparate të cilat janë shpallur të rrezikshme, narkotike ose substanca psikotrope dënohet me gjobë dhe burgim prej tre deri në dhjetë vjet.

(4) Nëse vepra penale nga paragrafi 1, 2, ose 3 i këtij neni kryhet në një ose në më shumë rrethana të mëposhtme, kryerësi dënohet me gjobë dhe me burgim prej tre deri në pesëmbëdhjetë vjet kur:

1) Kryerësi vepron si anëtar i një grupi;

1637. Gjykata konsideron se veprimet e kryera nga N.K. i përmbushin karakteristikat e eksportit të narkotikëve, pasi që përfshijnë transportimin trans-kufitar të heroinës. Duhet theksuar se KPPK nuk e përmban përkufizimin e shprehjes “grup” edhe pse e ka përkufizuar “grupin e strukturuar” dhe “grupin terrorist”. Për këtë arsye, duhet të zbatohet kuptimi i fjalëpërfjalshëm i kësaj shprehjeje, që do të thotë, një numër njerëzish që konsiderohen ose klasifikohen së bashku. Për këto arsye, veprimi i kryer nga N.K. duhet të klasifikohet si vepër penale e përcaktuar me nenin 229 paragrafët 3 dhe 5 dhe duhet të dënohet sipas paragrafit 4.1.

1638. Kryerja e krimit së bashku me disa persona të tjerë duhet të klasifikohet në KPPK si Pjesëmarrje në grup të organizuar kriminal sipas nenit 274 paragrafit 1 të KPRK-së. Ky krim është i dënueshëm me gjobë deri në 250,000 EUR dhe me

së paku 7 vjet burgim.

1639. Sipas nenit 90 paragrafit 2 të KPPK-së, ndjekja penale e veprës penale e cila i atribuohet të akuzuarit parashkruhet pas 15 viteve nga kryerja e saj.

KPRK

1640. Sipas KPRK-së, vepra e kryer nga i akuzuari i plotëson karakteristikat e veprës së përcaktuar me nenin 273 paragrafin 3:

Kushdo që pa autorizim eksporton ose importon substanca apo preparate të cilat janë shpallur me ligj si narkotikë, substanca psikotropike ose substanca analoge, dënohet me gjobë dhe me burgim prej tre (3) deri në dhjetë (10) vjet.

1641. Kryerja e krimit së bashku me disa persona të tjerë i përmbush karakteristikat e Pjesëmarrjes në ose organizimi i grupit kriminal të organizuar sipas nenit 283 paragrafit 1 të KPRK-së e cila është e dënueshme me gjobë deri në 250,000 EUR dhe me burgim prej së paku 7 vjet.

1642. Neni 106 paragrafi 1.2 i KPRK-së e parasheh parashkrimin pas 10 viteve nga kryerja e veprës penale të dënueshme me më shumë se dhjetë (10) vjet burgim dhe parasheh parashkrimin pas 20 viteve nga kryerja e veprës penale të dënueshme me më shumë se dhjetë (10) vjet burgim.

Përcaktimi i ligjit më të favorshëm

1643. Ekziston një parim i përcaktuar fuqishëm i zbatimit të detyrueshëm të ligjit më të favorshëm material i cili ka qenë në fuqi në Kosovë gjatë periudhës nga kryerja e veprës penale deri te dënimi.

1644. Sipas nenit 4 të KPRSFJ-së:

“1. Ndaj kryerësit të veprës penale aplikohet ligji që ishte në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale;

2. Në qoftë se pas kryerjes së veprës penale është ndryshuar ligji, një ose disa herë, do të aplikohet ligji që është më i butë për kryerësin.”

1645. I njëjti parim është përsëritur në legjislacionin vijues p.sh. në nenin 2 paragrafët 1 dhe 2 të KPPK-së dhe në nenin 3 paragrafët 1 dhe 2 të KPRK-së.

1646. Ligji nuk e përcakton asnjë kriter për ta treguar ligjin më të favorshëm. Gjykata e ka ndjekur interpretimin i cili dikton marrjen në konsideratë të situatës specifike të të akuzuarit. E ka bërë të domosdoshëm një simulim të dënimit në përputhje me të dy legjislacionet relevante.

1647. Krahasimi i sanksioneve nga legjislacionet relevante e paraqet KPRSFJ si ligj më të butë në situatën e të akuzuarit. Jo vetëm që parasheh sanksionin më të butë për vënien e substancës narkotike në qarkullim, por gjithashtu e përjashton shqiptimin e dënimit të ndarë për kryerjen e kësaj vepre penale së bashku me disa persona të tjerë.

5.3. Përcaktimi i fajësisë

1648. Gjykata ka gjetur se N.K. ka qenë plotësisht në dijeni për veprimet e të gjithë personave të tjerë të përfshirë në vënien në qarkullim të drogave të rrezikshme narkotike, siç është paraqitur në pikën I të dispozitivit. Duhet të supozohet se ai e ka ditur se do të ketë persona të cilët do ta marrin dërgesën nga K2. Prandaj, ai ka vepruar me dashje të drejtpërdrejtë për të kryer këtë vepër penale. Nuk ekzistojnë rrethana të cilat do ta përjashtonin fajin e tij nga kjo vepër penale.

5.4. Caktimi i dënimeve

1649. Gjatë caktimit të dënimeve për të akuzuarin, gjykata ka pasur parasysh qëllimet e renditura në nenin 33 të KPRSFJ-së. Prioritet i është kushtuar nevojës për të shprehur gjykimin e shoqërisë për veprat penale, për të rritur moralin dhe për ta forcuar detyrimin për të respektuar ligjin. Trupi gjykues gjithashtu është udhëhequr nga parimi i parandalimit të përgjithshëm duke e pasur parasysh se aktgjykimi do të dekurajojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale.
1650. Gjkata i është përmbajtur obligimit të saj për të vlerësuar të gjithë faktorët lehtësues dhe rëndues, siç është përcaktuar me nenin 41 të KPRSFJ-së.
1651. Si rrethana rënduese në lidhje me veprën e vënies në narkotikëve në qarkullin, gjykata e ka marrë parasysh sasinë e kontrabandës, përfshirjen e shumë personave, metodën e sofistikuar të përdorur për fshehjen e drogës, kontekstin trans-kufitar të aktiviteti kriminal.
1652. Si faktor lehtësues, gjykata ka marrë parasysh kohën e kaluar nga kryerja e veprës penale. Që nga ajo kohë N.K. nuk është dënuar për ndonjë shkelje tjetër të ligjit që e dikton supozimin se ai ka zgjedhur që ta respektoj rendin juridik. Përveç kësaj, gjykata ka marrë parasysh sjelljen e të akuzuarit gjatë procedurës kundër tij, ku ai plotësisht i ka respektuar të gjitha kufizimet e shqiptuara ndaj tij.
1653. Duke e marrë parasysh si më lart, gjykata ka vendosur që të akuzuarit t'ia shqiptojë dënimin prej gjashtë (6) vjet burgim.
1654. Sipas nenit 50 paragrafit 1 të KPRSFJ-së, periudha e privimit të lirisë së N.K prej 13 majit 2013 deri më 27 qershor 2017, është llogaritur në dënimin e shqiptuar nga tij.

5.4.Shpenzimet

1655. Gjykata e ka bazuar vendimin e saj lidhur me shpenzimet e procedurës penale në dispozitat ligjore të cituara në dispozitiv.
1656. Shkalla dhe proporcioni midis paushallit të cilin i akuzuari është i obliguar ta paguaj dhe shpenzimeve të përgjithshme të procedurës është përcaktuar duke pasur parasysh numrin e akuzave për të cilat ai është liruar, dhe veprimeve hetimore dhe të të provuarit të cilat janë ndërmarrë për t'i vërtetuar këto akuza.
1657. Duke marrë parasysh të gjitha shpenzimet e bëra gjatë rrjedhës së procedurës, gjykata ka vendosur se i akuzuari do t'i paguaj shpenzimet në shumën prej 5000 (pesëmijë) euro.

Gjyqtarja e EULEX-it Anna Adamska-Gallant

Kryetare e trupit gjykues

Murlan Prizreni

Procesmbajtës

Personat e autorizuar mund të paraqesin ankesë kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, përmes Gjykatës Themelore të Prishtinës brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e dorëzimit të kopjes së aktgjykimit, sipas nenit 380 paragrafit (1) të KPPK-së.